

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje
të Rënda të Së Drejtës Humanitare
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-
Jugosllavisë që prej vitit 1991

Lënda Nr: IT-05-87/1-A
Data: 27 janar 2014
Origjinali: Anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësit Carmel Agius, Kryegjykatës
Gjykatësit Patrick Robinson
Gjykatësit Mehmet Güney
Gjykatësit Khalida Rachid Khan
Gjykatësit Bakhtiyar Tuzmukhamedov

Sekretari: Z. John Hocking

Aktgjykim i datës: 27 janar 2014

PROKURORI

k.

VLLASTIMIR GJORGJEVIQIT

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit:

Zj. Daniela Kravetz
Z. Kyle Wood
Zj. Priya Gopalan
Zj. Saeeda Verrall

Avokatëve të të Akuzuarit:

Z. Dragolub Gjorgjeviq
Z. Velko Gjurgjiq
Z. Russell Hopkins
Zj. Marie O'Leary

I. HYRJE	1
A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	1
B. APELET.....	2
1. Apeli i Gjorgjeviqit.....	2
2. Apeli i Prokurorisë	4
3. Seanca e Apelit.....	5
II. STANDARDI I SHQYRTIMIT TË APELIMEVE.....	6
III. “ARSYE TË FORTA” QË DHOMA E APELIT TË DEVIJOJË NGA JURISPRUDENCA E VET	11
A. HYRJE	11
B. LIGJI PËRKATËS.....	11
C. PIKA E DYTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: EKZISTENCA E NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE NË TË DREJTËN ZAKONORE NDËRKOMBËTARE	12
1. Hyrje	12
2. Pretendim për zbatim të gabuar të ligjit dhe të rëndësisë kushtuar jurisprudencës së Pasluftës së Dytë Botërore në Aktgjykimin e Apelit <i>Tadiq</i> . 13	13
(a) Argumentet e palëve.....	13
(b) Analizë	15
a. Pretendim për shpërfillje prej Dhomës së Apelit të metodologjisë së përdorur në Aktgjykimin e TUN-së dhe në kartën e TUN-së	15
b. Pretendim për interpretim të gabuar të Statutit të GJPN-së.....	17
c. Jurisprudenca pas Luftës së Dytë Botërore	20
3. Ekzistenca e arsyeve të forta për anashkalimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.....	24
(a) Argumentet e palëve.....	24
(b) Analizë	25
4. Pretendim për gabime në lidhje me natyrën e fajësisë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale	27
(a) Argumentet e palëve.....	27
(b) Analizë	27
5. Konkluzion	28
D. PIKA E GJASHTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT, PJESËRISHT: PRETENDIME PËR GABIME NË LIDHJE ME NGARKIMIN E PËRGJEGJËSISË PENALE ANËTARËVE TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE PËR KRIMET KRYER NGA AUTORËT FIZIKË,	28
1. Hyrje	28
2. Pretendim për kundërshti ndërmjet Aktgjykimit të Apelit <i>Bërgjanin</i> dhe Aktgjykimit të Apelit <i>Stakiq</i>	29
(a) Argumentet e palëve.....	29
(b) Analizë	30
3. Pretendim për gabim në mbështetjen në Aktgjykimin e Apelit <i>Martiq</i> dhe Aktgjykimin e Apelit <i>Krajishnik</i>	31
(a) Argumentet e palëve.....	31
(b) Analizë	32
4. Konkluzion	34
E. PIKA E TETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: FAJËSIA PËR KRIME ME SYNIM KONKRET NË BAZË TË KATEGORISË SË TRETË TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE	34
1. Argumentet e palëve.....	34
2. Analizë	36
3. Konkluzion	39
F. KONKLUZION.....	39

IV. PIKA E PARË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME EKZISTENCËN E NPK-SË.....	40
A. HYRJE	40
B. SHKELJA E MARRËVESHJEVE TË TETORIT	41
1. Argumentet e palëve.....	41
2. Analizë	42
C. NATYRA E RREZIKUT PREJ UÇK-SË	43
1. Argumentet e palëve.....	43
2. Analizë	44
D. NATYRA E RREZIKUT PREJ NATO-S.....	46
1. Argumentet e palëve.....	46
2. Analizë	46
E. REZULTANTJA E KUNDËRSHTIMEVE TË GJORGJEVIQIT	46
1. Argumentet e palëve.....	46
2. Analizë	47
V. PIKA E TRETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME NATYRËN, PIKËNISJEN, KOHËZGJATJEN DHE ANËTARËSINË E NPK-SË.....	50
A. HYRJE	50
B. NATYRA E PLANIT TË PËRBASHKËT	51
1. Argumentet e palëve.....	51
2. Analizë	52
C. PIKËNISJA DHE KOHËZGJATJA E NPK-SË.....	54
1. Argumentet e palëve.....	54
2. Analizë	54
D. ANËTARËSIA E NPK-SË	55
1. Argumentet e palëve.....	55
2. Analizë	55
E. KONKLUZION	57
VI. PIKA E KATËRT E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME SHUMËSINË E PERSONAVE.....	58
A. ARGUMENTET E PALËVE	58
B. ANALIZË.....	60
VII. PIKA E PESTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME QËLLIMIN E PËRBASHKËT	64
A. ARGUMENTET E PALËVE	64
B. ANALIZË.....	65
C. KONKLUZION	69
VIII. PIKA E GJASHTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT PJESËRISHT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME ATRIBUIMIN E KRIMEVE TË AUTORËVE TË DREJTPËRDREJTË, ANËTARËVE TË NPK-SË	70
A. HYRJE	70
B. ARGUMENTET E PALËVE	70
C. ANALIZË	71
D. KONKLUZION	74
IX. PIKA E SHTATË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME PËRFUNDIMIN SE VRASJET DHE PËRNDJEKJET ISHIN PJESË E QËLLIMIT TË NPK-SË.....	76
A. HYRJE	76

B. PRETENDIM PËR GABIM NË KONKLuzionIN SE VRASJA ISHTE Pjesë E Qëllimit të NPK-së.....	77
1. Argumentet e palëve.....	77
2. Analizë	78
C. PRETENDIM PËR KONKLuzion TË GABUAR SIPAS TË CILIT KRIMI I PËRNDJEKJES ISHTE Pjesë E Qëllimit të NPK-së.....	85
1. Argumentet e palëve.....	85
2. Analizë	86
D. KONKLuzion	90
X. PIKA E NËNTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME Pjesëmarrjen E GJORGJEVIQIT NË NPK	91
A. NËNPIKA 9(A): PRETENDIM PËR GABIME NË VLERËSIMIN PREJ DHOMËS GJYQËSORE TË STRUKTURËS SË MPB-SË DHE ROLIT TË GJORGJEVIQIT	92
1. Hyrje	92
2. Shtabi Ministror dhe roli i Gjorgjeviqit	93
(a) Hyrje	93
(b) Argumentet e palëve.....	95
(c) Analizë.....	97
3. Roli i Gjorgjeviqit në ngjarjet në Kosovë më 1998 dhe 1999	101
(a) Hyrje	101
(b) Argumentet e palëve.....	102
(c) Analizë.....	103
4. Pushteti mbi PJP-në dhe SAJ-in.....	105
(a) Argumentet e palëve.....	105
(b) Analizë	105
5. Sistemi i raportimit brenda MPB-së.....	107
(a) Argumentet e palëve.....	107
(b) Analizë	107
6. Kompetencat e ndihmësministrave	111
(a) Hyrje	111
(b) Argumentet e palëve.....	111
(c) Analizë.....	112
7. Kolegjiumi Ministror.....	117
(a) Hyrje	117
(b) Argumentet e palëve.....	117
(c) Analizë.....	117
8. Marrëveshjet e Tetorit.....	119
(a) Hyrje	119
(b) Argumentet e palëve.....	120
(c) Analizë.....	120
9. Konkluzion	121
B. NËNPIKA 9(B): PRETENDIM PËR GABIME TË DHOMËS GJYQËSORE NË VLERËSIMIN E KOMANDËS SË PËRBASHKËT DHE ROLIT TË GJORGJEVIQIT NË TË	121
1. Hyrje	121
2. Argumentet e palëve.....	122
3. Analizë	123
4. Konkluzion	127
C. NËNPIKA 9(C): PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME VEPRIMET E GJORGJEVIQIT MË 1998 SI BAZË PËR FAJËSINË E NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE PËR KRIME TË KRYERA MË 1999	128
1. Hyrje	128
2. Argumentet e palëve.....	128
3. Analizë	129
4. Konkluzion	131

D. NËNPIKA 9(D): PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME ARMATOSJEN E SERBËVE VENDAS DHE ÇARMATOSJEN E SHQIPTARËVE KOSOVARË	131
1. Hyrje	131
2. Analizë	131
(a) Pretendim për gabim në konkluzionin se çarmatosja e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosja e popullatës civile serbe kishin lidhje me NPK-në...	131
a. Argumentet e palëve	131
b. Analizë.....	132
(b) Pretendim për gabim në mbështetjen në çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosjen e popullatës civile serbe si faktor për pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në NPK	134
a. Hyrje	134
b. Argumentet e palëve.....	135
c. Analizë.....	136
3. Konkluzion	140
E. NËNPIKA 9(E): PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME INCIDENTIN E REÇAKUT DHE ROLIN E GJORGJEVIQIT NË TË	140
1. Hyrje	140
2. Pretendim për gabim në mbështetjen e konkluzionit për rolin e Gjorgjeviqit në realizmin e NPK-së në operacionin e Reçakut.....	141
(a) Argumentet e palëve.....	141
(b) Analizë	142
3. Pretendim për gabim në konkluzionin se 45 civilë shqiptarë kosovarë u vranë në Reçak më 15 janar 1999	144
(a) Argumentet e palëve.....	144
(b) Analizë	145
4. Pretendim për gabim në konkluzionin se kishte “vendngjarje të inskenuar” dhe se Gjorgjeviqi luajti rol në fshehjen e faktit të përdorimit të forcës së tepruar gjatë operacionit të Reçakut	146
(a) Hyrje	146
(b) Argumentet e palëve.....	147
(c) Analizë.....	147
5. Konkluzion	150
F. NËNPIKA 9(F): PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME ROLIN E GJORGJEVIQIT NË KRIMET E KRYERA NGA PARASHTARAKËT NË KOSOVË	151
1. Hyrje	151
2. Pretendim për gabime në lidhje me përgjegjësinë e Gjorgjeviqit për dislokimin e Akrepave	151
(a) Argumentet e palëve.....	151
(b) Analizë	153
3. Pretendim për gabim në fajësimin e Gjorgjeviqit për parashtarakë të tjerë që vepronin në Kosovë	157
(a) Hyrje	157
(b) Argumentet e palëve.....	158
(c) Analizë.....	159
4. Konkluzion	161
G. NËNPIKA 9(G): PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME ROLIN E GJORGJEVIQIT NË FSHEHJEN E KRIMEVE.....	161
1. Hyrje	161
2. Pretendim për konkluzion të gabuar se fshehja e kufomave përbënte kontribut në NPK	162
(a) Argumentet e palëve.....	162
(b) Analizë	163
3. Pretendim për gabime në lidhje me Shënimet e Grupit të Punës	167
(a) Hyrje	167

(b) Besueshmëria e Shënimeve të Grupit të Punës	168
a. Argumentet e palëve	168
b. Analizë	169
(c) Pretendim për gabim për përdorimin si provë të Shënimeve të Grupit të Punës	170
a. Argumentet e palëve	170
b. Analizë	171
c. Konkluzion	174
4. Roli i Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave	174
(a) Hyrje	174
(b) Pretendim për gabim në nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi mori pjesë në rivarrosjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të gjetura në një kamion- frigorifer në lumin Danub	175
a. Hyrje	175
b. Argumentet e palëve	175
c. Analizë	176
(c) Qendra e PJP-së në Petrovo Sello	178
a. Hyrje	178
b. Argumentet e palëve	179
c. Analizë	180
(d) Liqeni i Peruqacit	181
a. Hyrje	181
b. Argumentet e palëve	182
c. Analizë	184
(e) Përfundim	186
5. Pretendime për gabime në vlerësimin e rolit të Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave	186
(a) Argumentet e palëve	186
(b) Analizë	187
6. Përfundim	188
H. NËNPIKA 9(H): PRETENDIME PËR GABIME LIDHUR ME MOSMARRJEN PREJ GJORGJEVIQIT TË MASAVE PËR HETIMIN E KRIMEVE	189
1. Hyrje	189
2. Argumentet e palëve	189
3. Analizë	192
(a) Pretendime për gabime lidhur me praktikën e mosraportimit dhe moshetimit të krimeve të kryera nga forcat serbe	192
(b) Pretendime për gabime në lidhje me detyrimin e hetimit	195
(c) Pretendime për gabime lidhur me kontributin në NPK	196
4. Konkluzion	197
I. KONKLUZION	197
XI. PIKA E DHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: GABIME LIGJORE DHE FAKTIKE NË PËRFUNDIMIN SE GJORGJEVIQI KISHTË SYNIMIN E NEVOJSHËM PËR PËRGJEGJËSI PENALE BAZUAR NË NDËRMARRJEN E PËRBASHKËT KRIMINALE	199
A. HYRJE	199
B. PRETENDIM PËR GABIM NË MOSNXJERRJEN E PËRFUNDIMEVE TË NEVOJSHME OSE NË NXJERRJEN E PËRFUNDIMEVE PALEJUESHMËRISHT TË PAQARTA	200
1. Argumentet e palëve	200
2. Analizë	201
C. PRETENDIM PËR GABIME GJATË ANALIZIMIT TË SYNIMIT KRIMINAL TË GJORGJEVIQIT ...	204
1. Pretendime për mosmarrjen parasysh të disa pjesëve të dëshmisë gojore të Gjorgjeviqit dhënë gjatë procesit gjyqësor	205
(a) Argumentet e palëve	205

(b) Analizë	206
2. Pretendim për gabime gjatë vlerësimit të dijenisë së Gjorgjeviqit	207
(a) Hyrje	207
(b) Argumentet e palëve	207
(c) Analizë	208
a. Mosraportimi	208
b. Urdhrat e Gjorgjeviqit	209
c. Mediat serbe dhe raportet ndërkombëtare	210
(d) Përfundim	212
3. Pretendim për gabime në përfundimin se veprimet e Gjorgjeviqit vërtetuan se ai kishte synimin e duhur	212
(a) Hyrje	212
(b) Argumentet e palëve	212
(c) Analizë	214
D. PËRFUNDIM	216
XII. PIKA E DYMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PËRKUFIZIMI I TERMIT “CIVIL”	217
A. HYRJE	217
B. ARGUMENTET E PALËVE	217
C. ANALIZË	219
D. PËRFUNDIM	224
XIII. PIKA E TREMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIM LIDHUR ME KRIMIN E DËBIMIT	224
A. HYRJE	224
B. ARGUMENTET E PALËVE	225
C. ANALIZË	226
D. PËRFUNDIM	230
XIV. PIKA E KATËRMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME SYNIMIN KRIMINAL TË VRASJES	231
A. ARGUMENTET E PALËVE	231
B. ANALIZË	232
C. PËRFUNDIM	235
XV. PIKA E PESËMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT PJESËRISHT: PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME SHKATËRRIMIN E OBJEKTEVE TË RËNDËSISHME FETARE OSE KULTURORE	236
A. HYRJE	236
B. SYNIMI KRIMINAL I NEVOJSHËM PËR PËRNDJEKJE NËPËRMJET SHKATËRRIMIT PA SHKAK	236
1. Argumentet e palëve	236
2. Analizë	238
C. PËSHA E BARABARTË	240
1. Argumentet e palëve	240
2. Analizë	240
D. PËRFUNDIM	242
XVI. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR VERDIKTE FAJËSIE LIDHUR ME KRIME QË NUK FIGUROJNË SI AKUZA NË AKTAKUZË	243
A. ARGUMENTET E PALËVE	243
B. ANALIZË	244
1. Hyrje	244

2. Dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit.....	247
(a) Komuna e Prizrenit	248
a. Dushanovë	248
b. Sërbicë	249
c. Landovicë.....	249
(b) Komuna e Skënderajt.....	251
a. Klladërnice	251
b. Burojë dhe Tushilë	253
(c) Komuna e Gjakovës.....	254
(d) Komuna e Suharekës.....	255
a. Qyteti i Suharekës	256
b. Peqan	257
(e) Komuna e Gjilanit.....	258
(f) Komuna e Ferizajt	259
(g) Komuna e Rahovecit	260
(h) Komuna e Pejës	261
(i) Komuna e Deçanit.....	263
3. Vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit	263
(a) Qyteti i Gjakovës, komuna e Gjakovës.....	264
(b) Qyteti i Podujevës në komunën e Podujevës	265
(c) Krushë e Vogël, komuna e Rahovecit.....	266
(d) Qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës.....	268
4. Përndjekjet.....	269
(a) Pretendim për gabime të Dhomës Gjyqësor në verdiktet e fajësisë për përndjekje lidhur me vendndodhje që nuk përmenden në Aktakuzë	269
(b) Pretendim për verdikt të gabuar fajësie të Dhomës Gjyqësore për përndjekje nëpërmjet vrasjeve në Pastasellë të komunës së Rahovecit.....	270
(c) Pretendim për gabim në përfshirjen e vrasjeve në Pikën 5	271
(d) Pretendim për verdikte të gabuara fajësie për përndjekje përmes zhvendosjes së dhunshme	273
C. PËRFUNDIM.....	274

XVII. PIKA E SHTATËMBËDHJETË DHE PJESËRISHT PIKA E PESËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: KRIMET E DËBIMIT, VEPRIMEVE TË TJERA ÇNJERËZORE (ZHVENDOSJE E DHUNSHME), VRASJES DHE PËRNDJEKJES LIDHUR ME DISA VENDE KRIMESH

A. HYRJE	277
B. ANALIZË.....	278
1. Pretendim për gabime lidhur me krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit	278
(a) Bellanicë, komuna e Suharekës	280
(b) Vataj, komuna e Kaçanikut	281
(c) Leçinë, komuna e Skënderajt	283
(d) Guskë, komuna e Gjakovës	284
(e) Përlepnice, komuna e Gjilanit	285
(f) Nosalë, komuna e Gjilanit.....	286
2. Vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit	288
(a) Krushë e Vogël , komuna e Rahovecit	289
a. 25 mars 1999	289
b. 26 mars 1999	290
(b) Qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës.....	291
(c) Mejë, komuna e Gjakovës.....	293
(d) Komuna e Vushtrrisë	295

(e) Kotlinë, komuna e Kaçanikut.....	296
(f) Vataj, komuna e Kaçanikut.....	298
3. Përndjekja si krim kundër njerëzimit	299
(a) Xhamia në Celinë dhe xhamia në Bellacërkë, në komunën e Rahovecit, dhe xhamia në Rogovë në komunën e Gjakovës	300
(b) Xhamia në Landovicë, komuna e Prizrenit.....	302
(c) Xhamia e Hadumit dhe biblioteka e bashkëngjitur në qytetin e Gjakovës	304
(d) Xhamia në Llashticë, komuna e Gjilanit	306
C. PËRFUNDIM.....	308
XVIII. PIKA E TETËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME LGJORE LIDHUR ME FAJËSINË E SHUMËFISHTË.....	309
A. PRETENDIM PËR GABIME LGJORE LIDHUR ME VERDIKTE FAJËSIE NË BAZË TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE DHE NDIHMËS E INKURAJIMIT	309
1. Argumentet e palëve.....	309
2. Analizë	312
B. PRETENDIM PËR GABIME LGJORE NË SHPALLJEN E FAJËSISË SË SHUMËFISHTË PREJ DHOMËS GJYQËSORE BAZUAR NË NENIN 5 TË STATUTIT	314
1. Argumentet e palëve.....	315
2. Analizë	316
XIX. PIKA E PARË E APELIT TË PROKURORISË: PËRGJEGJËSI PENALE PËR PËRNDJEKJE PËRMES DHUNËS SEKSUALE.....	318
A. HYRJE	318
B. PRETENDIME PËR GABIME NË PËRFUNDIMET MBI DHUNËN SEKSUALE	319
1. Hyrje	319
2. Përkufizimi dhe elementët e dhunës seksuale	319
3. Vajza shqiptare kosovare nga kolona në komunën e Prishtinës.....	321
(a) Argumentet e palëve.....	321
(b) Analizë	322
4. Dy të rejtat shqiptare kosovare në Beleg.....	324
(a) Argumentet e palëve.....	325
(b) Analizë	326
C. PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME PËRFUNDIMET MBI PËRNDJEKJEN NËPËRMJET DHUNËS SEKSUALE	329
1. Hyrje	329
2. Pretendim për gabim ligjor në vlerësimin e provave të rëndësishme për përcaktimin e synimit diskriminues në lidhje me përdhunimin e Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14.....	330
(a) Hyrje	330
(b) Argumentet e palëve.....	330
(c) Analizë.....	332
3. A përbënte përndjekje dhuna seksuale e lartpërmendur	333
(a) Argumentet e palëve.....	333
(b) Analizë	335
a. Synimi diskriminues	335
i. Hyrje.....	335
ii. Dëshmitarja K20 dhe dy të rejtat e tjera shqiptare kosovare në Beleg ...	337
iii. Dëshmitarja K14.....	340
iv. Vajza shqiptare kosovare në një kolonë në komunën e Prishtinës	341
b. Kushtet <i>ombrellë</i> dhe pesha e barabartë	343
(c) Përfundim	344
D. PËRGJEGJËSIA E GJORGJEVIQIT	344
1. Hyrje	344
2. Probleme ligjore të ngritura nga Gjorgjeviqi.....	344

(a) Standardi i synimit kriminal në kuadrin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.....	344
a. Argumentet e palëve.....	344
b. Analizë.....	345
(b) Lidhja midis NPK-së dhe autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve të parashikueshme	346
a. Argumentet e palëve.....	346
b. Analizë.....	346
3. Pretendim për përgjegjësi penale të Gjorgjeviqit për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale	348
(a) Argumentet e palëve.....	348
(b) Analizë	349
E. PËRFUNDIM	353
XX. DËNIMI	355
A. HYRJE	355
B. LIGJI PËRKATËS DHE STANDARDI I RISHIKIMIT	355
C. PIKA E NËNTËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME PËRCAKTIMIN E DËNIMIT	356
1. Pretendim për gabime në konsiderimin e pozitës eprore të Gjorgjeviqit si faktor rëndues.....	356
(a) Argumentet e palëve.....	356
(b) Analizë	357
2. Pretendim për mosmarrje parasysh të rrethanave lehtësuese.....	359
(a) Argumentet e palëve.....	359
(b) Analizë	360
3. Pretendim për gabim në vlerësimin e rolit të Gjorgjeviqit krahasuar me rolin e të dënuarve në çështjen <i>Millutinoviqi dhe të tjerët</i>	360
(a) Argumentet e palëve.....	360
(b) Analizë	361
4. Pretendim për gabim lidhur me praktikën e dënimeve me burgim në RFJ.....	363
(a) Argumentet e palëve.....	363
(b) Analizë	363
5. Përfundim	364
D. PIKA E DYTË E APELIT TË PROKURORISË: DËNIMI I GJORGJEVIQIT ME 27 VJET BURGIM ËSHTË QARTAZI I PAMJAFTUESHËM.....	364
1. Argumentet e palëve.....	364
2. Analizë	367
3. Përfundim	369
E. NDIKIMI I KONKLUSIONEVE TË DHOMËS SË APELIT NË DËNIMIN E GJORGJEVIQIT	369
XXI. VENDIM.....	372
XXII. MENDIM PJESËRISHT MOSPAJTUES DHE I VEÇANTË I GJYKATËSIT MEHMET GÜNEY	382
1. Vrasja e 281 shqiptarëve Kosovarë gjatë Operacionit Reka	382
2. Verdikte të reja fajësie në apel në lidhje me krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale	383
3. Fajësi e shumëfishtë në lidhje me Nenin 5	384
4. Anëtarët e tjerë të NPK-së.....	384
XXIII. MENDIM MOSPAJTUES I GJYKATËSIT TUZMUKHAMEDOV	387
A. HYRJE	387
B. KONTRIBUTI I GJORGJEVIQIT NË PLANIN E PËRBASHKËT	387

1. Dislokimi i paraushtarakëve.....	387
(a) Konstatime të përgjithshme: kontributi në planin e përbashkët përmes dislokimit të personave që nuk ishin anëtarë të NPK-së.....	388
(b) Implikimi i Gjorgjeviqit në dislokimin e njësisve të tjera paraushtarake në Kosovë, përveç Akrepave	389
(c) Implikimi i Gjorgjeviqit në dislokimin e Akrepave.....	391
(d) Përfundim	393
2. Ngjarjet në Reçak.....	393
3. Fshehja e krimeve	396
C. KRIMET BAZË.....	397
1. Vrasje	397
(a) Hyrje	397
(b) Konstatime lidhur me ligjin përkatës	398
(c) Bellacërkë (komuna e Rahovecit).....	400
(d) Krushë e Vogël (komuna e Rahovecit).....	401
(e) Operacioni Reka (komuna e Gjakovës).....	402
(f) Komuna e Vushtrrisë	404
2. Shkatërrimi i xhamisë në Landovicë (Përndjekje).....	405
D. PËRGJEGJËSIA PENALE E GJORGJEVIQIT PËR PËRNDJEKJE NËPËRMJET DHUNËS SEKSUALE.....	407
XXIV. SHTOJCA A – HISTORIA PROCEDURALE.....	413
A. APELI.....	413
1. Përbërja e Dhomës së Apelit.....	413
2. Njoftimet për Apel.....	413
3. Dosjet	413
4. Vendime dhe Urdhra të Tjerë	414
5. Konferencë për Gjendjen	415
6. Seanca e Apelit.....	415
XXV. SHTOJCA B – FJALORI I TERMAVE	416
A. NGA JURISPRUDENCA	416
1. TPNJ.....	416
2. TPNR.....	422
3. Vendime lidhur me krime të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	425
4. GJPN.....	426
5. TSL	426
6. ECCC	426
7. GJND.....	426
8. Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut.....	427
<i>Cyprus v. Turkey</i> , European Commission of Human Rights, European Human Rights Reports, Vol. 4 (1982), pp 482-528 (“ <i>Cyprus v. Turkey case</i> ”).....	427
9. Nga jurisprudenca e shteteve.....	427
(a) Australi	427
(b) Izrael.....	427
B. BURIME TË TJERA.....	427
1. Botime	427
2. Dokumente të tjera.....	428
LISTA E TERMAVE TË PËRKUFIZUARA DHE SHKURTESAVE	429

I. HYRJE

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar Për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali” ose “TPNJ-ja”) ka marrë apelimet e paraqitura nga Vllastimir Gjorgjeviqi (“Gjorgjeviqi”)¹ dhe Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”)² kundër aktgjykimit të shqiptuar nga Dhoma Gjyqësore II më 23 shkurt 2011 në çështjen *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit* (përkatësisht “Aktgjykimi” dhe “Dhoma Gjyqësore”).³

A. Të dhëna të përgjithshme

2. Gjorgjeviqi u lind më 17 nëntor 1948 në Koznicë, në komunën Vlladiçin Han, në Serbi.⁴ Ai filloi karrierën në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë (“MPB”) më 1971.⁵ Më 11 shtator 1996, ai u emërua ndihmësm ministër i Brendshëm.⁶ Më 30 maj 1997, Gjorgjeviqi u caktua zëvendësues në postin e kreut të Drejtorisë së Sigurimit Publik të MPB-së (“RJB”), dhe më 27 janar 1998, u emërua shef i RJB-së.⁷ Ai ishte në këtë post deri më 30 janar 2001, kur u emërua këshilltar i ministrit të Brendshëm dhe anëtar i një organi bashkërendues për jugun e Serbisë.⁸ Gjithashtu në korrik 1997, Gjorgjeviqi u gradua gjeneralkolonel duke u bërë kështu oficeri me gradën më të lartë në MPB në atë kohë.⁹

3. Ngjarjet që kanë të bëjnë me apelimet e lartpërmendura ndodhën në Kosovë gjatë periudhës 1 janar - 20 qershor 1999. Prokuroria formuloi akuza kundër Gjorgjeviqit për krimet që vijnë më poshtë kundër njerëzimit në kuadër të Nenit 5 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”): dëbim në bazë të paragrafit d të Nenit 5 (Pika 1); veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në bazë të paragrafit 1 të Nenit 5 (Pika 2); vrasje në bazë të paragrafit a të Nenit 5 (Pika 3); dhe përndjekje për arsye politike, racore dhe fetare në bazë të paragrafit h të Nenit 5 (Pika 5).¹⁰ Gjithashtu, Prokuroria e akuzoi Gjorgjeviqin për vrasje si shkelje e ligjeve ose

¹ Njoftimi për Apel i Vllastimir Gjorgjeviqit, 24 maj 2011 (“Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit”); Dosja e Apelit të Vllastimir Gjorgjeviqit, 15 gusht 2011 (konfidenciale, e dorëzuar në formë publike të redaktuar më 23 janar 2012) (“Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit”) (bashkërisht, “Apeli i Gjorgjeviqit”).

² Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 24 maj 2011 (“Njoftimi për Apel i Prokurorisë”); Dosja e Apelit të Prokurorisë, 15 gusht 2011 (konfidenciale, e dorëzuar në formë publike të redaktuar më 17 gusht 2011) (“Dosja e Apelit të Prokurorisë”) (bashkërisht, “Apeli i Prokurorisë”).

³ *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Aktgjykimi Publik me Shtojcë Konfidenciale, 23 shkurt 2011.

⁴ Aktgjykimi, para. 2209.

⁵ Aktgjykimi, para. 2209.

⁶ Aktgjykimi, para. 38, 2209.

⁷ Aktgjykimi, para. 40, 2209.

⁸ Aktgjykimi, para. 40, 2209.

⁹ Aktgjykimi, para. 43, 2209.

¹⁰ *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda Nr. IT-05-87/1-PT, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt, 9 korrik 2008 (“Aktakuza”), f. 8-20.

zakoneve të luftës në kuadër të Nenit 3 të Statutit (Pika 4).¹¹ Në Aktakuzë Gjorgjeviqi akuzohet për përgjegjësi në këto krime si në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 (planifikim, nxitje, urdhërim, ndihmë dhe inkurajim dhe kryerje nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale), po ashtu edhe në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 (mosparandalimi ose mosndëshkimi i krimeve të kryera nga vartësit).¹²

4. Dhoma Gjyqësore konkludoi se në më shumë se 40 lagje, fshatra dhe qytete të 14 komunave të ndryshme në Kosovë u kryen krime dhe përcaktoi se “rreth 724 banorë shqiptarë kosovarë u vranë dhe se qindra mijëra të tjerë u shpërngulën brenda Kosovës apo përtej kufijve [në Shqipëri, ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë (“IRJM”) ose në Mal të Zi]”.¹³ Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se Gjorgjeviqi mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me qëllim që synonte ndryshimin e përbërjes etnike në Kosovë për të mundësuar kontrollin serb mbi krahinën (“NPK”).¹⁴ Kjo u arrit përmes kryerjes së vrasjeve të paligjshme, dëbimeve, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), dhe përndjekjeve (nëpërmjet dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjeve të paligjshme dhe shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve me vlerë kulturore dhe fetare).¹⁵ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi i ndihmoi dhe inkurajoi këto krime.¹⁶ Më tej, Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin penalisht përgjegjës në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit për mosparandalimin dhe mosndëshkimin e krimeve të kryera nga pjesëtarë të MPB-së nën pushtetin e tij.¹⁷ Gjithsesi Dhoma Gjyqësore formuloi verdikte fajësie për të gjitha pikat vetëm mbi bazën e paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit, e në të njëjtën kohë e konsideroi faktor rëndësues pozitën eprore të Gjorgjeviqit gjatë përcaktimit të dënimit.¹⁸ Dhoma Gjyqësore shqiptoi një dënim të vetëm me 27 vjet burgim.¹⁹

B. Apelet

1. Apeli i Gjorgjeviqit

5. Gjorgjeviqi ka paraqitur apel me 19 pika kundër Aktgjykimit.²⁰ Së pari, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në përfundimin se NPK-ja ekzistonte.²¹ Së dyti, Gjorgjeviqi argumenton se megjithëse Dhoma Gjyqësore ishte e detyruar të bazohej në jurisprudencën e

¹¹ Aktakuza, f. 15-19.

¹² Aktakuza, para. 16-22.

¹³ Aktgjykimi, para. 2212.

¹⁴ Aktgjykimi, para. 2003, 2130, 2134, 2149, 2152, 2193, 2210, 2213.

¹⁵ Aktgjykimi, para. 2130, 2149, 2193, 2213.

¹⁶ Aktgjykimi, para. 2194.

¹⁷ Aktgjykimi, para. 2195.

¹⁸ Aktgjykimi, para. 2195.

¹⁹ Aktgjykimi, para. 2231.

²⁰ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit.

²¹ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 5-11; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 6-19.

Tribunalit për të gjitha kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ekzistojnë arsye bindëse që Dhoma e Apelit të devijojë nga vendimet e veta të mëparshme ku vërtetohet se fajësia në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ekziston në të drejtën zakonore ndërkombëtare.²² Së treti, ai pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktik në lidhje me natyrën, periudhën kohore dhe anëtarësinë e NPK-së.²³ Së katërti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar për ekzistencën e një “shumësie personash” në kontekstin e NPK-së.²⁴ Së pesti, ai argumenton se Dhoma Gjyqësori gaboi në nxjerrjen e përfundimit se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin qëllim të përbashkët të NPK-së.²⁵ Së gjashti, ai pretendon se Dhoma Gjyqësore zbatoi gabimisht ose në fund të fundit shtrembëroi ligjin përse i përket fajësimit të anëtarëve të NPK-së për krime të kryera fizikisht nga individë të cilët nuk ishin anëtarë.²⁶ Së shtati, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimet e vrasjes dhe përndjekjeve ishin brenda kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁷ Së teti, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke lejuar fajësinë brenda kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret.²⁸ Në pikën e nëntë dhe të dhjetë të apelit të tij, Gjorgjeviqi paraqet një sërë argumentesh kundër pjesëmarrjes së tij në NPK.²⁹ Në pikën e njëmbëdhjetë të apelit, Gjorgjeviqi apelon konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me ndihmën dhe inkurajimin.³⁰ Në pikat 12-15 të apelit të tij, Gjorgjeviqi paraqet argumente në lidhje me përkufizimin e termit “civil”,³¹ shpërnguljen përtej një kufiri *de facto* në lidhje me krimin e dëbimit,³² paramendimin në lidhje me krimin e vrasjes së paligjshme,³³ dhe në lidhje me elementët e krimit të përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve fetare.³⁴ Në pikën e gjashtëmbëdhjetë të apelit, Gjorgjeviqi trajton incidente konkrete që pretendohet se nuk janë përfshirë në Aktakuzë.³⁵ Pika e shtatëmbëdhjetë e apelit të tij përmban pretendime për gabime në lidhje me vende konkrete krimesh.³⁶ Pika e tetëmbëdhjetë e apelit të Gjorgjeviqit ka të bëjë me fajësinë e njëkohshme dhe të shumëfishtë.³⁷ Në pikën e nëntëmbëdhjetë të apelit të tij,

²² Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 12-17; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 20-77.

²³ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 18-27; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 78-88.

²⁴ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 28-32; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 89-99.

²⁵ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 33-36; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 100-107.

²⁶ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 37-41; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 108-129.

²⁷ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 42-49; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 130-146.

²⁸ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 50-52; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 147-155.

²⁹ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 53-85; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 156-295.

³⁰ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 86-88; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 296-303.

³¹ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 89-94; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 304-319.

³² Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 95-97; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 320-328.

³³ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 98-100; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 329-343.

³⁴ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 101-105; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 344-351.

³⁵ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 106-112; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 352-361.

³⁶ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 113-119 (pretendohet se përfundimet faktike të Dhomës Gjyqësore nuk mbështesin konkluzionet përfundimtare të Dhomës në lidhje me disa vende krimesh); shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 362-379.

³⁷ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 120-125; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 380-406.

Gjorgjeviqi pretendon për një sërë gabimesh ligjore dhe faktike në përcaktimin e dënimit të tij.³⁸

6. Në përgjigjen e vet, Prokuroria ndër të tjera argumenton se apeli i Gjorgjeviqit duhet rrëzuar në tërësi sepse argumentet e tij “janë pa vlerë”.³⁹

7. Në kundërpërgjigje, Gjorgjeviqi parashtron se Prokuroria nuk ka mundur të provojë si të gabuar asnjë nga argumentet e apelit të tij.⁴⁰

2. Apeli i Prokurorisë

8. Apeli i Prokurorisë kundër Aktgjyqimit përbëhet prej dy pikash. Së pari, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktik dhe ligjor me mosnxjerrjen e konkluzionit se ekzistonin prova të mjaftueshme që vërtetonin se së paku pesë femra shqiptare kosovare ishin përndjekur nëpërmjet dhunës seksuale.⁴¹ Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi është fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale, krim kundër njerëzimit në kontekstin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁴² Së dyti, Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi në dhënien e një dënimi qartazi të papërshtatshëm kundrejt peshës së krimeve dhe rolit të Gjorgjeviqit në to.⁴³ Prokuroria kërkon që Dhoma Gjyqësore të shtojë dënimin e Gjorgjeviqit në burgim të përjetshëm.⁴⁴

9. Në përgjigje, Gjorgjeviqi argumenton se Prokuroria nuk ka arritur të provojë gabime në pjesët e apeluara të Aktgjyqimit dhe gjithsesi, Dhoma e Apelit nuk ka kompetencë të shpallë verdikte të reja fajësie ose të zgjasë dënimin kur nuk ekziston e drejta për apelim të mëtejshëm.⁴⁵

10. Në kundërpërgjigje, Prokuroria argumenton se në bazë të Statut dhe jurisprudencës së konsoliduar dhe në kundërshtim me argumentet e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit ka kompetencë për shpalljen e verdikteve të reja të fajësisë dhe zgjatjen e dënimeve, dhe e ka ushtruar rregullisht këtë kompetencë.⁴⁶ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk ka

³⁸ Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit, para. 126-140; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-426.

³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, 26 shtator 2011 (konfidenciale, e dorëzuar në formë publike të redaktuar më 30 janar 2012) (“Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë”), para. 8.

⁴⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 tetor 2011 (konfidenciale; riklasifikuar publike më 9 shkurt 2012) (“Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit”).

⁴¹ Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 2-3; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1.

⁴² Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 3; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1, 4-56.

⁴³ Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 4; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 2, 57-96.

⁴⁴ Njoftimi për Apel i Prokurorisë, para. 4; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 2, 57-96.

⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 shtator 2011 (konfidenciale, e dorëzuar në formë publike të redaktuar më 30 janar 2012) (“Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit”), para. 3-6.

⁴⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, 26 tetor 2011 (konfidenciale, e dorëzuar në formë publike të redaktuar më 8 shkurt 2012) (“Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë”), para. 1.

mundur të tregojë arsyen pse Dhoma e Apelit nuk duhet të veprojë kështu edhe në këtë çështje.⁴⁷

3. Seanca e Apelit

11. Më 13 maj 2013, Dhoma e Apelit dëgjoi parashtrime gojore të palëve në lidhje me apelet.

12. Pas shqyrtimit të parashtrimeve me shkrim dhe gojore të Prokurorisë dhe Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit paraqet më poshtë Aktgjykimin e vet.

⁴⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 1.

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT TË APELIMEVE

13. Në Nenin 25 të Statutit përcaktohet se Dhoma e Apelit mund të lërë në fuqi, të shfuqizojë ose të ndryshojë vendimet e marra nga një dhomë gjyqësore. Dhoma e Apelit rikujton se faza e apelimit nuk është gjykim *de novo*.⁴⁸ Dhoma e Apelit shqyrton vetëm gabimet ligjore që mund të zhvlerësojnë vendimin e dhomës gjyqësore dhe gabimet faktike që kanë rezultuar në dështim të drejtësisë.⁴⁹ Këto kritere janë të përcaktuara në Nenin 25 të Statutit dhe janë të rrënjësura në jurisprudencën si të Tribunalit, po ashtu edhe të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”).⁵⁰ Në rrethana të jashtëzakonshme, Dhoma e Apelit gjithashtu shqyrton apeline ku një nga palët ngre një problem ligjor që nuk rezulton në zhvlerësimin e aktgjykimit të dhomës gjyqësore, por që gjithsesi ka rëndësi të përgjithshme për jurisprudencën e Tribunalit.⁵¹

14. Pala që pretendon për ekzistencën e një gabimi ligjor duhet të identifikojë gabimin e pretenduar, të paraqesë argumentet mbështetëse dhe të shpjegojë se në çfarë mënyre ky gabim e bën të pavlefshëm vendimin.⁵² Një pretendim për gabim ligjor që nuk ka asnjë gjasë të ndryshojë rezultatin e një vendimi, mund refuzohet pikërisht për këtë arsye.⁵³ Gjithsesi, edhe në qoftë se një palë paraqet argumente të pamjaftueshme në mbështetje të pretendimit të vet, Dhoma e Apelit mund të konkludojë për ekzistencën e një gabimi ligjor nisur nga arsye të tjera.⁵⁴ Është e nevojshme që apeliuesi që pretendon ekzistencën e një gabimi ligjor bazuar në

⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 13.

⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 10.

⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 6; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Seromba*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 11. Shih Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 11.

⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 7. Shih Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 8.

⁵² Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 20; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 8.

⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 20; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 7. Shih Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 8.

⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 20; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski*

mungesë të një mendimi të arsyetuar. të identifikojë konkretisht aspektet, përfundimet faktike ose argumentet të cilat sipas tij dhoma gjyqësore nuk i mori parasysh dhe të shpjegojë pse mosmarrja parasysh e këtyre faktorëve zhvlerëson vendimin.⁵⁵

15. Dhoma e Apelit shqyrton përfundimet ligjore të dhomës gjyqësore për të përcaktuar nëse janë të sakta ose të gabuara.⁵⁶ Në qoftë se Dhoma e Apelit konstaton një gabim ligjor në aktgjykimin e dhomës gjyqësore që ka rezultuar prej zbatimit të standardit të gabuar ligjor, Dhoma e Apelit parashtron standardin e duhur ligjor dhe në përputhje me këtë standard rishikon përfundimet faktike përkatëse të dhomës gjyqësore.⁵⁷ Në këtë mënyrë, Dhoma e Apelit jo vetëm që korrigjon gabimin ligjor, por kurdoherë që lind nevoja përdor standardin e duhur ligjor për provat e administruara gjatë fazës së gjykimit dhe vendos nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm mbi përfundimin ligjor të apeluar nga apeluesi para se ta konfirmojë këtë përfundim në apel.⁵⁸ Dhoma Gjyqësore nuk do të shqyrtojë sërish të gjitha provat e procesit gjyqësor, por si rregull do të marrë në shqyrtim vetëm provat e përmendura në një pjesë të aktgjykimit ose në shënimin përkatës nga dhoma gjyqësore dhe provat e administruara të përmendura nga palët.⁵⁹

16. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për gabime faktike, Dhoma e Apelit do të zëvendësojë përfundimin e dhomës gjyqësore me përfundimin e vet, vetëm në qoftë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në vendimin origjinal.⁶⁰ Dhoma e Apelit mbështetet

dhe *Tarçullovski*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana*, para. 8; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 8.

⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 20; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviç*, para. 7; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 9.

⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviç*, para. 8.

⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Oriç*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 9.

⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Oriç*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 9.

⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 21; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Galiç*, para. 8.

⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviç dhe të tjerët*, para. 22; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Llukiç dhe Llukiç*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe*

në të njëjtin standard arsyeshmërie në lidhje me pretendimet për gabime faktike, pavarësisht nga fakti nëse përfundimi faktik u bazua në prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta.⁶¹ Dhoma e Apelit nuk përmbys vendimet e Dhomës Gjyqësore për çfarëdo gabimi faktik, por vetëm për ato gabime që kanë rezultuar në dështim të drejtësisë.⁶²

17. Në përcaktimin e arsyeshmërisë së një konkluzioni të Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit nuk i ndryshon përfundimet faktike të Dhomës Gjyqësore pa pasur arsye të fortë.⁶³ Dhoma e Apelit kujton konkluzionin e formuluar si rregull i përgjithshëm nga Dhoma e Apelit në çështjen *Kupreshkiq dhe të tjerët* ku u shpreh si vijon:

bazuar në jurisprudencën e Tribunalit, detyra e dëgjimit, vlerësimit dhe peshimit të provave të paraqitura në gjyq i është lënë kryesisht Dhomës Gjyqësore. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit duhet të demonstrojë një farë respekti në lidhje me një përfundim faktik të Dhomës Gjyqësore. Vetëm në qoftë se provat e shfrytëzuara nga Dhoma Gjyqësore nuk do të mund të pranoheshin prej asnjë gjykuesi të arsyeshëm faktesh ose në qoftë se vlerësimi i provave është “tërësisht i gabuar”, Dhoma e Apelit mund ta zëvendësojë përfundimin e Dhomës Gjyqësore me përfundimin e saj,⁶⁴

18. I njëjti standard arsyeshmërie dhe e njëjta përparësi në lidhje me përfundimet faktike vlen edhe për apelin e Prokurorisë kundër një verdikti pafajësie.⁶⁵ Si rrjedhojë gjatë shqyrtimit të apelit të Prokurorisë, Dhoma e Apelit konstaton gabim faktik vetëm nëse nxjerr përfundimin se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në konkluzionin e apeluar.⁶⁶ Duke marrë parasysh se gjatë fazës së gjykimit i takon Prokurorisë që të provojë fajësinë e një të akuzuari jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, pesha e një gabimi faktik që

Shlivançanin, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 10.

⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 22; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11.

⁶² Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 22; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 10.

⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 14.

⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 30. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 10.

⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 10.

⁶⁶ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10.

rezulton në dështim të drejtësisë është disi e ndryshme midis rastit të prokurorisë që apelon një verdikt pafajësie dhe apeli të mbrojtjes që apelon një verdikt fajësie.⁶⁷ I akuzuari duhet të provojë se gabimet faktike të dhomës gjyqësore krijojnë dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë e tij.⁶⁸ Prokuroria duhet të provojë se pas marrjes parasysh të të gjitha gabimeve faktike të dhomës gjyqësore, eliminohet çfarëdo dyshimi i arsyeshëm për fajësinë e të akuzuarit.⁶⁹

19. Dhoma e Apelit kujton se ashtu sikurse u konkludua në çështjen *D. Millosheviq*:

ka kompetencë të vetvetishme në përzgjedhjen e argumenteve që meritojnë një arsyetim të hollësishëm me shkrim dhe se mund të hedhë poshtë argumente qartësisht të pabazuara pa dhënë arsyetim të hollësishëm.⁷⁰ Faktikisht mandati i Dhomës së Apelit nuk mund të përmbushet me efikasitet dhe rendiment pa kontributet e përqendruara të palëve. Që Dhoma e Apelit të shqyrtojë argumentet e një pale gjatë fazës së apelit, prej palës në fjalë pritet një paraqitje e qartë, logjike dhe tërësore e argumenteve. Dhoma e Apelit gëzon të drejtën të rrëzojë argumentet si të pabazuara dhe pa dhënë arsyetim të hollësishëm në qoftë se argumentet e një pale janë të paqarta, kundërtëne, të mjegullta ose kanë mangësi të tjera formale dhe të dukshme.⁷¹

20. Në lidhje me zbatimin e këtyre parimeve themelore, Dhoma e Apelit kujton se në çështjet e mëparshme ka identifikuar llojet e përgjithshme të argumenteve të mangëta në apel të cilat mund të rrëzohen pa analizë të hollësishme.⁷² Konkretisht, si rregull Dhoma e Apelit hedh poshtë: (i) argumente që nuk identifikojnë përfundimet faktike të apeluara, që shtrembërojnë përfundimet faktike ose provat, ose që shpërfillin përfundime faktike të tjera përkatëse; (ii) pretendimet se dhoma gjyqësore me siguri nuk ka marrë parasysh prova përkatëse, duke mos provuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh bazuar në prova, nuk do të

⁶⁷ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10.

⁶⁸ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10.

⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Seromba*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, para. 24.

⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 16, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 18, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 16, Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 16, Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 12. Shih Aktgjykimi i Apelit *Karaxhiq 98bis*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*, para. 13.

⁷¹ Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 16, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 17, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 16, Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 14, Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 13-14 dhe referencat e cituara atje, Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 12. Shih Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Mugenzi dhe Mugiraneza*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 12.

⁷² Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 27; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 13.

kishte arritur në të njëjtin përfundim si ai i dhomës gjyqësore; (iii) apeline kundër përfundimeve faktike të cilat nuk janë bazë e një verdikti fajësie dhe argumente që janë qartësisht të parëndësishme që mbështesin ose që nuk janë në kundërshtim me përfundimin e apeluar; (iv) argumente që apelojnë kundër mbështetjes ose mosmbështetjes prej dhomës gjyqësore në një provë pa ofruar shpjegim pse provat e tjera janë të pamjaftueshme si bazë e verdiktit të fajësisë; (v) argumente që shkojnë kundër gjykimit të shëndoshë; (vi) apeline kundër përfundimeve faktike rëndësia e të cilëve është e paqartë dhe nuk është shpjeguar nga apeluasi; (vii) përsëritje argumentesh që u refuzuan në fazën e gjykimit duke mos provuar se refuzimi i tyre nga dhoma gjyqësore përbën gabim që përlligj ndërhyrjen e Dhomës së Apelit; (viii) akuza të bazuara në materiale që nuk janë ndër provat e administruara gjyqësore; (ix) thjesht pretendime të pabazuara në prova, deklarata të pashtjelluara, mosqartësimi i gabimeve; dhe (x) thjesht përsëritje se dhoma gjyqësore nuk u kushtoi rëndësi të mjaftueshme provave, ose nuk i interpretoi provat sipas një mënyre të caktuar.⁷³

21. Së fundi në rastet kur Dhoma e Apelit konstaton se në një pikë apeli për të cilën argumentohet se përbën pretendim për gabim ligjor, nuk është formuluar një kundërshtim ligjor i qartë, por janë apeluar përfundime faktike të dhomës gjyqësore në kontekstin e vlerësimit të provave prej dhomës gjyqësore, Dhoma e Apelit ose do t'i analizojë këto parashtrime për të qartësuar arsyeshmërinë e konkluzioneve të apeluara, ose do t'i referohet analizës përkatëse në pikat e tjera të apelit.⁷⁴

⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 27; Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 17; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 17-27; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 14-21; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 18-24; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 17-31; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 256-313.

⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit *D Millosheviq*, para. 18. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 252, 269.

III. “ARSYE TË FORTA” QË DHOMA E APELIT TË DEVIJOJË NGA JURISPRUDENCA E VET

A. Hyrje

22. Në të tërë apelimin e tij, Gjorgjeviqi vijimësisht parashtron se ekzistojnë arsye bindëse që Dhoma e Apelit të mos i përmbahet jurisprudencës së vet të mëparshme. Konkretisht në pikën e dytë, të gjashtë dhe të tetë të apelit të tij, Gjorgjeviqi paraqet një sërë argumentesh sipas të cilave Dhoma e Apelit duhet të devijojë nga jurisprudenca e vet në lidhje me disa aspekte të kategorisë së parë dhe kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁷⁵ Duke marrë parasysh vijimësinë e këtyre parashtrimeve si dhe shpeshtësinë e argumenteve lidhur me ekzistencën e arsyeve të forta të ngritura në apel,⁷⁶ Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë argumentet e lartpërmendura në këtë pjesë të Aktgjykimit, pas një parashtrimi përmbledhës të ligjit përkatës.

B. Ligji përkatës

23. Në jurisprudencën e Tribunalit është më se e provuar se në rrethana të jashtëzakonshme, Dhoma e Apelit mund të anashkalojë vendimet e veta të mëparshme në qoftë se ekzistojnë arsye të forta për këtë.⁷⁷ Në çështjen *Aleksovski*, Dhoma e Apelit konkludoi se “për hir të qartësisë dhe parashikueshmërisë, Dhoma e Apelit duhet të ndjekë vendimet e veta të mëhershme, mirëpo gjithashtu duhet të ketë lirinë që t’i anashkalojë këto vendime për arsye të forta duke vepruar në interes të drejtësisë”.⁷⁸ Në të njëjtën çështje, Dhoma e Apelit gjithashtu theksoi se “normalisht duhen ndjekur vendimet e mëparshme dhe devijimi prej tyre është përjashtim”.⁷⁹ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore “do të anashkalojë një vendim të mëparshëm vetëm pas një analize të imtësishme ligjore ku përfshihen edhe burimet e cituara ligjore dhe të fakteve”.⁸⁰

24. Në interpretimin e Dhomës së Apelit nocioni “arsye të forta” përmban faktorë që janë të qartë dhe bindës. Rrjedhimisht, arsyet e forta që diktojnë një anashkalim të vendimeve të mëparshme në interes të drejtësisë përfshijnë edhe rastin ku një vendim i mëparshëm u mor “mbi bazën e një parimi ligjor të gabuar” ose u mor *per incuriam*, gjegjësisht, “në mënyrë të

⁷⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 20-22, 32, 68-71, 110, 117, 129, 155.

⁷⁶ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 161-168; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 582-586;

Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 167-182; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 415-426.

⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 107; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 655; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 117.

⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 107. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 117.

⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 109. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 117.

⁸⁰ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 109.

gabuar sepse gjykatësi ose gjykatësit kishin informacion të gabuar për ligjin përkatës”.⁸¹ Pala që kërkon anashkalimin e një vendimi të mëparshëm prej Dhomës së Apelit, duhet të provojë ekzistencën e arsyeve të forta për hir të drejtësisë që përlligjin anashkalimin në fjalë.⁸²

C. Pika e dytë e apelit të Gjorgjeviqit: ekzistenca e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare

1. Hyrje

25. Në pikën e dytë të apelit të tij, Gjorgjeviqi argumenton se ndonëse Dhoma Gjyqësore ishte e detyruar të mbështetej në jurisprudencën ekzistuese të Dhomës së Apelit, ekzistojnë arsye të forta që Dhoma e Apelit të anashkalojë jurisprudencën e vet të mëparshme sipas të cilës në të drejtën zakonore ndërkombëtare një ndër format e kryerjes së krimit është edhe ndërmarrja e përbashkët kriminale.⁸³ Thelbi i argumentit të Gjorgjeviqit është se arsyetimi i shtjelluar në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* është “i përciptë dhe i paqartë” dhe gjithsesi nuk përbën bazë “për të gjitha nivelet e NPK-së të identifikuar në atë çështje”, e as “për zbatimin e mëpasshëm të NPK-së në çështjet lidhur me udhëheqjen ku i akuzuari është organizativisht dhe fizikisht larg një krimi dhe autori fizik nuk është anëtar i NPK-së”.⁸⁴ Për këto arsye, Gjorgjeviqi kërkon që Dhoma e Apelit: (i) të shfuqizojë të gjitha verdiktet e fajësisë së tij që bazohen në ndërmarrjen e përbashkët kriminale; ose ndryshe (ii) të shfuqizojë çfarëdo verdikti ekzistues fajësie “për të cilët është konkluduar (sipas pikave të tjera të apelit) se bazohen në kategorinë III të NPK-së”; ose (iii) të qartësojë se ndërmarrja e përbashkët kriminale është formë përgjegjësie dytësore dhe jo formë e kryerjes së krimeve dhe të bëjë ndryshimin përkatës në dënimin e tij.⁸⁵

26. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme që do të përlligjin një anashkalim të jurisprudencës së Dhomës së Apelit

⁸¹ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 108.

⁸² Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 655; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 117; Vendimi i Apelit *Millutinoviç dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 18.

⁸³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 20-23, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, Vendimi i Apelit *Millutinoviç dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 107-108. Gjithashtu, Gjorgjeviqi përmend një sërë vendimesh të tjera në mbështetje të argumentit të tij se Dhoma e Apelit ka të drejtë dhe duhet të anashkalojë jurisprudencën e vet të mëparshme në lidhje me këtë aspekt (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 24-27, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1040, *Laurent Semanza . Prokurorit*, Lënda nr. ITCR-97-20-A, Vendim, 31 maj 2000, para. 92-97 dhe Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 38, *Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit*, Lënda nr. IT-08-91-AR65.1, Vendim mbi Apelin e Miqo Stanishiqit Kundër Vendimit në lidhje me Mocionin e tij për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 11 maj 2011, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Robinson, para. 16, 21, *Prokurori k. Zoran Zhigiqit*, Lënda nr. IT-98-30/1-A, Vendim mbi “Mocion për Rishqyrtim të Aktgjyimit të Dhomës së Apelit IT-98-30/1-A Dorëzuar më 28 shkurt 2005”, i Zoran Zhigiqit 26 qershor 2006, para. 9).

⁸⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 21. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 29-31; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 10.

⁸⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 77.

në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale.⁸⁶ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se: (i) Dhoma Gjyqësore bëri vlerësim të drejtë të karakterit zakonor të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në çështjen *Tadiq*; (ii) kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale është formë e vërtetuar fajësie në të drejtën zakonore ndërkombëtare; dhe (iii) ndërmarrja e përbashkët kriminale është formë kryerjeje krimesh pavarësisht nga fakti se autorët fizikë të angazhuar në kryerjen e krimeve nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁸⁷

2. Pretendim për zbatim të gabuar të ligjit dhe të rëndësisë kushtuar jurisprudencës së Pasluftës së Dytë Botërore në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*

(a) Argumentet e palëve

27. Gjorgjeviqi parashtron se metodologjia e përdorur në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* për deduktimin e rregullave të së drejtës zakonore ndërkombëtare “kishte mangësi themelore”.⁸⁸ Ai argumenton se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* u bazua në burime thuajse të panjohura dhe të papublikuara dhe nuk shpjegoi se në çfarë mënyre vërtetoi ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare.⁸⁹ Ai paraqet tri argumente.⁹⁰

28. Së pari, ai pretendon se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* shpërfilli metodologjinë e përdorur nga Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar në Nuremberg (“TUN”) dhe Karta e këtij Tribunali (“Karta e TUN-së”), ku “pjesëmarrja në një plan të përbashkët” u penalizua vetëm në lidhje me “krimet kundër paqes” por jo në lidhje me “krimet e luftës” ose “krimet kundër njerëzimit”.⁹¹ Gjorgjeviqi gjithashtu pretendon se konstatimet e TUN-së në Aktgjykimin e TUN-së nuk ofrojnë bazë për konkluzionin se ndërmarrja e përbashkët kriminale është një ndër format e kryerjes së krimeve.⁹² Më tej, ai argumenton se Dhoma e Apelit gaboi kur rrëzoi një argument të ngjashëm në çështjen *Rwamakuba*.⁹³

⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 32, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 108-109.

⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 35.

⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 29; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 10-17.

⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 29, 31.

⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 32-67.

⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 32-43, përmendet Karta e TUN-së, Neni 6, *The United States of America, the French Republic, the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland, and the Union of Soviet Socialist Republics against Herman Wilhelm Göring et al.*, Judgement, 1 October 1946, Trial of Major War Criminals Before the International Military Tribunal Under Control Council Law No. 10, Vol. 1 (1947) (“IMT Judgement”)/*Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Republika Franceze, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike kundër Herman Wilhelm Göring-ut dhe të tjerëve*, Aktgjykimi, 1 tetor 1946, Gjykimi i Kriminelëve më të Mëdhenj të Luftës në Tribunalin Ushtarak Ndërkombëtar Sipas Ligjit nr. 10 të Këshillit të Fuqive Aleate, Vëll. 1, (1947) (“Aktgjykimi i TUN-së”) Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 10-11.

⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 44.

⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 38, 43, përmendet Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 15; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 11.

29. Së dyti, Gjorgjeviqi pretendon se Aktgjykimi i Apelit *Tadiq* interpretoi dhe zbatoi në mënyrë të gabuar dispozitat e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (përkatësisht, “Statuti i GJNP-së” dhe “GJNP-ja”).⁹⁴ Gjorgjeviqi argumenton se Neni 25 i Statutit të GJNP-së i pasqyruar në vendimet e GJNP-së, “e mohon kategorikisht NPK-në si formë përgjegjësie kryesore”.⁹⁵ Më tej, ai argumenton se në ndryshim nga metodologjia e Tribunalit dhe TPNR-së, Neni 25(3)(d) i Statutit të GJNP-së ofron “një formë plotësuese dhe më të gjerë të përgjegjësisë dytësore se NPK-ja”⁹⁶ dhe se Neni 30 i Statutit të GJNP-së përjashton zbatimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁹⁷

30. Së treti, Gjorgjeviqi pretendon se Aktgjykimi i Apelit *Tadiq* u kushtoi rëndësi të tepër disa çështjeve gjyqësore të Pasluftës së Dytë Botërore si shembuj të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁹⁸ Gjithashtu ai mbështetet në pikëpamje akademike se çështjet që kanë të bëjnë me dhunën e grupit ose kampet e burgimit janë faktikisht shembuj të bashkautorësisë në përputhje me Nenin 25(3)(a) të Statutit të GJNP-së, mirëpo nuk mbështesin konceptin “e shpërhapur” të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të përdorur nga Tribunali dhe TPNR-ja.⁹⁹ Në lidhje me mbështetjen prej Dhomës së Apelit në jurisprudencën e çështjes *Einsatzgruppen* në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, Gjorgjeviqi i referohet Mendimit të Përbashkët të gjykatësit McDonald dhe gjykatësit Vohrah, bashkëngjitur Aktgjykimit të Apelit *Erdemoviq*, ku Aktgjykimi *Einsatzgruppen* konsiderohet “i karakterit ndërkombëtar ‘të diskutueshëm’” sepse në të u zbatua e drejta amerikane, dhe jo “thjesht e drejta ndërkombëtare”.¹⁰⁰ Gjithashtu, ai thekson se sidoqoftë, në çështjen *Tadiq* Dhoma e Apelit iu referua argumenteve hyrëse dhe përmbyllëse në çështjen *Einsatzgruppen* në vend të aktgjykimit të çështjes.¹⁰¹ Në lidhje me çështjen *Justice*, Gjorgjeviqi argumenton se në çështjen *Kunarac dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit refuzoi shprehimisht qëndrimin e sugjeruar në çështjen *Justice* ku një politikë apo një plan

⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 32, 46-55. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 12.

⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 53. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 47-52.

⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 54.

⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 54.

⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 56-67, përmendet *The United States of America v. Otto Ohlenforf et al.*, U.S. Military Tribunal, Judgement, 8 and 9 April 1948, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10, Vol. IV (“*Einsatzgruppen* case”), *The United States of America v. Alstoetter et al.*, U.S. Military Tribunal, Judgement, 3 and 4 December 1947, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10 (1951), Vol. III (“*Justice* case”), *The United States of America v. Greifelt et al.*, U.S. Military Tribunal, Judgement, 10 March 1948, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10 (1951), Vol. V (“*RuSHA* case”). Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 64 (argumentohet se këto çështje duhen marrë në konsideratë me rezervë sepse ato nuk pasqyrojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare, por mbështeten në të drejtën amerikane).

⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 57, përmendet J.S. Martinez/A.M. Danner, “Guilty Associations: Joint Criminal Enterprise, Command Responsibility, and the Development of International Criminal Law/Grupimet Fajtoke/ Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale, Përgjegjësia Eprorë dhe Zhvillimi i Së Drejtës Penale Ndërkombëtare”, 93 *California Law Review* 75 (2005), f. 110.

¹⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 59, citohet Aktgjykimi i Apelit *Erdemoviq*, Vendim i Përbashkët i Gjykatësit McDonald dhe Gjykatësit Vohrah, para. 53-54.

¹⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 60, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 200, sh. 245.

ishte element i nevojshëm i një krimi kundër njerëzimit.¹⁰² Më tej ai shton se në çështjen *Bërgjanin*, Dhoma e Apelit u bazua gabimisht në çështjen *Justice* për nxjerrjen e konkluzionit se nuk është e nevojshme që autorët fizikë të jenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale sepse shihej qartë që çështja *Justice* nuk zbatoi teorinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁰³ Për më tepër, të akuzuarit në atë çështje nuk u shpallën fajtorë në lidhje me vende konkrete krimesh si në praktikën e Tribunalit, por u shpallën fajtorë për pjesëmarrje në një “sistem mizorie dhe padrejtësie”.¹⁰⁴ Së fundi në lidhje me çështjen *RuSHA*, Gjorgjeviqi pretendon se edhe sikur ky burim të konsiderohet me peshë, ai nuk mbështet konceptin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të zbatuar nga Dhoma e Apelit.¹⁰⁵ Gjithsesi dhe duke marrë në konsideratë të gjithë kushtëzimet në lidhje me vlerën e këtyre çështjeve, Gjorgjeviqi këmbëngul se asnjë prej këtyre çështjeve nuk mbështet ndërmarrjen e përbashkët kriminale si formë fajësie kryesore dhe se këto çështje nuk mund të gjejnë zbatim në çështje që kanë të bëjnë me udhëheqjen si çështja që gjykohet këtu.¹⁰⁶

31. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Tadiq* ndërmori një “analizë rrënjësore dhe të balancuar” të ligjit në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se Gjorgjeviqi vetëm përsërit argumentet që janë shqyrtuar dhe rrëzuar më parë.¹⁰⁷ Prokuroria argumenton se Dhoma e Apelit kishte marrë informacionin e duhur për ligjin në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe shqyrtoi në mënyrën e duhur Aktgjykimin e TUN-së dhe Kartën e TUN-së, Statutin e GJPN-së dhe jurisprudencën pas Luftës së Dytë Botërore.¹⁰⁸ Prokuroria shton se jurisprudenca e GJPN-së e cila bazohet në interpretimin e Statutit të GJPN-së, nuk ka vlerë në lidhje me analizimin e Aktgjykimit të Apelit *Tadiq* si dhe në lidhje me ligjshmërinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁰⁹

(b) Analizë

a. Pretendim për shpërfillje prej Dhomës së Apelit të metodologjisë së përdorur në Aktgjykimin e TUN-së dhe në kartën e TUN-së

¹⁰² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 61, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 98, sh. 114.

¹⁰³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 62.

¹⁰⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 62.

¹⁰⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 63. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 15.

¹⁰⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 66-67. Në kundërpërgjigje, Gjorgjeviqi gjithashtu pretendon se jurisprudenca e analizuar në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* dhe e cituar nga Prokuroria, është e pavlefshme sepse nuk mbështet shprehimisht fajësinë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe është marrë nga e drejta shtetërore dhe jo ndërkombëtare (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 15-17).

¹⁰⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 36, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 185-226. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 37-38, përmendet Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 29, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 659, Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 80-81.

32. Në lidhje me pretendimin e Gjorgjeviqit se në çështjen *Tadiq* Dhoma e Apelit shpërfilli faktin se TUN-ja “refuzoi” një formë fajësie të ngjashme me ndërmarrjen e përbashkët kriminale në lidhje me krimet e luftës ose krimet kundër njerëzimit,¹¹⁰ Dhoma e Apelit gjykon se ai ngatërron konceptin e komplotit dhe ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Dhoma e Apelit e ka qartësuar këtë dallim në Vendimin *Millutinoviqi dhe të tjerët* të 21 majit 2003.¹¹¹ Argumenti i Gjorgjeviqit se komploti dhe pjesëmarrja në një plan të përbashkët janë forma fajësie që u refuzuan në Aktgjykimin e TUN-së¹¹², bie duke iu referuar thjesht formulimit të përdorur në Aktgjykimin e TUN-së:

Pika një përmban jo vetëm akuzë për komplot për ndërmarrjen e agresionit, por edhe për kryerjen e Krimeve të Luftës dhe Krimeve Kundër Njerëzimit. Sidoqoftë Karta *nuk përkufizon komplotin si krim i veçantë përveçse për ndërmarrjen e akteve të agresionit*. Në Nenin 6 të Kartës përcaktohet:

‘Udhëheqësit, organizatorët, nxitësit dhe bashkautorët që marrin pjesë në formulimin ose zbatimin e një Plani apo Komploti të Përbashkët për kryerjen e cilitdo prej krimeve të lartpërmendura mbajnë përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga cilido person gjatë zbatimit të planit.’

Për mendimin e Tribunalit, këto fjalë *nuk shtojnë krime të ndryshme të veçanta nga krimet tashmë të renditura. Këto fjalë shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësinë e individëve që marrin pjesë në një plan të përbashkët*. Rrjedhimisht, Tribunali do të anashkalojë akuzat e Pikës Një se të pandehurit bënë marrëveshje për kryerjen e Krimeve të Luftës dhe Krimeve kundër Njerëzimit, dhe do të marrë parasysh vetëm planin e përbashkët për përgatitjen, nisjen dhe kryerjen e luftës agresive.¹¹³

Shihet qartë se TUN-ja e shtriu juridiksionin e vet në lidhje me *krimin* e komplotit vetëm ndaj akteve të agresionit. Gjithsesi, TUN-ja nuk përjashtoi që *fajësia* për shkak të pjesëmarrjes në një plan të përbashkët ishte e zbatueshme edhe për krime të tjera të përmendura në Kartën e vet.¹¹⁴ Në fund të fundit, interpretimi prej TUN-së i Kartës së vet nuk devijon nga zbatimi i njëtrajtshëm i doktrinës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale sipas Statutit dhe jurisprudencës së Tribunalit.

¹⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 39, përmendet Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 15, Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 195-223. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 40-51.

¹⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 45-49.

¹¹⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 37-38, citohet Aktgjykimi i TUN-së, f. 226. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 39-45.

¹¹¹ Vendimi i Apelit *Millutinoviqi dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 22-23.

¹¹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 38-43.

¹¹³ Aktgjykimi i TUN-së, f. 226 (theksi i shtuar).

¹¹⁴ Shih gjithashtu *The United States of America, the French Republic, the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland, and the Union of Soviet Socialist Republics against Herman Wilhelm Göring et al.*, International Military Tribunal, Indictment dated 6 October 1945, Trial of Major War Criminals Before the International Military Tribunal, Vol. 1/ *Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Republika Franceze, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike kundër Herman Wilhelm Göring-ut dhe të tjerëve*, Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar, Aktakuzë 1 tetor 1946, Gjykimi i Kriminelëve më të Mëdhenj të Luftës në Tribunalin Ushtarak Ndërkombëtar, Vëll. 1, (1947), Pikat 3 dhe 4, f. 42-68.

33. Gjithashtu Dhoma e Apelit i gjykon jobindëse citimet e shkrimeve akademike prej Gjorgjeviqit që sipas tij provojnë të kundërtën.¹¹⁵ Autorët e cituar nga Gjorgjeviqi nuk përcaktojnë shprehimisht se Aktgjykimi ose Karta e TUN-së përjashtuan fajësinë sipas një plani të përbashkët ose ndërmarrjeje të përbashkët kriminale. Faktikisht, atje diskutohet përdorimi i fjalës “komplot” dhe mungesa e një dispozite konkrete për fajësinë dytësore.¹¹⁶ Më tej, Dhoma e Apelit kujton se ndonëse në diskutimet mbi nxjerrjen e përfundimeve ligjore mund të merren parasysh shkrimet e akademikëve të njohur, është provuar se ato shërbejnë si material ndihmës dhe nuk kanë efekt detyrues ndaj Dhomës së Apelit.¹¹⁷ Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se në çfarë mënyre shkrimet e cituara akademike ofrojnë arsye të fortë për anashkalimin e jurisprudence ekzistuese të Tribunalit.

34. Gjithashtu, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma e Apelit gaboi në konkluzionin e nxjerrë në Vendimin e vet *Rwamakuba* të 22 tetorit 2004, se aktgjykimet e TUN-së dhe çështja *RuSHA* “i shpallën të akuzuarit fajtorë [...] mbi një bazë të barasvlershme me fajësinë sipas ndërmarrjes së përbashkët kriminale”.¹¹⁸ Dhoma e Apelit arsyetoi se ndonëse Aktgjykimi i TUN-së nuk përmendi konkretisht ndërmarrjen e përbashkët kriminale, “diskutimi faktik në atë çështje bëri të qartë se disa prej të akuzuarve u shpallën fajtorë për pjesëmarrje në një plan të gjerë për kryerje mizorish që përbënte gjenocid”.¹¹⁹ Duket se Gjorgjeviqi nuk pajtohet me këtë interpretim dhe pretendon se Dhoma e Apelit ishte “e keqinformuar” në nxjerrjen e konkluzionit të lartpërmendur,¹²⁰ mirëpo nuk faktin asnjë gabim përkatës.

b. Pretendim për interpretim të gabuar të Statutit të GJNP-së

35. Argumenti i Gjorgjeviqit se jurisprudenca e GJNP-së provon se interpretimi prej Dhomës së Apelit në çështjen *Tadiq* i të drejtës zakonore ndërkombëtare në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale, është jobindës. Sikurse shtjellohet më poshtë,¹²¹ Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* e bazoi analizën e vet në burime të ndryshme ndër të cilat në

¹¹⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 40, 42, 44.

¹¹⁶ R. Cryer / H. Friman / D. Robinson / E. Wilmschurst, *Një Paraqitje e Së Drejtës dhe Procedurës Penale Ndërkombëtare*. (Cambridge University Press 2007), f. 304-305; H. Olásolo, *The Criminal Responsibility of Senior Political and Military Leaders as Principals to International Crimes/Përgjegjësia Penale e Udhëheqësve të Lartë Politikë dhe Usharakë si Autorë Kryesorë të Krimeve Ndërkombëtare* (Hart Publishing, 2009), p. 213.

¹¹⁷ Në paragrafin 1 të Nenit 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (“GJND”), që konsiderohet si pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare, ndër të tjera përmenden: “teoritë e autorëve më të shquar të vendeve të ndryshme si mjet ndihmës në përcaktimin e rregullave të së drejtës”. Shih Aktgjykimi *Kupreshkiqi dhe të tjerët*, para. 540; Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 414; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 227; Aktgjykimi *Aleksovski*, Deklaratë e Gjykatësit Hunt, para. 2; Aktgjykimi i Apelit *Erdemoviç*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit McDonald dhe Gjykatësit Vohrah, para. 43. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kërstić*, para. 11, sh. 20.

¹¹⁸ Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 15.

¹¹⁹ Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 23, përmendet Aktgjykimi i TUN-së, f. 226-228.

¹²⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 43; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 11.

¹²¹ Shih më poshtë, para. 40-45.

jurisprudencën e TUN-së dhe jurisprudenca të tjera të pasluftës së dytë botërore, legjislacion dhe jurisprudencë shtetërore dhe konventa ndërkombëtare, për të vërtetuar se ndërmarrja e përbashkët kriminale ishte formë e vlefshme fajësie në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹²² Në këtë kontekst u analizua edhe Statuti i GJPN-së duke marrë parasysh faktin se në kohën përkatëse ai ishte vetëm një traktat pa fuqi detyruese që shërbente për të bërë të njohur qëndrimin juridik të shteteve nënshkruese.¹²³

36. Përmbledhtazi, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* pa arsye iu referua paragrafit 3 të Nenit 25 të Statutit të GJPN-së në mbështetje të përfundimit të saj se ndërmarrja e përbashkët kriminale është formë fajësie kryesore dhe jo dytësore.¹²⁴ Në pjesën përkatëse të Nenit 25 të Statutit të GJNP-së lexohet se:

një person është penalisht përgjegjës dhe i ndëshkueshëm për një krim brenda juridiksionit të gjykatës, në qoftë se ky person:

(a) Kryen një krim të tillë, vetë, së bashku me një tjetër, ose nëpërmjet një personi tjetër pavarësisht nga fakti nëse personi tjetër është ose nuk është penalisht përgjegjës;

(b) Urdhëron, kërkon ose nxit kryerjen e një krimi të tillë që faktikisht ndodh ose bëhet orvatje për kryerje;

(c) Për të mundësuar kryerjen e krimit, ndihmon, inkurajon ose ndryshe kontribuon në kryerjen e krimit ose në orvatjen për kryerje përfshirë edhe dhënien e mjeteve për kryerjen e krimit;

(d) Kontribuon në çfarëdo mënyre tjetër në kryerjen apo orvatjen për kryerje të një krimi të tillë nga një grup personash të cilët veprojnë me një qëllim të përbashkët. Një kontribut i tillë është i qëllimshëm dhe jepet ose:

(i) me synim realizimin e veprimtarisë ose qëllimit kriminal të grupit ku veprimtaria ose qëllimi kërkon kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të gjykatës; ose

(ii) ose duke qenë në dijeni të synimit të grupit për kryerjen e krimit;

(e) Në lidhje me krimin e gjenocidit, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nxit të tjerët për të kryer gjenocid;

(f) Orvatet të kryejë një krim të tillë nëpërmjet kryerjes së veprimeve që shënojnë pikënisjen e zbatimit në një mënyrë thelbësore, mirëpo krimi nuk ndodh për shkak të rrethanave që nuk kanë lidhje me synimet e personit. Gjithsesi një person që heq dorë nga orvatja për të kryer krim ose ndryshe parandalon kryerjen e krimit, nuk mbart fajësi të ndëshkueshme në bazë të Statutit për orvatje të kryerjes së krimit, në qoftë se ky person hoqi dorë tërësisht dhe me vullnet të lirë nga qëllimi kriminal.

37. Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* theksoi shprehimisht se elementët subjektivë dhe objektivë të përmendur në paragrafin 3 të Nenit 25 të Statutit të GJNP-së në njëfarë mase ishin të ndryshëm nga elementët në jurisprudencën e analizuar në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* në

¹²² Shih Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 194-226.

¹²³ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 223.

¹²⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 47-48, 52-53.

lidhje me qëllimin e përbashkët kriminal, dhe gjithsesi duheshin verifikuar nga jurisprudenca e GJPN-së.¹²⁵ Për më tepër, Dhoma e Apelit theksoi se teksti i miratuar në Statutin e GJPN-së ishte “në përputhje me pikëpamjen se kategoria e përgjegjësisë ndihmëse që diskutohet është më se e provuar në të drejtën ndërkombëtare dhe është e dallueshme nga ndihma dhe inkurajimi”.¹²⁶ Askund në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* nuk pohohet se paragrafi 3 i Nenit 25 të Statutit të GJPN-së parashtron të ashtuquajturën përgjegjësi kryesore, duke qenë se nuk u diskutua ky aspekt. Në fakt, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Apelit *Tadiq* ku përmendet Statuti i GJPN-së, trajtohet koncepti i një plani të përbashkët dhe pjesëmarrjes në të i ndryshëm nga fajësia e ndihmës dhe inkurajimit.¹²⁷ Si rrjedhojë, Gjorgjeviqi nuk ka provuar ekzistencën e ndonjë gabimi në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* në lidhje me interpretimin e kësaj dispozite.

38. Në lidhje me jurisprudencën e GJPN-së përmendur nga Gjorgjeviqi,¹²⁸ Dhoma e Apelit gjykon se kjo jurisprudencë nuk është me rëndësi për diskutimin nëse ekzistojnë arsye të forta për të anashkaluar analizën në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* në lidhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Jurisprudenca e GJPN-së nuk e ka trajtuar aspektin e ekzistencës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare, por as e ka përjashtuar.¹²⁹ Faktikisht atje është trajtuar “kriteri dallues midis autorëve kryesorë dhe ndihmësve në një krim të kryer nga shumë persona”,¹³⁰ bazuar në dispozitat e hollësishme të Statutit të GJPN-së.¹³¹ Sikurse është përmendur më lart, në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, Dhoma e Apelit e shfrytëzoi Statutin e GJPN-së vetëm si provë që zbulonte ekzistencën e një forme fajësie bazuar në “një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët” e ndryshme nga ndihma dhe inkurajimi.¹³² Më tej, Dhoma e Apelit arriti në përfundimin mbi ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare duke analizuar një sërë çështjesh gjyqësore pas Luftës së Dytë Botërore.¹³³ Si rezultat, interpretimi i

¹²⁵ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, sh. 282.

¹²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 223. Shih gjithashtu Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 20; Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 7. Rrjedhimisht “përgjegjësia e bashkautorit” përmendur në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* nuk duhet ngatërruar me të ashtuquajturën përgjegjësi ndihmëse.

¹²⁷ Në fakt, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Apelit *Tadiq* ku përmendet Statuti i GJPN-së, trajtohet koncepti i një plani të përbashkët dhe pjesëmarrjes në të i ndryshëm nga fajësia e ndihmës dhe inkurajimit (Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 221).

¹²⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 49-50, përmendet *Prokurori k. Jean-Pierre Bemba Gombo-s*, Lënda nr. ICC-01/05-01/08, Vendim Bazuar në Nenin 61(7)(a) dhe (b) të Statutit të Romës mbi Akuzat e Prokurorit Kundër Jean-Pierre Bemba Gombo-s, 15 qershor 2009, *Prokurori k. Omar Hassan Ahmad Al Bashir-it*, Lënda nr. ICC-02/05-01/09, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Fletarrestim Kundër Omar Hassan Ahmad Al Bashir-it, 4 mars 2009, *Prokurori k. Germain Katanga-s dhe Mathieu Ngudjolo-s*, Lënda nr. ICC-01/04-01/07, Vendim mbi Konfirmimin e Akuzave, 30 shtator 2008, *Prokurori k. Thomas Lubanga Dyilo-s*, Lënda nr. ICC-01/04-01/06, Vendim mbi Konfirmimin e Akuzave, 29 janar 2007 (“Vendimi *Lubanga* mbi Konfirmimin e Akuzave”).

¹²⁹ Shih Vendimi *Lubanga* mbi Konfirmimin e Akuzave, para. 326, 335, 338.

¹³⁰ Vendimi *Lubanga* mbi Konfirmimin e Akuzave, para. 327.

¹³¹ Neni 25 (3) i Statutit të GJPN-së.

¹³² Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220.

¹³³ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 194-225. Konkretisht, para. 197 (përmendet *Trial of Otto Sandrock and Three Others*, British Military Court for the Trial of War Criminals/*Gjykimi i Otto Sandrock-ut dhe Tre Të*

jurisprudencës së GJPN-së në lidhje me elementët objektivë ose subjektivë të formës së fajësisë që bazohet në një “qëllim të përbashkët”, dalë nga Statutit i GJPN-së nuk e cenon analizën e Tribunalit të aspektit të ekzistencës së “konceptit të qëllimit të përbashkët” në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, argumentet e Gjorgjeviqit lidhur me këtë pikë hidhen poshtë.

39. Si përmbledhje, Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* gëzonte të drejtën të analizonte Statutin e GJPN-së si një nga burimet që vinin në pah ekzistencën e elementëve të fajësisë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Gjithashtu, interpretimi në çështjen *Tadiq* i Nenit 25(3) të Statutit të GJPN-së prej Dhomës së Apelit ishte i saktë, dhe jurisprudenca e mëvonshme e GJPN-së bazuar në këtë dispozitë nuk ndikon në konkluzionin e Dhomës. Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë të kundërtën.

c. Jurisprudenca pas Luftës së Dytë Botërore

40. Më parë Dhoma e Apelit ka theksuar se Aktgjykimi i Apelit *Tadiq* ofroi “arsyetim të hollësishëm për deduktimin e arsyeve për fajësinë në çështjet gjyqësore [pas Luftës së Dytë Botërore] që citoi”.¹³⁴ Ky aktgjykim gjithashtu ka provuar se këto çështje tregojnë se ndërmarrja e përbashkët kriminale vlen për “çështje të mëdha gjyqësore dhe se NPK-ja nga pikëpamja juridike është e ndryshme nga kompleti dhe fajësia organizative”.¹³⁵ Dhoma e Apelit gjykon se shumica e argumenteve të Gjorgjeviqit në lidhje me pasluftën e dytë botërore nuk tregojnë asgjë të re në këtë aspekt dhe rrjedhimisht do të analizojë vetëm argumentet që meritojnë vëmendje.

Tjerëve, Gjykata Ushtarake Britanike për Gjykimin e Kriminelëve të Luftës Almelo, Holandë, 24-26 nëntor 1945, Law Reports of Trials of War Criminals/Raporte Gjyqësore të Gjykimeve të Kriminelëve të Luftës, UNWCC, Vëll. I, Lënda nr. 3, *Hölzer et al/ Hölzer dhe të tjerë*, Canadian Military Court/Gjykata Ushtarake Kanadeze, Aurich, Gjermani, Royal Canadian Air Force Binder/Dosja e Forcës Mbretërore Ajrore Kanadeze 181.009 (D2474), Record of Proceedings of the Canadian Military Court/Evidencë e Seancave të Gjykatës Ushtarake Kanadeze, 25 mars-6 prill 1946, vëll. I, f. 341, 347, 349 (kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit)), 198 (përmendet *Trial of Gustav Alfred Jepsen et al*, Proceedings of a War Crimes Trial, Luneberg, Germany, 13-23 August 1946, Judgement of 24 August 1946, /Gjykimi i *Gustav Alfred Jepsen-it dhe të tjerëve*, Seanca nga një Gjykim për Krime Luftë, Luneberg, Gjermani, 13-23 gusht 1946, Aktgjykimi i 24 gushtit 1946 f. 241 (transkriptet origjinale në Zyrën e Arkivit Publik, Kew, Richmond; kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit), *Trial of Franz Schonfeld and Nine Others*, British Military Court, Essen, 11-26 June 1946, Law Reports of Trials of War Criminals, UNWCC./Gjykimi i *Franz Schonfeld-it dhe Nëntë Të Tjerëve*, Gjykata Ushtarake Britanike, Essen, 11-26 qershor 1946, Raporte Gjyqësore të Gjykimeve të Kriminelëve të Luftës vëll. XI, Lënda nr. 66, f. 68 (përmbledhje e këshilltarit ligjor të gjykatës ushtarake), 199 (përmendet *Trial of Feurstein and others/Gjykimi i Feuerstein-it dhe të tjerëve*, Proceedings of a War Crimes Trial/Seanca të një Gjykimi për Krime Luftë, Hamburg, Gjermani, 4-24 gusht 1948, Aktgjykimi i 24 gusht 1948 (transkriptet origjinale në Zyrën e Arkivit Publik, Kew, Richmond; kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit), 200 (përmendet çështja *Einsatzgruppen*).

¹³⁴ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 659, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 195-219.

¹³⁵ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 659 (pa citime), përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 422-423, Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 25, Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 23, 25-26. Bazuar në analizën e mëposhtme që rrëzon argumentet e Gjorgjeviqit lidhur me rëndësinë e çështjeve *Justice*, *RuSHA*, dhe *Einsatzgruppen*, Dhoma e Apelit rrëzon edhe parashtrimin e tij se këto çështje janë “të pamjaftueshme për të vërtetuar fajësinë sipas NPK-së në çështjet në lidhje me udhëheqjen” (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 75).

41. Pas shqyrtimit të Aktgjykimit të Apelit *Tadiq* dhe burimeve ku u mbështet ky aktgjykim, Dhoma e Apelit nuk bindet se burimet janë pak të njohura dhe të pabotuara.¹³⁶ Dhoma e Apelit thekson se gjatë arsyetimit të vet në lidhje me çështjen *Tadiq*, Dhoma e Apelit analizoi një sërë çështjesh të ndryshme,¹³⁷ dhe i konsideron këto burime të besueshme. Pas shqyrtimit të këtyre çështjeve, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Tadiq* u bind se “doktrina e veprimit në bazë të një qëllimi të përbashkët ishte e rrënjësuar në sistemet ligjor të shumë shteteve”.¹³⁸ Gjithashtu, Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* bëri dallimin midis “konceptit të qëllimit të përbashkët” dhe “trajtimit të këtij koncepti” dhe konkludoi se ndonëse sistemet kryesore ligjore ndërkombëtare e njihnin këtë koncept, trajtimi i këtij koncepti prej tyre nuk ishte i njëjtë.¹³⁹ Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* së fundi arriti në përfundimin se doktrina e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare bazuar në “njëtrajtmërinë dhe logjikën e qartësinë e jurisprudencës dhe traktateve të cituara [...], si edhe përputhjen e tyre me parimet e përgjithshme mbi përgjegjësinë penale të përcaktuara në Statut, si edhe të drejtën penale ndërkombëtare të përgjithshme dhe legjislacionet shtetërore”.¹⁴⁰ Rrjedhimisht, Gjorgjeviqi nuk ka të drejtë kur argumenton se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* nuk shpjegoi si vërtetoi ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁴¹

42. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin* ishte kundërthënës në lidhje me Aktgjykimin *Kunarac dhe të tjerë* dhe gabimisht u bazua në çështjen *Justice*, që sipas Gjorgjeviqit nuk përdori përgjegjësinë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale,¹⁴² Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi ngatërron problemet e dala në këto çështje. Në Aktgjykimin e Apelit *Kunarac dhe të tjerë* u trajtua problemi “nëse një politikë apo plan përbën element brenda përkufizimit të krimeve kundër njerëzimit”.¹⁴³

¹³⁶ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 21, 29, 31, 56-67.

¹³⁷ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 194-225. Konkretisht, para. 197 (përmendet *Gjykimi i Otto Sandrock-ut dhe Tre Të Tjerëve*, Gjykata Ushtarake Britanike për Gjykimin e Kriminelëve të Luftës Almelo, Holandë, 24-26 nëntor 1945, Raporte Gjyqësore të Gjykimeve të Kriminelëve të Luftës, UNWCC, vëll. I, Lënda nr. 3, *Hölzer dhe të tjerë*, Gjykata Ushtarake Kanadeze, Aurich, Gjermani, Dosja e Forcës Mbretërore Ajrore Kanadeze 181.009 (D2474), Evidencë e Seancave të Gjykatës Ushtarake Kanadeze, 25 mars-6 prill 1946, vëll., f. 341, 347, 349 (kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit)), 198 (përmendet *Gjykimi i Gustav Alfred Jepsen-it dhe të tjerëve*, Seanca nga një Gjykim për Krime Luftë, Luneberg, Gjermani, 13-23 gusht 1946, Aktgjykimi i 24 gushtit 1946 f. 241 (transkriptet origjinale në Zyrën e Arkivit Publik, Kew, Richmond; kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit)), *Gjykimi i Franz Schonfeld-it dhe Nëntë Të Tjerëve*, Gjykata Ushtarake Britanike, Essen, 11-26 qershor 1946, Raporte Gjyqësore të Gjykimeve të Kriminelëve të Luftës vëll. XI, Lënda nr. 66, f. 68 (përmbledhje e këshilltarit ligjor të gjykatës ushtarake), 199 (përmendet *Gjykimi i Feuerstein-it dhe të tjerëve*, Seanca të një Gjykimi për Krime Luftë, Hamburg, Gjermani, 4-24 gusht 1948, Aktgjykimi i 24 gusht 1948 (transkriptet origjinale në Zyrën e Arkivit Publik, Kew, Richmond; kopja e arkivuar në bibliotekën e Tribunalit), 200 (përmendet çështja *Einsatzgruppen*).

¹³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 224.

¹³⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 225.

¹⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 226. Për analizën e Dhomës së Apelit në çështjen *Tadiq*, shih Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 194-225.

¹⁴¹ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 29, 31.

¹⁴² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 61-62.

¹⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 98, sh. 114.

Pikërisht në këtë kontekst, Dhoma e Apelit citoi mendimin e një gjykatësi nga çështja *Polyukhovich* si bazë për përfundimin e vet se “as në Statut, e as në të drejtën zakonore ndërkombëtare të kohës kur pretendohet të jenë kryer veprimet [...] nuk kërkohej të provohej ekzistenca e një plani apo politike për kryerjen e këtyre krimeve”.¹⁴⁴ Në çështjen *Bërgjanin*, Dhoma e Apelit citoi çështjet *Justice* dhe *RuSHA* sepse gjykoi se ato “ofronin bazë të fortë për argumentin e Prokurorisë” se jurisprudenca pas Luftës së Dytë Botërore mundësoi që një i akuzuar të mbante përgjegjësi për pjesëmarrje në një qëllim kriminal të përbashkët ndonëse veprimi i fajshëm i krimit ishte kryer nga persona të cilët nuk kishin këtë qëllim.¹⁴⁵ Dhoma e Apelit nuk konstaton asnjë kundërshti midis dy aktgjykimeve të veta. Për më tepër, Gjorgjeviqi nuk ka provuar ekzistencën e arsyeve të forta që do të përligjin anashkalimin e përfundimit të lartpërmendur në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin*.¹⁴⁶

43. Nuk qëndron as pretendimi tjetër i Gjorgjeviqit se gjatë analizës së të drejtës zakonore ndërkombëtare, Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* nuk mund të bazohet në jurisprudencë shtetesh apo jurisprudencën e gjykatave që vepruan nën juridiksionin e Ligjit nr. 10 të Këshillit të Fuqive Aleate.¹⁴⁷ Si burimet ndërkombëtare, po ashtu edhe shtetërore mund të shërbejnë si tregues të zakoneve ndërkombëtare.¹⁴⁸ Konkretisht në lidhje me jurisprudencën pas Luftës së Dytë Botërore, Dhoma e Apelit thekson miratimin e saj për konstatimin e bërë në Aktgjykimin *Kupreshkiq dhe të tjerët*:

është e vetëkuptueshme se një vlerë e madhe u duhet kushtuar vendimeve të gjykatave penale ndërkombëtare si tribunalët ndërkombëtarë të Nurembergut ose Tokios, ose gjykatave shtetërore që vepruan në sajë të dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 10 të Këshillit të Fuqive

¹⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 98, përmendet, ndër të tjera, çështja *Justice* dhe komenti i atjeshëm në *Ivan Timofeyevich Polyukhovich v The Commonwealth of Australia and Anor*, (1991) 172 CLR 501 (“çështja *Polyukhovich*”), f. 586-587.

¹⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 394. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 395-404.

¹⁴⁶ Dhoma e Apelit asnjëherë nuk ka është shprehur se në çështjen *Justice* ose në çështjen *RuSHA* përgjegjësia në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale u zbatua në të njëjtën mënyrë sikurse është zhvilluar në jurisprudencën e Tribunalit. Faktikisht, Dhoma e Apelit u bazua në këto çështje ashtu si edhe në shumë burime të tjera për të vërtetuar se elementët thelbësorë të kësaj forme përgjegjësie ishin të njohur në të drejtën zakonore ndërkombëtare (Shih më poshtë, para. 58).

¹⁴⁷ Dhoma e Apelit rikujton se Ligji nr. 10 i Këshillit të Fuqive Aleate është një akt legjislativ që hyri në fuqi më 20 dhjetor 1945 dhe u miratua nga Fuqitë Pushtuese i cili pasqyrore marrëveshjen ndërkombëtare ndërmjet këtyre vendeve në lidhje me të drejtën përkatëse për krimet ndërkombëtare dhe juridiksionin e gjykatave që u kërkohej të gjykojnë këto krime. Ligji nr. 10 i Këshillit të Fuqive Aleate ofroi përkufizime për krime konkrete për të garantuar që Fuqitë Aleate të bazohen në të njëjtin standard ligjor (Shih Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 541; Shih gjithashtu *Trials of War Criminals before the Nuremberg Military Tribunals under Control Council Law No. 10/Gjykimet e Kriminelëve të Luftës në Tribunalët Ushtarakë të Nurembergut në bazë të Ligjit nr. 10 të Këshillit të Fuqive Aleate* (1946-1949) 15 volumes, Washington D.C., U.S. Government Printing Office).

¹⁴⁸ Shih Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 537-542; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 227; North Sea Continental Shelf cases/çështjet e Cekëtinës Kontinentale në Detin e Veriut, Aktgjykimi i GJND-së, 20 shkurt 1969, ICJ Reports 1969, f. 43, para. 74. Gjithsesi Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* theksoi se “çitimi i legjislacionit dhe jurisprudencës shtetërore shërben vetëm për të provuar se koncepti i qëllimit të përbashkët përdorur në të drejtën penale ndërkombëtare ka bazë mbështetëse në shumë sisteme shtetërore”. Gjithashtu u theksua se “në lidhje me aspektin që diskutohet, legjislacioni dhe jurisprudenca shtetërore nuk mund të përdoren si burim i parimeve ose rregullave ndërkombëtare, bazuar në doktrinën e parimeve të përgjithshme të së drejtës pranuar nga bashkësia e shteteve: që kjo të jetë e lejueshme, është e nevojshme të provohet se shumica e vendeve në rast se jo të gjithë, mbështeten në të njëjtin koncept të qëllimit të përbashkët” (Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 225).

Aleate, një akt legjislativ i miratuar bashkërisht më 1995 nga të katër Fuqitë Pushtuese dhe si rezultat pasqyrim i marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Fuqive të Mëdha, në lidhje me të drejtën përkatëse për krimet ndërkombëtare dhe juridiksionin e gjykatave që u kërkohej të gjykojnë këto krime. Gjykatat në fjalë vepruan në bazë të instrumenteve ndërkombëtare që përcaktuan dispozitat, qoftë në formë deklarative të ligjeve ekzistuese, ose që gradualisht ishin shndërruar në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁴⁹

44. Përveç mospajtit me formulimin e mësipërm,¹⁵⁰ Gjorgjeviqi nuk ka arritur të krijojë dyshime në lidhje me të. Shihet qartë se nuk ekzistojnë kushte që kërkojnë verifikimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare, vetëm në prizmin e “së drejtës ndërkombëtare”.¹⁵¹ Përkundrazi, Dhoma e Apelit kujton se:

në analizimin e krijimit të rregullave zakonore ose parimeve të përgjithshme duhet [...] mbajtur parasysh se [...] vëmendje parësore u duhet kushtuar elementëve si deklaratat zyrtare të shteteve, udhëzuesit ushtarakë dhe vendimet gjyqësore.¹⁵²

Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* me të drejtë analizoi burimet ndër të cilat, jurisprudencën e Pasluftës së Dytë Botërore në kuadrin e Ligjit nr. 10 të Këshillit të Fuqive Aleate dhe jurisprudencën shtetërore sepse “arsyeja për konkluzionin e Dhomës së Apelit se fajësia sipas NPK-së mbështetej në të drejtën zakonore ndërkombëtare ishte ‘njëtrajtshmëria dhe qartësia e logjika e jurisprudencës dhe traktateve të përmendura në diskutimin e vet.’”¹⁵³

45. Së fundi, në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se analiza e Aktgjykimit *Einsatzgruppen* në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* është e mangët sepse u referohet argumenteve të palëve dhe jo arsyetimit të trupit gjykues,¹⁵⁴ Dhoma e Apelit shpreh miratimin me sqarimin e Gjykatësit Shahabuddeen që ishte kryegjykatës në çështjen *Tadiq*, ku pohohet se:

Dhoma e Apelit kishte të drejtë, veçanërisht ‘në mungesë të një deklaratë gjyqësore të qartë’, të analizonte deklaratat e avokatëve në ato çështje për të qartësuar mënyrën e procedimit të gjykatës: gjykatat e bëjnë këtë ndonjëherë. Në disa juridiksione, argumentet e avokatëve pasqyrohen në raporte më të mira ligjore, para paraqitjes së aktgjykimit. Në rastet kur zbatohet kjo praktikë, ajo nuk shërben thjesht si zbulim: argumentet e avokatëve ndihmojnë në identifikimin e problemeve në fjalë. Si rrjedhojë, nuk është gabim t’u referohesh argumenteve të avokatëve. [...] Pyetja që ka rëndësi thelbësore nga ana ligjore është nëse [këto deklaratat] pasqyruan saktësisht të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁵⁵

¹⁴⁹ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 541.

¹⁵⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 58.

¹⁵¹ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 59, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Erdemoviq*, Mendim i Përbashkët i Gjykatësit McDonald dhe Gjykatësit Vohrah, para. 53-54.

¹⁵² *Prokurori k. Dushko Tadiqit*, Lënda nr. IT-94-1-AR72, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Apel të Ndërkohshëm në lidhje me Juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 99.

¹⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 31, citohet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 226.

¹⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 60.

¹⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 24 (pa citimet). Ky sqarim u bë në lidhje me argumentin e paraqitur nga avokati i Krajishnikut se “Dhoma në çështjen *Tadiq* i dha liri të tepruar vetes në interpretim, kur vazhdimisht dhe në mënyrë të pabazuar deduktoi arsyet për fajësinë nga deklaratat të veçuara të prokurorisë në një kohë që nuk ekzistonte një deklaratë gjyqësore e qartë” (*Prokurori k. Momçillo Krajishnikut*, Lënda nr. IT-00-39-A, Parashtrim mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale në Emër të Momçillo Krajishnikut, 4 prill 2008, para. 12 (pa ndonjë citim konkret në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*)).

3. Ekzistenca e arsyeve të forta për anashkalimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

(a) Argumentet e palëve

46. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma e Apelit duhet të anashkalojë jurisprudencën ekzistuese sipas të cilës ekziston një formë përgjegjësie penale e konkretizuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁶ Gjorgjeviqi pretendon se pesha e jurisprudencës ku është mbështetur Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* është e diskutueshme dhe faktikisht nuk provon ekzistencën e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁵⁷ Gjithashtu, ai argumenton se koncepti i kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ose nuk konfirmohet, ose shprehimisht rrëzohet nga burime të tjera ndër të cilat jurisprudenca e TUN-së, çështjet gjyqësore pas Luftës së Dytë Botërore dhe Statutit i GJPN-së.¹⁵⁸ Gjorgjeviqi parashtron se këto argumente vlejné si për kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale si alternativë e kategorisë së parë kriminale, po ashtu edhe për pikën e parë të apelit të Prokurorisë.¹⁵⁹ Në mbështetje të argumenteve të veta, Gjorgjeviqi citon edhe një vendim të Dhomës Paragjyqësore të Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (“ECCC”), që sipas tij refuzon ekzistencën e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶⁰

47. Prokuroria përgjigjet se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* analizoi si duhej çështjet *Borkum Island* dhe *Essen Lynching*, si shembuj të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale duke marrë parasysh argumentet e palëve.¹⁶¹ Prokuroria shton se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* citoi konkluzione të gjykatave italiane pas Luftës së Dytë Botërore në mbështetje të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶² Prokuroria thekson se jurisprudenca përkatëse e gjykatave të tjera si ECCC ose GJPN, nuk është detyruese

¹⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 68-71.

¹⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 70. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 14.

¹⁵⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 71.

¹⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 68.

¹⁶⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 69, përmendet *Prosecutor v. Ieng Thirith et al/ Prokurori k. Ieng Thirith-it dhe të tjerëve et al.* (Lënda 002), Dosja e Çështjes nr: 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ (PTC38), Decision on the Appeals Against the Co-Investigative Judges Order on Joint Criminal Enterprise (JCE)/Vendim mbi Apelet Kundër Urdhrit të Gjykatësve Hetues mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale (NPK), 20 maj 2010 (“ECCC Decision on Joint Criminal Enterprise of 20 May 2010/Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010”), para. 83.

¹⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 54, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 205-213; *Trial of Erich Heyer and Six Others, British Military Court for the Trial of War Criminals*,/Gjykimi i Erich Heyer-t dhe Gjashtë Të Tjerëve Essen, 18^h-19^h dhe 21-22 dhjetor 1945, *Law Reports of Trials of War Criminals/Raporte Ligjore të Kriminelëve të Luftës, UNWCC, vëll. I, Lënda nr. 8* (“Essen Lynching case/çështja Essen Lynching”), *The United States of America v. Kurt Goebell et al/Shtetet e Bashkuara të Amerikës k. Kurt Goebell-it dhe të tjerëve*, Records of United States Army War Crimes Trials, February 6 – March 21, 1946, National Archives Microfilm Publications M1103, (Washington: 1980) (“*Borkum Island case*”).

¹⁶² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 54, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 214-219.

për Dhomën e Apelit.¹⁶³ Po ashtu përmenden edhe çështje të tjera gjyqësore pas Luftës së Dytë Botërore të paanalizuara në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, të cilat konfirmojnë karakterin zakonor të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶⁴

(b) Analizë

48. Dhoma e Apelit rikujton se në çështjen *Karemera dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit e TPNR-së refuzoi të shqyrtonte Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* në lidhje me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke konfirmuar se “në bazë të kategorisë së tretë ose “të zgjeruar” të fajësisë sipas NPK-së, i akuzuari mund të mbajë përgjegjësi për krime që fizikisht janë kryer nga pjesëmarrës të tjerë në NPK në qoftë se këto krime janë pasoja të parashikueshme të NPK-së, edhe sikur i akuzuari të mos ketë qenë dakord me pjesëmarrësit e tjerë për kryerjen e krimeve në fjalë”.¹⁶⁵

49. Për arsyet e shtjelluara më poshtë, Dhoma e Apelit nuk bindet nga sugjerimi i Gjorgjeviqit se ekzistojnë arsye të forta për rishikimin e jurisprudencës së lartpërmendur dhe për eliminimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶⁶ Veçanërisht, Dhoma e Apelit gjykon se parashtrimi i Gjorgjeviqit sipas të cilit pesha e çështjeve *Borkum Island* dhe *Essen Lynching* është “e diskutueshme”¹⁶⁷ – është i pamjaftueshëm për të vënë në pikëpyetje analizën e Dhomës së Apelit në çështjen *Tadiq*.¹⁶⁸ Përveçse u është referuar këtyre dy çështjeve, Gjorgjeviqi nuk ka ofruar arsye pse Dhoma e Apelit duhet të rishikojë jurisprudencën e vet të mirëprovuar, bazuar në burime të shumta, se si juridiksionet e të drejtës kontinentale po ashtu edhe anglosaksone njohin fajësinë e pjesëmarrjes në një plan të përbashkët kriminal në lidhje me krimet e kryera jashtë planit të përbashkët, por që prapëseprapë janë të parashikueshme.¹⁶⁹

50. Së fundi, Vendimi i ECCC-së në lidhje me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010 nuk është detyruar ndaj Dhomës së Apelit dhe si rrjedhojë nuk përbën arsye të fortë

¹⁶³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 55-56.

¹⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 57-60, përmendet çështja *RuSHA*, f. 117, 120, 160-162, Decision of the Supreme Court for the British Zone against *Sch. et al.*, 20 April 1949/Vendim i Gjykatës së Lartë për Zonën Britanike kundër *Sch. dhe të tjerëve*, *Entscheidungen des Obersten Gerichtshofes für die Britische Zone, Entscheidungen in Strafsachen*, Walter de Gruyter & Co. (Berlin: 1950), vëll. 2 (“*Sch. et al. case*/çështja *Sch. dhe të tjerë*”), f. 11-15, Review of Proceedings of General Military Court in the case of *United States vs. Martin Gottfried Weiss et al.* of the Recommendation of the Staff Judge Advocate (“*Weiss et al. case*”)/Rishikim i Procedimit të Gjykatës së Përgjithshme Ushtarake në çështjen *Shtetet e Bashkuara k. Martin Gottfried Weiss-it dhe të tjerëve* i Rekomandimit të Këshilltarit Ligjor të Gjykatës Ushtarake (“çështja *Weiss dhe të tjerët*”, f. 1, 141.

¹⁶⁵ *Edouard Karemera dhe të tjerët. k. Prokurorit*, Lëndët nr. ICTR-98-44-AR72.5, ICTR-98-44-AR72.6, Vendim mbi Apelimet Juridiksionale: Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale, 12 prill 2006, para. 13, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 99, Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220.

¹⁶⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 68-71.

¹⁶⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 70.

¹⁶⁸ Argumentet e Gjorgjeviqit kundër këtyre burimeve të tjera ku u bazua Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq*, nuk janë bindëse dhe për rrjedhojë hidhen poshtë (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 70).

¹⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204-220, 224.

për anashkalimin e jurisprudencës së vet të rrënjosur. Gjithsesi, Dhoma e Apelit thekson se ECCC-ja nuk përcaktoi nëse kategoria e tretë e fajësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte apo nuk ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹⁷⁰ ECCC-ja vuri në dukje çështjet që ishin përdorur si burime në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq* për të cilat gjykoi se ishin “precedentët e duhur në përcaktimin e statusit të së drejtës zakonore ndërkombëtare në këtë aspekt”.¹⁷¹ Më tej ECCC-ja arriti në përfundimin se këto çështje nuk “përbëjnë një bazë mjaftueshmërisht të fortë për të konkluduar se NPK III ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën që ka lidhje me Çështjen 002”.¹⁷² Dhoma Paragjyqësore e ECCC-së nuk e gjykoi të nevojshme të analizonte nëse kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte apo nuk ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹⁷³ Dhoma konkludoi se asnjë dispozitë e së drejtës kamboxhiane nuk përmbante një formë të tillë të zgjeruar përgjegjësie në kohën e krimeve të pretenduara, dhe u shpreh si më poshtë:

Dhoma Paragjyqësore nuk ka mundur të identifikojë në të drejtën kamboxhiane që ishte në fuqi gjatë kohës në fjalë, asnjë dispozitë që do t’u kishte bërë me dije Personave të Akuzuar se edhe një formë e tillë e zgjeruar e përgjegjësisë ishte e ndëshkueshme. Në këto rrethana, parimi i ligjshmërisë i dikton ECCC-së që të mos bazohet në formën e zgjeruar të NPK-së gjatë procedimit të saj.¹⁷⁴

51. Në këtë mënyrë, ECCC-ja zbuloi mangësitë në arsyetimin e Dhomës së Apelit në çështjen *Tadiq* në lidhje me vërtetimin e ekzistencës së kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në të drejtën zakonore ndërkombëtare,¹⁷⁵ por e kufizoi përfundimin e vet “për aq sa ka lidhje me zbatueshmërinë e kategorisë III të NPK-së në ECCC”.¹⁷⁶

52. Më tej, megjithëse kritikoi qëndrimin në lidhje me çështjen *Tadiq*, ECCC-ja nuk bëri analizë të mëtejshme të praktikës shtetërore dhe *opinio juris* përkatës për të përcaktuar nëse kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, por u mjaftua me interpretimin e burimeve të analizuara në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*.¹⁷⁷ Dhoma e Apelit është bindur se burimet ligjore të analizuara nga Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* janë të besueshme dhe se parimet e shtjelluara atje në lidhje me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale janë të rrënjosura si në të drejtën zakonore ndërkombëtare po ashtu edhe në jurisprudencën e këtij Tribunali.¹⁷⁸ Së fundi, megjithëse nuk vë në dyshim vlerën bindëse të Vendimit të ECCC-së në lidhje me

¹⁷⁰ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 87.

¹⁷¹ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 82.

¹⁷² Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 83 (theksi i shtuar).

¹⁷³ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 87.

¹⁷⁴ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 87 (theksi i shtuar).

¹⁷⁵ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 79-85.

¹⁷⁶ Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 88.

¹⁷⁷ Shih Vendim i ECCC-së mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010, para. 77, 79-85.

¹⁷⁸ Shih gjithashtu më lart, para. 41.

Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale të 20 majit 2010 përtej juridiksionit të ECCC-së, Dhoma e Apelit përsërit se nuk është e detyruar prej tij.

53. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se Vendimi i ECCC-së në lidhje me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 20 majit 2010 nuk përbën arsye të fortë që Dhoma e Apelit të anashkalojë jurisprudencën e vet përputhëse.

4. Pretendim për gabime në lidhje me natyrën e fajësisë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

(a) Argumentet e palëve

54. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* dhe në çështjet e mëvonshme e karakterizoi gabimisht ndërmarrjen e përbashkët kriminale si formë kryesore përgjegjësie dhe e zbatoi në të ashtuquajturat “çështje të udhëheqjes” ku autorët fizikë nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁷⁹ Gjorgjeviqi argumenton se përgjegjësia e të akuzuarve të nivelit të lartë të cilët “përdorin” autorë fizikë për kryerjen e krimeve në terren, nuk mund të barazohet me kryerjen (ose përgjegjësinë e autorëve).¹⁸⁰ Sipas tij, rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gaboi në shpalljen e tij fajtor për kryerje që rezultoi në një dënim më të rëndë se ai që do të ishte dhënë në rast se përgjegjësia e tij do të ishte karakterizuar me të drejtë si përgjegjësi ndihmëse/dytësore dhe jo kryesore.¹⁸¹

55. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk mund të pretendojë shkeljen e parimit të ligjshmërisë sepse ai ishte në dijeni se akuzohej për kryerjen e krimeve nga individë të cilët nuk ishin anëtarë të NPK-së.¹⁸² Prokuroria parashtron se të gjitha kategoritë e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale përfshihen në “kryerje” sepse anëtarët e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale kanë një qëllim të përbashkët kriminal, kanë të njëjtin synim për kryerjen e krimeve, dhe janë të vetëdijshëm për rrezikun e veprimeve të tyre në realizmin e qëllimit të lartpërmendur.¹⁸³

(b) Analizë

56. Dhoma e Apelit ka konkluduar rregullisht se pjesëmarrja në një ndërmarrje të përbashkët kriminale të çfarëdo kategorie përbën kryerje.¹⁸⁴ Ashtu sikurse është shpjeguar në

¹⁷⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 48-53, 55, 66, 72-76, 77.

¹⁸⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 72-76, ndër të tjera përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 664, Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, sh. 891, Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 20, 31.

¹⁸¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 72.

¹⁸² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 62.

¹⁸³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 63-65, përmendet ndër të tjera Vendimi i Apelit *Millutinoviq dhe të tjerët* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 21 majit 2003, para. 20.

Aktgjykimin e Apelit *Krajishnik*, një verdikt fajësie bazuar në përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime të kryera nga autorë fizikë të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, gjithashtu përfshihet në juridiksionin e paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit.¹⁸⁵

57. Gjithsesi, është i gabuar sugjerimi i Gjorgjeviqit se fajësia dhe dënimi i tij duhen ndryshuar në përputhje me faktin se ai vetë nuk kreu asnjë nga krimet për të cilat është shpallur fajtor në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Dhoma e Apelit ka theksuar vazhdimisht se pjesëmarrja dhe kontributi i një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale “shpesh është jetik në mundësimin e kryerjes së krimit në fjalë” dhe, rrjedhimisht, “pesha morale e pjesëmarrjes shpesh nuk është më e pakët – ose faktikisht nuk është e ndryshme – nga ajo e autorëve fizikë të kryerjes së veprimeve në fjalë”.¹⁸⁶

5. Konkluzion

58. Bazuar në analizën e mësipërme, Dhoma e Apelit riafirmon se ndërmarrja e përbashkët kriminale, përfshirë edhe kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, është një formë kryerje krimi brenda kornizës së të drejtës zakonore ndërkombëtare, dhe gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar ekzistencën e arsyeve të forta që do të justifikonin anashkalimin e jurisprudencës më se të provuar në lidhje me këtë aspekt. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrezon pikën e dytë të apelit të Gjorgjeviqit.

D. Pika e gjashtë e apelit të Gjorgjeviqit, pjesërisht: pretendime për gabime në lidhje me ngarkimin e përgjegjësisë penale anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krimet kryer nga autorët fizikë,

1. Hyrje

59. Gjorgjeviqi parashtron se: (i) edhe sikur përgjegjësia e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të ekzistojë në të drejtën zakonore ndërkombëtare, nuk është e vlefshme në “çështjet e udhëheqjes” dhe se Dhoma e Apelit duhet të anashkalojë jurisprudencën e vet në Aktgjykimet e Apeleve *Bërgjanin*, *Martiq*, dhe *Krajishnik* ose të qartësojë arsyetimin në këto çështje;¹⁸⁷ dhe (ii) gjithsesi, Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e gabuar ligjor dhe “dhe

¹⁸⁴ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 663-664; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 80; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, sh. 891; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 188, 191-192. Ky konkluzion në veçanti nuk mbështetet nga çështjet *Justice* dhe *RuSHA* (Shih analizën në Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 395-404). Shih gjithashtu më lart, para. 32-34.

¹⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 665.

¹⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 663, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 80, Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 191.

¹⁸⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 110. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 129.

thjesht i ngarkoi Gjorgjeviqit krime mbi bazën e përkatësisë së autorëve të krimeve (MPB, Ushtria Jugosllave (“UJ”)], etj.)”¹⁸⁸

60. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të identifikojë arsye bindëse për anashkalimin prej Dhomës Gjyqësore të jurisprudencës së vet të mirënjohur.¹⁸⁹ Gjithashtu Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale.¹⁹⁰

2. Pretendim për kundërshti ndërmjet Aktgjykimit të Apelit *Bërgjanin* dhe Aktgjykimit të Apelit *Stakiq*

(a) Argumentet e palëve

61. Gjorgjeviqi argumenton se arsyetimi i shtjelluar në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin* bie ndesh me arsyetimin në Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*.¹⁹¹ Sipas Dhomës së Apelit, Gjorgjeviqi argumenton se teoria e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale e shtjelluar në *Bërgjanin* – ku autorët fizikë të krimeve jo domosdoshmërisht janë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në qoftë se një anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale i cili vepron në përputhje me planin e përbashkët i përdor atë për kryerjen e krimeve – faktikisht bazohet në konceptin e kontrollit ndaj veprimit të autorit fizik.¹⁹² Sipas Gjorgjeviqit, koncepti i kontrollit u hodh poshtë shprehimisht nga Dhoma e Apelit në çështjen *Stakiq*.¹⁹³ Ai sugjeron se forma e ndërmarrjes së përbashkët kriminale e zbatuar në çështjen *Bërgjanin*, kur zbatohet në çështjet lidhur me udhëheqjen, është thjesht “bashkautorësi e tërthortë e emërtuar ndryshe”.¹⁹⁴ Gjorgjeviqi gjykon se vetëm kjo mospërputhje në vetvete përbën një arsye të fortë që Dhoma e Apelit të anashkalojë arsyetimin në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin*.¹⁹⁵ Në mbështetje të argumentit të tij, Gjorgjeviqi gjithashtu citon pikëpamjet e gjykatësit Cassese dhe gjykatësit Shahabuddeen, dy “etërve të jurisprudencës në lidhje me NPK-në”, të cilët nuk pajtohen me zbatimin e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin*.¹⁹⁶

¹⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 111. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 129.

¹⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 96-97.

¹⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 105-106.

¹⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 116-117.

¹⁹² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 116-117.

¹⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 117.

¹⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 117. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 112, 116; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 32.

¹⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 117.

¹⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 118, përmendet Antonio Cassese, “The Proper Limits of Individual Responsibility Under the Doctrine of Joint Criminal Enterprise/ Kufijtë e Duhur të Përgjegjësisë Individuale në kontekst të Doktrinës së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale”, *Journal of International Criminal Justice*, vol. 5 (2007), f. 126, 133; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 18.

62. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk tregon arsye të forta që të do justifikonin anashkalimin prej Dhomës së Apelit të jurisprudencës së saj të mirënjohur.¹⁹⁷ Prokuroria argumenton se nuk ka asnjë mospërputhje midis refuzimit të konceptit të bashkautorësisë prej Dhomës së Apelit në çështjen *Stakiq* dhe konkluzionit në çështjen *Bërgjanin* se anëtarët e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale mund të mbajnë përgjegjësi për veprime të individëve të cilët nuk janë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁹⁸ Faktikisht, Dhoma e Apelit në çështjen *Bërgjanin* u mbështet në parimin e miratuar në çështjen *Stakiq* se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale mbajnë përgjegjësi për krimet e kryere nga individë të cilët nuk janë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁹⁹

(b) Analizë

63. Dhoma e Apelit vazhdimisht ka konkluduar se përgjegjësia në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale është e zbatueshme në çështje të udhëheqjes, edhe kur krimet kryhen nga individë të cilët nuk janë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁰⁰ Dhoma e Apelit e gjykon jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se arsyetimi në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin* bie në kundërshti me arsyetimin në Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*. Në çështjen *Stakiq*, Dhoma e Apelit konkludoi se Dhoma Gjyqësore në *Stakiq* gaboi që u mbështet në kategorinë e “bashkautorësisë” sepse kjo formë përgjegjësie “nuk ka bazë në të drejtën zakonore ndërkombëtare ose në jurisprudencën e krijuar nga ky Tribunal” dhe nuk ishte “ligj i vlefshëm brenda juridiksionit të këtij Tribunali”.²⁰¹ Dhoma e Apelit nuk “rrezoi shprehimisht”, sikurse pretendon Gjorgjeviqi, bashkautorësinë për shkak të konceptit të “kontrollit ndaj veprimeve të autorëve fizikë”.²⁰² Dhoma e Apelit konstaton se në ndryshim nga forma e bashkautorësisë e përdorur nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Stakiq*, përgjegjësia në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale sikurse shtjellohet në çështjen *Bërgjanin*, në rast se zbatohet për krimet e kryera nga autorë fizikë të cilët nuk janë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, nuk kërkon “bashkëpunim të bashkërenduar dhe kontroll të përbashkët ndaj sjelljes kriminale”.²⁰³

¹⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 96-97.

¹⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 100.

¹⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 100.

²⁰⁰ Aktgjykimin i Apelit *Bërgjanin*, para. 410-414, 420-424, 430-431. Shih gjithashtu Aktgjykimin i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 89; Aktgjykimin i Apelit *Krajishnik*, para. 664-665; Aktgjykimin i Apelit *Martiq*, para. 168-169; Aktgjykimin i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 120.

²⁰¹ Aktgjykimin i Apelit *Stakiq*, para. 62.

²⁰² Shih Aktgjykimin i Apelit *Stakiq*, para. 62. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 117. Problemi i kontrollit analizuar nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Stakiq* ka të bëjë me kontrollin e bashkautorëve ndaj kryerjes së veprimeve të përbashkëta. Në atë çështje, Dhoma Gjyqësore gjykoi se në lidhje me llojin e bashkautorësisë që po analizonte ishte e zakonshme por jo laksative që një nga bashkautorët zotëronte aftësi ose pushtet të cilat nuk i kishte bashkautorit tjetër. Dhoma Gjyqësore shpjegoi se këto aftësi ose pushteti “mund të përshkruhen si veprime të përbashkëta rezultantja e të cilave përmbush qëllim e përbashkët bazuar në të njëjtin nivel kontrolli në kryerjen e veprimeve të përbashkëta”. Dhoma Gjyqësore në atë çështje nuk sugjeroi ekzistencën e kushtit të kontrollit ndaj autorëve fizikë të kimit, dhe çfarë është më e rëndësishme, ky nuk ishte “saktësisht faktori i rrezuar prej Dhomës së Apelit në çështjen *Stakiq*” (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 117).

²⁰³ Aktgjykimin *Stakiq*, para. 440; Aktgjykimin i Apelit *Bërgjanin*, para. 412.

Në kundërshtim me çfarë sugjeron Gjorgjeviqi, nuk kërkohet as që përdorimi i autorit fizik nga anëtari i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të jetë i barasvlershëm me përdorimin e një “vegje”.²⁰⁴ Që një i akuzuar si anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të ngarkohet me përgjegjësi për një krim të kryer nga një individ i cili nuk është anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, sipas Dhomës së Apelit duhet të vërtetohet ekzistenca e lidhjes midis të akuzuarit dhe krimit dhe kjo lidhje analizohet në bazë të rrethanave të çështjes konkrete.²⁰⁵ Gjithashtu, duhet vërtetuar se në përdorimin e autorit të drejtpërdrejtë të krimit, anëtari i ndërmarrjes së përbashkët kriminale veprimi në përputhje me planin e përbashkët.²⁰⁶

64. Gjorgjeviqi nuk ka vërtetuar ekzistencën e mospërputhjeve midis Aktgjykimit të Apelit *Bërgjanin* dhe Aktgjykimit të Apelit *Stakiq*, e as ekzistencën e arsyeve të forta që do të justifikonin anashkalimin prej Dhomës së Apelit të jurisprudencës së vet.

65. Së fundi, Dhoma e Apelit thekson se asnjëherë nuk e ka anashkaluar teorinë mbi ndërmarrjen e përbashkët kriminale të cilën e shtjelloi në Aktgjykimet e Apelit *Stakiq* dhe *Bërgjanin* dhe e ka zbatuar vazhdimisht në çështjet e mëvonshme gjyqësore gjatë viteve.²⁰⁷ Dhoma e Apelit njeh dhe shpreh respekt ndaj kontributit të vyer të gjykatësit Cassese dhe gjykatësit Shahabuddeen në analizën ligjore të kësaj teme. Gjithsesi duke u bazuar në jurisprudencën përputhëse të paraqitur më lart, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se në çfarë mënyre shkrimet dhe mendimet e këtyre gjykatësve të përmendura prej tij përbëjnë arsye të fortë për anashkalimin e jurisprudencës së zhvilluar.²⁰⁸

3. Pretendim për gabim në mbështetjen në Aktgjykimin e Apelit *Martiq* dhe Aktgjykimin e Apelit *Krajishnik*

(a) Argumentet e palëve

66. Si argument alternativ, Gjorgjeviqi parashtrohet se gjithsesi në çështjet gjyqësore lidhur me udhëheqjen ekziston paqartësi e madhe mbi natyrën e lidhjes që duhet vërtetuar midis anëtarit të akuzuar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe autorit fizik të krimit i cili nuk është anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁰⁹ Gjithashtu, ai argumenton se as Dhoma Gjyqësore në këtë çështje, e as Dhoma e Apelit në çështjen *Krajishnik* nuk duhej të ishin

²⁰⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 412-413. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 116. Ky nuk është përfundim i Dhomës së Apelit, por pikëpamje e Prokurorisë sipas të cilës lidhja mund të vërtetohet prej faktit se anëtarët e NPK-së i përdorën autorët fizikë si “vegla” për kryerjen e krimeve (Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 412).

²⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413.

²⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413.

²⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 120.

²⁰⁸ Shih më lart, para. 23-24.

bazuar në Aktgjykimin e Apelit *Martiq*, sepse është mospërputhës me Aktgjykimin e Apelit *Stakiq* dhe Aktgjykimin e Apelit *Limaj dhe të tjerët*.²¹⁰

67. Prokuroria përgjigjet se midis Aktgjykimit të Apelit *Martiq* dhe Aktgjykimit të Apelit *Stakiq*, duke qenë se aktgjykimi i parë zbatoi metodologjinë e aktgjykimit të dytë në analizën nëse disa krime mund t'i ngarkoheshin një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²¹¹ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi shtrembëron Aktgjykimin e Apelit *Limaj dhe të tjerët* dhe se nuk ekziston asnjë kundërshti midis Aktgjykimit të Apelit *Martiq* dhe Aktgjykimit të Apelit *Limaj dhe të tjerët*.²¹² Sipas Prokurorisë, në *Limaj dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit refuzoi të analizonte përgjegjësinë e njërit prej të akuzuarve për krime të kryera nga individë të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke qenë se kjo pikë nuk ishte ngritur gjatë gjykimit apo fazës së apelit.²¹³ Së fundi, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të argumentojë se për çfarë arsye Dhoma e Apelit duhet të anashkalojë metodologjinë e përdorur në çështjen *Krajishnik*.²¹⁴

68. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se koncepti “vegël” nuk është shpjeguar asnjëherë tërësisht dhe se Dhoma Gjyqësore duhet të ofrojë sqarime në lidhje me Aktgjykimet e Apelit *Bërgjanin, Martiq, dhe Krajishnik*.²¹⁵

(b) Analizë

69. Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi shtrembëron disa pjesë të Aktgjykimit të Apelit *Martiq*. Ai parashtron se Dhoma e Apelit në atë çështje konkludoi se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Martiq* “nuk nxori përfundime konkrete se në çfarë mënyre NPK-ja përdori autorët fizikë”.²¹⁶ Mirëpo nga paragrafi që Gjorgjeviqi e citon në mbështetje të argumentit të tij, shihet qartë se Dhoma e Apelit e kishte fjalën për mosnxjerrjen e një konkluzioni konkret nga Dhoma Gjyqësore se anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në rastet kur përdorën disa forca të identifikuar nën kontrollin e tyre, “vepronin në përputhje me qëllimin e përbashkët”.²¹⁷ Dhoma e Apelit gjykoj se ndonëse Dhoma Gjyqësore duhej të kishte nxjerrë një përfundim të tillë, ky fakt nuk e bënte të pavlefshëm Aktgjykimin *Martiq*.²¹⁸ Dhoma e Apelit në atë rast konstatoi në lidhje me disa struktura të armatosura dhe njësi parashtarake, se Dhoma

²⁰⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 110, 119, tregohet mënyra e shtjellimit të lidhjes së nevojshme prej Dhomës së Apelit në çështjet *Bërgjanin, Martiq* dhe *Krajishnik*.

²¹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 120-122; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 33.

²¹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 102.

²¹² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 103.

²¹³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 103.

²¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 104.

²¹⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 31.

²¹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 120 (theksi në origjinal).

²¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 181 (theksi i shtuar).

²¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 181.

Gjyqësore nuk kishte nxjerrë *përfundime të prera* mbi lidhjen midis këtyre forcave dhe Millan Martiqit.²¹⁹ Duke u bazuar në këtë fakt, Dhoma e Apelit analizoi përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me të cilat Millan Martiqi ishte shpallur penalisht fajtor,²²⁰ dhe shfuqizoi një sërë verdiktesh fajësie në të gjitha rastet kur konstatoi se kjo lidhje ishte tejet e dobët.²²¹ Gjithsesi, Dhoma e Apelit konkludoi se ekzistenca e lidhjes ishte vërtetuar në masë të mjaftueshme në rastet kur krimet ishin kryer nga Armata Popullore e Jugosllavisë (“APJ”), Mbrojtja Territoriale (“MT”), dhe forca të tjera, bazuar në:

përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi pozitën e Martiqit si ministër i Brendshëm dhe pushtetin e tij absolut mbi MPB-në, kontrollin e tij mbi forcat e armatosura, MT-në dhe *Milicija Krajine*, bashkëpunimin midis MT-së, APJ-së, *Milicija Krajine* dhe forcave të armatosura të [“Rajonit Autonom Serb (“SAO”)”] të Krajines, dhe kontrollit mbi APJ-në dhe MT-në të ushtruar nga anëtarë të tjerë të NPK-së.²²²

Ky arsyetim përputhet me arsyetimin e ndjekur në Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*, ku Dhoma e Apelit analizoi nëse Millomir Stakiqit mund t’i ngarkoheshin krimet në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, pasi kishte rrëzuar mbështetjen prej Dhomës Gjyqësore të çështjes *Stakiq* në formën e përgjegjësisë së “bashkautorësisë”.²²³ Rrjedhimisht, hidhet poshtë argumenti i Gjorgjeviqit lidhur me këtë pikë.

70. Sa i përket pretendimit për mospërputhje midis Aktgjykimit të Apelit *Martiq* dhe Aktgjykimit të Apelit *Limaj dhe të tjerët*, Gjorgjeviqi shtrembëron konkluzionet e Dhomës së Apelit në ato çështje. Në *Limaj dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit nuk e kundërshtoi konceptin se individë të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale mund “të përdroreshin” për kryerjen e krimeve. Faktikisht, Dhoma e Apelit pranoi se problemi nëse i akuzuari “mund të ngarkohet me përgjegjësi të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime të kryera nga joanëtarë të ndërmarrjes” nuk ishte argumentuar as në procesin gjyqësor, e as në apelim dhe konkludoi se do të ishte e padrejtë të nxirrte verdikte të reja fajësie në atë fazë.²²⁴ Gjithashtu në atë çështje, Dhoma Gjyqësore nuk shpalli verdikte fajësie në lidhje me krime të kryera nga “të jashtëm” sepse nuk ishte në gjendje të identifikonte keqbërësit apo të vërtetonte se këto krime ishin kryer për realizimin e planit të përbashkët, dhe jo sepse keqbërësit nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²²⁵ Ky arsyetim përputhet me jurisprudencën e Tribunalit se kushti kyç për fajësimin e një anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krimet e kryera nga individë të cilët nuk janë anëtarë është se “krimi në fjalë është pjesë e

²¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 181 (theksi i shtuar).

²²⁰ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 181-212.

²²¹ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 192, 200, 207.

²²² Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 187. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 189, 205, 210.

²²³ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 59, 62-63, 79-85. Shih Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 169.

²²⁴ Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 120. Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët* përmend “të jashtëm” në kampin e burgimit (Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 120).

²²⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 115, 117.

qëllimit të përbashkët kriminal²²⁶. Dhoma e Apelit nuk gjen asnjë mospërputhje midis dy aktgjykimeve të veta. Rrjedhimisht hidhet poshtë argumenti përkatës i Gjorgjeviqit.

71. Argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me Aktgjykimin e Apelit *Krajishnik* tregojnë se ai i ka keqkuptuar konkluzionet në atë çështje. Dhoma e Apelit nuk i shfuqizoi verdiktet e fajësisë së Momçillo Krajishnikut për shkak të shtjellimit të gabuar të ligjit mbi ndërmarrjen e përbashkët kriminale prej Dhomës Gjyqësore. Përkundrazi, Dhoma e Apelit konkludoi se Dhoma Gjyqësore bëri parashtrimin e duhur të ligjit përkatës në lidhje me përdorimin e individëve të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve, në përputhje me Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin*.²²⁷ Dhoma e Apelit shfuqizoi disa verdikte fajësie sepse Dhoma Gjyqësore në atë çështje bëri gabime ligjore në lidhje me faktet dhe nuk nxori përfundimet përkatëse.²²⁸ Për më tepër, Gjorgjeviqi shpërfill faktin se Dhoma e Apelit la në fuqi verdiktet e tjera të fajësisë në rastet kur u bind se Dhoma Gjyqësore kishte nxjerrë përfundimet e nevojshme faktike që vërtetnin lidhjen midis autorëve fizikë dhe një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²²⁹

4. Konkluzion

72. Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar ekzistencën e arsyeve të forta që Dhoma e Apelit të anashkalojë jurisprudencën më se të provuar që mundëson fajësimin e anëtarëve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale për krimet e autorëve të drejtpërdrejtë.

E. Pika e tetë e apelit të Gjorgjeviqit: fajësia për krime me synim konkret në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

1. Argumentet e palëve

73. Në pikën e tetë të apelit të tij, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se në qoftë se në kundërshtim me përfundimet e veta, disa krime nuk kishin qenë pjesë e planit të përbashkët (NPK), këto krime ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e këtij plani (kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale).²³⁰ Sipas Gjorgjeviqit, ky konkluzion alternativ është i gabuar sepse parimisht, në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk mund të shpallet asnjë verdikt fajësie për

²²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 418 (theksi në origjinal).

²²⁷ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225-226, 235-236.

²²⁸ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 237, 281, 284.

²²⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 237, 256-257, 259-261, 264, 267, 270, 272, 275, 278, 282.

²³⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 147, përmendet Aktgjykimi, para. 2158.

krime me synim konkret.²³¹ Ai gjithashtu kërkon që Dhoma e Apelit të mos pranojë të nxjerrë verdikte të reja fajësie në lidhje me apelimin e Prokurorisë për përdhunimin si formë përndjekjeje, duke u bazuar vetëm në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²³²

74. Gjorgjeviqi pranon se jurisprudenca e Tribunalit mundëson zbatueshmërinë e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në lidhje me krimet me synim konkret.²³³ Gjithsesi ai parashtron se Dhoma e Apelit duhet ta anashkalojë këtë jurisprudencë dhe të deklarojë se “NPK III nuk është bazë për verdikte fajësie për krime me synim konkret”.²³⁴ Duke iu referuar Vendimit të Apelit *Bërgjanin* të 19 marsit 2004, Gjorgjeviqi pretendon se Dhoma e Apelit duhet të ndjekë pikëpamjen e gjykatësit Shahabuddeen se një person nuk mund të shpallet fajtor si autor i drejtpërdrejtë i një krimi me synim konkret në qoftë se ai nuk ka synim konkret.²³⁵ Gjithashtu, Gjorgjeviqi përmend Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq* ku sipas tij, Dhoma e Apelit “ka miratuar [...] pikëpamjen e gjykatësit Shahabuddeen nëpërmjet shfuqizimit të verdikteve të fajësisë për gjenocid bazuar në kategorinë I dhe kategorinë III të NPK-së, me arsyetimin se gjeneral Kërstiqi nuk kishte synimin konkret të nevojshëm për gjenocid.”²³⁶ Gjithashtu, ai pretendon se Dhoma e Apelit asnjëherë nuk ka vërtetuar se e drejta zakonore ndërkombëtare mundëson zbatimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret.²³⁷ Së fundi, në mbështetje të argumenteve të tij, Gjorgjeviqi citon shkrimet jo brenda kontekstit gjyqësor të gjykatësit Cassese dhe një konkluzion të Dhomës së Apelit të Tribunalit Special për Libanin (“TSL”), ku lexohet se “metodologjia më e mirë në kontekst të së drejtës ndërkombëtare është mosfajësimi në kuadër të NPK-së për krime me synim konkret”.²³⁸

75. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të tregojë arsye të forta që do të justifikonin anashkalimin prej Dhomës së Apelit të jurisprudencës së vet që mundëson verdikte

²³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 155; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 43. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 150-154.

²³² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 147, 155. Dhoma e Apelit konstaton se krimi konkret që apelohej nga Prokuroria është krimi i përndjekjeve nëpërmjet dhunës seksuale (Shih Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 56).

²³³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 148, përmendet Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 9; Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, para. 7.

²³⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 155.

²³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 149-150, citohet Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, Mendim [i Veçantë] dhe Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 4. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 43.

²³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 151, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 134.

²³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 152, përmendet Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 205, 207-209.

²³⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 153-154, citohet Antonio Cassese, “The Proper Limits of Individual Responsibility under the Doctrine of Joint Criminal Enterprise/Kufijtë e Duhur të Përgjegjësisë Individuale në kontekst të Doktrinës së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale”, *Journal of International Criminal Justice*, vol. 5 (2007), p. 121, dhe përmendet *Prokurori k. Salim Jamil Ayyash-it dhe të tjerëve*, Lënda nr. STL-11-01/I/AC/R176bis, Vendim i Ndërkohshëm mbi Ligjin Përkatës: Terrorizëm, Komplot, Vrasje e Paligjshme, Autorësi Krimi, Akuza të Shumëfishta, 16 shkurt 2011 (“Vendim i TSL-së i 16 shkurtit 2011”), para. 249.

fajësie për krime me synim konkret bazuar në kategorinë e tretë të përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²³⁹ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq* ku bazohet Gjorgjeviqi, nuk trajton problemin nëse kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale është e zbatueshme për krimet me synim konkret.²⁴⁰ Për më tepër, Prokuroria parashtron se pjesët përkatëse të Aktgjykimit të Apelit *Tadiq* ku analizohet e drejta zakonore ndërkombëtare në lidhje me këtë aspekt, nuk sugjerojnë se kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale është e papajtueshme me krimet me synim konkret.²⁴¹ Së fundi, Prokuroria parashtron se vendimet e juridiksioneve të tjera të cituara nga Gjorgjeviqi nuk janë detyruese për Dhomën Gjyqësore.²⁴²

76. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq* është i rëndësishëm sepse sipas tij, “Dhoma e Apelit refuzoi të nxirrte, madje edhe të shqyrtonte mundësinë e nxjerrjes së një verdikti të ri fajësie na bazë të kategorisë III të NPK-së, kur shfuqizoi fajësinë në bazë të kategorisë I të NPK-së”.²⁴³ Sipas tij, kjo provon se jurisprudenca në këtë pikë “ende nuk është përfundimtare”.²⁴⁴ Gjithashtu, Gjorgjeviqi pretendon se Prokuroria nuk shpjegoi arsyen pse Dhoma e Apelit nuk duhet t’i kushtojë “rëndësi të konsiderueshme” Vendimit të TSL-së të 16 shkurtit 2011.²⁴⁵

2. Analizë

77. Dhoma e Apelit rikujton se:

si formë përgjegjësie, kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk është e ndryshme nga format e tjera të përgjegjësisë penale për të cilat nuk kërkohet provë për synim për kryerjen e një krimi nga i akuzuari para se ai të ngarkohet me përgjegjësi penale.²⁴⁶

Në qoftë se vërtetohet standardi përkatës për atë formë përgjegjësie, pra “pasoja logjike të parashikueshme dhe të natyrshme”, atëherë të akuzuarit mund t’i atribuohet përgjegjësi penale për çfarëdo krimi jashtë kontekstit të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të arritur me marrëveshje.²⁴⁷

²³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 124.

²⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 125, përmendet Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 633, Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 134.

²⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 126. Sipas Prokurorisë, faktikisht, “Dhoma e Apelit rikujtoi se rëndësi ka fakti se krimi i paplanifikuar duhet të jetë pasojë e parashikueshme dhe jo thjesht pasojë rastësore e krimit me synim” (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 126, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 218-220).

²⁴² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 127.

²⁴³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 42.

²⁴⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 42.

²⁴⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 43.

²⁴⁶ Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, para. 7.

²⁴⁷ Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, para. 9.

Konkretisht, Dhoma e Apelit ka gjykuar se një i akuzuar mund të shpallet penalisht përgjegjës në kuadrin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret në qoftë se krimet ishin logjikisht të parashikueshme për të akuzuarin.²⁴⁸

78. Për arsyet e shtjelluara më poshtë, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë ekzistencën e arsyeve të forta për anashkalimin e kësaj jurisprudence.

79. Në Vendimin e Apelit *Bërgjanin* të 19 marsit 2004, gjykatësi Shahabuddeen nuk shprehu mospajtim, por një mendim të veçantë se kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale “nuk përjashtoj në rastet e krimeve për të cilat kërkohet provë e synimit konkret”.²⁴⁹ Sipas gjykatësit Shahabuddeen, zbatimi i kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale “nuk eliminon nevojën për të provuar ekzistencën e synimit, por ofron një mënyrë për të provuar synimin në rrethana konkrete, gjegjësisht nëpërmjet provës së parashikimit në këto rrethana”.²⁵⁰

80. Argumenti i Gjorgjeviqit është çorientues në lidhje me Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq*.²⁵¹ Në çështjen *Kërstiq*, fajësia për gjenocid u shpall në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ku kërkohet që të gjithë anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të kenë të njëjtin synim për kryerjen e krimin të përbashkët.²⁵² Në atë çështje, Dhoma e Apelit gjykoi se Dhoma Gjyqësore kishte nxjerrë konkluzionin e gabuar se Radislav Kërstiqi kishte synimin për kryerjen e gjenocidit, kështu që Dhoma e Apelit e shpalli fajtor për ndihmë dhe inkurajim të gjenocidit.²⁵³ Në lidhje me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Dhoma e Apelit la në fuqi verdiktet e fajësisë së Radislav Kërstiqit për veprime çnjerëzore dhe përndjekje, që ndodhën si pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për zhvendosjen me dhunë të civilëve myslimanë boshnjakë nga Potoçari.²⁵⁴ Në nxjerrjen e këtyre vendimeve, Dhoma e Apelit qartësoi se “ishte

²⁴⁸ Shih Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, para. 6 (ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se një i akuzuar mund të shpallet fajtor për krimin e gjenocidit në kontekstin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale). Shih gjithashtu Aktgjykimin i Apelit *Stakiq*, para. 38.

²⁴⁹ Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 8.

²⁵⁰ Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 2. Shih gjithashtu Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i 19 marsit 2004, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 6-8. Për një pasqyrim më të hollësishëm të pikëpamjeve të tij mbi këtë temë, shih Aktgjykimin i Apelit *Krajishnik*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 29-52.

²⁵¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 151.

²⁵² Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 644.

²⁵³ Aktgjykimin i Apelit *Kërstiq*, para. 133-134, 143-144. Gjykatësi Shahabuddeen shpjegoi si ai nuk pajtohej me shumicën e Dhomës së Apelit dhe mendonte se Dhoma Gjyqësore me të drejtë kishte konkluduar se Kërstiqi kishte synimin e nevojshëm për fajësinë për gjenocid në bazë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (Aktgjykimin i Apelit *Kërstiq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 2, 72, 95-96). Gjorgjeviqi nuk paraqet fakte në mbështetje të pretendimit se Dhoma e Apelit në çështjen *Kërstiq* duhej të kishte shqyrtuar mundësinë e fajësisë për gjenocid në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (Shih Aktgjykimin i Apelit *Kërstiq*, sh. 234, duke saktësuar se në kontekst të atij apelimi, Dhoma e Apelit shqyrtoi vetëm ndihmën dhe inkurajimin).

²⁵⁴ Aktgjykimin i Apelit *Kërstiq*, para. 149-151, f. 87; Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 617-618.

e mjaftueshme që [kryerja e krimeve të tjera] ishte e parashikueshme për të dhe se krimet e tjera faktikisht u kryen”.²⁵⁵ Në kundërshtim me pretendimet e Gjorgjeviqit, Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq* faktikisht konfirmoi se është e mundshme që bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, të jepen verdikte fajësie për krime me synim konkret.²⁵⁶

81. Lidhur me argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma e Apelit asnjëherë nuk ka konkluduar se e drejta zakonore ndërkombëtare ofron bazë për kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret, Dhoma e Apelit thekson se ka vërtetuar që kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale si formë përgjegjësie, ekzistonte në të drejtën zakonore ndërkombëtare para periudhës së trajtuar në Aktakuzë.²⁵⁷ Për më tepër, Dhoma e Apelit është shprehur se ndërmarrja e përbashkët kriminale vlen për **të gjitha krimet** brenda juridiksionit të Tribunalit, e në këtë mënyrë edhe për krimet me synim konkret.²⁵⁸ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se nuk është kusht që të provohet se çdo *kombinim* i mundshëm midis krimit dhe formës së fajësisë të lejohet shprehimisht ose të ketë precedentë në të drejtën zakonore ndërkombëtare.

82. Përsa u përket çështjeve *Essen Lynching* dhe *Borkum Island*, për të cilat Gjorgjeviqi pretendon se nuk mbështesin zbatueshmërinë e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret,²⁵⁹ Dhoma e Apelit thekson se këto çështje u përmendën në çështjen *Tadiq* vetëm si “shembuj” të ekzistencës së kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe nuk u diskutuan në kontekst të krimeve me synim konkret,²⁶⁰ e as ishte e nevojshme të diskutoheshin. Rrjedhimisht, këto çështje nuk kanë vlerë për analizën e tanishme. Dhoma e Apelit nuk e gjykon bindës as pretendimin tjetër të Gjorgjeviqit se çështja *Essen Lynching* “sugjeron se [kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale] nuk mund të shërbejë si bazë për fajësinë e një të akuzuari për një krim me synim kriminal më të gjerë se plani origjinal”.²⁶¹ Përkundrazi, Dhoma e Apelit thekson se ndonëse plani origjinal i të akuzuarve në çështjen *Essen Lynching* përfshinte keqtrajtimin e të ndaluarve, në fund ata u shpallën fajtorë për vrasje sepse ata parashikuan mundësinë e vrasjes dhe e morën atë rrezik me vullnet të plotë.²⁶²

²⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 150.

²⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 150-151, f. 87; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 617-618.

²⁵⁷ Shih më lart, para. 58.

²⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 188-193; Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i 22 tetorit 2004, para. 10, 17, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 188, 190.

²⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 152.

²⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 205.

²⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 152.

²⁶² Çështja *Essen Lynching* f. 89-90. Shih gjithashtu transkriptet e argumenteve gojore në *Gjykimi i Erich Heyer-it dhe Gjashtë Të Tjerëve*, Gjykata Ushtarake Britanike për Gjykimin e Krimineleve të Luftës, Essen, 18-19 dhe 21-22 dhjetor, 1945, raporte ligjore të gjyqimeve të kriminelëve të luftës, UNWCC, vëll. I, f. 65-66. Shih më lart, para. 49.

83. Së fundi, në lidhje me mbështetjen e Gjorgjeviqit në Vendimin e TSL-së të 16 shkurtit 2011, Dhoma e Apelit thekson se ky vendim nuk ka efekt detyrues për Tribunalin.²⁶³ Dhoma e Apelit e TSL-së e gjykoi të përshtatshme të mos lejonte verdikte fajësie brenda kontekstit të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime me synim konkret si terrorizmi.²⁶⁴ Ndonëse Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma e Apelit e TSL-së konkludoi se “e drejta zakonore ndërkombëtare nuk mundëson fajësinë si autor i drejtpërdrejtë për krime me synim konkret mbi bazën e synimit kriminal të parashikueshmërisë dhe marrjes së rrezikut”,²⁶⁵ Dhoma e Apelit e TSL-së nuk përmend të drejtën *zakonore* ndërkombëtare gjatë diskutimit të kësaj teme.²⁶⁶ Jurisprudenca e këtij Tribunali jo vetëm mundëson parimisht verdikte fajësie për krime me synim konkret në kontekstin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por edhe disa të akuzuar janë shpallur faktikisht fajtorë për krime me synim konkret në përputhje me përgjegjësinë e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁶⁷ Këta janë precedentë që nuk mund të rrëzohen lehtësisht nga Dhoma e Apelit thjesht për arsyen se një gjykatë tjerë ka marrë vendim të ndryshëm për këtë aspekt. Po ashtu, megjithëse Tribunali mund të marrë parasysh shkrime akademike dhe vendime të gjykatave të tjera në marrjen e vendimeve ligjore, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi nuk shpjegon pse Vendimi i TSL-së i 16 shkurtit 2011 ose shkrimi individual i gjykatësit justifikojnë anashkalimin e praktikës së mëparshme.

3. Konkluzion

84. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se parashtrimet e Gjorgjeviqit nuk zbulojnë arsye të forta për anashkalimin e jurisprudencës tashmë të rrënjosur të Tribunalit në lidhje me përgjegjësinë për krime me synim konkret sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

F. Konkluzion

85. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon pikën e dytë, pikën e gjashtë (pjesërisht),²⁶⁸ dhe pikën e tetë të apelit të Gjorgjeviqit.

²⁶³ Shih, Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 24.

²⁶⁴ Vendimi i TSL-së i 16 shkurtit 2011, para. 249.

²⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 154.

²⁶⁶ Vendimi i TSL-së i 16 shkurtit 2011, para. 248-249.

²⁶⁷ P.sh. Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 150; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 194-195, 202-204, 205. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Popoviq dhe të tjerët*, vëll. 2, para. 1195, 1332, 1427, 1733-1735 (në apel).

²⁶⁸ Një nga argumentet e Gjorgjeviqit në pikën 6 të apelit (përkatesisht se Dhoma Gjyqësore zbatoi në mënyrë të gabuar standardet ekzistuese në lidhje me përdorimin e autorëve të drejtpërdrejtë nga anëtarët e NPK-së) është analizuar veçazi në Kapitullin VIII të Aktgjykimit (Shih më poshtë, para. 161-172).

IV. PIKA E PARË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME EKZISTENCËN E NPK-SË

A. Hyrje

86. Dhoma Gjyqësore konkludoi se NPK-ja u formua nga mesi i janarit 1999, në qoftë se jo më parë.²⁶⁹ NPK-ja kishte qëllimin e ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës, për të mundësuar kontrollin serb mbi krahinën nëpërmjet ndërmarrjes së një fushate terrori dhe dhune kundër shqiptarëve kosovarë.²⁷⁰ Dhoma Gjyqësore konstatoi se kjo fushatë filloi më 1998 para ekzistencës së NPK-së nga mesi i janarit 1999, dhe u vu në zbatim nga forcat e RFJ-së, konkretisht forcat e UJ-së, ose forcat e Republikës së Serbisë, konkretisht forcat e MPB-së, ose të dyja forcat bashkërisht (“forcat serbe”) kundër shqiptarëve kosovarë, nga viti 1998 dhe në vijim gjatë tërë luftës.²⁷¹ Gjithashtu u konkludua se shkalla dhe natyra si dhe struktura e “forcave të koordinuara që zbatuan atë”, provuan qartë ekzistencën e “udhëheqjes që përfshinte strukturat politike, ushtarake dhe policore të qeverive të RFJ-së dhe Serbisë që drejtonte dhe koordinonte ngjarjet në terren”.²⁷²

87. Për nxjerrjen e konkluzionit mbi ekzistencën e NPK-së, Dhoma Gjyqësore identifikoi dhe analizoi shtatë faktorë si provë e planit të përbashkët: (i) treguesit demografikë; (ii) shtimi dhe përdorimi i forcave serbe dhe armatosja e popullatës civile joshqiptare në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit të 1998 dhe bisedimet për paqe që po zhvilloheshin në fillim të vitit 1999; (iii) praktika e krimeve; (iv) përdorimi në mënyrë të koordinuar i MPB-së dhe UJ-së;; (v) përdorimi i forcës së tepruar gjatë operacioneve “kundërterroriste”; (vi) grumbullimi

²⁶⁹ Aktgjykimi, para. 2134; më poshtë, para. 121-123.

²⁷⁰ Aktgjykimi, para. 2007, 2128, 2130-2131. Në Aktakuzë lexohet se qëllimi i NPK-së “ndër të tjera ishte ndryshimi i përbërjes etnike në Kosovë për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën. Ky qëllim do të arrihej nëpërmjet metodave kriminale nëpërmjet një fushate gjerësisht të përhapur ose sistematike terrori dhe dhune që përfshinte dëbimet, vrasjet, shpërnguljet e dhunshme dhe përndjekjet kundër popullatës shqiptare kosovare gjatë periudhës së Aktakuzës” (Aktakuza, para. 19).

²⁷¹ Aktgjykimi, para. 2130, 2134. Dhoma Gjyqësore i përkufizoi forcat serbe si forca të Republikës Federale të Jugosllavisë (“RFJ”), konkretisht forcat e Ushtrisë Jugosllave (“UJ”), ose forca të Republikës së Serbisë, konkretisht forcat e MPB-së, ose të dyja forcat bashkërisht (Aktgjykimi, para. 6). Dhoma e AELIT do të përdorë të njëjtin përkufizim në Aktgjykimin e vet.

²⁷² Aktgjykimi, para. 2130. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2126-2128. Dhoma Gjyqësore identifikoi këta anëtarë të NPK-së:

përsa i përket elementit politik [...] Presidenti i RFJ-së, Slobodan Millosheviqi, zëvendëskryeministri i RFJ-së përgjegjës për Kosovën, Nikolla Shainoviqi [...] Përsa u përket anëtarëve të NPK-së nga radhët e MPB-së [...] ministri i Punëve të Brendshme, Vllajko Stojilkoviqi, i Akuzuari Vllastimir Gjorgjeviqi, i cili ishte shef i RJB-së, Radomir Markoviqi, shef i Drejtorisë së Sigurimit Shtetëror të MPB-së (“RDB”), shefi i Shtabit të MPB-së për Kosovën, Sreten Llukiqi, shefi i Administratës Policore të RJB-së, Obrad Stevanoviqi, dhe shefi i Administratës së Policisë për Krime, Dragan Iliqi [...]. Përsa u përket anëtarëve të NPK-së nga radhët e UJ-së [...], shefi i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së, Dragolub Ojdaniqi, komandanti i Armatës së Tretë të UJ-së, Nebojsa Pavkoviqi dhe komandanti i Korpusit të Prishtinës, Vladimir Llazareviqi [...]. (Aktgjykimi, para. 2127).

sistematik i letërnjoftimeve dhe targave të automjeteve të shqiptarëve kosovarë; dhe (vii) përpjekjet për fshehjen e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë.²⁷³

88. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi gjatë “analizimit të synimeve të anëtarëve të NPK-së së pretenduar” dhe si rrjedhojë edhe thjesht të ekzistencës së NPK-së, si edhe “në nxjerrjen e konkluzionit se ekzistonte një sulm gjerësisht i përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile”.²⁷⁴ Konkretisht, Gjorgjeviqi pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk bëri vlerësim të duhur të faktorëve vijues, të marrë veçazi dhe bashkërisht: (i) shkelja e Marrëveshjeve të Tetorit;²⁷⁵ (ii) natyra e rrezikut prej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”); dhe (iii) natyra e rrezikut prej NATO-s.²⁷⁶ Sipas, Gjorgjeviqit, si pasojë Dhoma Gjyqësore nuk bëri vlerësimin e rrethanave në kontekstin e duhur dhe arriti në konkluzionin përfundimtar të gabuar se anëtarët e NPK-së e konsideronin krejt popullatën shqiptare kosovare si armik.²⁷⁷

89. Dhoma e Apelit do të verifikojë nëse Dhoma Gjyqësore bëri gabim në analizimin e këtyre faktorëve veçazi dhe bashkërisht.

B. Shkelja e Marrëveshjeve të Tetorit

1. Argumentet e palëve

90. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri cilësim të gabuar të veprimeve të RFJ-së si shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit dhe rrjedhimisht si tregues të ekzistencës së NPK-së.²⁷⁸ Gjorgjeviqi argumenton se Marrëveshjet e Tetorit nuk duheshin konsideruar detyruese ndaj RFJ-së sepse UÇK-ja nuk i respektoi dhe Misioni Verifikues për Kosovën (“MVK”) nuk arriti të garantonte respektimin e këtyre marrëveshjeve nga UÇK-ja.²⁷⁹ Sipas tij, në këto marrëveshje parashikohej e drejta e RFJ-së për t’iu kundërpërgjigjur veprimeve të UÇK-së.²⁸⁰ Për më tepër, Gjorgjeviqi pretendon se Marrëveshjet e Tetorit ishin “të dështuara që në

²⁷³ Aktgjykimi, para. 2008.

²⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 6. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 8, 17.

²⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 6. Dhoma Gjyqësore përcaktoi se titulli “Marrëveshjet e Tetorit” përfshinte: (i) një dokument të titulluar “Marrëveshje Mirëkuptimi Midis [Misionit të Vëzhguesve Diplomatikë në Kosovë] dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë”, nënshkruar nga Shaun Byrnes për delegacionin ndërkombëtar dhe nga Gjorgjeviqi për palën serbe; dhe (ii) një dokument të titulluar “Procesverbal i Takimit në Beograd, 25 tetor 1998” nënshkruar në emër të autoriteteve të RFJ-së nga Nikolla Shainoviqi, (“Shainoviqi”), zëvendëskryeministër i RFJ-së, në emër të Republikës së Serbisë nga Gjorgjeviqi, shef i RJB-së së MPB-së, dhe për Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (“NATO”) nga gjeneral Klaus Naumann dhe gjeneral Wesley Clark (Aktgjykimi, para. 360-363).

²⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 6; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 171-172.

²⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 8, përmendet Aktgjykimi, para. 2018.

²⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 10, përmendet, ndër të tjera, Aktgjykimi, ndarja XII.B.2(ii). Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 7.

²⁷⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 9.

²⁸⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 9, përmendet Prova Materiale P837, Neni III.

pikënisje”.²⁸¹ Ai parashtron se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* mori më shumë prova domethënëse dhe pranoi se negociatat për Marrëveshjet e Tetorit kishin qenë të anshme kundër RFJ-së.²⁸²

91. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë gjykoi se shkeljet e Marrëveshjeve të Tetorit ishin prova për ekzistencën një plani kriminal të përbashkët.²⁸³ Gjithashtu, Prokuroria parashtron se në kundërshtim me argumentet e Gjorgjeviqit, Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët* përmban arsyetim të ngjashëm dhe arrin në të njëjtat konkluzione në lidhje me këtë pikë.²⁸⁴

2. Analizë

92. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi keqkupton referimin e Dhomës Gjyqësore në shkeljen e Marrëveshjeve të Tetorit prej RFJ-së. Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se shkelja e Marrëveshjeve të Tetorit në vetvete ishte tregues i ekzistencës së NPK-së.²⁸⁵ Faktikisht, Dhoma Gjyqësore mori parasysh qëndrimin e disa anëtarëve të NPK-së kundrejt Marrëveshjeve të Tetorit në kontekstin e tërësisë së provave,²⁸⁶ dhe konkludoi se:

provat për shtimin gradual të efektivit të forcave të UJ-së, MPB-së dhe forcave të tjera lidhur me to dhe përdorimin e tyre, si edhe armatosjen e popullatës civile joshqiptare që nga fillimi i vitit 1999, në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit dhe me qëllimin e deklaruar për gjetjen e zgjidhjes politike për çështjen e Kosovës, së bashku me një sërë mbledhjesh të mbajtura duke filluar nga fundi i tetorit 1998 në të cilat morën pjesë udhëheqës të lartë politikë, ushtarakë dhe të MPB-së gjatë të cilave u diskutuan plane për pengimin e monitorimit të mirëfilltë të veprimeve të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë prej përfaqësuesve të MVK-së, vërtetojnë se udhëheqësit politikë, ushtarakë dhe policorë të Serbisë dhe të RFJ-së kishin hartuar një plan të përbashkët.²⁸⁷

93. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit mendon se fakti nëse negociatat ndërkombëtare nuk ishin tërësisht të paanshme nuk ka vlerë thelbësore nga ana ligjore duke marrë parasysh konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se udhëheqësit politikë, ushtarakë dhe policorë të Serbisë dhe të RFJ-së kishin hartuar një plan të përbashkët, bazuar ndër të tjera në provat për shtimin gradual të efektivit të forcave serbe në Kosovë, armatosjen e popullatës civile joshqiptare të Kosovës dhe mbledhjet gjatë të cilave u diskutuan plane për pengimin e zbatimit të duhur të

²⁸¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para 10. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 168-169, ku Gjorgjeviqi argumenton se “prapakthimi” të ngjarjet rreth Marrëveshjeve të Tetorit të vitit 1998 e bënë Dhomën Gjyqësore të tejkalohe kufijtë dhe të mbivlerësonte rolin e tij në NPK. Mbështetja prej Dhomës Gjyqësore në ngjarjet e vitit 1998 për të analizuar pjesëmarrjen e tij në NPK do të diskutohet në kontekstin e pikës 9(C) të apelit të Gjorgjeviqit (Shih më poshtë, para. 292-299).

²⁸² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 10, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 410.

²⁸³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 15, përmendet Aktgjykimi, para. 2008, 2026.

²⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 18, citohet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 410, vëll. 3, para. 76.

²⁸⁵ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore e bazoi konkluzionin e vet mbi ekzistencën e NPK-së në shtatë tregues (Shih më lart, para. 87. Shih gjithashtu më poshtë, para. 183).

²⁸⁶ Aktgjykimi, para. 2012-2014.

²⁸⁷ Aktgjykimi, para. 2026.

Marrëveshjeve të Tetorit.²⁸⁸ Më tej, problemi nëse Marrëveshjet e Tetorit ishin ose nuk ishin detyruese për RFJ-në, apo nëse RFJ-ja kishte “të drejtë t’u kundërpërgjigjej veprimeve të UÇK-së” nuk e cenon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se kundër popullatës civile u ndërморën sulme,²⁸⁹ ose se forcat serbe përdorën forcë të tepruar gjatë operacioneve të supozuara kundërterroriste.²⁹⁰ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se Dhoma Gjyqësore bëri gabim.

C. Natyra e rrezikut prej UÇK-së

1. Argumentet e palëve

94. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri vlerësim të gabuar në lidhje me madhësinë dhe natyrën e UÇK-së.²⁹¹ Së pari, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se forcat e MPB-së dhe të UJ-së të marra së bashku ishin shtatëfishi i forcave të UÇK-së.²⁹² Veçanërisht ai pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim që u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit Richard Ciaglini (“Dëshmitar Ciaglini”), i cili bëri të ditur se UÇK-ja kishte 10.000 ushtarë dhe jo në dëshminë e Dëshmitarit Bislim Zyrapi (“Dëshmitar Zyrapi”), sipas të cilit UÇK-ka kishte rreth 17.000-18.000 ushtarë.²⁹³ Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri këto gabime: (i) nuk mori parasysh deklaratën e Dëshmitar Ciaglini-t se ishte “thujse e pamundur” të përlllogaritej numri i ushtarëve të UÇK-së; (ii) konkludoi se Dëshmitar Zyrapi mund të ketë pasur interes në paraqitjen e një numri më të madh ushtarësh; dhe (iii) shpërfilli dëshmitë e vëzhguesve të tjerë ndërkombëtarë sipas të cilëve kishte gjasë që anëtarësia e UÇK-së të ishte e pakufizuar.²⁹⁴

95. Së dyti, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk mori parasysh taktikat e UÇK-së gjatë analizimit të veprimeve të RFJ-së.²⁹⁵ Veçanërisht, ai pretendon se në nxjerrjen e konkluzioneve të veta përfundimtare mbi përdorimin e tepruar të forcës, Dhoma Gjyqësore bëri gabim që nuk mbajti parasysh: (i) armatimin që kishte UÇK-ja;²⁹⁶ (ii) se UÇK-

²⁸⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2013-2014.

²⁸⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 109. Dhoma e Apelit rikujton se në jurisprudencën e Tribunalit është përcaktuar se “nga pikëpamja ligjore nuk ka rëndësi nëse sulmi ishte parandalues, mbrojtës apo mësymës [...]. Problemi në rastin në fjalë është nëse mënyra e zbatimit të operacionit ushtarak ishte apo nuk ishte kriminale.” (Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 268 citohet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 812). Shih Aktgjykimi, para. 2016.

²⁹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 2052-2069. Shih më lart, para. 87; më poshtë, para. 102, 106-109, 184.

²⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 11.

²⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 12, përmendet Aktgjykimi, para. 2061.

²⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 11-12, përmendet Aktgjykimi, para. 1540, Prova Materiale P833, f. 3336.

²⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 12, përmendet Aktgjykimi, para. 1540. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 8.

²⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 13.

²⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 13, përmendet Aktgjykimi, para. 1567. Gjorgjeviqi përmend armë kundërtanke, mitraloza të rëndë, granatahedhës, Zola, mortaja 80 dhe 120-milimetërshe dhe armë të tjera të rënda.

ja ishte “oportuniste – ditën shtireshin si bujq, mirëpo natën faktikisht shndërroheshin në UÇK”, e në këtë mënyrë u pamundësonte forcave të RFJ-së të bënin dallimin midis civilëve dhe luftëtarëve;²⁹⁷ (iii) dëshminë e Dëshmitarit Karol John Drewienkiewicz se UÇK-ja kishte deklaruar që 1999 do të ishte viti i pavarësisë së Kosovës dhe UÇK-ja u bë edhe më oportuniste gjatë dhe pas bisedimeve në Rambuje në shkurt 1999;²⁹⁸ dhe (iv) dëshminë e Dëshmitarit Joseph Maisonneuve se brenda 23 janarit 1999, UÇK-ja kishte hartuar plane për rifillimin e luftimeve në përgjithësi dhe se në mars 1999, iu kthye dhunës në masë të gjerë.²⁹⁹ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore vazhdimisht dhe gabimisht deduktoi se veprimet luftarake të forcave të RFJ-së ishin shproporcionale në raport me rrezikun me të cilin përballeshin.³⁰⁰

96. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri një vlerësim të arsyeshëm të madhësisë numerike dhe taktikave të UÇK-së.³⁰¹ Gjithsesi, Prokuroria parashtron se edhe sikur të pranoheshin argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me rrezikun e UÇK-së, ato nuk cenojnë konkluzionin përfundimtar të Dhomës Gjyqësore se operacionet e forcave serbe ishin shproporcionale dhe më shumë se kundërterroriste.³⁰²

2. Analizë

97. Në lidhje me madhësinë numerike të UÇK-së, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi konkretisht dhe rrëzoi dëshminë e Dëshmitar Zyrapit se UÇK-ja kishte 17.000-18.000 luftëtarë, pas analizimit të besueshmërisë së dëshmitarit.³⁰³ Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi thjesht përsërit argumente të cilat ishin të pasuksesshme në gjykim,³⁰⁴ dhe nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim në parapëlqimin e dëshmisë së Dëshmitar Ciaglinski-t në vend të Dëshmitar Zyrapit.³⁰⁵ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në përlllogaritjen e numrit të luftëtarëve të UÇK-së. Gjithsesi, Dhoma e Apelit vë në dukje konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se përbërja numerike e forcave serbe në Kosovë ishte 14.571-15.779 efektivë të MPB-së dhe 61.892 efektivë të UJ-së.³⁰⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se edhe sikur të kishte konkluduar se Dhoma Gjyqësore gaboi me refuzimin e dëshmisë sipas të cilës UÇK-ja kishte 17.000-18.000 luftëtarë, ky gabim

²⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 13, përmendet Karol John Drewienkiewicz, 22 qershor 2009, T. 6378, Prova Materiale P997, f. 7878.

²⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 14, përmendet Prova Materiale P996, para. 114, 189.

²⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 15, përmendet Prova Materiales P873, f. 3, P853, f. 11044, 11119-11121, 11126.

³⁰⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 171.

³⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 19-27.

³⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 23, 27, përmendet Aktgjykimi, para. 2052-2053, 2055, 2061, 2069.

³⁰³ Aktgjykimi, para. 1539-1540, 2052.

³⁰⁴ Aktgjykimi, para. 2052, 2055, 2065. Shih më lart, para. 20. Shih gjithashtu më poshtë, para. 522.

³⁰⁵ Aktgjykimi, para. 1539-1540, 2052, 2058.

³⁰⁶ Aktgjykimi, para. 2060.

nuk do të kishte pasur asnjë ndikim ndaj konkluzionit të Dhomës Gjyqësore se forcat serbe kishin epërsi të madhe numerike ndaj UÇK-së dhe se këto shifra ishin një “tregues tjetër” se qëllimi i operacioneve të forcave serbe tejkaloi shumë objektivat e luftës kundër terrorizmit.³⁰⁷ Gjithashtu, gabimi nuk do të kishte zhvlerësuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore për përdorim të forcës së tepruar nga forcat serbe.³⁰⁸ Dhoma e Apelit thekson se nxjerrjen e konkluzionit mbi proporcionalitetin e sulmeve, Dhoma Gjyqësore nuk e mbështeti mbi përfundimin e vet mbi epërsinë numerike të forcave serbe ndaj UÇK-së, por këtë provë e shqyrtoi në kontekstin e provave të shumta mbi praktikën e forcës së tepruar përdorur nga forcat serbe kundër popullatës shqiptare kosovare.³⁰⁹

98. Gjithashtu, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh taktikat e UÇK-së në terren në Kosovë dhe armët që dispononte.³¹⁰ Veçanërisht, Dhoma Gjyqësore pranoi shprehimisht se kishte pasur raste kur forcat serbe mund të jenë përballur me individë për të cilët dyshonin se ishin anëtarë të UÇK-së, edhe pse të veshur civilë.³¹¹ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore ishte në dijeni të qëndrimit të UÇK-së para, gjatë dhe pas negociatave të Rambujesë.³¹² Sidoqoftë, Dhoma Gjyqësore u bind se shumica e krimeve të kryera në Kosovë më 1999, ndodhën në rrethana ku thuajse nuk kishte veprimtari të UÇK-së. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forca e përdorur nga forcat serbe ishte “krejtësisht e tepruar”.³¹³ Gjorgjeviqi përsërit argumente që rezultuan të pafrytshme në gjykim,³¹⁴ dhe nuk ka provuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion.

99. Së fundi, Dhoma e Apelit gjykon se qëndrimi dhe deklaratat e UÇK-së gjatë negociatave ndërkombëtare nuk kanë asnjë ndikim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi përdorimin e tepruar të forcës nga forcat serbe.³¹⁵ Ndonëse nuk përmendi konkretisht provat e cituara nga Gjorgjeviqi, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi qartazi qëndrimin e UÇK-së para, gjatë dhe pas negociatave të Rambujesë.³¹⁶ Sikurse u përmend më lart, Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi taktikat e UÇK-së në terren si dhe mbajti parasysh faktin se më 1999, shkalla dhe niveli i kontrollit territorial të UÇK-së në Kosovë ishin më të pakta se më 1998.³¹⁷ Rrjedhimisht, argumenti i Gjorgjeviqit në këtë pikë hidhet poshtë.

³⁰⁷ Aktgjykimi, para. 2061.

³⁰⁸ Aktgjykimi, para. 2065-2069.

³⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2062-2069, 2083-2085.

³¹⁰ Aktgjykimi, para. 1564-1570, 2065.

³¹¹ Aktgjykimi, para. 2065.

³¹² Shih Aktgjykimi, para. 432-433.

³¹³ Aktgjykimi, para. 2065.

³¹⁴ Aktgjykimi, para. 2054-2055, 2064-2065. Shih më lart, para. 20. Shih gjithashtu më poshtë, para. 522.

³¹⁵ Shih më poshtë, para. 106-110.

³¹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 432-433.

³¹⁷ Shih më lart, para. 97-98; Aktgjykimi, para. 2059.

D. Natyra e rrezikut prej NATO-s

1. Argumentet e palëve

100. Gjorgjeviqi argumenton se gjatë shqyrtimit të proporcionalitetit të veprimeve të RFJ-së, Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk mori parasysh: (i) bombardimin e NATO-s që shkaktoi vrasjen e së paku 500 civilëve;³¹⁸ dhe (ii) provat që vërtetonin se “NATO-ja ka vendosur të mbështesë UÇK-në dhe ‘ndryshimin e regjimit’ në Serbi dhe se UÇK-ja ishte instrumenti zbatues i këtij”.³¹⁹

101. Prokuroria parashtroi se Dhoma Gjyqësore vlerësoi dhe shqyrtoi si duhej ndërhyrjen e NATO-s dhe se përfundimet e veta mbi përdorimin e MPB-së dhe UJ-së për zbatimin e planit të përbashkët kriminal nuk cenohen nga argumentet e Gjorgjeviqit.³²⁰

2. Analizë

102. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se forcat serbe përdorën forcë të tepruar në kuadrin e një sulmi kundër popullatës shqiptare kosovare. Gjorgjeviqi nuk ka shpjeguar se si granatimi, grabitja dhe/ose djegia e fshatrave mund të konsiderohen si forcë proporcionale kundër UÇK-së, kur në këto fshatra nuk kishte ose kishte fare pak veprimtari të UÇK-së dhe ku u vranë shqiptarë kosovarë të paarmatosur, të ndaluar ose të cilët nuk merrnin pjesë në luftime.³²¹

E. Rezultantja e kundërshtimeve të Gjorgjeviqit

1. Argumentet e palëve

103. Gjorgjeviqi këmbëngul se në qoftë se Dhoma Gjyqësore do të kishte marrë parasysh si duhej të gjithë faktorët e përmendur më lart, do të kishte konkluduar se planet dhe operacionet e RFJ-së ishin përgjigje proporcionale dhe të ligjshme ndaj rrezikut prej UÇK-së dhe NATO-s, dhe jo tregues të ekzistencës së një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve.³²² Gjorgjeviqi argumenton se në mungesë të vlerësimit të duhur të kontekstit dhe rreziqeve me të cilat u përball RFJ-ja, konkluzioni se popullata civile ishte objektivi parësor nuk qëndron.³²³ Gjithashtu, Gjorgjeviqi parashtroi se

³¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 16, përmendet Raporti Përfundimtar për Prokurorin prej Komisionit për Shqyrtimin e Fushatës së Bombardimit të NATO-s Kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, para. 54. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 18.

³¹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 16, përmendet Prova Materiales P1335, f. 3-10, P1402 f. 9866, D170, D545, D549, D750, para. 21, D767. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 9.

³²⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 28-29, përmendet Aktgjykimi, para. 2017, 2020.

³²¹ Aktgjykimi, para. 2027-2035, 2055, 2065. Shih më lart, para. 98; më poshtë, para. 524.

³²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 17, përmendet Aktgjykimi, para. 2020-2026.

³²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 18, përmendet Aktgjykimi, para. 1599-1600.

Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se NPK-ja ekzistonte vetëm bazuar në faktin se ishin kryer krime.³²⁴ Ai pranon se “veprimet e nevojshme” nga forcat e RFJ-së “u shoqëruan me krime kundër civilëve”, mirëpo pretendon se “jo domosdoshmërisht qëllimi i udhëheqjes ishte kriminal”.³²⁵

104. Prokuroria sugjeron se kjo pikë e apelit duhet hedhur poshtë menjëherë dhe se gjithsesi, Gjorgjeviqi nuk provon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se përdorimi i forcës nga forcat serbe ishte i tepruar.³²⁶ Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi shpërfill faktorët përkatës të marrë parasysh nga Dhoma Gjyqësore për vërtetimin e ekzistencës së planit të përbashkët kriminal si: (i) treguesit demografikë; (ii) praktika e krimeve; (iii) përdorimi i koordinuar i MPB-së dhe UJ-së në kryerjen e krimeve; (iv) grumbullimi gjerësisht i përhapur i dokumenteve të identitetit; dhe (v) fshehja e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë.³²⁷

105. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se në Aktgjykim veprimet e NATO-s dhe të UÇK-së përmenden në analizimin e planit të përbashkët, por këto veprime nuk përfshihen në kontekstin e duhur të tyre si rreziqe të përbashkëta ndaj “papakshëmërisë sovraane të RFJ-së”.³²⁸ Sipas Gjorgjeviqit, nga kjo rrjedh se Dhoma Gjyqësore gaboi në “analizimin e synimeve të anëtarëve të NPK-së në zbrazëti”.³²⁹ Gjorgjeviqi mendon se veprimet e RFJ-së ishin në proporcion me rreziqet, kështu që është i pabazë konkluzioni se këto veprime kishin si objektiv popullatën civile.³³⁰

2. Analizë

106. Dhoma e Apelit gjykon se thelbi i kësaj pike të apelit të Gjorgjeviqit ka të bëjë me përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi përdorimin e tepruar të forcës nga RFJ-ja në operacionet “kundërterroriste.”³³¹ Dhoma e Apelit thekson se ky është vetëm një ndër shtatë faktorët ku u bazua Dhoma Gjyqësore për vërtetimin e NPK-së.³³²

107. Për nxjerrjen e këtyre përfundimeve, Dhoma Gjyqësore mori parasysh pikat që Gjorgjeviqi përsërit në apel, ndër të tjera edhe argumentin e tij se veprimet e RFJ-së ishin fushatë e ligjshme kundër terrorizmit për mbrojtjen e vendit dhe jo plan i përbashkët

³²⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 3.

³²⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 5(2). Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 5(3).

³²⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 9-10, 12-13, 30-31.

³²⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 11.

³²⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 1, përmendet Aktgjykimi, para. 2020.

³²⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 2 (theksi i shtuar).

³³⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 6.

³³¹ Aktgjykimi, para. 2052-2069.

³³² Shih më lart, para. 87.

kriminal.³³³ Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ndonëse disa operacione të forcave serbe “mund të jenë kryer nën maskën e operacioneve kundërterroriste dhe se kjo mund të ketë qenë një prej objektivave, provat tregojnë qartazi se këto operacione nuk synonin vetëm pjesëtarët e UÇK-së”, por edhe civilët shqiptarë kosovarë.³³⁴ Në këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

operacionet [e forcave serbe] zakonisht kishin për qëllim terrorizimin e popullatës civile shqiptare kosovare në qytete dhe fshatra. Kjo u realizua përmes mjeteve të ndryshme. Zonat e banuara u granatuan nga forcat serbe me armë të rënda. [...] Ndikimi i veprimeve të forcave serbe që kishin për qëllim terrorizimin e shqiptarëve kosovarë ishte aq i rëndë sa që shumë prej shqiptarëve kosovarë u larguan nga shtëpitë, fshatrat dhe qytetet e tyre pa urdhrin e forcave serbe, vetëm për t’iu shmangur atyre. [...]

Dëbimet, vrasjet, shpërnguljet e dhunshme dhe përndjekjet ishin karakteristika tipike të fushatës së dhunës dhe terrorit. Dhoma konkludon se shkalla dhe natyra e planit, si dhe struktura e forcave të koordinuara që zbatuan atë, provojnë qartë ekzistencën e udhëheqjes që përfshinte strukturat politike, ushtarake dhe policore të qeverive të RFJ-së dhe Serbisë që drejtonte dhe koordinonte ngjarjet në terren.³³⁵

108. Përveç shprehjes së mospajtimit të tij me këto përfundime, Gjorgjeviqi nuk ofron asnjë argument thelbësor se ku konsiston gabimi i Dhomës Gjyqësore. Rrjedhimisht, parashtrimet e tij hidhen poshtë.

109. Në veçanti, argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me kontekstin e konfliktit dhe rreziqet me të cilat përballëj RFJ-ja³³⁶ nuk ndikojnë aspak në përfundimin e Dhomës Gjyqësore se *natyra*, ose *praktika* e krimeve të kryera nga forcat serbe provuan qartë se objektivi parësor i këtyre krimeve ishte popullata shqiptare kosovare.³³⁷ Në kundërshtim me sugjerimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore e deduktoi ekzistencën e NPK-së ndër të tjera nga mënyra e kryerjes së krimeve dhe jo nga fakti se këto krime u kryen.³³⁸ Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe “kryen fushatë terrori dhe dhune të skajshme kundër shqiptarëve kosovarë” dhe shkalla dhe *natyra* e planit, si dhe struktura e forcave të koordinuara që zbatuan atë provojnë qartë ekzistencën e udhëheqjes që përfshinte strukturat politike, ushtarake dhe policore të qeverive të RFJ-së dhe Serbisë që drejtonte dhe koordinonte ngjarjet në terren.³³⁹ Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se ky deduksion ishte i paarsyeshëm. Si rezultat, edhe sikur Dhoma e Apelit të pranonte, *arguendo*, të gjitha parashtrimet e Gjorgjeviqit në lidhje me kontekstin e konfliktit,³⁴⁰ kjo nuk mund t’i çlirojë anëtarët e NPK-së nga përgjegjësia e tyre për krimet e

³³³ Aktgjykimi, para. 2002.

³³⁴ Aktgjykimi, para. 2129.

³³⁵ Aktgjykimi, para. 2129-2130.

³³⁶ Shih më lart, para. 90, 94-95, 100.

³³⁷ Aktgjykimi, para. 2128-2129.

³³⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2027-2035, 2132-2135, 2137-2140.

³³⁹ Aktgjykimi, para. 2130.

³⁴⁰ Gjeggjesisht se nuk duhet gjykuar se Marrëveshjet e Tetorit ishin detyruese ndaj RFJ-së, se UÇK-ja mund të ketë përdorur taktika terroriste dhe se aksionet e NATO-s mund të kenë shkaktuar viktima civile (Shih më lart, para. 90, 95, 100).

planifikuara dhe të kryera kundër popullatës shqiptare të Kosovës. Gjorgjeviqi nuk ka provuar se sugjerimi i tij alternativ – se gjatë kësaj fushate u përdor forcë proporcionale në përgjigje të aksioneve të NATO-s/UÇK-së – u përjashtua në mënyrë të paarsyeshme nga Dhoma Gjyqësore. Rrjedhimisht, ai nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore.

110. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon pikën e parë të apelit të Gjorgjeviqit.

V. PIKA E TRETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME NATYRËN, PIKËNISJEN, KOHËZGJATJEN DHE ANËTARËSINË E NPK-SË

111. Ashtu sikurse u citua edhe më lart, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale objektivi i të cilës ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën, nëpërmjet ndërmarrjes së një fushate terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare kosovare që përfshiu dëbime, zhvendosje të dhunshme, vrasje, dhe shkatërrim të objekteve me vlerë kulturore.³⁴¹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ndër anëtarët e NPK-së ishin Sllobodan Millosheviqi, President i RFJ-së, Nikolla Shainoviqi, zëvendëskryeministër i RFJ-së përgjegjës për Kosovën, Vllajko Stojilkoviqi, ministër i Punëve të Brendshme, Vllastimir Gjorgjeviqi, shef i RJB-së, Radomir Markoviqi (“Markoviqi”), shef i RDB-së, Sreten Llukiqi (“Llukiqi”), shef i Shtabit të MPB-së për Kosovën, Obrad Stevanoviqi (“Stevanoviqi”), shef i Administratës Policore të RJB-së; Dragan Iliqi (“Iliqi”), shef i Administratës së Policisë për Krime të RJB-së, Dragolub Ojdaniqi (“Ojdaniqi”), shef i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së, Nebojsa Pavkoviqi (“Pavkoviqi”), komandant i Armatës së Tretë të UJ-së, dhe Vladimir Llazareviqi (“Llazareviqi”), komandant i Korpusit të Prishtinës.³⁴² Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se brenda mesit të janarit 1999, NPK-ja tashmë ishte formuar dhe ka të ngjarë të ketë ekzistuar që në tetor 1998.³⁴³

A. Hyrje

112. Në pikën e tretë të apelit të tij Gjorgjeviqi argumenton se përfundimet e Dhomës Gjyqësore janë palejueshmërisht të pasaktësuar në lidhje me: (i) natyrën e planit të përbashkët që shërbeu si bazë për NPK-në; (ii) periudhën kohore të ekzistencës; dhe (iii) përbërjen e anëtarësisë.³⁴⁴ Prokuroria përgjigjet se argumentet e Gjorgjeviqit shpërfillin dhe shtrembërojnë përfundimet përkatëse të Dhomës Gjyqësore dhe rrjedhimisht duhet të hidhen poshtë menjëherë.³⁴⁵ Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë radhazi argumentet e Gjorgjeviqit.

³⁴¹ Aktgjykimi, para. 2007. Shih gjithashtu më lart, para. 86.

³⁴² Aktgjykimi, para. 2127.

³⁴³ Aktgjykimi, para. 2134.

³⁴⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 78, 83, 88.

³⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 67.

B. Natyra e planit të përbashkët

1. Argumentet e palëve

113. Gjorgjeviqi pretendon se përfundimet e Dhomës Gjyqësore që karakterizojnë qëllimin e përbashkët janë mospërputhëse.³⁴⁶ Konkretisht ai apelon konkluzionet vijuese të Dhomës Gjyqësore: (i) qëllimi i NPK-së ishte të ndryshohej përbërja etnike e Kosovës për të mundësuar *vijimësinë* e kontrollit serb mbi krahinën; (ii) qëllimi i NPK-së ishte të *rifitohet* kontrolli i territorit të Kosovës; dhe (iii) objektivat e NPK-së *evoluuan* gjatë konfliktit nga hakmarrja në reprezalje në shkatërrimin e UÇK-së.³⁴⁷ Gjorgjeviqi parashtron se konkluzioni i fundit është “kleçkë shumë e dobët për të kapur përgjegjësinë penale”, veçanërisht duke marrë parasysh përfundimin e Dhomës së Apelit në çështjen *Krajishnik* se evoluimi i qëllimit të përbashkët duhet të arrihet me marrëveshje midis anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.³⁴⁸

114. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore vërtetoi si duhej qëllimin e përbashkët dhe gjithashtu se të gjitha krimet për të cilat Gjorgjeviqi u shpall fajtor, ishin pjesë e objektivit të NPK-së për ndryshimin e përbërjes etnike në Kosovë.³⁴⁹ Prokuroria gjithashtu parashtron se “*vijimësia* dhe *rifitimi* i kontrollit [mbi Kosovën] ishin aspekte të padallueshme ndërmjet tyre të të njëjtit plan që garantonte objektivin afatgjatë të ruajtjes së sundimit serb në Kosovë”.³⁵⁰ Së fundi, Prokuroria parashtron se në kundërshtim me argumentin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se evoluimi i planit të përbashkët përfshiu edhe krime të tjera, por konstatoi se “arsye të tjera për të vepruar – si hakmarrja dhe reprezaljet – evoluuan gjatë zbatimit të planit”.³⁵¹ Sipas Prokurorisë kjo nuk ka rëndësi ligjore thelbësore për natyrën e planit të përbashkët.³⁵²

115. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se sugjerimi i Prokurorisë sipas të cilit Dhoma Gjyqësore konkludoi se evoluuan vetëm “arsyet për të vepruar” dhe jo objektivat e NPK-së, nuk ka kuptim sepse “bëhet fjalë për qëllime qartazi të ndryshme në një kohë që qëllimi duhet të jetë i

³⁴⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 84. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, T. 61 (parashtrohet se përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi rolin dhe synimin e Gjorgjeviqit pësojnë një “metamorfozë nëpërmjet së cilës “bëhen përmbledhje të pasakta të analizave të mëparshme të provave që më pas përdoren si bazë për konkluzione përgjithësuese”).

³⁴⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 84-85.

³⁴⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 85, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 163. Shih Aktgjykimi, para. 2007.

³⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 68.

³⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 69.

³⁵¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 70.

³⁵² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 70.

përbashkët”.³⁵³ Ai këmbëngul se përfundimet përkatëse të Dhomës Gjyqësore janë palejueshmërisht të pasaktësuar.³⁵⁴

2. Analizë

116. Gjatë shqyrtimit nëse ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale, Dhoma Gjyqësore theksoi se qëllimi i përgjithshëm i NPK-së së pretenduar – gjegjësisht, ndryshimi demografik i Kosovës për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën – në vetvete nuk ishte krim i përcaktuar në Statut.³⁵⁵ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore u shpreh se “NPK-ja mund të ekzistojë [...] vetëm në rast se dhe kur ky qëllim përbën apo përfshin kryerjen e një krimi statutor”.³⁵⁶

117. Më tej Dhoma Gjyqësore konkludoi se tërësia e provave:

zbulon një sërë karakteristikash për mënyrën se si u kryen krimet kundër shqiptarëve kosovarë, gjë që, për mendimin e Dhomës, është dëshmi bindëse për ekzistencën e një plani të përbashkët të udhëheqjes së RFJ-së dhe Serbisë, duke përfshirë politikanë, ushtarakë dhe drejtues policorë (siç përshkruhet me më shumë hollësimë poshtë) për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës përmes fushatës së terrorit kundër popullatës civile shqiptare kosovare. Ky plan përfshinte dëbimet, shpërnguljet e dhunshme, vrasjet dhe shkatërrimin e objekteve me vlerë kulturore. Provat në lidhje me mënyrën se si u kryen krimet kundër popullatës civile shqiptare kosovare gjithashtu vërtetojnë se u zhvilluan edhe qëllime të reja të planit të përbashkët, veçanërisht gjatë gjithë konfliktit të armatosur që filloi më 24 mars 1999, duke përfshirë hakmarrjen për vrasjet e pjesëtarëve MPB-së dhe të UJ-së, hakmarrjen për bombardimet e NATO-s, dhe luftimin dhe shkatërrimin e plotë të UÇK-së, madje edhe përmes pushkatimeve dhe përdorimit të forcës së tepruar.³⁵⁷

118. Dhoma e Apelit thekson se fillimisht Dhoma Gjyqësore parashtroi se megjithëse pretendohet se qëllimi i *përgjithshëm* i NPK-së ishte ndryshimi demografik i Kosovës për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën, duhej vërtetuar se një qëllim i tillë i përbashkët përbënte apo përfshinte një *krim* të përcaktuar në Statut.³⁵⁸ Pikërisht në kontekstin e vërtetimit të këtij faktori, Dhoma Gjyqësore analizoi rrethanat e përgjithshme politike dhe konstatoi se si pasojë e prirjeve dhe tensioneve të përshkallëzuara separatiste, udhëheqja serbe donte të rifitonte kontroll mbi Kosovën nëpërmjet ndryshimit të përbërjes etnike të krahinës e si rrjedhojë popullata shqiptare u vu nën presion për të ikur nga Kosova.³⁵⁹

119. Bazuar në sa më sipër dhe pas shqyrtimit të provave të administruara, Dhoma Gjyqësore konkludoi se qëllimi i përbashkët *kriminal* i NPK-së ishte “ndryshimi i përbërjes etnike në Kosovë nëpërmjet një fushate terrori kundër popullatës civile shqiptare kosovare [që

³⁵³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 19.

³⁵⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 18.

³⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2003.

³⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2003.

³⁵⁷ Aktgjykimi, para. 2007.

³⁵⁸ Aktgjykimi, para. 2003.

³⁵⁹ Aktgjykimi, para. 2005.

përfshinte] dëbimet, shpërnguljet e dhunshme, vrasjet dhe shkatërrimin e objekteve me vlerë kulturore”.³⁶⁰ Rrjedhimisht nuk ekziston asnjë mospërputhje ndërmjet formulimit prej Dhomës Gjyqësore të mundësisë të vijimësisë së kontrollit mbi Kosovën ose rifitimit të këtij kontrolli sepse këto fraza u përdorën në kontekste të ndryshme. Është e rëndësishme të theksohet se këto terma përshkruese janë praktikisht pa vlerë për konkluzionin përfundimtar të Dhomës Gjyqësore në lidhje me qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së ku përmendet vetëm ndryshimi i përbërjes demografike nëpërmjet metodave kriminale, por jo kontrolli i krahinës.³⁶¹

120. Lidhur me evoluimin e planit të përbashkët, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “u zhvilluan edhe *qëllime* të tjera të planit të përbashkët, duke përfshirë hakmarrjen për vrasjet e pjesëtarëve MPB-së dhe të UJ-së, hakmarrjen për bombardimet e NATO-s, dhe luftimin dhe shkatërrimin e plotë të UÇK-së, madje edhe përmes pushkatimeve dhe përdorimit të forcës së tepruar”.³⁶² Dhoma e Apelit gjykon se përdorimi i shprehjes “qëllime të tjera” nga Dhoma Gjyqësore duhet kuptuar në kontekstin e duhur, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se hakmarrja, reprezaljet për bombardimet e NATO-s dhe luftimet për shkatërrimin e UÇK-së në vetvete nuk përbëjnë krime të përcaktuara në Statut. Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se qëllimi i përbashkët i NPK-së duhet të përbëjë apo të përfshijë kryerjen e një krimi statutor.³⁶³ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se nëpërmjet përdorimit të fjalës “qëllim”, Dhoma Gjyqësore donte të thoshte se me zhvillimin e rrethanave në terren, keqbërësit kryen veprime që mund të jenë motivuar nga hakmarrja për realizimin e planit të përbashkët. Mirëpo motivi i veprimeve të autorëve të krimeve nuk ka rëndësi në përcaktimin e qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së.³⁶⁴ Megjithëse motivi për kryerjen e krimeve në kuadër të planit të përbashkët evoluoi duke përfshirë edhe vrasje hakmarrëse dhe reprezalje për bombardimet e NATO-s,³⁶⁵ vetë qëllimi, pra ndryshimi i përbërjes etnike në Kosovë mbeti i pandryshuar. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk bëri asnjë gabim në lidhje me këtë aspekt. Gjithashtu dhe në kundërshtim me sugjerimin e Gjorgjeviqit, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik* nuk ka lidhje me këtë çështje sepse atje trajtohen *krime* të zgjeruara në kuadër të qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.³⁶⁶

³⁶⁰ Aktgjykimi, para. 2007.

³⁶¹ Aktgjykimi, para. 2007.

³⁶² Aktgjykimi, para. 2007 (theksi i shtuar). Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranoi se operacionet kundërterroriste mund të kenë qenë ndër *objektivat* e operacioneve serbe (Aktgjykimi, para. 2129).

³⁶³ Aktgjykimi, para. 2003, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100.

³⁶⁴ Shih p.sh. Aktgjykimi, para. 2063, përmendet përdorimi i forcës së tepruar në vrasje të kryera gjatë reprezaljeve, dhe para. 2069 ku konkludohet se “qëllimi i operacioneve ishte të vazhdoheshin krimet e provuara, dhe jo të luftohej UÇK-ja, ose të luftohej UÇK-ja”.

³⁶⁵ Aktgjykimi, para. 2007.

³⁶⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 161-178.

C. Pikënisja dhe kohëzgjatja e NPK-së

1. Argumentet e palëve

121. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori dy konkluzione kundërthënëse ndërmjet tyre, kur konkludoi se NPK-ja ishte në ekzistencë jo më vonë se në janar 1999 dhe nga ana tjerë se një ndërmarrje e përbashkët kriminale mund të lindë spontanisht.³⁶⁷ Gjorgjeviqi argumenton se rrjedhimisht Aktgjykimi është palejueshmërisht i pasaktësuar nëse dëbimi i qindra mijëra civilëve ishte i planifikuar apo i paplanifikuar.³⁶⁸

122. Prokuroria përgjigjet se konstatimi i Dhomës Gjyqësore se një plan i përbashkët mund të materializohet spontanisht, nuk është mospërputhës me përfundimin e saj se NPK-ja ishte në ekzistencë nga mesi i janarit 1999.³⁶⁹

2. Analizë

123. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi i interpreton përfundimet e Dhomës Gjyqësore jashtë kontekstit. Përmendjen e aspektit të materializimit spontan të një plani të përbashkët ose qëllimi kriminal, Dhoma Gjyqësore e bëri në vija të përgjithshme kur i referua ligjit përkatës në lidhje me kryerjen e krimeve nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.³⁷⁰ Në një pjesë tjetër të Aktgjykimit, pas një analize të gjerë e të hollësishme të provave, Dhoma Gjyqësore konkludoi se NPK-ja ishte formuar brenda mesit të janarit 1999 dhe ndoshta edhe më herët.³⁷¹ Në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, ky përfundim nuk është palejueshmërisht i pasaktësuar sepse identifikohet qartësisht koha kur erdhi në jetë plani i përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike. Fakti se Dhoma Gjyqësore përmendi edhe aspekte të ligjit në lidhje me materializimin spontan të një qëllimi të përbashkët nuk e cenon këtë përfundim. Nuk ekziston asnjë mospërputhje midis afirmimit të parimit të përgjithshëm të ligjor dhe përfundimit faktik në fjalë.³⁷² Rrjedhimisht argumenti i Gjorgjeviqit hidhet poshtë.³⁷³

³⁶⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 86, përmendet Aktgjykimi, para. 1862, 2007, 2025-2026, 2134. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 20.

³⁶⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 86. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 20.

³⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 71, përmendet Aktgjykimi, para. 2007, 2134.

³⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1862, 2007, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227, Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 97, Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 109, Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 415, 418. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1859-1868.

³⁷¹ Aktgjykimi, para. 2134. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2003-2133; 2135-2153 (këta paragrafë trajtojnë krimet brenda kuadrit të qëllimit të përbashkët).

³⁷² Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 86.

³⁷³ Shih më lart, para. 20.

D. Anëtarësia e NPK-së

1. Argumentet e palëve

124. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore ishte kundërthënëse në identifikimin e anëtarëve të NPK-së me arsyetimin se disa anëtarë u përmendën me emër ndër të cilët edhe ai, dhe në anën tjetër u përdorën formulime të pasaktësuara për “drejtues të lartë politikë, ushtarakë dhe policorë”.³⁷⁴ Ai përmend se cilësime të tilla palejueshmërisht të pasaktësuara u refuzuan nga Dhoma e Apelit në çështjen *Krajishnik*.³⁷⁵ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore “shtoi edhe një paqartësi më shumë kur konkludoi se ‘nuk mund të përcaktojë saktësisht se kush ishin pjesëmarrësit e kush autorët e krimeve’”.³⁷⁶

125. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore identifikoi saktësisht me emër anëtarët e NPK-së dhe konstatoi se ata më së shumti kishin postet më të larta politike, ushtarake dhe policore në RFJ dhe në Serbi.³⁷⁷ Më tej, Prokuroria argumenton se nuk ka asnjë pasaktësi në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se disa nga autorët e krimeve mund të mos kenë qenë anëtarë të NPK-së, duke mbajtur parasysh se nuk është kusht të vërtetohet se autorët fizikë që u përdorën si vegla të kishin të njëjtin plan të përbashkët.³⁷⁸

126. Në kundërpërgjigje, Gjorgjeviqi pranon se “përfundimet e Dhomës [Gjyqësore] duhet të jenë vetëm në lidhje me individë konkretë të identifikuar me emër si anëtarë të NPK-së”, mirëpo në lidhje me “pasojat” u referohet argumenteve të tij paraqitur në pikën katër dhe pikën gjashtë të apelit të tij.³⁷⁹

2. Analizë

127. Dhoma Gjyqësore identifikoi saktësisht ligjin përkatës për këtë aspekt.³⁸⁰ Në nxjerrjen e përfundimeve faktike në lidhje me anëtarët e NPK-së, Dhoma Gjyqësore konkludoi se plani i përbashkët kriminal ekzistonte, përkatësisht “udhëheqësit politikë të RFJ-së dhe Serbisë, udhëheqja e UJ-së, përfshirë korpusin në Kosovë, dhe e MPB-së dhe udhëheqja e administratave përkatëse që e përbënin atë, duke përfshirë edhe Shtabin në Kosovë”.³⁸¹ Më tej Dhoma Gjyqësore identifikoi me emër “anëtarët kyç” nga të tre fushat ndër të cilët, Sllobodan

³⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 87, përmendet Aktgjykimi, para. 2051, 2126, 2127.

³⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 87, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 157.

³⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 87, citohet Aktgjykimi, para. 2128.

³⁷⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 72-73, përmendet Aktgjykimi, para. 1861, sh. 6359, 2126-2127, 2211.

³⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 74.

³⁷⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 21.

³⁸⁰ Aktgjykimi, para. 1861.

³⁸¹ Aktgjykimi, para. 2126.

Milloseviqi, Nikolla Shainoviqi, Vllajko Stojilkoviqi, Dragolub Ojdaniqi dhe Vllastimir Gjorgjeviqi.³⁸²

128. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrëzon parashtrimin e Gjorgjeviqit se formulimi i pakonkretizuar i Dhomës Gjyqësore në lidhje me një “plan që ekzistonte brenda udhëheqjes së lartë politike, ushtarake dhe policore”³⁸³ nuk është më i mirë se anëtarësia “e rangut të ulët” në ndërmarrjen e përbashkët kriminale refuzuar në Aktgjykimin e Apelit *Krajishnik*.³⁸⁴ Në atë çështje, dhoma gjyqësore përmendi “rangun e ulët që përbëhej nga politikanë komandantë ushtarakë dhe policorë dhe drejtues paraushtarakë të atjeshëm si dhe të tjerë”.³⁸⁵ Dhoma Gjyqësore e konsideroi këtë karakterizim palejueshmërisht të pakonkretizuar sepse “Dhoma Gjyqësore nuk ka arritur të saktësojë nëse të gjithë apo vetëm disa politikanë, komandantë ushtarakë dhe policorë dhe drejtues paraushtarakë të atjeshëm ishin anëtarë të ulët të NPK-së.”³⁸⁶ Gjithsesi në këtë çështje, anëtarët janë identifikuar me emër dhe janë renditur në komponentin përkatës të NPK-së.

129. Në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, komenti i Dhomës Gjyqësore se “nuk mundët të përcaktojnë saktësisht se kush ishin pjesëmarrësit e kush autorët e krimeve” nuk i bën të pakonkretizuar përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi NPK-në.³⁸⁷ Faktikisht, kjo deklaratë ka të bëjë vetëm me pjesëtarë të njërive të posaçme të MPB-së dhe të UJ-së të cilët “u përfshinë në zbatimin e planit si pjesëmarrës dhe autorë të krimeve”, dhe jo me “anëtarët kryesorë” të NPK-së të identifikuar me emër të cilët drejtuan “planin e përgjithshëm të përbashkët”.³⁸⁸

130. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se përfundimet e Dhomës Gjyqësore³⁸⁹ janë mjaftueshmërisht konkrete në identifikimin e anëtarëve të NPK-së, duke marrë parasysh se “anëtarët kryesorë” janë renditur me emra dhe të tjerët përmenden në bazë të kategorive ose grupeve të individëve në mënyrë të qartë.

³⁸² Aktgjykimi, para. 2127. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2211.

³⁸³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 87, citohet Aktgjykimi, para. 2051, 2126.

³⁸⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 87, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 157.

³⁸⁵ Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 1087.

³⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 157. Gjithashtu, Dhoma e Apelit konkludoi se Aktgjykimi ishte tejet pasaktësues në lidhje me kuadrin kohor dhe gjeografik të NPK-së, faktor që nuk përbën problem në Aktgjykimin e kësaj çështjeje sikurse u shtjellua më lart.

³⁸⁷ Aktgjykimi, para. 2128.

³⁸⁸ Aktgjykimi, para. 2128. Dhoma Gjyqësore u shpreh qartë se megjithëse nuk mund të përcaktonte saktësisht se kush ishin pjesëmarrësit e kush autorët e krimeve, ishte e qartë se:

disa pjesëtarë të njërive të tilla bashkëpunuan në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Bashkëpunimi midis forcave të MPB-së dhe UJ-së ishte i koordinuar dhe njësitë dhe individët u përfshinë në zbatimin e planit si pjesëmarrës dhe autorë të krimeve, kurse plani i përgjithshëm i përbashkët u drejtua nga të paktën anëtarët kryesorë të NPK-së të identifikuar më lart (Aktgjykimi, para. 2128).

³⁸⁹ Aktgjykimi, para. 2126-2128.

E. Konkluzion

131. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht pikën e tretë të apelit.

VI. PIKA E KATËRT E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME SHUMËSINË E PERSONAVE

A. Argumentet e palëve

132. Në pikën e katërt të apelit të tij, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabime ligjore dhe faktike gjatë shqyrtimit: (i) nëse anëtarët e identifikuar të NPK-së bashkëpunuan; dhe (ii) në qoftë se bashkëpunuan, a ishte ky bashkëpunim për realizmin e një qëllimi kriminal të përbashkët.³⁹⁰

133. Në lidhje me argumentin e parë, Gjorgjeviqi pretendon se gjatë analizës nëse drejtuesit e UJ-së, MPB-së dhe drejtuesit civilë bashkëpunuan, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh përfundimin e vet se MPB-ja nuk u vu në varësi të UJ-së.³⁹¹ Sipas tij përfundimi i Dhomës Gjyqësore se forcat e MPB-së dhe të UJ-së u koordinuan nga Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë (përkatesisht, “Komanda e Përbashkët” dhe “KM”) nuk është i mjaftueshëm për të provuar bashkëveprimin.³⁹²

134. Në lidhje me argumentin e dytë, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk analizoi sjelljen e secilit anëtar të NPK-së në hollësi dhe më tej ta krahasonte me veprimet e anëtarëve të tjerë për të përcaktuar nëse ata vepruan për realizmin e qëllimit të përbashkët.³⁹³

135. Gjithashtu, Dhoma e Apelit vëren se në këtë pikë të apelit del shpesh një argument bazë. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nxori një konkluzion të ndryshëm nga i Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*, megjithëse u bazua në të njëjtat prova; dhe konkluzionin në fjalë e nxori duke përdorur gabimisht një standard të ndryshëm dhe më të ulët vërtetimi në lidhje me provat mbi anëtarët kryesorë të NPK-së në këtë çështje, krahasuar me standardin e zbatuar në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*.³⁹⁴ Konkretisht, Gjorgjeviqi parashtron se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të kishte konkluduar se Ojdaniqi dhe Llazareviqi ishin anëtarë të NPK-së dhe bashkëpunuan me anëtarët e tjerë duke marrë parasysh se në gjykimin *Millutinoviqi dhe të tjerët*. Dhoma Gjyqësore konkludoi se ata nuk ishin anëtarë të NPK-së.³⁹⁵ Ai argumenton se në këtë çështje nuk mund të arrihej në një rezultat të ndryshëm meqenëse “Dhoma Gjyqësore në gjykimin e Gjorgjeviqit

³⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 93.

³⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 94, përmendet Aktgjykimi, para. 261-263, 2126. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 23.

³⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 95, përmendet Aktgjykimi, para. 264.

³⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 97, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 250-282. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 24-26.

³⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 96, 98.

³⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 96, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 618, 919. Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 26.

nuk mori më shumë prova se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*.³⁹⁶ Më tej, Gjorgjeviqi argumenton se provat mundësonin edhe një konkluzion tjetër të arsyeshëm, konkretisht se përgatitjet për operacione ushtarake në fillim të vitit 1999 ishin veprim i përbashkët kundrejt objektivave të ligjshme si UÇK-ja ose NATO-ja.³⁹⁷ Po ashtu, Gjorgjeviqi vë në dukje se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* nuk mundi të nxirrte konkluzionin se veprimet e Llukiqit ishin pjesë e qëllimit kriminal në lidhje me fshehjen e krimeve.³⁹⁸ Gjorgjeviqi argumenton se si rrjedhojë, metodologjia e Dhomës Gjyqësore në këtë çështje nuk e përmbushi “kushtin e veprimit të përbashkët për realizimin e NPK-së”, dhe se për vërtetimin e përgjegjësisë penale ishte i nevojshëm një standard më i lartë vërtetimi.³⁹⁹

136. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shtrembëron ligjin kur argumenton se për përmbushjen e kriterit në lidhje me përgjegjësinë në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duhet vërtetuar se ishin një shumësi personash që bashkëpunuan.⁴⁰⁰ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se përfundimet faktike të Dhomës Gjyqësore tregojnë se ekzistenca e shumësisë së personave që kishin vepruar bashkërisht u vërtetua duke u bazuar në provat.⁴⁰¹ Prokuroria shton se përmendja prej Gjorgjeviqit e Aktgjykimit *Millutinoviqi dhe të tjerët* është e papërshtatshme sepse përfundimet në atë aktgjykim nuk mund të kenë “efekt pengues ndaj Dhomës Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq*”.⁴⁰² Lidhur me argumentin e Gjorgjeviqit se forcat serbe vepruan kundrejt objektivave të ligjshme, Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shpërfill përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ndonëse veprimtaritë kundërterroriste mund të kenë qenë ndër objektivat, operacionet serbe u ndërmorën kundër civilëve shqiptarë kosovarë.⁴⁰³ Së fundi, Prokuroria argumenton se në kundërshtim me parashtrimet e Gjorgjeviqit, Aktgjykimi Dhomës Gjyqësore pasqyron përfundime të mjaftueshme në lidhje me veprimet e secilit prej 11 anëtarëve të identifikuar të NPK-së.⁴⁰⁴

137. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se argumenti i tij nuk përbën një kusht shtesë në lidhje me përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por parashtron se në rast se “anëtarët e

³⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 96.

³⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 98. Për këtë aspekt, Gjorgjeviqi citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* se nuk mund të konkludonte se veprimet e Ojdaniqit dhe Llazareviqit “pasqyruan një qëllim kriminal të përbashkët”. Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 98, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, para. 618, 919. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 26.

³⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 98, përmendet Aktgjykimi, para. 2120, sh. 5174.

³⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 98.

⁴⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 75, 78-80.

⁴⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 81, përmendet Aktgjykimi, para. 2126.

⁴⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 82.

⁴⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 83, përmendet Aktgjykimi, para. 2129-2130.

⁴⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 84, përmenden nëpërmjet shembujve përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me Slobodan Millosheviqin (Aktgjykimi, para. 230, 233, 1979).

NPK-së së pretenduar nuk bashkëveprojnë”, pritet që gjykuesi i fakteve të shqyrtojë imtësisht provat para se të arrijë në konkluzionin mbi ekzistencën e një qëllimi të përbashkët.⁴⁰⁵

B. Analizë

138. Në lidhje me argumentin e parë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit thekson se për nxjerrjen e një konkluzioni mbi ekzistencën e qëllimit të përbashkët, *nuk kërkohet* të vërtetohet se ekzistonte një shumësi personash të cilët bashkëvepruan.⁴⁰⁶ Elementi që duhet vërtetuar është “që një shumësi personash kishin të njëjtin qëllim të përbashkët kriminal”.⁴⁰⁷ Ekzistenca e qëllimit të përbashkët kriminal, veçanërisht e një qëllimi i cili nuk është formuluar apo nuk është përcaktuar më parë, por materializohet spontanisht, *mund të deduktohet* “nga fakti se një shumësi personash bashkëveprojnë për jetësimin e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale”.⁴⁰⁸ Thënë ndryshe, për nxjerrjen e konkluzionit mbi ekzistencën e qëllimit të përbashkët, nuk është e nevojshme të vërtetohet se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale kanë bashkëvepruar.

139. Në këtë çështje, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonte “një plan për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës përmes fushatës së terrorit dhe dhunës, i cili përfshinte shumësi personash të cilët morën pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët dhe kishin të njëjtin synim për të kryer krime të tilla”.⁴⁰⁹ Për nxjerrjen e këtij konkluzioni Dhoma Gjyqësore ndër të tjera u bazua te “shkalla e operacioneve anembanë Kosovës, praktika e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë si dhe numri i madh i njëjësive të ndryshme të UJ-së dhe MPB-së që u përfshinë në operacione të tilla”.⁴¹⁰ Në mbështetje të këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore iu referua disa faktorëve ndër të cilët, provat për ngritjen dhe funksionimin e Komandës së Përbashkët për planifikimin dhe koordinimin e operacioneve të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë, procesverbale të mbledhjeve të Kolegjiut të UJ-së, Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Kolegjiut të MPB-së dhe Shtabit të MPB-së për Kosovën, gjatë të cilave u planifikuan dhe urdhëruan operacione të përbashkëta, urdhra për zbatimin e planeve të tilla dhe prova se këto plane u zbatuan në terren, dhe se ato u mbikëqyrën dhe u raportuan prej të njëjtëve persona, si edhe fakti se të paktën disa anëtarë të NPK-së u implikuan drejtpërsëdrejti në fshehjen e krimeve të kryera në përputhje me planin e përbashkët.⁴¹¹ Përveç faktorëve të lartpërmendur, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konstatoi se provat e paraqitura në gjykim i mundësuan të konkludonte se anëtarët e NPK-së bashkëvepruan për realizimin e

⁴⁰⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 22.

⁴⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430, dhe referencat e cituara në të. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 91.

⁴⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430, dhe referencat e cituara në të.

⁴⁰⁸ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, sh. 418, dhe referencat e cituara në të.

⁴⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2128.

⁴¹⁰ Aktgjykimi, para. 2128.

NPK-së.⁴¹² Dhoma e Apelit gjykon se edhe në qoftë se MPB-ja nuk kaloi në varësi të UJ-së, Gjorgjeviqi nuk ka provuar se si kjo do të zhvlerësonte konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi ekzistencën e NPK-së. Rrjedhimisht, përveç shprehjes së mospajtit me përfundimet e Dhomës Gjyqësore, Gjorgjeviqi nuk ka provuar se përfundimet në fjalë ishin të gabuara.

140. Dhoma e Apelit vëren se argumenti i Gjorgjeviqit se midis MPB-së dhe UJ-së kishte bashkërendim dhe jo varësi, u paraqit gjatë gjykimit.⁴¹³ Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat e MPB-së dhe të UJ-së “bashkëpunuan më mënyrë të koordinuar” për arritjen e qëllimit kriminal.⁴¹⁴ Në këtë kontekst, mungesa e varësisë midis këtyre dy institucioneve nuk është faktor me rëndësi duke mbajtur parasysh se bashkëpunimi midis pjesëmarrësve të NPK-së nënkupton ekzistencën e qëllimit të përbashkët kriminal. Gjithashtu, bashkëpunimi dhe jo varësia nuk cenon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se anëtarët e NPK-së bashkëvepruan.⁴¹⁵ Faktikisht, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Komanda e Përbashkët bashkërendoi veprimet e MPB-së dhe UJ-së jo vetëm që nuk e cenon por e përforcon edhe më shumë konkluzionin se anëtarët e NPK-së bashkëvepruan në zbatimin e qëllimit të përbashkët.⁴¹⁶ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore mbajti qartësisht parasysh problemet e ndryshimit të varësisë në nxjerrjen e këtyre përfundimeve.⁴¹⁷ Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi.

141. Në lidhje me parashtrimin e dytë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit rikujton se për të arritur në konkluzionin se individët e identifikuar si anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale vepruan për jetësimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhoma gjyqësore duhet të identifikojë shumësinë e pjesëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe të vërtetojë se ata kishin të njëjtin qëllim kriminal të përbashkët.⁴¹⁸ Është e mjaftueshme që kjo shumësi individësh të identifikohet nëpërmjet “kategorive ose grupeve të individëve”, dhe nuk është i nevojshëm identifikimi i çdo individi me emër.⁴¹⁹ Gjithashtu, qëllimi i përbashkët mund të deduktohet nga fakti që një shumësi personash bashkëveprojnë për të jetësuar ndërmarrjen e

⁴¹¹ Aktgjykimi, para. 2126.

⁴¹² Dhoma Gjyqësore mori parasysh: (i) provat për ngritjen dhe “funsionimin” e Komandës së Përbashkët për planifikimin dhe koordinimin e operacioneve të MPB-së dhe UJ-së; (ii) procesverbale të mbledhjeve të Kolegjiut të UJ-së, Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Kolegjiut të MPB-së dhe Shtabit të MPB-së për Kosovën, gjatë të cilave u planifikuan dhe urdhëruan operacione të përbashkëta; (iii) urdhra për zbatimin e planeve të tilla; (iv) prova se këto plane u zbatuan në terren, dhe se ato u mbikëqyrën dhe u raportuan prej të njëjtëve persona; dhe (v) se të paktën disa anëtarë të NPK-së u implikuan drejtpërsëdrejti në fshehjen e krimeve (Aktgjykimi, para. 2126).

⁴¹³ Shih Aktgjykimi, para. 2123, përmendet Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 297.

⁴¹⁴ Aktgjykimi, para. 2128.

⁴¹⁵ Shih më lart, para. 139.

⁴¹⁶ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 95, përmendet Aktgjykimi, para. 264.

⁴¹⁷ Shih Aktgjykimi, para. 2123.

⁴¹⁸ Shih më lart, para. 138. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

⁴¹⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 156, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 99, Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

përbashkët kriminale.⁴²⁰ Rrjedhimisht, nga pikëpamja ligjore nuk kërkohet që dhoma gjyqësore të nxjerrë konkluzion të veçantë për veprimet dhe synimet e secilit anëtar të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për të vërtetuar se një shumësi individësh bashkëvepruan në zbatimin e qëllimit të përbashkët. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk kishte detyrim të verifikonte ose analizonte me imtësi veprimet individuale dhe synimet e secilit prej anëtarëve të NPK-së.

142. Gjithashtu në lidhje me argumentin e përgjithshëm të Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nxori një konkluzion të ndryshëm nëpërmjet zbatimit të një standardi të ndryshëm nga ai i përdorur nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*,⁴²¹ Dhoma e Apelit gjykon se “përfundimet mbi përgjegjësinë penale në një çështje të Tribunalit janë detyruese vetëm për të akuzuarin përkatës në çështjen në fjalë”.⁴²² Rrjedhimisht, në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* Dhomës Gjyqësore iu desh të analizonte imtësisht veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të secilit anëtar të NPK-së që ishte i akuzuar në atë çështje për nxjerrjen e një konkluzioni jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm mbi përgjegjësinë e tyre penale si individë. Gjithsesi, përfundimet në këtë çështje në lidhje me këta individë kanë rëndësi vetëm për analizën që synon të vërtetojë se Gjorgjeviqi bashkëveproi me një shumësi personash dhe kishte të njëjtin qëllim të përbashkët me ta për jetësimin e NPK-së, për nxjerrjen e një konkluzioni jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm vetëm në lidhje me përgjegjësinë e tij penale si individ.

143. Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore rikujton se në nxjerrjen e përfundimeve faktike, gjykatësit mbështeten thjesht dhe vetëm në provat e paraqitura në çështjen përkatëse.⁴²³ Rrjedhimisht, është tërësisht e pranueshme që në bazë të dosjeve të dy çështjeve të ndryshme, gjykatësit arrijnë në konkluzione të ndryshme, edhe në qoftë se është fjala për të njëjtat ngjarje.⁴²⁴ Thjesht përmendja e konkluzioneve faktike nga një çështje tjetër nuk arrin të provojë se *asnjë* gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore bazuar në provat e paraqitura në çështjen përkatëse.⁴²⁵

⁴²⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, sh. 418, dhe referencat e cituara në të; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

⁴²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 96, 98.

⁴²² *Prokurori k. Ante Gotovinës dhe të tjerëve*, Lënda nr. IT-06-90-A, Vendim mbi Mocionin për Ndërhyrje dhe Deklaratë Interesi nga Republika e Kroacisë, 8 shkurt 2012, para. 12.

⁴²³ Shih në një kontekst të ndryshëm, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 78, 84-85; Aktgjykimi i Apelit *Akayesu*, para. 269.

⁴²⁴ Aktgjykimi i Apelit *Llukij dhe Llukij*, para. 396, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 11-12. Duhet mbajtur parasysh se dy gjykatës të cilët veprojnë në mënyrë të arsyeshme mund të nxjerrin konkluzione të ndryshme edhe bazuar në të njëjtat prova (Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkij dhe të tjerët*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 64; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, para. 22).

⁴²⁵ Shih më lart, para. 20.

144. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrëzon parashtrimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk shqyrtoi veprimet dhe synimet e secilit prej pjesëmarrësve të identifikuar të NPK-së, duke zbatuar një standard më të ulët.

145. Problemi që duhet të zgjidhë Dhoma e Apelit është nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të nxirrte të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore, bazuar në provat e administruara në këtë çështje. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi prova të shumta në lidhje me këtë pikë dhe nxori përfundime mbi kontributet e anëtarëve të NPK-së në qëllimin e përbashkët.⁴²⁶ Dhoma identifikoi anëtarët kryesorë të NPK-së dhe sikurse u shtjellua më lart, konkludoi se ata bashkëvepruan për jetësimin e NPK-së.⁴²⁷ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore formuloi disa përfundime në lidhje me synimin e njëjtë të anëtarëve të NPK-së për zbatimin e qëllimit të përbashkët nëpërmjet kryerjes së dëbimeve, zhvendosjes së dhunshme, vrasjeve dhe përndjekjeve.⁴²⁸ Sikurse diskutohet më vonë në Aktgjykim, Gjorgjeviqi nuk shpjegon se ku konsiston gabimi i Dhomës Gjyqësore kur konkludoi se anëtarët e NPK-së morën pjesë në planin e përbashkët, bazuar në këto përfundime.

146. Dhoma e Apelit tashmë ka diskutuar dhe rrëzuar argumentet e Gjorgjeviqit se forcat serbe vepruan në lidhje me objektiva të ligjshme dhe jo për realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal.⁴²⁹ Argumentet e Gjorgjeviqit në këtë pikë të apelit nuk shtojnë asgjë të re në lidhje me këtë pikë.

147. Duke u bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se bazuar në provat, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore; dhe vetëm sa përsërit argumentet që nuk ishin të suksesshme në gjykim, pa vërtetuar se rrëzimi i tyre nga Dhoma Gjyqësore përbën gabim që do të përlligjte ndërhyrjen prej Dhomës së Apelit.⁴³⁰

148. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon pikën e katërt të apelit të Gjorgjeviqit.

⁴²⁶ Shih Aktgjykimi, para. 2012, 2013, 2018, 2020, 2021, 2023, 2025, 2035, 2037, 2051, 2068, 2112, 2118, 2127. Shih gjithashtu Prova Materiales P387, f. 3; D343. Kontributet e tyre përfshinin urdhërimin e operacioneve të bashkërenduara të MPB-së dhe UJ-së dhe forcave të atashuara për kryerjen e krimeve në kuadrin e realizimit të planit të përbashkët dhe për fshehjen e provave të këtyre krimeve (Aktgjykimi, para. 2112, 2118, 2128). Shih gjithashtu më poshtë, para. 179-193, 198-208.

⁴²⁷ Shih më lart, para. 139; Aktgjykimi, para. 2126-2128.

⁴²⁸ Aktgjykimi, para. 2014, 2018, 2020, 2021, 2023, 2025, 2118, 2126.

⁴²⁹ Shih më lart, para. 97-98, 107-109.

⁴³⁰ Shih më lart, para. 20.

VII. PIKA E PESTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME QËLLIMIN E PËRBASHKËT

A. Argumentet e palëve

149. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se qëllimi i NPK-së ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën, pa pasur prova se anëtarët e NPK-së ndër të cilët edhe Gjorgjeviqi kishin synim dëbimin *e përhershëm* të shqiptarëve kosovarë.⁴³¹ Ai argumenton se synimi për dëbim të përkohshëm do të shkaktonte një ndryshim të përkohshëm në përbërjen etnike; si rrjedhojë, nuk do të arrihej qëllimi i mundësimit të kontrollit serb mbi krahinën, për arsye se ky kontroll do të humbej me rikthimin e shqiptarëve kosovarë.⁴³² Për më tepër, Gjorgjeviqi argumenton se ekziston një “mangësi” në analizën e Dhomës Gjyqësore sepse nuk është formuluar asnjë përfundim se “si shpërngulja e qëllimshme e shqiptarëve kosovarë brenda vendit dhe përkohësisht shërbeu si bazë për konkluzionin se qëllimi i NPK-së ishte ndryshimi i përhershëm i përbërjes etnike të Kosovës”.⁴³³

150. Më tej, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se konfiskimi dhe asgjësimi i dokumenteve të identitetit ishte gjerësisht i përhapur dhe sistematik⁴³⁴ meqenëse: (i) dokumentet e identitetit e së paku tetë dëshmitarëve – në gjashtë komuna – nuk u konfiskuan gjatë largimit të tyre nga Kosova;⁴³⁵ dhe (ii) Dhoma nuk mori parasysh mundësinë se asgjësimi i dokumenteve nuk ishte rezultat i një praktike të përgjithshme të paraplanifikuar të formuluar prej një niveli më të lartë, por një dukuri e shkaktuar nga armiqësia e shpeshtë dhe mungesa e disiplinës ndërmjet pjesëtarëve të rangut të ulët të UJ-së dhe/ose MPB-së.⁴³⁶ Gjithashtu, Gjorgjeviqi argumenton se përfundimet e Dhomës Gjyqësore janë mospërputhëse dhe me mangësi në arsyetim sepse Dhoma Gjyqësore përdori “referenca të pasaktësuar në lidhje me ‘udhëheqjen e lartë ose [...] qeveritë e RFJ-së dhe të Serbisë’”, në vend që të bënte një analizë të imtësishme të synimeve të anëtarëve të NPK-së.⁴³⁷

⁴³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 100-101, 105-107; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 27. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 173, ku në lidhje me anëtarët e NPK-së, Gjorgjeviqi përsërit se ndonëse paragrafi 2127 i Aktgjykimit i identifikon, rolet e tyre përkatës nuk janë të qartë (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 173).

⁴³² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 100-101, 105-107; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 27.

⁴³³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 105-107.

⁴³⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 102-103, përmendet Aktgjykimi, para. 2007-2008, 2080.

⁴³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 103, përmendet Aktgjykimi, sh. 1857, para. 643, 724, 777, 822, 1075, 1095, 1099.

⁴³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 103.

⁴³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 104, përmendet Aktgjykimi, para. 2051.

151. Prokuroria përgjigjet se argumentet e Gjorgjeviqit duhen hedhur poshtë menjëherë.⁴³⁸ Argumentohet se me gjithë kundërpretendimet e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore u bazua në një “sasi të madhe provash” në nxjerrjen e konkluzionit se praktika e MPB-së për konfiskimin dhe asgjësimin e dokumenteve të identifikimit të shqiptarëve kosovarë, ishte e zakonshme dhe gjerësisht e përhapur.⁴³⁹ Në lidhje me dëshmitarët dokumentet e identifikimit të të cilëve nuk u konfiskuan, Prokuroria thekson se Dhoma Gjyqësore gjykoj se këta individë u ekspozuan ndaj veprimeve që synonin të ngjallnin frikë dhe t’i bënin që të largoheshin nga Kosova.⁴⁴⁰ Prokuroria gjithashtu thekson se përveç asgjësimit të dokumenteve të identifikimit prej MPB-së, Dhoma Gjyqësore mori parasysh gjashtë faktorë të tjerë në nxjerrjen e konkluzionit se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin synim të përbashkët, përkatësisht: (i) treguesit demografikë; (ii) shtimi dhe përdorimi i forcave serbe dhe të RFJ-së si dhe armatosja e popullatës civile joshqiptare; (iii) praktika e krimeve; (iv) përdorimi i koordinuar i forcave të MPB-së dhe UJ-së; (v) përdorimi i forcës së tepruar në operacionet “kundërterroriste”; dhe (vi) përpjekjet për fshehjen e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë.⁴⁴¹ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk citoi asnjë shembull që tregonte se Dhoma Gjyqësore konkludoi se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë ishte menduar e përkohshme.⁴⁴² Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk identifikon përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me të cilat pretendon se janë “mospërputhëse dhe të mangëta në arsyetim” dhe se rrjedhimisht edhe ky argument duhet hedhur poshtë menjëherë.⁴⁴³ Prokuroria gjithashtu parashtron se Gjorgjeviqi nuk e fakton pretendimin e tij se Dhoma Gjyqësore nuk bëri analizë të imtësishme të synimeve të anëtarëve të NPK-së së pretenduar.⁴⁴⁴

152. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se Prokuroria shpërfill argumentet e tij se prej Dhomës Gjyqësore kërkohet të konkludonte se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin qëllim të përbashkët për dëbimin e përhershëm të shqiptarëve kosovarë dhe se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të nxirrte një përfundim të tillë.⁴⁴⁵

B. Analizë

153. Dhoma e Apelit gjykon se argumentet e Gjorgjeviqit shtrembërojnë përfundimet e Dhomës Gjyqësore. Qëllimi i NPK-së sipas përfundimit të Dhomës Gjyqësore nuk ishte të ndryshohej *përgjithmonë* përbërja etnike në Kosovë, por të bëhej modifikim demografik i

⁴³⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 86.

⁴³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 87.

⁴⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 90-91.

⁴⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 89, përmendet Aktgjykimi, para. 2009-2069, 2081-2108.

⁴⁴² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 93.

⁴⁴³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 92, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 104.

⁴⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 92.

⁴⁴⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 27.

Kosovës “për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën”⁴⁴⁶ nëpërmjet një fushate terrori kundër popullatës civile shqiptare kosovare, që përfshiu dëbime, zhvendosje të dhunshme, vrasje dhe shkatërrimin e objekteve me vlerë fetare ose kulturore.⁴⁴⁷

154. Dhoma e Apelit gjykon se ekzistenca e këtij qëllimi nuk varej nga nxjerrja e përfundimit për ndryshimin e përhershëm të përbërjes etnike apo se të gjithë anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin qëllim për dëbimin e përhershëm të shqiptarëve kosovarë. Nga pikëpamja ligjore, realizimi i objektivit ose qëllimit të përbashkët nuk përbën kusht për nxjerrjen e konkluzionit të dhomës gjyqësore se një shumësi personash kishin të njëjtin qëllim të përbashkët ose, se gjatë jetësimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale u kryen krime.⁴⁴⁸ Rrjedhimisht, konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se qëllimi i përbashkët ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar kontrollin serb mbi krahinën do të ishte përsëri logjik edhe sikur ndryshimi i përbërjes etnike të ishte i përkohshëm dhe të mos arrihej qëllimi. Për më tepër në lidhje me krimet përmes të cilave realizohet qëllimi i përbashkët, Dhoma e Apelit thekson se për ekzistencën e synimit kriminal për dëbim dhe zhvendosje të dhunshme nuk kërkohet ekzistenca e synimit të shpërnguljes së personave përtej një kufiri në mënyrë të përhershme.⁴⁴⁹ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore nuk kishte detyrim të formulonte përfundime të tilla.

155. Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore nuk kishte pengesa që të bazohej në prova të shpërnguljes së përhershme për nxjerrjen e konkluzioneve të veta. Në këtë çështje, Dhoma Gjyqësore ishte qartësisht e vetëdijshme se provat për pengimin e kthimit të popullatës shqiptare kosovare zbulonin qëllimin e përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës dhe garantimin e kontrollit serb. Dhoma Gjyqësore konkludoi se i vetmi deduksion i arsyeshëm që mund të nxirrej në lidhje me synimin e praktikës së konfiskimit dhe asgjësimit të letërnjoftimeve dhe lejeve të qarkullimit si dhe të targave të automjeteve, për shembull ishte “për të penguar shqiptarët kosovarë që të provonin se ishin qytetarë të Kosovës, me të drejtën e rikthimit”.⁴⁵⁰ Dhoma Gjyqësore “u bind se kjo përbën[te] provë të fortë për ekzistencën e një plani kriminal për dëbimin e popullatës shqiptare kosovare nga Kosova”.⁴⁵¹ Dhoma e Apelit nuk konstaton asnjë mangësi në analizën e Dhomës Gjyqësore.

⁴⁴⁶ Aktgjykimi, para. 2003.

⁴⁴⁷ Shih Aktgjykimi, para. 2003, 2007, 2128, 2130-2153.

⁴⁴⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100.

⁴⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 304. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 278, 307; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 206.

⁴⁵⁰ Aktgjykimi, para. 2080 (theksi i shtuar). Dhoma Gjyqësore e konsideroi jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se faktikisht dokumentet nuk u humbën duke qenë se shqiptarët kosovarë thjesht mund të riparaqisnin kërkesë për dokumente zëvendësuese, sepse kjo do të thoshte që ata do të duhej ‘t’ua paraqisnin kërkesat të njëjtave forca që ua kishin konfiskuar fillimisht dokumentet dhe qeveria serbe kishte urdhëruar numrat e identifikimit personal nuk do të rinxirreshin “deri në një njoftim të mëvonshëm” (Aktgjykimi, para. 2079).

⁴⁵¹ Aktgjykimi, para. 2080.

156. Më tej, Dhoma e Apelit gjykon se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore sipas të cilit konfiskimi i letërnjoftimeve dhe lejeve të qarkullimit e targave të automjeteve ishte praktikë gjerësisht e përhapur dhe sistematike, nuk vihet në pikëpyetje nga fakti se së paku tetë personave nuk ua konfiskuan dokumentet e identifikimit.⁴⁵² Për nxjerrjen e konkluzionit të vet mbi ekzistencën e një praktike të tillë, Dhoma Gjyqësore u bazua në prova të shumta se në mars dhe prill 1999, forcat e MPB-së konfiskuan dhe asgjësuan letërnjoftimet dhe në disa raste lejet e qarkullimit dhe targat e automjeteve të individëve të dëbuar nga një sërë qytetesh dhe fshatrash.⁴⁵³ Gjithashtu, [Dhoma Gjyqësore] u bazua në faktin se kjo praktikë u zbatua thuajse në të gjitha komunat në Kosovë dhe se njerëzve që udhëtonin në kolona u kërkuan disa herë letërnjoftimet në postbllloqe të caktuara dhe sërish në vendkalimet kufitare.⁴⁵⁴ Dhoma Gjyqësore mori prova të shumta se njerëzit që kalonin kufirin në kolona refugjatësh u udhëzuan të dorëzonin letërnjoftimet, dokumentet dhe targat e automjeteve në vendkalimin përkatës kufitar.⁴⁵⁵ Bazuar në dëshmitë e dy dëshmitarëve, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në qershor 1999, oficerë të MPB-së dogjën qëllimisht një sasi të madhe letërnjoftimesh, pasaportash dhe kërkesash për pasaporta në Prishtinë.⁴⁵⁶ Dhoma Gjyqësore konstatoi se ndonëse ndër provat e administruara nuk ekzistonin urdhra me shkrim me udhëzime për MPB-në dhe UJ-në për konfiskimin e dokumenteve, Dëshmitari K54 dëshmoi se “dihej gjerësisht” se ekzistonin urdhra që policia dhe UJ-ja të konfiskonin dokumentet e shqiptarëve kosovarë në kufi dhe t’i digjnin, për t’i penguar që të provonin se ishin nga Kosova.⁴⁵⁷ Dëshmitari K89 dëshmoi se ai mori një urdhër për asgjësimin e dokumenteve të identifikimit të shqiptarëve kosovarë dhe gjithashtu pa kur UJ-ja konfiskoi dhe asgjësoi dokumente identifikimi.⁴⁵⁸ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore gjithashtu shqyrtoi dhe i gjykoi jo të besueshme dëshmi të dëshmitarëve të Mbrojtjes të cilët pretenduan se nuk ishin në dijeni të ndonjë praktike të tillë,

⁴⁵² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 103.

⁴⁵³ Aktgjykimi, para. 2072-2073.

⁴⁵⁴ Aktgjykimi, para. 2072-2073, 2080. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2077, diskutohet besueshmëria e dëshmitarëve të Mbrojtjes të cilët mohuan të kishin dijeni për praktikën e konfiskimit të dokumenteve të identifikimit, ose se forcat e UJ-së dhe të MPB-së kishin konfiskuar dokumente.

⁴⁵⁵ Aktgjykimi, para. 530-531 (e paqartë sa individë, që dolën si dëshmitarë dhanë dëshmi mospërputhëse për numrin: 8.000, 10.000, apo 4.000-5.000 (Aktgjykimi, sh. 1943)), 700 (disa mijëra), 739 (i papërcaktuar numri i personave, megjithëse në bazë të provave, kolona u transportua për në kufi nga 20 autobusë dhe kamionë që bënë disa udhëtime (Aktgjykimi, para. 736-738)), 905 (300 persona), 906 (7.000-8.000), 909 (10.000-15.000). Shih Prova Materiales P281, f. 3 (rreth 10.000-12.000 ishin në kolonë; në kufi ishte një shportë në të cilën njerëzit duhej të hidhnin dokumentet e identifikimit); P499, f. 4458-4459, 4484 (nuk jepet numri, ndonëse kalimi i kufirit prej kolonës me shumë njerëz zgjati shumë dhe dëshmitarit iu deshën tri orë të ecte rreth 50 metra. Në kufi kishte shporta brenda të cilave refugjatët duhej të hidhnin dokumentet e tyre të identifikimit para se të kalonin kufirin); P628, f. 4156-4157 (paksa nën 20.000); K81, 15 maj 2009, T. 4545-4546 (“afërsisht një mijë”).

⁴⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2075-2076, përmendet Richard Ciaglinski, 25 May 2009, T. 5290-5291, Karol John Drewienkiewicz, 23 qershor 2009, T. 6399, Prova Materiale P832, f. 10, P833, f. 3210-3211, P834, f. 6848-6849, P997, f. 7816, 7822, 7994-7996.

⁴⁵⁷ Aktgjykimi, para. 2078, përmendet Prova Materiale P784, f. 2.

⁴⁵⁸ Aktgjykimi, para. 2078, përmendet Prova Materiale P1274 f. 9124-9126, 9154-9155, 9186, K89, 26 gusht 2009, T. 8476-8478.

apo se ekzistonte një praktikë e tillë.⁴⁵⁹ Ndonëse Dhoma Gjyqësore pranoi se tetë dëshmitarëve të përmendur nga Gjorgjeviqi nuk ua kishin konfiskuar dokumentet e identifikimit, Dhoma e Apelit konkludon se duke u bazuar në analizën e vet të gjerë të provave, Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se ekzistonte një praktikë e konfiskimit të letërnjoftimeve dhe lejeve të qarkullimit e targave të automjeteve, e cila ishte gjerësisht e përhapur dhe sistematike.⁴⁶⁰

157. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh dhe përjashtoi mundësinë që rastet e asgjësimit të dokumenteve të identifikimit ishin tregues të “armiçësisë dhe mungesës disiplinore” ndërmjet pjesëtarëve të rangut të ulët të UJ-së dhe MPB-së dhe jo provë e një praktike që vinte nga nivelet e larta,⁴⁶¹ Dhoma e Apelit rikujton se dhoma gjyqësore nuk ka detyrim të analizojë deduksione të tjera që mund të ketë pasur parasysh në qoftë se bindet se deduksioni që nxori ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.⁴⁶² Veç shprehjes së mospajimit më përfundimin e Dhomës Gjyqësore, Gjorgjeviqi nuk ka mundur të citojë asnjë provë të administruar në mbështetje të tezës së tij dhe të provojë se në çfarë mënyre gaboi Dhoma Gjyqësore. Rrjedhimisht, argumenti i tij hidhet poshtë.⁴⁶³

158. Gjithashtu, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës parashtrimin e Gjorgjeviqit se përfundimet e Dhomës Gjyqësore janë “mospërputhëse dhe të mangëta në arsyetim”, sepse përdori “referenca të pasaktësuar në lidhje me ‘udhëheqjen e lartë ose [...] qeveritë e RFJ-së dhe të Serbisë’” në vend që të bënte një “analizë të imtësishtme” të synimeve të anëtarëve të NPK-së së pretenduar.⁴⁶⁴ Së pari, Dhoma e Apelit rikujton se për të vërtetuar që një shumësi personash kishin të njëjtin synim të përbashkët,⁴⁶⁵ ligjërisht, Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar të analizonte imtësisht synimin e çdo anëtari të NPK-së.⁴⁶⁶ Më tej, Dhoma Gjyqësore kishte të drejtë të deduktonte, ashtu sikurse deduktoi duke u bazuar në prova rrethore se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin plan të përbashkët, përfshirë edhe faktin se ata

⁴⁵⁹ Aktgjykimi, para. 2071, përmendet Dosja Përmblylëse e Mbrojtjes, para. 351-352, 355 dhe 358. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2007-2008, 2072-2080 (pa citimet). Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore nuk bëri përlllogaritje të numrit të individëve të cilëve u konfiskuan dokumentet e identifikimit, por gjithsesi Dhoma Gjyqësore përlllogariti se nga 24 marsi deri më 20 qershor 1999, nga vendndodhjet konkrete të renditura në Aktakuzë, u dëbuan së paku 200.000 shqiptarë kosovarë (Aktgjykimi, para. 1700).

⁴⁶⁰ Aktgjykimi, para. 2080. Dhoma Gjyqësore konkludoi se kjo përbënte provë të fortë dhe jo sikurse shprehet Gjorgjeviqi provën më të fortë të një plani për të penguar kthimin e shqiptarëve kosovarë (Aktgjykimi, para. 2080.) Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 102-103.

⁴⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 103.

⁴⁶² Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 192. Shih Aktgjykimi, para. 2080, 2130. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2077 (diskutohet besueshmëria e dëshmitarëve të Mbrojtjes të cilët pretenduan se nuk ishin në dijeni të një praktike të tillë).

⁴⁶³ Shih më lart, para. 20.

⁴⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 104. Shih Aktgjykimi, para. 2126-2128.

⁴⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430, dhe referencat e cituara në të. Shih më lart, para. 138-139, 141; më poshtë, para. 175.

⁴⁶⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, sh. 418, dhe referencat e cituara në të; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430, dhe referencat e cituara në të. Shih gjithashtu më lart, para. 141.

bashkëvepruan.⁴⁶⁷ Gjithashtu, Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e tjera përkatëse të Dhomës Gjyqësore.⁴⁶⁸ Sikurse është diskutuar në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi, Dhoma Gjyqësore identifikoi qartësisht anëtarët kryesorë të NPK-së,⁴⁶⁹ shtjelloi gjerësisht dhe hollësisht strukturën komanduese që bashkërendoi operacionet e forcave serbe në Kosovë, ravijëzoi rolin e anëtarëve të identifikuar të NPK-së në këtë strukturë,⁴⁷⁰ dhe konkludoi se provat mbështesnin konkluzionin se ata bashkëvepruan për zbatimin e NPK-së.⁴⁷¹ Rrjedhimisht, argumenti i Gjorgjeviqit hidhet poshtë.⁴⁷²

159. Bazuar në faktorët e lartpërmendur, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte konkluduar se ekzistonte një plan i përbashkët me qëllim ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës për të garantuar kontrollin serb mbi territorin nëpërmjet një fushate terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare kosovare.

C. Konkluzion

160. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrezon tërësisht pikën e pestë të apelit të Gjorgjeviqit.

⁴⁶⁷ Aktgjykimi, para. 2025-2026, 2051, 2126-2128. Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, sh. 418, dhe referencat e cituara në të. Shih gjithashtu më lart, para. 145.

⁴⁶⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 104, përmendet Aktgjykimi, para. 2051. Shih Aktgjykimi, para. 2126-2128.

⁴⁶⁹ Shih më lart, para. 111, 127, 145. Shih më poshtë, para. 166.

⁴⁷⁰ Shih më poshtë, para. 166-169.

⁴⁷¹ Shih më lart, para. 139, 145. Dhoma e Apelit përmend shkarazi sugjerimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte synimin e anëtarëve të NPK-së së pretenduar për vrasje dhe përndjekje të shqiptarëve kosovarë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 106). Ky argument do të shqyrtohet më vonë në këtë Aktgjykimi (Shih më poshtë, para. 188-193, 199-207). Pyetja nëse Gjorgjeviqi zotëronte synimin e nevojshëm, do të trajtohet më vonë në këtë Aktgjykimi (Shih më poshtë, para. 463-514).

⁴⁷² Shih më lart, para. 20.

**VIII. PIKA E GJASHTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT PJESËRISHT:
PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME ATRIBUIMIN E
KRIMEVE TË AUTORËVE TË DREJTPËRDREJTË, ANËTARËVE TË
NPK-SË**

A. Hyrje

161. Dhoma Gjyqësore konkludoi se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin plan të përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar kontrollin serb nëpërmjet një fushate terrori kundër popullatës shqiptare kosovare e cila përfshiu vrasje, dëbime, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe përndjekje (nëpërmjet, vrasjeve, dëbimeve dhe shkatërrimit pa shkak të objekteve fetare).⁴⁷³ Sikurse u përmend më herët, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe e ndërmorën këtë fushatë kundër shqiptarëve kosovarë që më 1998 para ardhjes në jetë të NPK-së brenda mesit të janarit 1999 dhe vazhdoi gjatë tërë luftës.⁴⁷⁴

B. Argumentet e palëve

162. Ndër argumentet e Gjorgjeviqit në pikën e gjashtë të apelit të tij, parashtrohet se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte dhe/ose të arsyetonte se “si u përdor secili prej autorëve të drejtpërdrejtë për kryerjen e krimeve prej tyre”,⁴⁷⁵ duke e zgjeruar në këtë mënyrë fajësinë e tij për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale përtej jurisprudencës së Aktgjykimit të Apelit *Bërgjanin* dhe *Krajishnik*.⁴⁷⁶ Ai shton se arsyetimi përkatës i Dhomës Gjyqësore është tejet i mjegullt dhe është formuluar në mënyrë të paqartë duke qenë se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore ishte se pjesa më e madhe, por jo të gjitha krimet, ishin pjesë e qëllimit të përbashkët.⁴⁷⁷ Gjorgjeviqi argumenton se si pasojë, Dhoma Gjyqësore nuk arriti të provonte lidhjen e kërkuar për çdo vend krimi.⁴⁷⁸

163. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore e zbatoi ligjin si duhej dhe konkludoi se anëtarët e NPK-së kishin kontroll mbi strukturat e MPB-së dhe UJ-së dhe bashkërenduan veprimet e tyre për jetësimin e NPK-së.⁴⁷⁹ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore shpalli verdiktin e përshtatshëm të fajësisë kundër Gjorgjeviqit pas nxjerrjes së përfundimeve të nevojshme në lidhje me: (i) natyrën e planit të përbashkët; (ii) mënyrën e përdorimit të autorëve të drejtpërdrejtë nga anëtarët e NPK-së për zbatimin e planit; dhe (iii) cilat krime ishin

⁴⁷³ Aktgjykimi, para. 2126-2128, 2130, 2136, 2138-2149, 2151-2152.

⁴⁷⁴ Shih më lart, para. 86.

⁴⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 126.

⁴⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 126; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 173.

⁴⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 127-128, përmendet Aktgjykimi, para. 2051, 2069, 2128, 2132, 2136.

⁴⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 127-128, përmendet Aktgjykimi, para. 2051, 2069, 2128, 2132, 2136.

⁴⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 105-106.

pjesë e planit të përbashkët.⁴⁸⁰ Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk provon se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të kishte nxjerrë këtë konkluzion.⁴⁸¹

164. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se në bazë të jurisprudencës, thjesht identifikimi i përkatësisë së një autori të drejtpërdrejtë (p.sh. MPB ose UJ) pa treguar kush e përdori autorin fizik, është i pamjaftueshëm.⁴⁸² Së fundi, ai argumenton se gjithsesi Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e gabuar me sugjerimin se krimet u kryen si pasojë e “formulimit të paqartë të urdhrave”.⁴⁸³

C. Analizë

165. Dhoma e Apelit rikujton se të gjithë anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale mbajnë përgjegjësi për një krim të kryer nga një individ i cili nuk është anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale në qoftë se provohet se krimi mund t’i ngarkohet së paku një anëtari i cili e përdori individin që nuk ishte anëtar gjatë realizimit të planit të përbashkët.⁴⁸⁴ Vërtetimi i lidhjes midis krimit në fjalë dhe anëtarit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale bëhet në kontekstin e rrethanave të çështjes.⁴⁸⁵ Për vërtetimin e lidhjes në fjalë nuk ekziston asnjë kusht ligjor që i kërkon dhomës gjyqësore të vërtetojë “si u përdor çdo autor fizik për kryerjen e krimeve”, me kusht që dhoma gjyqësore të identifikojë mënyrën si një apo më shumë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale përdorën forcat ku bënin pjesë autorët e drejtpërdrejtë për realizimin e planit të përbashkët.⁴⁸⁶

166. Dhoma Gjyqësore identifikoi si anëtarë të NPK-së këta individë: Sllobodan Millosheviqi, President i RFJ-së; Nikolla Shainoviqi, zëvendëskryeministër i RFJ-së përgjegjës për Kosovën; Vllajko Stojilkoviqi, ministër i Punëve të Brendshme; Vllastimir Gjorgjeviqi, shef i RJB-së; Radomir Markoviqi, shef i RDB-së; Sreten Llukiqi, shef i Shtabit të MPB-së për Kosovën; Stevanoviqi, shef i Administratës së Policore të RJB-së; Dragan Iliqi, shef i Administratës së Policisë për Krime të RJB-së; Dragolub Ojdaniqi, shef i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së; Nebojsa Pavkoviqi; komandant i Armatës së Tretë të UJ-së; dhe Vladimir Llazareviqi, komandant i Korpusit të Prishtinës.⁴⁸⁷

⁴⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 106-111.

⁴⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 111.

⁴⁸² Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 29-30.

⁴⁸³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 35.

⁴⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225, 235.

⁴⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168-169; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, 418; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225-226. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 235-237.

⁴⁸⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 235-237. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 126 (theksi në origjinal).

⁴⁸⁷ Aktgjykimi, para. 2127.

167. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se UJ-ja, MPB-ja dhe forcat e atashuara të cilat kryen krimet, “u përdorën në mënyrë të koordinuar nga anëtarët e NPK-së për zbatimin e planit të përbashkët”.⁴⁸⁸ Për nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma arriti në përfundimin se Komanda e Përbashkët bashkërendoi veprimet e UJ-së, MPB-së dhe forcave të atashuara para dhe gjatë periudhës së Aktakuzës.⁴⁸⁹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se organet komanduese të UJ-së (Këshilli i Lartë i Mbrojtjes, Kolegjiumi i UJ-së, dhe në veçanti udhëheqja e Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës), dhe të MPB-së (Shtabi i MPB-së në Prishtinë, Kolegjiumi i MPB-së, shefat e RDB-së dhe RJB-së, dhe në kuadër të RJB-së, shefat e Administratës Policore dhe Administratës së Policisë për Krime) “të cilët vazhduan të ushtronin pushtetin dhe kontrollin e tyre mbi forcat nën komandën e tyre, duke përfshirë njësitë e Policisë së Posaçme dhe Kundërterroriste (përkatësisht “PJP” dhe “SAJ”), ishin përgjegjëse për zbatimin e planit në përdorimin e këtyre forcave në aspektin operativ”.⁴⁹⁰

168. Dhoma Gjyqësore përshkroi në imtësi strukturën hierarkike dhe funksionimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së të pranishme dhe/ose të dislokuara në Kosovë, si edhe forcat paraushtarake ose vullnetare.⁴⁹¹ Ndër forcat e MPB-së përfshiheshin: RJB-ja, e drejtuar nga Gjorgjeviqi,⁴⁹² njësitë më të rëndësishme të së cilës nga ana organizative ishin Administrata e Policisë për Krime e drejtuar nga Dragan Iliqi, dhe Administrata Policore e drejtuar nga Stevanoviqi,⁴⁹³ Sekretariati për Punë të Brendshme (“SPB”) (i përbërë nga DPB-të), të gjitha në varësi të RJB-së⁴⁹⁴ dhe operacionet e të cilave planifikoheshin dhe bashkërendoheshin nga Shtabi i MPB-ë në Prishtinë me në krye Llukiqin,⁴⁹⁵ PJP-ja nën kontrollin e Gjorgjeviqit,⁴⁹⁶ SAJ-i, nën kontrollin e Gjorgjeviqit,⁴⁹⁷ dhe RDB-ja, nën drejtimin dhe kontrollin e Sllobodan Millosheviqit, nëpërmjet shefit të RDB-së, Markoviqit.⁴⁹⁸ Elementi kryesor i UJ-së në Kosovë ishte Korpusi i Prishtinës që ishte në përbërje të Armatës së Tretë të UJ-së, me seli në

⁴⁸⁸ Aktgjykimi, para. 2051. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2036, 2128.

⁴⁸⁹ Aktgjykimi, para. 252, 241, 2051. Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e mëhershëm të Dhomës Gjyqësore se ndër anëtarët e Komandës së Përbashkët përfshiheshin këta anëtarë të NPK-së: Nikolla Shainoviqi, Vllastimir Gjorgjeviqi, Nebojsa Pavkoviqi, Sreten Llukiqi, Vladimir Llazareviqi (Aktgjykimi, para. 239. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 241).

⁴⁹⁰ Aktgjykimi, para. 2051. Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh dëshmitë ë dëshmitarëve të UJ-së sipas të cilëve ata u urdhëruan të dëbonin shqiptarë kosovarë ose të digjnin fshatra (Aktgjykimi, para. 2007); urdhrat erdhën nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së, komanda e Armatës së Tretë në lidhje me përdorimin e UJ-së në bashkërendim me MPB-në para ndërhyrjes së NATO-s (Aktgjykimi, para. 2018); telegrami i Gjorgjeviqit për mobilizimin dhe regjistrimin e vullnetarëve në përfundim të MPB-së për operacionet e afërta të pastrimit të terrenit (Aktgjykimi, para. 2020-2021); dhe përfundimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me një vendim të përbashkët për përdorimin e përbashkët të paraushtarakëve dhe MPB-së (Aktgjykimi, para. 2021).

⁴⁹¹ Aktgjykimi, Kapitulli IV.

⁴⁹² Aktgjykimi, para. 40-45, 1892, 1898, 2154, 2171.

⁴⁹³ Aktgjykimi, para. 41, 60.

⁴⁹⁴ Aktgjykimi, para. 46, 48.

⁴⁹⁵ Aktgjykimi, para. 49, 1897.

⁴⁹⁶ Aktgjykimi, para. 61-63, 1892, 1898, 2154, 2171.

⁴⁹⁷ Aktgjykimi, para. 71-72, 1892, 1898, 2154, 2171.

⁴⁹⁸ Aktgjykimi, para. 79. Pjesë e RDB-së ishte edhe JSO-ja, e udhëhequr nga Franko Simatoviqi (Aktgjykimi, para. 80).

Prishtinë.⁴⁹⁹ Kjo njësi drejtohej nga Llazareviqi i cili kishte epror të drejtpërdrejtë, komandantin e Armatës së Tretë, Pavkoviqin.⁵⁰⁰ Gjithashtu, ekzistonin edhe dy forca të posaçme për veprimtari kundërterroriste: Brigada e 72-të Speciale e UJ-së dhe Brigada e 63-të Parashutiste, në varësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, nën kontrollin e Ojdaniqit.⁵⁰¹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi si shef i RJB-së dhe ndihmësministër, kishte pushtet *de jure* dhe ushtroi kontroll efektiv mbi policinë në Kosovë që kreu shumicën e krimeve kundër shqiptarëve kosovarë gjatë periudhës së Aktakuzës, ndër të tjerë, policia e rregullt dhe rezervistët, PJP-ja, SPB-të dhe SAJ-i.⁵⁰²

169. Në përmbledhje, Dhoma Gjyqësore identifikoi cilat njësi dhe/ose degë të MPB-së dhe UJ-së vepronin në Kosovë gjatë periudhës përkatëse, drejtuesit e këtyre njësive në aspektin operativ dhe lidhjet e këtyre personave me organet më të larta komanduese të MPB-së dhe UJ-së në Beograd. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat e MPB-së që vepronin në Kosovë në fund të fundit ishin në varësi të Gjorgjeviqit, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet anëtarëve të tjerë të NPK-së të pranishëm në terren si Llukiqi, Stevanoviqi, dhe Dragan Iliqi. Gjithashtu u konkludua se njësitë e UJ-së ishin në varësinë e Ojdaniqit, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet anëtarëve të NPK-së në terren si Pavkoviqi dhe Llazareviqi. Dhoma Gjyqësore identifikoi në cilat njësi të UJ-së ose MPB-së ishin atashuar ose vartësuar njësitë vullnetare/parashtarake.⁵⁰³ Në këtë mënyrë, Dhoma Gjyqësore vërtetoi se autorët fizikë ishin nën përgjegjësinë ose komandën e disa individëve të identifikuar qartësisht si anëtarët kryesorë të NPK-së. Dhoma e Apelit rikujton se nuk është e nevojshme që lidhja midis autorit fizik dhe një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët të jetë e drejtpërdrejtë, por mund të jetë edhe e tërthortë, me fjalë të tjera identifikohet duke u bazuar në strukturën hierarkike të forcave të implikuara në kryerjen e krimeve.⁵⁰⁴ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore vërtetoi lidhjen e nevojshme midis autorëve fizikë dhe disa anëtarëve të NPK-së.

⁴⁹⁹ Aktgjykimi, para. 158.

⁵⁰⁰ Aktgjykimi, para. 158, 166.

⁵⁰¹ Aktgjykimi, para. 155, 157-158, 164, 166. Për parashtaraket, shih Aktgjykimi, para. 205, 208-209, 214, 216; më poshtë, Pjesa X.F.

⁵⁰² Aktgjykimi, para. 1892, 1898, 2154, 2171.

⁵⁰³ Aktgjykimi, para. 204-207, 1231-1261 (Akrepit), 208-211 (Tigrat e Arkanit), 212-215, 938-1012 (Shqiponjat e Bardha), 216 (Merimangat).

⁵⁰⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 174-181, përmendet Aktgjykimi *Martiq*, para. 135, 140-143, 155, 159-160, 445-446, 453-455, ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se lidhja midis Martiqit dhe autorëve fizikë ishte vërtetuar kryesisht mbi bazën e: (i) strukturës hierarkike të APJ-së, të policisë dhe të forcave të tjera serbe që vepronin në territorin e SAO-së së Krajnës dhe Republikës së Krajnës serbe; (ii) rolit në përgjithësi të Martiqit si ministër i Brendshëm, pushtetit të tij absolut mbi MPB-në dhe kontrollit të tij mbi forcat e armatosura të SAO-së së Krajnës; (iii) bashkëpunimit të Mbrojtjes Territoriale, APJ-së *Milicija Krajine* dhe forcave të armatosura të SAO-së; (iv) kontrollit ndaj APJ-së dhe Mbrojtjes Territoriale nga anëtarë të tjerë të NPK-së; dhe (v) veprimet dhe synimin e Martiqit. Shih më tej Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 187-189, 195, 205-206, përmendet Aktgjykimi *Martiq*, para. 174-181, 202-203, 244-247, 266, 274-275, 281-288, 294, 443-444, 446, 450-454, ku Dhoma Gjyqësore përmendi provat që vërtetonin se disa individë të armatosur që ishin vetidentifikuar si “njerëzit e Martiqit”, “milicia e Martiqit”, ose “forcat rezerviste, trupat ose ushtria e Martiqit” të cilët mbanin uniforma si ato të ushtrisë, faktikisht ishin ushtarë të

170. Më tej, Dhoma e Apelit konstaton se në pjesën e Aktgjykimit ku diskutohen krimet e përmendura në Aktakuzë, Dhoma Gjyqësore përcaktoi konkretisht cilat forca serbe u angazhuan në secilën komunë dhe përshkroi urdhrat nëpërmjet të cilëve u dislokuan këto forca.⁵⁰⁵

D. Konkluzion

171. Si konkluzion, Dhoma e Apelit nuk u bind nga sugjerimi i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore duhej të vërtetonte, vërtetim të cilin nuk mundi ta bënte “mënyrën e përdorimit të çdo autori fizik për kryerjen e krimeve”,⁵⁰⁶ kur e ngarkoi atë me përgjegjësi penale na bazë të

APJ-së ose Mbrojtjes Territoriale, ose pjesëtarë të *Milicija Krajina*, ose së paku vepruan në bashkëpunim me APJ-në për kryerjen e krimeve që ishin pjesë e NPK-së. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 226; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 169, konkludohet se vërtetimi i lidhjes midis një autori fizik i cili nuk është anëtar i NPK-së dhe një anëtar i NPK-së bëhet në varësi të rrethanave të çështjes konkrete.

⁵⁰⁵ Për komunën e Rahovecit: Aktgjykimi, para. 450-455, 478 (Bellacërkë), 501 (Krushë e Vogël), 515 (Krushë e Madhe dhe Nagavc), 533-534 (Celinë). Për komunën e Prizrenit: Aktgjykimi, para. 563-564 (qyteti i Prizrenit), 572 (Dushanovë), 581-582 (Piranë), 590-592 (Landovicë), 597 (Sërbicë). Për komunën e Skënderajt: Aktgjykimi, para. 610, 644, 649, 651. Për komunën e Suharekës: Aktgjykimi, para. 653, 658, 692 (qyteti i /Suharekës), 704 (Peqan), 708 (Tërrnje), 714, 716, 718 (Bellanicë), 727 (Budakovë). Për komunën e Pejës: Aktgjykimi, para. 742 (qyteti i Pejës). Për komunën e Mitrovicës: Aktgjykimi, para. 766-767, 774 (Mitrovicë), 786, 789, 791 (Zhabar). Për Prishtinën: Aktgjykimi, para. 797, 800, 816-817, 819, 823, 825, 829. Për komunën e Gjakovës: Aktgjykimi, para. 923, 925 (Gjakovë), 949-950, 953, 955, 1002-1010 (luginat e Carragojit, Erenikut dhe Travës – operacioni Reka). Për komunën e Gjilanit: Aktgjykimi, para. 1013, 1041, 1054, 1056. Për komunën e Ferizajt: Aktgjykimi, para. 1062-1063. Për komunën e Kaçanikut: Aktgjykimi, para. 1105, 1127, 1134. Për komunën e Deçanit: Aktgjykimi, para. 1144, 1157-1159. Për komunën e Vushtrrisë: Aktgjykimi, para. 1162, 1165, 1218 (qyteti i Vushtrrisë), 1169 (Sfaraçak i Poshtëm), 1176, 1182 (Studime e Poshtme), 1213 (Smrekonicë), 1215 (Dobërllukë). Për komunën e Podujevës: Aktgjykimi, para. 1223, 1225, 1230, 1239, 1261.

Për shembull, gjatë diskutimit të operacionit të kryer nga forcat e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Rahovec, Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Më 23 mars 1999, Komanda e Përbashkët për Kosovën lëshoi një urdher në të cilin elementë të përforcuar të Korpusit të Prishtinës të UJ-së, përbërë prej Brigadës së Motorizuar 549, Brigadës së Mekanizuar 243 dhe bazës logjistike 202, në bashkëpunim me “popullatën e armatosur jo-UÇK” të kryenin operacion në mbështetje të “bllokimit, zmbropsjes dhe shkatërrimit” të forcave të UÇK-së në zonën e përgjithshme të Rahovecit dhe Krushës së Madhe (Aktgjykimi, para. 450).

Në përputhje me urdhrin e Komandës së Përbashkët, më 23 mars 1999, Bozhidar Deliqi komandanti i Brigadës së Motorizuar 549, i cili ishte vartës i drejtpërdrejtë i gjeneralletjënant Vladimir Llazareviqit, i cili në atë kohë komandonte Korpusin e Prishtinës, urdhëroi Kompaninë 37 të PJP-së së Nishit, Kompaninë 4 të PJP-së së Prizrenit dhe Kompaninë 4 të PJP-së së Gjakovës – që të gjitha pjesë të MPB-së - që të bashkërendonin veprimet me Brigadën e Motorizuar 549 (Aktgjykimi, para. 451).

Pas operacioneve në territorin e komunës së Rahovecit, siç shtjellohet më poshtë, Komanda e Korpusit të Prishtinës mori raporte të cilat konfirmonin praninë e forcave të UJ-së dhe MPB-së në këtë komunë midis 25 marsit 1999 dhe 3 prillit 1999. [...] Është dokumentuar se gjatë operacionit të kryer në komunë nga data 25 mars 1999, u dislokuan rreth 2.000 pjesëtarë të forcave serbe, prej të cilave rreth 1.020 ishin pjesëtarë të MPB-së. V Njësitë e UJ-së që u përfshinë në operacion (në komunën e Rahovecit) ishin: Detashmenti Territorial-Ushtarak 101, Brigada e Motorizuar 243, Brigada e Blinduar 15, Kompania e Mortajave 120, dhe Batalioni i 2-të i Motorizuar. Forcat e MPB-së të dislokuara në zonën e operacioneve nga data 25 mars 1999 përfshinin: Detashmentin e 37-të të PJP-së së Nishit, Detashmentin e 23-të të PJP-së, Kompaninë e 5-të të PJP-së së Prishtinës dhe Kompaninë e 4-të të Detashmentit të PJP-së nga Gjakova (Aktgjykimi, para. 455. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 450-454 (jepen hollësi të urdhrave të dislokimit).

Më pas, Dhoma Gjyqësore parashtroi me hollësi provat për veprimtarinë e këtyre forcave në diskutimin e ngjarjeve të pretenduara në Aktakuzë (Aktgjykimi, para. 456-554).

⁵⁰⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 126.

doktrinës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime të kryera nga individë të cilët nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore duhej të vërtetonte: (i) se krimet e pretenduara ishin kryer; (ii) identitetin e autorëve fizikë të krimeve (individë, grupe, apo njësi); (iii) se krimet ishin pjesë e qëllimit kriminal të përbashkët; dhe (iv) se së paku një anëtar i NPK-së i përdori autorët fizikë për realizimin e planit të përbashkët.⁵⁰⁷ Pas një analize të gjerë dhe të imtësishme sikurse përmendet më lart, Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimet ishin kryer, identifikoi autorët fizikë (në këtë rast njësitë e UJ-së, MPB-së dhe forcat e atashuara në to), vërtetoi cilët individë ishin përgjegjës për këto forca ose që komandonin këto forca, vërtetoi se veprimet e autorëve fizikë ishin pasojë e drejtpërdrejtë e urdhrave dhe udhëzimeve të individëve komandues dhe përcaktoi se individët komandues ishin anëtarë të NPK-së. Për nxjerrjen e këtyre përfundimeve, Dhoma Gjyqësore u bazua në jurisprudencën e Aktgjykimit të Apelit *Bërgjanin* dhe Aktgjykimit të Apelit *Krajishnik*. Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore doli jashtë kësaj jurisprudence ose e zgjeroi atë. Gjithashtu, Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte lidhjen e nevojshme, me fjalë të tjera se si një anëtar i NPK-së urdhëroi dislokimin e forcave pjesëtarë të të cilave ishin autorët fizikë të krimeve, për zbatimin e planit të përbashkët.

172. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rrëzon pjesërisht pikën e gjashtë të apelit të Gjorgjeviqit.⁵⁰⁸

⁵⁰⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225-226, 235-237; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410-414. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 1269, 183-189.

⁵⁰⁸ Shih gjithashtu më lart, para. 59-72, ku Dhoma e Apelit rrëzon pjesën e mbetur të pikës së gjashtë të apelit të Gjorgjeviqit.

IX. PIKA E SHTATË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME PËRFUNDIMIN SE VRASJET DHE PËRNDJEKJET ISHIN PJESË E QËLLIMIT TË NPK-SË

A. Hyrje

173. Dhoma Gjyqësore konkludoi se anëtarët e NPK-së kishin të njëjtin plan të përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar kontrollin serb nëpërmjet një fushate terrori kundër popullatës shqiptare kosovare, që përfshiu vrasje, dëbime, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje të dhunshme), dhe përndjekje (nëpërmjet vrasjes, dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, dhe shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore).⁵⁰⁹

174. Konkluzionin e vet, Dhoma Gjyqësore ndër të tjera e bazoi në provat për: (i) krijimin e Komandës së Përbashkët;⁵¹⁰ (ii) procesverbalet e mbledhjeve të Kolegjiumit të UJ-së, Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Kolegjiumit të MPB-së dhe Shtabit të MPB-së për Kosovën gjatë të cilave u planifikuan dhe u urdhëruan operacione të përbashkëta të UJ-së dhe të MPB-së;⁵¹¹ (iii) nxjerrjen e urdhrave, zbatimin e tyre në terren si dhe mbikëqyrjen dhe raportimin e tyre;⁵¹² (iv) “shtimin” dhe përdorimin e forcave të UJ-së, MPB-së dhe forcave të atashuara në to në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit;⁵¹³ (v) përdorimin e koordinuar të forcave të UJ-së, MPB-së dhe forcave të atashuara;⁵¹⁴ (vi) praktikën e krimeve të kryera nga këto forca gjatë marrjes nën kontroll dhe hyrjes në fshatra;⁵¹⁵ (vii) planin dhe fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë gjatë këtyre operacioneve;⁵¹⁶ (viii) përdorimin e forcës së tepruar;⁵¹⁷ dhe (ix) qëndrimin e udhëheqësve kryesorë politikë dhe ushtarakë.⁵¹⁸

175. Veçanërisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ndonëse në urdhrat dhe udhëzimet lidhur me këto operacione nuk urdhërohej shprehimisht kryerja e krimeve prej forcave të armatosura, “pasaktësia e qëllimshme e këtyre urdhrave mundësoi dhe faktikisht inkurajoi një interpretim që nënkuptonte ekzekutimin e luftëtarëve të UÇK-së, e atyre që dyshohej se ishin pjesëtarë të UÇK-së dhe të njerëzve që konsideroheshin përkrahës të UÇK-së dhe “pastrimin” e pjesëve të

⁵⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2126, 2128, 2130. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2136-2149, 2151-2152.

⁵¹⁰ Aktgjykimi, para. 2126-2127. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 226-237.

⁵¹¹ Aktgjykimi, para. 2126-2127, 2134. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2023-2024.

⁵¹² Aktgjykimi, para. 2126, 2132-2136.

⁵¹³ Aktgjykimi, para. 2010-2026.

⁵¹⁴ Aktgjykimi, para. 2036-2051.

⁵¹⁵ Aktgjykimi, para. 2027-2035, 2036-2051, 2129-2130, 2132-2135. Dhoma Gjyqësore konkludoi se UJ-ja rrethonte fshatin apo zonën dhe sipas nevojës mundësoi mbështetje me artileri, kurse MPB-ja ndërmerre sulm me këmbësorie (Aktgjykimi, para. 2037). Shih gjithashtu Aktgjykimi, Kapitulli VI.

⁵¹⁶ Aktgjykimi, para. 2111-2117.

⁵¹⁷ Aktgjykimi, para. 2052-2069.

⁵¹⁸ Aktgjykimi, para. 2023-2025, 2062.

tëra të Kosovës nga banorët shqiptarë dhe largimin e tyre përtej kufijve, duke përdorur të gjitha mjetet e disponueshme”.⁵¹⁹ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

shkalla e operacioneve anembanë Kosovës, praktika e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë si dhe numri i madh i njëjësive të ndryshme të UJ-së dhe MPB-së që u përfshinë në operacione të tilla e bindin Dhomën se ekzistonte një plan për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës përmes fushatës së terrorit dhe dhunës, i cili përfshinte shumësi personash të cilët morën pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët dhe kishin të njëjtin synim për të kryer krime të tilla.⁵²⁰

176. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se krimet e vrasjes dhe përndjekjeve (nëpërmjet dëbimit, zhvendosjes së dhunshme dhe shkatërrimit të objekteve fetare) ishin pjesë e NPK-së, për shkak se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte se çdo anëtar i NPK-së kishte të njëjtin synim kriminal.⁵²¹ Dhoma e Apelit fillimisht do të analizojë parashtrimet e tij në lidhje me vrasjen dhe më pas në lidhje me përndjekjet.

B. Pretendim për gabim në konkluzionin se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së

1. Argumentet e palëve

177. Gjorgjeviqi argumenton se megjithëse në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*, nuk u arrit të vërtetohej se Shainoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Llazareviqi, ose Llukiqi kishin synimin e vrasjes, Dhoma Gjyqësore në çështjen në fjalë “shfrytëzoi urdhrat dhe komandat e këtyre njerëzve për të deduktuar synimin e vrasjes që më tej iu ngarkua NPK-së dhe Gjorgjeviqit”.⁵²² Gjorgjeviqi citon konkluzionin në Aktgjykimin *Millutinoviqi dhe të tjerët*, që supozohet se u bazua në të njëjtat fakte, se nuk ekzistonte një praktikë e identifikueshme vrasjesh.⁵²³ Gjorgjeviqi argumenton se në qoftë se vrasja do të kishte qenë pjesë e synimit të NPK-së, në tërë Kosovën do të ishin vrarë shumë më tepër njerëz dhe do të kishte pasur më shumë raste të

⁵¹⁹ Aktgjykimi, para. 2132 (theksi i shtuar). Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

në shumicën e rasteve forcat e UJ-së dhe MPB-së i zbatuan [urdhrat dhe direktivat] në një mënyrë që përfshinte dëbimin e dhunshëm të civilëve shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre, djegien e shtëpive, fshatrave dhe pronave të shqiptarëve, vrasjen e civilëve shqiptarë kosovarë, në veçanti të burrave dhe djemve të rinj të aftë për luftë, dhe ekzekutimin e luftëtarëve të UÇK-së të zënë rob (Aktgjykimi, para. 2133).

Operacionet e përbashkëta përfshinin asgjësimin e UÇK-së nëpërmjet vrasjes së anëtarëve të saj, pastrimin e zona prej mbështetësve të UÇK-së apo NATO-s në pritje të sulmit tokësor të NATO-s, dhe nëpërmjet vrasjes dhe shpërnguljes së popullatës civile shqiptare kosovare nga zonat, shpeshherë duke i dëbuar përtej kufijve në mënyrë që të mos ishin më pjesë e popullsisë së Kosovës. Për realizimin e këtyre qëllimeve u vunë në zbatim metoda si zhvendosja e dhunshme, dëbimi, vrasja dhe shkatërrimi i shtëpive, fshatrave dhe i objekteve me rëndësi fetare apo kulturore të civilëve shqiptarë kosovarë (Aktgjykimi, para. 2135).

⁵²⁰ Aktgjykimi, para. 2128.

⁵²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 130, 132-133, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 220, Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 418, Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 109, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 110. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 136.

⁵²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 137.

⁵²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 136, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 94, theksohet se Dhoma Gjyqësore në çështjen në fjalë e konfirmoi këtë konkluzion në shqyrtimin e dënimit (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 191, përmendet Aktgjykimi, para. 2227, sh. 7435).

vrasjeve masive.⁵²⁴ Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte vërtetuar “vrasja” e së paku 724 individëve në dhjetë vendndodhje në Kosovë,⁵²⁵ në 7 nga 14 komunat e atëhershme dhe më së shumti në fshatra në krahasim me qytetet e mëdha.⁵²⁶ Gjithashtu, Gjorgjeviqi argumenton se përfundimi alternativ i Dhomës Gjyqësore në lidhje me synimin e tij kriminal në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale është i paqartë dhe lë të hapur deduksionin se Gjorgjeviqi dhe anëtarë të tjerë të NPK-së nuk kishin synim për vrasje.⁵²⁷

178. Prokuroria përgjigjet se meqenëse përfundimet e çështjes *Millutinoviqi dhe të tjerët* nuk ishin detyruese për Dhomën Gjyqësore, argumenti i Gjorgjeviqit duhet hedhur poshtë.⁵²⁸ Gjithashtu, Prokuroria përgjigjet se Dhoma e Apelit duhet të rrëzojë menjëherë argumentin e Gjorgjeviqit se që Dhoma Gjyqësore të konkludonte se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së, duhej të kishte pasur shumë më tepër të vrarë në Kosovë.⁵²⁹ Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi nuk shpjegon sa persona duhej të ishin vrarë që Dhoma Gjyqësore të arrinte në një përfundim të tillë dhe argumenton se nuk ekziston asnjë numër që të do të shërbente si kufi i poshtëm.⁵³⁰ Për më tepër, Gjorgjeviqi “shpërfill përfundimet e Dhomës Gjyqësore se vrasja ishte ‘elementi qendror i fushatës së terrorit,’ e kryer në mënyrë të shpeshtë ‘që synonte largimin e shqiptarëve kosovarë nga Kosova,’”⁵³¹ dhe zëvendëson interpretimin e provave prej Dhomës Gjyqësore me interpretimin e vet.⁵³² Së fundi, Prokuroria argumenton se përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishin alternative dhe nuk janë të paqarta.⁵³³

2. Analizë

179. Dhoma e Apelit gjykon se parashtrimi i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi me nxjerrjen e konkluzionit se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së, pak a shumë mbështetet në tre argumente bazë. Së pari argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi sepse këtë konkluzion e

⁵²⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 36. Gjithashtu, Gjorgjeviqi parashtron se vrasjet masive në Kosovë ishin relativisht të rralla në krahasim me konfliktet e tjera (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134).

⁵²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134, përmendet Aktgjykimi, para. 1780.

⁵²⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 135.

⁵²⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 138, sh. 196; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 39. Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se fakti që Dhoma Gjyqësore nxori përfundime alternative në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, sugjeron se Dhoma Gjyqësore “nuk ishte e sigurtë se ai kishte pasur synimin e vrasjes” (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 138, sh. 196). Rrjedhimisht, ai argumenton se bazuar në përfundimet e veta faktike, për Dhomën Gjyqësore ishte po aq i mundshëm edhe deduksioni se ai nuk kishte synimin e nevojshëm për vrasje (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 138, përmendet Aktgjykimi, para. 2139, 2141, 2145, 2147, 2153, 2158, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 237). Aspekti nëse Gjorgjeviqi kishte synimin e nevojshëm në lidhje me vrasjen do të diskutohet më vonë në këtë Aktgjykimi (Shih më poshtë, Kapitulli XI).

⁵²⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 117.

⁵²⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 112.

⁵³⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 112, 116.

⁵³¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 115, përmendet Aktgjykimi, para. 2137.

⁵³² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 112, 115-116, përmendet Aktgjykimi, para. 674-675, 2007, 2032, 2137.

⁵³³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 119.

bazoi në urdhrat dhe direktivat e nxjerra nga Shainoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Llazareviqi, ose Llukiqi, megjithëse Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*, mbi bazën e fakteve të njëjta, nuk arriti të konkludonte se ata kishin synimin e nevojshëm për vrasje.⁵³⁴ Së dyti, ai argumenton se numri i kufizuar i vrasjeve dhe vendndodhjeve përkatëse tregon se nuk kishte plan të një shkalle të gjerë për vrasjen e shqiptarëve kosovarë dhe se anëtarët e NPK-së nuk kishin synimin e përbashkët për kryerje vrasjesh.⁵³⁵ Rrjedhimisht, mbetet i mundshëm edhe përfundimi se vrasja “nuk ishte pjesë e qëllimit të NPK-së së pretenduar”.⁵³⁶ Së treti, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të nxirrte përfundim në lidhje me synimin për vrasje të anëtarëve të tjerë të NPK-së, duke mos qenë në gjendje të përvijonte “kushtin themelor” që anëtarët e NPK-së të kishin të njëjtin synim për krimet sipas marrëveshjes.⁵³⁷ Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë një nga një këto pika.

180. Në lidhje me argumentin e parë të Gjorgjeviqit për konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* mbi vrasjet, Dhoma e Apelit kujton se për nxjerrjen e përfundimeve faktike, gjykatësit bazohen tërësisht dhe vetëm në provat e administruara në çështjen konkrete që gjykohej.⁵³⁸ Do të ishte tejet e parregullt që Dhoma e Apelit të merrte parasysh çfarëdo prove që nuk është në provat e administruara të çështjes në apel.⁵³⁹ “*quod non est in actis, non est in mundo*”. Edhe mbi bazën e të njëjtave fakte, dëshmitë gojore dhe provat mund të ndryshojnë nga çështja në çështje. Rrjedhimisht, pranohet se dy gjykues të arsyeshëm faktesh mund të arrijnë në dy konkluzione të ndryshme, por logjikisht të barazvlefshme, edhe pse kanë të bëjnë me të njëjtat ngjarje.⁵⁴⁰ Pyetja të cilës duhet t’i japë përgjigje Dhoma e Apelit është nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si të Dhomës Gjyqësore dhe jo nëse konkluzioni i nxjerrë nga një dhomë tjetër gjyqësore ishte i arsyeshëm.⁵⁴¹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do të qartësojë nëse ishte e arsyeshme që si bazë

⁵³⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 136-137. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*, konkludoi se plani i përbashkët nuk përfshinte krimin e vrasjes (Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, para. 94-95). Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se vrasja ishte logjikisht e parashikueshme për Shainoviqin, Pavkoviqin, dhe Llukiqin (Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 470, 785, 1134) dhe i shpalli fajtorë për vrasje mbi bazën e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 475, 788, 1138). Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* konkludoi se ndonëse kishte “prova të konsiderueshme” në mbështetje të akuzës se Ojdaniqi dhe Llazareviqi ishin përkrahës të kryerjes së krimeve anëmbanë Kosovës nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së, nuk ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ata “kishin synim të përbashkët me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale” (Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 616, 917).

⁵³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134-135.

⁵³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134-136.

⁵³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 136-137.

⁵³⁸ Shih, në një kontekst të ndryshëm, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 78, 84-85. Shih gjithashtu më lart, para. 143.

⁵³⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 311, 312.

⁵⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 396, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kërmojelac*, para. 11-12. Dhoma e Apelit rikujton se “dy gjykatës që arsyetojnë në mënyrë logjike, mund të arrijnë në konkluzione të ndryshme”, edhe pse bazohen në të njëjtat prova (Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiqi dhe të tjerët*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 64; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, para. 22).

⁵⁴¹ Shih më lart, para. 16.

për konkluzionin se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së, Dhoma Gjyqësore t'u referohej urdhrave të Shainoviqit, Ojdaniqit, Pavkoviqit, Llazareviqit ose Llukiqit.

181. Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi nuk identifikon shprehimisht asnjë urdhër apo udhëzim të Shainoviqit, Ojdaniqit, Pavkoviqit, Llazareviqit, ose Llukiqit, që sipas tij Dhoma Gjyqësore iu referua gabimisht për të deduktuar se vrasja ishte pjesë e planit të përbashkët.⁵⁴² Faktikisht, ai citon disa paragrafë të Aktgjykimit,⁵⁴³ në të cilët përmenden: (i) një direktivë e UJ-së e 16 janarit 1999 nënshkruar nga Ojdaniqi ("Direktiva e Operacionit Grom-3"),⁵⁴⁴ (ii) urdhri i Pavkoviqit në lidhje me përdorimin e Armatës së Tretë të UJ-së në Kosovë me datën 27 janar 1999;⁵⁴⁵ (iii) shembuj të urdhrave për "pastrimin e terrenit",⁵⁴⁶ (iv) shembuj të urdhrave për vendosjen e "kontrollit luftarak" në disa zona të Kosovës;⁵⁴⁷ dhe (v) disa urdhra të Komandës së Përbashkët dhe një urdhër të Komandës së Korpusit të Prishtinës për "shkatërrimin" e "forcave terroriste" shqiptare kosovare.⁵⁴⁸

182. Dhoma e Apelit vë në dukje se vetëm tre prej këtyre urdhrave mund t'i atribuohen Shainoviqit, Ojdaniqit, Pavkoviqit, Llazareviqit, ose Llukiqit: (i) direktiva e UJ-së e 16 janarit 1999 nënshkruar nga Ojdaniqi,⁵⁴⁹ (ii) urdhri mbi përdorimin e Armatës së Tretë në Kosovë me datë 27 janar 1999 nxjerrë nga Pavkoviqi;⁵⁵⁰ dhe (iii) urdhri i Komandës së Korpusit të Prishtinës për "shkatërrimin" e "forcave terroriste" shqiptare kosovare nxjerrë nga Llazareviqi.⁵⁵¹

183. Dhoma Gjyqësore diskutoi direktivën e UJ-së të 16 janarit 1999 nënshkruar nga Ojdaniqi⁵⁵² dhe urdhrin e Pavkoviqit në lidhje me përdorimin e Armatës së Tretë të UJ-së në

⁵⁴² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 137.

⁵⁴³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 137, sh. 193, përmendet Aktgjykimi, para. 2018-2026, 2034-2035, 2051, 2056, 2062, 2066, 2069, 2126, 2129, 2130, 2132, 2134-2135, 2138-2152. Disa paragrafë të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore cituar nga Gjorgjeviqi nuk e mbështesin parashkrimin e tij. Për shembull paragrafi 2056 përmend disa urdhra gojorë, mirëpo asnjë prej këtyre urdhrave nuk u dha nga Shainoviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi, Llazareviqi, ose Llukiqi (Aktgjykimi, para. 2056; K89, 26 gusht 2009, T. 8476 (seancë private); Prova Materiale P1273, f. 9124 (konfidenciale); Prova Materiale P1274, f. 9124 (versioni publik i redaktuar i Provës Materiale P1273); Prova Materiale P320, para. 41 (konfidenciale); Prova Materiale P321, para. 41 (versioni publik i redaktuar i Provës Materiale P320)). Paragrafi 2062 i Aktgjykimit diskuton raportet e vëzhguesve të huaj mbi përdorimin e forcës së tepruar nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së në përgjigje të aksioneve të UÇK-së. Edhe paragrafi 2066 diskuton përdorimin e forcës së tepruar në kontekstin e parimeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare, kurse paragrafi 2069 përmban konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi përdorimin e forcës së tepruar nga UJ-ja dhe MPB-së.

⁵⁴⁴ Prova Materiale D179. Shih Aktgjykimi, para. 2018, 2035, 2134.

⁵⁴⁵ Prova Materiale D343. Shih Aktgjykimi, para. 2018.

⁵⁴⁶ Prova Materiales P957, f. 3; P493, para. 45-46; P782, f. 2; K54, 13 maj 2009, T. 4367. Shih Aktgjykimi, para. 2132.

⁵⁴⁷ Prova Materiale P896, f. 4, 6. Shih Aktgjykimi, para. 2132.

⁵⁴⁸ Prova Materiales P350; P969; P970; P766; P767; P961; P1235; P1382. Shih Aktgjykimi, para. 2132.

⁵⁴⁹ Prova Materiale D179. Shih Aktgjykimi, para. 2018, 2035, 2134.

⁵⁵⁰ Prova Materiale D343. Shih Aktgjykimi, para. 2018.

⁵⁵¹ Prova Materiale P961. Shih Aktgjykimi, para. 2132.

⁵⁵² Prova Materiale D179. Shih Aktgjykimi, para. 2018, 2035, 2134.

Kosovë të 27 janarit 1999,⁵⁵³ si prova që tregonin se në Kosovë kishte shtim dhe përdorim të forcave të UJ-së dhe të MPB-së “në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit dhe me qëllimin e deklaruar për gjetjen e zgjidhjes politike për çështjen e Kosovës”.⁵⁵⁴ Shtimi dhe përdorimi i forcës ishte një nga shtatë “elementët kyç” të identifikuar dhe analizuar nga Dhoma Gjyqësore si prova të një plani të përbashkët.⁵⁵⁵ Direktiva për operacionin Grom-3 iu drejtua komandave të Armatës së Parë, të Dytë dhe të Tretë të UJ-së, Forcës Ajrore, Mbrojtjes Kundërajrore, dhe Korpusit të Njësisive të Posaçme. Ndër të tjera këto forca u ngarkuan me detyrë që të përgatiteshin për ndërhyrjen e pritshme të NATO-s, parandalimin e hyrjes me forcë të një brigade shumëkombëshe të NATO-s në Kosovë, dhe për mobilizimin dhe veprime të bashkërenduara me MPB-në për shpartallimin e brigadës shumëkombëshe të NATO-s dhe shkatërrimin e “forcave terroriste *shiptare*”.⁵⁵⁶ Po ashtu më 27 janar 1999 pasoi urdhri i Pavkoviqit mbi përdorimin e Armatës së Tretë për operacionin Grom-3 dhe në përputhje me direktivën e UJ-së, i ngarkoi njësitë e Armatës së Tretë që në bashkëpunim me forcat e MPB-së të shpartallonin dhe shkatërronin brigadën e NATO-s dhe “forcat terroriste *shiptare*”, dhe të pamundësonin bashkëpunimin midis këtyre dy forcave.⁵⁵⁷

184. Vlen të theksohet konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se “e gjithë popullata shqiptare kosovare filloi të konsiderohej si armik” dhe se operacionet e ndërmarra nën maskën e operacioneve “kundërterroriste” faktikisht ishin kundër popullatës civile shqiptare kosovare.⁵⁵⁸ Dhoma Gjyqësore theksoi se ndonëse në këto dokumente përmendeshin sulmet kundër forcave terroriste shqiptare dhe se objektivi i deklaruar publikisht i forcave serbe ishte lufta kundër terrorizmit, kishte prova të shumta, ndër të cilat edhe përdorimi i forcës së tepruar nga forcat serbe,⁵⁵⁹ që tregonin se këto forca vepruan “në mënyrë të vetëdijshme dhe me vendosmëri kundër tërë popullatës shqiptare kosovare të Kosovës”.⁵⁶⁰

⁵⁵³ Prova Materiale D343. Shih Aktgjykimi, para. 2018.

⁵⁵⁴ Aktgjykimi, para. 2026. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2010-2025.

⁵⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2008. Shtatë “elementët kyç” të identifikuar nga Dhoma Gjyqësore si prova të planit të përbashkët janë: (i) treguesit demografikë; (ii) shtimi dhe përdorimi i forcave serbe dhe armatosja e popullatës civile joshqiptare në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit të 1998 dhe bisedimet për paqe që po zhvilloheshin në fillim të vitit 1999; (iii) praktika e krimeve; (iv) përdorimi në mënyrë të koordinuar i MPB-së dhe UJ-së; (v) përdorimi i forcës së tepruar gjatë operacioneve “kundërterroriste”; (vi) grumbullimi në mënyrë sistematike i dokumenteve të identifikimit dhe targave të makinave të shqiptarëve kosovarë; dhe (vii) përpjekjet për fshehjen e krimeve kundër civilëve shqiptarëve kosovarë (Aktgjykimi, para. 2008). Shih më lart, para. 173, 174.

⁵⁵⁶ Prova Materiale D179, f. 1-2, 7. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2018.

⁵⁵⁷ Prova Materiale D343, f. 3, 6-8. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2018. Urdhri gjithashtu angazhonte “popullatën e armatosur *joshiptare*” për sigurimin e forcave serbe, objekteve ushtarake dhe rrugëve të komunikacionit, dhe mbrojtjen e popullatës *joshiptare* (Prova Materiale D343, f. 5-6. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2018).

⁵⁵⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2018, 2035, 2055-2056, 2062, 2065, 2069, 2129. Shih gjithashtu më poshtë, para. 521-526.

⁵⁵⁹ Aktgjykimi, para. 2018, 2027-2035, 2036-2051, 2052-2080. Gjetiu në Aktgjykimi Dhoma e Apelit ka rrëzuar argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nxori përfundime të gabuara mbi përdorimin e forcës së tepruar nga forcat serbe (Shih më lart, para. 108). Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2035, 2055-2056, 2062, 2065, 2069, 2129. Shih gjithashtu më poshtë, para. 351-371.

⁵⁶⁰ Aktgjykimi, para. 2018, 2035, 2134-2135.

185. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova në lidhje me: (i) mbledhje të udhëheqjes së lartë të Serbisë;⁵⁶¹ (ii) deklarata publike të politikanëve të lartë;⁵⁶² (iii) angazhimin e vullnetarëve;⁵⁶³ dhe (iv) planin për fshehjen e krimeve të kryera kundër popullatës civile.⁵⁶⁴ Dhoma Gjyqësore arsyetoi se këto prova të marra së bashku me urdhrat e Ojdaniqit dhe Pavkoviqit tregonin se lufta kundër NATO-s dhe UÇK-së do të mundësonte një “justifikim për përdorimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së në operacione luftarake, dhe në veçanti mbulimin e vrasjeve të meshkujve shqiptarë kosovarë të aftë për luftë”.⁵⁶⁵ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se “krime të tilla jo vetëm që u planifikuan si mjet për zbatimin e qëllimit të përbashkët, por edhe fshehja e gjurmëve të tyre – kufomave të qindra civilëve shqiptarë kosovarë – u planifikua dhe u zbatua prej anëtarëve të NPK-së dhe forcave të përdorura prej tyre”.⁵⁶⁶

186. Në lidhje me urdhrin e Llazareviqit të identifikuar më lart, Dhoma Gjyqësore e mori parasysh së bashku me urdhra të tjerë⁵⁶⁷ në nxjerrjen e konkluzionit se krimet e kryera nga forcat serbe gjatë operacioneve të planifikuara dhe të bashkërenduara ishin pjesë e qëllimit të NPK-së, dhe jo incidente të veçuara sikurse argumentoi Gjorgjeviqi gjatë gjykimit.⁵⁶⁸ Ndonëse urdhrat në lidhje me këto operacione nuk urdhëronin shprehimisht kryerje krimesh, Dhoma Gjyqësore gjykoi se mënyra e zbatimit të këtyre urdhrave nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së ishte e rëndësishme për zbërthimin e kuptimit të vërtetë të tyre.⁵⁶⁹ Ndër të tjera, Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova të shumta mbi praktikën e krimeve dhe përdorimin e forcës së tepruar nga forcat serbe të diskutuara me më shumë hollësi në pjesët e mëparshme të këtij Aktgjykimi.⁵⁷⁰ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “pasaktësia e qëllimshme e këtyre urdhrave” inkurajoi kryerjen e krimeve nga UJ-ja dhe MPB-ja gjatë operacioneve të planifikuara dhe të bashkërenduara të UJ-së dhe MPB-së.⁵⁷¹ Gjorgjeviqi nuk ka arritur të tregojë se Dhoma Gjyqësore u bazua në mënyrë të paarsyeshme në këto prova.

⁵⁶¹ Aktgjykimi, para. 2020, 2025, përmendet Prova Materiales P85, P387.

⁵⁶² Aktgjykimi, para. 2023-2024, përmendet Knut Vollebaek, 10 korrik 2009, T. 7215-7218.

⁵⁶³ Aktgjykimi, para. 2021. Shih gjithashtu më poshtë, Pjesa X.F.

⁵⁶⁴ Aktgjykimi, para. 2025, 2081-2082, 2086-2105, 2108-2120. Shih gjithashtu më poshtë, Pjesa X.G.

⁵⁶⁵ Aktgjykimi, para. 2026.

⁵⁶⁶ Aktgjykimi, para. 2026.

⁵⁶⁷ Shih më lart, para. 183-184. ndër këta urdhra përfshihen: (i) urdhra për “pastrimin e terrenit” (Aktgjykimi, para. 2132, përmendet Prova Materiale P957, f. 3, P493, para. 7, 45-46, P782, f. 2, K54, 13 maj 2009, T. 4367); (ii) urdhra për vendosjen e “kontrollit luftarak” mbi disa zona në Kosovë (Aktgjykimi, para. 2132, përmendet Prova Materiale P896, f. 4); dhe (iii) disa urdhra të Komandës së Përbashkët dhe një urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për “shkatërrimin” e “forcave terroriste” shqiptare kosovare. (Aktgjykimi, para. 2132, përmendet Prova Materiales P1235, P969, P970, P1382, P766, P767, P350, P961 (Komanda e Korpusit të Prishtinës), D104).

⁵⁶⁸ Aktgjykimi, para. 2132-2135.

⁵⁶⁹ Shih më lart, para. 184. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2007, 2133.

⁵⁷⁰ Shih Aktgjykimi, para. 2007, 2132-2133. Shih më lart, para. 97-99, 102, 184.

⁵⁷¹ Shih më lart, para. 175. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2027-2035 (praktikat e krimeve), 2036-2051 (përdorimi i koordinuar i MPB-së dhe UJ-së), 2132.

187. Më tej Dhoma e Apelit konkludon se urdhrat cituar nga Gjorgjeviqi ishin vetëm një pjesë e provave të shumta të analizuara nga Dhoma Gjyqësore.⁵⁷² Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi nuk e ka zhvilluar argumentin e tij, nuk arrin të identifikojë asnjë gabim në analizën e Dhomës Gjyqësore, ose të provojë se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore i bazuar në të gjitha provat e diskutuara dhe të marra parasysht, ishte i paarsyeshëm.⁵⁷³ Argumenti i Gjorgjeviqit bazohet në faktin se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* nxori një konkluzion të ndryshëm, mirëpo ai nuk ka paraqitur asnjë argument tjetër pse në këtë çështje Dhoma Gjyqësore veprroi në mënyrë të paarsyeshme kur konkludoi se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma bëri gabim që u bazua në këto urdhra për nxjerrjen e konkluzionit se vrasja ishte një prej krimeve përmes të cilëve gjeti zbatim NPK-ja.

188. Përsa i përket argumentit të dytë të Gjorgjeviqit në lidhje me numrin e individëve të vrarë, Dhoma e Apelit bën të qartë që prej fillimit se nuk ekziston asnjë kusht ligjor që përcakton numrin minimal të vrasjeve për të mundësuar konkluzionin se vrasja është pjesë e qëllimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁵⁷⁴

189. Dhoma e Apelit gjykon se në disa raste Gjorgjeviqi ngatërron objektivin e NPK-së me mjetet kriminale përmes të cilave do të vihej në jetë.⁵⁷⁵ Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ekzistonte një plan për *ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës* dhe ky plan u vu në jetë nëpërmjet një fushate terrori dhe dhune kundër popullatës shqiptare kosovare, ndër veçoritë tipike të së cilës *përfshiheshin* vrasjet.⁵⁷⁶ Rrjedhimisht vrasja ishte një nga mjetet identifikuar prej Dhomës Gjyqësore nëpërmjet së cilës do të vihej në zbatim plani i përbashkët, dhe jo qëllimi përfundimtar. Dhoma Gjyqësore arsyetoi se vrasjet, përfshirë vrasjet e grave, fëmijëve dhe familjeve të tëra u bënë me synimin për largimin e popullatës shqiptare për të shërbyer si shembull se çfarë do të ndodhte me ta në rast se nuk do të largoheshin nga fshatrat apo qytetet e tyre, apo thjesht për të krijuar atmosferë terrori që do ta detyronte popullatën të largohej.⁵⁷⁷ Gjorgjeviqi nuk arrin të rrëzojë arsyetimin në fjalë dhe përfundimet përkatëse.

⁵⁷² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 137.

⁵⁷³ Shih më lart, para. 20.

⁵⁷⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 309. Dhoma e Apelit gjithashtu rikujton se, “veç shfarosjes, jo domosdoshmërisht një krim kundër njerëzimit duhet të jetë krim kundër shumë viktimave: një krim kundër një numri të kufizuar viktimash, ose madje edhe kundër një viktime të vetme gjithashtu mund të përbëjë krim kundër njerëzimit, në qoftë se kryhet në kuadrin e një sulmi gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër një popullate civile” (Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 309). Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 25.

⁵⁷⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 135.

⁵⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2130-2131.

⁵⁷⁷ Aktgjykimi, para. 2032, 2137-2140, 2143. Dhoma Gjyqësore diskutoi në hollësi incidentet e vrasjes së familjeve të tëra (Aktgjykimi, para. 2137-2140).

190. Veçanërisht vlen të theksohet konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se vrasjet publike të familjeve të njohura shqiptare kosovare (familjet Berisha, Vejsa, dhe Caka) patën ndikim në pjesën tjetër të popullatës shqiptare kosovare të këtyre fshatrave, duke shkaktuar largimin e shumë njerëzve.⁵⁷⁸ Dhoma e Apelit pranon arsyetimin e Dhomës Gjyqësore se vrasjet e qëllimshme të disa individëve të njohur mund të jenë shkak i mjaftueshëm për largimin e njerëzve dhe si rrjedhojë kontribuojnë në realizimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së. Rrjedhimisht, është i pabazë sugjerimi i Gjorgjeviqit se numri i vrasjeve “nuk arrin të provojë se vrasjet ishin pjesë e planit të NPK-së.”⁵⁷⁹ Po ashtu nuk janë bindëse argumentet e Gjorgjeviqit se faktet nuk mbështesin konkluzionin se vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së sepse vrasjet shumica e të cilave u kryen në fshatra dhe jo në qytetet të mëdha, u vërtetuan vetëm për shtatë komuna.⁵⁸⁰ Dhoma e Apelit gjykon se vendkryerja e vrasjeve nuk ka rëndësi thelbësore për arsye se Dhoma Gjyqësore konkludoi se vrasjet shërbyen si “shembull për popullatën vendase shqiptare kosovare se çfarë do të ndodhte me ta në rast se nuk do të largoheshin nga fshatrat apo qytetet e tyre, apo thjesht për të krijuar atmosferë terrori që do t’i detyronte shqiptarët kosovarë të largoheshin”.⁵⁸¹

191. Në lidhje me argumentin e tretë të Gjorgjeviqit mbi mosnxjerrjen prej Dhomës Gjyqësore të një konkluzioni për synimin e nevojshëm për vrasje të anëtarëve të tjerë të NPK-së, Dhoma e Apelit rikujton se Dhomës Gjyqësore nuk i kërkohej të analizonte një për një synimet e secilit prej anëtarëve të NPK-së.⁵⁸² Dhoma Gjyqësore duhej vetëm të identifikonte shumësinë e personave që ishin anëtarë të NPK-së dhe të vërtetonte se ata kishin të njëjtin qëllim kriminal të përbashkët.⁵⁸³ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore konkludoi se vrasja ishte një prej krimeve nëpërmjet të cilëve u vu në zbatim qëllimi i përbashkët.⁵⁸⁴ Dhoma Gjyqësore u shpreh se “anëtarët e NPK-së synuan zbatimin e planit të përbashkët përmes krimeve të dëbimit, shpërnguljes së dhunshme, vrasjeve dhe përndjekjes me anë të veprimeve të tilla.”⁵⁸⁵ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk dështoi në nxjerrjen e konkluzioneve të nevojshme. Si pasojë ky argument hidhet poshtë.

192. Së fundi Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore qartësisht dhe pa mëdyshje konkludoi se krimet ishin kryer në përputhje me kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.⁵⁸⁶ Për hir të skrupulozitetit, Dhoma Gjyqësore theksoi se edhe sikur këto krime të mos kishin qenë pjesë e qëllimit të përbashkët, provat gjithashtu mbështesnin konkluzionit se

⁵⁷⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2032. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 500, 668-676, 687-689, 904, 2045, 2143.

⁵⁷⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134.

⁵⁸⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 135.

⁵⁸¹ Aktgjykimi, para. 2137.

⁵⁸² Shih më lart, para. 141.

⁵⁸³ Shih më lart, para. 141; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

⁵⁸⁴ Aktgjykimi, para. 2126, 2137-2149.

⁵⁸⁵ Aktgjykimi, para. 2025. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2010-2026, 2035, 2051.

këto krime ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e planit të përbashkët.⁵⁸⁷ Dhoma e Apelit nuk konstaton asnjë paqartësi dhe gjykon se ishte e drejtë e Dhomës Gjyqësore të nxirrte konkluzione të tilla të arsyeshme.

193. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se një gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore, dhe si rrjedhojë nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin e vrasja ishte pjesë e qëllimit të NPK-së.

C. Pretendim për konkluzion të gabuar sipas të cilit krimi i përndjekjes ishte pjesë e qëllimit të NPK-së

1. Argumentet e palëve

194. Në lidhje me përfundimet mbi synimin diskriminues të përndjekjeve, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte për çdo vend krimi për të cilin kishte nxjerrë një verdikt fajësie se individët u përdoqën për shkak të përkatësisë së tyre etnike.⁵⁸⁸ Në lidhje me përndjekjet nëpërmjet vrasjes, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi sepse nuk vërtetoi synimin e nevojshëm diskriminues të autorëve të krimit për katër nga dhjetë vendet e krimeve për të cilat shpalli verdikte fajësie.⁵⁸⁹ Përsa u përket përndjekjeve nëpërmjet dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme, ai argumenton se përfundimet e përgjithshme të Dhomës Gjyqësore se të shpërngulurit u përdoqën për shkak të përkatësisë së tyre etnike, janë të pamjaftueshme.⁵⁹⁰ Në lidhje me përndjekjet nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte se tri prej tetë xhamive të shkatërruara, ishin shkatërruar qëllimisht.⁵⁹¹ Më tej, ai pretendon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte konkluduar se shkatërrimi i objekteve fetare ishte pjesë e qëllimit të NPK-së me arsyetimin se “se gjatë konfliktit, në tërë Kosovën u dëmtuan vetëm tetë xhami”.⁵⁹²

195. Më tej, Gjorgjeviqi argumenton se dobësia e arsyetimit të Dhomës Gjyqësore është pasojë e mbështetjes në një urdhër drejtuar një njësie të UJ-së të dislokuar në Rahovec më 24

⁵⁸⁶ Shih Aktgjykimi, para. 2135-2136, 2138, 2140.

⁵⁸⁷ Shih Aktgjykimi, para. 2139, 2141, 2147, 2153.

⁵⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 139, 141. Gjorgjeviqi nuk apelon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se dëbimi dhe zhvendosja e dhunshme ishin pjesë e qëllimit të NPK-së, ai apelon vetëm përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ishte vërtetuar se përndjekjet e realizuara nëpërmjet këtyre krimeve ishin pjesë e qëllimit të NPK-së (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 130, 140-142).

⁵⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 139, përmendet Aktgjykimi, para. 1780-1790; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit para. 37-38. Gjorgjeviqi gjithashtu vë në dukje se Prokuroria nuk ofroi përgjigje për argumentin e tij se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte synim kriminal për vrasje prej anëtarëve të NPK-së (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 38).

⁵⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 141, përmendet Aktgjykimi, para. 1777.

⁵⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 144; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 41.

mars 1999, që “në Kosovë të mos mbetet as edhe një vesh shqiptari”.⁵⁹³ Ai parashtron se provat nuk vërtetuan se ky urdhër apo synimi i tij mund t’i atribuoheshin një anëtarit konkret të NPK-së.⁵⁹⁴ Gjithashtu, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk përmendi se provat treguan se urdhri në fjalë mund të ketë qenë që “në Kosovë të mos mbetet as edhe një vesh terroristi”.⁵⁹⁵

196. Në lidhje me synimin e nevojshëm diskriminues të përndjekjeve nëpërmjet vrasjes, Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore konkludoi se “synimi i nevojshëm konkret’ ishte vërtetuar në lidhje me të gjitha vrasjet” dhe se Gjorgjeviqi shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore.⁵⁹⁶ Përsa u përket gjashtë vendeve të krimeve përmendur nga Gjorgjeviqi, Dhoma Gjyqësore identifikoi “prova konkrete shtesë” të synimit diskriminues.⁵⁹⁷ Më tej, Prokuroria parashtron se përfundimet e Dhomës Gjyqësore se anëtarët e NPK-së synonin të kryenin përndjekje nëpërmjet zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimeve bazohen në prova të shumta, dhe se Gjorgjeviqi nuk arrin të provojë se Dhoma Gjyqësore ka gabuar.⁵⁹⁸ [Prokuroria] citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se nga 24 marsi 1999 deri më 10 qershor 1999, rreth 800.000 shqiptarë kosovarë u larguan nga shtëpitë e tyre, dhe analizën e çdo incidenti që provonte se ekzistonte një praktikë e forcave serbe për shpërnguljen e dhunshme dhe vrasjen e civilëve shqiptarë kosovarë.⁵⁹⁹

197. Së fundi, në lidhje me përndjekjet nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi nuk shpjegon sa objekte me vlerë kulturore duhen shkatërruar që Dhoma Gjyqësore të nxjerrë përfundimin se është kryer krimi i përndjekjes.⁶⁰⁰

2. Analizë

198. Ndonëse fillimisht, Gjorgjeviqi shprehet se Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari kishte të njëjtin synim konkret të nevojshëm si anëtarët e tjerë të NPK-së,⁶⁰¹ përveç faktit se Dhoma Gjyqësore nuk ia atribuoi urdhrin e 24 marsit 1999 (*apo synimin e tij*) ndonjë anëtarit të NPK-së, argumenti i tij përqendrohet në synimin kriminal të autorëve të drejtpërdrejtë të

⁵⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 143; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 41.

⁵⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 142, citohet Aktgjykimi, para. 2056.

⁵⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 142.

⁵⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 142, citohet Prova Materiale P1274, f. 9179, K89, 26 gusht 2009, T. 8443 (seancë e mbyllur) (është hequr theksi).

⁵⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 118.

⁵⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 118, përmendet Aktgjykimi, para. 1783.

⁵⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 113, 120, 123.

⁵⁹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 120, përmendet Aktgjykimi, para. 1613-1704, 2009. Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi gjithashtu shtrembëron provat (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 120, sh. 359, përmendet Prova Materiale P1273, f. 9179-9180 (konfidenciale).

⁶⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 114, 121.

⁶⁰¹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 133, 140-142.

krimet.⁶⁰² Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se argumenti i Gjorgjeviqit do të thotë se këto mangësi të pretenduara në analizën e Dhomës Gjyqësore provojnë se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh sa duhej nëse krimet bazë mund të shërbenin si bazë për konkluzionin mbi përndjekjet.⁶⁰³

199. Fillimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë sugjerimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se krimi i përndjekjeve ishte pjesë e qëllimit të NPK-së për shkak se sipas tij, [Dhoma Gjyqësore] nuk vërtetoi se individët në secilin prej incidenteve u përdoqën sepse ishin shqiptarë kosovarë. Synimi diskriminues mund të deduktohet nga provat rrethore, ndër të cilat natyra përgjithësisht diskriminuese e sulmit në qoftë se duke u bazuar në faktet e çështjes konkrete rrethanat e kryerjes së veprimeve të pretenduara përndjekëse faktojnë ekzistencën e një synimi të tillë.⁶⁰⁴

200. Dhoma e Apelit thekson se kjo është metodologjia e përdorur nga Dhoma Gjyqësore në këtë çështje. Pas analizimit të çdo incidenti, [Dhoma Gjyqësore] arriti në përfundimin se viktimat e shkeljeve bazë të përndjekjeve ishin shqiptarë kosovarë dhe ata u përdoqën pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre etnike.⁶⁰⁵

201. Në lidhje me përndjekjet nëpërmjet vrasjeve, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi i shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore dhe i interpreton jashtë kontekstit. Dhoma Gjyqësore nxori përfundime konkrete se viktimat u përdoqën për shkak të përkatësisë së tyre

⁶⁰² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 139, 140-142. Konkretisht në lidhje me vrasjen, ai argumenton se “Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte për çdo vend krimi se individët ishin vrasarë *sepse* ishin shqiptarë kosovarë” dhe se Dhoma Gjyqësore bëri analizën e nevojshme të synimit kriminal të “autorëve të krimeve” vetëm për gjashtë prej dhjetë vendeve përkatëse (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 139 (theksi në origjinal)). Në lidhje me dëbimin dhe zhvendosjen e dhunshme, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi sepse nuk nxori një “përfundim konkret se individët në çdo vend konkret krimi u dëbuam ose u zhvendosën me dhunë për shkak të përkatësisë së tyre etnike” para dhënies së verdikteve të fajësisë për përndjekje (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 141). Në mënyrë të ngjashme argumenti në lidhje me shkatërrimin e objekteve fetare përqendrohet nëse autorët e krimeve i shkatërruan qëllimisht xhamitë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 144).

⁶⁰³ Aspekti nëse Gjorgjeviqi kishte të njëjtin synim diskriminues me anëtarët e tjerë të NPK-së do të shqyrtohet më tej në Aktgjykimi. Shih më poshtë, para. 466-476.

⁶⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184. Gjithsesi, Dhoma e Apelit rikujton se synimi diskriminues mund të mos deduktohet drejtpërsëdrejti vetëm nga natyra përgjithësisht diskriminuese e sulmit kundër popullatës civile (Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184).

⁶⁰⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1626-1627, 1629, 1633, 1638, 1640-1642, 1646-1650, 1652, 1656-1657, 1659, 1663, 1665, 1667-1668, 1670-1671, 1673-1674, 1679 (për dëbim), 1619-1620, 1622, 1627-1628, 1630-1631 (në lidhje me para. 606), 1635-1637, 1645, 1651, 1653-1655, 1658 (në lidhje me paragrafin 1015), 1660 (në lidhje me paragrafët 1036, 1048 – kur njerëzit u kthyen, ata gjetën “afërsisht 120 shtëpi të shqiptarëve krejtësisht të djegura dhe rreth 420 shtëpi pjesërisht të djegura. Shtëpitë e serbëve kishin mbetur të paprekura”), 1664, 1666, 1669, 1672, 1676-1677 (për zhvendosje të dhunshme), 1681, 1683, 1697, 1776-1778 (për dëbim dhe zhvendosje të dhunshme), 497, 1710-1712, 1715-1718, 1721-1724, 1727-1728, 1731-1732, 1735-1736, 1738-1739, 1742, 1744, 1745 (për një shembull ku Dhoma Gjyqësore konstatoi se provat ishin të pamjaftueshme për të vërtetuar synimin e autorëve të kimit dhe për të përjashtuar mundësinë e pjesëmarrjes aktive të viktimave në luftime dhe si rrjedhojë konkludoi se nuk ishte vërtetuar krimi i vrasjes), 1747, 1750-1751, 1781-1790 (për vrasje); më poshtë, para. 555-569 (për shkatërrimin e objekteve me vlerë fetare ose kulturore).

etnike në lidhje me të dhjetë vendet e krimeve ku u vërtetua kryerja e vrasjes.⁶⁰⁶ Bazuar në analizën dhe përfundimet mbi këtë aspekt, [Dhoma Gjyqësore] në pjesën e Aktgjykimit për konkluzionet ligjore mbi përndjekjet nëpërmjet vrasjes, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe i kryen këto vrasje me synimin e nevojshëm diskriminues.⁶⁰⁷ Në këtë kontekst, [Dhoma Gjyqësore] konstatoi se në lidhje me disa vrasje, ekzistonin madje prova konkrete shtesë për komente dhe kërkesa diskriminuese të bëra nga forcat serbe dhe paraqiti gjashtë shembuj të tillë.⁶⁰⁸

202. Në lidhje me përndjekjet nëpërmjet dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme, Dhoma Gjyqësore bëri një analizë të gjerë të provave për çdo incident të dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme e cila provoi: (i) mënyrën e organizuar me anë të së cilës UJ-ja, MPB-ja dhe forcat e atashuara në to sulmuan fshatrat dhe shpërngulën me dhunë popullatën;⁶⁰⁹ (ii) se shumica e viktimave ishin shqiptarë kosovarë;⁶¹⁰ (iii) se shumica e fshatrave të sulmuara ishin thuajse tërësisht shqiptarë kosovarë;⁶¹¹ (iv) në qoftë se një pjesë e popullatës së këtyre fshatrave ishin serbë, ata dhe shtëpitë e tyre nuk u prekën nga sulmi;⁶¹² dhe (v) praktika e organizuar e konfiskimit të dokumenteve të identitetit dhe targave të automjeteve të shqiptarëve kosovarë për t'i penguar që të vërtetonin identitetin e tyre dhe kthimin e tyre në Kosovë.⁶¹³ Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe vepruan me synimin e nevojshëm diskriminues.⁶¹⁴ Ndonëse Dhoma Gjyqësore pranoi se gjatë periudhës së Aktakuzës, nga Kosova mund të jenë larguar edhe njerëz të përkatësive të tjera etnike, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ky fakt nuk ndryshonte konkluzionet e saj në lidhje me krimet bazë dhe se shumica dërrmuese e viktimave ishin shqiptarë kosovarë.⁶¹⁵

203. Dhoma e Apelit gjykon se fakti që edhe njerëz që nuk ishin të asaj përkatësie patën pasoja nga sulmet e forcave serbe kundër popullatës shqiptare kosovare nuk ua heq karakterin diskriminues këtyre sulmeve.⁶¹⁶ Argumenti i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të

⁶⁰⁶ Aktgjykimi, Kapitulli VI, konkretisht para. 472, 473, 481-482, 485, 486, 495, 633, 672, 676, 678, 683, 873, 889, 892. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1718.

⁶⁰⁷ Aktgjykimi, Kapitulli XI, konkretisht para. 1779-1782.

⁶⁰⁸ Aktgjykimi, para. 1783-1789.

⁶⁰⁹ Shih Aktgjykimi, para. 2036-2051.

⁶¹⁰ Aktgjykimi, para. 1697. Për konkluzionet konkrete në Aktgjykimi shih më lart, sh. 565, 568. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 457 (Bellacërkë: “Të gjithë banorët ishin shqiptarë kosovarë.”), 482-483 (Krushë e Vogël: “Serbët vendas u tregonin forcave serbe se cilat ishin shtëpitë e shqiptarëve në fshat, dhe më pas së bashku me forcat serbe u vinin zjarrin shtëpive shqiptare”; “Për shkak se forcat serbe po shtinin me armë dhe po dignin shtëpitë, nga frika rreth 400-500 shqiptarë kosovarë u larguan nga fshati”; “Banorët serbë të fshatit qëndruan nëpër shtëpitë e tyre”), 494, 497, 500, 570 (“Një polic me uniformë të zezë u tha që të shkonin në Shqipëri sepse nuk kishte më vend për ta në Kosovë”), 576 (Policët serbë u thanë romëve dhe goranëve të cilët po udhëtonin me kolonën e shqiptarëve të shpërngulur që të ktheheshin në shtëpitë e tyre), 1621-1622, 1627, 1629, 1777.

⁶¹¹ Shih më lart, sh. 586.

⁶¹² Shih Aktgjykimi, para. 1171.

⁶¹³ Aktgjykimi, para. 2077-2080. Shih gjithashtu më lart, para. 157-158.

⁶¹⁴ Aktgjykimi, para. 1777.

⁶¹⁵ Aktgjykimi, para. 1681.

⁶¹⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185.

palejueshme nxori konkluzione të përgjithësuara në lidhje me synimin diskriminues të autorëve të krimit, nuk merr parasysh përfundimet e tjera përkatëse të Dhomës Gjyqësore.

204. Në lidhje me përndjekjen nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore, argumenti i Gjorgjeviqit se shkatërrimi i xhamive duhej të ishte i qëllimshëm është analizuar dhe rrëzuar gjetiu në këtë Aktgjykim.⁶¹⁷ Sa për argumentin e Gjorgjeviqit se numri i xhamive të shkatërruara ishte shumë i vogël për të nxjerrë konkluzionin se ky krim ishte pjesë e qëllimit të NPK-së, Dhoma e Apelit sërish gjykon se ai ngatërron objektivin e NPK-së me mjetet përmes të cilave do të realizohej.⁶¹⁸ Sikurse është theksuar më parë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se plani i përbashkët synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës, nëpërmjet terrorizimit të popullatës shqiptare kosovare për ta detyruar që të largohej⁶¹⁹ dhe shkatërrimi i xhamive ishte një nga mjetet për vënien në zbatim të planit të përbashkët.⁶²⁰ Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se ky konkluzion i Dhomës Gjyqësore ishte i paarsyeshëm. Rrjedhimisht hidhet poshtë argumenti i tij se numri i xhamive të shkatërruara ishte shumë i vogël për të mundësuar konkluzionin se shkatërrimi i objekteve me vlerë fetare ose kulturore ishte pjesë e qëllimit të NPK-së.

205. Përsa i përket urdhrin të 24 marsit 1999 që “‘asnjë vesh shqiptari’ të mos mbetej në Kosovë” Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi shtrembëron provat dhe shpërfill përfundime të tjera përkatëse të Dhomës Gjyqësore në lidhje me këtë urdhër. Ndonëse është e vërtetë se në pyetjet nga Mbrojtja, Dëshmitari K89 pohoi se në urdhër mund të jetë përmendur “vesh terroristi” dhe jo “vesh shqiptari”,⁶²¹ në pyetjet shtesë dëshmitari konfirmoi se kishte dëgjuar “vesh shqiptari”.⁶²² Për më tepër, në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi konkretisht dëshminë mospërputhëse të dëshmitarit dhe shpjegoi pse vendosi të pranojë atë pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit K89 sipas të cilës në këtë urdhër përmendeshin të gjithë shqiptarët, ndër të cilët edhe civilët.⁶²³

206. Gjithashtu, Dhoma e Apelit arsyeton se apelimi prej Gjorgjeviqit i përfundimeve të Dhomës Gjyqësore mbi përndjekjet duke u bazuar në urdhrin e 24 marsit 1999, e nxjerr këtë urdhër jashtë kontekstit të duhur. Dhoma Gjyqësore e diskutoi këtë urdhër në kontekstin e analizës së vet mbi përdorimin e forcës së tepruar nga forcat serbe kundër shqiptarëve kosovarë

⁶¹⁷ Shih më poshtë, para. 555-569.

⁶¹⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 144-145; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 41. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 134 ku Gjorgjeviqi argumenton se numri i vrasjeve të kryera “nuk mjafton për të provuar se vrasja ishte pjesë e planit të NPK-së”.

⁶¹⁹ Aktgjykimi, para. 2126, 2128, 2130, 2136-2149, 2151-2152 Shih gjithashtu më lart, para. 111, 173, 189.

⁶²⁰ Aktgjykimi, para. 2151. Shih gjithashtu më lart, para. 204.

⁶²¹ K89, 26 gusht 2009, T. 8442-8443 (seancë private). Shih gjithashtu Prova Materiale P1273, f. 9179-9180 (konfidenciale).

⁶²² K89, 26 gusht 2009, T. 8475-8476 (seancë private). Shih gjithashtu Prova Materiale P1273, f. 9179-9180 (konfidenciale).

⁶²³ Aktgjykimi, Shtojcë Konfidenciale, f. 970, sh. 1570 (konfidenciale).

gjatë operacionit të pretenduar kundërterrorist.⁶²⁴ Rrjedhimisht, argumenti i Gjorgjeviqit rrëzohet.⁶²⁵

207. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin përfundim si Dhoma Gjyqësore dhe si rrjedhojë nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjeve nëpërmjet vrasjes, dëbimit, zhvendosjes së dhunshme dhe shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore ishte pjesë e qëllimit të NPK-së.

D. Konkluzion

208. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon në tërësi pikën e shtatë të apelit të Gjorgjeviqit.

⁶²⁴ Aktgjykimi, para. 2056. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2052-2069.

⁶²⁵ Shih më lart, para. 20.

X. PIKA E NËNTË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN E GJORGJEVIQIT NË NPK

209. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në NPK⁶²⁶ duke u bazuar në këta faktorë: (i) si shef i RJB-së dhe ndihmësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjatë periudhës së Aktakuzës, Gjorgjeviqi gëzonte “kompetenca *de jure* dhe ushtronte kontroll efektiv mbi policinë e rregullt dhe rezerviste në Kosovë”, përfshirë PJP-në dhe SAJ-in;⁶²⁷ (ii) ai ishte një nga zyrtarët më të lartë të MPB-së në atë kohë;⁶²⁸ (iii) ai luajti rol kyç në koordinimin e punës së forcave të MPB-së në Kosovë më 1998 dhe 1999;⁶²⁹ (v) ai ishte anëtar i Komandës së Përbashkët dhe i Kolegjiut të MPB-së dhe mori pjesë rregullisht në mbledhjet e këtyre dy organeve;⁶³⁰ (vi) ai ishte në terren në Kosovë më 1998 dhe 1999 dhe mori pjesë në mbledhjet e Shtabit të MPB-së në Prishtinë;⁶³¹ (vii) zyrtarisht ai ishte përgjegjës për forcat e përfshira në çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë në një kohë që popullata civile serbe në Kosovë po armatosej dhe po organizohej në Skuadra Policore Rezerviste (“RPO”),⁶³² (viii) në tetor 1998, ai përfaqësoi Republikën e Serbisë në negociatat ndërkombëtare lidhur me rolin e policisë në Kosovë;⁶³³ (ix) ai luajti rol udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për të fshehur vrasjen e 45 civilëve në Reçak, në janar 1999;⁶³⁴ (x) kontribuoi në dislokimin e njërive paraushtarake në Kosovë;⁶³⁵ (xi) personalisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, ai mori pjesë në përfshirjen e Akrepave në MPB-së dhe në bashkimin zyrtar të tyre me SAJ-in, dhe dislokimin e tyre në Kosovë më 1999;⁶³⁶ (xii) ai luajti rol udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për fshehjen e vrasjeve të civilëve shqiptarë kosovarë dhe të tjerëve që nuk morën pjesë aktive në luftime;⁶³⁷ dhe (xiii) kur ishte shef i RJB-së, ai asnjëherë nuk mori masa që do të mundësonin hetimin e krimeve të kryera në Kosovë, apo ndëshkimin e të implikuarve në kryerjen e tyre.⁶³⁸

210. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte vepruar me synimin e duhur.⁶³⁹

⁶²⁶ Aktgjykimi, para. 2158.

⁶²⁷ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶²⁸ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶²⁹ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³⁰ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³¹ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³² Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³³ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³⁴ Aktgjykimi, para. 2154.

⁶³⁵ Aktgjykimi, para. 2155.

⁶³⁶ Aktgjykimi, para. 2155.

⁶³⁷ Aktgjykimi, para. 2156.

⁶³⁸ Aktgjykimi, para. 2157.

⁶³⁹ Aktgjykimi, para. 2158. Dhoma e Apelit la në fuqi konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi kishte vepruar me synimin e duhur (Shih më poshtë, para. 463, 468, 470 477, 504, 513-514).

211. Në pikën e nëntë të apelit të tij, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri një sërë gabimesh ligjore dhe faktike të cilat të marra veç e veç dhe së bashku rezultuan në një përcaktim të gabuar të veprimeve të tij dhe padrejtësisht e cilësuan pjesëmarrës në NPK.⁶⁴⁰ Veçanërisht, ai argumenton se arsyetimi i Dhomës Gjyqësore është i mangët sepse u bazua në supozimin e gabuar se ai ushtroi kontroll efektiv mbi autorët e drejtpërdrejtë të krimeve.⁶⁴¹ Gjorgjeviqi i shtjellon argumentet e veta në tetë nënpika të cilat Dhoma e Apelit do t'i shqyrtojë një nga një.

A. Nën-pika 9(A): pretendim për gabime në vlerësimin prej Dhomës Gjyqësore të strukturës së MPB-së dhe rolit të Gjorgjeviqit

1. Hyrje

212. Dhoma Gjyqësore konkludoi se si shef i RJB-së dhe ndihmësministër në MPB, Gjorgjeviqi gëzonte pushtet *de jure* mbi njësitë përbërëse të RJB-së që vepronin në Kosovë gjatë gjithë periudhës përkatëse.⁶⁴² Për Gjorgjeviqin i cili gjithashtu ishte anëtar i Kolegjiut të MPB-së dhe i Komandës së Përbashkët, mbante gradën më të lartë të mundshme, gjeneralkolonel, dhe cilësohej “njeriu numër dy” në ministri, u konkludua edhe se kishte “ushtuar kontroll efektiv *de jure* dhe *de facto*, mbi forcat e MPB-së nën varësinë e RJB-së në vitin 1998 dhe 1999”.⁶⁴³ Më tej, Dhoma Gjyqësore konkludoi se kompetencat e tij në lidhje me njësitë e RJB-së që merrnin pjesë në veprimtari kundërterroriste nuk u pakësuan pas krijimit të Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë (“Shtabi Ministror”) më 16 qershor 1998.⁶⁴⁴

213. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore “interpretroi në mënyrë thelbësisht të gabuar rolin e tij në Kosovë më 1999 dhe e ekzagjeroi rëndësinë e tij”.⁶⁴⁵ Në veçanti, ai parashtron se: (i) krijimi i Shtabit Ministror ndikoi në rolin e tij në lidhje me policinë në Kosovë;⁶⁴⁶ (ii) Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se ai mori pjesë aktivisht ose pati kontroll efektiv ndaj ngjarjeve në Kosovë më 1998 dhe 1999;⁶⁴⁷ (iii) nuk ka prova se ai ushtroi kontroll ndaj njësive të PJP-së dhe SAJ-it;⁶⁴⁸ (iv) ai nuk ishte në dijeni të raporteve në

⁶⁴⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 156; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 61.

⁶⁴¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 156.

⁶⁴² Aktgjykimi, para. 40, 1892, 1898.

⁶⁴³ Aktgjykimi, para. 1898.

⁶⁴⁴ Aktgjykimi, para. 1895. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 108-124.

⁶⁴⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 157, 194; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 61, 71-72, 74, 80-81. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 160; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 44-45.

⁶⁴⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 161-172; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 79-80. Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 45-49.

⁶⁴⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 49-50. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 168-169.

⁶⁴⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 174-179. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 51.

lidhje me operacionet e MPB-së në Kosovë dhe si rrjedhojë nuk kishte dijeni për ngjarjet në terren;⁶⁴⁹ (v) Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se ndihmësministrat e tjerë ishin në varësinë e tij;⁶⁵⁰ (vi) provat nuk mbështesin përfundimin e Dhomës Gjyqësore se mbledhjet e Kolegjiumit Ministror shërbyen për të diskutuar dhe planifikuar veprimtaritë e MPB-së në Kosovë;⁶⁵¹ dhe (vii) Dhoma Gjyqësore nxori përfundime të gabuara në lidhje me rolin e Gjorgjeviqit në negociatat që u paraprinë marrëveshjeve të Tetorit.⁶⁵² Sipas Gjorgjeviqit, këto gabime bëjnë të pavlefshëm ligjrisht konkluzionin mbi kontrollin e tij ndaj RJB-së dhe pjesëmarrjen e tij në NPK.⁶⁵³ Si rrjedhojë, Gjorgjeviqi kërkon anulimin e të gjitha verdikteve të fajësisë së tij apo uljen përkatëse të dënimit të tij.⁶⁵⁴

214. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshem se Gjorgjeviqi ishte pjesëmarrës në NPK.⁶⁵⁵ Parashtrahet se Gjorgjeviqi thjesht përsërit argumentet e rrëzuara shprehimisht nga Dhoma Gjyqësore, pa identifikuar asnjë gabim dhe se për këtë arsye këto argumente duhen hedhur poshtë menjëherë.⁶⁵⁶ Gjithashtu, Prokuroria parashtron se argumentet e Gjorgjeviqit nuk kanë bazë.⁶⁵⁷

215. Dhoma e Apelit do të shqyrtojë me radhë argumentet e Gjorgjeviqit.

2. Shtabi Ministror dhe roli i Gjorgjeviqit

(a) Hyrje

216. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 11 qershor 1997, Gjorgjeviqi formoi Shtabin e MPB-së për Kosovën, i cili krijoi një nivel të ndërmjetëm komandimi midis MPB-së në Beograd dhe SPB-ve në Kosovë.⁶⁵⁸ Detyrat e Shtabit të MPB-së ishin planifikimi, organizimi dhe marrja e “masave dhe veprimeve për shtypjen e kryengritjeve të armatosura; parandalimi dhe shtypja e trazirave publike [dhe] parandalimi i terrorizmit”.⁶⁵⁹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më 15 janar 1998, Gjorgjeviqi lëshoi një vendim të për zgjerimin e mandatit të Shtabit të MPB-së, duke përfshirë bashkëpunimin midis “RDB-së, UJ-së dhe

⁶⁴⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 180-185; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 52-53. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 170-171.

⁶⁵⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 186-190; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 71, 74. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 54-55.

⁶⁵¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 158. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 194; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 56-57.

⁶⁵² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 193.

⁶⁵³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 194.

⁶⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 194.

⁶⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 129, 156. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 116-117.

⁶⁵⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 129, 131, 133, 139-142, 145-146, 149, 152-154, 156. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 116-117.

⁶⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 132.

⁶⁵⁸ Aktgjykimi, para. 104, 107.

⁶⁵⁹ Aktgjykimi, para. 104, përmendet Prova Materiale D402, pika 2, Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9469-9470.

organeve të tjera shtetërore dhe të vetëqeverisjes vendore,”” dhe se një prej detyrave të Shtabit të MPB-së ishte “parandalimi dhe shtypja e terrorizmit”.⁶⁶⁰ Më 15 maj 1998, me anë të një vendim Gjorgjeviqi e zgjati edhe me një vit mandatin e Shtabit të MPB-së.⁶⁶¹ Më 11 qershor 1998 ai nxori një vendim tjetër nëpërmjet të cilit Llukiqi u emërua shef i Shtabit të MPB-së, kurse Shtabi u zgjerua në 14 anëtarë, që të gjithë pjesëtarë të RJB-së.⁶⁶² Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se Gjorgjeviqi si shef i RJB-së nuk kishte kompetencë për inkuadrimin zyrtar të RDB-së në Shtabin e MPB-së dhe se vetëm ministri kishte kompetenca ligjore për të mundësuar zyrtarisht përfaqësimin e RDB-së në Shtabin e MPB-së.⁶⁶³ Dhoma Gjyqësore konstatoi se ministri e kishte bërë këtë gjë më 16 qershor 1998 me nxjerrjen e vendimit për ngritjen e Shtabit Ministror përmes të cilit e zgjeroi anëtarësinë e Shtabit të MPB-së duke përfshirë shefat e “sekretariateve të punëve të brendshme, të qendrave dhe të degëve të RDB-së”.⁶⁶⁴ Dhoma Gjyqësore theksoi se:

ndonëse nga forma ky ishte një shtab i ri që zëvendësoi shtabin e deriatëhershëm dhe i Akuzuari këmbënguli se nuk ishte këshilluar në lidhje me këtë vendim, drejtues i Shtabit vazhdoi të ishte Sreten Llukiqi i RJB-së dhe përbërja e tij nuk ndryshoi shumë prej shtabit që krijoi Gjorgjeviqi pesë ditë më parë. Ndryshimi i rëndësishëm që u bë ishte përfshirja zyrtare e përfaqësuesve të sigurimit shtetëror (RDB-së) në Shtab.⁶⁶⁵

217. [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se “Shtabi i MPB-së për Shtypjen e Terrorizmit ishte organ koordinues midis Ministrisë në Beograd dhe SPB-ve në Kosovë”.⁶⁶⁶ Dhoma Gjyqësore konkludoi se në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes, krijimi i Shtabit

⁶⁶⁰ Aktgjykimi, para. 105.

⁶⁶¹ Aktgjykimi, para. 105.

⁶⁶² Aktgjykimi, para. 106, përmendet Prova Materiale P760. Anëtarë të Shtabit të MPB-së ishin: Sreten Llukiq, ndihmësshef i Sekretariatit në Beograd për çështje të policisë, si drejtues i Shtabit; Radosllav Gjinoviq, ndihmësshef i SPB-së në Smederevë, si zëvendësdrejtues i Shtabit; Goran Radosavleviq, shef i degës për PJP-të në SPB-në e Beogradit, si ndihmësdrejtues i Shtabit për ndërhyrje; Zharko Brakoviq, shef i degës së policisë në SPB-në e Prishtinës, si ndihmësdrejtues i Shtabit për çështje të policisë; Millutin Vukoviq, komandant i Brigadës së Mekanizuar në Prishtinë, si ndihmësdrejtues i Shtabit për njësitë e mekanizuara; Miodrag Rshumoviq, shef i degës për luftimin e Krimit Ekonomik në SPB-në e Beogradit, si koordinator për çështje të krimit ekonomik; Novica Zdravkoviq, punonjës në degën e Policisë për Krime në SPB-në e Vrarjes për luftimin e krimit financiar, si koordinator i përgjithshëm për krime; Radovan Vushurevq, shef i degës së Policisë Kufitare, për të Huaj dhe për Çështje Administrative në SPB-në e Novi Sadit, si ndihmësdrejtues i Shtabit për policinë kufitare, për të huaj dhe për çështje administrative; Millan Çankoviq, furnizues me pajisje të ndërlihdjes, automjete dhe pajisje të tjera në Administratën e Policisë në kuadër të Ministrisë, si ndihmësdrejtues i Shtabit për radiolidhje; Millosh Deretiq, shef i degës së Ndërlidhjes në SPB-në e Prishtinës, si ndihmësdrejtues i shtabit të ndërlihdjes; Millorad Rajciq, shef i degës për Punë të Përbashkëta në SPB-në e Prishtinës, si ndihmësdrejtues i Shtabit për sigurinë e pajisjeve; Gojko Çelebiq, i cili punonte në përgatitjen e mbrojtjes në degën e Policisë të SPB-së së Prishtinës, si ndihmësdrejtues i shtabit për logjistikë; Dobrashin Kërxiq, i cili merrej me çështje të mjekësisë parandaluese, si ndihmësdrejtues i shtabit për siguri mjekësore; dhe Rashko Milenkoviq, shef i degës së Analizave në SPB-në e Prishtinës, si ndihmësdrejtues i shtabit për analizë të përgjimeve (Aktgjykimi, sh. 392).

⁶⁶³ Aktgjykimi, para. 107-108.

⁶⁶⁴ Aktgjykimi, para. 108, përmendet Prova Materiale P57.

⁶⁶⁵ Aktgjykimi, para. 108. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 110, 1896-1897. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore vuri në dukje se “Prej 14 anëtarëve të mëparshëm të Shtabit të datës 11 qershor 1998, vetëm katër (Brakoviqi, Rshumoviqi, Deretiqi dhe Çelebiq) nuk vazhduan të ishin pjesëtarë të Shtabit të Ministrisë” (Aktgjykimi, sh. 394).

⁶⁶⁶ Aktgjykimi, para. 1897.

Ministor as i pakësoi kompetencat e Gjorgjeviqit, e as e ndërpreu apo cenoi pushtetin e tij ndaj SPB-ve dhe policisë në Kosovë.⁶⁶⁷

(b) Argumentet e palëve

218. Gjorgjeviqi argumenton se me krijimin e Shtabit Ministror, hierarkitë komanduese të RJB-së dhe RDB-së u shkrinë në një të vetme dhe u vunë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të ministrit i cili të gjithë komandën e këtyre forcave ia delegoi shefit të Shtabit të MPB-së, Llukiqit, si dhe individëve të zgjedhur nga ministri të cilët ishin të pranishëm në Kosovë.⁶⁶⁸ Rrjedhimisht, shefi i RJB-së dhe ai i RDB-së u anashkaluan dhe u përjashtuan nga hierarkia komanduese.⁶⁶⁹ Si pasojë, megjithëse Gjorgjeviqi vijoi të ishte shef i RJB-së, ai nuk mund të ushtronte komandë ose kontroll ndaj policisë në Kosovë.⁶⁷⁰

219. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri analizë të gabuar të vendimit të ministrit të 16 qershorit 1998 (“Vendimi i Ministrit”) për krijimin e Shtabit Ministror.⁶⁷¹ Sipas Gjorgjeviqit, pika 3 e Vendimit të Ministrit përmban dy dispozita të ndryshme: ‘shefi i Shtabit të [MPB-së] *i raporton* ministrit [...]’ dhe 2. ‘[*informon*] ministrin për [...]’.⁶⁷² Ai argumenton se këto dispozita kanë kuptim të ndryshëm dhe se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh formulimin origjinal në tekstin në gjuhën serbe të Vendimit të Ministrit.⁶⁷³ Gjorgjeviqi parashtron se përdorimi i fjalës *odgovara* në versionin origjinal në serbishte, që do të thotë “jep llogari para”, tregon se shefi i Shtabit varej vetëm prej ministrit.⁶⁷⁴ Sipas tij, ky interpretim gjen mbështetje në vendimin e ministrit të 31 majit 1999, që zgjati afatin e Vendimit të Ministrit ku shkruhej: “shef i Shtabit **jep llogari** para ministrit për punën e tij, punën e Shtabit dhe gjendjen e sigurisë”.⁶⁷⁵ Gjorgjeviqi parashtron se përdorimi shtesë i fjalës *izveštava* – që do të thotë informon – do të ishte i tepërt në pjesën e dytë të fjalisë në qoftë se të dyja fjalët kanë të njëjtin kuptim.⁶⁷⁶ Ai shprehet se rrjedhimisht del qartë se Shtabi Ministror bëri një ristrukturim themelor të hierarkisë dhe funksionimit të MPB-së, duke eliminuar rolin e mëhershëm të Gjorgjeviqit dhe duke e zhvendosur varësinë hierarkike nga ministri

⁶⁶⁷ Aktgjykimi, para. 111-124, 1895-1897.

⁶⁶⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 162. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 159, përmendet Aktgjykimi, para. 124. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 168; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 161, përmendet Aktgjykimi, para. 108; Prova Materiale P57; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 75-76, 79.

⁶⁶⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 162-163. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 77-78.

⁶⁷⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 163, 167. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 45-46.

⁶⁷¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 164, përmendet Prova Materiale P57.

⁶⁷² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 164 (theksi në origjinal).

⁶⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 164, përmendet Prova Materiale P57.

⁶⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 165.

⁶⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 165; Prova Materiale P67, Pika 3 (theksi në origjinal).

⁶⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 166, përmendet Prova Materiale P57, Pika 3, P67, Pika 3.

drejtpërsëdrejti te shefi i Shtabit të MPB-së.⁶⁷⁷ Sipas Gjorgjeviqit, transferimi i Stojanoviçit duhej të ishte konsideruar si shenjë e qartë e ndryshimit në hierarki.⁶⁷⁸

220. Gjorgjeviçi gjithashtu parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim që u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit Lubinko Cvetiq (“Dëshmitar Cvetiq”), i cili ishte shef i një prej shtatë SPB-ve në Kosovë, për nxjerrjen e konkluzionit se krijimi i Shtabit Ministror nuk pati asnjë ndikim në rolin e Gjorgjeviçit.⁶⁷⁹ Gjorgjeviçi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në: (i) moskonstatimin e faktit se Dëshmitar Cvetiqi ndryshoi dëshminë e vet kur iu tregua Vendimi i Ministrorit; dhe (ii) që u bazua në dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit sepse “sepse ai nuk kishte asnjë dëgjim të drejtpërdrejtë për lidhjet midis Shtabit Ministror dhe Beogradit”.⁶⁸⁰ Ai thekson se Dëshmitar Cvetiqi pranoi se “lidhjet midis Kosovës dhe Gjorgjeviçit kishin ndryshuar me krijimin e Shtabit Ministror”.⁶⁸¹ Gjorgjeviçi gjithashtu parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi që u mbështet në dëshminë e dorës së dytë të Dëshmitarit Shaun Byrnes (“Dëshmitari Byrnes”) dhe në përmbledhjen e deklaratës së cituar pasaktësisht të shefit të kabinetit të Gjorgjeviçit, Sllobodan Borisavleviqit (“Borisavleviq”).⁶⁸² Gjithashtu, Gjorgjeviçi vë në dukje se deklarata e Borisavleviqit nuk u pranua si provë.⁶⁸³

221. Për më tepër, Gjorgjeviçi argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin e gabuar se ai emëronte dhe pushonte nga detyra shefat e SPB-ve.⁶⁸⁴ Ai këmbëngul se ministri gëzonte kompetencën e autorizimit të emërimeve apo largimeve nga detyra prej Gjorgjeviçit të punonjësve të RJB-së në Shtabin Ministror.⁶⁸⁵ Gjorgjeviçi pretendon se “roli i tij i kufizuar nuk do të thoshte se ai ‘u angazhua aktivisht’ në funksionimin aktual të Shtabit deri në fund të luftës”.⁶⁸⁶

222. Prokuroria përgjigjet se provat mbështesin përfundimin se roli i Gjorgjeviçit si shef i RJB-së mbeti i pandryshuar pas krijimit të Shtabit Ministror.⁶⁸⁷ [Prokuroria] argumenton se “Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se hierarkia komanduese e RJB-së kalonte nga ministri i Brendshëm, Stojilkoviçi, dhe Gjorgjeviçi” te Shtabi i MPB-së udhëhequr nga Llukiqi, “i cili ishte në krye të bashkërendimit dhe drejtimit të njësisë të MPB-së të angazhuara

⁶⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 166.

⁶⁷⁸ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 78. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 170, përmendet Prova Materiale D99.

⁶⁷⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 168.

⁶⁸⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 168. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviçit, para. 47.

⁶⁸¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 168, përmendet Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6789-6790.

⁶⁸² Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 169.

⁶⁸³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 169.

⁶⁸⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 171. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviçit, para. 48.

⁶⁸⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 172.

⁶⁸⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 172, përmendet Aktgjykimi, para. 120-121.

⁶⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 130.

në veprime luftarake në Kosovë”.⁶⁸⁸ Gjithashtu, Vendimi i Ministrit nuk bie ndesh me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi vijoi të ishte shef i RJB-së dhe eprori i Llukiqit.⁶⁸⁹

223. Në lidhje me dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme ushtroi kompetencën e vet të brendaqenësishme për pranimin e kësaj dëshmie dhe se Gjorgjeviqi gabimisht pohon se Dëshmitari Cvetiq pranoi se kishte gabuar.⁶⁹⁰ Më tej argumentohet se Gjorgjeviqi nuk ofron fakte për pretendimin se Dhoma Gjyqësore nuk kishte prova të forta për konkluzionin se Llukiqi vijoi t’i raportonte Gjorgjeviqit pas Vendimit të Ministrit.⁶⁹¹ Prokuroria parashtron se duke u përqendruar vetëm në një paragraf të Aktgjykimit, Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e tjera faktike, “thjesht pretendon se Dhoma [Gjyqësore] nuk i interpretoi provat në një mënyrë të caktuar, dhe citon prova të tjera pa vërtetuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë këtë konkluzion”.⁶⁹²

224. Po ashtu, në lidhje me kompetencat e Gjorgjeviqit për emërimin dhe pushimin nga detyra të shefave të SPB-ve, Prokuroria shprehet se Gjorgjeviqi përsërit argumente që Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi dhe i rrëzoi, dhe nuk arrin të identifikojë asnjë gabim.⁶⁹³

(c) Analizë

225. Fillimisht, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi në apel përsërit disa nga argumentet që ngriti në gjykim që Dhoma Gjyqësore konkretisht i shqyrtoi dhe i rrëzoi.⁶⁹⁴ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit rikujton se faza e apelit nuk është gjykim *de novo*; Dhoma e Apelit shqyrton vetëm pretendimet për gabime ligjore ose faktike.⁶⁹⁵ Në jurisprudencën e Tribunalit është përcaktuar se argumentet e përsëritura në apel të cilat u rrëzuan gjatë gjykimit, pa provuar se rrëzimi i tyre përbën gabim që përligj ndërhyrjen prej Dhomës së Apelit, mund të rrëzohen tërësisht.⁶⁹⁶

226. Në lidhje me vlerësimin prej Dhomës Gjyqësore të Vendimit të Ministrit, Dhoma e Apelit thekson se ndonëse Dhoma Gjyqësore konkludoi se sipas Vendimit të Ministrit, Llukiqi

⁶⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 134.

⁶⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 134.

⁶⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 136.

⁶⁹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 137.

⁶⁹² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 137, përmendet Aktgjykimi, para. 1897, Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 169-170.

⁶⁹³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 138-139.

⁶⁹⁴ Shih Aktgjykimi, para. 111, 115, 1893; Argumentet Përmbyllëse (14 korrik 2010), T. 14451-14452, 14481, 14492-14493; Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 136-137, 146-148, 185-209, 285, 406. Shih më lart, para. 211, 214, 218-224.

⁶⁹⁵ Neni 25 i Statutit; më lart, para. 13-19.

⁶⁹⁶ Shih më lart, para. 20.

“duhet t’i raportojë ministrit për veprimet e tij”, [Dhoma] nuk u mbështet vetëm në këtë frazë apo në këtë dokument për nxjerrjen e konkluzionit se kompetencat e Gjorgjeviqit nuk u kufizuan për shkak të krijimit të Shtabit Ministror.⁶⁹⁷ Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore arsyetoi se formulimi i Vendimit të Ministrit nuk përbënte asgjë të jashtëzakonshme nga funksionimi standard i MPB-së, konkretisht se “Ministri është personi që mban përgjegjësinë përfundimtare dhe i cili mund të ndërhyjë apo të parashtojë kërkesa ose të japë udhëzime që i gjykon të nevojshme”.⁶⁹⁸ Gjithashtu, [Dhoma Gjyqësore] arsyetoi se funksionimi normal i MPB-së gjithashtu parashikonte që drejtuesit më të lartë të departamenteve të kryenin detyrat e tyre normale për të ndihmuar ministrin të kryente rolin e tij.⁶⁹⁹ Më tej Dhoma Gjyqësore bëri një analizë të hollësishme të provave që kishin shërbyer si bazë për konkluzionin se roli dhe pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në veprimtaritë e MPB-së nuk ishin pakësuar.⁷⁰⁰ [Dhoma Gjyqësore] mori parasysh provat për: (i) praninë e shpeshtë të Gjorgjeviqit në terren në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999, Kosovë dhe rolin e tij drejtues në angazhimin e forcave të MPB-së në Kosovë;⁷⁰¹ (ii) pjesëmarrjen e tij aktive në mbledhjet e Kolegjiumit ku u diskutuan dhe planifikuan aksionet kundërterroriste;⁷⁰² (iii) pjesëmarrjen e tij aktive në mbledhjet e Komandës së Përbashkët lidhur me koordinimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë;⁷⁰³ (iv) faktin se shumica e operacioneve të drejtpërdrejta të MPB-së në Kosovë vijuan të kryheshin prej RJB-së, duke përfshirë detashmentet e PJP-së dhe SAJ-it, për të cilat edhe më tej ishte përgjegjës Gjorgjeviqi;⁷⁰⁴ (v) faktin se Gjorgjeviqi mori vendime për ligjësimin e të drejtave të anëtarëve të MPB-së që ishin emëruar anëtarë të Shtabit, përfshirë Stevanoviqin;⁷⁰⁵ dhe se (vi) Llukiqi pranoi se Gjorgjeviqi ishte eprori i tij.⁷⁰⁶

227. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës pretendimin e Gjorgjeviqit se përdorimi i fjalëve *odgovara* dhe *izveštava* në Vendimin e Ministrit provon qartësisht se “Shtabi Ministror bëri një ristrukturim themelor të hierarkisë dhe funksionimit të MPB-së, nëpërmjet kushtit që shefi i Shtabit të jepte llogari drejtpërsëdrejti para [ministrit] dhe

⁶⁹⁷ Shih Aktgjykimi, para. 110.

⁶⁹⁸ Aktgjykimi, para. 112. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 115.

⁶⁹⁹ Aktgjykimi, para. 112-114.

⁷⁰⁰ Shih Aktgjykimi, para. 118.

⁷⁰¹ Aktgjykimi, para. 118, 244, 359, 398, 1900-1907, 1920-1925, 2178. Shih më poshtë, para. 231, 235-238, 242-243, 450-451.

⁷⁰² Aktgjykimi, para. 98, 118, 1897.

⁷⁰³ Aktgjykimi, para. 118, 229, 237, 239-240, 244, 247, 249, 1902, 1904, 1906, 1988, 2178. Shih më poshtë, para. 250, 283-287, 321. më tej Dhoma e Apelit thekson se sikurse shtjellohet në hollësi më poshtë, Gjorgjeviqi vijoi me nxjerrjen e telegrameve për dislokimin e njësisë PJP në Kosovë gjatë tërë periudhës së Aktakuzës (Shih më poshtë, para. 242).

⁷⁰⁴ Aktgjykimi, para. 118, 124.

⁷⁰⁵ Aktgjykimi, para. 120. Shih më poshtë, para. 230.

⁷⁰⁶ Aktgjykimi, para. 119, 1897-1899. Shih më poshtë, para. 229.

gjithashtu të informonte ministrin për zhvillimet në lidhje me sigurinë, masat e marra dhe pasojat e këtyre masave”.⁷⁰⁷ Rrjedhimisht, këto argumente hidhen poshtë.

228. Pretendimi i dytë i Gjorgjeviqit për gabim ka të bëjë me mbështetjen e Dhomës Gjyqësore në dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit dhe dëshminë e Dëshmitar Byrnes-it, si edhe në përmbledhjen e deklaratës së Borisavleviqit.⁷⁰⁸ Dhoma e Apelit e gjykon jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi që u bazua në dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit për nxjerrjen e konkluzionit se pushteti dhe kompetencat e Gjorgjeviqit mbetën të pandryshuara pas krijimit të Shtabit Ministror. Dhoma e Apelit konstaton se Dëshmitar Cvetiqi dëshmoi për Shtabin e MPB-së dhe deklaroi se ky shtab ishte një “komandë e ndërmjetme” midis MPB-së në Beograd dhe SPB-ve në Kosovë.⁷⁰⁹ Ai nuk dëshmoi për Shtabin Ministror dhe në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, nuk e ndryshoi dëshminë e vet, e as nuk pranoi se kishte gabuar.⁷¹⁰ Pas shqyrtimit të dëshmisë gojore të Dëshmitar Cvetiqit, shihet qartë se gjatë diskutimit për lidhjet midis Shtabit të MPB-së dhe Beogradit, ai e kishte fjalën për Shtabin e MPB-së të krijuar nga Gjorgjeviqi më 1997, të cilin Dhoma Gjyqësore e dalloj qartësisht nga Shtabi Ministror i krijuar me Vendim të Ministrit.⁷¹¹ Dëshmitar Cvetiqi dëshmoi se gjatë periudhës së Aktakuzës, ai nuk kishte dijeni për ekzistencën e Shtabit Ministror dhe para dhënies së dëshmisë me gojë nuk e kishte parë asnjëherë Vendimin e Ministrit për krijimin e këtij shtabi.⁷¹² Me fjalë te tjera, ai nuk dalloj ndryshim në lidhjen midis SPB-së dhe selisë në Beograd përse i përket Shtabit të MPB-së të krijuar nga Gjorgjeviqi.⁷¹³ Dëshmia e tij përputhet me konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se krijimi i Shtabit Ministror ishte një formalitet për përfshirjen e RDB-së në Shtabin e MPB-së për Kosovën, por nuk ndryshoi marrëdhëniet midis SPB-ve në Kosovë, Shtabit të MPB-së dhe qendrës në Beograd, në kuptimin që [SPB-të] mbetën në varësinë e RJB-së e rrjedhimisht të Gjorgjeviqit.⁷¹⁴ Për nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh faktin se Llukiqi vijoi të ishte shef i Shtabit dhe se më përjashtim të përfshirjes së përfaqësuesve të RDB-së, përbërja e Shtabit të ri Ministror mbeti pak a shumë e pandryshuar.⁷¹⁵ Dhoma e Apelit i gjykon jobindëse parashtrimet e

⁷⁰⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 166.

⁷⁰⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 168-169.

⁷⁰⁹ Aktgjykimi, para. 124.

⁷¹⁰ Shih Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6789-6790.

⁷¹¹ Shih Aktgjykimi, para. 104-107, 123; Lubinko Cvetiq, 29 qershor 2009, T. 6590, 6597; Lubinko Cvetiq, 30 qershor 2009, T. 6645.

⁷¹² Lubinko Cvetiq, 30 qershor 2009, T. 6624-6626; Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6784-6785.

⁷¹³ Shih Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6785-6786.

⁷¹⁴ Aktgjykimi, para. 124.

⁷¹⁵ Aktgjykimi, para. 108-109. Dhoma e Apelit gjykon se në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dhe shpjegoi ndryshimet në përbërjen e Shtabit Ministror duke e krahasuar me Shtabin e MPB-së (Shih Aktgjykimi, para. 108-109, sh. 394. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 162). Gjorgjeviqi vetëm jep një interpretim alternative të fakteve duke shpërfillur të tëra përfundimet përkatëse të Dhomës Gjyqësore.

Gjorgjeviqit ku shtrembërohet dëshmia gojore dhe me shkrim e dëshmitarit. Si rrjedhojë argumentet e tij hidhen poshtë.

229. Në lidhje me dëshminë e Dëshmitar Byrnes-it, Dhoma e Apelit vë në dukje se sipas dëshmisë së tij Llukiqi i kishte thënë se gjatë udhëtimeve të tij javore në Beograd ai i raportonte si Gjorgjeviqit, po ashtu edhe Stevanoviqit.⁷¹⁶ Dhoma e Apelit rikujton se një dhomë gjyqësore ka të drejtë të pranojë dëshmi të dorës së dytë ndonëse në përcaktimin e vlerës së tyre provuese, duhen marrë parasysh rrethanat konkrete.⁷¹⁷ Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore nuk u bazua vetëm në dëshminë gojore të Dëshmitar Byrnes-it për nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi vijoi të kishte pushtet mbi Llukiqin, por gjithashtu u bazua edhe në provat mbi rolin e Gjorgjeviqit në negociatat që u paraprinë Marrëveshjeve të Tetorit.⁷¹⁸ Në lidhje me deklaratën që Borisavleviqi dha në Dhomën për Krime Lufte të Beogradit⁷¹⁹ se Llukiqi i raportonte Gjorgjeviqit me telefon,⁷²⁰ Dhoma e Apelit thekson se faktikisht kjo deklaratë u pranua si provë në këtë proces gjyqësor. Sidoqoftë Dhoma Gjyqësore nuk u bazua në deklaratën e Borisavleviqit për nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi “vijoi të ishte eprori i Shtabit Ministror dhe Sreten Llukiqit”.⁷²¹ Deklarata e Borisavleviqit iu tregua Gjorgjeviqit gjatë dhënies së dëshmisë së tij. Në vlerësimin e besueshmërisë së tij, Dhoma Gjyqësore theksoi se mohimi prej Gjorgjeviqit i raporteve që merrte prej Llukiqit nuk ishte “as përputhës, e as bindës”.⁷²² Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore u bazua në deklaratën e Borisavleviqit për të përcaktuar besueshmërinë e Gjorgjeviqit në pikën përkatëse dhe jo për vërtetësinë e përmbajtjes sikurse parashtroi Gjorgjeviqi.⁷²³ Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi i interpreton përfundimet e Dhomës Gjyqësore jashtë kontekstit të tyre dhe shpërfill analizën e imtësishme [prej Dhomës Gjyqësore] të dëshmive gojore dhe shkresore mbi të cilat u bazua për nxjerrjen e konkluzionit se Shtabi Ministror nuk ndryshoi lidhjen epror-vartës midis Gjorgjeviqit dhe Llukiqit.⁷²⁴ Rrjedhimisht, argumentet e tij hidhen poshtë.

⁷¹⁶ Aktgjykimi, sh. 6502.

⁷¹⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 303; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 656, sh. 1374; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 85-86.

⁷¹⁸ Aktgjykimi, para. 1897.

⁷¹⁹ Kjo dhomë u krijua në qershor 2003 në Gjykatën e Qarkut të Beogradit, me kompetencë për gjykimin e krimeve kundër njerëzimit dhe të shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare sikurse parashihej në Kodin Penal të Serbisë si edhe për gjykimin e shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare që ishin kryer në territorin e ish-Jugosllavisë që prej 1 janarit 1991.

⁷²⁰ Aktgjykimi, para. 1897, sh. 6502.

⁷²¹ Shih Aktgjykimi, para. 1897, sh. 6502. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 169.

⁷²² Aktgjykimi, sh. 6502. Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10061. Gjorgjeviqi gjithashtu sugjeron se Dhoma Gjyqësore bëri një përmbledhje të pasaktë të deklaratës së Borisavleviqit (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 169). Pas shqyrtimit të transkriptit, Dhoma e Apelit konstaton se nuk është kështu. Në Aktgjykimi lexohet se sipas deklaratës së Borisavleviqit se Gjorgjeviqi merrte raporte gojore nga Llukiqi I cili e kontaktonte me telefon, pohim që përputhet me deklaratën e dokumentuar të Borisavleviqit (shih Aktgjykimi, sh. 6502 me Vllastimir Gjorgjeviqin, 14 dhjetor 2009, T. 10063).

⁷²³ Shih Aktgjykimi, sh. 6502; Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10061-10067.

⁷²⁴ Aktgjykimi, para. 104-124, 1897-1899.

230. Gjithashtu, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se ai nuk kishte kompetencë për emërimin dhe pushimin nga detyra të shefave të SPB-ve. Dhoma Gjyqësore e analizoi konkretisht këtë argument të cilin e rrëzoi.⁷²⁵ Gjorgjeviqi thjesht kërkon që Dhoma e Apelit të pranojë interpretimin e tij të provave, pa qenë në gjendje të identifikojë asnjë gabim.⁷²⁶ Po ashtu, argumenti i Gjorgjeviqit se roli i tij në “emërimet dhe pushimet nga detyra e punonjësve të RJB-së në Shtabin Ministror” kufizohej në ligjësimin e të drejtave të punësimit, dëshmon se ai e ka keqkuptuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore.⁷²⁷ Faktikisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore konkludoi se pavarësisht nga mungesa e “kompetencës për emërimet” e Gjorgjeviqit të anëtarëve të Shtabit Ministror, nëpërmjet ligjësimin të të drejtave të punonjësve të RJB-së të emëruar në Shtabin Ministror, ai “mbeti i angazhuar në mënyrë aktive në lidhje me anëtarësinë dhe funksionimin e Shtabit Ministror në Kosovë gjatë gjithë vitit 1999.”⁷²⁸ Gjorgjeviqi thjesht ofron një konkluzion alternativ por nuk ka arritur të identifikojë gabim të Dhomës Gjyqësore. Për këtë arsye argumenti i tij hidhet poshtë.

3. Roli i Gjorgjeviqit në ngjarjet në Kosovë më 1998 dhe 1999

(a) Hyrje

231. Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas miratimit të Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë në korrik 1998, Gjorgjeviqi ishte i pranishëm në Kosovë afërsisht tre muaj e gjatë kësaj kohe ai mbikëqyri zbatimin e planit dhe mori pjesë aktive në mbledhjet e Shtabit Ministror.⁷²⁹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se në mbledhjen e Shtabit Ministror në Kosovë, më 22 korrik 1998, Gjorgjeviqi i udhëzoi të pranishmit për detyrimet e tyre në të ardhmen në përputhje me Planin për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë.⁷³⁰ Gjithashtu u konkludua se gjatë gjithë vitit 1999, Gjorgjeviqi “vazhdoi të ishte i angazhuar në Kosovë dhe

⁷²⁵ Aktgjykimi, para. 40, 48; Dosja përmblylëse e Gjorgjeviqit, para. 163.

⁷²⁶ Shih më lart, para. 20.

⁷²⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 172.

⁷²⁸ Aktgjykimi, para. 120. ndër provat e analizuara nga Dhoma Gjyqësore përmenden dy vendime të nënshkuara nga Gjorgjeviqi në lidhje me të drejtat e Stojanoviqit dhe Bozoviqit (Aktgjykimi, para. 120, përmenden përkatësisht Prova Materiales P1044, dhe D405); Letër e Llukiqit për Gjorgjeviqin ku propozohen përfundime të mandateve dhe shtimi i numrit të anëtarëve të Shtabit Ministror duke filluar prej datës 1 qershor 1999 (Aktgjykimi, para. 120, përmendet Prova Materiale D406); vendimi vijues i ministrit që pasqyron propozimin e Llukiqit për Gjorgjeviqin (Aktgjykimi, para. 120, përmendet Prova Materiale P67); dhe vendimi i Gjorgjeviqit i 30 majit 1999 që përfundonte mandatin e Millan Çankoviqit si anëtar i Shtabit Ministror (Aktgjykimi, para. 120, përmendet Prova Materiale P144).

⁷²⁹ Aktgjykimi, para. 1901. Dhoma e Apelit thekson se “në përputhje me përdorimin e përgjithshëm të këtij emërtimi nga dëshmitarët dhe palët gjatë parashtrimeve të tyre” Dhoma Gjyqësore përdori “emërtimin ‘Shtabi i MPB-së’, ose ‘Shtabi i MPB-së për Kosovën’, sa herë që do t’i referohej Shtabit të MPB-së për Kosovën para datës 16 qershor 1998, apo Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë pas kësaj date.” Dhoma Gjyqësore theksoi se ky “emërtim është i përshtatshëm meqë është i shkurtër dhe nuk përbën mosnjohje të ndryshimeve në strukturën zyrtare” të Shtabit (Aktgjykimi, para. 123). Nga ana e vet, Dhoma e Apelit do të bëjë dallimin dhe do të përdorë termin “Shtabi Ministror” gjatë diskutimit mbi Shtabin pas 16 qershorit 1998.

⁷³⁰ Aktgjykimi, para. 1901.

të bashkëpunonte me ministrin në Kosovë në më shumë se një rast”.⁷³¹ Sipas Dhomës Gjyqësore, kjo sjellje nuk përputhej me qëndrimin e Gjorgjeviqit gjatë fazës së gjykimit se ministri e kishte lënë “jashtë” ngjarjeve të Kosovës.⁷³²

(b) Argumentet e palëve

232. Gjorgjeviqi argumenton se ndikimi i krijimit të Shtabit Ministror ndaj “kontrollit të tij mbi ngjarjet në Kosovë ishte i menjëhershëm”⁷³³ dhe se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar sipas të cilit ai “mori pjesë aktivisht në” mbledhjet e Shtabit Ministror, ose pati kontroll efektiv mbi ngjarjet në Kosovë më 1998 dhe 1999.⁷³⁴ Ai parashtron se Dhoma Gjyqësore konkludoi gabimisht se ai mori pjesë aktivisht në mbledhjet e Shtabit Ministror më 1998.⁷³⁵ Gjorgjeviqi parashtron se gjatë vitit 1998, me kalimin e kohës angazhimi i tij në Kosovë u pakësua dhe më 1999 ai ishte i pranishëm në Kosovë vetëm pak herë.⁷³⁶ Në mbështetje të argumentit të tij Gjorgjeviqi përmend: (i) praninë dhe angazhimin e tij të pretenduar në Reçak në mes të janarit 1999; (ii) një mbledhje të shtabit më 17 shkurt 1999, kryesuar nga Llukiqi në emër të ministrit gjatë së cilës Gjorgjeviqi thau se nuk foli; (iii) një mbledhje të Shtabit Ministror, kryesuar nga ministri dhe shefi i Shtabit të MPB-së gjatë së cilës Gjorgjeviqi nuk foli; (iv) një vizitë në Kosovë më 16 dhe 18 prill 1999 ku ai përfundoi mandatet e dy shefave të SPB-ve me autorizim të ministrit dhe takoi Llukiqin dhe Stevanoviqin; (v) praninë e pretenduar të tij në mbledhjen e Komandës së Përbashkët më 1 qershor 1999; dhe (vi) praninë e tij në një mbledhje më 10 qershor 1999 në lidhje me tërheqjen e forcave të MPB-së nga Kosova.⁷³⁷

233. Gjithashtu në mbështetje të argumentit të tij Gjorgjeviqi u referohet provave mbi një sërë mbledhjesh të Shtabit Ministror gjatë të cilave Stevanoviqi ose kryesoi mbledhjen, ose dha udhëzime të hollësishme, kurse Gjorgjeviqi nuk ishte i pranishëm në këto mbledhje.⁷³⁸

234. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore i rrëzoi pretendimet e Gjorgjeviqit se mori pjesë vetëm në pak mbledhje të Shtabit Ministror më 1998 dhe se prania e tij në Kosovë më 1999 ishte e rrallë.⁷³⁹ Argumentohet se Dhoma Gjyqësore e nxori këtë konkluzion të

⁷³¹ Aktgjykimi, para. 1925.

⁷³² Aktgjykimi, para. 1925.

⁷³³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173.

⁷³⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173.

⁷³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173.

⁷³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173.

⁷³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173. Angazhimi i Gjorgjeviqit në Reçak në janar 1999 dhe pjesëmarrja e tij në një mbledhje të Komandës së Përbashkët më 1 qershor 1999, do të shqyrtohen më poshtë përkatësisht nën nënpikën 9(E) dhe nënpikën 9(B) të apelit të tij.

⁷³⁸ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 78-79. Konkretisht Gjorgjeviqi përmend këto mbledhje të Shtabit Ministror: (i) 21 dhjetor 1998 (shih Prova Materiale P1043); (ii) 4 prill 1999 (shih Prova Materiale P764); (iii) 7 maj 1999 (shih Prova Materiale P771); dhe (iv) 11 maj 1999 (shih Prova Materiale P345).

⁷³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 141.

arsyeshëm pas analizimit të provave në lidhje me praninë në terren të Gjorgjeviqit pas krijimit të Shtabit Ministror në qershor 1998 dhe nuk e gjykoj bindës pretendimin e tij se ai ishte lënë “jashtë” ngjarjeve në Kosovë.⁷⁴⁰

(c) Analizë

235. Dhoma e Apelit thekson argumentin e Gjorgjeviqit se ishte “ishte tërësisht e gabuar të konkludohej se [ai] ‘mori pjesë aktivisht’ në mbledhjet e Shtabit Ministror më 1998”.⁷⁴¹ Dhoma e Apelit gjykon se kjo shprehje është interpretuar jashtë kontekstit. Më poshtë vijon konkluzioni i plotë i Dhomës Gjyqësore:

duke filluar nga korriku 1998, i Akuzuari ishte i pranishëm në Kosovë për së paku tre muaj, për të mbikëqyrur zbatimin e Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë dhe gjatë kësaj periudhe ai mori pjesë aktive në mbledhjet e Shtabit të MPB-së.⁷⁴²

236. Përfundimet e Dhomës në lidhje me këtë pikë bazohen në prova të shumta që kanë të bëjnë me angazhimin e Gjorgjeviqit në Kosovë gjatë tërë vitit 1998 dhe pjesëmarrjen e tij aktive në krijimin dhe zbatimin e Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë.⁷⁴³ Dhoma e Apelit rikujton se emërtimi i plotë i Shtabit Ministror ishte “Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit”⁷⁴⁴ dhe se ky shtab u krijua për të mundësuar formalisht koordinimin midis RJB-së dhe RDB-së për “luftën kundër terrorizmit” në Kosovë.⁷⁴⁵ Menjëherë pas krijimit të Shtabit Ministror, Gjorgjeviqi u dërgua në Kosovë për monitorimin dhe vënien në zbatim të Planit për Shtypjen e Terrorizmit.⁷⁴⁶ Vetë Gjorgjeviqi dëshmoi si ai morë pjesë herë pas here në mbledhjet e Shtabit Ministror, “mori pjesë në zhvillimin e mbledhjeve, kontribuoi në të nëpërmjet disa propozimeve [...] ose ndihmoi në çfarëdo mënyre të mundshme”.⁷⁴⁷ Po ashtu gjatë diskutimit të rolit të tij në Kosovë, ai dëshmoi se nuk ishte “thjesht vëzhgues”, por detyra e tij ishte “të angazhohej dhe të jepte ndihmë në veprimtaritë e atjeshme dhe të jepte kontributin [e tij] për suksesin e veprimtarive kundërterroriste.”⁷⁴⁸ Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se fakti që Gjorgjeviqi nuk mori pjesë në të gjitha mbledhjet e Shtabit Ministror sikurse theksoi ai vetë, nuk ndikon në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ai mori pjesë aktivisht në mbledhjet e Shtabit Ministror.⁷⁴⁹ Gjithashtu, nuk cenohet as konkluzioni tjetër i Dhomës Gjyqësore se krijimi i Shtabit Ministror nuk pati ndikim ndaj angazhimit të tij

⁷⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 141.

⁷⁴¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173.

⁷⁴² Aktgjykimi, para. 1901.

⁷⁴³ Aktgjykimi, para. 1901, sh. 6522-6531. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 228-293, 1900-1907.

⁷⁴⁴ Aktgjykimi, para. 108. Shih gjithashtu më lart, para. 209-211.

⁷⁴⁵ Aktgjykimi, para. 110.

⁷⁴⁶ Vllastimir Gjorgjeviq, 8 dhjetor 2009, T. 9791; Aktgjykimi, para. 1900-1907.

⁷⁴⁷ Aktgjykimi, sh. 6526, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 3 dhjetor 2009, T. 9589.

⁷⁴⁸ Aktgjykimi, sh. 6526, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 8 dhjetor 2009, T. 9791.

⁷⁴⁹ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 256.

në ngjarjet në Kosovë, në kundërshtim me çfarë sugjeron ai. Argumentet e tij lidhur me këtë pikë hidhen poshtë.

237. Më tej Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim që u bazua në provat mbi pjesëmarrjen e tij të kufizuar në mbledhjet në Kosovë më 1999, për nxjerrjen e konkluzionit si ai ishte pjesëmarrës aktiv dhe kishte kontroll efektiv mbi forcat në Kosovë më 1999.⁷⁵⁰ Megjithatë, Gjorgjeviqi shpërfill përfundimin e Dhomës Gjyqësore se vizitat e tij në Kosovë më 1999 u analizuan në kontekst të pjesëmarrjes së tij aktive në krijimin e Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë dhe “pranisë së tij si drejtues në Reçak”.⁷⁵¹ Pasiviteti relativ i Gjorgjeviqit në disa mbledhje apo fakti se një mbledhje u drejtua nga dikush tjetër nuk i zhvlerëson këto përfundime.⁷⁵² Përkundrazi, duke mbajtur parasysh rolin e tij në krijimin e Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë dhe “praninë e tij si drejtues në Reçak”, si dhe pozitën e tij të lartë, prania e Gjorgjeviqit në Kosovë dhe në mbledhje “për të ngritur moralin e forcave të policisë” dhe për të parë “dorëzimin e detyrave prej dy shefave të SPB-ve”, është e rëndësishme për konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi vijimësinë e angazhimit të Gjorgjeviqit në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës.⁷⁵³ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore veprimi në mënyrë të arsyeshme që u bazua në pjesëmarrjen e tij në mbledhje në Kosovë më 1999, për nxjerrjen e konkluzionit se ai ishte ende aktiv në Kosovë dhe nuk u mbajt “jashtë ngjarjeve”, sikurse pretendoi Gjorgjeviqi gjatë fazës së gjyqimit.⁷⁵⁴

238. Sidoqoftë, Gjorgjeviqi i keqkupton konkluzionet e Dhomës Gjyqësore kur parashtron se nuk u vërtetua se ai pati “kontroll efektiv” ndaj ngjarjeve në Kosovë.⁷⁵⁵ Dhoma Gjyqësore nuk e përcaktoi kontrollin efektiv për ngjarje konkrete, por konkludoi se Gjorgjeviqi “luajti rol kyç në koordinimin e punës së forcave të MPB-së në Kosovë më 1998 dhe 1999”,⁷⁵⁶ dhe gjithashtu se gëzonte kompetenca *de jure* dhe ushtronte kontroll efektiv mbi policinë në Kosovë.⁷⁵⁷ Përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me praninë e Gjorgjeviqit në Kosovë më 1999 treguan se Gjorgjeviqi “vazhdoi të ishte i përfshirë në Kosovë dhe të bashkëpunonte me ministrin në Kosovë në më shumë se një rast”.⁷⁵⁸ Duke u bazuar në vizitat e tij të vazhdueshme gjatë vitit 1998 dhe 1999, “praninë e tij si drejtues” në disa raste, dhe rolin e tij kyç në koordinimin e forcave të MPB-së në Kosovë, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi vijoi angazhimin e tij dhe ishte aktiv në Kosovë edhe më 1999.

⁷⁵⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵¹ Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173, përmendet Prova Materiale P85, f. 4, Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵³ Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 173(b).

⁷⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2154.

239. Bazuar në sa më sipër, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe si rrjedhojë nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se ai ishte i angazhuar dhe aktiv në Kosovë gjatë gjithë vitit 1999.

4. Pushteti mbi PJP-në dhe SAJ-in

(a) Argumentet e palëve

240. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kishte pushtet dhe kontroll efektiv mbi PJP-në dhe SAJ-in sepse ai i angazhoi dhe i dislokoj këto njësi.⁷⁵⁹ Për më tepër, ai argumenton se ai thjesht zbatoi vendimet e ministrit dhe kaq ishte roli i tij.⁷⁶⁰ Më tej, ai apelon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ai inkuadroi pjesëtarë shtesë të njësive të PJP-së dhe SAJ-it në forcat rezerviste dhe i dislokoj në Kosovë.⁷⁶¹

241. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi ishte në kontroll të njësive të PJP-së dhe SAJ-it gjatë vitit 1998 dhe 1999 dhe rrëzoi argumentin e Gjorgjeviqit se ai thjesht zbatoi vendimet e ministrit.⁷⁶² Prokuroria përsërit se krijimi i Shtabit Ministror në qershor 1998 nuk e pakësoi pushtetin e Gjorgjeviqit ndaj njësive të PJ-së dhe SAJ-it.⁷⁶³ Gjithashtu Prokuroria pretendon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se përfundimi i Dhomës Gjyqësore lidhur me dislokimin e vullnetarëve dhe rezervistëve në Kosovë ishte i paarsyeshëm.⁷⁶⁴

(b) Analizë

242. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se “mobilizimi dhe angazhimi i njësive të PJP-së mund të bëhej vetëm me urdhrin e ministrit dhe me urdhrin e shefit të RJB-së, pas miratimit prej ministrit”, pra me urdhër nga Gjorgjeviqi.⁷⁶⁵ Dhoma Gjyqësore shqyrtoi konkretisht dëshminë e Gjorgjeviqit se ministri asnjëherë nuk e autorizoi për “të dërguar” njësi të PJP-së në ndonjë mision, dhe konkludoi se kjo dëshmi binte në

⁷⁵⁷ Aktgjykimi, para. 2154.

⁷⁵⁸ Aktgjykimi, para. 1925.

⁷⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 174, 176, 178-179.

⁷⁶⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 175, 177-179.

⁷⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 177.

⁷⁶² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 143. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 119.

⁷⁶³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 144.

⁷⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 145.

⁷⁶⁵ Aktgjykimi, para. 61, përmendet Prova Materiale P58, para. 2, P1360, f. 5, Lubinko Cvetiq, 29 qershor 2009, T. 6604, 6607, Vllastimir Gjorgjeviq, 1 dhjetor 2009, T. 9453, Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9459. Dhoma e Apelit vë në dukje se në mbështetje të argumentit të tij, Gjorgjeviqi citon prova që provojnë vetëm përfundimin e përgjithshëm të Dhomës Gjyqësore se angazhimi i njësive të PJP-së ishte kompetencë e ministrit (krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 174-175, sh. 263 me Aktgjykimi, para. 61).

kundërshti “të hapët” me provat e administruara.⁷⁶⁶ U konkludua se gjatë periudhës së Aktakuzës, ai kishte autorizimin e ministrit për të marrë vendime në lidhje me angazhimin e forcave të PJP-së, bazuar në: (i) provat shkresore sipas të cilave gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës, Gjorgjeviqi si shef i RJB-së, dërgoi telegrame për angazhimin e njërive të PJP-së;⁷⁶⁷ dhe (ii) dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit, shef i SPB-së së Mitrovicës, sipas të cilit vendimet për angazhimin e njërive të PJP-së zakonisht merreshin prej shefit të RJB-së, me fjalë të tjera prej Gjorgjeviqi.⁷⁶⁸ Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arrin të faktojë pretendimin e tij se ai thjesht zbatoi vendimet e ministrit dhe se Dhoma Gjyqësore u bazua në dëshmitë gojore dhe provat shkresore të gabuara për nxjerrjen e konkluzionit të vet. Dhoma e Apelit gjykon se rrjedhimisht Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se arsyetimi i Dhomës dhe interpretimi i provave prej Dhomës Gjyqësore ishin të gabuar.⁷⁶⁹

243. Argumenti i Gjorgjeviqit në lidhje me SAJ-in është se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ai kishte pushtet ndaj njërive të SAJ-it sepse mund t’i angazhonte, nuk e plotëson kushtin e kontrollit efektiv.⁷⁷⁰ Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se kontroll efektiv automatikisht nënkupton kontroll gjatë operacioneve luftarake,⁷⁷¹ Dhoma e Apelit rikujton se nga pikëpamja ligjore ky argument nuk është i saktë.⁷⁷² Sidoqoftë, Dhoma e Apelit gjykon se fakti nëse Gjorgjeviqi ushtroi ose nuk ushtroi kontroll efektiv ndaj këtyre njërive në Kosovë gjatë operacioneve luftarake nuk ka rëndësi për aspektin thelbësor nëse duke i angazhuar këto njësi ai veprroi për realizimin e NPK-së. Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore formuloi konkluzionin konkret se ndonëse pas dislokimit të tyre njësitë e PJP-së dhe SAJ-it i merrnin detyrat nga Shtabi i MPB-së, Gjorgjeviqi ishte përgjegjës për ta.⁷⁷³

244. Rrjedhimisht Gjorgjeviqi nuk ka arritur të tregojë se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se ai kishte kontroll efektiv mbi njësitë e dislokuara.

⁷⁶⁶ Shih Aktgjykimi, para. 61, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9459.

⁷⁶⁷ Aktgjykimi, para. 61, përmendet Prova Materiale P131, P132, P137, P138, P139, P346, P1182, P1183.

⁷⁶⁸ Aktgjykimi, para. 61.

⁷⁶⁹ Shih më lart, para. 20.

⁷⁷⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 176. Në këtë kontekst, Gjorgjeviqi apelon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ai pranoi pjesëtarë në forcat rezerviste dhe i dislokoi, bazuar vetëm në kundërshtimet e ngritura ndaj përfundimeve të Dhomës Gjyqësore mbi dislokimin e Akrepave (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 176-177). Dhoma e Apelit do ta shqyrtojë këtë argument më poshtë në Aktgjykimin e vet (Shih më poshtë, para. 355-362, 366-371).

⁷⁷¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 176, 178-179.

⁷⁷² Dhoma e Apelit rikujton se “nga pikëpamja ligjore nuk është thelbësor fakti nëse kontrolli efektiv kalon nga eprori te vartësi fajtor për krimin nëpërmjet vartësve të ndërmjetëm, rëndësi ka nëse eprori ka aftësinë thelbësore për parandalimin ose ndëshkimin e vartësit penalisht përgjegjës” (Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 20).

⁷⁷³ Aktgjykimi, para. 72, 110, 112, 118, 124, 1896-1897. Shih gjithashtu më poshtë, para. 406-408.

5. Sistemi i raportimit brenda MPB-së

(a) Argumentet e palëve

245. Argumenti i Gjorgjeviqit në lidhje me sistemin e raportimit brenda MPB-së ka dy elementë. Së pari, ai argumenton se praktika e raportimit brenda MPB-së u ndikua nga krijimi i Shtabit Ministror, që është një dëshmi më shumë për pakësimin e kompetencave të Gjorgjeviqit.⁷⁷⁴ Veçanërisht, Gjorgjeviqi kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se raportet e SPB-ve dërguar nga Shtabi Ministror selisë së MPB-së në Beograd, përfshirë edhe shefat e RJB-ve të RDB-së, përmbanin informacion mbi operacione kundërterroriste të njëjësive policore.⁷⁷⁵ Sipas tij, fakti i ekzistencës së një sistemi raportimi të dyfishë, ku një linjë raportimi shkonte nga SPB-të në Shtabin Ministror në Prishtinë dhe tjetra shkonte drejtpërsëdrejti në MPB, tregon se ai nuk ishte i informuar për operacionet e MPB-së në Kosovë.⁷⁷⁶ Së dyti, Gjorgjeviqi pretendon se Dhoma Gjyqësore deduktoi gabimisht se ai kishte dijeni për ngjarjet në Kosovë, duke qenë se raportet për Beogradin nuk përfshinin informacion për operacionet kundërterroriste, edhe në qoftë se Shtabi i MPB-së kishte marrë të gjithë informacionin përkatës mbi operacionet kundërterroriste të MPB-së.⁷⁷⁷

246. Prokuroria përgjigjet se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore sipas të cilit Gjorgjeviqi ishte i informuar për operacionet e MPB-së në Kosovë ishte i arsyeshëm dhe “i bazuar në një mori provash”.⁷⁷⁸

(b) Analizë

247. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi hollësisht sistemin e raportimit brenda MPB-së.⁷⁷⁹ Për nxjerrjen e konkluzioneve lidhur me sistemin e raportimit, [Dhoma Gjyqësore] u bazua në udhëzimet e MPB-së mbi informacionin dhe raportimin,⁷⁸⁰ dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit dhe dëshminë e Dëshmitar Simoviqit, si edhe në prova të tjera shkresore.⁷⁸¹

⁷⁷⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 180, 182, 184-185; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 52-53.

⁷⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 182, përmendet Aktgjykimi, para. 132. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 170-171.

⁷⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 184. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 170-171.

⁷⁷⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 180, 182, 184-185; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 52-53.

⁷⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 147. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 125. Gjithashtu, Prokuroria parashtroi se Dhoma Gjyqësore konkludoi se dijenia e Gjorgjeviqit bazohej në burime të ndryshme ndër të tjera në sistemet ekzistuese të raportimit në MPB që ishin të gjera dhe të hollësishme, raportimet telefonike, kontaktet personale, pjesëmarrja e tij në mbledhjet e Shtabit të MPB-së, Komandës së Përbashkët, Kolegjiumit të MPB-së, dhe vizitave në terren (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 147-148).

⁷⁷⁹ Aktgjykimi, para. 125-135.

⁷⁸⁰ Prova Materiale D232.

⁷⁸¹ Shih Aktgjykimi, para. 125-135, 1258.

U konkludua se: (i) më 1999, SPB-të në Kosovë⁷⁸² dërguan raporte në lidhje me ngjarjet në territorin e Kosovës si MPB-së në Beograd, po ashtu edhe Shtabit të MPB-së në Prishtinë;⁷⁸³ (ii) informacionin më të rëndësishëm për ngjarjet në lidhje me sigurinë që ndodhnin në territoret e SPB-ve, Dega e Analizave e RJB-së në Beograd ua dërgonte SPB-ve përkatëse dhe shefit të Shtabit të MPB-së me qëllim informimin e tyre në lidhje me gjendjen e sigurisë jashtë zonave të tyre të përgjegjësisë;⁷⁸⁴ (iii) shefat e SPB-ve i raportonin Llukiqit çdo mëngjes çfarëdo informacioni shtesë që nuk ishte përfshirë në buletinet ditore;⁷⁸⁵ dhe (iv) raportimi bëhej edhe gjatë mbledhjeve të Shtabit të MPB-së.⁷⁸⁶ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se Shtabi i MPB-së i dorëzonte raporte qendrës në Beograd dhe raporte përmbledhëse MPB-së në Beograd për çdo gjë që kishte ndodhur në terren. Gjorgjeviqi i karakterizoi raportet përmbledhëse si “kanal i dyfishtë” meqenëse i njëjti informacion i dërgohej Qendrës Operative të MPB-së edhe prej SPB-vë në Kosovë.⁷⁸⁷

248. Gjatë analizimit të këtyre raporteve, Dhoma Gjyqësore nuk e pranoi dëshminë e Gjorgjeviqit se ndonëse këto raporte duhej të përfshinin informacion mbi lëvizjet e policisë dhe operacionet policore, informacioni i marrë nga Beogradi kishte të bënte vetëm me veprimtaritë terroriste (dhe rrjedhimisht jo me reagimin kundërterrorist të UJ-së dhe MPB-së).⁷⁸⁸ Faktikisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto raporte përmendnin: (i) sulmet terroriste dhe përgjigjen e policisë ndaj tyre; (ii) operacionet policore, përfshirë llojin e operacionit, kohën dhe vendin e kryerjes së operacionit, numrin e policëve të përfshirë në operacion, pajisjet luftarake dhe joluftarake të përdorura gjatë operacionit, dhe rezultatet dhe pasojat e operacionit; (iii) lëvizjet e njësive policore në drejtim të, nga dhe brenda në Kosovë; dhe (iv) vëzhgimet në lidhje me punën e pjesëtarëve të MVK-së.⁷⁸⁹ Këto pika u parashtruan në një telegram që Llukiqi u dërgoi të gjitha SPB-ve në Kosovë më 21 tetor 1998 në bazë të detyrimeve të ndërmarra nga Serbia në Marrëveshjet e Tetorit.⁷⁹⁰

249. Dhoma e Apelit gjykon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore nuk qartëson nëse përmbajtja e “raporteve” ka të bëjë me raportet e dërguara: (i) nga SPB-të për Shtabin e MPB-së, (ii) nga SPB-të për Qendrën Operative të MPB-së në Beograd, apo (iii) nga Shtabi i MPB-së për Beogradin. Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore iu referua Provës Materiale

⁷⁸² Tridhjetë e tre Sekretariatet e Punëve të Brendshme (SPB-të) në territorin e Republikës së Serbisë ishin në varësi të RJB-së dhe ishin përgjegjëse për situatën e sigurisë në zonat gjeografike për të cilat ishin krijuar (Aktgjykimi, para. 46).

⁷⁸³ Aktgjykimi, para. 129, përmendet Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6723, 6726, Prova Materiale P1060.

⁷⁸⁴ Aktgjykimi, para. 129, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9495, 9499-9504.

⁷⁸⁵ Aktgjykimi, para. 129, përmendet Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6763.

⁷⁸⁶ Aktgjykimi, para. 129, përmendet Lubinko Cvetiq, 3 korrik 2009, T. 6860, Prova Materiale P764.

⁷⁸⁷ Aktgjykimi, para. 131, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9508 (diskutohet Prova Materiale D284).

⁷⁸⁸ Aktgjykimi, para. 132, përmendet Prova Materiale P1041.

⁷⁸⁹ Aktgjykimi, para. 132.

⁷⁹⁰ Aktgjykimi, para. 132; Prova Materiale P1041.

D274 dhe Proves Materiale D275.⁷⁹¹ Prova Materiale D274 është një raport i një SPB-je për Shtabin e MPB-së me datë 14 janar 1999, që përkon saktësisht me temat e raportimit të parashtruara në telegramin e 21 tetorit 1998 të dërguar nga Llukiqi.⁷⁹² Prova Materiale D275, është një raport ditor nga një SPB për Qendrën Operative në Beograd, që bën fjalë vetëm për vepra penale ngjarje dhe incidente kriminale, por nuk përmend operacione policore.⁷⁹³ Sidoqoftë për arsye të shtjelluara më poshtë dhe gjetiu në këtë Aktgjykim,⁷⁹⁴ Dhoma e Apelit gjykon se ky dallim nuk ka asnjë ndikim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se krijimi i Shtabit Ministror nuk i kufizoi kompetencat e Gjorgjeviqit dhe se ai ishte në dijeni të ngjarjeve që zhvilloheshin në Kosovë.

250. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e qartë se me gjithë sistemin e hollësishëm e të gjerë të raportimit nëpërmjet të cilit SPB-të në Kosovë dhe Shtabi i MPB-së në Prishtinë e informonin Beogradin për ngjarjet në terren në Kosovë, në këto raporte nuk u përmendën krimet e rënda të kryera prej forcave të MPB-së kundër popullatës shqiptare kosovare gjatë vitit 1998 dhe 1999.⁷⁹⁵ Si rrjedhojë [Dhoma Gjyqësore] deduktoi dijeninë e Gjorgjeviqit për ngjarjet në Kosovë duke u bazua në: (i) prova se ndonjëherë SPB-të i raportonin selisë së MPB-së me telefon;⁷⁹⁶ (ii) prova se më 28 mars 1999, komandanti i SAJ-it, Zoran Simoviqi, i telefonoi Gjorgjeviqit dhe e informoi për krimet e kryera atë ditë në Podujevë kundër civilëve shqiptarë kosovarë, prej njësisë së Akrepave që i ishte atashuar SAJ-it;⁷⁹⁷ (iii) kontaktet personale dhe të drejtpërdrejta të Gjorgjeviqit ndër të tjerë me disa shefa të SPB-ve në Kosovë dhe me shefin e Shtabit të MPB-së, Llukiqin;⁷⁹⁸ (iv) praninë dhe pjesëmarrjen e tij aktive në mbledhje të Komandës së Përbashkët;⁷⁹⁹ (v) pjesëmarrjen e tij në Kolegjiumin e MPB-së për të cilin Dhoma konkludoi se shërbeu si forum për diskutimin e

⁷⁹¹ Aktgjykimi, para. 132.

⁷⁹² Shih Prova Materiales D274, P1041.

⁷⁹³ Shih Prova Materiale D275.

⁷⁹⁴ Shih më lart, para. 226-227, 235-238; më poshtë, para. 250-251.

⁷⁹⁵ Aktgjykimi, para. 1985-1986.

⁷⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1986, përmendet dëshmia gojore e Lubinko Cvetiqit, 1 korrik 2009, T. 6723, 6726.

⁷⁹⁷ Aktgjykimi, para. 1986, përmendet dëshmia gojore e Vllastimir Gjorgjeviqit, 7 dhjetor 2009, T. 9703, Zoran Simoviqi, 19 prill 2010, T. 13588-13589, Zoran Simoviqi, 20 prill 2010, T. 13654.

⁷⁹⁸ Aktgjykimi, para. 1987. Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova se në vitin 1999, ai shkoi disa herë në Kosovë ku mori pjesë në mbledhjet e Shtabit të MPB-së dhe vizitoi shefat e SPB-ve (Aktgjykimi, para. 1987). Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se: (i) më 1999, Gjorgjeviqi mori pjesë në mbledhjen e Shtabit të MPB-së gjatë të cilës Llukiqi foli për operacionet e "spastrimit" të RJB-së që do të kryheshin në zonat e Podujevës, Dragobilit dhe Drenicës (Aktgjykimi, para. 1987, përmendet Prova Materiale P85, f. 1); (ii) Në mars 1999, në kohën kur forcat e MPB-së dhe UJ-së po kryenin të ashtuquajturat operacione "spastrimi" në komunat e Kaçanikut dhe Vushtrisë, ai mori pjesë në diskutimet me Shtabin e MPB-së në lidhje me situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë dhe zbatimin e planit për mbrojtjen (Aktgjykimi, para. 1987, përmendet Lubinko Cvetiqi, 1 korrik 2009, T. 6682-6683. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1925); (iii) më 16 prill 1999, ai shoqëroi ministrin për një vizitë në Kosovë gjatë së cilës ata u takuan me shefat e SPB-ve dhe Shtabin e MPB-së (Aktgjykimi, para. 1987, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9735); (iv) më 18 prill 1999, Gjorgjeviqi u kthye në Kosovë për të mbikëqyrur dorëzimin e detyrave nga disa shefa të SPB-ve ku ai takoi Llukiqin, Petriqin, Pavkoviqin, Llazareviqin, dhe Gjakoviqin) (Aktgjykimi, para. 1987, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9738-9739, Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 10020).

⁷⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1988. Shih më lart, para. 226; më poshtë, para. 283-287, 321.

hollësishëm të operacioneve kundërterroriste të UJ/MPB-së;⁸⁰⁰ (vi) dijeninë e tij për krimet e kryera nga forcat serbe në Kosovë më 1998;⁸⁰¹ (vii) praninë e tij në terren në Reçak në janar 1999, ku një operacion kundër UÇK-së shkaktoi vdekjen e shumë civilëve;⁸⁰² (viii) implikimin e tij në fshehjen e krimeve;⁸⁰³ dhe (ix) mediat e atjeshme.⁸⁰⁴ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të tregojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si ai i Dhomës Gjyqësore dhe si pasojë nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi me nxjerrjen e konkluzionit se ai ishte në dijeni të ngjarjeve që po ndodhnin në Kosovë.⁸⁰⁵

251. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se pas 24 marsit 1999, sistemi i komunikimit u dëmtua dhe informacionet nga terreni u bënë shumë të vështira për t'u marrë, Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore konkludoi shprehimisht se sistemi telefonik i raportimit u ndërpre në prill të vitit 1999 si rezultat i bombardimit të postës në Prishtinë.⁸⁰⁶ Ndonëse Dhoma Gjyqësore nuk saktësoi se në çfarë mënyre vijoi sistemi i raportimit, provat e cituara në shënimet përfund faqeve konfirmojnë konkluzionin se sistemi i raportimit vijoi gjatë gjithë luftës.⁸⁰⁷ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore citoi vetë dëshminë e Gjorgjeviqit në lidhje me disa telegrame të RJB-së dërguar SPB-ve dhe Shtabit të MPB-së në prill dhe maj 1999.⁸⁰⁸ Konkretisht, duke folur për një telegram me datë 24 prill 1999, Gjorgjeviqi tha se ai i merrte të gjitha raportet ditore⁸⁰⁹ dhe se telegrami iu dërgua “të gjithë sekretariateve dhe MPB-së në Prishtinë”.⁸¹⁰ Gjithashtu, Dhoma e Apelit i referohet dëshmisë së Dëshmitarit Cvetiq brenda kontekstit të diskutimit mbi shkatërrimin e ndërtesës postare që shkaktoi ndërprerjen e linjave telefonike sipas të cilës SPB-të kishin qendra ndërlidhjeje dhe përdorën “teleprintues” për dërgimin e telegrameve dhe buletineve Shtabit të MPB-së dhe qendrës në Beograd.⁸¹¹ Për këto arsye argumenti i Gjorgjeviqit bie.

252. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar sipas të cilit krijimi i Shtabit Ministror nuk i

⁸⁰⁰ Aktgjykimi, para. 1989. Dhoma e Apelit rikujton se ka lënë në fuqi konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se gjatë mbledhjeve të Kolegjiumit të Ministrisë u diskutuan operacionet kundërterroriste (Shih më poshtë, para. 269-271).

⁸⁰¹ Aktgjykimi, para. 1990-1991.

⁸⁰² Aktgjykimi, para. 1920-1924, 1992. Dhoma e Apelit ka lënë në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me incidentin e Reçakut dhe rolin e Gjorgjeviqit në këtë incident (Shih më poshtë, para. 338-340, 345-349).

⁸⁰³ Aktgjykimi, para. 1994, 2156. Dhoma e Apelit ka lënë në fuqi konstatimet dhe konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me implikimin e Gjorgjeviqit në fshehjen e krimeve të kryera nga forcat serbe në Kosovë (Shih më poshtë, para. 378-384, 406-409, 413-415, 421-425, 428-431).

⁸⁰⁴ Aktgjykimi, para. 1996. Shih më poshtë, para. 500.

⁸⁰⁵ Shih gjithashtu më poshtë, para. 463, 468, 470, 477, 504, 513-514.

⁸⁰⁶ Aktgjykimi, para. 130. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 185.

⁸⁰⁷ Aktgjykimi, sh. 442, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9499-9504, Prova Materiale D407, D408, D410, D411, D412. Shih gjithashtu Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6723-6724.

⁸⁰⁸ Aktgjykimi, sh. 442, përmendet Prova Materiales D407, D408, D410, D411.

⁸⁰⁹ Aktgjykimi, sh. 442, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9500.

⁸¹⁰ Vllastimir Gjorgjeviq, 2 dhjetor 2009, T. 9500.

⁸¹¹ Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6723-6724.

kufizoi kompetencat e tij dhe se ai ishte në dijeni të operacionit të MPB-së dhe të ngjarjeve që po ndodhnin në Kosovë.

6. Kompetencat e ndihmësministrave

(a) Hyrje

253. Dhoma Gjyqësore konkludoi se, gjatë gjithë kohës së Aktakuzës, Gjorgjeviqi ushtronte kontroll *de jure* mbi RJB-në⁸¹² që ishte njësia më e madhe organizative brenda MPB-së.⁸¹³ U konstatua se në korrik 1997 Gjorgjeviqit iu dha grada e gjeneralkolonelit, grada më e lartë e mundshme brenda MPB-së dhe si rrjedhojë ai u bë oficeri me gradën më të lartë në MPB.⁸¹⁴ Më 27 janar 1998, Gjorgjeviqi u emërua shef i RJB-së.⁸¹⁵ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin se ndihmësministrat e tjerë në RJB ishin në varësi të Gjorgjeviqit për arsye të: (i) gradës së tij si gjeneralkolonel; (ii) postit të tij si shef i RJB-së; (iii) dëshmisë së Aleksandar Vasileviqit (“Dëshmitar Vasileviqi”) sipas të cilit Gjorgjeviqi ishte “numri dy në MPB”;⁸¹⁶ dhe (iv) faktit se ai kishte gradën më të lartë të mundshme në MPB.⁸¹⁷

(b) Argumentet e palëve

254. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në nxjerrjen e konkluzionit se si ndihmësministër dhe shef i RJB-së ai ishte epror i tre ndihmësministrave të tjerë në RJB.⁸¹⁸ Ai këmbëngul se të gjithë ndihmësministrat ishin në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit.⁸¹⁹ Ai citon disa ligje dhe dy dokumente të lëshuara prej ministrit dhe argumenton se në vend që “të merrej” me këto dokumente, Dhoma Gjyqësore i bazoi konkluzionet e veta mbi hierarkinë e MPB-së dhe dëshmitë gojore të Dëshmitar Vasileviqit dhe Dëshmitarit K87.⁸²⁰ Sipas Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore veproi në mënyrë të gabuar kur për përcaktimin e pozitës së tij kundrejt ndihmësministrave të tjerë, u bazua në gradën e tij sepse ndryshe nga ushtria, parimi i hierarkisë në MPB nuk respektohej përpikmërisht dhe grada më e lartë nuk do të thoshte pozitë eprore në MPB.⁸²¹ Gjorgjeviqi deklaroi se Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerë* me të drejtë e pranoi këtë fakt dhe se Dhoma Gjyqësore në këtë çështje duhej të kishte

⁸¹² Aktgjykimi, para. 40.

⁸¹³ Aktgjykimi, para. 43.

⁸¹⁴ Aktgjykimi, para. 43, 1898.

⁸¹⁵ Aktgjykimi, para. 43.

⁸¹⁶ Aktgjykimi, para. 43, 1898.

⁸¹⁷ Aktgjykimi, para. 43, 1898.

⁸¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 159(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 42-43, 1976.

⁸¹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 186, përmendet Prova Materiale P258, Neni 18, P263, D208. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 188; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 76, përmendet Prova Materiale P208, P258, Neni 18, P263.

⁸²⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 73, 75-76.

⁸²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 187, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll.3, para. 943-944. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 74-75, 174.

nxjerrë të njëjtin konkluzion.⁸²² Ai parashtron se dëshmia e Dëshmitar Vasileviqit në lidhje me këtë aspekt ishte pa vlerë dhe se Dëshmitari K87 ishte në “nivele më të ulët të RJB-së”.⁸²³ Gjorgjeviqi këmbëngul se kufizimet në kompetencat e tij ndodhën kur pati mbivendosje kompetencash me ndihmësministrat e tjerë.⁸²⁴ Ai parashtron se Dhoma Gjyqësore e konstatoi këtë fakt në mënyrën e duhur, mirëpo më tej nuk bëri vlerësim të duhur të rolit të dy ndihmësministrave, Petar Zekoviqit (“Zekoviqi”) dhe Stevanoviqi, kompetencat e të cilëve kishin mbivendosje me ato të Gjorgjeviqit.⁸²⁵

255. Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se nuk pati prova se Zekoviqi kishte qenë shef i Administratës për Çështje të Përbashkëta dhe se Stevanoviqi ishte shef i Administratës Policore në RJB, sikurse konkludoi Dhoma Gjyqësore.⁸²⁶

256. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore faktikisht i mori parasysh ligjet, provat dhe dëshmitarët e përmendur nga Gjorgjeviqi në mbështetje të argumentit të tij dhe konkludoi se kompetencat e Stevanoviqit dhe Zekoviqit nuk kishin mbivendosje, apo nuk kufizuan, pushtetin e Gjorgjeviqit si shef i RJB-së.⁸²⁷ Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore me të drejtë arsyetoi se si oficeri i MPB-së me gradën më të lartë në RJB dhe “numri dy i MPB-së” dhe për faktin se “parimi i hierarkisë respektohej më së miri në gjithë strukturën e MPB-së”, tre ndihmësministrat e tjerë, Zekoviqi, Stevanoviqi dhe Mishiqi ishin në varësi të Gjorgjeviqit.⁸²⁸ Gjithashtu, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore me të drejtë u bazua në dëshmi konfirmuese ndërsjellash dhe konkludoi se ndihmësministrat, Zekoviqi dhe Stevanoviqi kishin poste brenda RJB-së dhe konstatoi se të dy ishin në krye të seksioneve brenda RJB-së.⁸²⁹ më tej, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gjykoi se nuk kishte prova se kompetencat e këtyre dy ndihmësministrave ndërhyjnë në kompetencat e Gjorgjeviqit.⁸³⁰

(c) Analizë

257. Së pari, Dhoma e Apelit rikujton se një dhomë gjyqësore duhet të nxjerrë përfundime të bazuara në të gjitha provat e administruara, dhe se dy gjykues të arsyeshëm faktesh mund të

⁸²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 187.

⁸²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 188; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 73-76.

⁸²⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 189-190; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, T. 75-77. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 55.

⁸²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 189-190; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 78-81. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 55.

⁸²⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 189-190; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 79, 172. Gjithashtu Gjorgjeviqi thekson se Zekoviqi organizoi marrjen e kufomave nga Prishtina dhe Mitrovica dhe transportimin e tyre drejtpërsëdrejti në qendrën e PJP-së në Petrovo Sello (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 79).

⁸²⁷ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 126.

⁸²⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 150; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 126.

⁸²⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 151; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 126-128, përmendet Aktgjykimi, para. 40-41, 60, 100, 1936, 2127, 2175, Prova Materiale P263, P357, Neni 13, P537.

⁸³⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 127, përmendet Aktgjykimi, para. 43.

nxjerrin konkluzione të ndryshme, por të barasvlershme logjikisht bazuar në të njëjtat prova.⁸³¹ Si rrjedhojë, nuk mund të pretendohet gabim thjesht duke iu referuar faktit se dhomat e tjera gjyqësore e kanë ushtruar kompetencën e tyre të brendaqenësishme në një mënyrë të ndryshme.⁸³² Pyetja që duhet t'i japë përgjigje Dhoma e Apelit është nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të nxirrte të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore.⁸³³ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi ishte në pozitë eprore kundrejt ndihmësministrave të tjerë, ishte konkluzion i arsyeshëm.

258. Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi por i konsideroi jobindëse dëshminë e Gjorgjeviqit dhe dëshminë e Dëshmitarit Stojan Mishiq (“Dëshmitar Mishiq”), ndihmësministër në MPB, të cilët dëshmuuan se ndryshe nga ushtria, në MPB nuk ekzistonte sistem hierarkik dhe se çdo ndihmësministër ishte në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit.⁸³⁴ Dhoma Gjyqësore konkludoi se ndihmësministrat e tjerë në RJB ishin në varësi të Gjorgjeviqit, bazuar në gradën dhe postin e tij si shef i RJB-së si dhe në dëshminë konfirmuese të Dëshmitar Vasileviqit.⁸³⁵

259. Dhoma e Apelit thekson se për nxjerrjen e konkluzionit se ndihmësministrat të cilët gjithashtu kishin një post në një nga seksionet e RJB-së ishin në varësi të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore u bazua kryesisht në rolin dhe pozitën e Gjorgjeviqit si shef i RJB-së.⁸³⁶ Në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore faktikisht shqyrtoi kuadrin ligjor organizativ të MPB-së.⁸³⁷ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore theksoi se në bazë të Nenit 54 të Provës Materiale P357 – Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të MPB-së e vitit 1997 – “drejtoritë kontrollohen prej krerëve të drejtorive”,⁸³⁸ dhe se Gjorgjeviqi si “shef i RJB-së”, ishte në kontroll të RJB-së.⁸³⁹ Bazuar në të njëjtën rregullore, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konstatoi se RJB-ja përbante disa administrata ndër të cilat Administrata e Policisë për Krime dhe Administrata Policore.⁸⁴⁰ Dhoma e Apelit gjykon se këto përfundime nuk cenohen nga ligjet shtesë të cituara nga Gjorgjeviqi në mbështetje të argumentit të tij se ndihmësministrat ishin në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit.⁸⁴¹ Në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit vëren se

⁸³¹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 11-12. Shih gjithashtu më lart, para. 180.

⁸³² Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 12.

⁸³³ Shih më lart, para. 16-17.

⁸³⁴ Aktgjykimi, para. 43.

⁸³⁵ Aktgjykimi, para. 43, përmendet Aleksandar Vasileviq, 11 qershor 2009, T. 5933, K87, 17 maj 2010, T. 14162.

⁸³⁶ Aktgjykimi, para. 43.

⁸³⁷ Shih Aktgjykimi, para. 37, 40-41; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 75-76, 78.

⁸³⁸ Aktgjykimi, para. 40, përmendet Prova Materiale P357.

⁸³⁹ Aktgjykimi, para. 40, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 1 dhjetor 2009, T. 9396-9397, Prova Materiale P357, D396, Vllastimir Gjorgjeviqi, 8 dhjetor 2009, T. 9788, 9817.

⁸⁴⁰ Aktgjykimi, para. 41.

⁸⁴¹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 75-76.

Prova Materiale P69 është pjesë e një dekreti në lidhje me “Ligji mbi Administratën Shtetërore” me datë 8 prill 1992, për të cilin Dhoma Gjyqësore gjykoi se paraqiste strukturën e MPB-së.⁸⁴² Gjorgjeviqi citon Nenin 46 të këtij dekreti ku përcaktohet se:

Në ministri emërohen ndihmësministra në krye të drejtorive të cilët kryejnë detyra të përcaktuara në dokumentin mbi organizimin dhe planifikimin e punës dhe detyra të tjera që mund t’u ngarkohen nga ministri.

Me propozim të ministrit, qeveria emëron ndihmësministra për mandate katërvjeçare dhe i liron ata nga detyra.⁸⁴³

Dhoma e Apelit thekson se kjo dispozitë nuk krijon një linjë të drejtpërdrejtë dhe të vetme raportimi ndërmjet ndihmësministrave dhe ministrave në Republikën e Serbisë. Aty përcaktohet mënyra e emërimit të ministrave dhe se ministri *mund t’u besojë detyra*. Kjo konfirmohet gjithashtu nga Prova Materiale P258 – dekret “që përcakton parimet në lidhje me gradimin dhe klasifikimin e posteve brenda ministrive dhe organizatave të posaçme” me datë 6 korrik 1994 – gjithashtu i cituar nga Gjorgjeviqi.⁸⁴⁴ Ndonëse Dhoma Gjyqësore nuk iu referua konkretisht Provës Materiale P258, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gëzonte të drejtën e një veprimi të tillë,⁸⁴⁵ duke marrë parasysh se përmbajtja e këtij dekreti pasqyron provat tashmë në dispozicion të Dhomës Gjyqësore.⁸⁴⁶ Në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit vëren se ndonëse në pikën 2 të Nenit 18 të Provës Materiale P258 parashtrahet se “ndihmësministri [...] është drejtpërsëdrejti përgjegjës para ministrit”⁸⁴⁷, në pikën 3 të Nenit 8 të së njëjtës provë materiale përcaktohet se:

kreu i një njësie organizative të brendshme jep llogari për punën e vet dhe punën e njësisë organizative që ai drejton para shefit të sektorit në të cilin bën pjesë njësi e tij organizative, me fjalë të tjera ai jep llogari para një drejtuesi ekzekutiv në krye të një organi administrativ apo të një organizate të posaçme brenda ministrisë.⁸⁴⁸

260. Si rrjedhojë, ndihmësministrat të cilët drejtonin njësi të brendshme brenda një drejtorie në çfarëdo ministrie ishin gjithashtu në varësi të shefit të sektorit ku bënte pjesë njësi që drejtonin.⁸⁴⁹ Për rastin në fjalë dhe në përputhje me çfarë përcakton neni 54 i Provës Materiale P357 dhe me konkluzionin e Dhomës Gjyqësore, drejtuesit e administratave përgjigjeshin para shefit të RJB-së, Gjorgjeviqit.⁸⁵⁰

⁸⁴² Shih Aktgjykimi, para. 37.

⁸⁴³ Prova Materiale P69, Neni 46.

⁸⁴⁴ Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 73, 75-76.

⁸⁴⁵ Shih p. sh. Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerët*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 498; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiqi dhe të tjerët*, para. 39; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 382.

⁸⁴⁶ Shih Aktgjykimi, para. 37, 40-41.

⁸⁴⁷ Prova Materiale P258, Neni 18(2).

⁸⁴⁸ Prova Materiale P258, Neni 18(3). Shih gjithashtu Prova Materiale P258, Nenet 16 dhe 17.

⁸⁴⁹ Shih Prova Materiale P258, Nenet 16-18; P357, Neni 54.

⁸⁵⁰ Prova Materiale P357, Neni 54.

261. Dhoma e Apelit vëren se fakti që Dhoma Gjyqësore u bazua në dëshminë gojore të Vasileviqit nuk luajti rol kyç në nxjerrjen e konkluzionit se tre ndihmësministrat e tjerë në RJB ishin në pozitë vartëse kundrejt Gjorgjeviqit.⁸⁵¹ Dhoma e Apelit konstaton se Dëshmitari Vasileviq, i cili ishte zëvendësshef i Sigurimit të UJ-së, ishte i pranishëm në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, dhe kishte kontakte me drejtues politikë, ushtarakë dhe të MPB-së.⁸⁵² Gjithashtu ai mori pjesë së paku në një mbledhje të Komandës së Përbashkët.⁸⁵³ Vasileviq dëshmoi se ai nuk kishte njohuri konkrete për hierarkinë komanduese ndërmjet Stevanoviqit dhe Gjorgjeviqit, e as nëse midis tyre kishte lidhje epror-vartës.⁸⁵⁴ Gjithsesi, ai dëshmoi se Gjorgjeviq ishte “numri dy në MPB”⁸⁵⁵ dhe se nga komunikimet “të gjithë [ata] e dinin se [Gjorgjeviq dhe Stevanoviq] ishin sektori i sigurimit publik i MPB-së.”⁸⁵⁶ Duke marrë parasysh pozitën e Vasileviqit, angazhimin e tij në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, dhe kontaktet e tij me politikanët e lartë dhe drejtuesit e MPB-së në atë kohë, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore veprimi në mënyrë të arsyeshme kur u mbështet në atë pjesë të dëshmisë së tij se Gjorgjeviq ishte individ i numër dy në hierarkinë e MPB-së. Gjorgjeviq nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim në këtë aspekt.

262. Në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit K87, Dhoma e Apelit vëren se ky dëshmitar konfirmon dëshminë e Dëshmitar Vasileviqit se Gjorgjeviq ishte “numri dy” në MPB, dhe se vetëm ministri kishte pozitë epreore ndaj tij.⁸⁵⁷ Më tej, Dhoma e Apelit thekson se Dëshmitari K87 ishte pjesëtar i SAJ-it (njësi e posaçme brenda RJB-së në varësi të Gjorgjeviqit),⁸⁵⁸ se ai kishte marrë pjesë në rivarrosjen e kufomave në qendrën e SAJ-it në Batajnicë, dhe se pati kontakt personal dhe të drejtpërdrejtë me Gjorgjeviqin gjatë gjithë operacioneve të rivarrosjes.⁸⁵⁹ Duke marrë parasysh faktin se Dëshmitari K87 ishte pjesëtar i SAJ-it dhe kontaktin e tij personal dhe të drejtpërdrejtë me Gjorgjeviqin gjatë kohës së Aktakuzës, Dhoma e Apelit e gjykon të arsyeshme mbështetjen prej Dhomës Gjyqësore në dëshminë e Dëshmitarit K87 sipas së cilës Gjorgjeviq ishte individ i dytë në hierarkinë e MPB-së.

263. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur për arsyeshmërinë e konkluzionit të Dhomës Gjyqësore se duke marrë parasysh pozitën e Gjorgjeviqit brenda MPB-së dhe si shef i RJB-së, ai ishte në pozitë epreore kundrejt zëvendësministrave të tjerë të cilët ishin në krye të administratave brenda RJB-së. Gjorgjeviq nuk ka arritur të provojë se konkluzioni i lartpërmendur i Dhomës Gjyqësore është i gabuar.

⁸⁵¹ Aktgjykimi, para. 43.

⁸⁵² Shih Aktgjykimi, para. 196, 237, 262, 1898,

⁸⁵³ Aktgjykimi, para. 237.

⁸⁵⁴ Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5683

⁸⁵⁵ Aleksandar Vasileviq, 11 qershor 2009, T. 5933.

⁸⁵⁶ Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5683.

⁸⁵⁷ Shih K87, 17 maj 2010, T. 14162, 14164-14165, 14172-14173, 14176-14177.

264. Përsa u përket funksioneve të ndihmësministrave Stevanoviq dhe Zekoviq, Dhoma e Apelit vëren se në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, ka prova se Zekoviqi ishte shefi i Administratës për Çështje të Përbashkëta⁸⁶⁰ dhe se Stevanoviqi ishte shefi i Administratës Policore deri më 1999.⁸⁶¹ Dhoma e Apelit gjykon se nuk është i rëndësishëm fakti nëse Stevanoviqi pati rol tjetër në MPB, përveç rolit të ndihmësministrit. Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi pozitën e Zekoviqit si vartës i Gjorgjeviqit në RJB më 1999 së bashku me faktorë të tjerë për nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviq i ishte në dijeni të fshehjes së kufomave në qendrën e PJP-së në Petrovo Sello.⁸⁶² Duke lënë mënjanë këtë aspekt, Dhoma e Apelit rikujton se u konkludua se Gjorgjeviq kishte kontribuar në NPK, jo nëpërmjet pozitës së tij kundrejt ndihmësministrave, por ndër të tjera prej faktit se ai kishte kontroll efektiv të forcave të dislokuara në Kosovë, se ai u implikua personalisht dhe drejtpërsëdrejti në dislokimin e Akrepave në Kosovë, dhe se ndërmori masa për të penguar hetimet e krimeve të kryera nga forcat nën kontrollin e tij dhe fshehjen e këtyre krimeve.⁸⁶³

265. Së fundi, Gjorgjeviq këmbëngul se kishte mbivendosje kompetencash midis kompetencave të tij dhe atyre të Zekoviqit dhe Stevanoviqit, gjë që rezultoi në kufizim të “kompetencave” të tij.⁸⁶⁴ Gjithsesi, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviq nuk identifikon ato kompetenca të Zekoviqit që ndërhyjnë në kompetencat e tij dhe si pasojë kufizuan pushtetin e tij.⁸⁶⁵ Sa për Stevanoviqin, thelbi i argumentit të Gjorgjeviqit qëndron në faktin se me krijimin e Shtabit Ministror Stevanoviqi “mori rolin praktik në terren në Kosovë në emër të ministrit” dhe se rrjedhimisht roli dhe kompetencat e Gjorgjeviqit u kufizuan.⁸⁶⁶ Sikurse u diskutua gjerësisht më lart, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviq mbeti i angazhuar dhe aktiv në Kosovë gjatë gjithë vitit 1999, edhe

⁸⁵⁸ Aktgjykimi, para. 70-77; më lart, para. 242-243.

⁸⁵⁹ Shih Aktgjykimi, para. 1325-1347.

⁸⁶⁰ Shih Vllastimir Gjorgjeviq, 1 dhjetor 2009, T. 9409-9410, 9751; Lubinko Cvetiq, 29 qershor 2009, T. 6594; Stojan Mishiq, 28 prill 2010, T. 14070; Prova Materiale P263.

⁸⁶¹ Shih Vllastimir Gjorgjeviq, 1 dhjetor 2009, T. 9409-9410; Lubinko Cvetiq, 29 qershor 2009, T. 6594; Prova Materiale P263.

⁸⁶² Shih më poshtë, Ndarja X. G. 4. (c) .

⁸⁶³ Shih më lart, para. 242-243; më poshtë, para. 304-308, 315-324, 355-362, 366-371, 378-384, 406-409, 413-415, 421-425, 428-432.

⁸⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 189.

⁸⁶⁵ Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 75, 79. Dhoma e Apelit vëren se pretendimi i Gjorgjeviqit sipas të cilit vendimi i ministrit i 4 qershorit 1997 krijoi “feude” për Zekoviqin dhe Stevanoviqin nuk konfirmohet nga provat (Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 76, përmendet Prova Materiale P263). Dhoma e Apelit thekson se pikërisht ky ishte vendimi për emërimin e Zekoviqit dhe Stevanoviqit përkatësisht në Administratën për Çështje të Përbashkëta dhe Administratën Policore të RJB-së (Shih Prova Materiale P263). Avokati i Gjorgjeviqit pranoi se përfundimet në lidhje me Zekoviqin janë shumë më të kufizuara dhe vetëm i referohet faktit se ai u implikua në fshehjen e kufomave, pa dhënë hollësi të mëtejshme (Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 79-80).

⁸⁶⁶ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 78-79. Konkretisht, Gjorgjeviq identifikon mbledhjet në vijim të Shtabit Ministror të cilat Stevanoviqi ose i kryesoi, ose dha udhëzime të hollësishme, kurse Gjorgjeviq nuk ishte as i pranishëm: (i) 21 dhjetor 1998 (Prova Materiale P1043); (ii) 4 prill 1999 (Prova Materiale P764); (iii) 7 maj 1999 (Prova Materiale P 771); dhe (iv) 11 maj 1999 (Prova Materiale P345).

pse Stevanoviqi faktikisht kryesoi disa mbledhje të Shtabit Ministror, dhe se kompetencat e Gjorgjeviqit nuk u kufizuan nga krijimi i Shtabit Ministror.⁸⁶⁷

7. Kolegjiumi Ministror

(a) Hyrje

266. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ishte anëtar i Kolegjiumit Ministror gjatë periudhës së Aktakuzës⁸⁶⁸ dhe se në mbledhjet e Kolegjiumit Ministror, anëtarët diskutuan dhe planifikuan angazhimin e MPB-së në Kosovë.⁸⁶⁹

(b) Argumentet e palëve

267. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se në mbledhjet e Kolegjiumit të Ministrisë me siguri janë diskutuar operacionet kundërterroriste.⁸⁷⁰ Gjorgjeviqi parashtron se të gjitha provat konfirmojnë se mbledhjet e Kolegjiumit Ministror thjesht ofruan informacion për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë dhe raportet përkatëse logjistike, mirëpo në këto mbledhje nuk u diskutuan plane apo raporte në lidhje me operacionet kundërterroriste.⁸⁷¹ Gjithashtu, ai pretendon se e vetmja provë shkresore ku u bazua Dhoma Gjyqësore ishte një shënim në një ditar, që nuk u pranua si provë dhe u kundërshtua nga Dëshmitar Mishiçi.⁸⁷²

268. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhej dëshmitë gojore të dëshmitarëve dhe prova shkresore për nxjerrjen e përfundimit se Kolegjiumi Ministror anëtar i të cilit ishte Gjorgjeviqi diskutoi dhe planifikoi angazhimin e MPB-së në Kosovë.⁸⁷³

(c) Analizë

269. Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi konkretisht por i konsideroi jobindëse dëshminë e Gjorgjeviqit dhe dëshminë e Dëshmitari Mishiçit se në mbledhjet e Kolegjiumit Ministror nuk u diskutua informacion për veprime luftarake kundërterroriste në Kosovë dhe se nuk u mor asnjë vendim në lidhje me sa më sipër.⁸⁷⁴ Dhoma Gjyqësore

⁸⁶⁷ Shih më lart, para. 225-230, 235-239.

⁸⁶⁸ Aktgjykimi, para. 2154.

⁸⁶⁹ Aktgjykimi, para. 103.

⁸⁷⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 159, përmendet Aktgjykimi, para. 101.

⁸⁷¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 191, përmendet Stojan Mishiçi, 27 prill 2010, T. 14032, 14040, 14053-14054, Stojan Mishiçi, 28 prill 2010, T. 14087-14090, 14094-14096, Sllobodan Spasiçi, 18 maj 2010, T. 14196-14198,

14230-14231, 14241-14242. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 56.

⁸⁷² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 192, përmendet Aktgjykimi, para. 102, Stojan Mishiçi, 28 prill 2010, T. 14099-14100.

⁸⁷³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 152.

⁸⁷⁴ Aktgjykimi, para. 100-101. Në lidhje me Dëshmitar Sllobodan Spasiçin ("Dëshmitar Spasiçi"), Dhoma e Apelit thekson se në Aktgjykimin e vet, Dhoma Gjyqësore nuk u mbështet në dëshminë e tij gojore, por në

konkludoi se e gjykonte “të pabesueshëm” faktin që Kolegjiumi Ministror të mos kishte diskutuar apo marrë vendime në lidhje me situatën në Kosovë në vitet 1998-1999, duke mbajtur parasysh se ishte “çështja më urgjente e sigurisë me të cilën ballafaqoheshin MPB-ja dhe Serbia në atë kohë”.⁸⁷⁵ Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dëshminë gojore të Dëshmitar Mishiqit i cili në kundërshti me pretendime të tjera të tij, dëshmoi se: (i) në disa mbledhje të Kolegjiumit Ministror ata analizuan “gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe kërkuan zgjidhje”; (ii) në një mbledhje të Kolegjiumit, ministri deklaroi se ishte krijuar një Shtab Ministror “për të trajtuar më mirë problemin e terrorizmit”; dhe (iii) një nga prioritetet gjatë mbledhjeve të Kolegjiumit Ministror ishte situata në Kosovë dhe Metohi dhe kërkesat për të ndihmuar forcat policore atje.⁸⁷⁶

270. Dhoma Gjyqësore arsyetoi se për të bërë vlerësimin e duhur të kërkesave për njësi shtesë, për përforcime, për zëvendësimin e njësive dhe të personelit, për pajisje shtesë apo pajisje të reja për njësitë, anëtarët e Kolegjiumit Ministror duhej të kishin dijeni për operacionet për të cilat i merrnin kërkesat.⁸⁷⁷ Dhoma Gjyqësore e gjykoi të pabesueshme që MPB-ja të kishte aq shumë njerëz, përfshirë njësi kyçe, të angazhuara rregullisht në Kosovë së bashku me ushtrinë dhe Kolegjiumi Ministror të mos ishte i përfshirë apo të mos kishte dijeni për këto veprime.⁸⁷⁸ Së fundi, Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranoi se Kolegjiumi Ministror nuk merrej me planifikimin e hollësishëm të operacioneve konkrete sepse këtë punë e bënte Shtabi i MPB-së në Prishtinë.⁸⁷⁹ Duke marrë parasysh këta faktorë, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si të Dhomës Gjyqësore dhe për këtë arsye nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në nxjerrjen e përfundimit se gjatë mbledhjeve të Kolegjiumit Ministror u diskutuan operacionet kundërterroriste.

271. Në lidhje me pretendimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore u bazua në dokumentacion që nuk ishte pranuar ndër provat, Dhoma e Apelit vëren se dokumentacioni në fjalë përbëhej nga shënime të mbajtura nga një mbledhje e Kolegjiumit Ministror më 14 shkurt 1999 ku ndër të tjerë morën pjesë Gjorgjeviqi, Markoviqi dhe Dëshmitar Mishiqi, gjatë së cilës

dëshminë gojore të Dëshmitar Mishiqit, i cili ishte ndihmësmiester në MPB dhe epror i drejtpërdrejtë i Dëshmitar Spasiqit (Shih Sllobodan Spasiq, 18 maj 2010, T. 14187). Dhoma e Apelit citon konstatimin e Dhomës Gjyqësore se kishte “mospërputhje të dukshme” midis dëshmive të dëshmitarëve të Mbrojtjes në lidhje me aspektin nëse ishin diskutuar operacione kundërterroriste (Aktgjykimi, para. 100), dhe faktin se prej dëshmisë së Dëshmitar Spasiqit rezultoi se ai mund të mos ketë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e MPB-së (“në mbledhjet e Kolegjiumit ku mora pjesë nuk u diskutuan [operacione kundërterroriste]”, Sllobodan Spasiq, 18 maj 2010, T. 12231). Për këtë arsye Dhoma e Apelit gjykon se ishte në të drejtën e Dhomës Gjyqësore që të mos bazohej në dëshminë e Dëshmitar Spasiqit.

⁸⁷⁵ Aktgjykimi, para. 101.

⁸⁷⁶ Aktgjykimi, para. 101.

⁸⁷⁷ Aktgjykimi, para. 101.

⁸⁷⁸ Aktgjykimi, para. 101.

⁸⁷⁹ Aktgjykimi, para. 103.

u diskutua nevoja e përgatitjes së një reagimi kundër një sulmi të afërt të NATO-s.⁸⁸⁰ Këto shënime iu treguan Dëshmitar Mishiqit gjatë dëshmisë së tij në fazën e gjykimit, dhe ai mohoi se kishte marrë pjesë në ndonjë mbledhje të tillë dhe madje vuri në pikëpyetje edhe mbajtjen e kësaj mbledhjeje.⁸⁸¹ Dhoma Gjyqësore theksoi se ndonëse shënimet nuk ishin ndër provat, “mendime shumë të ngjashme” të përshkruara në këto shënime, u evidentuan në procesverbalin e një mbledhjeje të Shtabit Ministror në Prishtinë më 17 shkurt 1999 dhe në një mbledhje tjetër që ishte planifikuar të mbahej më 20 shkurt 1999.⁸⁸² Në të dy mbledhjet u diskutua dislokimi dhe angazhimi afërsisht i 5.000 policëve.⁸⁸³ Dhoma Gjyqësore gjykoi se provat në lidhje me këto mbledhje shtesë, konkretisht procesverbali i mbledhjes së Shtabit Ministror të 17 shkurtit 1999,⁸⁸⁴ treguan “tërësisht masën” e përfshirjes së anëtarëve të Kolegjiut Ministror në planifikimin dhe shqyrtimin e operacioneve të MPB-së në Kosovë.⁸⁸⁵ Gjithashtu [Dhoma Gjyqësore] u bazua në këto prova për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitar Mishiqit sipas të cilit, ai nuk kishte dijeni për një plan të RJB-së për parandalimin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.⁸⁸⁶ Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore u bazua në dëshminë gojore të Dëshmitar Mishiqit mbi shënimet e mbledhjes së Kolegjiut Ministror të 14 shkurtit 1999 për të vlerësuar besueshmërinë e tij, dhe jo për të verifikuar vërtetësinë e këtyre shënimeve.⁸⁸⁷ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi i shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore nëpërmjet pretendimit të tij se [Dhoma Gjyqësore] u bazua në material që nuk ishte ndër provat për nxjerrjen e konkluzionit se në mbledhjet e Kolegjiut Ministror u diskutuan dhe u planifikuan operacione kundërterroriste.

8. Marrëveshjet e Tetorit

(a) Hyrje

272. Dhoma Gjyqësore konkludoi se roli i Gjorgjeviqit në negociatat që çuan në Marrëveshjet e Tetorit tregon se ai ushtronte kontroll efektiv mbi forcat policore në Kosovë

⁸⁸⁰ Aktgjykimi, para. 102.

⁸⁸¹ Aktgjykimi, para. 102.

⁸⁸² Aktgjykimi, para. 102.

⁸⁸³ Aktgjykimi, para. 102, përmendet Prova Materiale P85, Stojan Mishiq, 28 prill 2010, T. 14104-14105. Duke u bazuar në përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së 17 shkurtit 1999 ku u diskutua edhe për dislokimin në të ardhmen afërsisht të 4000 policëve, 70 policëve të grupit operativ dhe rreth 900 rezervistëve, Dhoma Gjyqësore e konsideroi të pabesueshëm Dëshmitar Mishiqin kur ai deklaroi se nuk kishte dijeni për ndonjë plan të RJB-së për parandalimin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë (Aktgjykimi, para. 102, përmendet Stojan Mishiq, 28 prill 2010, T. 14099-14100).

⁸⁸⁴ Aktgjykimi, para. 102, përmendet Prova Materiale P85.

⁸⁸⁵ Aktgjykimi, para. 102.

⁸⁸⁶ Aktgjykimi, para. 102.

⁸⁸⁷ Shih Aktgjykimi, para. 101-102.

dhe ishte edhe një provë më shumë se atij nuk iu hoq pushteti mbi forcat e MPB-së, nga vendimi i 16 qershorit 1998 për krijimin e Shtabit Ministror.⁸⁸⁸

(b) Argumentet e palëve

273. Gjorgjeviqi argumenton se pjesëmarrja e tij në negociatat që çuan në Marrëveshjet e Tetorit më 1998 nuk mund të shërbejë si dëshmi e kontrollit efektiv prej tij sepse vendimet e tij në këto mbledhje nuk ishin absolute dhe ai ishte vetëm një ndër anëtarët e autorizuar për të nënshkruar në emër të një delegacioni të Republikës së Serbisë.⁸⁸⁹ Gjithashtu, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk analizoi synimin e RFJ-së gjatë negociatave për Marrëveshjet e Tetorit, i cili ishte zgjidhja paqësore e krizës në Kosovë.⁸⁹⁰

274. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin e arsyeshëm se roli drejtues i Gjorgjeviqit në negociatat për Marrëveshjet e Tetorit tregoi se ai ishte përgjegjës për njësitë në Kosovë, se kishte njohuri të hollësishme të gjendjes në terren, dhe se ishte plotësisht i informuar për veprimtarinë e forcave të MPB-së.⁸⁹¹

(c) Analizë

275. Dhoma e Apelit nuk i pranon parashtrimet e Gjorgjeviqit në lidhje me Marrëveshjet e Tetorit. Në kundërshtim me sugjerimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se pjesëmarrja e tij në negociatat e Marrëveshjeve të Tetorit “përbënte pasjen e kontrollit në periudhën e incidenteve të Aktakuzës”, me fjalë të tjera më 1999.⁸⁹² Dhoma Gjyqësore konkludoi se pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në negociatat e Marrëveshjeve të Tetorit tregoi kontrollin e tij efektiv mbi forcat policore në fund të vitit 1998.⁸⁹³ Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, [Dhoma Gjyqësore] theksoi se Gjorgjeviqi mund të jepte zotime në emër të Republikës së Serbisë për tërheqjen e forcave policore, si dhe të negocionte për ngritjen e një sërë pikash vëzhgimi dhe vendndodhjet konkrete të tyre.⁸⁹⁴ Gjithashtu u konkludua se këto fakte gjithashtu zbuluan se krijimi i Shtabit Ministror nuk i hoqi atij pushtetin mbi forcat policore në Kosovë dhe operacionet e tyre dhe se ai kishte njohuri të hollësishme “për situatën në terren, për forcat e MPB-së në Kosovë në vitin 1998, dhe për nevojat strategjike dhe problemet e këtyre forcave”.⁸⁹⁵ Dhoma Gjyqësore gjykoi se ky ishte tregues i kontrollit efektiv të Gjorgjeviqit mbi forcat policore në aspektin se ai mund të vendoste për “dislokimin,

⁸⁸⁸ Aktgjykimi, para. 1917.

⁸⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 193. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 58.

⁸⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 193.

⁸⁹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 155.

⁸⁹² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 193.

⁸⁹³ Aktgjykimi, para. 1916-1917.

⁸⁹⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1916-1917.

⁸⁹⁵ Aktgjykimi, para. 1917-1918.

tërheqjen, lëvizjen dhe funksionimin operativ të tyre në Kosovë”.⁸⁹⁶ Mirëpo [Dhoma Gjyqësore] nuk e bazoi konkluzionin e vet mbi kontrollin efektiv të Gjorgjeviqit ndaj forcave të MPB-së më 1999, vetëm në rolin e tij gjatë negociatave të Marrëveshjeve të Tetorit. Sikurse është analizuar gjerësisht në një pjesë tjetër të Aktgjykimit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh edhe faktorë të tjerë si: (i) aftësinë e tij për dërgimin e njësive të PJP-së gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës; (ii) autorizimin e tij për inkuadrimin e paraushtarakëve dhe vullnetarëve në SAJ gjatë periudhës së Aktakuzës; dhe (iii) faktin se shefat e SPB-së i raportonin atij.⁸⁹⁷ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka mundur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi në vlerësimin e rolit të tij në negociatat që çuan në Marrëveshjet e Tetorit në fund të vitit 1998.

276. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore u tregua e kujdesshme në nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me rolin e Gjorgjeviqit gjatë negociatave të Marrëveshjeve të Tetorit.⁸⁹⁸ Faktikisht, Dhoma Gjyqësore nuk shkoi deri atje sa të konkludonte se *vetë* roli i tij përbënte kontroll efektiv mbi forcat e MPB-së në Kosovë më 1999. Dhoma Gjyqësore e analizoi rolin e Gjorgjeviqit në Marrëveshjet e Tetorit në fund të vitit 1998 së bashku me faktorë të tjerë të identifikuar për të verifikuar nëse ai veproi me synimin e nevojshëm për realizimin e NPK-së.⁸⁹⁹

277. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore veproi brenda kompetencave të veta dhe veproi në mënyrë të arsyeshme kur u bazua në rolin dhe përgjegjësitë e Gjorgjeviqit gjatë negociatave të Marrëveshjeve të Tetorit si tregues të kontrollit të tij efektiv mbi forcat policore.

9. Konkluzion

278. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht nënpikën 9(A) të apelit të Gjorgjeviqit.

B. Nën-pika 9(B): pretendim për gabime të Dhomës Gjyqësore në vlerësimin e Komandës së Përbashkët dhe rolit të Gjorgjeviqit në të

1. Hyrje

279. Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se Komanda e Përbashkët u formua në bazë të një urdhri të Presidentit Millosheviq në qershor 1998,⁹⁰⁰ filloi të funksiononte më 22 korrik

⁸⁹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1917.

⁸⁹⁷ Shih më lart, para. 242-243, 247-252; më poshtë, para. 355-362, 366-371; Aktgjykimi, para. 2173.

⁸⁹⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1916-1917.

⁸⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1916-1919, 2154-2158.

⁹⁰⁰ Aktgjykimi, para. 230.

1998⁹⁰¹ dhe “funksionoi për rreth një vit, me anë të vendimeve dhe veprimeve të niveleve më të larta politike, ushtarake dhe policore, për të bashkërenduar dhe komanduar bashkërisht operacionet e UJ-së federale dhe MPB-së në rang republike me disa forca të tjera gjatë zbatimit të masave kundërterroriste dhe mbrojtëse në Kosovë”.⁹⁰² Dhoma Gjyqësore konstatoi se “ndonëse fundi i tetorit shënoi përfundimin e fazës së parë të punës së Komandës së Përbashkët, u mor vendimi që Komanda e Përbashkët të vazhdonte të funksiononte si mënyra më e efektshme për bashkërendimin e operacioneve të UJ-së dhe MPB-së”⁹⁰³ dhe se provat konfirmuan se Komanda e Përbashkët funksionoi “së paku deri më 1 qershor 1999”.⁹⁰⁴ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ishte anëtar i këtij organi si përfaqësues i RJB-së.⁹⁰⁵

2. Argumentet e palëve

280. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin e gabuar se gjatë periudhës së Aktakuzës ai ishte anëtar i Komandës së Përbashkët dhe se gabo i bazua në anëtarësinë e lartpërmendur si tregues i pjesëmarrjes së tij në NPK.⁹⁰⁶

281. Konkretisht, Gjorgjeviqi pretendon se konkluzioni se ai ishte anëtar i Komandës së Përbashkët bazohet tërësisht në “shënimet e mbajtura gjatë verës së vitit 1998”, në një kohë që “provat mbi anëtarësinë e ardhme në Komandën e Përbashkët nuk ishin të mjaftueshme”.⁹⁰⁷ Gjorgjeviqi argumenton se prania e tij vetëm në një mbledhje të Komandës së Përbashkët më 1 qershor 1999 nuk mund të provojë anëtarësinë dhe rolin e tij në funksionimin e këtij organi gjatë periudhës së Aktakuzës.⁹⁰⁸ Gjorgjeviqi gjithashtu pretendon se Komanda e përbashkët vepronte nga zona e Prishtinës, mirëpo ai shkoi në Kosovë vetëm pak herë.⁹⁰⁹ Gjorgjeviqi gjithashtu sugjeron se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh si duhej 16 urdhrat me emërtimin “Komanda e Përbashkët për KM-në” (“16 Urdhrat”) të protokolluar në regjistrin e Korpusit të Prishtinës dhe një ndryshim të urdhrat të Komandës së Përbashkët me datë 22 mars 1999 nënshkruar nga komandanti i Korpusit të Prishtinës.⁹¹⁰ Sipas tij këto prova tregojnë se “provat nuk ofronin asnjë bazë për konkluzionin se Gjorgjeviqi luajti rol në funksionimin e Komandës

⁹⁰¹ Aktgjykimi, para. 230.

⁹⁰² Aktgjykimi, para. 231.

⁹⁰³ Aktgjykimi, para. 233.

⁹⁰⁴ Aktgjykimi, para. 236.

⁹⁰⁵ Aktgjykimi, para. 239, përmendet Prova Materiale P886, f. 2, Lubinko Cvetiq, 30 qershor 2009, T. 6627-6628, Millan Gjakoviq, 17 gusht 2009, T. 7880.

⁹⁰⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 195-201. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 59.

⁹⁰⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 197, përmendet Aktgjykimi, para. 233, 238-239, Prova Materiale P87, f. 12-15.

⁹⁰⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 200, përmendet Aktgjykimi, para. 1925. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 61.

⁹⁰⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 199. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 59.

⁹¹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 198, përmendet Aktgjykimi, para. 236, 241, sh. 837, Millan Gjakoviq, 17 gusht 2009, T. 7945-7946, Millan Gjakoviq, 19 gusht 2009, T.8067-8068, Prova Materiales D104, D105.

së Përbashkët gjatë periudhës së Aktakuzës.”⁹¹¹ Së fundi, ai argumenton se Komanda e Përbashkët ishte “kompetencë e Presidentit të RFJ-së”.⁹¹² Rrjedhimisht, “nuk mund të nxirrej deduksion për parregullsi”, dhe në fund të fundit Dhoma Gjyqësore konkludoi se anëtarësia në “Komandën e Përbashkët nuk ishte baras me anëtarësi në NPK”.⁹¹³

282. Prokuroria përgjigjet se kjo nënpikë e apelit duhet të rrëzohet menjëherë sepse Gjorgjeviqi thjesht përsërit parashtrime të cilat u rrëzuan gjatë gjykimit, pa identifikuar gabim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore.⁹¹⁴ Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi me kujdes të gjashtëmbëdhjetë urdhrat dhe arriti në përfundimin e arsyeshëm se urdhrat zbulonin se Komanda e Përbashkët luajti rol qendror në planifikimin dhe komandimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së gjatë periudhës së Aktakuzës.⁹¹⁵ Gjithashtu, Prokuroria citon urdhra të tjerë ushtarakë të asaj kohe si konfirmim të rolit të Komandës së Përbashkët.⁹¹⁶ Së fundi, Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi shpërfill provat përkatëse që konfirmojnë përfundimin se ai ishte anëtar i Komandës së Përbashkët dhe pjesëmarrës në NPK.⁹¹⁷

3. Analizë

283. Së pari, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi nuk kundërshton faktin se ai ishte anëtar aktiv i Komandës së Përbashkët më 1998,⁹¹⁸ e as apelon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se Komanda e Përbashkët vijoi funksionimin së paku deri më 1 qershor 1999.⁹¹⁹ Përfundimi i fundit ka lidhje me përfundimin e Dhomës Gjyqësore mbi vijimin e anëtarësisë së Gjorgjeviqit në Komandën e Përbashkët. Për nxjerrjen e përfundimeve të veta, Dhoma Gjyqësore u bazua në: (i) procesverbalet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët në tetor 1998,⁹²⁰ ku mori pjesë Gjorgjeviqi,⁹²¹ gjatë të cilave u shprehën mendime në lidhje me vijimin e ekzistencës së Komandës së Përbashkët;⁹²² (ii) mbështetjen prej President Millosheviqit të

⁹¹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 198, përmendet Aktgjykimi, para. 236, 241, sh. 837, Millan Gjakoviç, 17 gusht 2009, T. 7945-7946, Millan Gjakoviç, 19 gusht 2009, T. 8067-8068, Prova Materiales D104, D105.

⁹¹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 196, përmendet Aktgjykimi, para. 231, 252. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 60. Krahaso Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 158.

⁹¹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 196. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 60.

⁹¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 157, 159-160.

⁹¹⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 161, përmendet Aktgjykimi, para. 236.

⁹¹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 161, përmendet Aktgjykimi, para. 236.

⁹¹⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 162.

⁹¹⁸ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ishte i pranishëm thuajse në të gjitha mbledhjet e shpeshta të këtij organi më 1998 dhe se gjatë këtyre mbledhjeve, ai dha informacion të aktualizuar për operacionet dhe/ose udhëzime të hollësishme mbi masat që do të merreshin (Shih Aktgjykimi, para. 239, 244, 247, 249, 1901-1902, 1904. Shih gjithashtu Prova Materiale P886).

⁹¹⁹ Aktgjykimi, para. 231, 233-236. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 237.

⁹²⁰ Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P87, P886.

⁹²¹ Prova Materiales P886, f. 137, 140 (Nuk evidentohet se Gjorgjeviqi ka munguar); P87, f. 1. Dhoma e Apelit thekson se ashtu si në rastin e anëtarëve të tjerë, mungesa e Gjorgjeviqit evidentohet konkretisht gjatë një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët (Shih Prova Materiale P886).

⁹²² Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P87, P886. Më 26 tetor 1998, Shainoviçi deklaroi se “duhet të mbyllet kjo pjesë e operacioneve luftarake” (Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P886,

“propozimit për vijimin e statusit të Komandës së Përbashkët”;⁹²³ (iii) një mbledhje të Shtabit të MPB-së më 5 nëntor 1998, ku mori pjesë Gjorgjeviqi gjatë së cilës Presidenti Millan Millutinoviç bëri një përmbledhje të vendimeve të marra dhe deklaroi se “përsa i përket Ushtrisë së Jugosllavisë dhe policisë, çdo gjë do të mbetet ashtu si deri tani (komanda e përbashkët, njësitë e UJ-së nuk do të tërhiqen kurse forcet policore janë zvogëluar vetëm duke hequr numrin e forcave që tashmë janë tërhequr)”;⁹²⁴ (iv) procesverbalin e Kolegjiumit të UJ-së së 21 janarit 1999 që evidenton komentin e gjeneral Ojdaniqit se operacioni i Reçakut ishte urdhëruar nga Komanda e Përbashkët;⁹²⁵ (v) 16 Urdhrat për operacione luftarake në Kosovë të lëshuara gjatë periudhës së Aktakuzës;⁹²⁶ (vi) raporte luftarake nga periudha e Aktakuzës që tregonin se detyrat merreshin në bazë të vendimeve të Komandës së Përbashkët;⁹²⁷ dhe (vii) dëshminë e Dëshmitar Vasileviqit për një mbledhje të Komandës së Përbashkët në Prishtinë më 1 qershor 1999, gjatë së cilës ai mbajti shënime të hollësishme dhe në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe Gjorgjeviqi.⁹²⁸

284. Gjithashtu, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi luajti rol drejtues në operacionin e Reçakut në janar të vitit 1999 i cili u urdhërua nga Komanda e Përbashkët,⁹²⁹ dhe se ai mori pjesë në mbledhje të Komandës së Përbashkët deri në qershor 1999.⁹³⁰ Dhoma e Apelit gjykon se pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në këtë mbledhje është me rëndësi për të vërtetuar vijimin e anëtarësisë së tij në Komandën e Përbashkët pas vitit 1998 (dhe gjatë tërë periudhës së Aktakuzës), veçanërisht nëse shqyrtohet brenda të njëjtit kontekst me provat e pjesëmarrjes së tij në operacionet dhe mbledhjet e mëhershme të Komandës së Përbashkët. Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi ishte anëtar aktiv i Komandës së Përbashkët gjatë tërë periudhës së Aktakuzës. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se provat e cituara nga Dhoma Gjyqësore tregojnë qartësisht se Dhoma

f. 139). Më 28 tetor 1998, është evidentuar një deklaratë e Millomir Miniçit se “kjo komandë duhet të mbetet e pandryshuar dhe të vijojë të punojë deri në fund të vitit duke u mbledhur sipas nevojës” (Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P886, f. 142). Më 29 tetor 1998, sipas provave Shainoviçi propozoi rivlerësimin e përbërjes së Komandës së Përbashkët (Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P87, f. 13).

⁹²³ Aktgjykimi, para. 233, përmendet Prova Materiale P87, f. 12.

⁹²⁴ Aktgjykimi, para. 234, përmendet Prova Materiale P770, f. 4.

⁹²⁵ Aktgjykimi, para. 236, përmendet Prova Materiale P902, f. 11.

⁹²⁶ Aktgjykimi, para. 236, përmendet Prova Materiale P973, D104, P972, P350, P971, P970, P1235, P1382, P766, P1383, P1384, P1385, P969, P767, P1386, D105. Shih më poshtë, para. 286.

⁹²⁷ Aktgjykimi, para. 236, përmendet Prova Materiale P1393, f. 2, P1394, f. 2.

⁹²⁸ Aktgjykimi, para. 237, përmendet Aleksandar Vasileviç, 8 qershor 2009, T. 5691-5696, Prova Materiale P885. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 235.

⁹²⁹ Aktgjykimi, para. 236, përmendet Prova Materiale P902, f. 11. Veçanërisht, Dhoma e Apelit thekson se në lidhje me ngjarjet në Reçak, më tej në këtë Aktgjykimi ka konfirmuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi luajti rol drejtues në këtë operacion të urdhëruar nga Komanda e Përbashkët (Shih më poshtë, para. 349).

⁹³⁰ Aktgjykimi, para. 237. Dhoma e Apelit vë në dukje se argumenti i tij se prania e tij në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 1 qershorit 1999, nuk vërteton anëtarësinë e tij në Komandën e Përbashkët, është përsëritje e argumenteve të ngritura nga Gjorgjeviqi gjatë procesit gjyqësor (Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 461). Gjithsesi, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se pse Dhoma Gjyqësore veprroi në mënyrë të paarsyeshme që e shqyrtoi këtë faktor gjatë analizës së anëtarësisë së Gjorgjeviqit në Komandën e Përbashkët.

Gjyqësore në kundërshtim me argumentin e Gjorgjeviqit nuk u bazua vetëm në “shënimet e mbajtura gjatë verës së vitit 1998” për nxjerrjen e konkluzionit mbi vijimin e pjesëmarrjes së tij në Komandën e Përbashkët edhe më 1999.⁹³¹

285. Gjithashtu, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës pretendimin e Gjorgjeviqit se nuk është e mundshme që ai të ketë qenë anëtar i Komandës së Përbashkët më 1999 duke qenë se selia e saj ishte në Prishtinë dhe ai shkoi në Kosovë më 1999 vetëm “pak herë”.⁹³² Edhe sikur prania e tij në Kosovë të ketë qenë e rrallë, Dhoma e Apelit nuk gjen arsye se si një fakt i tillë do ta bënte të paarsyeshëm konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi anëtarësinë e tij në Komandën e Përbashkët duke marrë parasysh tërësinë e provave ku u mbështet Dhoma Gjyqësore. Për më tepër, Dhoma e Apelit rikujton se tashmë ka arritur në konkluzionin se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi mbeti i angazhuar dhe aktiv në Kosovë më 1999, është i arsyeshëm.⁹³³

286. Në lidhje me 16 Urdhrat, Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi përsërit argumente të ngritura gjatë gjykimit, konkretisht se urdhrat u lëshuan nga Korpusi i Prishtinës dhe jo nga Komanda e Përbashkët.⁹³⁴ Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi konkretisht pretendimin e Gjorgjeviqit se Komanda e Përbashkët nuk ishte në gjendje të nxirrte urdhra të cilin nuk e pranoi dhe pas një analize të hollësishme të provave arriti në përfundimin se “Komanda e Përbashkët ishte një organ që lëshonte rregullisht urdhra gjatë periudhës së Aktakuzës”.⁹³⁵ Parashtrimi i Gjorgjeviqit se herë pas here urdhrat protokolloheshin në regjistrin e Korpusit të Prishtinës as nuk zhvlerëson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Komanda e Përbashkët lëshoi urdhra për përdorimin e koordinuar të forcave të UJ-së dhe të MPB-së për kryerjen e operacioneve luftarake kundër fshatrave konkrete,⁹³⁶ e as nuk i jep përgjigje përfundimit tjetër të Dhomës Gjyqësore mbi operacione si ai i Reçakut urdhëruar nga Komanda e Përbashkët.⁹³⁷ Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore vuri në dukje se përpilimin e urdhrave të Komandës së Përbashkët zakonisht e bënte UJ-ja,⁹³⁸ dhe se komanda operative u lihej njësisë në terren.⁹³⁹ Dhoma Gjyqësore nuk citoi konkretisht dëshminë e Dëshmitarit Millan Gjakoviç (“Dëshmitar Gjakoviç”) sipas të cilit urdhrat protokolloheshin në regjistrin e Korpusit të Prishtinës dhe se ndryshimi në urdhrin e Komandës së Përbashkët të 22 marsit 1999 u nënshkrua nga Llazareviqi, komandant i Korpusit të Prishtinës. Gjithsesi Dhoma

⁹³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 197.

⁹³² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 199.

⁹³³ Shih më lart, para. 235-239.

⁹³⁴ Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 462. Shih gjithashtu Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 322-327.

⁹³⁵ Aktgjykimi, para. 243. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 241, 242, 244-251.

⁹³⁶ Aktgjykimi, para. 241. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 236.

⁹³⁷ Aktgjykimi, para. 236.

⁹³⁸ Aktgjykimi, para. 254.

⁹³⁹ Aktgjykimi, para. 250, 254, 948.

e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore e mori parasysh rolin e Korpusit të Prishtinës në konkluzionin e vet se urdhrat lëshoheshin nga Komanda e Përbashkët.⁹⁴⁰ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore as e pranoi, as e gjykoi të besueshme dëshminë e Dëshmitar Gjakoviqit në lidhje me problemin e Komandës së Përbashkët dhe mundësisë së saj për nxjerrjen e urdhrave.⁹⁴¹ Dhoma Gjyqësore u shpreh se kishte “përshtypjen se ai u mundua të minimizonte natyrën dhe rolin e Komandës së Përbashkët”.⁹⁴² Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të identifikojë asnjë gabim në analizën e 16 Urdhrave prej Dhomës Gjyqësore.⁹⁴³

287. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte mundur të konkludonte se gjatë periudhës së Aktakuzës, ai ishte anëtar i Komandës së Përbashkët.

288. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të gabuar e përdori anëtarësinë e tij në Komandën e Përbashkët si tregues të pjesëmarrjes së tij në NPK,⁹⁴⁴ Dhoma e Apelit nënvizon se Dhoma Gjyqësore formuloi përfundimin konkret se “ndërsa Komanda e Përbashkët mund të ketë ndihmuar zbatimin e planit të përbashkët, kjo nuk do të thotë që të gjithë anëtarët e saj domosdoshmërisht ishin anëtarë të NPK-së apo se ata synonin krimet e kryera në përputhje me këtë plan.”⁹⁴⁵ Me fjalë të tjera, Dhoma Gjyqësore nuk e përktheu anëtarësinë e Gjorgjeviqit në Komandën e Përbashkët në pjesëmarrje në NPK. Gjatë shqyrtimit të pretendimit për pjesëmarrje të tij në NPK, [Dhoma Gjyqësore] mori parasysh anëtarësinë e tij si edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm.⁹⁴⁶ Pasi tashmë ka konkluduar se Dhoma Gjyqësore nuk gabo i kur konkludoi se Gjorgjeviqi ishte anëtar i Komandës së Përbashkët, Dhoma e Apelit gjykon se ky ishte një faktor i arsyeshëm që duhej marrë parasysh gjatë shqyrtimit të pretendimit për pjesëmarrje të tij në NPK.

289. Së fundi, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori një deduksion të gabuar për parregullsi bazuar në faktin se struktura ligjore e RFJ-së dhe e Republikës së Serbisë nuk ofronin bazë ligjore për ekzistencën e Komandës së Përbashkët.⁹⁴⁷ Sipas Dhomës së Apelit, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore e përdori në mënyrë të gabuar këtë përfundim si provë të

⁹⁴⁰ Shih Millan Gjakoviq, 17 gusht 2009, T. 7945-7946; Prova Materiale D104 (Urdhër i Komandës së Përbashkët i 22 marsit 1999); D105 (ndryshim në Urdhrin e Komandës së Përbashkët të 22 marsit 1999), f. 5. Gjithashtu, në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit rikujton se përveçse Dhoma Gjyqësore gëzon kompetencë të gjerë në vlerësimin e provave, gjithashtu Dhoma nuk është e detyruar të shpjegojë çdo pikë të arsyetimit ose të rendisë çdo provë gjatë nxjerrjes së përfundimeve të veta (Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 27; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 21. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 481; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 115).

⁹⁴¹ Aktgjykimi, para. 243. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 242.

⁹⁴² Aktgjykimi, para. 243. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 242.

⁹⁴³ Shih Aktgjykimi, para. 236, 241-252, 254, dhe provat e cituara atje.

⁹⁴⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 201.

⁹⁴⁵ Aktgjykimi, para. 2124. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 196, 201.

⁹⁴⁶ Shih Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2051, 2126-2128.

⁹⁴⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 196.

ekzistencës së NPK-së ndonëse krijimi i Komandës së Përbashkët ishte thjesht një masë presidenciale për bashkërendim midis MPB-së dhe UJ-së.⁹⁴⁸ Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Komanda e Përbashkët nuk ishte një organ i paraparë në Kushtetutën e RFJ-së, apo të Serbisë. Struktura ligjore e RFJ-së mbi bazë të së cilës funksiononte UJ-ja, dhe struktura ligjore e Serbisë mbi bazë të së cilës funksiononte MPB-ja, dallonin dukshëm prej njëra-tjetrës. Nuk ekzistonte asnjë bazë ligjore për një Komandë të Përbashkët të UJ-së dhe të MPB-së.⁹⁴⁹

290. Dhoma e Apelit gjykon se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore duhet lexuar duke mbajtur parasysh argumentin e Gjorgjeviqit gjatë gjykimit se ekzistenca e Komandës së Përbashkët nuk ishte e mundur për arsye se nuk ishte e paraparë në strukturën ligjore të RFJ-së ose Serbisë.⁹⁵⁰ Dhoma Gjyqësore e gjykoi jobindës këtë argument dhe konkludoi se “megjithëse nuk parashikohej prej kushtetutave dhe sistemeve ligjore të atëhershme, Komanda e Përbashkët u krijua” dhe se “kufizimet e strukturave ekzistuese ligjore nuk u morën parasysh dhe u shkelën prej atyre që ishin në majën më të lartë të pushtetit, në përpjekjet e tyre për realizimin e qëllimeve të dëshiruara politike dhe shoqërore”.⁹⁵¹ Gjithashtu u konkludua se: “nevoja diktoi formimin e Komandës së Përbashkët si një masë e jashtëzakonshme e marrë nga Presidenti së bashku me udhëheqjen politike dhe atë të UJ-së dhe MPB-së për të mundur gjatë periudhës së krizës, mjete më të efektshme për zbatimin e planit të udhëheqjes serbe për Kosovën.”⁹⁵² Dhoma e Apelit konkludon se ishte e drejtë e Dhomës Gjyqësore të arrinte në konkluzionin se Komanda e Përbashkët ishte një masë e jashtëzakonshme për realizimin e objektivave të udhëheqjes serbe dhe gjithashtu ishte e drejtë e Dhomës Gjyqësore që të bazohej në të ndërmjet faktorëve të tjerë për të deduktuar se një shumësi personash bashkëpunuan për realizimin e qëllimit të përbashkët të NPK-së. Dhoma e Apelit konkludon se argumenti i Gjorgjeviqit nuk merr parasysh kontekstin konkret të përfundimeve të Dhomës Gjyqësore.⁹⁵³ Për këtë arsye, ky argument hidhet poshtë.

4. Konkluzion

291. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht nënpikën 9(B) të apelit të Gjorgjeviqit.

⁹⁴⁸ Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 60.

⁹⁴⁹ Aktgjykimi, para. 231.

⁹⁵⁰ Shih Aktgjykimi, para. 231. Shih gjithashtu Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 38-41, 298-299.

⁹⁵¹ Aktgjykimi, para. 231. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 242, 252, 2124.

⁹⁵² Aktgjykimi, para. 252.

⁹⁵³ Shih Aktgjykimi, para. 2008, 2036-2051. Shih gjithashtu më lart, para. 90-109, 116-120, 127-130, 138-147, 153-159, 179-193, 198-208.

C. Nënpika 9(C): pretendim për gabime në lidhje me veprimet e Gjorgjeviqit më 1998 si bazë për fajësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale për krime të kryera më 1999

1. Hyrje

292. Dhoma Gjyqësore konkludoi se NPK-ja e formuar ndërmjet udhëheqësve të lartë politikë, ushtarakë dhe të policisë, filloi ekzistencën jo më vonë se janari 1999.⁹⁵⁴ Gjatë nxjerrjes së konkluzioneve mbi ekzistencën e NPK-së dhe përgjegjësisë kriminale të Gjorgjeviqit për pjesëmarrje në të, Dhoma Gjyqësore gjykoi ndër të tjera prova të veprimeve të tij dhe të ngjarjeve që ndodhën në periudhën e Aktakuzës.⁹⁵⁵

2. Argumentet e palëve

293. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi që për të deduktuar synimin e tij kriminal mbi krimet e përfshira në Aktakuzë, u bazua në ngjarjet e ndodhura më 1998 dhe në fillim të vitit 1999.⁹⁵⁶ Ai pretendon se një metodologji e tillë është “prej natyre e padrejtë dhe Dhoma e Apelit duhet ta shkurajojë ndjekjen e saj”.⁹⁵⁷ Veçanërisht, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore duhej të kishte zbatuar metodologjinë e përdorur nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerë*, gjegjësisht se “që Prokuroria të mund të mbështetej në krimet e mundshme të kryera në vitin 1998, ajo duhej të provonte se ato krime ishin kryer”.⁹⁵⁸ Gjorgjeviqi argumenton se krimet në fjalë duhej të ishin “formuluar si akuza, shtjelluar në gjyq dhe provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”.⁹⁵⁹

294. Prokuroria përgjigjet se argumentet e Gjorgjeviqit janë të pashtjelluara dhe duhen rrëzuar menjëherë.⁹⁶⁰ [Prokuroria] argumenton se Dhoma Gjyqësore veproi në mënyrë të arsyeshme duke u bazuar në veprimet e Gjorgjeviqit dhe ngjarjet më 1998 në lidhje me përgjegjësinë e tij për krimet e kryera më 1999, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK.⁹⁶¹ Më tej parashtrohet se Gjorgjeviqit iu dha informacion i mjaftueshëm për ta vënë në dijeni të akuzave të cilave ai iu referua konkretisht gjatë gjykimit.⁹⁶²

⁹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 2025-2026. Shih gjithashtu Aktakuza, para. 72.

⁹⁵⁵ Shih Aktgjykimi, para. 2026, 2083-2085.

⁹⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 203-204, 207. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 62-63; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 113-114, 168.

⁹⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 204.

⁹⁵⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 205, përmendet Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 844. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 63. Gjorgjeviqi argumenton se në këtë çështje nuk u ndoq një metodë e tillë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 205).

⁹⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 204. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 206.

⁹⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 167.

⁹⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 163; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 157-158.

⁹⁶² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 164-165, përmendet Dosja Përmblyëse e Gjorgjeviqit, para. 36-37, 43-68, 74-93.

3. Analizë

295. Së pari, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës parashtrimin e Gjorgjeviqit se marrja parasysh e provave jashtë periudhës së Aktakuzës prej Dhomës Gjyqësore ishte prej natyre e padrejtë. Dhoma e Apelit rikujton se në bazë të paragrafit C të Rregullës 89 të Rregullores së procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”) një dhomë gjyqësore gëzon të drejtën të pranojë “çfarëdo prove përkatëse për të cilën gjykon se ka vlerë provuese”.⁹⁶³ Është konkluduar se mund të përdoren materiale të periudhës para Aktakuzës për të përcaktuar “evolimin e Qëllimit të Përbashkët që ekzistonte gjatë periudhës përkatëse të Aktakuzës si dhe rolin e luajtur nga Apeluesi gjatë asaj periudhe”.⁹⁶⁴ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se ishte e drejtë e Dhomës Gjyqësore të merrte parasysh prova para periudhës së Aktakuzës për qëllimin e lartpërmendur.

296. Gjorgjeviqi gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore duhej të kishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm të gjitha ngjarjet e përmendura në përfundimet e veta.⁹⁶⁵ Fillimisht, Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi nuk citon raste ku Dhoma Gjyqësore gaboi në zbatimin e standardit të duhur të vërtetimit; ai përmend një incident të vetëm në Reçak në janar 1999, pa identifikuar asnjë gabim konkret.⁹⁶⁶ Gjithsesi, Dhoma e Apelit rikujton se “në Aktgjykim nuk është e nevojshme që çdo fakt të vërtetohet, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, duhen vërtetuar vetëm faktet ku bazohet verdikti i fajësisë ose dënimi”.⁹⁶⁷ Në mënyrë të ngjashme, nuk kërkohet që të vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm “çdo provë rrethanore.”⁹⁶⁸ Dhoma e Apelit rikujton se të drejtat e të akuzuarit garantohen prej kushtit që konkluzionet e procesit gjyqësor bazuar në provat rrethanore duhet të jenë të vetmet konkluzione të arsyeshme që mund të nxirren nga këto prova.⁹⁶⁹

297. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh një sërë ngjarjesh që ndodhën më 1998 dhe në fillim të vitit 1999, ndër të cilat: (i) një sërë mbledhjesh ku morën pjesë udhëheqës të lartë politikë, ushtarakë dhe të MPB-së;⁹⁷⁰ (ii) shtimi i forcave serbe në Kosovë nga fillimi i vitit 1999;⁹⁷¹ (iii) përdorimi i forcës së tepruar nga forcat serbe kundër

⁹⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 122; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 31, citohen paragrafët C dhe D të Rregullës 89 të Rregullores.

⁹⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 123.

⁹⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 204.

⁹⁶⁶ Incidenti i Reçakut diskutohet në hollësi në nënpikën 9(E) dhe për këtë arsye do të shqyrtohet veçazi (Shih më poshtë, para. 325-350).

⁹⁶⁷ Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 20.

⁹⁶⁸ Aktgjykimi i Apelit *Galiq* para. 218, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458.

⁹⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Galiq* para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 303.

⁹⁷⁰ Aktgjykimi, para. 2026.

⁹⁷¹ Aktgjykimi, para. 2010-2026.

popullatës shqiptare kosovare që më 1998;⁹⁷² (iv) implikimi i Gjorgjeviqit në operacionet kundërterroriste në Kosovë që nga marsi 1998;⁹⁷³ (v) roli i Gjorgjeviqit në çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë;⁹⁷⁴ dhe (vi) pjesëmarrja e tij në negociatat ndërkombëtare në tetor 1998.⁹⁷⁵ Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gëzonte të drejtën të bazohet në ngjarje të tilla për vërtetimin e ekzistencës së NPK-së, si edhe për shqyrtimin e rolit të Gjorgjeviqit dhe synimit të tij kriminal. Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi as nuk vë në pikëpyetje vlerën e ngjarjeve më 1998 dhe fillim të vitit 1999 që provojnë dijeninë dhe synimin e tij në lidhje me krimet e përmendura në Aktakuzë, e as nuk pretendon asnjë gabim të bërë nga Dhoma Gjyqësore veç faktit të thjeshtë të mbështetjes në ngjarjet në Reçak.⁹⁷⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur ndër të tjera u bazua në ngjarjet e vitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999 për të vërtetuar dijeninë e Gjorgjeviqit të një praktike konkrete veprimesh kriminale të forcave të MPB-së dhe mosmarrjen e masave hetimore.⁹⁷⁷

298. Së fundi, duket se Gjorgjeviqi sugjeron se ngjarjet para Aktakuzës nuk ishin argumentuar ligjërisht sa duhej.⁹⁷⁸ Dhoma e Apelit rikujton se kur gjendja mendore e të akuzuarit parashtrohet si fakt juridikisht thelbësor, “faktet nëpërmjet të cilave duhet të vërtetohet fakti juridikisht thelbësor kanë të bëjnë me çështje të zakonshme të provave, dhe nuk është e nevojshme të parashtrihen”.⁹⁷⁹ Dhoma e Apelit thekson se në Aktakuzë konkretisht u argumentua se Gjorgjeviqi kishte synimin e nevojshëm për fajësi në bazë të paragrafëve 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit dhe se ky konkluzion ndër të tjera mund të nxirrej nga ngjarje që ndodhën më 1998 dhe dijenia e tij për to.⁹⁸⁰ Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore i përdori ngjarjet para Aktakuzës për të provuar dijeninë dhe synimin e tij në lidhje me krimet e kryera për të cilat ai u shpall fajtor.⁹⁸¹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se nuk ishte e nevojshme që ngjarjet e periudhës para Aktakuzës të cilat Dhoma Gjyqësore i mori parasysh për të përcaktuar synimin kriminal të Gjorgjeviqit “të argumentoheshin konkretisht” në Aktakuzë.

⁹⁷² Aktgjykimi, para. 2062-2063, 2083-2084.

⁹⁷³ Aktgjykimi, para. 1900-1907.

⁹⁷⁴ Aktgjykimi, para. 1908-1912.

⁹⁷⁵ Aktgjykimi, para. 1916-1919.

⁹⁷⁶ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 202-206.

⁹⁷⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1906, 2083-2085.

⁹⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 204. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 206.

⁹⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 219. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 347. Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, ku Dhoma e Apelit mbështeti metodën e Dhomës Gjyqësore për përdorimin e fakteve në lidhje me incidente që nuk përmendeshin në Aktakuzë në nxjerrjen e përfundimeve për rrethimin e Sarajevës, nëpërmjet konkluzionit se “Dhoma Gjyqësore u bazua si duhej mbi provat për përfundimet e veta në lidhje me qëllimin e rrethimit” nëpërmjet marrjes parasysh të dëshmimeve gojore të dëshmitarëve për objektivat dhe strategjinë e fushatës (Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 133).

⁹⁸⁰ Aktakuza, para. 64.

⁹⁸¹ Shih Aktgjykimi, para. 1900-1907, 2026, 2083-2084.

4. Konkluzion

299. Për arsyet e mësipërme, Dhoma Gjyqësore rrëzon tërësisht nënpikën 9(C) të apelit të Gjorgjeviqit.

D. Nën-pika 9(D): pretendim për gabime në lidhje me armatosjen e serbëve vendas dhe çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë

1. Hyrje

300. Dhoma Gjyqësore konkludoi se nga mesi i vitit 1998, në bazë të planit të RFJ-së për eliminimin e UÇK-së në Kosovë miratuar në korrik 1998 (“Plani për Shtypjen e Terrorizmit”), Komanda e Përbashkët ngarkoi UJ-në dhe MPB-në të kryenin çarmatosjen e fshatrave kryesisht shqiptare në Kosovë dhe armatosjen e civilëve serbë.⁹⁸² Këto masa do të viheshin në zbatim nga SPB-të.⁹⁸³ Armatosja e civilëve serbë në Kosovë përfshiu edhe organizimin e popullatës serbe në njësi vendore të mbrojtjes të njohura si RPO që u armatosën dhe stërvitën nga UJ-ja dhe MPB-ja.⁹⁸⁴ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ishte “përgjegjës *de jure* për çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare”,⁹⁸⁵ dhe se ai ishte në dijeni të armatosjes së popullatës civile serbe më 1998 dhe 1999.⁹⁸⁶

301. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në: (i) konkluzionin se çarmatosja e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosja e popullatës civile serbe kishin lidhje me NPK-në; dhe (ii) që u bazua në këto ngjarje për të provuar pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në NPK.⁹⁸⁷

2. Analizë

(a) Pretendim për gabim në konkluzionin se çarmatosja e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosja e popullatës civile serbe kishin lidhje me NPK-në

a. Argumentet e palëve

302. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gabimisht lidhi çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosjen e popullatës civile serbe me NPK-në.⁹⁸⁸ Në mbështetje të parashtrimit të tij, ai argumenton se veprimet e kryera më 1998 ishin “masa të arsyeshme për të

⁹⁸² Aktgjykimi, para. 92, 1910-1915.

⁹⁸³ Aktgjykimi, para. 92, 1910. Në lidhje me çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë, megjithëse SPB-të ishin përgjegjëse për çarmatosjen e fshatrave në Kosovë, Korpusit të Prishtinës iu besua detyra e çarmatosjes së fshatrave që ndodheshin në brezin kufitar (Aktgjykimi, para. 1910).

⁹⁸⁴ Aktgjykimi, para. 92, 1911, 1913. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 93-97.

⁹⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1910.

⁹⁸⁶ Aktgjykimi, para. 1910-1915.

⁹⁸⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 208, përmendet Aktgjykimi, para. 2154.

⁹⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 208-209, 212.

luftuar dhe për tu mbrojtur kundër UÇK-së”.⁹⁸⁹ Në lidhje me çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare, Gjorgjeviqi argumenton konkretisht se Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk nxori përfundimin se ishte masë mbrojtëse pa asnjë qëllim kriminal.⁹⁹⁰ Në ilustrim të argumentit të tij, Gjorgjeviqi përmend rrethanat në Isniq më 1998, që sipas tij tregojnë “rikthimin e refugjatëve dhe nga ana tjetër dorëzimin e armëve të UÇK-së”.⁹⁹¹ Ai parashtron se masa të tilla ishin të ligjshme dhe se përfundimi që mbetej ishte se çarmatosja ishte masë e ligjshme dhe e nevojshme kundër “rrezikut gjithnjë e më të madh terrorist”.⁹⁹² Në lidhje me armatosjen e civilëve serbë, Gjorgjeviqi pretendon se RPO-të u krijuan “vetëm për mbrojtje kundër forcave terroriste” dhe parashtron se ata ishin “civilë të cilët u angazhuan në kuadër të mbrojtjes territoriale vullnetare”.⁹⁹³

303. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk arrin të identifikojë asnjë gabim në përfundimet e Dhomës Gjyqësore.⁹⁹⁴ Parashtrohet se Dhoma Gjyqësore i rrëzoi argumentet e Gjorgjeviqit se çarmatosja e shqiptarëve kosovarë ishte e nevojshme për parandalimin e rënies së armëve ilegale në duart e UÇK-së dhe se armatosja e shqiptarëve kosovarë ishte e ligjshme dhe arriti në përfundimin se këto veprimtari u kryen mbi baza diskriminuese dhe nuk kishin për qëllim vetëm vetëmbrojtjen e popullatës civile.⁹⁹⁵ Veçanërisht, në lidhje me fshatin Isniq, Prokuroria pretendon se “Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dhe rrëzoi dëshminë gojore të Gjorgjeviqit sipas të cilit çarmatosja e fshatrave ishte bërë me qëllimin e vetëm për të mundësuar rikthimin e refugjatëve dhe dorëzimin e armëve të UÇK-së.”⁹⁹⁶

b. Analizë

304. Dhoma e Apelit thekson se argumenti sipas të cilit çarmatosja e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosja e popullatës serbe ishin “masa të arsyeshme për të luftuar dhe për tu mbrojtur kundër UÇK-së”,⁹⁹⁷ është një ndër argumentet e përsëritura të Gjorgjeviqit i cili u shqyrtua gjatë gjykimit, por rezultoi i pasuksesshëm.⁹⁹⁸

305. Në lidhje me çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë rrëzoi parashtrimin e Gjorgjeviqit se ky ishte operacion legjitim

⁹⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 208-209, 212. Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 64.

⁹⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 209 (pa theksin dhe citimet), përmendet Prova Materiale P431, f. 5, Aktgjykimi, para. 1566.

⁹⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 210 (pa citime), përmendet Aktgjykimi, para. 1910, Prova Materiale D429.

⁹⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 210.

⁹⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 212.

⁹⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 171, 174.

⁹⁹⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 171, 174, përmendet Aktgjykimi, para. 1910, 1915.

⁹⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 173, përmendet Aktgjykimi, para. 1910.

⁹⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 208. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 210, 212, 217. Shih gjithashtu më lart, para. 302.

që nuk kishte lidhje me NPK-në, bazuar në ngjarjet e tjera në atë kohë të cilat Dhoma Gjyqësore i konsideroi si tregues të ekzistencës së një plani të përbashkët.⁹⁹⁹ Veçanërisht, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi shprehimisht argumentin e Gjorgjeviqit se çarmatosja e fshatit Isniq në komunën e Deçanit ishte legjitime me arsyetimin se MPB-ja ishte përpjekur të hynte për të parandaluar përshkallëzimin e situatës duke u kërkuar “terroristëve që ishin përzierë me popullatën civile që të largoheshin nga ajo zonë”.¹⁰⁰⁰ Ndonëse Dhoma Gjyqësore pranoi se çarmatosja e fshatit Isniq mund të ketë pasur këtë qëllim, në bazë të tërësisë së provave mbi çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare nga SPB-të dhe në të njëjtën kohë armatosjen e civilëve serbë dhe organizimin e tyre në RPO, Dhoma Gjyqësore e rrëzoi parashtrimin e Gjorgjeviqit.¹⁰⁰¹ Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e qartë se armatosja e civilëve serbë në kundërshtim me qëllimin zyrtar për “mbrojtjen e fshatrave serbe”,¹⁰⁰² u bë në mënyrë diskriminuuese, dhe jo për “vetëmbrojtjen e popullatës civile kundër ‘armikut’”.¹⁰⁰³ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se civilët serbë të armatosur morën pjesë në operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁰⁰⁴ Ky konkluzion u bazua në prova të shumta, veçanërisht në provat shkresore ndër të tjera mbi lidhjen e ngushtë të RPO-ve me MPB-në dhe angazhimin e civilëve serbë të armatosur në operacione të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së.¹⁰⁰⁵

⁹⁹⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1910, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 4 dhjetor 2009, T. 9624-9625, Vllastimir Gjorgjeviq, 8 dhjetor 2009, T. 9804. Shih gjithashtu Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 605-619.

⁹⁹⁹ Shih Aktgjykimi, para. 1910-1915, 2003-2026.

¹⁰⁰⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1910, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 4 dhjetor 2009, T. 9624-9625, Vllastimir Gjorgjeviq, 8 dhjetor 2009, T. 9804.

¹⁰⁰¹ Aktgjykimi, para. 1910-1911.

¹⁰⁰² Aktgjykimi, para. 1911.

¹⁰⁰³ Aktgjykimi para. 1915.

¹⁰⁰⁴ Aktgjykimi, para. 95-96, 1915. Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Në një numër të madh urdhrash të Korpusit të Prishtinës të UJ-së dhe të Komandës së Përbashkët që janë paraqitur si prova, “popullatës joshqiptare në Kosovë dhe Metohi”, “joshqiptarëve të armatosur” apo “popullatës së armatosur joshqiptare” iu dha detyrë të mbështesnin forcat e MPB-së në “thyerjen dhe shkatërrimin e forcave terroriste shqiptare”. Lubinko Cvetiqi konfirmoi se kjo ndodhi në praktikë. Edhe provat shkresore e vërtetojnë këtë gjë. Një raport i Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë i datës 2 tetor 1998 informon se “pajisja me armë e qytetarëve besnikë ndaj RFJ-së (të kombësisë serbe dhe malazeze) mundësoi organizimin e rezistencës së gjerë ndaj terroristëve”. Në mbledhjen e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbajtur më 21 janar 1999, u raportua se “duke mbajtur parasysh numrin e personave që posedojnë armë ose të cilëve u janë dhënë armë, ekziston mundësi reale që popullata serbe dhe malazeze të vetorganizohet për rezistencë dhe për daljen gjithnjë e më të madhe të forcave radikale”. Dhoma pranon se RPO-të luajtën rol në operacionet luftarake në bashkëpunim dhe koordinim me MPB-në dhe UJ-në. Mirëpo, nga disa urdhra të përmendur në Aktgjykimi shihet qartë se ky rol nuk kufizohet çdo herë në detyrat e përcaktuara të RPO-ve (Aktgjykimi, para. 95).

¹⁰⁰⁵ Shih p.sh. Prova Materiale P886 (procesverbal i mbledhjes së mbajtur nga Komanda e Përbashkët në korrik dhe gusht 1998 ku ndër të tjera diskutohet armatosja e popullatës serbe dhe rekrutimin e tyre në RPO); P87 (procesverbal i një mbledhjeje të MPB-së dhe UJ-në në tetor 1998 ku diskutohet zbatimi i Planit për Shtypjen e Terrorizmit); P690 (procesverbali i një mbledhjeje të mbajtur nga Shtabi i MPB-së në Kosovë, gjatë së cilës shefat e SPB-ve dhe komandantët e PJP-së i udhëzuan pjesëmarrësit që të mos u tregonin përfaqësuesve të MVK-së për armatosjen e civilëve serbë). Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 92-97 (për formimin e RPO-ve).

306. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova të tjera që tregonin se angazhimi i civilëve serbë të armatosur vijoi gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës në shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit.¹⁰⁰⁶ Dhoma Gjyqësore u bind se provat për shtimin dhe përdorimin e forcave të UJ-së dhe të MPB-së dhe armatosja e popullatës serbe dëshmonin për ekzistencën e një plani të përbashkët që synonte të ndryshonte përbërjen etnike në Kosovë.¹⁰⁰⁷ Dhoma e Apelit gjykon se thjesht nëpërmjet paraqitjes së pretendimit të tij se RPO-të u krijuan vetëm për vetëmbrojtje kundër forcave terroriste, Gjorgjeviqi nuk arrin të provojë gabim të Dhomës Gjyqësore.

307. Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ndonëse qëllimi i deklaruar i operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së ishte lufta kundër forcave terroriste, mënyra e kryerjes së tyre përfshirë edhe përdorimin forcës së tepruar dhe kryerjen e gjithandejme të krimeve kundër shqiptarëve kosovarë, treguan se faktikisht objektivi i forcave serbe ishte tërë popullata shqiptare kosovare.¹⁰⁰⁸ Dhoma e Apelit e la në fuqi këtë konkluzion.¹⁰⁰⁹

308. Bazuar në këto përfundime, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin e arsyeshëm se njësi të UJ-së dhe të MPB-së ndërmorën çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosjen e civilëve serbë vendas në kuadër të Planit për Shtypjen e Terrorizmit dhe se këto veprime ishin tregues të ekzistencës së një ndërmarrje të përbashkët kriminale.¹⁰¹⁰

309. Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë asnjë gabim në përfundimin e Dhomës Gjyqësore. Për këtë arsye argumentet e tij rrëzohen.

(b) Pretendim për gabim në mbështetjen në çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosjen e popullatës civile serbe si faktor për pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në NPK

a. Hyrje

310. Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se Gjorgjeviqi ishte përgjegjës *de jure* për çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare në Kosovë.¹⁰¹¹ Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se Komanda e Përbashkët ngarkoi me detyrë njësi të MPB-së që të çarmatosnin individë të popullatës shqiptare kosovare, dhe se SPB-të në Kosovë

¹⁰⁰⁶ Aktgjykimi, para. 1915, 2010-2026.

¹⁰⁰⁷ Aktgjykimi, para. 2026. Shih më lart, para. 183-184, 187; Aktgjykimi, para. 1910-1915, 2003-2026.

¹⁰⁰⁸ Aktgjykimi, para. 2018, 2026-2035, 2036-2051, 2052-2080, 2132-2136, 2138, 2140. Shih më lart, para. 183-184, 187.

¹⁰⁰⁹ Shih më lart, para. 187.

¹⁰¹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1910-1915, 2003-2026, 2130.

¹⁰¹¹ Aktgjykimi, para. 1910.

ishin përgjegjës për veprimtari të tilla.¹⁰¹² Më tej u mor parasysh roli i Gjorgjeviqit në lidhje me SPB-së, sikurse shtjellohet më poshtë.¹⁰¹³ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore mbajti parasysh se Gjorgjeviqi u përfshi personalisht në çarmatosjen e fshatit Isniq në komunën e Deçanit në fund të shtatorit 1998.¹⁰¹⁴ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të armatosjes së popullatës civile serbe në Kosovë dhe të angazhimit të civilëve serbë të armatosur.¹⁰¹⁵

b. Argumentet e palëve

311. Së pari, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e gabuar se ai ishte përgjegjës *de jure* për çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë.¹⁰¹⁶ Ai argumenton se provat: (i) tregojnë se Shtabi i MPB-së në Prishtinë ushtronte kontroll mbi SPB-së dhe nuk provojnë se ai kishte lidhje me këtë; dhe (ii) “nuk çojnë në një konkluzion bindës se [ai] u informua për çarmatosjen, e aq më tepër se kishte kontroll”.¹⁰¹⁷

312. Së dyti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore “konkludoi gabimisht se ai kishte dijeni të gjerë të ‘armatosjes së popullatës civile serbe në Kosovë’ jo vetëm më 1998, por deri në fund të periudhës së Aktakuzës më 1999”, sepse provat nuk e konfirmuan këtë konkluzion.¹⁰¹⁸ Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzion të gabuar se ai: (i) luajti rol në krijimin ose armatosjen e RPO-ve duke u bazuar në dëshminë gojore të pakonfirmuar të Dëshmitar Cvetiqit;¹⁰¹⁹ dhe(ii) kishte dijeni të drejtpërdrejtë për sulmet e RPO-ve duke u bazuar në ngjarjet në Çiçavicë në shtator 1998, për arsye se ai nuk ishte i pranishëm atje.¹⁰²⁰

313. Gjorgjeviqi parashtron se gabimi tërësor është se Dhoma Gjyqësore i barazon këto përfundime me “njëfarë kontrolli efektiv për të cilin konkludon se përbën ‘kontribut të konsiderueshëm’ në NPK”.¹⁰²¹

314. Prokuroria përgjigjet se parashtrimi i Gjorgjeviqit duhet rrëzuar menjëherë sepse ai nuk arrin të provojë se përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin të paarsyeshme dhe përsërit

¹⁰¹² Aktgjykimi, para. 1910.

¹⁰¹³ Shih më poshtë, para. 317-318.

¹⁰¹⁴ Aktgjykimi, para. 1910.

¹⁰¹⁵ Aktgjykimi, para. 1915.

¹⁰¹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 211, përmendet Aktgjykimi, para. 49, 1910, Prova Materiale D244.

¹⁰¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 211, përmendet Aktgjykimi, para. 49, 1910, Prova Materiale D244.

¹⁰¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 215, përmendet Aktgjykimi, para. 1915. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 64.

¹⁰¹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 212-213, përmendet Aktgjykimi, para. 92, 1911, 2000, 2026, Prova Materiale P85, P688, P901, P1052, P1054, P1055, P1355, D449-D451, Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T.6742, Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6713.

¹⁰²⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 214, përmendet Aktgjykimi, para. 1903, Prova Materiale P866, Vllastimir Gjorgjeviq, 9 dhjetor 2009, T. 9863.

¹⁰²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 216 (pa citimet).

argumente që paraqiti gjatë fazës së gjyqimit.¹⁰²² Gjithashtu, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi, duke u bazuar në prova të shumta, se Gjorgjeviqi u përfshi në armatosjen e popullatës joshqiptare,¹⁰²³ se ai ishte përgjegjës *de jure* për çarmatimin e fshatrave shqiptare kosovare,¹⁰²⁴ dhe se gjithashtu ai kishte dijeni për angazhimin e civilëve serbë të armatosur në operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së më 1998 dhe gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁰²⁵ Konkretisht në lidhje me armatosjen e civilëve serbë, Prokuroria gjithashtu parashtron se Dhoma Gjyqësore e konsideroi bindës Dëshmitar Cvetiqin në lidhje me këtë pikë dhe e pranoi dëshminë e tij, dhe se Gjorgjeviqi nuk bëri “asnjë përpjekje për të anashkuar prioritetin që i jepet” një dhome gjyqësore në përcaktimin e besueshmërisë së një dëshmitari.¹⁰²⁶ Prokuroria argumenton se rrjedhimisht, nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në procesin e armatosjes dhe çarmatosjes, Gjorgjeviqi kontribuoi në zbatimin e NPK-së.¹⁰²⁷

c. Analizë

315. Fillimisht, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore konkludoi se njësi të UJ-së dhe të MPB-së kryen çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare dhe armatosjen e civilëve serbë vendas në kuadër të Planit për Shtypjen e Terrorizmit dhe se këto operacione ishin tregues të ekzistencës së një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.¹⁰²⁸ Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se çarmatosja e fshatrave shqiptare ose armatosja e civilëve serbë provonin kontributin e Gjorgjeviqit në NPK.¹⁰²⁹ Konkluzioni i Dhomës Gjyqësore ishte se roli i luajtur nga Gjorgjeviqi në procesin e çarmatosjes dhe armatosjes së civilëve serbë tregonte se ai kishte dijeni për këto veprime.¹⁰³⁰ Dhoma Gjyqësore u bazua në dijeninë e lartpërmendur gjatë shqyrtimit të përgjegjësisë së tij dhe nxjerrjes së konkluzionit se ai kishte synimin e nevojshëm për krime në kuadër të NPK-së.¹⁰³¹ Për këtë arsye pretendimet e Gjorgjeviqit për gabime kanë të bëjnë me përfundimet mbi synimin e tij kriminal dhe jo kontributin e tij në NPK, sikurse sugjeron Gjorgjeviqi.

316. Si rrjedhojë, argumenti i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore i barazoi këto përfundime me “njëfarë kontrolli efektiv për të cilin konkludon se përbën ‘kontribut të konsiderueshëm’ në

¹⁰²² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 170, përmendet Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 605-619.

¹⁰²³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 176-177, përmendet Aktgjykimi, para. 1913-1915, Prova Materiale P85, P1055, f. 8.

¹⁰²⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 172, përmendet Aktgjykimi, para. 46, 48, 238-239, 1910, 1895. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1899.

¹⁰²⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 169, përmendet Aktgjykimi, para. 1910-1915.

¹⁰²⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 175, 179, përmendet Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6713, Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 63, Vendimi *Popoviq* mbi Besueshmërinë e Dëshmitarit, para. 32; Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 10, 303.

¹⁰²⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 169, përmendet Aktgjykimi, para. 1915, 2154.

¹⁰²⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1910-1915, 2003-2026, 2130.

¹⁰²⁹ Shih Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹⁰³⁰ Aktgjykimi, para. 1990, 1999. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1915, 1983-1989, 1991-1998. Shih më poshtë, para. 320-321.

NPK”¹⁰³², përbën keqinterpretim. Dhoma nuk u bazua në këto përfundime për të nxjerrë konkluzionin mbi kontributin e Gjorgjeviqit në NPK (veprimi i fajshëm).¹⁰³³ Megjithatë Dhoma e Apelit do t’i analizojë argumentet e tij në kontekstin e synimit kriminal.

317. Dhoma e Apelit vë në dukje se Gjorgjeviqi nuk citon prova në mbështetje të pretendimit të tij se ai “madje as u informua” për çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare.¹⁰³⁴ Dhoma e Apelit nënvizon se përkundrazi Gjorgjeviqi dëshmoi vetë mbi dijeninë e tij për operacionin e çarmatosjes në fshatin Isniq të komunës së Deçanit në fund të shtatorit 1998.¹⁰³⁵ Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi shtrembëron provat kur argumenton se provat “nuk çojnë në konkluzion bindës” se ai kishte “kontroll *de jure*” në çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare.¹⁰³⁶ Megjithëse ai citon saktësisht përfundimin e Dhomës Gjyqësore se SPB-të në Kosovë në aspektin operativ komandoheshin prej Shtabit të MPB-së në Prishtinë që bashkërendonte dhe planifikonte operacionet e tyre,¹⁰³⁷ Gjorgjeviqi shpërfill prova të tjera të marra parasysh nga Dhoma Gjyqësore që vërtetojnë se ai ishte përgjegjës *de jure* për punën e SPB-ve. Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova shkresore që tregonin se shefat e SPB-ve ishin në varësi të drejtpërdrejtë të Gjorgjeviqit, i cili si shef i RJB-së ishte “eprori i vetëm i drejtpërdrejtë” i tyre.¹⁰³⁸ Provat gjithashtu treguan se shefat e SPB-ve “përgjigjeshin drejtpërsëdrejti vetëm para [Gjorgjeviqit], i cili nga ana tjetër, për punën e tij dhe të njësive dhe personelit të drejtorisë së tij [RJB], përgjigjej vetëm para ministrit”.¹⁰³⁹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se SPB-të ishin në varësi të RJB-së.¹⁰⁴⁰

318. Bazuar në përfundimet e mësipërme që provojnë përgjegjësinë *de jure* të Gjorgjeviqit mbi punën e SPB-ve dhe duke mbajtur parasysh rolin kyç të SPB-ve në çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare,¹⁰⁴¹ Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të mund të konkludonte se si pasojë ai ishte përgjegjës *de jure* për çarmatosjen e fshatrave shqiptare kosovare. Rrjedhimisht, argumenti i tij hidhet poshtë.

¹⁰³¹ Aktgjykimi, para. 1908-1915, 2154.

¹⁰³² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 216 (pa referencat).

¹⁰³³ Shih Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹⁰³⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 211. Shih më lart, para. 311.

¹⁰³⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1910, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 4 dhjetor 2009, T. 9622-9625.

¹⁰³⁶ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 211, përmendet Aktgjykimi, para. 49, 1910, Prova Materiale D244.

¹⁰³⁷ Aktgjykimi, para. 49.

¹⁰³⁸ Aktgjykimi, para. 48, përmendet Prova Materiale D933, f. 21.

¹⁰³⁹ Aktgjykimi, para. 48, përmendet Prova Materiale D933, f. 21.

¹⁰⁴⁰ Aktgjykimi, para. 46, përmendet Lubinko Cvetiq, 26 qershor 2009, T. 6591, 6598. Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore citoi gabimisht T. 5691, mirëpo gjykon se ky është gabim shtypi, duke qenë se Lubinko Cvetiqi dha dëshmi në T. 6591 se SPB-të ishin në varësi të RJB-së. Shih gjithashtu më lart, para. 216, 228, 247, 250-251.

¹⁰⁴¹ Shih më lart, para. 315.

319. Në lidhje me dijeninë e tij për armatosjen e popullatës serbe, Gjorgjeviqi paraqet kundërshtim ndaj mbështetjes së Dhomës Gjyqësore në dëshminë gojore të pakonfirmuar të Dëshmitar Cvetiqit për nxjerrjen e konkluzionit se ai luajti rol në armatosjen e civilëve serbë.¹⁰⁴² Dhoma e Apelit rikujton se një dhomë gjyqësore gëzon të drejtën e peshimit të provave,¹⁰⁴³ përfshirë edhe të drejtën e pranimit të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm.¹⁰⁴⁴ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore u mbështet gjerësisht në dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit gjatë gjithë Aktgjykimit të vet, veçanërisht për strukturën e MPB-së,¹⁰⁴⁵ dhe se Gjorgjeviqi nuk bëri orvatje për diskreditimin e besueshmërisë së këtij dëshmitari, as në fazën e gjykimit, e as në apel.¹⁰⁴⁶

320. Për më tepër, Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore. Në kundërshtim me argumentin e tij, Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se ai “luajti rol”¹⁰⁴⁷ në armatosjen e civilëve serbë, por se ai kishte dijeni për këtë operacion.¹⁰⁴⁸ Ky përfundim u bazua në tërësinë e provave sikurse shtjellohet më poshtë. Ndër këto prova ishte edhe deklarata e Dëshmitar Cvetiqit se procesi i armatosjes së civilëve serbë “kalonte nga MPB-ja në Shtabin e MPB-së dhe më tej në Sekretariatit e Punëve të Brendshme”.¹⁰⁴⁹ Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia gojore e Dëshmitar Cvetiqit, megjithëse e pakonfirmuar, u analizua prej Dhomës Gjyqësore në kontekstin më të gjerë të formimit të RPO-ve¹⁰⁵⁰ dhe përkundrajt të gjitha provave të tjera që vërtetojnë se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të armatosjes, por jo se ai mori pjesë në proces.¹⁰⁵¹ Si rrjedhojë, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi që u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit.

321. Dhoma e Apelit thekson se apeli prej Gjorgjeviqit i konkluzionit të Dhomës Gjyqësore si ai kishte dijeni për armatosjen e civilëve serbë më 1998 dhe 1999, është përsëritje e argumenteve të paraqitura në fazën e gjykimit, pa identifikuar asnjë gabim.¹⁰⁵² Në lidhje me parashtrimin e Gjorgjeviqit për operacionin e përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në fshatin

¹⁰⁴² Shih më lart, para. 312; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 213. Shih Aktgjykimi, para. 92, 1911, përmendet Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6713.

¹⁰⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 88; Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 51; Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 31, Aktgjykimi i Apelit *Rukundo*, para. 207; Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 103; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47; Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 116; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 194.

¹⁰⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 375, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 219, Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkqiqi dhe të tjerët*, para. 33, Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62, Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 65.

¹⁰⁴⁵ Shih Aktgjykimi, para. 41-143.

¹⁰⁴⁶ Shih Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6735-6810; Lubinko Cvetiq, 3 korrik 2009, T. 6812-6871; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 213. Shih gjithashtu më lart, para. 228.

¹⁰⁴⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 212-213.

¹⁰⁴⁸ Aktgjykimi, para. 1911-1915.

¹⁰⁴⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 213, përmendet Lubinko Cvetiq, 2 korrik 2009, T. 6713.

¹⁰⁵⁰ Aktgjykimi, para. 92, 1911. Shih gjithashtu më lart, para. 300.

¹⁰⁵¹ Shih më poshtë, para. 321.

¹⁰⁵² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 215, përmendet Aktgjykimi, para. 1915; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 64. Shih gjithashtu Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 605-619.

Çiçavicë në shtator 1998,¹⁰⁵³ Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë e Gjorgjeviqit se ndonëse ai kishte dijeni për këtë operacion, ai nuk e dinte se civilë të armatosur u përdorën si përforcime për ushtrinë dhe policinë sepse ai ndodhej “në anën tjetër të malit” gjatë kryerjes së operacionit.¹⁰⁵⁴ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore mori parasysh deklaratën e Gjorgjeviqit se ai nuk kishte dijeni për armatosjen e popullatës serbe në përgjithësi dhe pjesëmarrjen e civilëve serbë të armatosur në operacione të përbashkëta të UJ-së dhe të MPB-së.¹⁰⁵⁵ Gjithsesi [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se dëshmia e Gjorgjeviqit nuk ishte e besueshme kundrejt tërësisë së kundërprovave.¹⁰⁵⁶ Ndër këto kundërprova ishin: (i) mbledhje të Komandës së Përbashkët më korrik e gusht 1998 ku Gjorgjeviqi mori pjesë e në të cilat u diskutua armatosja e popullatës serbe dhe rekrutimi i kësaj popullate në RPO;¹⁰⁵⁷ (ii) procesverbali i një mbledhjeje të mbajtur më 29 tetor 1998, ku morën pjesë zyrtarë të lartë të UJ-së dhe të MPB-së ndër të cilët edhe Gjorgjeviqi, ku u diskutua zbatimi i Planit për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë i cili përmbante armatosjen e popullatës joshqiptare dhe formimin e RPO-ve;¹⁰⁵⁸ (iii) përpjekja e pafrytshme e Gjorgjeviqit për të minimizuar komentet e bëra nga Lluqiqi gjatë një mbledhjeje në lidhje me serbët e armatosur dhe RPO-të;¹⁰⁵⁹ (iv) prania e Gjorgjeviqit në mbledhjen e 17 shkurtit 1999 ku Lluqiqi i informoi të pranishmit se RPO-të ishin në veprim thuajse në të gjitha fshatrat ku kishte banorë serbë dhe e kishin shtuar veprimtarinë e tyre;¹⁰⁶⁰ si edhe (v) mbledhje të tjera së bashku me procesverbalet dhe raportet nga këto mbledhje që tregojnë lidhjen e ngushtë midis MPB-së dhe RPO-ve më 1999.¹⁰⁶¹ Bazuar në këto prova si tërësi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte dijeni për armatosjen e popullatës civile serbe në Kosovë, për organizimin e tyre në RPO dhe përfshirjen e MPB-së në mundësimin e mbështetjes logjistike, si dhe për angazhimin e civilëve serbë të armatosur në operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së.¹⁰⁶² [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se ai kishte

¹⁰⁵³ Shih më lart, para. 312; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 214.

¹⁰⁵⁴ Aktgjykimi, para. 1913, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 9 dhjetor 2009, T. 9860-9863, Prova Materiale P866, f. 103, P1422. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 214.

¹⁰⁵⁵ Aktgjykimi, para. 1912, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 9 dhjetor 2009, T. 9862-9863, Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009 9901-9903. Konkretisht, Dhoma Gjyqësore mori gjithashtu parasysh: (i) dëshminë e Gjorgjeviqit se roli i MPB-së në lidhje me RPO-të ishte i kufizuar dhe kishte të bënte vetëm me mbështetjen e RPO-ve dhe përgatitjen e tyre për aksione mbrojtëse kundër terroristëve (Aktgjykimi, para. 1914, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009, T. 9938-9940); dhe (ii) mohimin prej tij se kishte dijeni për faktin se deri në atë kohë, nga shkurti 1999, RPO-ve ekzistuese u ishin shpërndarë 64.080 armë duke qenë se nuk e kishte parë raportin përkatës (Aktgjykimi, para. 1914, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009, T. 9940-9941).

¹⁰⁵⁶ Aktgjykimi, para. 1915, përmendet Aktgjykimi, para. 92-96. Shih Aktgjykimi, para. 1912-1914.

¹⁰⁵⁷ Aktgjykimi, para. 1913, përmendet Prova Materiale P886; Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009, T. 9915, 9920-9922, Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10143.

¹⁰⁵⁸ Aktgjykimi, para. 1913, përmendet Prova Materiale P87; Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 9 dhjetor 2009, T. 9872-9873, 9875.

¹⁰⁵⁹ Aktgjykimi, para. 1913, përmendet Prova Materiale P690.

¹⁰⁶⁰ Aktgjykimi, para. 1914, përmendet Prova Materiale P85, Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009, T. 9936-9937.

¹⁰⁶¹ Shih Aktgjykimi, para. 1914, përmendet një raport mbi mbledhjet e mbajtura në periudhën 13 - 16 shkurt 1999 dhe procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së mbajtur më 17 shkurt 1999. Shih Prova Materiale P85; P1055, f. 3.

¹⁰⁶² Aktgjykimi, para. 1915.

dijeni jo vetëm në lidhje me gjysmën e dytë të vitit 1998, por për krejt periudhën deri në fund të periudhës së Aktakuzës më 1999.¹⁰⁶³

322. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të kishte konkluduar se Gjorgjeviqi kishte dijeni për armatosjen e popullatës serbe në gjysmën e dytë të vitit 1998 e deri në fund të periudhës së Aktakuzës më 1999.

323. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit i rrëzon argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi përgjegjësinë e tij *de jure* për çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë dhe dijeninë e tij për armatosjen e popullatës civile serbe në Kosovë.

3. Konkluzion

324. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht nën pikën 9(D) të apelit të Gjorgjeviqit.

E. Nën-pika 9(E): pretendim për gabime në lidhje me incidentin e Reçakut dhe rolin e Gjorgjeviqit në të

1. Hyrje

325. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi: (i) kishte dijeni dhe luajti rol aktiv në operacionin e përbashkët të UJ-së dhe të MPB-së në Reçak më 15 janar 1999 që shkaktoi vdekjen e jo më pak se 45 shqiptarëve kosovarë,¹⁰⁶⁴ dhe (ii) kryesoi “përprjekjet e MPB-së për të fshehur provat e forcës jashtëzakonisht të tepruar të përdorur nga ana e policisë dhe për të paraqitur operacionin në Reçak si një operacion legjitim kundërterrorist”.¹⁰⁶⁵

326. Në veçanti, Dhoma Gjyqësore konkludoi se operacioni i Reçakut, i urdhëruar nga Komanda e Përbashkët, ishte “shembull i hershëm i praktikës së re dhe të intensifikuar të operacioneve të koordinuara ‘kundërterroriste’ të UJ-së dhe MPB-së”.¹⁰⁶⁶ Gjithashtu u konkludua se NPK-ja ishte formuar që para kryerjes së operacionit në Reçak,¹⁰⁶⁷ dhe se kjo mënyrë e përdorimit të koordinuar të UJ-së, MPB-së dhe forcave të tjera serbe u shfrytëzua për realizimin e qëllimit të NPK-së.¹⁰⁶⁸ Sipas Dhomës Gjyqësore, nga mesi i janarit 1999, udhëheqja politike serbe dhe udhëheqja e UJ-së dhe MPB-së e kishin të qartë se për të realizuar synimet afatgjata për vijimësinë e kontrollit serb mbi Kosovën, ishte i domosdoshëm

¹⁰⁶³ Aktgjykimi, para. 1915.

¹⁰⁶⁴ Shih Aktgjykimi para. 257, 397-416, 425, 1920-1924, 2134.

¹⁰⁶⁵ Shih Aktgjykimi, para. 415, 425, 1924.

¹⁰⁶⁶ Aktgjykimi, para. 2134, përmendet Prova Materiale P902, f. 9, 11.

¹⁰⁶⁷ Aktgjykimi, para. 2134, përmendet Prova Materiale P902, f. 9, 11, 29.

bashkëpunim më i madh midis UJ-së dhe MPB-së gjatë operacioneve të përbashkëta.¹⁰⁶⁹ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se roli dhe dijenia e Gjorgjeviqit në operacionin e Reçakut ishin tregues të pjesëmarrjes së tij në NPK.¹⁰⁷⁰

327. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktik që: (i) u bazua në operacionin e Reçakut për konkluzionin mbi rolin e tij në realizimin e NPK-së;¹⁰⁷¹ (ii) në konkluzionin se gjatë operacionit u vranë 45 shqiptarë kosovarë;¹⁰⁷² (iii) në përfundimin se gjykatëses hetuese Danica Marinković (“Gjykatësja Marinković”) iu tregua një vendngjarje e inskenuar; dhe (iv) në përfundimin se Gjorgjeviqi luajti rol në përdorimin e forcës së tepruar.¹⁰⁷³ Gjorgjeviqi argumenton se për këto arsye incidenti i Reçakut nuk duhet marrë parasysh në përcaktimin e përgjegjësisë së tij penale për krimet e përfshira në Aktakuzë dhe si rrjedhojë kërkon që Dhoma e Apelit ose të shfuqizojë verdiktet e fajësisë së tij, ose të ulë dënimin e tij.¹⁰⁷⁴

328. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk arrin të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore mbi operacionin në Reçak dhe se për këtë arsye kjo nënpikë e apelit të tij duhet rrëzuar.¹⁰⁷⁵

2. Pretendim për gabim në mbështetjen e konkluzionit për rolin e Gjorgjeviqit në realizimin e NPK-së në operacionin e Reçakut

(a) Argumentet e palëve

329. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi që u bazua në operacionin e Reçakut për të vërtetuar “‘operacion të koordinuar’ midis MPB-së dhe UJ-së në përputhje me NPK-në”.¹⁰⁷⁶ Ai parashtron se ky përfundim ka të bëjë me veprimin e tij të fajshëm, në një kohë që rëndësia e operacionit të Reçakut duhej të ishte vlerësuar vetëm në lidhje me synimin e tij kriminal të pretenduar, pas heqjes së incidentit të Reçakut nga Aktakuza.¹⁰⁷⁷ Në mbështetje të argumentit të tij, ai citon Vendimin e Dhomës për Pranim Provash të 30 marsit 2010, që sipas tij e kufizon mbështetjen në incidentin e Reçakut vetëm përsa i përket analizimit të

¹⁰⁶⁸ Aktgjykimi, para. 2037.

¹⁰⁶⁹ Aktgjykimi, para. 2134.

¹⁰⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1920-1924, 2134, 2154.

¹⁰⁷¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218-220.

¹⁰⁷² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218-223.

¹⁰⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 223-224.

¹⁰⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 226; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 65-66.

¹⁰⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 180, 184, 187.

¹⁰⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218, 220, përmendet Aktgjykimi, para. 1923-1925, 1992, 2154.

¹⁰⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218, 220, përmendet *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Mocion i Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Përbashkët të Ndryshuar për Herë të Tretë me Shtojcat A, B, dhe C, 2 qershor 2008, para. 23, miratuar nga Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Ndryshimin e Aktakuzës i 7 korrikut 2008, para. 47, 51.

synimit të tij kriminal.¹⁰⁷⁸ Ai parashtron se rrjedhimisht përfundimet në lidhje me incidentin e Reçakut që nuk kanë të bëjnë me synimin e tij kriminal duhet të shfuqizohen për shkak të informimit dhe të shtjellimit të pamjaftueshëm ligjor të akuzave.¹⁰⁷⁹

330. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi u paralajmërua në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me akuzat për operacionin e Reçakut, sepse ato u shtjelluan si në Aktakuzë, po ashtu edhe në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë.¹⁰⁸⁰ Gjorgjeviqi dëshmoi për ngjarjet në Reçak dhe i përmendi në Dosjen e vet Përmbyllëse.¹⁰⁸¹

(b) Analizë

331. Së pari, Dhoma e Apelit thekson se Prokuroria hoqi vetëm akuzën e vrasjes në lidhje me incidentin e Reçakut dhe se Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjet e kryera gjatë incidentit të Reçakut.¹⁰⁸² Dhoma e Apelit rikujton se një aktakuzë së paku duhet të saktësojë “se mbi çfarë baze ligjore në Statut akuzohet një individ”,¹⁰⁸³ dhe se Prokurorisë i kërkohet “të paraqesë faktet juridikisht thelbësore në mbështetje të akuzave të aktakuzës, por jo provat nëpërmjet të cilave vërtetohen faktet juridikisht thelbësore”.¹⁰⁸⁴ Formulimi i aktakuzës me konkretësi të mjaftueshme kushtëzohet nga fakti nëse faktet juridikisht thelbësore ku mbështet Prokuroria paraqiten “me hollësi të mjaftueshme që e informojnë të akuzuarin qartësisht për akuzat kundër tij me qëllim që ai të mund të përgatisë mbrojtjen e vet”.¹⁰⁸⁵ “Si rrjedhojë, ekziston një dallim i dukshëm midis fakteve juridikisht thelbësore ku mbështetet Prokuroria që duhen argumentuar ligjërisht dhe provave të paraqitura për vërtetimin e fakteve juridikisht thelbësore.”¹⁰⁸⁶ Gjithashtu, Dhoma e Apelit rikujton se rëndësia ligjore e një fakti konkret nuk përcaktohet në mënyrë abstrakte, por në varësi të argumenteve të Prokurorisë.¹⁰⁸⁷

¹⁰⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218, 220, përmendet Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranim Provasi i 30 marsit 2010, para. 9. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 67.

¹⁰⁷⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218, 220, përmendet Aktgjykimi, para. 1923-1925, 1992, 2154

¹⁰⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 181-182, përmendet Aktakuza para. 61(c), 64(g), *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda nr. IT-05-87/1-PT, Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, 1 shtator 2008 (“Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë”), para. 289.

¹⁰⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 182, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9666-9675, Vllastimir Gjorgjeviq, 9 dhjetor 2009, T. 9885-9893, Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 73-93.

¹⁰⁸² Shih Aktakuza, para. 64(g); Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Ndryshimin e Aktakuzës i 7 korrikut 2008, para. 45-47. Prokuroria nuk paraqiti asnjë akuzë për dëbim ose veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në lidhje me Reçakun (*Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda nr. IT-05-87/1-PT, Mocion i Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Përbashkët të Ndryshuar për Herë të Tretë me Shtojcat A, B, dhe C, 2 qershor 2008, para. 23; Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Ndryshimin e Aktakuzës i 7 korrikut 2008, para. 47); Aktgjykimi, para. 2230, f. 886-950.

¹⁰⁸³ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 138.

¹⁰⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq*, para. 88.

¹⁰⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 116, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 88.

¹⁰⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 116.

¹⁰⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 117; citohet Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 89.

332. Në këtë çështje, në Aktakuzë operacioni i Reçakut cilësohet shprehimisht si një ndër faktorët mbi bazën e të cilëve mund të deduktohej synimi i Gjorgjeviqit.¹⁰⁸⁸ Sidoqoftë [në Aktakuzë] pretendohet edhe se Gjorgjeviqi mori pjesë në NPK, ndër të tjera nëpërmjet, (i) ushtrimit të kontrollit efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përfshirë të gjitha njësitë e RJB-së që morën pjesë në kryerjen e krimeve që renditen në Aktakuzë; dhe (ii) pjesëmarrjes në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimtarive të forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, që morën pjesë në kryerjen e krimeve të renditura në Aktakuzë, në veçanti RJB-ja dhe njësitë vartëse.¹⁰⁸⁹ Në Dosjen e vet Paragjyqësore, Prokuroria argumentoi se operacioni i Reçakut ishte provë e angazhimit “të drejtpërdrejtë” të Gjorgjeviqit në veprimtaritë e MPB-së në Kosovë më 1999, që është një ndër faktorët ku Prokuroria bazon argumentin e vet se Gjorgjeviqi mori pjesë dhe kontribuoi në NPK.¹⁰⁹⁰ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se faktet juridikisht thelbësore në lidhje me natyrën e pjesëmarrjes së Gjorgjeviqit në NPK u pasqyruan mjaftueshëm në Aktakuzë dhe se Gjorgjeviqi u paralajmërua se gjithashtu Prokuroria synonte të mbështetej në incidentin e Reçakut për të provuar pjesëmarrjen e lartpërmendur.

333. Për më tepër, Gjorgjeviqi jep interpretim të shtrembër të Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 30 marsit 2010.¹⁰⁹¹ Në atë vendim, Dhoma Gjyqësore nuk vendosi kufizime në lidhje me peshën e operacionit të Reçakut.¹⁰⁹² Faktikisht, [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se ndonëse për ngjarjet në Reçak nuk kishte akuza konkrete për vrasje, “këto akuza të përgjithshme [...] janë me rëndësi për *aspekte të tjera* në Aktakuzë.”¹⁰⁹³ Pasi i cilësoi ngjarjet në Reçak “si faktor me vlerë për vërtetimin e synimit të tij kriminal në bazë të paragrafit 1 dhe paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit të Tribunalit”, [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se këto ngjarje “ishin me rëndësi për vërtetimin e *akuzave kundër të Akuzuarit*”, dhe gjithashtu theksoi se “të dy palët [...] paraqitën një sasi të konsiderueshme provash në lidhje me operacionin e Reçakut”.¹⁰⁹⁴

334. Rrjedhimisht, Prokuroria kishte plotësisht të drejtë të bazohej në këtë incident në mbështetje të argumentit të vet se Gjorgjeviqi mori pjesë në NPK, sikurse parashtrohet qartësisht në Dosjen e saj Paragjyqësore.¹⁰⁹⁵

¹⁰⁸⁸ Shih Aktakuza, para. 64(g).

¹⁰⁸⁹ Aktakuza, para. 61(a)-(c).

¹⁰⁹⁰ Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 289; Aktakuza, para. 61(a)-(c).

¹⁰⁹¹ Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranim Provash i 30 marsit 2010, para. 9. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218.

¹⁰⁹² Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranim Provash i 30 marsit 2010, para. 9. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218.

¹⁰⁹³ Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranim Provash i 30 marsit 2010, para. 9 (theksi i shtuar).

¹⁰⁹⁴ Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranim Provash i 30 marsit 2010, para. 9 (theksi i shtuar). Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 218.

¹⁰⁹⁵ Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 289.

335. Duke marrë parasysh sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi që operacionin e Reçakut e konsideroi si provë të një ‘operacioni të koordinuar’ midis MPB-së dhe UJ-së brenda kontekstit të kontributit të Gjorgjeviqit në NPK.

3. Pretendim për gabim në konkluzionin se 45 civilë shqiptarë kosovarë u vranë në Reçak më 15 janar 1999

(a) Argumentet e palëve

336. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se 45 shqiptarë kosovarë u vranë në Reçak më 15 janar 1999.¹⁰⁹⁶ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh: (i) raportet mjekoligjore;¹⁰⁹⁷ (ii) prova në lidhje me llojin e armëve të gjetura të UÇK-së në Reçak;¹⁰⁹⁸ (iii) “prova të tjera për veprimtari të UÇK-së” që tregonin se më 15 janar 1999, UÇK-ja ishte e pranishme në fshat;¹⁰⁹⁹ (iv) prova se të plagosurit u mjekuan në spitale ushtarake;¹¹⁰⁰ (v) prova se të vdekurit u varrosën në përputhje me rregulloren ushtarake të UÇK-së; dhe (vi) prova të ekzistencës së një shtabi të UÇK-së.¹¹⁰¹

337. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se në operacionin e Reçakut u vranë jo më pak se 45 civilë shqiptarë kosovarë.¹¹⁰² Gjithashtu parashtrohet se Gjorgjeviqi përsërit argumente të cilat u rrëzuan në procesin gjyqësor,¹¹⁰³ jep interpretimin e tij të provave,¹¹⁰⁴ dhe nuk arrin të identifikojë asnjë gabim në ushtrimin e kompetencës së brendaqenësishme prej Dhomës Gjyqësore.¹¹⁰⁵

¹⁰⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 219, përmendet Aktgjykimi, para. 416, 2134.

¹⁰⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 221-222, përmendet, ndër të tjera Prova Materiale D895 (Lista e individëve të vdekur në fshatin Reçak), D899 (Konkluzion i përgjithshëm i ekspertëve mjekësorë në lidhje me 40 kufoma të gjetura në një xhami në Reçak).

¹⁰⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222, përmendet Prova Materiale D149 (Raport i gjykatësës hetuese ku përfshihet një listë e armëve të UÇK-së që u gjetën në Reçak më 15 janar 1999 gjatë një hetimi të vendngjarjes), D148 (Evidencë e hetimit të vendngjarjes kryer në Reçak, nënshkruar nga gjykatësja hetuese më 18 janar 1999), D757, f. 4 (Raport i Korpusit të Prishtinës që përmban një raport mbi 26 kufoma të gjetura nga MVK-ja në Reçak më 20 janar 1999, me “veshje civile, por me armë dhe me mbishkrimin ‘UÇK’”), D896 (Raport mbi ekzaminimin mjekoligjor për incidentin e Reçakut përfshirë edhe një listë të armëve të gjetura në vendngjarje më 15 janar 1999), Momir Stojanoviq, 22 shkurt 2010, T. 11739.

¹⁰⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222, përmendet Joseph Maisonneuve, 4 qershor 2009, T. 5539.

¹¹⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222, përmendet Aktgjykimi, para. 401, 402, Prova Materiale P872, Joseph Maisonneuve, 4 qershor 2009, T. 5544-5545, Branko Mlladenoviq, 8 mars 2010, T. 12500.

¹¹⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222, përmendet Aktgjykimi, para. 401, 402, Prova Materiale P872, Joseph Maisonneuve, 4 qershor 2009, T. 5544-5545, Branko Mlladenoviq, 8 mars 2010, T. 12500.

¹¹⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 180, përmendet Aktgjykimi, para. 397-402, 421-425, 1920-1923.

¹¹⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 184, përmendet Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 73, 75-81. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 184-186, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 221-223.

¹¹⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 185-187.

¹¹⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 185-187.

(b) Analizë

338. Dhoma e Apelit gjykon se për arsyet që shtjellohen më poshtë, asnjë prej argumenteve të Gjorgjeviqit nuk provon se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin e vrasjes së 45 civilëve shqiptarë kosovarë. Dhoma e Apelit vëren se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore sipas të cilit në operacionin e Reçakut u vranë 45 civilë shqiptarë kosovarë u bazua në shqyrtimin e një sasive të konsiderueshme provash mbi ngjarjet që ndodhën në atë zonë më 15 janar 1999 dhe në ditët e mëpasme.¹¹⁰⁶ Ndër to përfshihen provat të një sërë përpjekjesh për hetime nga gjykatësja Marinkoviq,¹¹⁰⁷ si edhe dëshmia e dhënë nga vetë Gjorgjeviqi dhe dëshmitarë të tjerë të Mbrotjtjes.¹¹⁰⁸ Në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit,¹¹⁰⁹ Dhoma Gjyqësore faktikisht mori parasysh: (i) raportet mjekoligjore të përmendura nga Gjorgjeviqi në Dosjen e tij të Apelit;¹¹¹⁰ (ii) prova në lidhje me llojet e armëve të gjetura në Reçak;¹¹¹¹ (iii) prova për praninë e UÇK-së më Reçak gjatë periudhës përkatëse;¹¹¹² (iv) dhe prova për ekzistencën e një shtabi të UÇK-së në Reçak.¹¹¹³ Për këtë arsye, argumentet e tij hidhen poshtë.

339. Dhoma e Apelit e gjykon spekulim argumentin e Gjorgjeviqit në lidhje me varrimet dhe mjekimin e të plagosurve në spitale ushtarake, ku ai sugjeron se viktimat mund të kenë

¹¹⁰⁶ Aktgjykimi, para. 416. Shih Aktgjykimi, para. 396-416. Në lidhje me operacionin e përbashkët të UJ-së dhe MPB-së, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi prova se që në orët e hershme të mëngjesit të datës 15 janar e deri pasdite, në stacionin policor në Shtime u dëgjuan të shtëna të herëpashershme që vinin nga drejtimi i Reçakut (Aktgjykimi, para. 397); në atë kohë, në stacionin policor të Shtimes ndodhën gjëra të pazakonta në kuptimin që të gjithë policët e rregullt dhe ata rezervistë ishin thirrur për t'u paraqitur, atje ishte edhe një togë e PJP-së dhe rreth 10-12 pjesëtarë të SAJ-it, si edhe shefi i SPB-së dhe shefi i degës së policisë në Ferizaj (Aktgjykimi, para. 397); u tha se në Reçak po zhvillohej një aksion për arrestimin e personave përgjegjës për vrasjen e katër policëve (Aktgjykimi, para. 397); pak orë pas fillimit të të shtënave, Gjorgjeviqi erdhi në stacionin policor të Shtimes dhe mori pati dy thirrje telefonike nga Shainoviqi (Aktgjykimi, para. 398); MVK-ja filloi të merrte raporte për një "operacion të gjerë që po zhvillohej në Reçak", që ishte një operacion i planifikuar i përbashkët i UJ-së dhe MPB-së (Aktgjykimi, para. 400, 402); dhe verifikuesit e MVK-së panë Praga dhe tanke T-5 të UJ-së tek granatonin fshatin dhe kodrat përreth, duke u pamundësuar civilëve të largoheshin nga fshati, në një kohë që në fshat hynë automjete të blinduara të MPB-së dhe forca të këmbësorisë të cilët shkuan shtëpi më shtëpi për kontroll (Aktgjykimi, para. 401). Në lidhje me civilët e vranë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se: shefi i Qendrës Rajonale u informua se në fshat kishte mbi 25 kufoma civilësh, të cilët dukej se ishin ekzekutuar (Aktgjykimi, para. 405); përfaqësuesit e MVK-së që vizituan fshatin, panë kufomën pa kokë të një plaku në një shtëpi bujku dhe mbi 20 kufoma të shtrira në varg në një kanal apo vijë uji të cilët dukej se ishin qëlluar nga afër në kokë (Aktgjykimi, para. 407); ata panë edhe katër kufoma të tjera në fshat, përfshirë kufomën e një femre 18-vjeçare dhe një djaloshi 12-vjeçar (Aktgjykimi, para. 407).

¹¹⁰⁷ Shih Aktgjykimi, para. 410-413, 1924.

¹¹⁰⁸ Shih Aktgjykimi, para. 419-425.

¹¹⁰⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 221-222.

¹¹¹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 413, sh. 1430 (përmendet Prova Materiale D899), sh. 1431 (përmendet Prova Materiale D895). Shih më lart, para. 336, sh. 1097.

¹¹¹¹ Aktgjykimi, para. 411, përmendet Prova Materiale D896. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 410, sh. 1410 (përmendet Prova Materiale D149), 411, sh. 1417, 1418 (përmendet Prova Materiale D148). Shih më lart, para. 336, sh. 1098.

¹¹¹² Aktgjykimi, para. 401, 410. Sidoqoftë Dhoma Gjyqësore konkludoi se pavarësisht nga ky fakt, nuk pati të shtëna nga fshati gjatë sulmit të koordinuar të UJ-së dhe MPB-së kundër fshatit (Aktgjykimi, para. 401, 1922). Dhoma e Apelit vë në dukje dëshminë e gjeneral Drewienkiewicz-it, në lidhje me operacionin e përbashkët UJ-MPB në Reçak se ai shprehu shqetësimin mbi operacionin për faktin se "përdorimi i armëve kundërajrore kundër një fshati ku jetonin edhe gra e fëmijë nuk mund të pranohej si operacion policor" (Aktgjykimi, para. 404, përmendet John Drewienkiewicz, Prova Materiale P996, para. 221, Karol John Drewienkiewicz, 22 qershor 2009, T. 6367-6368; Prova Materiale P1007).

¹¹¹³ Aktgjykimi, para. 401, 410.

qenë anëtarë të UÇK-së dhe rrjedhimisht objektiva legjitime.¹¹¹⁴ Dhoma e Apelit citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se në kohën kur u vranë 45 viktimat mbanin rroba civile dhe se ndër të vdekurit ishin një burrë i moshuar, një grua dhe një fëmijë.¹¹¹⁵ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se së paku një viktime i kishin prerë kokën dhe shumica e të vrarëve ishin mbi 50 vjeç dhe ishin qëlluar në kokë nga afër.¹¹¹⁶ Vetëm sugjerimi i Gjorgjeviqit se disa prej viktimave mund të jenë varrosur me ceremoni ushtarake apo se të plagosurit u mjekuan në spitale ushtarake nuk mjafton për të provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se ishin vrarë 45 civilë shqiptarë kosovarë.

340. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se më 15 janar 1999, në Reçak u vranë 45 civilë shqiptarë kosovarë.

4. Pretendim për gabim në konkluzionin se kishte “vendngjarje të inskenuar” dhe se Gjorgjeviqi luajti rol në fshehjen e faktit të përdorimit të forcës së tepruar gjatë operacionit të Reçakut

(a) Hyrje

341. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 18 janar 1999, gjykatësja hetuese Marinković kryen në Reçak hetim të vendit të ngjarjeve të ndodhura më 15 janar 1999.¹¹¹⁷ Policia e çoi në xhami ku ajo pa 40 kufoma, që të gjitha me përjashtim të njëjës ishin kufoma meshkujsh.¹¹¹⁸ Dhoma Gjyqësore konkludoi se vendi që iu tregua gjykatësës hetuese Marinković nuk përkonte me vëzhgimet dhe videofilmimet e vëzhguesve ndërkombëtarë të MVK-së më 16 janar.¹¹¹⁹ Për këtë arsye [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se gjykatësës hetuese Marinković iu tregua një vendngjarje e inskenuar dhe se Gjorgjeviqi kryesoi përpjekjet e MPB-së për fshehjen

¹¹¹⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222. Në lidhje me varrimet, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit K86 për nxjerrjen e konkluzionit se kufomat u varrosën në një kodër përballë xhamisë (Aktgjykimi, sh. 1433, përmendet K86, 28 maj 2009, T. 5189-5190) dhe jo në dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes, Mlladenović, i cili dëshmoi se arkivolet ishin mbështjellë me flamurin shqiptar që sipas dëshmitarit nuk ishte karakteristik në varrimet e civilëve (Shih Branko Mlladenović, 8 mars 2010, T. 12500). Dhoma Gjyqësore u shpreh se dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes në lidhje me Reçakun nuk ishin të besueshme dhe “në shumë pikëpamje [...] të pavërteta” (Aktgjykimi, para. 419). Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gëzonte të drejtën të bazohej në dëshminë e Dëshmitarit K86 dhe jo në dëshminë e Dëshmitarit Mlladenovićit (Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 82; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 21, sh. 12). Në lidhje me mjekimin e të plagosurve në spitalet ushtarake, Dhoma e Apelit i gjykon jobindëse provat e cituara nga Gjorgjeviqi në Dosjen e tij të Apelit (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 222, sh. 368, përmendet Prova Materiale P872, Joseph Maisonneuve, 4 qershor 2009, T. 5544-5545).

¹¹¹⁵ Aktgjykimi, para. 416, 1920. Shih më lart, sh. 1106; Aktgjykimi, para. 407. Shih gjithashtu më poshtë, para. 522-523.

¹¹¹⁶ Aktgjykimi, para. 416, 1920. Shih më lart, para. 338, sh. 1106, 1734.

¹¹¹⁷ Aktgjykimi, para. 412.

¹¹¹⁸ Aktgjykimi, para. 412.

¹¹¹⁹ Aktgjykimi, para. 412, 1924.

e provave mbi përdorimin e forcës së tepruar dhe për paraqitjen e operacionit të Reçakut si operacion legjitim kundërterrorist.¹¹²⁰

(b) Argumentet e palëve

342. Së pari, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se gjykatëses hetuese Marinković iu tregua një “vendngjarje e inskenuar”.¹¹²¹ Ai argumenton se nuk kishte absolutisht asnjë provë në mbështetje të këtij konkluzioni, duke theksuar ndër të tjera se Dhoma Gjyqësore e rrëzoi dëshminë e gjykatëses hetuese Marinković për këtë ngjarje.¹¹²² Së dyti, ai parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se ai “kryesoi përpjekjet e MPB-së për fshehjen e provave mbi përdorimin e forcës jashtëzakonisht të tepruar dhe për paraqitjen e tij si operacion legjitim kundërterrorist”.¹¹²³ Gjorgjeviqi argumenton se “nuk kishte prova në mbështetje” të një konkluzioni të tillë, dhe gjithashtu se “atij nuk bë asnjë akuzë për fshehje’ gjatë dhënies së dëshmisë së tij gojore”.¹¹²⁴ Ai parashtron kundërpretendimin se ka të ngjarë të ketë qenë “UÇK-ja që inskenoi vendngjarjen paraprake të vëzhguar nga MVK-ja më 15 janar pas një luftimi të ashpër me armë zjarri”.¹¹²⁵

343. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se vendngjarja që iu tregua gjykatëses hetuese ishte e inskenuar dhe se Gjorgjeviqi kryesoi përpjekjet e MPB-së për fshehjen e provave mbi përdorimin e forcës së tepruar gjatë operacioneve të pretenduara “kundërterroriste”.¹¹²⁶

(c) Analizë

344. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore pranoi se palët paraqitën “prova të shumta dhe shpesh kundërshtuese,” në lidhje me operacionin e Reçakut; sidoqoftë, Dhoma Gjyqësore gjithashtu pohoi se i kishte analizuar dhe vlerësuar me kujdes të gjitha provat për nxjerrjen e konkluzionit se vendngjarja në Reçak ishte e inskenuar dhe provat u fshehën.¹¹²⁷

345. Dhoma e Apelit thekson se në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk e refuzoi dëshminë e gjykatëses hetuese Marinković, por e analizoi dhe vlerësoi me kujdes kundrejt dëshmive të vëzhguesve ndërkombëtarë të MVK-së të cilët e kryen dhe e

¹¹²⁰ Aktgjykimi, para. 412, 1923-1924.

¹¹²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 223; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 65, përmendet Aktgjykimi, para. 415, 425, 1924.

¹¹²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 223; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 65, përmendet Aktgjykimi, para. 415, 425, 1924.

¹¹²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 224, përmendet Aktgjykimi, para. 1924.

¹¹²⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 224, përmendet Aktgjykimi, para. 1924.

¹¹²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 225.

¹¹²⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 184-186.

¹¹²⁷ Aktgjykimi, para. 396. Shih Aktgjykimi, para. 415.

videofilmuan hetimin e tyre më 16 janar 1999.¹¹²⁸ Dhoma e Apelit vë në dukje se vëzhguesit ndërkombëtarë e kryen hetimin e tyre në pasditen e 16 janarit 1999.¹¹²⁹ Ata dëshmuan kur iu afruan fshatit, panë gjithandej policë dhe gazetarë, si dhe armë të rënda, artileri dhe tanke të UJ-së në faqe të kodrës.¹¹³⁰ Gjatë hetimit, vëzhguesit ndërkombëtarë zbuluan: (i) “mbi 25 kufoma civilësh në fshat përfshirë edhe kufomën e një të moshuari, shumica e të cilëve dukej se ishin ekzekutuar”,¹¹³¹ (ii) kufomën e një të moshuari tjetër në një shtëpi bujku të cilit i kishin prerë kokën;¹¹³² dhe (iii) 20 kufoma në një kanal të cilët dukej se ishin qëlluar në kokë nga afër.¹¹³³ Këto kufoma nuk kishin uniforma dhe “i kishte mbuluar vesa që do të thoshte se kishin qenë aty që nga mëngjesi”.¹¹³⁴ Përfaqësuesit e MVK-së panë kufoma të tjera në Reçak ndër të cilat kufomën e një femre 18-vjeçare dhe të një djaloshi 12-vjeçar.¹¹³⁵ Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore vuri në dukje se dëshmia e dhënë nga gjykatësja hetuese Marinković bëri të qartë se gjatë hetimit të vendngjarjes në Reçak më 18 janar 1999, asaj dhe ekipit të saj iu tregua një vendngjarje që ndryshonte dukshëm nga çfarë kishin parë vëzhguesit ndërkombëtarë të MVK-së.¹¹³⁶ Gjykatësja hetuese Marinković e konfirmoi këtë dhe ndër të tjera dëshmoi se kufomat që pa ajo nuk ishin të njëjtat kufoma që ajo pa në videofilmimin e bërë nga MVK-ja më 16 janar 1999.¹¹³⁷ Ajo e ilustroi këtë duke dëshmuar se kufomat që kishte parë nuk kishin plagë armësh zjarri në kokë dhe se nga 40 kufomat që kishte parë asnjëri nuk i mungonte koka, ndonëse një apo dy prej tyre kishin pasur dëmtime në kokë me sa dukej prej zogjve apo kafshëve të tjera”.¹¹³⁸ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore u bind se së paku disa nga kufomat që kishte parë gjykatësja hetuese Marinković nuk ishin kufomat që shiheshin në videofilmimin e bërë nga vëzhguesit ndërkombëtarë gjatë hetimit të vendngjarjes prej tyre më 16 janar 1999.¹¹³⁹

346. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se gjatë periudhës 15-18 janar 1999, gjykatësja hetuese Marinković u përpoq tri herë që të shkonte në Reçak për kryerjen e hetimit, mirëpo iu

¹¹²⁸ Aktgjykimi, para. 407, 412-413, 415-416. Shih dëshminë gojore të Dëshmitarit Maisonneuve (Joseph Maisonneuve, 3 qershor 2009, T. 5463, 5466-5467; Prova Materiale P851, para. 33-34, 36, 45, 53; P852, f. 5778-5779,

5781-5782, 5786-5787, 5795-5796, 5805, 5844, 5856, 5863; P853, f. 11059, 11170-11172), Drewienkiewicz (Karol John Drewienkiewicz, 22 qershor 2009, T. 6366-6367, 6370-6373; Prova Materiale P996, para. 138, 141-148, 150-152, 154-156, 158-162, 221; P997, f. 7792-7795, 7968, 7971), Ciaglinski (Prova Materiale P832, f. 8; P833, f. 3205-3206; P834, f. 6844-6845), dhe Michael Phillips (Michael Phillips, 1 shtator 2009, T. 8712-8713; Prova Materiale P1303, f. 11854).

¹¹²⁹ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³⁰ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³¹ Aktgjykimi, para. 405.

¹¹³² Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³³ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³⁴ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³⁵ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹³⁶ Aktgjykimi, para. 412-416, 425, 1924. Gjatë gjykimit Gjorgjeviqi parashtrroi teorinë e tij se kush ishte përgjegjës për vendngjarjen e inskenuar (Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 73, 75).

¹¹³⁷ Aktgjykimi, para. 412.

¹¹³⁸ Aktgjykimi, para. 412-413, përmendet Danica Marinković, 18 mars 2010, T. 13083, 13090.

¹¹³⁹ Aktgjykimi, para. 415.

desh të hiqte dorë nga këto përpjekje sepse kundër saj u hap zjarr.¹¹⁴⁰ Vetëm më 18 janar 1999, kur sipas dëshmisë së Gjorgjeviqit vetë ai ishte në stacionin policor të Shtimes për të siguruar vendngjarjen për hetim, ajo arriti të shihte kufomat.¹¹⁴¹ Dhoma Gjyqësore theksoi se gjykatëses Marinković nuk i treguan as kufomat e qëlluara me armë zjarri në kokë, e as gropën që shiheshin në videofilmimin e MVK-së, “por i treguan me sa dukej një shtab të UÇK-së të cilin vëzhguesit e MVK-së nuk e kishin parë”.¹¹⁴² Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 16 janar 1999, vëzhguesit e MVK-së panë një llogore të hapur kohëve të fundit që nuk dukej se ishte përdorur apo se dikush kishte luftuar nga ai vend.¹¹⁴³ Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjykatëse hetuese Marinković i ishte treguar një “vendngjarje e inskenuar”, e përgatitur nga policia për të krijuar përshtypje të gabuar për ngjarjen e vërtetë.¹¹⁴⁴

347. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se pretendimi i Gjorgjeviqit sipas të cilit konkluzioni i Dhomës Gjyqësore ishte i pambështetur në prova, është i gabuar. Gjithashtu, Dhoma e Apelit nxjerr përfundimin se duke marrë parasysh praninë e shumë të policisë dhe të artilerisë së rëndë të UJ-së më 16 janar 1999, faktin se gjykatësja hetuese Marinković u pengua të shkonte në vendngjarje deri më 18 janar, kurse MVK-ja mundi të shkonte në vendngjarje në pasditen e 16 janarit, Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se vendngjarja që iu tregua gjykatëses hetuese Marinković ishte e inskenuar. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë gabim të Dhomës Gjyqësore.

348. Në lidhje me rolin e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit thekson se duke u bazuar në prova rrethore, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai kryesoi përpjekjet e MPB-së për fshehjen e provave mbi përdorimin e forcës së tepruar.¹¹⁴⁵ Dhoma e Apelit rikujton se dhomat gjyqësore kanë të drejtë të nxjerrin konkluzione bazuar mbi prova rrethore.¹¹⁴⁶ Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi dhe e rrëzoi dëshminë e Gjorgjeviqit se ai nuk dinte asgjë për këtë operacion dhe nuk shkoi në Shtime ose në Reçak më 15 janar 1999, duke e

¹¹⁴⁰ Aktgjykimi, para. 411. Gjykatësja hetuese Danica Marinković dhe ekipi i saj u orvatën të kryenin hetimin për herë të parë më 15 janar 1999 në orën 14, herën e dytë më 16 janar rreth orës 10 ose 10:30., dhe herën e tretë në mëngjesin e 17 janarit 1999 (Aktgjykimi, para. 410-411).

¹¹⁴¹ Aktgjykimi, para. 412, 424-425, 1924.

¹¹⁴² Aktgjykimi, para. 415.

¹¹⁴³ Aktgjykimi, para. 407.

¹¹⁴⁴ Aktgjykimi, para. 415. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 411-412. Në lidhje me pretendimin e Gjorgjeviqit se ka më shumë të ngjarë që “UÇK-ja të ketë inskenuar vendngjarjen paraprake që panë vëzhguesit e MVK-së më 15 janar pas një luftimi të ashpër me armë zjarri”, Dhoma e Apelit konkludon se ai nuk citon asnjë provë në mbështetje të këtij pretendimi (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 225). Gjithashtu, Dhoma e Apelit e gjykon të pamundshme që UÇK-ja të kishte mundësinë e inskenimit të vendngjarjes, duke marrë parasysh praninë e shumë të policisë, të mediave dhe të UJ-së në fshat dhe rreth tij që panë vëzhguesit e MVK-së (Aktgjykimi, para. 400-405, 407). Rrjedhimisht, argumentet e tij për këtë pikë hidhen poshtë.

¹¹⁴⁵ Aktgjykimi, para. 1923-1925.

¹¹⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 303. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 56; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 83.

konsideruar të papranueshme në shumë pikëpamje.¹¹⁴⁷ Dhoma Gjyqësore vendosi të bazohej në dëshminë e Dëshmitarit K86, se Gjorgjeviqi ishte në stacionin e policisë në Shtime në kohën kur filloi operacioni i përbashkët i UJ-së dhe MPB-së dhe se ai pati dy biseda telefonike me Shainoviçin.¹¹⁴⁸ Dhoma Gjyqësore e mori parasysh këtë dëshmi së bashku me faktorë si koordinimi i ngushtë midis MPB-së dhe UJ-së gjatë kryerjes së operacionit, faktin se UJ-ja përdori artilerinë e rëndë si edhe faktin se njësitë PJP dhe SAJ ishin të pranishme në terren në nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi “mori përsipër një rol organizues në lidhje me veprimet e policisë në terren”.¹¹⁴⁹ Duke marrë parasysh pozitën e Gjorgjeviqit si zyrtari më i lartë i MPB-së i pranishëm në terren gjatë operacionit dhe vetë dëshminë e tij se më 18 janar 1999 ai ishte në Shtime për të siguruar vendngjarjen për kryerjen e hetimit, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai “kryesoi përpjekjet e MPB-së për të fshehur provat e forcës jashtëzakonisht të tepruar të përdorur nga ana e policisë dhe për të paraqitur operacionin në Reçak si një operacion legjitim kundërterrorist”.¹¹⁵⁰

349. Duke marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, veçanërisht se gjykatëses hetuese iu tregua një vendngjarje e inskenuar dhe përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me tendencën në përgjithësi për përdorimin e forcës së tepruar nga forcat serbe në operacionet e përbashkëta “kundërterroriste” të UJ-së dhe MPB-së, moskryerjen e hetimeve dhe fshehjen e krimeve më 1998 dhe 1999,¹¹⁵¹ Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh duke u bazuar në tërësinë e provave, nuk do të kishte konkluduar se pas operacionit të Reçakut, ai luajti rol drejtues në përpjekjet për fshehjen e përdorimit të forcës së tepruar nga forcat serbe gjatë operacioneve të përbashkëta.

5. Konkluzion

350. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht nën pikën 9(E) të apelit të Gjorgjeviqit.

¹¹⁴⁷ Aktgjykimi, para. 421-425, 1924. Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte qenë i pranishëm në stacionin policor në Shtime së paku më 15 janar 1999.

¹¹⁴⁸ Aktgjykimi, para. 398, 422-425, 1921, përmendet K86, 27 maj 2009, T. 5127-5129, 5131.

¹¹⁴⁹ Aktgjykimi, para. 401-406, 1923.

¹¹⁵⁰ Aktgjykimi, para. 1922-1924.

¹¹⁵¹ Shih Aktgjykimi, para. 2052-2069, 2083-2108.

F. Nënepika 9(F): pretendim për gabime në lidhje me rolin e Gjorgjeviqit në krimet e kryera nga paraushtarakët në Kosovë

1. Hyrje

351. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “kontribuoi ndjeshëm në fushatën e terrorit dhe dhunës së skajshme të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë” ndër të tjera nëpërmjet dislokimit prej tij të paraushtarakëve në Kosovë.¹¹⁵² Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se Gjorgjeviqi “personalisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, mori pjesë në përfshirjen e njësisë famëkeqe paraushtarake “Akrepat” në forcat rezerviste të MPB-së dhe në bashkimin zyrtar të tyre me SAJ-in dhe dislokimin e tyre në Kosovë në mars 1999” të cilët pas ardhjes së tyre vranë 14 gra dhe fëmijë shqiptarë kosovarë në Podujevë.¹¹⁵³ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “mori masa për zbatimin e vendimit për angazhimin e vullnetarëve dhe njësisë paraushtarake” anembanë Kosovës.¹¹⁵⁴ Në lidhje me dislokimin e forcave rezerviste, përfshirë edhe Akrepat, Dhoma Gjyqësore formuloi përfundimin se “njësia e Akrepave që i ishte bashkuar SAJ-it, u dislokua qëllimisht në [Podujevë] si përforsim për të ‘pastruar’ pjesën e qytetit që ende nuk ishte nën kontrollin serb”.¹¹⁵⁵ Gjithashtu, [Dhoma Gjyqësore] arriti në përfundimin se “pjesëtarët e këtyre forcave paraushtarake e shfrytëzuan përgjithshmërinë dhe moskonkretësinë e urdhrit për pastrimin e një pjese të qytetit që ende nuk ishte nën kontrollin serb, duke vranë shqiptarë kosovarë”.¹¹⁵⁶

352. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në lidhje me: (i) natyrën dhe masën e implikimit dhe dijenisë së tij për “mizorinë e kryer në Podujevë më 28 mars 1999” kur pjesëtarë të Akrepave vranë një grup civilësh shqiptarë kosovarë;¹¹⁵⁷ dhe (ii) përgjegjësinë e tij për krimet e kryera nga paraushtarakët të tjerë në Kosovë.¹¹⁵⁸ Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë një nga një këto parashtrime.

2. Pretendim për gabime në lidhje me përgjegjësinë e Gjorgjeviqit për dislokimin e Akrepave

(a) Argumentet e palëve

353. Përgjithësisht, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin e gabuar se atij mund t’i ngarkoheshin krimet në Podujevë.¹¹⁵⁹ Ai paraqet pesë argumente kundër

¹¹⁵² Aktgjykimi, para. 2155, 2158.

¹¹⁵³ Aktgjykimi, para. 2155.

¹¹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 2155.

¹¹⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2142.

¹¹⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2144.

¹¹⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 227, 233.

¹¹⁵⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 227, 236.

¹¹⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 227, 233.

konkluzionit të Dhomës Gjyqësore se dislokimi i rezervistëve kontribuoi në NPK.¹¹⁶⁰ Së pari, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi me konkluzionin se inkuadrimi i forcave rezerviste në SAJ, përfshirë edhe pjesëtarët e Akrepave dhe dislokimin e tyre në Podujevë ishin “kriminale nga këndvështrimi i tij në kohën e marrjes së këtyre vendimeve”.¹¹⁶¹ Së dyti, Gjorgjeviqi argumenton se “nuk kishte prova, dhe Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se [ai] luajti ndonjë rol në një urdhër kriminal që ‘Akrepat’ të pastronin pjesën e qytetit të [Podujevës] që nuk ishte ende nën kontrollin serb”.¹¹⁶² Ai argumenton e konkluzioni më i mundshëm ishte se “një pjesë e vogël e 128 rezervistëve të SAJ-it të dislokuar në [Podujevë] u përfshinë në një argëtim të llahtarshëm me kokën e vet”.¹¹⁶³ Së treti, Gjorgjeviqi parashtron se pas vrasjeve, të gjithë Akrepat u zhvendosën nga Kosova, filluan hetime penale, dhe njësia u çarmatos dhe nuk u dërgua sikurse mund të pritej, “në kërkim të viktimave të tjera”.¹¹⁶⁴ Së katërti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore i anashkaloi hetimet dhe dënimet e mëpasme kundër Akrepave dhe e ngarkoi padrejtësisht me detyrimin për të hetuar krimet,¹¹⁶⁵ duke qenë se ai “nuk kishte asnjë rol me të filluar hetimet gjyqësore”.¹¹⁶⁶ Së pesti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur mori parasysh ridislokimin e rezervistëve të SAJ-it, duke qenë se “ekzistonte një rrjedhim i qartë” se të ridislokuarit në Kosovë në prill 1999 nuk ishin autorët e vrasjeve në Podujevë, duke mbajtur parasysh se nga 128 rezervistët e SAJ-it, faktikisht u ridislokuan 108.¹¹⁶⁷ Ai argumenton se çfarëdo krimi që është kryer gjatë ridislokimit “duhej të ishte formuluar si akuzë dhe vërtetuar”¹¹⁶⁸ dhe pretendon se fakti që kjo nuk u bë i hoqi atij “mundësinë e hetimit” të veprimeve të tilla.¹¹⁶⁹

354. Prokuroria përgjigjet se “Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në zbatimin e NPK-së dhe veproi me synimin e nevojshëm

¹¹⁶⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 227-233.

¹¹⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 69. Ai pretendon se: (i) konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se ai “nuk mund të mos ketë ditur” për vrasjet e kryera nga Akrepat në fillim deri në mes të viteve ’90, ishte spekulim; (ii) vetëm një numër vogël i forcave rezerviste të SAJ-it të dislokuara në Podujevë kishin qenë pjesëtarë të Akrepave; (iii) mungesa e përvojës luftarake të tyre mbështetet nga [provat se rekrutët e rinj “nevojiteshin në një rol ndihmës”]; dhe (iv) për rekrutët e rinj u bë kontroll i të kaluarës së tyre (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 63-64). Gjorgjeviqi gjithashtu argumenton se dihet nga kushdo se videofilmimi i masakrës së Tërnovos të vitit 1995 doli në dritë për herë të parë gjatë gjykimit të Sllobodan Millosheviqit në Tribunal që do të thotë pas vitit 2001 (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 63).

¹¹⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 229; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 70.

¹¹⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 229.

¹¹⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 230; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 71. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT 66-67.

¹¹⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 231. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 72. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 67-68.

¹¹⁶⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 231. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 67-68.

¹¹⁶⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 232. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 68-69.

¹¹⁶⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 232; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 73. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 69-70.

¹¹⁶⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 73.

kur diskoi njësitë paraushtarake ndër të cilat edhe Akrepat, në Kosovë më 1999.”¹¹⁷⁰ Gjithashtu, Prokuroria përgjigjet se “nuk ka rëndësi ligjore fakti se Dhoma Gjyqësore nuk nxori konkluzion se Gjorgjeviqi urdhëroi Akrepat të pastronin një pjesë të qytetit” dhe se veprimet e forcave serbe “vunë në zbatim planin e përbashkët dhe vrasjet që vijuan shihej qartë që ishin në kuadrin e planit të përbashkët”.¹¹⁷¹ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë u bazua në provat mbi krimet e kryera nga Akrepat pas ridislokimit të tyre në Kosovë më 1999 dhe konkludoi se Gjorgjeviqi, duke pasur dijeni të plotë se për ngjarjet në Podujevë nuk ishte kryer hetim i duhur, autorizoi ridislokimit e Akrepave në Podujevë.¹¹⁷²

(b) Analizë

355. Dhoma Gjyqësore konkludoi se dislokimi prej Gjorgjeviqit i njërive paraushtarake dhe rezerviste, përfshirë edhe Akrepat përbënte kontribut në planin e përbashkët.¹¹⁷³ Dhoma e Apelit konstaton se Gjorgjeviqi keqkupton përfundimet e Dhomës Gjyqësore me sugjerimin se [Dhoma Gjyqësore] e deduktoi kontributin e tij nga fakti se inkuadrimi dhe dislokimi ishin kriminalë nga pozita e tij. Dhoma Gjyqësore nuk analizoi nëse inkuadrimi i Akrepave në SAJ dhe dislokimi i tyre në Podujevë ishin “kriminal”.¹¹⁷⁴ Dhoma Gjyqësore e analizoi dislokimin e tyre në kontekstin e përfundimit të vet se forcat serbe (MPB, UJ, dhe forcat e atashuara) u përdorën për krijimin e një atmosfere dhune dhe frike për të detyruar popullatën shqiptare kosovare civile që të largohej si mjet për realizimin e planit të përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës.¹¹⁷⁵ Në këtë kontekst, Dhoma Gjyqësore konkludoi se veprimet e forcave serbe në Podujevë përfshirë edhe veprimet e Akrepave kontribuuan në planin e përbashkët dhe vrasja e grave dhe fëmijëve ishin në kuadër të planit të përbashkët dhe “synonte terrorizimin e popullatës shqiptare kosovare [...] dhe përfundimisht [...] largimin e popullatës nga qyteti”.¹¹⁷⁶ Në nxjerrjen e këtij konkluzioni [Dhoma Gjyqësore] jo vetëm mbajti parasysh se Akrepat ishin një njësi paraushtarake famëkeqe, por gjithashtu se ata u angazhuan pa një

¹¹⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 188. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 190-197; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 119-120, 128.

¹¹⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 193. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 119.

¹¹⁷² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 196-197.

¹¹⁷³ Aktgjykimi, para. 2155, 2158. Gjorgjeviqi gjithashtu kundërshton cilësimin prej Dhomës Gjyqësore të Akrepave si njësi paraushtarake sepse ata “u inkuadruan në forcat rezerviste të SAJ-it dhe u përfshinë në hierarkinë komanduese të SAJ-it, kështu që nuk ishin para çfarëdo qoftë” (Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 65). Sidoqoftë Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi njësia e Akrepave ishte përfshirë në forcat rezerviste të MPB-së me miratimin e Gjorgjeviqit, iu bashkëngjit zyrtarisht SAJ-it dhe ishte nën komandën e SAJ-it (Shih Aktgjykimi, para. 1943. Për këtë arsye cilësimi i Akrepave nga Dhoma Gjyqësore si njësi paraushtarake nuk ka rëndësi.

¹¹⁷⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228, ku Gjorgjeviqi shprehet se “nuk ekzistonte asnjë arsye (përvese hamendësime të mbështetura nga mend pas kuvendit) për konkluzionin se inkuadrimi i [Akrepave] në SAJ dhe dislokimi i tyre në Podujevë ishte kriminal nga pozita e Gjorgjeviqit në kohën e marrjes së këtyre vendimeve”.

¹¹⁷⁵ Aktgjykimi, para. 2142-2144.

¹¹⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2144. Dhoma e Apelit kujton se plani i përbashkët synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës për të mundësuar vijimësinë e kontrollit serb mbi krahinën, nëpërmjet ndërmarrjes së një fushate terrori kundër popullatës civile shqiptare kosovare (Shih Aktgjykimi, para. 2126, 2130), dhe se fushata e terrorit u vu në zbatim nga forcat serbe (UJ, MPB, dhe forcat e atashuara) (Shih gjithashtu më lart, para. 86, 161, 173).

verifikim të së kaluarës së tyre dhe/ose pa stërvitjen e duhur në kontekstin e një konflikti shpërthyes etnik.¹¹⁷⁷ Dhoma e Apelit kujton se veç angazhimit të këtyre njësive, Gjorgjeviqi kontribuoi në NPK nëpërmjet “rolit kyç në koordinimin e veprimtarisë së forcave të MPB-së”.¹¹⁷⁸ Duke qenë përgjegjës për këtë koordinim, Gjorgjeviqi “dinte se policia përdori forcë të tepruar më 1998” dhe gjithashtu dinte për “armatosjen e popullatës civile serbe në Kosovë [...] më 1998 dhe 1999”.¹¹⁷⁹ Gjorgjeviqi nuk arrin të shpjegojë se si nuk përbën kontribut në NPK, dërgimi i forcave shtesë përfshirë edhe njësi paraushtarake famëkeqe në ndihmë të këtyre operacioneve.

356. Më tej, në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se ai “nuk mund të mos ketë ditur” për të kaluarën kriminale të Akrepave.¹¹⁸⁰ Dhoma Gjyqësore faktikisht konkludoi se Gjorgjeviqi “nuk mund të mos ketë ditur se ata ekzistonin dhe së paku,” për *praninë* e tyre ndër rezervistët që do të dërgoheshin në Kosovë.¹¹⁸¹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se dijenia e Gjorgjeviqit për *praninë* e Akrepave vinte në pah “nevojën për kontrollimin e biografive të [rezervistëve] siç parashikohet me ligj”.¹¹⁸² Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi: (i) nuk mundësoi që këto njësi të kishin stërvitje luftarake bazë; (ii) faktikisht nuk bëri verifikim të biografive të tyre; dhe (iii) pasi u informua për krimet e kryera nga Akrepat në Podujevë, vendosi për ridislokimit e menjëhershëm të kësaj njësie.¹¹⁸³ Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi në NPK duke pasur synimin e nevojshëm, bazuar në faktorë të shumtë, si roli i tij në fshehjen e kufomave, pozita e tij e lartë në MPB, dhe fakti se ai ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e MPB-së që kryen krime në Kosovë.¹¹⁸⁴ Në këtë kontekst Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se dislokimi i rezervistëve përbënte kontribut në NPK.¹¹⁸⁵ Bazuar në përfundimet e marra parasysht nga Dhoma Gjyqësore dhe kontekstin e dislokimit, Dhoma e Apelit është bindur se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i

¹¹⁷⁷ Aktgjykimi, para. 1955. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se vetëm një numër i vogël i pjesëtarëve të parë të Akrepave ishin në grupin që u dërgua në Podujevë (shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 64), Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore e analizoi konkretisht këtë pikë (Shih Aktgjykimi, para. 1937). Sërish, Gjorgjeviqi sugjeron se Dhoma Gjyqësore u bazua tej mase në të kaluarën kriminale të Akrepave duke e përdorur si bazë për konkluzionin se ai kontribuoi në NPK. Dhoma e Apelit gjykon se nuk është kështu: Dhoma Gjyqësore konkretisht mori parasysht se vetëm një numër i vogël i ish-pjesëtarëve të Akrepave u dislokuan në Podujevë, dhe theksoi se gjysma e tyre ishin të pastërvitur, bënë vetëm stërvitje njëditore në përdorimin e pushkëve automatike dhe nuk morën asnjë udhëzim për trajtimin e civilëve (Shih Aktgjykimi, para. 1937). Gjithsesi ata u pajisën me uniforma, emblemën e Akrepave, armë dhe u dërguan në një konflikt të ashpër etnik (Shih Aktgjykimi, para. 1937, 1955).

¹¹⁷⁸ Aktgjykimi, para. 2154.

¹¹⁷⁹ Aktgjykimi, para. 2154.

¹¹⁸⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 63.

¹¹⁸¹ Aktgjykimi, para. 1953. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228(a).

¹¹⁸² Aktgjykimi, para. 1953. Gjithashtu rrëzohet argumenti i Gjorgjeviqit në lidhje me masakrën në Tërnovë më 1995 (Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 63).

¹¹⁸³ Aktgjykimi, para. 1955, 1966.

¹¹⁸⁴ Shih më lart, para. 166-169, 209-210. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2027-2035.

¹¹⁸⁵ Shih Aktgjykimi, para. 2154-2155.

arsyeshëm faktesh nuk do të kishte konkluduar se ai kontribuoi në NPK-së nëpërmjet dislokimit të rezervistëve.

357. Në lidhje me pretendimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore “nuk mori parasysh prova që tregonin se faktikisht u bënë verifikime të cilat nuk nxorën gjë”,¹¹⁸⁶ Dhoma e Apelit thekson se individë brenda njësisë së Akrepave që u dërgua në Kosovë, kishin dosje penale në kohën e dislokimit të tyre.¹¹⁸⁷ Kur biografitë e tyre u kontrolluan pas tërheqjes së tyre nga Kosova pas ngjarjeve në Podujevë në maj 1999, u konkludua se “në radhët e tyre ka njerëz kriminelë dhe problematikë”.¹¹⁸⁸ Duke marrë parasysh detyrimin e qartë ligjor të Gjorgjeviqit për të garantuar angazhim rezervistësh pa të kaluar kriminale,¹¹⁸⁹ dhe faktin se pas verifikimit të duhur të tyre, faktikisht u zbulua se kishte rezervistë me të kaluar kriminale,¹¹⁹⁰ Dhoma e Apelit është bindur se Gjorgjeviqi nuk garantoj verifikimin e duhur të së kaluarës kriminale të rezervistëve ndër të cilët edhe pjesëtarët e njësisë së Akrepave të cilët u dislokuan në Kosovë.

358. Përsa i përket parashtrimit të Gjorgjeviqit në lidhje me nxjerrjen e urdhrin për “pastrimin” e Podujevës,¹¹⁹¹ Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimin të gjykatës Tuzmukhamedovit gjykon se për konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se dislokimi i forcave rezerviste në Kosovë përbënte kontribut në NPK, nuk është me rëndësi fakti nëse Gjorgjeviqi lëshoi apo nuk lëshoi urdhrin. Dhoma Gjyqësore e analizoi vendimin e Gjorgjeviqit për dislokimin e Akrepave në kontekst të pozitës së tij të rëndësishme si zyrtar, urdhrin të tij për angazhimin e paraushtarakëve dhe vullnetarëve dhe kontributet e tij të tjera në NPK.¹¹⁹² Duke mbajtur parasysh se kontributi i tij në NPK ndër të tjera përfshiu dislokimin e Akrepave, Dhoma e Apelit gjykon se nuk ka rëndësi fakti se urdhri i drejtpërdrejtë për Akrepat nuk u lëshua nga Gjorgjeviqi. Gjithashtu, Dhoma e Apelit rikujton se urdhri për “pastrimin” e qytetit u lëshua nga udhëheqësi i Akrepave dhe se ishte Gjorgjeviqi ai që mori vendimin për inkuadrimin dhe dislokimin e kësaj njësie në Kosovë.¹¹⁹³ Gjithashtu, Dhoma e Apelit nuk bindet nga parashtrimi i Gjorgjeviqit se “shpjegimi më i mundshëm ishte se një numër i vogël i 128 rezervistëve të SAJ-it [...] u përfshinë në një argëtim të llahtarshëm”,¹¹⁹⁴ apo se tërheqja e Akrepave, çarmatosja e rezervistëve apo dhënia e ndihmës së parë pas vrasjes së civilëve në Podujevë në njëfarë mënyre neutralizon konkluzionin e Dhoma Gjyqësore se Gjorgjeviqi

¹¹⁸⁶ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 228(c); Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 64-65.

¹¹⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1954.

¹¹⁸⁸ Aktgjykimi, sh. 6728, përmendet Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5666-5667.

¹¹⁸⁹ Aktgjykimi, para. 1955.

¹¹⁹⁰ Aktgjykimi, para. 1954.

¹¹⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 229.

¹¹⁹² Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹¹⁹³ Shih Aktgjykimi, para. 1238; Prova Materiale P493, para. 46.

¹¹⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 229.

angazhoi individë që kryen krime.¹¹⁹⁵ Sidoqoftë këto parashtrime rezultojnë të pavlera për shkak të vendimit të Gjorgjeviqit që autorizoi “ridislokimin e pjesëtarëve të së njëjtës njësi në Kosovë pak ditë” pas masakrës.¹¹⁹⁶

359. Në lidhje me pretendimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore “e ngarkoi padrejtësisht me detyrimin për të hetuar masakrën”,¹¹⁹⁷ Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se megjithëse u informua për krimet në Podujevë në ditën që u kryen, Gjorgjeviqi nuk mori kurrfarë masash kundër oficerëve të policisë të cilët nuk e përmendën këtë incident në raportin e tyre.¹¹⁹⁸ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se kufomat e viktimave kishin mbetur në oborr deri më 30 mars 1999 kur gjykatësi hetues kreu një hetim paraprak.¹¹⁹⁹ Gjithsesi në raportin hetimor vetëm një viktimë identifikohet me emër e mbiemër, nuk përmendet përkatësia etnike e asnjë viktime e as autorët e krimit dhe nuk rezultoi në ndërmarrjen e ndonjë veprimi pas ngjarjes.¹²⁰⁰ Më tej Dhoma Gjyqësore konkludoi se raporti i mëvonshëm i 13 majit 1999 në lidhje me angazhimin e forcave rezerviste me SAJ-in, paraqitur nga Gjorgjeviqi, nuk përmbante masat e marra kundër njësisë rezerviste dhe në vend të ndëshkimit të ndonjë prej të dyshuarve për krim, përmendte ridislokimin e tyre të menjëhershëm.¹²⁰¹ Ndonëse depozitimi i një kallëzimi penal më 23 maj 1999, faktikisht rezultoi në paraburgimin e përkohshëm të dy pjesëtarëve të Akrepave për 10 ditë,¹²⁰² Dhoma Gjyqësore konstatoi se faktikisht këta individë as u proceduan penalisht, e as u dënuan dhe se “gjatë gjithë kohës që [Gjorgjeviqi] ushtroi detyrën e shefit të RJB-së, asnjë person i vetëm nuk u ndoq penalisht për krimet e kryera në Podujevë.”¹²⁰³ Bazuar në këto përfundime, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimin të gjykatës Tuzmukhamedovit, është bindur se Dhoma Gjyqësore nuk e ngarkoi me detyrim të padrejtë Gjorgjeviqin dhe arriti në konkluzionin e arsyeshëm se ai “ishite plotësisht i vetëdijshëm për moskryerjen e hetimit dhe se, megjithëse e dinte këtë gjë, përsëri miratoi ridislokimin e pjesëtarëve të së njëjtës njësi në Kosovë për të marrë pjesë në operacione të tjera”.¹²⁰⁴

¹¹⁹⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 230. Gjithashtu, Dhoma e Apelit nuk është bindur se dhënia e ndihmës mjekësore nga një njësi tjetër dhe jo nga Akrepat, ndikon në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me veprimet e Akrepave (Shih Aktgjykimi, para. 1253; Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 389).

¹¹⁹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 2155. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1947-1948.

¹¹⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 231.

¹¹⁹⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1258, 1958, 1963.

¹¹⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1959. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1258.

¹²⁰⁰ Aktgjykimi, para. 1960, përmendet Prova Materiale D441.

¹²⁰¹ Aktgjykimi, para. 1961, përmendet Prova Materiale D442.

¹²⁰² Aktgjykimi, para. 1962, përmendet Prova Materiale P1592, P1593.

¹²⁰³ Aktgjykimi, para. 1962. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më në fund gjykimi kundër Sasha Cvetanit filloi në gjykatën e qarkut të Prokuplës dhe iu kalua gjykatës së qarkut të Beogradit duke qenë se ishte e qartë që ushtrohej presion mbi dëshmitarët (Aktgjykimi, para. 1962, përmendet Prova Materiale P493, para. 83-88, Goran Stopariq, 26 mars 2009, T. 2845-2849, 2867-2868, Prova Materiale P40, P41).

¹²⁰⁴ Aktgjykimi, para. 1966.

360. Duke kaluar në argumentin e pestë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore pranoi shprehimisht se disa nga të dyshuarit për krimet në Podujevë ishin larguar nga njësia e Akrepave para ridislokimit.¹²⁰⁵ Gjithsesi, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtit të gjykatës Tuzmukhamedovit, gjykon se konstatimi se disa pjesëtarë të kësaj njësie ishin larguar, nuk ka asnjë ndikim në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ridislokimi i njësisë tregoi sërish kontributin e tij në realizimin e NPK-së.¹²⁰⁶ Për më tepër, Dhoma e Apelit rikujton se menjëherë pas masakrës nuk u krye asnjë hetim i mirëfilltë.¹²⁰⁷ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtit të gjykatës Tuzmukhamedovit bindet se ridislokimi i pjesës më të madhe të njësisë menjëherë pas kryerjes së masakrës dhe moskryerja e hetimit penal të mirëfilltë vërtetojnë konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se ridislokimi i paraushtarakëve u bë për realizimin e NPK-së.¹²⁰⁸

361. Gjithashtu, Dhoma e Apelit e gjykon të pavlerë pretendimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte se Akrepat kryen krime pas ridislokimit të tyre.¹²⁰⁹ Dhoma Gjyqësore e përdori ridislokimin e tyre në funksion të theksimit të përfundimit të vet se Gjorgjeviqi nuk ndërmori asnjë hetim penal të mirëfilltë të ngjarjeve në Podujevë.¹²¹⁰ Gjithsesi dhe në ndryshim nga pretendimi i Gjorgjeviqit se këto ngjarje duhej të ishin “formular si akuzë dhe provuar”,¹²¹¹ Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë gojore të dëshmitarit Goran Stopariq (“Dëshmitar Stopariq”) se pjesëtarët e ridislokuar të Akrepave bashkëvepruan me forcat e UJ-së dhe të MPB-së për ndjekjen e “terroristëve shqiptarë dhe pushtimin e fshatrave dhe lagjeve, proces që ai e përshkroi si ‘pastrim’”.¹²¹²

362. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi në NPK nëpërmjet dislokimit të Akrepave dhe kur e shpalli fajtor për krimet e kryera në Podujevë.

3. Pretendim për gabim në fajësimin e Gjorgjeviqit për paraushtarakë të tjerë që vepronin në

Kosovë

(a) Hyrje

363. Dhoma Gjyqësore konkludoi se “në Kosovë ishin të pranishme në terren disa grupe paraushtarake [...] të cilat bashkëvepronin kryesisht me forcat e MPB-së si forca plotësuese të

¹²⁰⁵ Aktgjykimi, para. 1946.

¹²⁰⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1946-1948.

¹²⁰⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1966.

¹²⁰⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1948, 1966. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹²⁰⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 232.

¹²¹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1948, 1964-1966.

¹²¹¹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 232; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 73. Shih më lart, para. 293.

tyre”.¹²¹³ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “mori masa për zbatimin e vendimit për angazhimin e vullnetarëve dhe njërive paraushtarake duke u dërguar të gjitha SPB-ve në Serbi një telegram me kërkesë që ato të vendosnin kontroll të plotë mbi vullnetarët dhe njësitë paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre.”¹²¹⁴ Në nxjerrjen e këtij konkluzioni Dhoma Gjyqësore mori parasysh: (i) dislokimin e Akrepave në Podujevë;¹²¹⁵ (ii) dijeninë e Gjorgjeviqit për paraushtarakë që vepronin në Kosovë;¹²¹⁶ dhe (iii) telegramet e shumta ndër të cilët një telegram të 18 shkurtit 1999 (“Telegrami”) që tregonte synimin e Gjorgjeviqit “për të angazhuar paraushtarakët në operacione kundërterroriste para fillimit të luftës”.¹²¹⁷

(b) Argumentet e palëve

364. Gjorgjeviqi parashtron se “Dhoma Gjyqësore pa arsye u mbështet në implikimin e tij në dislokimin e “Akrepave” për ta fajësuar atë për të gjitha veprimet e të gjithë paraushtarakëve që vepronin në Kosovë” dhe se përfundimet e [Dhomës Gjyqësore] në lidhje me rolin e grupeve të ndryshme paraushtarake në Kosovë nuk provojnë se këto grupe “u përdorën nga anëtarë të NPK-së sikurse kërkohet me qëllim që atij të mund t’i ngarkohet përgjegjësi penale”.¹²¹⁸ Gjorgjeviqi parashtron se: (i) përveç angazhimit të Akrepave prej tij, nuk kishte asnjë bazë për konkluzionin se paraushtarakët u inkuadruan në radhët e RJB-së; (ii) edhe sikur Telegrami të interpretohej kundër tij, nuk kishte asnjë provë që vërtetonte se paraushtarakët u inkuadruan në MPB dhe UJ dhe u përdorën prej tyre; dhe (iii) përfundimet në lidhje me grupet paraushtarake si Tigrat e Arkanit, Shqiponjat e Bardha dhe Merimangat nuk janë të mjaftueshme dhe nuk tregojnë se këto grupe u përdorën për kryerjen e krimeve.¹²¹⁹ Gjithashtu Gjorgjeviqi argumenton se “Dhoma Gjyqësore nuk kishte të drejtë të interpretonte [Telegramin] kundër tij” sepse nuk mori parasysh dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit se “SPB-së gjykuan se Telegrami ishte një urdhër për të penguar pranimin e vullnetarëve”.¹²²⁰

365. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore “u mbështet në prova të forta për konkluzionin se paraushtarakët u inkuadruan në MPB dhe UJ dhe u përdorën prej tyre”.¹²²¹ Prokuroria argumenton se: (i) Dhoma Gjyqësore u bazua në dëshmitë e disa dëshmitarëve kur konkludoi se në Kosovë vepronin grupe paraushtarake;¹²²² (ii) argumentet e Gjorgjeviqit janë

¹²¹² Aktgjykimi, para. 1948.

¹²¹³ Aktgjykimi, para. 1927.

¹²¹⁴ Aktgjykimi, para. 2155.

¹²¹⁵ Aktgjykimi, para. 1928.

¹²¹⁶ Aktgjykimi, para. 1928.

¹²¹⁷ Aktgjykimi, para. 1929, sh. 6616.

¹²¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 234.

¹²¹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 234.

¹²²⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 235; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 75.

¹²²¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 198.

¹²²² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 198.

të pambështetura, të paqarta dhe të pashtjelluara;¹²²³ (iii) anëtarët e NPK-së “përdorën [grupe paraushtarake] për kryerjen e krimeve që ishin në kuadër të qëllimi të përbashkët kriminal”;¹²²⁴ (iv) Telegrami dhe dokumente të tjera tregojnë se “angazhimi i forcave paraushtarake me forcat e MPB-së në Kosovë” ishte një vendim i përbashkët;¹²²⁵ (v) Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhej dëshminë e Dëshmitar Cvetiqit;¹²²⁶ dhe (vi) Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi kontribuoi në NPK nëpërmjet dislokimit të paraushtarakëve, duke u bazuar në tërësinë e provave.¹²²⁷

(c) Analizë

366. Fillimisht, Dhoma e Apelit kundërshton argumentin e Gjorgjeviqit se “nuk kishte prova që shërbenin si bazë”¹²²⁸ për konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se grupet paraushtarake bashkëvepronin “kryesisht me forcat e MPB-së si forca plotësuese të tyre”.¹²²⁹ Për nxjerrjen e këtij konkluzioni, Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshmi gojore dhe provat shkresore përkatëse se grupe paraushtarake si Tigrat e Arkanit,¹²³⁰ Shqiponjat e Bardha,¹²³¹ dhe Merimangat,¹²³² luajtën rol aktiv në operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së.¹²³³ Ndër to pati edhe prova që tregonin se këto njësi paraushtarake furnizuan RDB-në me efektiva të tyre dhe se ata mbanin dokumente identifikuese të RDB-së.¹²³⁴ Gjithashtu, Dhoma e Apelit rikujton konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi angazhoi si rezervistë në forcat serbe në Kosovë një grup paraushtarak që njiheshin si Akrepat.¹²³⁵ Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore dhe si rrjedhojë nuk ka arritur të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se njësitë paraushtarake bashkëvepruan me forcat e MPB-së dhe të UJ-së në Kosovë dhe në disa raste u përfshinë në planet e këtyre forcave.

¹²²³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 199.

¹²²⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 200.

¹²²⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 202.

¹²²⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 203.

¹²²⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 203-204.

¹²²⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 234.

¹²²⁹ Aktgjykimi, para. 194, 1927.

¹²³⁰ Aktgjykimi, para. 209-210, përmendet, ndër të tjera, Nikë Peraj, 18 shkurt 2009, T. 1211, Nikë Peraj, 20 shkurt 2009, T. 1266, Adnan Merovci, 13 mars 2009, T. 2210-2211, Sada Lama, 24 prill 2009, T. 3698, Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5668-5670, 5681, Baton Haxhiu, 18 qershor 2009, T. 6226, K89, 26 gusht 2009, T. 8547, 8567-8568, Prova Materiale P283, f. 4, P313, para. 38, 80, P416, para. 44, P661, f. 2-3, P793, f. 7086, P798, f. 2, P884, f. 1, P1274, f. 9127, 9224-9225, P1400, para. 15, P994, f. 6092, 6133.

¹²³¹ Aktgjykimi, para. 212, 214, përmendet Nikë Peraj, 20 shkurt 2009, T. 1258, Hysni Kryeziu, 5 qershor 2009, T. 5607-5608, Bajram Bucaliu, 25 maj 2009, T. 5054, Prova Materiale P313, para. 12, 95, P420, f. 4, P512, para. 35.

¹²³² Aktgjykimi, para. 216, përmendet Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5663, 5680, Aleksandar Vasileviq, 11 qershor 2009, T. 5908, 5921, Prova Materiale D723, f. 19778-19780, P884, f. 1.

¹²³³ Aktgjykimi, para. 208-216 (dhe referencat e atjeshme).

¹²³⁴ Aktgjykimi, para. 209, përmendet Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5669-5670, Prova Materiale P884, f. 1.

¹²³⁵ Shih më lart, para. 351.

367. Gjithashtu, Dhoma e Apelit thekson se argumenti i Gjorgjeviqit sipas të cilit synimi i Telegramit ishte “të parandalohet angazhimi gjerësisht i paraushtarakëve në Kosovë, në përputhje me masat parandaluese të marra nga Gjorgjeviqi më 1998”¹²³⁶ është përsëritje e argumentit të tij gjatë gjykimit.¹²³⁷ Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë pse Telegrami ishte një udhëzim “për parandalimin e përdorimit të paraushtarakëve dhe vullnetarëve që vepronin në Kosovë”, dhe jo “një udhëzim mjaft i qartë” për angazhimin e vullnetarëve sikurse konkludoi Dhoma Gjyqësore.¹²³⁸ Në analizën e vet, Dhoma Gjyqësore mori parasysh formulimin e Telegramit përfshirë edhe nevojën për “vendosjen e kontrollit të plotë mbi njësitë vullnetare dhe paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre”¹²³⁹ dhe telegramin vijues të dërguar nga ministër Stojilkoviqi që i referohej Telegramit dhe bënte fjalë për “angazhimin e pritur të njërive paraushtarake në Kosovë”.¹²⁴⁰ Po ashtu Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova të mbledhjeve të qeverisë në të cilat mori pjesë Gjorgjeviqi dhe ku u diskutua inkuadrimi i vullnetarëve në MPB si dhe mbi përfshirjen personale dhe të drejtpërdrejtë të Gjorgjeviqit në dislokimin e Akrepave në Kosovë në mars 1999.¹²⁴¹

368. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtit të gjykatës Tuzmukhamedovit bindet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi që u bazua në përmbajtjen e Telegramit apo rolin e Gjorgjeviqit në dislokimin e Akrepave për nxjerrjen e konkluzionit se ai kishte synim angazhimin e paraushtarakëve në operacionet e MPB-së në Kosovë, dhe jo kufizimin e angazhimit të tyre.

369. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykon se Dhoma Gjyqësore bëri një interpretim të arsyeshëm të dëshmisë gojore të Dëshmitar Cvetiqit.¹²⁴² Në ndryshim nga parashtrimi i Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit konstaton se Dëshmitar Cvetiqi u shpreh qartësisht se paraushtarakët dhe vullnetarët duhej të vihehin “nën kontroll”.¹²⁴³ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi këtë deklaratë në kontekst të provave shtesë se gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës në Kosovë vepronin një numër grupesh paraushtarake që bashkëvepronin me forcat e MPB-së,¹²⁴⁴ se Gjorgjeviqi kishte dijeni për këto njësi,¹²⁴⁵ dhe se ai dhe ministër Stojilkoviqi dërguan telegrame ku MPB-së i kërkohej të vendoste “plotësisht kontroll mbi njësitë paraushtarake dhe vullnetare” dhe t’i angazhonte sipas nevojave.¹²⁴⁶ Bazuar në këto

¹²³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 235.

¹²³⁷ Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 101.

¹²³⁸ Aktgjykimi, para. 2021.

¹²³⁹ Aktgjykimi, sh. 6616, përmendet Prova Materiale P356.

¹²⁴⁰ Aktgjykimi, sh. 6616, përmendet Prova Materiale P702.

¹²⁴¹ Aktgjykimi, para. 1928.

¹²⁴² Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 235.

¹²⁴³ Shih Aktgjykimi, sh. 6616; Lubinko Cvetiq, 1 korrik 2009, T. 6679.

¹²⁴⁴ Aktgjykimi, para. 194.

¹²⁴⁵ Aktgjykimi, para. 1927-1929.

¹²⁴⁶ Aktgjykimi, sh. 6616. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova shtesë që vërtetonin kontrollin e MPB-së mbi njësitë. Ndër provat e shqyrtuara nga Dhoma Gjyqësore ishte procesverbali i një

përfundime, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë parashtrimin e tij se përfundimet e Dhomës Gjyqësore “nuk arrijnë” të provojnë se anëtarë të NPK-së përdorën forca paraushtarake në kryerjen e krimeve.¹²⁴⁷

370. Bazuar në analizën e mësipërme, Dhoma e Apelit bindet se Dhoma Gjyqësore formuloi konkluzionin e arsyeshëm se grupet paraushtarake u inkuadruan në MPB dhe bashkëvepruan me forcat e MPB-së në kryerjen e krimeve në Kosovë gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës.

4. Konkluzion

371. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatës Tuzmukhamedovit është bindur për arsyeshmërinë e konkluzionit të Dhomës Gjyqësore sipas të cilit Gjorgjeviqi u përfshi dhe ishte në dijeni të dislokimit të njësive paraushtarake në Kosovë, përfshirë edhe dislokimin e Akrepave në Podujevë, në bashkëpunim me forcat e MPB-së dhe RJB-së dhe se kjo ishte pjesë e kontributit të tij të ndjeshëm në NPK.¹²⁴⁸ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht nënpikën 9(F).

G. Nën-pika 9(G): pretendim për gabime në lidhje me rolin e Gjorgjeviqit në fshehjen e krimeve

1. Hyrje

372. Dhoma Gjyqësore konkludoi se, që prej marsit 1999, ndër zyrtarët e lartë të qeverisë së RFJ-së ekzistonte një plan për fshehjen e krimeve të kryera kundër civilëve shqiptarë kosovarë nga forcat serbe në Kosovë, nëpërmjet fshehjes së kufomave.¹²⁴⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi luajti drejtpërsëdrejti rol udhëheqës në operacionin e fshehjes.¹²⁵⁰ Gjithashtu u konkludua se ky plan ishte “dëshmi e fuqishme se vrasjet ishin pjesë e planit të përbashkët për terrorizimin e një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare për ta bërë që të largohesh nga Kosova [...] [dhe] gjithashtu dëshmi e marrëveshjes së fshehtë dhe synimit të

mbledhjeje të Shtabit të MPB-së në Prishtinë më 17 shkurt 1999 ku gjeti një citim të një deklaratë të ministër Stojilkoviqit si vijon “vullnetarët duhen trajtuar dhe përdorur me kujdes, duke e kushtëzuar angazhimin e tyre përmes forcave rezerviste të policisë me domosdoshmërinë” (Aktgjykimi, para. 195). Ditën e nesërme, Gjorgjeviqi u dërgoi një telegram RDB-së dhe të gjitha SPB-ve në Serbi i cili përmbante pak a shumë të njëjtën porosi (Aktgjykimi, para. 195). Gjithashtu, më 24 mars 1999, Stojilkoviqi u dërgoi një telegram tjetër shefit të RJB-së, selisë së njësive organizative të RJB-së, të gjitha SPB-ve, Shtabit të MPB-së në Prishtinë dhe të gjitha stacioneve të policisë rrugore ku u kërkonte të bënin “regjistrimin e vullnetarëve dhe njësive paraushtarake dhe pjesëtarëve të tyre dhe vendosjen e kontrollit mbi ta në rast të nevojës për angazhimin” (Aktgjykimi, para. 195).

¹²⁴⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 234.

¹²⁴⁸ Aktgjykimi, para. 2158.

¹²⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1980-1981, 2117. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1967.

¹²⁵⁰ Aktgjykimi, para. 1972, 2211.

përbashkët të Millosheviqit, Stojilkoviqit, [...] Gjorgjeviqit dhe Markoviqit për përdorimin, midis të tjerash, të forcave të MPB-së për të kryer krime dhe fshehur gjurmët e tyre”.¹²⁵¹

373. Për nxjerrjen e konkluzionin se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave Dhoma Gjyqësore mori parasysh mosraportimin dhe moshetimin e krimeve të kryera nga pjesëtarë të MPB-së dhe UJ-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë.¹²⁵² U konkludua se “mosraportimi dhe moshetimi i krimeve të kryera nga pjesëtarë të MPB-së dhe UJ-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë në vetvete tregon se kishte një plan për fshehjen e këtyre vrasjeve”.¹²⁵³ Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh shënimet zyrtare të një grupi pune (përkatësisht “Shënimet e Grupit të Punës” dhe “Grupi i Punës”) formuar nga qeveria serbe më 2001.¹²⁵⁴ Në Shënimet e Grupit të Punës konstatohet se gjatë një mbledhjeje të mbajtur në mars 1999, Gjorgjeviqi “ngriti çështjen e ‘pastrimit të terrenit’ në Kosovë”¹²⁵⁵ dhe se gjatë një mbledhjeje të mëpasme të Kolegjiumit të MPB-së në mars 1999, Gjorgjeviqit iu dha urdhër të zhdukte gjurmët e viktimave civile.¹²⁵⁶ Dhoma Gjyqësore konkludoi se “pastrim i terrenit” nënkuptonte “fshehjen e kufomave të personave të vrarë nga forcat serbe gjatë operacioneve kundërterroriste, duke përfshirë edhe personat që nuk morën pjesë aktive në luftime”.¹²⁵⁷

374. Në kuadrin e nënpikës 9(G), Gjorgjeviqi paraqet tri argumente kryesore. Ai parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në: (i) konkluzionin se fshehja e kufomave ishte kontribut në NPK;¹²⁵⁸ (ii) interpretimin e Shënimeve të Grupit të Punës dhe konkluzionin se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave;¹²⁵⁹ dhe (iii) zbatimin e një standardi të padrejtë në lidhje me përfundimet për rolin e tij në operacionet e fshehjes.¹²⁶⁰ Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë me radhë argumentet e lartpërmendura.

2. Pretendim për konkluzion të gabuar se fshehja e kufomave përbënte kontribut në NPK

(a) Argumentet e palëve

375. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur arriti në konkluzionin se fshehja e kufomave përbënte kontribut në NPK.¹²⁶¹ Ai gjithashtu argumenton se fshehja e kufomave është një veprim *ex post facto* që nuk mund të kontribuojë në një krim më të hershëm.¹²⁶² Sipas

¹²⁵¹ Aktgjykimi, para. 2025.

¹²⁵² Aktgjykimi, para. 2111.

¹²⁵³ Aktgjykimi, para. 2111.

¹²⁵⁴ Aktgjykimi, para. 1289, 2112.

¹²⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2112. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2025.

¹²⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2025, 2112.

¹²⁵⁷ Aktgjykimi, para. 2025, 2116.

¹²⁵⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 237-267.

¹²⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 244-251.

¹²⁶⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 252-267; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 80.

¹²⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 77.

¹²⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240.

tij, përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me fshehjen e kufomave mund të çojnë në fajësi në bazë të përgjegjësisë së eprorit në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 7 të Statutit, mirëpo nuk mund të jenë bazë për konkluzionin se veprimet e tij përbëjnë kontribut në NPK në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit.¹²⁶³ Gjorgjeviqi parashtron se ky përfundim “mjegullon” dallimin midis dy kategorive të përgjegjësisë penale.¹²⁶⁴

376. Më tej Gjorgjeviqi parashtron se mungojnë provat që do të vërtetonin lidhjen midis operacioneve të fshehjes dhe NPK-së¹²⁶⁵ sepse: (i) në kundërshtim me çfarëdo plani fshehjeje, përfundimet e Dhomës Gjyqësore tregojnë se u ndërmorën hetime në lidhje me zbulimin e kamionit-frigorifer në lumin Danub;¹²⁶⁶ (ii) Dhoma Gjyqësore “nuk mundi të formulonte përfundime konkrete kundër ‘zyrtarëve të tjerë të lartë konkretë politikë, ushtarakë dhe të MPB-së’” në lidhje me fshehjen e kufomave;¹²⁶⁷ dhe (iii) konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se “në të gjitha nivelet e MPB-së dhe UJ-së” kishte ‘konspiracion heshtjeje’, zhvlerësohet nga përfundimet e tjera.¹²⁶⁸ Sipas Gjorgjeviqit, i vetmi element kundër argumentit të tij është “sugjerimi i një mbledhjeje në mars 1999” bazuar në “provat tejet jo të besueshme të Grupit të Punës”.¹²⁶⁹

377. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se fshehja e kufomave kontribuoi në NPK.¹²⁷⁰ Parashtrohet se Gjorgjeviqi “bën cilësim të gabuar të operacionit të fshehjes si ndihmë pas faktit”, kurse provat tregojnë se plani ekzistonte që në vigjilje të sulmeve të NATO-s.¹²⁷¹ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se duke pretenduar se u bënë përpjekje për hetimin e krimeve, Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e Dhomës Gjyqësore dhe provat sipas të cilave ai pengoi çfarëdo hetimi të fshehjes së kufomave.¹²⁷²

(b) Analizë

378. Dhoma e Apelit e gjykon jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se fshehja e krimeve në këtë çështje është një veprim *ex post facto* që si rrjedhojë nuk mund të kontribuojë në një krim

¹²⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240. Gjorgjeviqi vëren se veprimet mund të ndihmojnë dhe inkurajojnë një krim të mëparshëm në qoftë se një bashkëfajtor “ka rënë dakord që më parë me autorin e drejtpërdrejtë për dhënien e ndihmës në fjalë” (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240, përmendet Aktgjykimi *Aleksovski*, para. 62, Aktgjykimi *Bllagojeviq dhe Jokiq*, para. 731, 745).

¹²⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240.

¹²⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 243.

¹²⁶⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 242, përmendet Aktgjykimi, para. 1293-1296.

¹²⁶⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 243, përmendet Aktgjykimi, para. 2119.

¹²⁶⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 241, përmendet Aktgjykimi, para. 2108.

¹²⁶⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 243. Gjithashtu Gjorgjeviqi argumenton se në qoftë se do të kishte ekzistuar plan për “të terrorizuar një pjesë të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare që të detyroheshin të largoheshin nga Kosova”, rrjedhimi më i arsyeshëm do të kishte qenë se kufomat do të ishin lënë atje ku kishin rënë” (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 77, përmendet Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 209).

¹²⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 209.

¹²⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 210, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240.

¹²⁷² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 211.

të mëparshëm.¹²⁷³ Sikurse shtjellohet në hollësi më poshtë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se që prej marsit 1999, ekzistonte një plan për fshehjen e krimeve.¹²⁷⁴ Dhoma Gjyqësore u shpreh si vijon:

planifikimi i fshehjes së qindra kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë gjatë operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së është dëshmi e fuqishme se vrasjet ishin pjesë e planit të përbashkët për terrorizimin e një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare për ta bërë që të largohej nga Kosova.¹²⁷⁵

Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se për më tepër ky planifikim ishte dëshmi e synimit të përbashkët të Gjorgjeviqit dhe anëtarëve të tjerë të NPK-së dhe Markoviqit për përdorimin, midis të tjerash, të forcave të MPB-së “për të kryer krime dhe fshehur gjurmët e tyre”.¹²⁷⁶ Për nxjerrjen e këtyre konkluzioneve, Dhoma Gjyqësore u bazua në një sërë mbledhjesh të zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe anëtarëve të NPK-së në mars 1999, gjatë të cilave: (i) Gjorgjeviqi ngriti çështjen e “pastrimit të terrenit”;¹²⁷⁷ (ii) Presidenti Millosheviq urdhëroi ministër Stojilkoviqin që të merrte masa për të zhdukur të gjitha gjurmët që mund të çonin te provat për krimet në Kosovë;¹²⁷⁸ dhe (iii) ministër Stojilkoviqi ua caktoi përgjegjësinë për kryerjen e detyrës së “pastrimit të terrenit” Gjorgjeviqit dhe Iliqit, me qëllim “zhvendosjen e viktimave civile që do të mund të përdoreshin si objekt hetimesh nga Tribunali i Hagës”.¹²⁷⁹ Përfundimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto mbledhje trajtuan zhvendosjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë nga forcat e UJ-së dhe të MPB-së.¹²⁸⁰ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se mosraportimi dhe moshetimi i krimeve të kryera nga pjesëtarë të MPB-së dhe UJ-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë tregon se ekzistonte një plan për fshehjen e këtyre vrasjeve¹²⁸¹ dhe mori parasysh prova konfirmuese në lidhje me fshehjen e kufomave.¹²⁸² Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore u bazua me arsye në këto përfundime ndër të cilat edhe interpretimin prej saj të frazës “pastrim terreni”, për nxjerrjen e konkluzionit se roli i Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave ishte në kuadrin e planit të koordinuar “për fshirjen e gjurmëve të krimeve të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës”.¹²⁸³

379. Më tej, Dhoma e Apelit vëren se pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave dhe moskryerjen e hetimeve të krimeve ndodhi njëkohësisht ose në disa raste para kryerjes së

¹²⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240.

¹²⁷⁴ Aktgjykimi, para. 2118.

¹²⁷⁵ Aktgjykimi, para. 2025.

¹²⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2025.

¹²⁷⁷ Aktgjykimi, para. 1373, përmendet Prova Materiale P387, f. 3

¹²⁷⁸ Aktgjykimi, para. 1373, përmendet Prova Materiale P387, f. 3.

¹²⁷⁹ Aktgjykimi, para. 1373, përmendet Prova Materiale P387, f. 3.

¹²⁸⁰ Aktgjykimi, para. 2025, 2117.

¹²⁸¹ Aktgjykimi, para. 2111.

¹²⁸² Shih Aktgjykimi, para. 2113-2116.

¹²⁸³ Aktgjykimi, para. 2126, 2156, 2158. Shih gjithashtu më lart, para. 373, 378.

krimeve të tjera nga forcat serbe në Kosovë, përfshirë vrasjet masive.¹²⁸⁴ Për shembull, Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas zbulimit të kufomave në Tekija në fillim të prillit 1999 dhe zhvendosjen e varrosjen e tyre të mëpasme,¹²⁸⁵ 296 shqiptarë kosovarë u vranë nga forcat serbe më 27 dhe 28 prill 1999 gjatë operacionit të përbashkët të UJ-së dhe të MPB-së me emrin e koduar “Operacioni Reka”.¹²⁸⁶ Po ashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në vend që të hetonin këto vrasje, autoritetet serbe ndërmorën përpjekje të koordinuara për fshehjen e krimeve nëpërmjet zhvendosjes dhe varrosjes së fshehtë të kufomave të viktimave.¹²⁸⁷ Dhoma e Apelit gjykon se përfundimet e Dhomës Gjyqësore tregojnë se pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në operacionin e fshehjes ndodhi në të njëjtën kohë me kryerjen e krimeve ose para kryerjes së tyre.¹²⁸⁸ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se këto veprime përgënjeshtrojnë pretendimin e Gjorgjeviqit se ishin thjesht veprime *ex post facto*.

380. Gjithashtu, Dhoma e Apelit nuk bindet nga parashtrimi i Gjorgjeviqit se fakti që në vendngjarje u thirrën gjykatësi hetues komunal, zëvendësprokurori komunal, një patolog dhe pas zbulimit të kufomave në lumin Danub edhe prokurori i qarkut, është kundërprovë kundrejt një plani për fshehjen e vrasjeve.¹²⁸⁹ Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e Dhomës Gjyqësore se gjykatësi dhe prokurori komunal deklaruan se nuk kishin kompetencë kur një numër i madh kufomash u gjetën në kamion dhe nuk u përfshinë më tej në hetim.¹²⁹⁰ Gjithashtu, ai shpërfill faktin se megjithëse u njoftuan, as gjykatësi hetues i qarkut, as prokurori i qarkut, nuk erdhën në vendngjarje.¹²⁹¹ Më tej, Gjorgjeviqi anashkalon [përfundimin e Dhomës Gjyqësore] se faktikisht veprimet e tij kishin për qëllim pengimin e hetimeve.¹²⁹² Në veçanti, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në bazë të udhëzimeve të Gjorgjeviqit kufomat e gjetura në kamionin- frigorifer në lumin Danub u transportuan në Beograd dhe u varrosën në varre të përbashkëta në qendrën e SAJ-it në Batajnicë për të fshehur zbulimin e këtyre kufomave dhe kombësinë e origjinën gjeografike të tyre, dhe për të penguar çdo hetim të mëtejshëm të vrasjes së atyre njerëzve.¹²⁹³ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu theksoi se Gjorgjeviqi udhëzoi shefin e SPB-së Çasllav Golluboviqin (“Golluboviqi”) që të mos e bënte rastin publik dhe të shkatërronte

¹²⁸⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1967-1982, 2099-2103, 2146.

¹²⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1287.

¹²⁸⁶ Aktgjykimi, para. 2099, 2146.

¹²⁸⁷ Aktgjykimi, para. 2099, 2146. Ndonëse Dhoma Gjyqësore theksoi se dëshmitë nuk përcaktonin se ku u dërguan kufomat, më 2001 u zhvarrosën kufomat e 295 viktimave të “Operacionit Reka” këtij operacioni nga varret e përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë (Aktgjykimi, para. 2099).

¹²⁸⁸ Shih më lart, para. 378.

¹²⁸⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 242, përmendet Aktgjykimi, para. 1293-1296.

¹²⁹⁰ Aktgjykimi, para. 1321.

¹²⁹¹ Aktgjykimi, para. 1321.

¹²⁹² Aktgjykimi, para. 1321, 1324.

¹²⁹³ Aktgjykimi, para. 1324, 1329, 1333, 1970.

kamionin-frigorifer pas heqjes së kufomave.¹²⁹⁴ Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore, dhe për këtë arsye nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë.

381. Për më tepër, Dhoma e Apelit nuk bindet se vendimi i Dhomës Gjyqësore për mosformulim të përfundimeve konkrete në lidhje me implikimin e zyrtarëve të tjerë të lartë politikë, ushtarakë dhe të MPB-së në fshehjen e kufomave tregon se “mungojnë provat që do të vërtetonin lidhjen midis [planit të fshehjes] dhe NPK-së”.¹²⁹⁵ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi fshehjen e krimeve në kontekstin e analizës së ekzistencës së një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe rolit të Gjorgjeviqit në të.¹²⁹⁶

382. Sikurse u përmend më parë, konkluzionin mbi planin për fshehjen e krimeve, Dhoma Gjyqësore ndër të tjera e bazoi në analizën e veprimeve të disa anëtarëve të NPK-së të implikuar në atë operacion, konkretisht Presidenti Millosheviq, ministër Stojilkoviqi, dhe Iliqi.¹²⁹⁷ Dhoma Gjyqësore konkretisht konkludoi se operacioni për fshehjen e kufomave u krye “nën drejtimin e [Gjorgjeviqit], me Dragan Iliqin, sipas udhëzimeve të ministër Stojilkoviqit, dhe në përputhje me urdhrin e Presidentit Millosheviq”.¹²⁹⁸ Dhoma Gjyqësore vendosi të mos nxirrte përfundime të tjera konkrete në lidhje me implikimin e zyrtarëve të tjerë të lartë politikë, të MPB-së apo të UJ-së në fshehjen e kufomave.¹²⁹⁹ Gjithsesi, duke u bazuar në prova [Dhoma Gjyqësore] arsyetoi se kishte “implikim të drejtpërdrejtë të mundshëm apo së paku dijani të mundshme të disa personave në lidhje me fshehjen e kufomave.”¹³⁰⁰ Duke marrë parasysh se Dhoma Gjyqësore u përqendrua vetëm në kontributin e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore formuloi përfundimet e nevojshme në lidhje me “zyrtarë të tjerë të lartë konkretë politikë, të MPB-së dhe të UJ-së”¹³⁰¹ që shërbyen si bazë për konkluzionin se ekzistonte një plan për fshehjen e krimeve dhe se pjesëmarrja e Gjorgjeviqit në këtë plan ishte në kuadër të kontributit të tij për realizmin e NPK-së. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore.

¹²⁹⁴ Aktgjykimi, para. 1302, 1313, 1970. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore vuri në dukje se Gjorgjeviqi pranoi se urdhri për shkatërrimin e kamionit ishte i paligjshëm (Aktgjykimi, sh. 6790, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 10002).

¹²⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 243.

¹²⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1981, 2025-2026, 2154-2158.

¹²⁹⁷ Shih më lart, para. 378; Aktgjykimi, para. 2112-2116.

¹²⁹⁸ Aktgjykimi, para. 1980. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2117-2118.

¹²⁹⁹ Aktgjykimi, para. 2119-2120.

¹³⁰⁰ Aktgjykimi, para. 2119.

¹³⁰¹ Aktgjykimi, para. 2119.

383. Së fundi, Dhoma e Apelit nuk bindet nga pretendimi i pafaktuar i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore zhvlerësoi përfundimet e veta në lidhje me “konspiracionin e heshtjes”.¹³⁰² Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore ra në kundërshti me vetveten sepse konkludoi se dokumentet me shkrim të veprimtarive dhe ecurisë së gjendjes në Kosovë ndër të tjera të fshehjes së krimeve ose nuk ishin mbajtur, ose ishin asgjësuar të gjitha, e në të njëjtin paragraf u shpreh se kishte pasur raportim gojor dhe/ose me shkrim të veprimtarive dhe ecurisë së gjendjes në Kosovë.¹³⁰³ Sidoqoftë leximi në tërësi i paragrafit të Aktgjykimit tregon se nuk ka asnjë kundërshti në arsyetimin e Dhomës Gjyqësore. Dhoma Gjyqësore konkludoi se konstatohej një “mungesë *thuajse e plotë* e çfarëdo raporti, dokumenti apo procesverbali të mbledhjeve” mbi veprimet dhe ecurinë e MPB-së dhe UJ-së në Kosovë.¹³⁰⁴ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se “nuk mund të pranohet se këto tema, të cilat ishin thelbësore për vetë mbijetesën e qeverisë dhe kombit serb [...], nuk u raportuan”.¹³⁰⁵ Si rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore konkludoi kishte pasur raportim gojor dhe/ose me shkrim për këto tema, mirëpo “ose të gjitha dokumentet me shkrim u asgjësuan, ose në të gjitha nivelet u ndërmor një veprim i prerë për t’iu shmangur raportimit me shkrim me qëllim që të mos mbetej asnjë provë për ndonjë hetim ndërkombëtar të mëtejshëm, ose të dyja.”¹³⁰⁶ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se ky përfundim mbështetej nga ato pak dokumente me shkrim të gjetura, dhe veprime që provonin dijeninë rreth tyre në “nivelet më të larta serbe”.¹³⁰⁷ Dhoma e Apelit nuk e gjykon kundërthënës arsyetimin e Dhomës Gjyqësore. Si pasojë bie argumenti i Gjorgjeviqit.

384. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatës Tuzmukhamedovit, konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në nxjerrjen e konkluzionit se fshehja e kufomave dhe roli i Gjorgjeviqit në të, përbënin kontribut në NPK. Si rrjedhojë, rrëzohet argumenti i Gjorgjeviqit se veprimet e tij duhej të ishin analizuar brenda kontekstit të përgjegjësisë penale sipas paragrafit 3 të Nenit 7.

3. Pretendim për gabime në lidhje me Shënimet e Grupit të Punës

(a) Hyrje

385. Duke u bazuar në Shënimet e Grupit të Punës, Dhoma Gjyqësore konstatoi se në mars 1999 u mbajtën dy mbledhje gjatë të cilave u diskutua fshehja e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë.¹³⁰⁸ Mbledhja e parë u mbajt në kabinetin Presidentit Millosheviq ku midis të tjerëve

¹³⁰² Shih Aktgjykimi, para. 2108; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 241.

¹³⁰³ Shih Aktgjykimi, para. 2108; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 241.

¹³⁰⁴ Aktgjykimi, para. 2108 (theksi i shtuar).

¹³⁰⁵ Aktgjykimi, para. 2108.

¹³⁰⁶ Aktgjykimi, para. 2108.

¹³⁰⁷ Aktgjykimi, para. 2108.

¹³⁰⁸ Aktgjykimi, para. 2112, 2117. Dhoma e Apelit do t’u referohet këtyre dy mbledhjeve si mbledhja e marsit 1999 dhe mbledhja e mëpasme e Kolegjiut të MPB-së.

morën pjesë Presidenti, Gjorgjeviqi, ministër Stojilkoviqi, dhe shefi i atëhershëm i RDB-së, Markoviqi.¹³⁰⁹ Dhoma Gjyqësore konstatoi se gjatë kësaj mbledhjeje, Gjorgjeviqi “ngriti çështjen e ‘pastrimit të terrenit’ në Kosovë” dhe se në lidhje me këtë, “Presidenti Slllobodan Millosheviq urdhëroi ministër Stojilkoviqin që të merrte masa për zhdukjen e të gjitha gjurmëve që mund të çonin drejt provave për ‘krimet e kryera’”.¹³¹⁰ Dhoma Gjyqësore u bazua ndër të tjera në Shënimet e Grupit të Punës për nxjerrjen e përfundimit se në një mbledhje të Kolegjiumit të MPB-së të mbajtur më pas, ministër Stojilkoviqi urdhëroi Gjorgjeviqin dhe Iliqin që të kryenin detyrën e “‘pastrimit të terrenit’ në Kosovë, me qëllim zhdukjen e gjurmëve të viktimave civile të cilat mund të hetoheshin nga Tribunali”.¹³¹¹

386. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë “duke u akorduar rëndësi [Shënimeve] të Grupit të Punës” në lidhje me mbledhjet e marsit 1999.¹³¹² Konkretisht, Gjorgjeviqi: (i) vë në dyshim besueshmërinë e Shënimeve të Grupit të Punës;¹³¹³ dhe (ii) argumenton se në nxjerrjen e konkluzionit se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi të tepruar Shënimeve të Grupit të Punës.¹³¹⁴

(b) Besueshmëria e Shënimeve të Grupit të Punës

a. Argumentet e palëve

387. Gjorgjeviqi argumenton se Shënimet e Grupit të Punës nuk janë të besueshme dhe nuk duhet t’u kushtohet kurrfarë rëndësie duke marrë parasysh se në to mungojnë: (i) numrat referues, datat, vendet dhe nënshkrimet e intervistave; dhe (ii) mundësia e rishqyrtimit të informacionit nga të intervistuarit.¹³¹⁵ Gjithashtu, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në përcaktimin e datës së formimit të Grupit të Punës dhe botimit të raportit të këtij grupi.¹³¹⁶ Sipas Gjorgjeviqit këto gabime “dëmtojnë përparësinë që në rrethana të tjera Dhoma e Apelit i jep Dhomës Gjyqësore në të drejtën e saj për vlerësimin e provave të administruara”.¹³¹⁷

¹³⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2112, përmendet Prova Materiale P387, f. 3.

¹³¹⁰ Aktgjykimi, para. 2112, përmendet Prova Materiale P387, f. 3. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2113-2117.

¹³¹¹ Aktgjykimi, para. 2112, përmendet Prova Materiale P387, f. 3, Aktgjykimi, para. 1289, 1387-1394. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2113-2117.

¹³¹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 244; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 86-87.

¹³¹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 247; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 86-87.

¹³¹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 251.

¹³¹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 247, përmendet K84, 12 mars 2009, T. 2123-2128, T. 2132 (seancë e mbyllur).

¹³¹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 246.

¹³¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 246.

388. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore ofroi mendim të arsyetuar në lidhje me besueshmërinë e provave të Grupit të Punës.¹³¹⁸ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se çfarëdo gabimi i pretenduar në lidhje me datën e formimit të Grupit të Punës nuk ka rëndësi juridikisht thelbësore.¹³¹⁹

b. Analizë

389. Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Dhoma Gjyqësore gaboi në vlerësimin e besueshmërisë relative të Shënimeve të Grupit të Punës. Dhoma e Apelit konstaton se gjatë gjykimit Dhoma Gjyqësore pranoi argumentet e Gjorgjeviqit dhe brenda këtij konteksti, theksoi se Shënimet e Grupit të Punës duheshin shqyrtuar me kujdes.¹³²⁰ Pyetjes kyçe nëse përmbajtja e Shënimeve të Grupit të Punës u vu në dyshim nga dëshmitë gojore të dëshmitarëve, vlerës së tyre provuese dhe analizimit të provave prej Dhomës Gjyqësore në kuadrin e planit për fshehjen e kufomave i jepet përgjigje më poshtë në këtë pjesë.¹³²¹

390. Në lidhje me përcaktimin e datës së formimit të Grupit të Punës dhe botimit të raporteve të këtij grupi, Dhoma e Apelit thekson se dy herë Dhoma Gjyqësore u shpreh pasaktësisht se Grupi i Punës ekzistonte më 1999, kur faktikisht Grupi i Punës u formua më 2001.¹³²² Konkretisht, [Dhoma Gjyqësore] gaboi kur konkludoi se aktakuza e Tribunalit kundër Sllobodan Millosheviqit doli “vetëm disa ditë” para mbajtjes së konferencës për shtyp nga Grupi i Punës,¹³²³ dhe se një anëtar i Grupit të Punës kontaktoi Gjorgjeviqin në maj 1999.¹³²⁴ Veç këtyre dy gabimeve, në të gjitha rastet e tjera Dhoma Gjyqësore përmendi saktësisht si datë të formimit të Grupit të Punës dhe daljes së raportit të tij të parë, majin 2001.¹³²⁵ Si pasojë, rezulton se së paku një herë përmendja e majit 1999, ka qenë thjesht gabim shtypi.¹³²⁶ Për më tepër, Dhoma e Apelit konstaton se të dy herët kur u përmend pasaktësisht data e formimit të Grupit të Punës, nuk kanë asnjë ndikim ndaj përfundimeve ligjore të Dhomës Gjyqësore.¹³²⁷ Dhoma e Apelit gjykon se rrjedhimisht këto gabime nuk ndikojnë ndaj përfundimeve të Dhomës Gjyqësore në lidhje me provat e Grupit të Punës.

¹³¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 216, përmendet Aktgjykimi, para. 2113-2116 (në lidhje me referimet e Dhomës Gjyqësore të provave të tjera).

¹³¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 215, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 246.

¹³²⁰ Aktgjykimi, para. 1289, sh. 4974.

¹³²¹ Shih më poshtë, para. 395-399.

¹³²² Aktgjykimi, para. 1371, 1982.

¹³²³ Aktgjykimi, para. 1371, sh. 5292.

¹³²⁴ Aktgjykimi, para. 1982.

¹³²⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1289, 1369, 1371-1372.

¹³²⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1982.

¹³²⁷ Në lidhje me datën e aktakuzës kundër Sllobodan Millosheviqit, Dhoma e Apelit vëren se u bë edhe një konstatim tjetër në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se raporti u përpilua dhe u bë i njohur nxitimthi dh dhe se ky konstatim u bë në kontekst të përfundimeve të tjera të Dhomës Gjyqësore (Shih Aktgjykimi, para. 1370-1373).

(c) Pretendim për gabim për përdorimin si provë të Shënimeve të Grupit të Punësa. Argumentet e palëve

391. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi që për nxjerrjen e konkluzionit se ekzistonte një plan për fshehjen e kufoma u bazua në Shënimet e Grupit të Punës.¹³²⁸ Ai argumenton se “sugjerimi” në Shënimet e Grupit të Punës ‘se këto dy mbledhje u mbajtën [në mars 1999] është tejet i pathemeltë” dhe se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte konkluduar se “këto mbledhje u mbajtën apo çfarë ndodhi gjatë tyre”.¹³²⁹ Ai pretendon se disa dëshmitarë kundërshtuan përmbajtjen e Shënimeve të Grupit të Punës dhe dëshmuan se [anëtarët] e Grupit të Punës “pranuan se ishin nën presion për të ngarkuar padrejtësisht me faj Gjorgjeviqin”.¹³³⁰

392. Gjithashtu, Gjorgjeviqi parashtron se efekti negativ i Shënimeve të Grupit të Punës, pjesërisht për shkak të mungesës së burimeve të drejtpërdrejta gjatë përpilimit të tyre, ul ndjeshëm vlerën e tyre provuese.¹³³¹ Ai argumenton konkretisht se ndërsa Shënimet e Grupit të Punës bazohen kryesisht në një deklaratë të shefit të RDB-së, Markoviçit, për punonjësit e RDB-së, faktikisht Grupi i Punës nuk e dispononte këtë deklaratë kur hartoi raportin e vet dhe gjithashtu se shënimet dytësore të përdorura nga Grupi i Punës në vend të kësaj deklarate nuk u pranuan si prova në gjyq.¹³³² Gjorgjeviqi argumenton se ndonëse provat e dorës së dytë janë të pranueshme në Tribunal, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do t’i kishte konsideruar të besueshme Shënimet e Grupit të Punës, duke parë mangësitë, ndër të cilat edhe mungesa e deklaratës origjinale të Markoviçit.¹³³³ Ai parashtron se vlera provuese e Shënimeve të Grupit të Punës merr rëndësi të veçantë duke qenë se këto shënime janë e vetmja provë e mbledhjes së pretenduar në mars 1999 në zyrën e Presidentit Millosheviq dhe e mbledhjes së mëpasme të Kolegjiumit të MPB-së.¹³³⁴

393. Së fundi, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi që u bazua në dëshminë gojore të Dëshmitarit K84 sepse: (i) “as [Dëshmitari K84], as Grupi i Punës nuk gjetën prova që tregonin se në mbledhje të Kolegjiumit të MPB-së ose në mbledhje me Millosheviqin u diskutua zhvendosja e kufomave nga Kosova”;¹³³⁵ dhe (ii) Dëshmitari K84 dëshmoi se shefi i

¹³²⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 244.

¹³²⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 251.

¹³³⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 248.

¹³³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 249.

¹³³² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 249; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 86-87.

¹³³³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 251; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 86-87.

¹³³⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 244, 249; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 86. Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi gabimisht përmend si datë të daljes së raportit majin 1999 në paragrafin 249 (mirëpo shih Aktgjykimi, para. 245, ku maj 2001 përmendet si data e saktë).

¹³³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 250, përmendet Prova Materiale P390, K84, 10 mars 2009, T. 2019 (seancë e mbyllur), K84, 11 mars 2009, T. 2049-2050 (seancë e mbyllur), K84, 12 mars 2009, T. 2160-2173

kabinetit të Gjorgjeviqit, Sllobodan Borisavleviqi asnjëherë nuk tha se ishte diskutuar fshehja e kufomave në ndonjë mbledhje të Kolegjiumit të MPB-së.¹³³⁶

394. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë u bazua në provat e Grupit të Punës për nxjerrjen e konkluzioneve të veta në lidhje me dy mbledhjet në mars 1999.¹³³⁷ Prokuroria parashtron se argumenti i Gjorgjeviqit bie sepse ai nuk ka provuar se në çfarë mënyre ishte i paarsyeshëm interpretimi i këtyre provave prej Dhomës Gjyqësore.¹³³⁸ Gjithashtu, Prokuroria argumenton se për nxjerrjen e konkluzionit mbi mbajtjen e mbledhjeve, Dhoma Gjyqësore nuk u bazua vetëm në këto prova.¹³³⁹

b. Analizë

395. Dhoma e Apelit rikujton se “në jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar është përcaktuar se gjykuesi i fakteve ka mundësinë më të mirë për vlerësimin e provave në tërësi si dhe të qëndrimit të një dëshmitari”.¹³⁴⁰ Gjithashtu, Dhoma e Apelit rikujton se dhoma gjyqësore gëzon të drejtën e zgjidhjes së mospërputhjeve në prova, “e vlerësimin nëse provat të marra si tërësi janë të sakta dhe të besueshme dhe të pranojë ose refuzojë veçori themelore të provave”.¹³⁴¹ Dhoma e Apelit i jep përparësi mendimit të Dhomë Gjyqësore në lidhje me aspektin e besueshmërisë dhe “konkludon për gabim faktik vetëm në qoftë se konstaton se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte nxjerrë përfundimin e apeluar”.¹³⁴² Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit kujton se Dhoma Gjyqësore e pranoi kundërshtimin e Gjorgjeviqit ndaj përmbajtjes së Shënimeve të Grupit të Punës, duke shpjeguar se:

Qëndrimi i Mbrojtjes është se Prokuroria padrejtësisht mundohet që t'u japë vlerë të konsiderueshme Shënimeve Zyrtare në lidhje me vërtetësinë e përmbajtjes së tyre [...]. Njëri nga dëshmitarët, K87, e kundërshtoi përmbajtjen thujse në tërësi të Shënimeve [të Grupit të Punës] të hartuara gjatë intervistimit të tij, duke thënë se kishte shumë të pavërteta dhe pasaktësi. Një dëshmitar tjetër, K93-shi, tha se kur e intervistuan, Grupi i Punës i bëri presion duke sugjeruar se Gjorgjeviqi duhet të ketë qenë i përfshirë. Ndonëse e vetëdijshme për qëndrimin e këtyre dy dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të tjerë në lidhje me përmbajtjen e intervistave të tyre gjegjëse në Shënimet [e Grupit të Punës], Dhoma gjithashtu thekson se, sikurse u tha më lart, e ka të vështirë të pranojë veçanërisht dëshminë e K87-ës dhe K93-shit në këtë gjykim në lidhje me aspektet kritike që kanë të bëjnë me rolin e të Akuzuarit në këto ngjarje. Atje ku ka dëshmi konkrete për përmbajtjen dhe saktësinë e [Shënimeve të Grupit të Punës] të intervistës së një dëshmitari, Dhoma e ka vlerësuar këtë dëshmi në kontekst të të

(seancë e mbyllur), T. 2177-2178 (seancë e mbyllur), T. 2186 (seancë e mbyllur), T. 2193-2195 (seancë e mbyllur), Adnan Merovci, 13 mars 2009, T. 2208.

¹³³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 250, përmendet K84, 12 mars 2009, T. 2168-2169 (seancë e mbyllur).

¹³³⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 213.

¹³³⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 214-215.

¹³³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 216, përmendet Aktgjykimi, para. 2113-2116 (në lidhje me përmendjen prej Dhomës Gjyqësore të provave të tjera).

¹³⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 88, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 21, sh. 12.

¹³⁴¹ Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 51, citohet Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 103; Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 31. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 129-130.

¹³⁴² Shih më lart, para. 16. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 31, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 355, Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 70; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 173; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 428.

gjithë dëshmisë së atij dëshmitari, si dhe provave të tjera përkatëse në dispozicion të Dhomës.¹³⁴³

Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore i bazoi përfundimet e veta në lidhje me intervistat e pasqyruara në Shënimet e Grupit të Punës në tërësinë e provave dhe i përmendi shprehimisht shqetësimet e ngritura nga Gjorgjeviqi në lidhje me Shënimet e Grupit të Punës.¹³⁴⁴ Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma Gjyqësore i parapriu analizës së Shënimeve të Grupit të Punës me përfundimin se mosraportimi dhe moshetimi i krimeve të kryera nga forcat serbe në vetvete tregonte se “kishte një plan për fshehjen” e këtyre vrasjeve.¹³⁴⁵ Më tej, [Dhoma Gjyqësore] mori parasysh prova të tjera që konfirmonin Shënimet e Grupit të Punës, ndër të cilat: (i) një Notë Zyrtare ku evidentohet se një individ i telefonoi Gjorgjeviqit për të marrë udhëzime ose informacion lidhur me ardhjen e një kamioni me kufoma në Qendrën 13 Maji në Batajnicë në prill 1999, të cilit Gjorgjeviqi iu përgjigj se “po bëhej pastrimi i terrenit në Kosovë”, se kamioni “duhej të fshihej në terrenin tonë”, se ishte “sekret numër një”, dhe se Gjorgjeviqi do të informonte Presidentin Millosheviq në lidhje me këtë;¹³⁴⁶ (ii) një deklaratë me shkrim nga shefi i kabinetit të Gjorgjeviqit, Sllobodan Borisavleviqi, ku përmendet një vendim për pastrimin e fushëbetëve në Kosovë;¹³⁴⁷ (iii) dëshmia gojore e Dëshmitarit Zhivko Trajkoviq (“Dëshmitar Trajkoviqi”) për një bisedë që ai kishte bërë me Gjorgjeviqin në qershor 1999 në lidhje me vendimin për varrosjen e kufomave në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, për të cilin Dëshmitar Trajkoviqit iu tha se ishte marrë “në kontekstin e pastrimit dhe higjienizimit të terrenit”, dhe mendimi i Dëshmitar Trajkoviqit se në krye të këtij operacioni ishte Iliqi;¹³⁴⁸ dhe (iv) procesverbali i një mbledhjeje të Komandës së Përbashkët mbajtur më 1 qershor 1999 ku evidentohet se Gjorgjeviqi i informoi të pranishmit se Iliqi nuk do të vinte në mbledhje për arsye se ishte i zënë me “disa detyra rreth masave sanitare dhe higjienike në terren”.¹³⁴⁹ Gjithashtu, Dhoma e Apelit vë në dukje se sa herë që pati dëshmi kundërtë, Dhoma Gjyqësore shpjegoi arsyen e parapëlqimit të një dëshmie kundrejt një dëshmie tjetër.¹³⁵⁰ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore analizoi me kujdes pikëpamjet e ndryshme, shqyrtoi provat ndër të cilat edhe prova

¹³⁴³ Aktgjykimi, para. 1289 (pa citime).

¹³⁴⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1289. Gjithashtu, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore “i ka vlerësuar me kujdes vërejtjet e ndryshme të personave të intervistuar në lidhje me procedurat që janë ndjekur gjatë intervistave të secilit dëshmitar dhe [...] ka shqyrtuar me kujdes dhe vëmendje përmbajtjen e çdo Shënimi Zyrtar para se, në disa raste, të pranonte përmbajtjen” (Aktgjykimi, sh. 4974).

¹³⁴⁵ Aktgjykimi, para. 2111.

¹³⁴⁶ Aktgjykimi, para. 2113, përmendet Shtojca konfidenciale (Prova Materiale P413 (konfidenciale), f. 1).

¹³⁴⁷ Aktgjykimi, para. 2114, përmendet Prova Materiale P390 (konfidenciale), K84, 10 mars 2009, T. 2024-2025 (seancë e mbyllur), K84, 12 mars 2009, T. 2172 (seancë e mbyllur).

¹³⁴⁸ Aktgjykimi, para. 2115, përmendet Zhivko Trajkoviq, 29 shtator 2009, T. 9126-9127, 9129-9130, 9138.

¹³⁴⁹ Aktgjykimi, para. 2116, citohet Aleksandar Vasileviq, 8 qershor 2009, T. 5694 (seancë private), 5702. Shih gjithashtu Prova Materiale P885. Dhoma Gjyqësore konstatoi se kjo binte në kundërshtim me dëshminë e Gjorgjeviqit sipas të cilit “më 2 qershor 1999, Iliqi i tha se kishte shkuar në Kosovë për t’u dhënë SPB-ve udhëzime në lidhje me përmirësimin e hetimeve të vendngjarjeve në kohë lufte” (Aktgjykimi, para. 2116, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9747, Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 9987).

¹³⁵⁰ Aktgjykimi, sh. 7270, 7278, 7280.

konfirmuese shitesë për ekzistencën e një plani për fshehjen e kufomave dhe u tregua e matur në përdorimin e Shënimeve të Grupit të Punës.¹³⁵¹ Për këto arsye, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur gjatë shqyrtimit të provave vendosi të mos bazohej në dëshmitë gojore të dëshmitarëve që ishin në kundërshti me Shënimet e Grupit të Punës.

396. Në lidhje me argumentin e Gjorgjeviqit se Shënimet e Grupit të Punës nuk mbështesin konkluzionet e Dhomës Gjyqësore për mbledhjet e marsit 1999, Dhoma e Apelit gjykon se është e drejtë ajo pjesë e argumentit të Gjorgjeviqit se Grupi i Punës nuk dispononte deklarata origjinale në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve.¹³⁵² Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore e pranoi këtë problem dhe ndonëse u kushtoi rëndësi të konsiderueshme Shënimeve të Grupit të Punës, u tregua e kujdesshme në këtë aspekt dhe mori parasysh provat konfirmuese:

ndërsa është e vetëdijshme se provat në lidhje me mbledhjet në mars 1999 nuk janë të dorës së parë, Dhoma është gjithashtu e vetëdijshme se ka prova të cilat të marra së bashku, priren të konfirmojnë të vërtetën thelbësore. Në bazë të tërësisë së provave të shqyrtuara së bashku, Dhoma gjykon se “pastrimi i terrenit” në kontekstin e fshehjes së kufomave të viktimave të vrara nga forcat serbe në Kosovë u diskutua në një apo më shumë mbledhje në mars 1999 dhe më pas.¹³⁵³

397. Dhoma e Apelit gjykon se një dhomë gjyqësore gëzon “të drejtën të shqyrtojë me kujdes dhe të bazohet në prova të dorës së dytë”.¹³⁵⁴ Ndonëse Gjorgjeviqi me të drejtë parashtron se Shënimet e Grupit të Punës janë e vetmja provë për mbledhjet e marsit 1999, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore tregoi kujdesin e duhur në përcaktimin e vlerës provuese të Shënimeve të Grupit të Punës dhe duke u bazuar në tërësinë e provave arriti në konkluzionin e arsyeshëm se ndërmjet zyrtarëve të lartë shtetërorë ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë nga forcat serbe.¹³⁵⁵ Ndonëse përfundimet e tjera të Dhomës Gjyqësore përmendin ngjarjet pas mbledhjeve të marsit 1999,¹³⁵⁶ ato zbulojnë synimin e qartë dhe të palëkundshëm të Gjorgjeviqit për vënien në jetë të planit për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë dhe konfirmojnë bindshëm Shënimet e Grupit të Punës. Këto konkluzione u përforcuan edhe më tej prej përfundimit të

¹³⁵¹ Aktgjykimi, para. 2112. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se në parashtrimin e tij se jobesueshmëria e Shënimeve të Grupit të Punës ka rëndësi mjaft të madhe meqë janë e vetmja provë e mbledhjeve të marsit 1999, Gjorgjeviqi shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 244, 249).

¹³⁵² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 249.

¹³⁵³ Aktgjykimi, para. 2117. Shih Aktgjykimi, para. 2113.

¹³⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 77, citohet Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 96; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 39; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 831. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 217.

¹³⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2117.

¹³⁵⁶ Shih Aktgjykimi, para. 2112-2117.

Dhomës Gjyqësore se mungesa tërësore e hetimeve të krimeve ishte provë e planit për fshehjen e kufomave.¹³⁵⁷

398. Për Dhomën e Apelit nuk është bindës as pretendimi i Gjorgjeviqit se Grupi i Punës nuk gjeti prova për zhvendosjen e kufomave.¹³⁵⁸ Dhoma e Apelit konstaton se në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore faktikisht mori prova, konkretisht deklaratën e Markoviqit, se gjatë mbledhjeve ishte diskutuar fshehja e kufomave.¹³⁵⁹

c. Konkluzion

399. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të tregojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte arritur në të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore dhe si rrjedhojë nuk ka mundur të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore bëri gabim që u mbështet në provat e Grupit të Punës për nxjerrjen e konkluzionit se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave.

4. Roli i Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave

(a) Hyrje

400. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi luajti rol udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për fshehjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë nëpërmjet dhënies së urdhrave për trajtimin, transportin dhe rivarrosjen e kufomave.¹³⁶⁰ Ndër të tjera [Dhoma Gjyqësore] u bazua në implikimin e tij në operacionet e varrosjes së kufomave të transportuara nga Kosova, në vendndodhje të ndryshme në Serbi që “ishin veprime që u ndërmorën në kuadër të operacionit të koordinuar për fshirjen e gjurmëve të krimeve”.¹³⁶¹

401. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi sepse zmadhoi masën e përgjegjësisë së tij në operacionet e fshehjes.¹³⁶² Ai pretendon konkretisht se Dhoma Gjyqësore nxori përfundime të gabuara në lidhje me: (i) fshehjen e afërsisht 80 kufomave të zbuluara më 4 prill 1999 në rimorkion e një kamioni-frigorifer në lumin Danub afër fshatit Tekija, zhvendosjen e mëpasme të kufomave dhe varrosjen e tyre në Qendrën e SAJ-it në

¹³⁵⁷ Shih Aktgjykimi, para. 2111.

¹³⁵⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 250.

¹³⁵⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 249-250. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2114.

¹³⁶⁰ Aktgjykimi, para. 1969, 2156.

¹³⁶¹ Aktgjykimi, para. 1969, 2156.

¹³⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 253; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 76, 80; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 88-89.

Batajnicë;¹³⁶³ (ii) dy ngarkesa kufomash në qendrën e PJP-së në Petrovo Sello në prill 1999;¹³⁶⁴ dhe (iii) varrosjen e kufomave pranë liqenit Peruqac.¹³⁶⁵

402. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi luajti rol udhëheqës në përpjekjet aktive për fshehjen e provave të vrasjeve të gjithandjeve të shqiptarëve kosovarë.¹³⁶⁶ Përgjithësisht, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore, përsërit argumente të cilat i ngriti gjatë gjykimit dhe nuk arrin të provojë se mund të nxirreshin edhe rrjedhime të tjera të arsyeshme.¹³⁶⁷

(b) Pretendim për gabim në nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi mori pjesë në rivarrosjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të gjetura në një kamion-frigorifer në lumin Danub

a. Hyrje

403. Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fillim të prillit 1999, Gjorgjeviqi organizoi transportin e kufomave të shqiptarëve kosovarë të gjetura në një kamion-frigorifer në lumin Danub afër Tekijes, për në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë¹³⁶⁸ dhe udhëzoi që kufomat të varroseshin atje në varre të përbashkëta.¹³⁶⁹ Dhoma Gjyqësore theksoi se “ndonëse asnjë dëshmi nuk tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë se ai dinte se vendi i saktë ku do të silleshin kufomat ishte Qendra e SAJ-it në Batajnicë [...] i vetmi deduksion që mund të bëhet është se ai kishte dijeni.”¹³⁷⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “ishte pika e parë dhe kryesore e kontaktit” dhe se ishte “e qartë se [Gjorgjeviqi] lëshoi urdhra në lidhje me trajtimin, transportin dhe rivarrosjen e fshehtë të kufomave”.¹³⁷¹

b. Argumentet e palëve

404. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi në nxjerrjen e konkluzionit se ai mori pjesë në operacionet e fshehjes në lidhje me 80 kufoma të zbuluara më 4 prill 1999 në pjesën e pasme të një kamioni-frigorifer në lumin Danub afër fshatit Tekija.¹³⁷² Ai argumenton konkretisht se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai dinte se “destinacioni konkret ku do të silleshin kufomat ishte Qendra e SAJ-it në Batajnicë” duke marrë parasysh se më parë [Dhoma Gjyqësore] kishte konkluduar se “asnjë dëshmi nuk tregon në mënyrë të

¹³⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 252, 255-258.

¹³⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 252, 262-263.

¹³⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 252, 259-261, 263.

¹³⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 217.

¹³⁶⁷ Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 217-231.

¹³⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1301-1324, 1969.

¹³⁶⁹ Aktgjykimi, para. 1325-1352, 1969.

¹³⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1347.

¹³⁷¹ Aktgjykimi, para. 1969.

drejtpërdrejtë” se ai kishte një dijeni të tillë.¹³⁷³ Gjithashtu, ai pretendon se “reagimi i befasuar dhe i vonuar” i tij kur e kontaktuan në lidhje me kufomat e gjetura afër Tekijes, tregon se ai nuk kishte dijeni të mëhershme për kufomat.¹³⁷⁴ Gjithashtu, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri paraqitje të shtrembëruar të provave në nxjerrjen e konkluzionit se ai takoi Dëshmitarin K87 dhe i tregoi paraprakisht për ardhjen në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë të kamionëve të tjerë që transportonin kufoma, me shoferë të MPB-së, në prill dhe ka të ngjarë në maj 1999.¹³⁷⁵ Më tej Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh “kërkesat e përsëritura të tij drejtuar ministër Stojilkoviçit për të hetuar zbulimin e kufomave në Tekija”, dhe se, edhe pse kërkesat e tij nuk rezultuan në hetime penale, gjithsesi nuk u konkludua se ai pengoi hetimet në fjalë apo se kishte pasur mundësinë për këtë.¹³⁷⁶

405. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se Gjorgjeviqi “luajti rol drejtues dhe kyç në operacionin e fshehtë të rivarrosjes së kufomave në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë”.¹³⁷⁷ [Prokuroria] argumenton se Gjorgjeviqi shpërfill dhe shtrembëron provat që tregojnë se ai organizoi transportimin e kufomave nga Tekija në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë në fillim të prillit 1999.¹³⁷⁸ Sipas Prokurorisë, ndonëse nuk kishte prova të drejtpërdrejta se Gjorgjeviqi ishte në dijeni se kufomat e gjetura në Tekija ishin transportuar në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, i vetmi rrjedhim i arsyeshëm që mund të nxirret nga tërësia e ngjarjeve është se ai ishte në dijeni.¹³⁷⁹ Gjithashtu, Prokuroria parashtron se gjatë fazës së gjykimit, Dhoma Gjyqësore nuk e pranoi pretendimin e Gjorgjeviçit se ai i bëri kërkesa të përsëritura ministër Stojilkoviçit për të hetuar zbulimin e kufomave në Tekija dhe se Gjorgjeviqi nuk arrin të identifikojë asnjë gabim në lidhje me këtë pikë.¹³⁸⁰

c. Analizë

406. Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi me të drejtë parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk pa asnjë provë të drejtpërdrejtë mbi dijeninë e tij se kufomat do të transportoheshin për në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë.¹³⁸¹ Sidoqoftë, Dhoma Gjyqësore shpjegoi me imtësi provat rrethore që provonin rolin e Gjorgjeviçit në koordinimin e shpërndarjes së kamionëve që transportonin kufoma dhe të varrosjeve në varre të përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë,¹³⁸² ndër të cilat prova se: (i) më 6 prill 1999, shefi i SPB-së, Golluboviçit kontaktoi

¹³⁷² Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 252, 255-258.

¹³⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 256, përmendet Aktgjykimi, para. 1347.

¹³⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 255.

¹³⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 257, përmendet Aktgjykimi, para. 1337, sh. 5145.

¹³⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 258.

¹³⁷⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 219.

¹³⁷⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 220.

¹³⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 222.

¹³⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 224.

¹³⁸¹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 256.

¹³⁸² Shih Aktgjykimi, para. 1325-1347.

Gjorgjeviqin dhe e informoi për kufomat e zbuluara në kamionin-frigorifer në Danub;¹³⁸³ (ii) i udhëzuar nga Gjorgjeviqi, Golluboviqi ndihmoi në organizimin e ngarkimit dhe transportimit të shumicës së kufomave në një kamion për në Beograd;¹³⁸⁴ (iii) Gjorgjeviqi planifikoi që një kamion i dytë do të transportonte kufomat e mbetura për në Beograd;¹³⁸⁵ (iv) dikur rreth datës 6 prill 1999, por para 9 prillit 1999, Gjorgjeviqi takoi Dëshmitarin K87 dhe e informoi se në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë ishin dy kamionë me kufoma dhe se këto kufoma duhej të varroseshin në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë;¹³⁸⁶ dhe (v) se pak kohë pas varrosjes së kufomave të para, erdhën kamionë me kufoma të tjera dhe se Gjorgjeviqi mori masa për varrosjen e këtyre kufomave.¹³⁸⁷ Dhoma e Apelit thekson se një dhomë gjyqësore mund të bazohet në prova rrethore për nxjerrjen e një rrjedhimi që vërteton një fakt i cili shërben si bazë e një verdikti fajësie në qoftë se është e bindur se ishte rrjedhimi i vetëm i mundshëm i arsyeshëm.¹³⁸⁸ Bazuar në provat e paraqitura që tregojnë rolin e rëndësishëm të Gjorgjeviqit në organizimin e transportimit dhe varrosjes së kufomave të gjetura në lumin Danub, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se rrjedhimi i vetëm i mundshëm ishte se Gjorgjeviqi ishte në dijeni se kufomat do të sillleshin në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë. Duke marrë parasysh natyrën dhe sasinë e provave që konfirmojnë dijeninë e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se befasimi i Gjorgjeviqit kur e informuan për zbulimin e kufomave tregon se ekzistonte edhe një tjetër rrjedhim i arsyeshëm.¹³⁸⁹

407. Në lidhje me Dëshmitarin K87, Dhoma e Apelit thekson se përse i përket kohës kur Gjorgjeviqi e informoi për kamionët ai dëshmoi se:

hera e parë ishte pasi kishte arritur. Për herët e tjera mendoj se ishte para mbërritjes. Nuk më kujtohet saktësisht tani. Gjithsesi herën e parë ishte pas mbërritjes së kamionit.¹³⁹⁰

Në deklaratën e tij, Dëshmitari K87 dëshmoi në mënyrë të ngjashme se ai u informua për mbërritjen e kamionëve pas mbërritjes së tyre në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë.¹³⁹¹ Duke marrë parasysh këtë dëshmi në të cilën u bazua Dhoma Gjyqësore, Dhoma e Apelit konstaton

¹³⁸³ Aktgjykimi, para. 1301, përmendet Prova Materiale P352, f. 3, P353, f. 7405-7406, 7408, Çasllav Golluboviq, 3 mars 2009, T. 1741. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1347.

¹³⁸⁴ Aktgjykimi, para. 1307-1308, përmendet, ndër të tjera, Prova Materiale P352, f. 4, P353, f. 7449. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 220.

¹³⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1307 (përmendet Prova Materiale P352, f. 4), 1312 (përmendet, ndër të tjera, Prova Materiale P359, f. 7452-7454, Boshko Radojkoviq, 4 mars 2009, T. 1846, Shtojcë Konfidenciale). Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 220.

¹³⁸⁶ Aktgjykimi, para. 1329, përmendet Prova Materiale P1414 (konfidenciale), para. 12-13, 24, K87, 17 maj 2010, T. 14158-14161, 14164. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 221.

¹³⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1337, përmendet Shtojcë Konfidenciale, Prova Materiale P1415, para. 21, P370A, para. 31, K87, 17 maj 2010, T. 14174-14175. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1338-1342; Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 221.

¹³⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiqi dhe të tjerë*, para. 303.

¹³⁸⁹ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 253.

¹³⁹⁰ K87, 17 maj 2010, T. 14175.

¹³⁹¹ Prova Materiale P1415, para. 21; P1414 (konfidenciale), para. 21.

se Dhoma Gjyqësore konkludoi pasaktësisht se Gjorgjeviqi e informoi paraprakisht Dëshmitarin K87 për ardhjen e kamionëve të tjerë, sepse sipas dëshmisë gojore të Dëshmitarit K87 rezulton se së paku herën e parë Gjorgjeviqi e informoi Dëshmitarin K87 pas ardhjes së kamionit.¹³⁹² Sidoqoftë, Dhoma e Apelit gjykon se fakti nëse Gjorgjeviqi e informoi Dëshmitarin K87 para apo pas ardhjes së kamionëve në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, as ndikon në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore për pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në varrosjet në këtë vendndodhje, e as vë në dyshim përfundimet e Dhomës Gjyqësore.

408. Përsa u përket argumenteve të Gjorgjeviqit mbi kërkesën e tij për hetime prej organeve gjyqësore, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dhe rrëzoi konkretisht pretendimet e Gjorgjeviqit se ai: (i) i bëri kërkesa të përsëritura ministër Stojilkoviçit për të hetuar zbulimin e kufomave në Tekija;¹³⁹³ (ii) nuk pengoi hetim dhe nuk kishte mundësi për të bërë një gjë të tillë;¹³⁹⁴ dhe (iii) nuk bëri të njohur çfarë kishte ndodhur sepse ministër Stojilkoviçit e kërcënoi me vdekje.¹³⁹⁵ Faktikisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ndërmoi masa për pengimin e hetimeve mbi zbulimin e këtyre kufomave duke koordinuar transportimin e kufomave dhe nëpërmjet implikimit të tij në varrosjen e fshehtë të kufomave në varre të përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë.¹³⁹⁶ Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arrin të identifikojë asnjë gabim në interpretimin e këtyre provave prej Dhomës Gjyqësore. Duke marrë parasysh se Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi konkretisht këto argumente dhe provat e konsiderueshme ku u mbështet Dhoma Gjyqësore në lidhje me dijeninë dhe implikimin e Gjorgjeviqit në operacionet e fshehjes si dhe mungesën e provave në mbështetje të pretendimeve të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte formuluar të njëjtin konkluzion si Dhoma Gjyqësore. Për këtë arsye, Gjorgjeviqi nuk ka arritur të provojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur i rrëzoi këto argumente.

409. Si rrjedhojë Dhoma e Apelit arrin në përfundimin se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi në interpretimin e provave në lidhje me implikimin e tij në fshehjen e kufomave të gjetura në Tekija dhe në konkluzionin se implikimi i tij kontribuoi në NPK.

(c) Qendra e PJP-së në Petrovo Sello

a. Hyrje

¹³⁹² Shih Aktgjykimi, para. 1337.

¹³⁹³ Aktgjykimi, para. 1970. Shih gjithashtu Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 556-557; Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9723; Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 10002-10003, 10009; Argumentet Përmbyllëse, 14 korrik 2010, T. 14500, 14506-14507.

¹³⁹⁴ Aktgjykimi, para. 1970. Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 10002-10003, 10009.

¹³⁹⁵ Aktgjykimi, para. 1971. Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 9975-9977, 10012; Vllastimir Gjorgjeviq, 12 dhjetor 2009, T. 10096-10097.

¹³⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1970.

410. Dhoma Gjyqësore konkludoi se përveç kufomave që mbërritën në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, “dy ngarkesa të tjera me kufoma u dërguan në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello”, ku u varrosën në varre të përbashkëta.¹³⁹⁷ Dhoma Gjyqësore gjykoi se kishte mjaft ngjashmëri midis operacioneve të fshehjes së kufomave në këto dy vendndodhje dhe konkludoi se ato u kryen si pjesë e një operacioni të bashkërenduar nën drejtimin e Gjorgjeviqit së bashku me Iliqin, “sipas udhëzimeve të ministër Stojilkoviqit dhe në përputhje me urdhrin e Presidentit Millosheviq”.¹³⁹⁸ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se i Akuzuari kishte dijeni për transportimin e kufomave nga Kosova në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello në prill 1999.¹³⁹⁹

b. Argumentet e palëve

411. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai ishte në dijeni të rivarrosjeve në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello.¹⁴⁰⁰ Ai veçanërisht argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur: (i) u mbështet në “karakteristikat e përbashkëta” të ngjarjeve në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë dhe ngjarjeve në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello, por shpërfilli faktin se kufomat e zbuluara në Tekija u transportuan shumë më larg;¹⁴⁰¹ (ii) zhvlerësoi faktin se fshehja u planifikua nga persona të ndryshëm;¹⁴⁰² dhe (iii) u mbështet në implikimin e tij në arrestimin dhe transferimin e vëllezërve Bytyqi në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello dhe vizitën që i bëri këtij vendi “dikur para korrikut 1999”, pas periudhës së Aktakuzës.¹⁴⁰³

412. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore “me arsye konkludoi se varret e përbashkëta në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello ishin pjesë e të njëjtit plan për fshehjen e provave në lidhje me krimet masive dhe se Gjorgjeviqi luajti rol udhëheqës në këtë plan”.¹⁴⁰⁴ [Prokuroria] argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë deduktoi dijeninë e Gjorgjeviqit mbi operacionet për fshehjen e kufomave në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello nga ngjashmëritë e dukshme dhe aspektet e përbashkëta të këtyre operacioneve dhe nga veprimet e bashkërenduara prej Gjorgjeviqit në Batajnicë dhe liqenin e Peruqacit.¹⁴⁰⁵ Së fundi, Prokuroria

¹³⁹⁷ Aktgjykimi, para. 1356. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1353-1355.

¹³⁹⁸ Aktgjykimi, para. 1976-1980.

¹³⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1981.

¹⁴⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 252, 262-263.

¹⁴⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 262. Gjorgjeviqi parashtron se ngjarjet në secilën prej vendndodhjeve dallonin nga karakteristikat e tyre, duke sugjeruar kështu se nuk kishte një plan gjithëpërfshirës (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 263).

¹⁴⁰² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 262.

¹⁴⁰³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 263; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 79. Në kundërpërgjigjen e tij, Gjorgjeviqi parashtron se Prokuroria gabon kur mbështetet në rastin e vëllezërve Bytyqi në përgjigjen e saj, meqenëse kjo “ka të bëjë me Serbinë” pas periudhës së Aktakuzës dhe nuk provon kontrollin mbi Kosovën (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 79). Dhoma e Apelit thekson se lidhur me këtë, Gjorgjeviqi interpreton gabimisht përgjigjen e Prokurorisë në lidhje me këtë pikë, meqenëse Prokuroria parashtron se rasti i vëllezërve Bytyqi lidhet me komandën e Gjorgjeviqit mbi punonjësit e policisë në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello (Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 231).

¹⁴⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 229.

¹⁴⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 229.

parashtron se Gjorgjeviqi thjesht përpiket të zëvendësojë interpretimin e provave prej Dhomës Gjyqësore me interpretimin e tij, dhe se parashtrimet e tij përligjin rrëzim të menjëhershëm.¹⁴⁰⁶

c. Analizë

413. Dhoma e Apelit është bindur se, duke marrë parasysh lidhjen dhe ngjashmëritë e dukshme midis operacioneve të ndryshme për fshehjen së kufomave dhe rolin e drejtpërdrejtë të Gjorgjeviqit në bashkërendimin e fshehjes së kufomave në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë dhe në liqenin e Peruqacit, Dhoma Gjyqësore me arsye gjykoi se i vetmi përfundim i arsyeshëm nga provat ishte se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të operacioneve të ngjashme për fshehjen e kufomave në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello. Dhoma e Apelit thekson përfundimet e Dhomës Gjyqësore, ndër të tjera se: (i) kufomat e varrosura në këto vende të ndryshme ishin nga Kosova dhe të vdekurit ishin shqiptarë kosovarë;¹⁴⁰⁷ (ii) kishte ngjashmëri në llojin e automjeteve të përdorura për transportimin e kufomave dhe në mënyrën e përgatitjes së varreve të përbashkëta;¹⁴⁰⁸ (iii) gjatë operacioneve të fshehjes të kryera në vende të ndryshme u përdorën pajisje dhe punonjës të njëjtë;¹⁴⁰⁹ (iv) terreni stërvitor i SAJ-it në Batajnicë dhe ai i PJP-së në Petrovo Sello ishin nën juridiksionin e Gjorgjeviqit si shef i RJB-së; dhe (v) punonjësit e MPB-së që morën pjesë në operacionet e fshehjes së kufomave ishin vartës të Gjorgjeviqit.¹⁴¹⁰ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se përfshirja e Gjorgjeviqit në arrestimin dhe transferimin e vëllezërve Bytyqi “tregon kontrollin efektiv të tij mbi punonjësit e MPB-së në qendrën e PJP-së në Petrovo Sello”,¹⁴¹¹ dhe se ai vizitoi Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello dikur para korrikut 1999.¹⁴¹² Në bazë të këtyre provave, veçanërisht të një vijimësie të qartë të veprimeve të Gjorgjeviqit gjatë operacioneve për fshehjen e kufomave, Dhoma e Apelit është bindur se për Dhomën Gjyqësore ishte e logjikshme të konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se operacionet për fshehjen e kufomave “përputheshin në kohën, zbatimin dhe qëllimin” e tyre me udhëzimet e Presidentit Millosheviq dhënë ministër

¹⁴⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 231.

¹⁴⁰⁷ Aktgjykimi, para. 1976.

¹⁴⁰⁸ Aktgjykimi, para. 1976. Për shembull, Dhoma Gjyqësore theksoi se një kamion-frigorifer dhe një kabinë kamioni e mbushur me kufoma, u gjetën të braktisura duke pluskuar përkatësisht në lumin Danub dhe liqenin Peruqac, dhe se në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello ishte përdorur plastmasë e ngjashme me atë të gjetur në një prej varreve të përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë (Aktgjykimi, para. 1977).

¹⁴⁰⁹ Aktgjykimi, para. 1976-1978.

¹⁴¹⁰ Aktgjykimi, para. 1978. Për shembull, Dhoma Gjyqësore theksoi se provat identifikuan Petar Zekoviqin, i cili ishte vartës i Gjorgjeviqit në MPB dhe ndihmësministër, si personi që lëshoi udhëzime për marrjen e kufomave nga Kosova dhe transportimin e tyre në qendrën e SAJ-it në Batajnicë dhe në qendrën e PJP-së në Petrovo Sello. (Aktgjykimi, para. 1979).

¹⁴¹¹ Aktgjykimi, para. 1978. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se gjatë dëshmisë së tij në Dhomën për Krime të Luftës të gjykatës së qarkut të Beogradit, Gjorgjeviqi konfirmoi se Sreten Popoviqi, oficeri roje në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello, me të cilin kishte folur në korrik 1999, “ishte ‘sigurisht’ i detyruar që të kryente detyrat e besuara nga i Akuzuari” lidhur me vëllezërit Bytyqi (Aktgjykimi, para. 1978). Dhoma Gjyqësore më tej theksoi se Gjorgjeviqi pranoi se kishte dëgjuar se kufomat e vëllezërve Bytyqi ishin zhvarrosur nga njëri prej varreve të përbashkëta në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello (Aktgjykimi, para. 1978, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqin, 11 dhjetor 2009, T. 9975, 10016-10017, Prova Materiale P1508, f. 3-7, 10-11 dhe P815, f. 31-35).

¹⁴¹² Aktgjykimi, para. 1978.

Stojilkoviçit në mars 1999 për “pastrimin e terrenit” dhe fshehjen e gjurmëve të krimeve të kryera në Kosovë, dhe me vendimin e mëpasshëm të ministrit për t’ua kaluar përgjegjësisë për zbatimin e masave të nevojshme Gjorgjeviçit dhe Iliçit.¹⁴¹³

414. Për më tepër, Dhoma e Apelit nuk është bindur se fakti që kufomat e zbuluara në Tekija, që është shumë afër Qendrës së PJP-së në Petrovo Sello, u çuan në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, që është shumë më larg, “bindshëm sugjeron” se në ngjarjet në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello u përfshinë persona të ndryshëm.¹⁴¹⁴ Duke marrë parasysh provat rrethore bindëse, të përshkruara më lart, Dhoma e Apelit është bindur se përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me ngjashmëritë e operacioneve, dhe konkluzioni se Gjorgjeviçi mori pjesë në to, ishin përfundimi i vetëm i arsyeshëm, pavarësisht nga fakti se kufomat nga Tekija u transportuan në një vend shumë më të largët. Lidhur me arrestimin dhe ndalimin e vëllezërve Bytyçi, Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ata u dërguan në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello nën udhëzimet e Gjorgjeviçit, dhe se kjo tregonte se Gjorgjeviçi kishte “kontroll efektiv mbi punonjësit e MPB-së në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello”.¹⁴¹⁵ Dhoma e Apelit kujton se megjithëse këto ngjarje u zhvilluan pas periudhës së Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore kishte të drejtë të bazohej në to¹⁴¹⁶ si prova të mëtejshme konfirmuese se Qendra e PJP-së në Petrovo Sello “ishte nën juridiksionin” e Gjorgjeviçit”.¹⁴¹⁷ Për këto arsye, Gjorgjeviçi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore vlerësoi gabimisht provat në lidhje me Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello. Përkundrazi, ai thjesht përpiqet të zëvendësojë interpretimin e provave prej Dhomës Gjyqësore me interpretimin e vet.

415. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviçi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai ishte në dijeni të operacioneve për fshehjen e kufomave në Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello.

(d) Liqeni i Peruqacit

a. Hyrje

416. Dhoma Gjyqësore konkludoi se dikur nga mesi i prillit 1999, policia vendore zbuloi kufoma të shqiptarëve kosovarë në një kamion-frigorifer në liqenin e Peruqacit dhe se sipas udhëzimeve të Gjorgjeviçit, ato u varrosën në afërsi të liqenit të Peruqacit.¹⁴¹⁸ Dhoma

¹⁴¹³ Shih Aktgjykimi, para. 1979.

¹⁴¹⁴ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 262.

¹⁴¹⁵ Aktgjykimi, para. 1978.

¹⁴¹⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 122. Shih gjithashtu më lart, para. 278. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviçit, para. 263

¹⁴¹⁷ Aktgjykimi, para. 1978.

¹⁴¹⁸ Aktgjykimi, para. 1359-1366.

Gjyqësore theksoi se Gjorgjeviqi pranoi se ishte i vetëdijshëm se varrosja e këtyre kufomave ishte kundërligjore dhe se nuk mori masa për hetimin e tyre.¹⁴¹⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “e dinte se edhe këto kufoma ishin të shqiptarëve kosovarë të vrarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës” dhe se “reagimi instiktiv ishte që të sigurohej se kufomat nuk do të zbuloheshin apo hetoheshin më tej”.¹⁴²⁰

b. Argumentet e palëve

417. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi që u mbështet në dëshminë e shefit të SPB-së së Uzhicës në Serbi, Gjorgje Keriqit (“Dëshmitar Keriqi”) se Gjorgjeviqi urdhëroi varrosjen e kufomave në afërsi të liqenit të Peruqacit, meqenëse kjo ishte dëshmi mospërputhëse.¹⁴²¹ Konkretisht, Gjorgjeviqi argumenton se: (i) Dëshmitar Keriqi pretendoi se Gjorgjeviqi dha urdhër të tillë për të parën herë gjatë dëshmisë së tij gojore në gjyq dhe se dëshmitë e tij të mëhershme nuk sugjeronin një gjë të tillë;¹⁴²² dhe (ii) “mënyra” se si Dhoma Gjyqësore pranoi disa pjesë të dëshmisë së Dëshmitar Keriqit ishte e paqartë.¹⁴²³ Konkretisht, Gjorgjeviqi parashtroi se megjithëse Dhoma Gjyqësore theksoi se në dëshminë e tij Keriqi mund të jetë përpjekur të shmang implikimin e tij në veprime kriminale, ajo nuk shpjegoi se pse atëherë ai implikoi veten në veprime kriminale kur dëshmoi para Dhomës së Krimeve të Luftës në Gjykatën e Qarkut të Beogradit.¹⁴²⁴

418. Gjorgjeviqi gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai e dinte se kufomat e zbuluara në liqenin e Peruqacit ishin të shqiptarëve kosovarë të vrarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁴²⁵ Ai pretendon se nuk kishte prova që vërtetonin se në

¹⁴¹⁹ Aktgjykimi, para. 1366, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqin, 11 dhjetor 2009, T. 10002.

¹⁴²⁰ Aktgjykimi, para. 1366 (pa citimet).

¹⁴²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 259. Dhoma e Apelit vë në dukje parashtrimin tjetër të Gjorgjeviqit se mungesa e numrit të saktë të kufomave të zhvarrosura në liqenin e Peruqacit duhej të ishte llogaritur në dobi të tij (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 431). Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore u kushtoi vëmendjen e duhur mospërputhjeve midis raportit të autoriteteve serbe dhe raportit të Zyrës për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (“ZPZHML”) në lidhje me numrin e kufomave të zhvarrosura në liqenin e Peruqacit dhe vendosi të mbështetej në shifrat e ZPZHML-së. Lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore theksoi se ka disa faktorë që mund t’i shpjegojnë këto mospërputhje: (i) në raportin e autoriteteve serbe nuk ishin përfshirë kufomat e zhvarrosura nga dy varre në Batajnicë; (ii) në raportin serb përmendeshin ‘kufoma të plota’ kurse në shumë raste ishin vetëm kufoma të pjesshme; dhe (iii) mospërputhjet midis mbishkrimeve dhe përmbajtjes së vërtetë të thasëve të kufomave të riatdhesuara në Kosovë, që përmbanin pjesë të kufomave të përziera (Aktgjykimi, para. 1460-1461. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, sh. 711). Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se në këto rrethana, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të mbështetej në shifrat e ZPZHML-së në vend të atyre të autoriteteve serbe.

¹⁴²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 259.

¹⁴²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 260.

¹⁴²⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 260. Lidhur me deklaratën e Dëshmitar Keriqit dhënë gjykatës Dillpariqit të Dhomës së Krimeve të Luftës në Gjykatën e Qarkut të Beogradit, Dhoma Gjyqësore shpjegoi se “në deklaratën e mëhershme të Keriqit bie në sy se nuk përmendet askund që i Akuzuari u përfshi në vendimet në lidhje me nxjerrjen e kufomave dhe varrosjen e tyre te penda” (Aktgjykimi, para. 1364). Dëshmitar Keriqi më tej “tha se vendimi për t’i nxjerrë kufomat nga liqeni i Peruqacit dhe për t’i varrosur në afërsi të pendës së liqenit ishte marrë nga ai vetë dhe Zoran Mitriçeviqi” (Aktgjykimi, para. 1364, përmendet Prova Materiale D316).

¹⁴²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 261, përmendet Aktgjykimin, para. 1366.

atë kohë ai kishte dijeni apo ishte i informuar për identitetin e viktimave¹⁴²⁶ dhe argumenton se Dëshmitar Keriqi dëshmoi se nuk e dinte, e as nuk e informoi Gjorgjeviqin për prejardhjen e kufomave dhe se në të vërtetë kishte menduar se kufomat ishin me prejardhje nga Bosnjë-Hercegovina.¹⁴²⁷

419. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se kufomat e zbuluara në një kamion-frigorifer në liqenin e Peruqacit dikur nga mesi i prillit 1999 u varrosën nga policia vendore nën mbikëqyrjen e Gjorgjeviqit.¹⁴²⁸ Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të pranonte dëshminë e Dëshmitar Keriqit se Gjorgjeviqi urdhëroi varrosjen e kufomave të zbuluara në liqenin e Peruqacit.¹⁴²⁹ Prokuroria këmbëngul se Dhoma Gjyqësore analizoi me kujdes dëshminë e Dëshmitar Keriqit.¹⁴³⁰

420. Prokuroria gjithashtu argumenton se Gjorgjeviqi gabon kur pretendon se për shkak të mungesës së provave të drejtpërdrejta lidhur me identitetin e viktimave, Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se viktimat ishin me prejardhje nga Kosova dhe se Gjorgjeviqi e dinte këtë gjë.¹⁴³¹ Sipas Prokurorisë, përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin “deduksione të arsyeshme nga tërësia e provave”.¹⁴³² Prokuroria më tej parashtron se Gjorgjeviqi thjesht jep interpretimin e vet të provave në vend të interpretimit të Dhomës Gjyqësore.¹⁴³³

¹⁴²⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 261.

¹⁴²⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 261, përmendet Gjorgje Keriq, 21 korrik 2009, T. 7763, Gjorgje Keriq, 22 korrik 2009, T. 7822.

¹⁴²⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 225.

¹⁴²⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 226.

¹⁴³⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 226.

¹⁴³¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 227.

¹⁴³² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 227.

¹⁴³³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 228.

c. Analizë

421. Dhoma e Apelit konstaton se Dëshmitar Keriqi dëshmoi tri herë lidhur me varrosjen e kufomave në afërsi të liqenit të Peruqacit: (i) një deklaratë me shkrim dhënë Grupit të Punës më 2001; (ii) deklarata nën betim dhënë gjykatës Dillpariqit të Dhomës së Krimeve të Luftës në Gjykatën e Qarkut të Beogradit më 2005; dhe (iii) dëshmia gojore gjatë procesit gjyqësor.¹⁴³⁴ Dhoma Gjyqësore mori parasysh mospërputhjet konkrete midis dëshmisë së Dëshmitar Keriqit dhënë në këtë proces dhe asaj dhënë para Dhomës së Krimeve të Luftës në Beograd më 2005.¹⁴³⁵ [Dhoma Gjyqësore] theksoi se në deklaratën e vitit 2005 dhënë gjykatësit hetues, Dillpariqit, Dëshmitar Keriqi nuk përmendi që i Akuzuari u përfshi në vendimet në lidhje me nxjerrjen e kufomave dhe varrosjen e tyre te liqeni i Peruqacit.¹⁴³⁶ Përkundrazi, ai tha se vendimi për nxjerrjen dhe varrosjen e kufomave ishte marrë nga ai vetë dhe Zoran Mitriçeviçi.¹⁴³⁷ Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoi se deklarata e tij me shkrim dhënë Grupit të Punës më 2001 në dukje ngjasonte më shumë me dëshminë në gjykimin aktual.¹⁴³⁸ Kur vlerësoi dëshminë e Dëshmitar Keriqit, Dhoma Gjyqësore theksoi se disa faktorë, si ndikimi i viteve të kaluara në kujtesën e tij, fakti që ishte ende oficer në shërbim i MPB-së kur dha dëshminë e parë për Grupin e Punës, por kishte dalë në pension para dëshmisë së tij në vitin 2005, dhe frika se mos e implikonte veten në veprime kriminale, mund të kenë ndikuar versionet e ndryshme të dëshmisë së tij.¹⁴³⁹

422. Pavarësisht nga mospërputhjet e ndryshme, Dhoma Gjyqësore në fund e konsideroi bindëse dëshminë e Dëshmitar Keriqit në këtë proces se Gjorgjeviçi i dha udhëzime në lidhje me varrosjen e kufomave të zbuluara në liqenin e Peruqacit, dhe se ai foli me Gjorgjeviçin në telefon disa herë për të marrë udhëzime të mëtejshme.¹⁴⁴⁰ Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore “ka kompetencë për të pranuar dëshminë e një dëshmitari, pavarësisht nga mospërputhjet midis saj dhe deklaratave të tij të mëparshme”¹⁴⁴¹ dhe se dhoma gjyqësore mban përgjegjësinë kryesore për zgjidhjen e mospërputhjeve të mundshme brenda një dëshmie të një dëshmitari dhe ndërmjet dëshmimeve të dëshmitarëve.¹⁴⁴² Kur vlerësoi dëshminë e Dëshmitar Keriqit, Dhoma Gjyqësore gjykoi se në atë kohë, Dëshmitar Keriqi nuk ndërmori asnjë hetim lidhur me zbulimin dhe varrosjen e kufomave, dhe se me sa dukej “një moskryerje kaq e rëndë

¹⁴³⁴ Aktgjykimi, para. 1357, 1364.

¹⁴³⁵ Aktgjykimi, para. 1357-1358, 1364-1365.

¹⁴³⁶ Aktgjykimi, para. 1364, përmendet Prova Materiale D316.

¹⁴³⁷ Aktgjykimi, para. 1364, sh. 5252, përmendet Prova Materiale D316.

¹⁴³⁸ Aktgjykimi, para. 1357.

¹⁴³⁹ Aktgjykimi, para. 1358.

¹⁴⁴⁰ Aktgjykimi, para. 1364-1365.

¹⁴⁴¹ Aktgjykimi i Apelit *Rukundo*, para. 86, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 96, Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, para. 443, Aktgjykimi i Apelit *Musema*, para. 89.

¹⁴⁴² Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 71, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 355, Aktgjykimi i Apelit *Rukundo*, para. 207, Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 103.

e detyrës nga ana e Keriqit mund të ndodhte vetëm nëse Keriqi ishte duke zbatuar urdhra”.¹⁴⁴³ Dhoma Gjyqësore gjithashtu theksoi se në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, deklarata e Dëshmitar Keriqit dhënë Grupit të Punës të MPB-së më 2001 ishte e ngjashme me dëshminë e tij në këtë proces.¹⁴⁴⁴ Në atë deklaratë, Dëshmitar Keriqi thekson se Gjorgjeviqi urdhëroi marrjen e masave për “pastrimin e terrenit”, që sipas shpjegimit të tij në gjyq e kishte kuptuar si urdhër për nxjerrjen e kufomave nga liqeni i Peruqacit dhe varrosjen e tyre, dhe e informoi Dëshmitar Keriqin se në vendngjarje do të dërgoheshin përfaqësues të MPB-së për nevoja koordinimi.¹⁴⁴⁵ Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se dëshmia e Dëshmitarit përputhet me mënyrën e implikimit të Gjorgjeviqit në operacionet e varrosjes.¹⁴⁴⁶ Duke marrë parasysh se Dhoma Gjyqësore analizoi me kujdes dëshminë e Dëshmitar Keriqit, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore kishte kompetencë për pranimin e dëshmisë së Keriqit pavarësisht nga mospërputhjet me deklaratat e tij të mëparshme.

423. Dhoma e Apelit nuk është bindur se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Gjorgjeviqi e dinte se kufomat e gjetura në liqenin e Peruqacit ishin të shqiptarëve kosovarë.¹⁴⁴⁷ Dhoma Gjyqësore theksoi dëshminë e Keriqit, i cili tha se në kohën kur u zbuluan kufomat, kishte hamendësime në publik se kufomat mund të kenë qenë viktimat të sulmeve ajrore të NATO-s ose se ishin kufoma të zhvarrosura nga ndonjë varr i përbashkët në Bosnjë-Hercegovinë, por se “askush nuk mendonte se kufomat ishin nga Kosova”.¹⁴⁴⁸ Dhoma Gjyqësore më tej citoi, por e konsideroi jobindëse dëshminë e Keriqit se ai “nuk mendoi shumë” për origjinën e kufomave sepse në atë kohë kishte prioritete të tjera.¹⁴⁴⁹ Dhoma Gjyqësore më pas konkludoi se “logjikisht mund të nxirret përfundimi” se Gjorgjeviqi e dinte se kufomat ishin të shqiptarëve kosovarë të vrarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës,¹⁴⁵⁰ duke u mbështetur në provat se: (i) Gjorgjeviqi pranoi se ishte i vetëdijshëm se varrosja e kufomave të zbuluara në liqenin e Peruqacit ishte kundërligjore; (ii) ai nuk ndërmori asnjë hetim lidhur me kufomat e gjetura; dhe (iii) vetëm pak kohë para se të zbuloheshin kufomat në liqenin e Peruqacit, Gjorgjeviqi ishte informuar për zbulimin e kufomave që dukej se ishin shqiptarë kosovarë në një kamion-frigorifer të gjetur në Danub; dhe (iv) nuk u ndërmor asnjë

¹⁴⁴³ Aktgjykimi, para. 1366. Dhoma Gjyqësore më tej shpjegoi se: Nuk ka arsye të tjera për këtë moskryerje kaq të hapët të detyrës përveç urdhrave nga lart dhe nuk ka asnjë motiv ose interes personal apo tjetër që do ta shtynte Keriqin që të vepronte në këtë mënyrë, përveç urdhrave nga lart” (Aktgjykimi, para. 1366, citon Gjorgje Keriqin, 22 korrik 2009, T. 7850).

¹⁴⁴⁴ Aktgjykimi, para. 1361. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 259, ku ai pretendon se në asnjë deklaratë të Keriqit dhënë para. dëshmisë së tij në gjyq nuk sugjerohet se Gjorgjeviqi urdhëroi varrosjen e kufomave në Liqenin e Peruqacit.

¹⁴⁴⁵ Aktgjykimi, para. 1361, përmendet Prova Materiale P1212, Gjorgje Keriq, 22 korrik 2009, T. 7863.

¹⁴⁴⁶ Shih më lart, para. 378-384, 406-408, 413-414, 421-425.

¹⁴⁴⁷ *Krahaso* Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 261, përmendet Aktgjykimin, para. 1366.

¹⁴⁴⁸ Aktgjykimi, para. 1363.

¹⁴⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1363.

¹⁴⁵⁰ Aktgjykimi, para. 1366.

hetim as në lidhje me këto kufoma.¹⁴⁵¹ Dhoma e Apelit është bindur se duke marrë parasysh mënyrën e veprimit dhe faktin se Gjorgjeviqi qartë pranoi se veprimet e tij ishin kundërligjore, ishte i logjikshëm përfundimi se ai e dinte që kufomat e gjetura në liqenin e Peruqacit ishin të shqiptarëve kosovarë. Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit u referohet përfundimeve të Dhomës Gjyqësore lidhur me implikimin e Gjorgjeviqit në zbulimin e kufomave të shqiptarëve kosovarë vetëm disa javë më herët.¹⁴⁵²

424. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur gjykoi se ai kishte dijeni dhe luajti rol të rëndësishëm në fshehjen e kufomave nga liqeni i Peruqacit.

(e) Përfundim

425. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se një gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore, dhe në këtë mënyrë nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gabimisht kur zmadhoi rolin e tij në operacionet e fshehjes së kufomave lidhur me Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, liqenin e Peruqacit dhe Qendrën e PJP-së në Petrovo Sello.

5. Pretendime për gabime në vlerësimin e rolit të Gjorgjeviqit në fshehjen e kufomave

(a) Argumentet e palëve

426. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore zbatoi standard të padrejtë kur vlerësoi implikimin e tij në fshehjen e kufomave.¹⁴⁵³ Konkretisht, ai argumenton se megjithëse Dhoma Gjyqësore pranoi se Gjorgjeviqi mund të kishte vepruar në përputhje me urdhrat e ministër Stojilkoviqit për fshehjen e kufomave, gjithsesi nuk e konsideroi këtë faktor në dobi të tij, edhe pse nga ana tjetër shfajësoi Keriqin për mosmarrjen e masave të tjera meqenëse ai kishte vepruar në bazë të ‘urdhrave nga lart’.¹⁴⁵⁴ Ai më tej argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk analizoi nëse ai kishte kompetenca për të marrë masa të mëtejshme.¹⁴⁵⁵ Gjorgjeviqi pretendon se fakti që ai kërkoi të kryhej hetim dhe u befasua kur dëgjoi për kufomat e gjetura në Tekija do të ishte i pakuptimtë sikur të kishte një “konspiracion të përgjithshëm heshtjeje”.¹⁴⁵⁶ Ai gjithashtu argumenton se “implikimi i tij lidhej vetëm me një fshehje të

¹⁴⁵¹ Aktgjykimi, para. 1366, sh. 5260.

¹⁴⁵² Shih më lart, para. 406.

¹⁴⁵³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 264.

¹⁴⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 264.

¹⁴⁵⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 265.

¹⁴⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 266.

mëpasshme” dhe se Dhoma Gjyqësore zmadhoi rolin e tij në operacionet e fshehjes meqenëse ai nuk mori pjesë në përpjekjen e parë të dështuar për zhvendosjen e kufomave nga Kosova.¹⁴⁵⁷

427. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi thjesht përsërit argumente të pasuksesshme nga gjykimi, pa identifikuar asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore.¹⁴⁵⁸ [Prokuroria] shton se edhe sikur të kishte vepruar në bazë të një urdhri të paligjshëm të ministrit, ai gjithsesi është përgjegjës për veprime të tilla.¹⁴⁵⁹

(b) Analizë

428. Dhoma e Apelit nuk bindet nga argumenti i Gjorgjeviqit se ai veproi në përputhje me urdhrat e ministër Stojilkoviqit dhe se i kërkoi disa herë ministrit marrjen e masave hetimore në lidhje me kufomat e zbuluara në Tekija. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se provat treguan se vetë Gjorgjeviqi lëshoi urdhra për trajtimin, transportimin dhe rivarrosjen e fshehtë të kufomave.¹⁴⁶⁰ Për nxjerrjen e këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore u mbështet në provat e shtjelluara në Kapitullin VII të Aktgjykimit në lidhje me kufomat e zbuluara në afërsi të fshatit Tekija dhe liqenin e Peruqacit.¹⁴⁶¹ Gjorgjeviqi në thelb riparashtron argumentin e tij të pasuksesshëm se ishte thjesht ndërmjetësues që i kalonte ministrit informacionin,¹⁴⁶² dhe nuk identifikon asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi standard të padrejtë dhe me arsye konkludoi se provat vërtetuan se Gjorgjeviqi “ishte pika e parë dhe kryesore e kontaktit për dy shefat e SPB-ve përkatëse, Çasllav Golluboviqin dhe Gjorgje Keriqin”.¹⁴⁶³ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit kujton përfundimin e saj se Gjorgjeviqi ishte në dijeni dhe u implikua në operacionet e fshehjes në më shumë raste,¹⁴⁶⁴ dhe hedh poshtë kundërshtimin e Gjorgjeviqit.

¹⁴⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 253.

¹⁴⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 232, përmendet Aktgjykimi, para. 1969-1971, 1980-1982, Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 556-561, 564, 572, 602, 604.

¹⁴⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 232, përmendet Neni 7(4) i Statutit.

¹⁴⁶⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1969-1970. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se kur parashtron se Dhoma Gjyqësore shfajësoi Keriqin për mosmarrjen e veprimeve të mëtejshme për shkak se ai veproi në bazë të urdhrave nga lart, Gjorgjeviqi interpreton gabimisht arsyetimin e Dhomës Gjyqësore. Siç theksohet më lart, kur vlerësoi besueshmërinë e dëshmisë së Keriqit, Dhoma Gjyqësore shpjegoi se e vetmja arsye se pse Dëshmitar Keriqi nuk filloi një hetim në liqenin e Peruqacit ishte se ai po zbatonte urdhra nga lart (Shih më lart, para. 416, 421-424. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore nuk nxori kurrfarë përfundimi që shfajësonte Dëshmitar Keriqin për përgjegjësinë e tij (Shih për krahasim Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 264).

¹⁴⁶¹ Aktgjykimi, para. 1357-1366, 1969.

¹⁴⁶² Shih Aktgjykimi, para. 1969. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1301, 1316.

¹⁴⁶³ Shih Aktgjykimi, para. 1969. Përsa i përket pretendimit të Gjorgjeviqit se ai nuk i dha asnjë urdhër Golluboviqit në lidhje me kufomat para se ta informonte ministrin për çfarë i kishte thënë Golluboviqi, Dhoma Gjyqësore theksoi se ky pretendim ishte në kundërshtim me rrefimin e vetë Gjorgjeviqit në një letër dërguar gazetës “Nedeljni Telegraf” në vitin 2004, në të cilën deklaronte se me të mësuar për kufomat, kishte udhëzuar Golluboviqin se si të vepronte dhe më pas kishte informuar ministrin (Aktgjykimi, para. 1315, përmendet Prova Materiale P1474, f. 7, Vllastimir Gjorgjeviq, 10 dhjetor 2009, T. 9967-9968).

¹⁴⁶⁴ Shih më lart, para. 406-408, 413-414, 421-423.

429. Dhoma e Apelit gjithashtu nuk është bindur se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Gjorgjeviqi nuk mori masa për hetimin e krimeve dhe ndëshkimin e keqbërësve. Në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, provat treguan qartë se Gjorgjeviqi mori masa për parandalimin e hetimeve, duke i dhënë Golluboviqit urdhra për varrosjen e kufomave të zbuluara në Tekija, për mosinformimin e mediave dhe për shkatërrimin e kamionit-frigorifer pas heqjes së kufomave.¹⁴⁶⁵

430. Përsa i përket parashtrimit të Gjorgjeviqit se veprimet e tij bien ndesh me përfundimin se ekzistonte “konspiracion heshtjeje”, Dhoma e Apelit kujton përfundimin e vet se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore vlerësoi gabimisht përpjekjet e tij hetimore të pretenduara.¹⁴⁶⁶ Pretendimi i përsëritur i Gjorgjeviqit se ai u befasua kur dëgjoi për kufomat e zbuluara në Tekija nuk provon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nxori përfundimin e saj të përgjithshëm në bazë të tërësisë së provave se ekzistonte një plan për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës dhe se Gjorgjeviqi luajti rol aktiv në këto operacione.¹⁴⁶⁷ Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se provat vërtetuan se ai u përfshi në mënyrë aktive në operacionet për fshehjen e kufomave.

431. Së fundi, Dhoma e Apelit nuk bindet nga argumentet e Gjorgjeviqit se kishte dy operacione të ndara të fshehjes së kufomave dhe se ai luajti rol vetëm në një plan tjetër ose të veçantë të fshehjes së kufomave. Dhoma e Apelit vë në dukje se Gjorgjeviqi luajti rol qendror në operacionet e fshehjes së kufomave dhe gjithashtu kujton përfundimin e saj se brenda udhëheqjes së lartë ekzistonte një plan për zbatimin e operacioneve të tilla.¹⁴⁶⁸

432. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore vlerësoi gabimisht implikimin e tij në fshehjen e kufomave.

6. Përfundim

433. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht nënpikën 9(G) të apelit të Gjorgjeviqit.

¹⁴⁶⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1970. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1301-1302, 1307, 1313.

¹⁴⁶⁶ Shih më lart, para. 408.

¹⁴⁶⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1967-1982.

¹⁴⁶⁸ Shih më lart, para. 400-430.

H. Nën-pika 9(H): pretendime për gabime lidhur me mosmarrjen prej Gjorgjeviqit të masave për hetimin e krimeve

1. Hyrje

434. Dhoma Gjyqësore konkludoi se në Kosovë ekzistonte një praktikë që përfshinte përgjithësisht moskallëzimin dhe moshetimin e krimeve të kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë nga viti 1998 deri të paktën në fund të fushatës së NATO-s në qershor 1999.¹⁴⁶⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se në vend se të kryheshin hetime, ekzistonte një “praktikë e njëtrajtshme veprimesh të MPB-së dhe herë-herë të UJ-së, e cila u konkretizua përmes përpjekjesh komplekse për të parandaluar zbulimin e krimeve dhe penguar hetimin e tyre”.¹⁴⁷⁰ [Dhoma Gjyqësore] gjykoi se si rrjedhojë e praktikës së mosraportimit, moshetimit dhe organizimit të operacioneve për fshehjen e kufomave, në shumicën e rasteve vrasjet dhe krimet e tjera të rënda të provuara në Aktgjykim nuk u hetuan në kohë dhe autorët nuk u proceduan penalisht.¹⁴⁷¹

435. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “kontribuoi ndjeshëm në fushatën e terrorit dhe dhunës së skajshme të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë e cila synonte të ndryshonte përbërjen demografike të Kosovës”.¹⁴⁷² Gjithashtu u konkludua se ai ishte në dijeni të krimeve të kryera nga forcat serbe në Kosovë dhe se veproi me synimin e duhur kur, ndër të tjera: (i) nuk mori masa për hetimin dhe ndëshkimin e pjesëtarëve të MPB-së për krimet e kryera në Kosovë; (ii) mori masa për fshehjen e krimeve;¹⁴⁷³ dhe (iii) dërgoi njësi paraushtarake në Kosovë.¹⁴⁷⁴

2. Argumentet e palëve

436. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai nuk mori masa për hetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së dhe se kjo ishte pjesë e kontributit të tij të ndjeshëm në NPK.¹⁴⁷⁵

437. Gjorgjeviqi kundërshton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se mosraportimi dhe moshetimi i krimeve nga viti 1998 deri të paktën në qershor 1999, zbulonte një praktikë që lidhej me NPK-në.¹⁴⁷⁶ Ai parashtroi se kjo praktikë përbëhej kryesisht nga incidente që

¹⁴⁶⁹ Aktgjykimi, para. 2102. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2081-2101.

¹⁴⁷⁰ Aktgjykimi, para. 2103.

¹⁴⁷¹ Aktgjykimi, para. 2105.

¹⁴⁷² Aktgjykimi, para. 2158.

¹⁴⁷³ Aktgjykimi, para. 2158. Shih më lart, para. 372-373.

¹⁴⁷⁴ Aktgjykimi, para. 2158. Shih më lart, para. 351.

¹⁴⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 268, përmendet Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹⁴⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269.

ndodhën midis vitit 1998 dhe fillimit të 1999,¹⁴⁷⁷ të cilat nuk ishin përfshirë në raportet e Shtabit të MBP-së,¹⁴⁷⁸ dhe ishin hetuar nga SPB-të e atjeshme apo organet e UJ-së.¹⁴⁷⁹ Ai gjithashtu parashtron se kur vlerësoi Provën Materiale D888 (koleksion i “mijëra përmbledhjeve” të shkeljeve të kryera në Kosovë nga korriku 1998 deri në qershor 1999) Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh faktin që kjo provë ishte pjesë e një vëllimi më të madh dokumentesh që nuk u pranua tërësisht si provë “thjesht për shkak të madhësisë”.¹⁴⁸⁰ Sipas Gjorgjeviqit, “thjesht madhësia” e këtij materiali ngre pikëpyetje mbi përfundimin e Dhomës Gjyqësore mbi praktikën e përgjithshme të mosraportimit dhe moshetimit.¹⁴⁸¹

438. Gjorgjeviqi gjithashtu argumenton se nuk ka prova që vërtetojnë se ai dinte ose kishte arsye të dinte për incidentet që nuk përmendeshin në raportet e MPB-së ose SPB-ve, dhe për këtë arsye ai nuk mbartte detyrimin e hetimit të tyre.¹⁴⁸² Gjorgjeviqi më tej pretendon se Dhoma Gjyqësore nxori “përfundime të mjegullta lidhur me detyrimin e hetimit të të gjitha krimeve”¹⁴⁸³ duke marrë parasysh konkluzionin e saj se ai kishte ‘kontroll efektiv’ dhe duhej t’i kishte ndëshkuar krimet”.¹⁴⁸⁴ Ai parashtron se masat e nevojshme hetimore që kërkoheshin prej tij duhej të ishin “brenda mundësisë së tij ligjore”.¹⁴⁸⁵ Lidhur me këtë, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh hierarkinë e MPB-së dhe cilat hetime dhe ndëshkime ishin brenda kompetencave reale të tij.¹⁴⁸⁶ Ai posaçërisht parashtron se Dhoma Gjyqësore shpërfilli faktin se me përfshirjen e organeve gjyqësore, MPB-ja nuk pati asnjë ndikim të mëtejshëm në hetimet dhe kallëzimet penale.¹⁴⁸⁷ Gjorgjeviqi më tej argumenton se me sa duket Dhoma Gjyqësore vlerësoi cilësinë e hetimeve dhe jo “përpjekjet për të kryer hetime” në kuadër të kompetencave që kishte, dhe nuk mori parasysh ndikimin e kushteve dhe rrethanave të vështira të kohës së luftës mbi mundësinë për të kryer hetime.¹⁴⁸⁸

¹⁴⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, përmendet Aktgjykimi, para. 2083-2085, 2178-2179, 2182.

¹⁴⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, përmendet Aktgjykimi, para. 2093, 2097-2098, 2100.

¹⁴⁷⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272. Në mbështetje të pretendimit të tij, Gjorgjeviqi përmend këto vendndodhje: Podujevë, Tërrnje, Izbicë, Pastasellë dhe Kotlinë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 469, përmendet Aktgjykimi, para. 1959, 2091, 2092, 2094, 2096).

¹⁴⁸⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269, përmendet Seanca, 2 mars 2010, T. 12180, 12182-12184, 12187 (seancë e mbyllur); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 82.

¹⁴⁸¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269.

¹⁴⁸² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272.

¹⁴⁸³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 270, përmendet Aktgjykimi, para. 2191, 2194.

¹⁴⁸⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 270, përmendet Aktgjykimi, para. 2174-2185, 2191; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 82. Gjorgjeviqi thekson se nuk ka një apel të plotë në lidhje me përgjegjësinë e tij bazuar në paragrafin 3 të Neni 7 meqenëse nuk u shpallën verdikte fajësie kundër tij bazuar në këtë Nen (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, sh. 464).

¹⁴⁸⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 271, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 230, Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 154, Aktgjykimi *Strugar*, para. 373, Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerët*, para. 526-527.

¹⁴⁸⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁴⁸⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁴⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273 (theksi në origjinal).

439. Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se përfundimet e vetme se ai pengoi në mënyrë aktive kryerjen e hetimeve u nxorën në lidhje me përgjegjësinë e tij për ndihmë dhe inkurajim, dhe se këto përfundime “me sa duket” mbështeten vetëm në rastet e fshehjes së krimeve të shtjelluara në nënpikën 9(G) të apelit të tij.¹⁴⁸⁹

440. Në përgjigjen e saj, Prokuroria parashtron se argumentet e Gjorgjeviqit për ligjin rrëzim të menjëhershëm, meqenëse ai thjesht përsërit argumente të ngritura gjatë gjykimit, pa vërtetuar gabim të Dhomës Gjyqësore.¹⁴⁹⁰ [Prokuroria] argumenton se pasi analizoi me kujdes provat, Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se ekzistonte praktikë mosraportimi dhe moshetimi krimesh të kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë, dhe se u bënë përpjekje për të parandaluar hetimet.¹⁴⁹¹ Prokuroria më tej parashtron se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në NPK nëpërmjet moshetimit dhe mosndëshkimit të pjesëtarëve të MPB-së për krimet e kryera në Kosovë, edhe pse ishte në dijeni të tyre.¹⁴⁹²

441. Përsa i përket argumentit të Gjorgjeviqit lidhur me Provën Materiale D888, Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi nuk kërkoi pranimin e kësaj prove materiale në tërësi.¹⁴⁹³ Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë pranoi dhe u mbështet vetëm në ato pjesë të dokumentit “të cilat iu treguan një dëshmitari”.¹⁴⁹⁴

442. Prokuroria argumenton se megjithëse pranoi se në raportet e MPB-së që i dërgoheshin Beogradit nuk përmendeshin krimet e rënda të kryera nga forcat e MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi informohej nëpërmjet mënyrave të tjera.¹⁴⁹⁵ Prokuroria më tej thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se mosraportimi në mënyrë sistematike i krimeve përputhej me praktikën e mbulimit ose fshehjes së krimeve në MPB.¹⁴⁹⁶ Prokuroria gjithashtu parashtron se Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë

¹⁴⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 274. Shih më lart, para. 372-432.

¹⁴⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 234, bën krahasimin midis Dosjes së Apelit të Gjorgjeviqit, para. 268, 270-273, dhe Dosjes Përmbyllëse të Gjorgjeviqit, para. 413-429, 447.

¹⁴⁹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 235, përmendet Aktgjykimi, para. 2081-2107. Prokuroria gjithashtu vë në dukje përfundimin e Dhomës Gjyqësore se mosraportimi në mënyrë sistematike i krimeve përputhet me praktikën e fshehjes së krimeve (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 238, përmendet Aktgjykimin, para. 1985).

¹⁴⁹² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 234, përmendet Aktgjykimi, para. 2157-2158. Prokuroria thekson se megjithëse pranoi se raportet e MPB-së që dërgoheshin në Beograd nuk përmendnin krimet e rënda të kryera prej forcave të MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë, Dhoma Gjyqësore prapëseprapë konkludoi se Gjorgjeviqi informohej për krimet në mënyra të tjera (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 238, përmendet Aktgjykimi, para. 1985-1998).

¹⁴⁹³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 236, përmendet 6D2, 5 mars 2010, T. 12440 (seancë e mbyllur). Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269.

¹⁴⁹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 236, përmendet seanca më 2 mars 2010, T. 12179-12187 (seancë e mbyllur), 6D2, 4 mars 2010, T. 12324 (seancë e mbyllur), 6D2, 5 mars 2010, T. 12440 (seancë e mbyllur), 17 mars 2010, T. 12954, Aktgjykimi, para. 279, 301, 310, 314, 384, 431, 548.

¹⁴⁹⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 238, përmendet Aktgjykimi, para. 1985-1998.

¹⁴⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 238, përmendet Aktgjykimi, para. 1985.

se Dhoma Gjyqësore vlerësoi gabimisht rolin e tij në hetimin dhe ndëshkimin e krimeve.¹⁴⁹⁷ Sipas Prokurorisë, si shef i RJB-së Gjorgjeviqi kishte kompetenca dhe detyrim ligjor që të parandalonte kryerjen e krimeve nga vartësit e tij, ndëshkonte keqbërësit dhe formonte komisione apo organe hetimore.¹⁴⁹⁸

3. Analizë

(a) Pretendime për gabime lidhur me praktikën e mosraportimit dhe moshetimit të krimeve të kryera nga forcat serbe

443. Sipas Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se në Kosovë ekzistonte një praktikë që përfshinte përgjithësisht moskallëzimin dhe moshetimin e krimeve të kryera nga forcat serbe,¹⁴⁹⁹ meqenëse provat ku u bazua përfshijnë kryesisht: (i) incidente që ndodhën midis vitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999, e për këtë arsye nuk kanë lidhje me veprimin e tij të fajshëm më 1999;¹⁵⁰⁰ (ii) incidente të cilat nuk u përmendën në raportet e Shtabit të MPB-së, e për këtë arsye ai nuk dinte, ose nuk kishte arsye të dinte për to;¹⁵⁰¹ dhe (iii) incidente lidhur me të cilat u kryen hetime në vend të ngjarjes.¹⁵⁰²

444. Në lidhje me parashtrimin e parë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit kujton se dhomat gjyqësore kanë kompetencë të bazohen në prova të ngjarjeve që kanë ndodhur para periudhës së aktakuzës, në qoftë se prova të tilla kanë lidhje me çështjen dhe kanë vlerë provuese.¹⁵⁰³ Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se provat në lidhje me ngjarjet gjatë vitit 1998 dhe gjysmës së parë të vitit 1999 zbuluan “një praktikë force të tepruar nga forcat serbe në Kosovë dhe mungesën e veprimeve për hetimin dhe ndëshkimin e autorëve të krimeve të kryera kundër shqiptarëve kosovarë”.¹⁵⁰⁴ Dhoma Gjyqësore njëkohësisht konkludoi se “nga fundi i marsit 1999, ishte krijuar një praktikë e moshetimit të incidenteve të vrasjeve të civilëve shqiptarë kosovarë” dhe se “kjo praktikë vazhdoi deri në fund të periudhës që mbulon Aktakuza, si dhe më pas”.¹⁵⁰⁵ Për këto arsye, Dhoma e Apelit është bindur se provat lidhur me ngjarjet që ndodhën para periudhës së Aktakuzës janë të rëndësishme dhe kanë vlerë provuese përsa i përket praktikës së përgjithshme të mosraportimit, moshetimit dhe mosndëshkimit të

¹⁴⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 239. Prokuroria parashtron se me gjithë dijeninë e tij për krimet e gjerësisht përhapura të kryera nga forcat e MPB-së në Kosovë, Gjorgjeviqi nuk mori masa për të garantuar hetimin e tyre apo ndëshkimin e të implikuarve në krime gjatë periudhës së Aktakuzës dhe më pas kur ende mbante postin e shefit të RJB-së (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 237, përmendet Aktgjykimi, para. 2157, 2191).

¹⁴⁹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 239, përmendet Aktgjykimi, para. 1999, 2174-2175, 2187.

¹⁴⁹⁹ Shih Aktgjykimi, para. 2102. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2083-2101.

¹⁵⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, përmendet Aktgjykimi, para. 2083-2085, 2178-2179, 2182.

¹⁵⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, përmendet Aktgjykimi, para. 2093, 2097-2098, 2100.

¹⁵⁰² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, përmendet Aktgjykimi, para. 1959, 2091, 2092, 2094, 2096.

¹⁵⁰³ Shih më lart, para. 295.

¹⁵⁰⁴ Aktgjykimi, para. 2083.

¹⁵⁰⁵ Aktgjykimi, para. 2086.

krimeve kundër shqiptarëve kosovarë të kryera nga forcat serbe në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se ishte brenda kompetencave të Dhomës Gjyqësore që të merrte parasysh provat në lidhje me ngjarjet që kishin ndodhur para periudhës së Aktakuzës.

445. Për arsyet e lartpërmendura, Gjorgjeviqi nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi në lidhje me këtë pikë.

446. Lidhur me parashtrimin e dytë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit kujton se më herët ajo konfirmoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi vazhdoi të informohej për operacionet e MPB-së gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁵⁰⁶ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ndonëse krimet e rënda të kryera prej forcave të MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë gjatë viteve 1998 dhe 1999 nuk përmendeshin në raportet e MPB-së, Gjorgjeviqit iu raportuan krimet “në mënyra të tjera”.¹⁵⁰⁷ Dhoma Gjyqësore veçanërisht mori parasysh faktin se: (i) Gjorgjeviqi kishte kontakte të drejtpërdrejta me disa shefa të SPB-ve; (ii) me shefin e Shtabit të MPB-së Llukiqin shkoi në terren disa herë; dhe (iii) vartësit i raportonin gojarisht përmes telefonit.¹⁵⁰⁸ Duke pasur parasysh mënyrat e tjera me anë të të cilave Gjorgjeviqi informohej për krimet, Dhoma e Apelit gjykoj se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të krimeve pavarësisht se nuk përmendeshin në raportet e SBP-ve dhe MPB-së.¹⁵⁰⁹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka vërtetuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në incidente që nuk përmendeshin në raportet e MPB-së dhe SPB-ve gjatë analizës së kontributit të tij në NPK.

447. Lidhur me parashtrimin e tretë të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dhe hodhi poshtë argumentin e tij se MPB-ja kreu hetime të vendeve të

¹⁵⁰⁶ Shih më lart, para. 247-252. Shih gjithashtu më poshtë, para. 492.

¹⁵⁰⁷ Aktgjykimi, para. 1985. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1986-1998. Dhoma Gjyqësore shpjegoi se mosraportimi në mënyrë sistematike i krimeve nga ana e MPB-së nuk provon se Gjorgjeviqi nuk kishte dijeni për krimet, por përkundrazi përputhet me praktikën e mbulimit ose fshehjes në MPB të krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë (Aktgjykimi, para. 1985). Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore analizoi dhe hodhi poshtë argumentin e Gjorgjeviqit se hetimet lidhur me disa incidente që u morën parasysh nga Dhoma Gjyqësore nuk u kryen për shkak se ato nuk ishin raportuar. Për shembull, në lidhje me vrasjet e civilëve shqiptarë kosovarë natën midis 1 dhe 2 prillit 1999 të kryera nga MPB-ja, Dhoma Gjyqësore shpjegoi: nuk mund të merret seriozisht ideja se vrasjet e një numri të madh civilësh dhe djegia e shtëpive në qendrën e qytetit të Gjakovës gjatë një operacioni ku morën pjesë një numër i madh policësh nuk u hetuan sepse nuk u kallëzuan nga dëshmitarët okularë (Aktgjykimi, para. 2093. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272, sh. 468, përmendet Aktgjykimi, para. 2093, në mbështetje të pretendimit të tij se nuk ka prova se ai ishte në dijeni të incidenteve që nuk përmendeshin në raportet e MPB-së).

¹⁵⁰⁸ Aktgjykimi, para. 1985-1987. Dhoma e Apelit thekson se parashtrimet e Gjorgjeviqit lidhur me këto “mënyra të tjera” shtjellohen në pjesën lidhur me pikën e dhjetë të apelit të tij (Shih më poshtë, para. 485-504).

¹⁵⁰⁹ Shih më lart, para. 250. Shih gjithashtu më poshtë, para. 492.

krimeve të kryera kundër shqiptarëve kosovarë.¹⁵¹⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat e paraqitura nga Mbrojtja për hetimet e vendeve të krimit të vrasjeve të shqiptarëve kosovarë të kryera nga MPB-ja “tregojnë se në shumicën e rasteve, këto hetime u sajuan për të paraqitur një ide të pavërtetë se viktimat ishin pjesëtarë të UÇK-së të vrarë në luftime”.¹⁵¹¹ Për më tepër, në kundërshtim me parashtrimet e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat treguan se nuk u kryen hetime të mirëfillta e as u përpiluan raporte në lidhje me krimet e kryera në Podujevë (30 mars 1999), Tërrnje (gjatë javës së fundit të marsit 1999), Izbicë (28 mars 1999), Pastasellë (31 mars 1999), dhe Kotlinë (9 dhe 24 mars 1999).¹⁵¹² Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi gabim të Dhomës Gjyqësore lidhur me këtë pikë.

448. Përsa i përket argumentit të Gjorgjeviqit në lidhje me “sasinë e madhe” të materialit nga i cili u mor Prova Materiale D888,¹⁵¹³ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore pranoi si provë vetëm pjesët që iu treguan Dëshmitarit 6D2.¹⁵¹⁴ Për më tepër, kur paraqiti këtë dokument si provë, Mbrojtja bëri të qartë se nuk synonte “të paraqesë si provë të gjithë dokumentin, por vetëm pjesët për të cilat mund të flasë dëshmitari nga përvoja e tij e drejtpërdrejtë”.¹⁵¹⁵ Dhoma e Apelit kujton se në parim, merr parasysh vetëm provat që përmend Dhoma Gjyqësore në tekstin e aktgjykimit apo në shënimet përkatëse poshtë faqes, prova nga dokumentacioni gjyqësor dhe që përmenden nga palët, dhe sipas nevojës prova të tjera të pranuar si prova materiale në apel.¹⁵¹⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me arsye mori parasysh vetëm pjesët e provës D888 që u pranuan si provë materiale. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit nuk do t’i shtjellojë pjesët e këtij dokumenti që nuk u pranuan si provë materiale dhe nuk do të nxjerrë përfundime në lidhje me “madhësinë” e materialit nga i cili u mor Prova Materiale D888.

449. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ekzistonte një praktikë që përfshinte përgjithësisht moskallëzimin dhe moshetimin e krimeve të kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë nga viti 1998 deri të paktën në fund të fushatës së NATO-s në qershor 1999.

¹⁵¹⁰ Aktgjykimi, para. 2102. Shih Aktgjykimi, para. 2086-2100. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 272.

¹⁵¹¹ Aktgjykimi, para. 2102.

¹⁵¹² Shih Aktgjykimi, para. 1959-1966 (Podujevë), 2091 (Tërrnje), 2092 (Izbicë), 2094-2095 (Pastasellë), 2096 (Kotlinë). Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269, sh. 469.

¹⁵¹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 269.

¹⁵¹⁴ Shih 6D2, 5 mars 2010, T. 12440 (seancë e mbyllur). Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 236.

¹⁵¹⁵ 6D2, 2 mars 2010, T. 12186 (seancë e mbyllur). Shih gjithashtu 6D2, 5 mars 2010, T. 12440 (seancë e mbyllur).

¹⁵¹⁶ Shih më lart, para. 15.

(b) Pretendime për gabime në lidhje me detyrimin e hetimit

450. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore nuk nxori, siç pretendon Gjorgjeviqi “[...] përfundime të mjegullta në lidhje me detyrimin e Gjorgjeviqit për hetimin e të gjitha krimeve në bazë të përgjegjësisë komanduese sipas paragrafit 3 të Neni 7”.¹⁵¹⁷ Përkundrazi, [Dhoma Gjyqësore] vlerësoi me kujdes nëse Gjorgjeviqi mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimeve dhe/ose ndëshkimin e keqbërësve, duke përmendur rastet konkrete kur Gjorgjeviqi nuk veproi kështu.¹⁵¹⁸ Për më tepër, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore konkludoi qartësisht se Gjorgjeviqi kishte pushtet *de jure* dhe kontroll efektiv mbi policinë në Kosovë në kuadrin e pjesëmarrjes së tij në planin e përbashkët, se ai “kishte dijeni të hollësishme për ngjarjet në terren”, dhe “luajti rol kryesor në bashkërendimin e punës së forcave të MPB-së në Kosovë më 1998 dhe 1999”.¹⁵¹⁹ Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e Dhomës Gjyqësore se ai në mënyrë aktive fshehu krimet e kryera nga forcat serbe dhe siguroi që ato të mos hetoheshin.¹⁵²⁰ Rrjedhimisht, veprimet e Gjorgjeviqit nuk ishin vetëm mosmarrje masash për hetimin e krimeve. Për këto arsye, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nxori këto përfundime.

451. Lidhur me argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh hierarkinë e MPB-së dhe nëse ai kishte kompetenca reale për të hetuar dhe ndëshkuar incidentet në lidhje me të cilat u kryen hetime, Dhoma e Apelit thekson se i vetmi incident mbi të cilin mbështetet argumenti i Gjorgjeviqit është zbulimi i kufomave në afërsi të fshatit Tekija.¹⁵²¹ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh faktin se përgjegjësia e MPB-së përfundonte në momentin kur kontaktohej gjykatësi dhe prokurori.¹⁵²² Gjithsesi, Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi faktikisht ndërmoi masa për pamundësimin e kryerjes së hetimit në lidhje me kufomat e zbuluara.¹⁵²³ Dhoma e Apelit gjykon se edhe sikur të kishte ekzistuar njëfarë hierarkie që kufizonte mundësinë e Gjorgjeviqit për hetimin e krimeve, pengimi i hetimeve dhe veçanërisht roli i tij në koordinimin e transportimit të kufomave dhe varrosjen e fshehtë të tyre tregojnë se veprimet e tij në lidhje me Tekijen dhe vendet e tjera ishin më shumë se shkelje e detyrimit të tij për të kryer hetime.¹⁵²⁴ Dhoma e Apelit gjithashtu citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se në shumicën e rasteve, hetimet u sajuan për të paraqitur një ide të pavërtetë se viktimat ishin

¹⁵¹⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 270, citon Aktgjykimin, para. 2174-2185, 2191, 2194 (pa citimet).

¹⁵¹⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2185-2192.

¹⁵¹⁹ Aktgjykimi, para. 2154.

¹⁵²⁰ Aktgjykimi, para. 1969-1982. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu më lart, para. 344-349, 400-431.

¹⁵²¹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁵²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁵²³ Aktgjykimi, para. 1970. Shih më lart, para. 408.

¹⁵²⁴ Aktgjykimi, para. 1970. Shih Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu më lart, para. 406-408, 413-414, 421-423.

pjesëtarë të UÇK-së të vrarë në luftime.¹⁵²⁵ Në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk e konsideroi atë përgjegjës për “standardin e [...] punës” së gjykatësit dhe prokurorit lidhur me hetimet,¹⁵²⁶ por me të drejtë analizoi veprimet e tij kur konkludoi se ai nuk ndërmori masa për hetimin e krimeve.¹⁵²⁷

452. Duke pasur parasysh përfundimet në lidhje me rolin e tij aktiv në fshehjen e kufomave dhe parandalimin e hetimeve, Dhoma e Apelit e konsideron jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se masat hetimore që duhej të kishte marrë, duhej të kishin qenë brenda mundësisë së tij ligjore dhe se detyrimi i ndëshkimit, në disa rrethana, mund të përmbushet kur çështja u raportohet organeve kompetente.¹⁵²⁸ Për këto arsye, Dhoma e Apelit e konsideron të pabazuar edhe argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh vështirësitë e krijuara nga rrethanat e luftës në kryerjen e hetimeve të mirëfillta.¹⁵²⁹

453. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai nuk mori masat e nevojshme që do të mundësonin hetimin e krimeve të kryera nga forcat serbe në Kosovë.

(c) Pretendime për gabime lidhur me kontributin në NPK

454. Së fundi, Dhoma e Apelit e gjykon jobindës sugjerimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se si moshetimi lidhej me NPK-në dhe “aq më pak të interpretonte atë si një ‘kontribut i ndjeshëm’” në NPK.¹⁵³⁰ Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore qartë konkludoi se veprimet e Gjorgjeviqit në lidhje me fshehjen e krimeve të forcave serbe dhe mosmarrja prej tij e masave për hetimin dhe ndëshkimin e pjesëtarëve të MPB-së për krimet e kryera në Kosovë, kontribuuan ndjeshëm në NPK.¹⁵³¹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoi se mosraportimi, moshetimi dhe operacionet e fshehjes ishin pjesë e një përpjekjeje të përgjithshme për fshirjen e gjurmëve të krimeve të kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁵³² Konkretisht ajo konkludoi se roli që luajti Gjorgjeviqi në fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë nga forcat serbe mundësoi që në atë kohë të mos bëhej hetim dhe keqbërësit të mos ndëshkoheshin, megjithëse

¹⁵²⁵ Aktgjykimi, para. 2102.

¹⁵²⁶ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁵²⁷ Shih Aktgjykimi, para. 2156-2157.

¹⁵²⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 271. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 268. Dhoma e Apelit më tej gjykon se ky argument është i pashtjelluar sa duhet (Shih më lart, para. 20)

¹⁵²⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 273.

¹⁵³⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 268, 275.

¹⁵³¹ Aktgjykimi, para. 2158.

¹⁵³² Aktgjykimi, para. 2111, 2156-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2083-2105.

në bazë të ligjit ai kishte për detyrë të mundësonte hetimin e nevojshëm mbi zbulimin e kufomave.¹⁵³³

455. Dhoma e Apelit më tej thekson se, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit se “përfundimet e vetme në lidhje me ‘përpyekjet e tij aktive për parandalimin e hetimeve’ përmenden në kuadër të përgjegjësisë për ndihmë dhe inkurajim”, Dhoma Gjyqësore iu referua përfundimeve të veta lidhur me “rolin udhëheqës” të Gjorgjeviqit në përpyekjet e MPB-së për fshehjen e kufomave dhe urdhrat e tij për parandalimin e hetimeve kur vlerësoi pjesëmarrjen e tij në NPK.¹⁵³⁴ Për më tepër, përsa i përket pretendimit të Gjorgjeviqit se këto përfundime “me sa dukej” mbështeteshin në operacionet e fshehjes të shtjelluara në nënpikën 9(G) të apelit të tij, ai shpërfill përfundimin e Dhomës Gjyqësore se roli i tij në pengimin e hetimeve lidhej drejtpërsëdrejti me planin e përgjithshëm për fshehjen e kufomave të civilëve shqiptarë kosovarë të vrarë nga forcat serbe në Kosovë.¹⁵³⁵ Gjorgjeviqi nuk provoi asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore lidhur me këtë pikë.

456. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur arriti në përfundimin se mosmarrja prej tij e masave për hetimin dhe ndëshkimin e krimeve të kryera në Kosovë ishte pjesë e kontributit të tij të ndjeshëm në NPK.

4. Konkluzion

457. Për arsyet e mësipërme, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përfundoi se ai nuk mori kurrfarë masash për hetimin e krimeve dhe se kjo ishte pjesë e kontributit të tij të ndjeshëm në NPK. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht nënpikën 9(H) të apelit të Gjorgjeviqit.

I. Konkluzion

458. Si përfundim, Dhoma e Apelit konkludoi se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi në nxjerrjen e përfundimit se me krijimin e Shtabit Ministror në përputhje me Vendimin e Ministrit, nuk përfunduan as përfshirja e Gjorgjeviqit në veprimet lidhur me Kosovën, e as roli dhe pushteti i tij mbi Shtabin e MPB-së në Prishtinë.¹⁵³⁶ Dhoma e Apelit konfirmoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi ishte i pranishëm dhe aktiv në Kosovë gjatë gjithë vitit 1999 dhe vazhdoi të kishte pushtet *de jure* dhe kontroll efektiv mbi forcat e MPB-së, ndër të cilat njësitë e PJP-së dhe SAJ-it në Kosovë, gjatë periudhës së

¹⁵³³ Aktgjykimi, para. 2156-2157.

¹⁵³⁴ Aktgjykimi, para. 2156. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 274.

¹⁵³⁵ Shih Aktgjykimi, para. 2156; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 274.

¹⁵³⁶ Shih më lart, para. 226-230.

Aktakuzës.¹⁵³⁷ Dhoma e Apelit gjithashtu është bindur se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se operacionet kundërterroriste u diskutuan në mbledhjet e Kolegjiumit Ministror, se Gjorgjeviqi vazhdoi të ishte anëtar aktiv i Komandës së Përbashkët më 1999, dhe se kishte dijëni për ngjarjet që ndodhën në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁵³⁸

459. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykoi se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se Gjorgjeviqi ishte *de jure* përgjegjës për çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë dhe se ishte në dijëni të armatosjes së civilëve serbë në Kosovë.¹⁵³⁹ Për më tepër, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatës Tuzmukhamedovit, konkludoi se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur e konsideroi incidentin e Reçakut provë të koordinimit të veprimeve të MPB-së dhe UJ-së, në nxjerrjen e përfundimit lidhur me kontributin e Gjorgjeviqit në NPK.
1540

460. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatës Tuzmukhamedovit, më tej gjykoi se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se: (i) Gjorgjeviqi mori pjesë dhe ishte në dijëni të dislokimit të njësive paraushtarake në Kosovë, ndër të cilat njësia e Akrepave që u dislokua në Podujevë, dhe se kjo ishte pjesë e kontributit të tij të ndjeshëm në NPK; (ii) ekzistonte një plan për fshehjen e krimeve kundër civilëve shqiptarë kosovarë të kryera nga forcat serbe; (iii) Gjorgjeviqi u implikua drejtpërsëdrejti në fshehjen e këtyre krimeve; dhe (iv) Gjorgjeviqi nuk ndërmori dhe/ose në mënyrë aktive pamundësoi hetimin e krimeve të kryera nga forcat serbe.¹⁵⁴¹

461. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatës Tuzmukhamedovit, gjykon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë u mbështet në këto përfundime kur konkludoi se Gjorgjeviqi veprroi me synimin e realizimit të NPK-së. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se ai nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur në bazë të faktorëve të lartpërmendur konkludoi se ai ishte anëtar i NPK-së, veprroi me synimin e realizimit të NPK-së dhe kontribuoi ndjeshëm në NPK.

462. Për këto arsye, Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht pikën e nëntë të apelit të Gjorgjeviqit.

¹⁵³⁷ Shih më lart, para. 235-239, 242-243.

¹⁵³⁸ Shih më lart, para. 247-252, 269-271, 283-290.

¹⁵³⁹ Shih më lart, para. 304-309, 315-323.

¹⁵⁴⁰ Shih më lart, para. 331-335. Shih gjithashtu më lart, 338-340, 344-349.

¹⁵⁴¹ Shih më lart, para. 355-362, 366-370, 378-384, 389-390, 395-399, 406-409, 413-415, 421-425, 428-432, 443-457.

**XI. PIKA E DHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: GABIME LIGJORE DHE
FAKTIKE NË PËRFUNDIMIN SE GJORGJEVIQI KISHTE SYNIMIN E
NEVOJSHËM PËR PËRGJEGJËSI PENALE BAZUAR NË NDËRMARRJEN E
PËRBASHKËT KRIMINALE**

A. Hyrje

463. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi mori pjesë në NPK¹⁵⁴² dhe se krimet e vrasjes, dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), dhe përndjekja ishin “instrument për realizimin e qëllimit të kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale”.¹⁵⁴³ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se Gjorgjeviqi kishte të njëjtin synim me anëtarët e tjerë të NPK-së.¹⁵⁴⁴ Po ashtu, Dhoma Gjyqësore arsyetoi se, ndryshe, në qoftë se nuk do të ishte bindur se Gjorgjeviqi kishte vepruar me synimin e duhur për të vërtetuar përgjegjësinë e tij penale sipas kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, [Dhoma] do të ishte bindur se ai ishte i vetëdijshëm se “kishte të ngjarë që forcat serbe në Kosovë të kryenin krime dhe në mënyrë të vetëdijshme e mori përsipër këtë rrezik”, që përbën standardin e nevojshëm për kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁴⁵ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se Gjorgjeviqi ndihmoi dhe inkurajoi krimet.¹⁵⁴⁶

464. Në pikën e dhjetë të apelit, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore kreu disa gabime ligjore dhe faktike kur vlerësoi synimin e tij kriminal, dhe kërkon shfuqizimin e verdikteve të fajësisë kundër tij.¹⁵⁴⁷ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk nxori përfundimet e duhura dhe kur nxori përfundime që ishin palejueshmërisht të paqarta.¹⁵⁴⁸ Ai më tej argumenton se vlerësimi i Dhomës Gjyqësore në lidhje me synimin e tij kriminal ishte i paarsyeshëm meqenëse “shpërfilli përfundimet e tjera të arsyeshme nga të cilat mund të deduktohej se Gjorgjeviqi nuk kishte synimin e nevojshëm” për vërtetimin e përgjegjësinë së tij penale sipas kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁴⁹

465. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore bëri interpretim të arsyeshëm të tërësisë së provave.¹⁵⁵⁰ [Prokuroria] argumenton se parashtrimi i Gjorgjeviqit është thjesht përpjekje për të zëvendësuar interpretimin e Dhomës Gjyqësore me interpretimin e tij, dhe meriton rrëzim të

¹⁵⁴² Aktgjykimi, para. 2127-2128, 2158, 2193. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2213; më lart, para. 461.

¹⁵⁴³ Aktgjykimi, para. 2193, 2213. Shih Aktgjykimi, para. 2131-2152, 2158.

¹⁵⁴⁴ Aktgjykimi, para. 1999, 2158.

¹⁵⁴⁵ Aktgjykimi, para. 2158.

¹⁵⁴⁶ Aktgjykimi, para. 2164, 2194.

¹⁵⁴⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 276-295.

¹⁵⁴⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 276-278, 281.

¹⁵⁴⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 280, 282-295; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 86. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 61.

¹⁵⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 244.

menjëhershëm meqenëse bazohet në argumente që ai ngriti gjatë procesit gjyqësor ose në pika të tjera të apelit.¹⁵⁵¹

B. Pretendim për gabim në mosnxjerrjen e përfundimeve të nevojshme ose në nxjerrjen e përfundimeve palejueshmërisht të paqarta

1. Argumentet e palëve

466. Gjorgjeviqi fillimisht argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk nxori “përfundime konkrete se ai synoi dëbimin e shqiptarëve kosovarë përgjithmonë nga Kosova” që, sipas tij, ishin të domosdoshme për verdikt fajësie bazuar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.¹⁵⁵² Së dyti, Gjorgjeviqi parashtron se përfundimi i Dhomës Gjyqësore lidhur me synimin kriminal se “ai veproi me synimin e duhur” ishte palejueshmërisht i paqartë meqenëse u nxor pa analizuar nëse ai synoi krimet e përmendura në Aktakuzë.¹⁵⁵³ Konkretisht, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk deduktoi synimin e nevojshëm për verdikt fajësie për përndjekje bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁵⁴ Ai pretendon se për të shpallur fajësi mbi këtë bazë, Dhoma Gjyqësore duhej të kishte konkluduar jo vetëm se ai kishte synimin e përgjithshëm të kryerjes së shkeljes bazë, por edhe se ai “kishte të njëjtin synim për politikën e përbashkët diskriminuese” dhe “në mënyrë të vetëdijshme synoi diskriminimin”.¹⁵⁵⁵ Së treti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore e ngatërroi çështjen edhe më shumë kur konkludoi se ai ndihmoi dhe inkurajoi krimet e vërtetuara dhe nxori përfundim alternativ në lidhje me synimin e tij kriminal sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁵⁶

467. Në përgjigjen e saj, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e drejtë ligjor dhe nxori përfundimet e nevojshme.¹⁵⁵⁷ Konkretisht, Prokuroria parashtron se argumenti i Gjorgjeviqit lidhur me përndjekjen për ligj rrezim të menjëhershëm meqenëse shpërfill përfundimet përkatëse.¹⁵⁵⁸ Sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore përkufizoi dhe zbatoi siç duhej ligjin mbi përndjekjen, duke përfshirë kushtin e ekzistencës së synimit diskriminues,

¹⁵⁵¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 245. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 247, 251, 254-255, 259-262.

¹⁵⁵² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 276. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 84.

¹⁵⁵³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277, përmendet Aktgjykimi, para. 2158. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 85.

¹⁵⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277-281.

¹⁵⁵⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 281.

¹⁵⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277-278; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 85. Gjorgjeviqi argumenton se në Aktgjykim u përcaktuan tre nivele të dallueshme të synimit kriminal – qëllimi, papërgjegjshmëria dhe vetëdija – mirëpo këto përfundime nuk ofrojnë arsyetim që vërteton jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm elementët mendorë të nevojshëm për cilëndo nga këto forma përgjegjësie (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 108-109, përmendet Aktgjykimi, para. 2158, 2163, 2194).

¹⁵⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 246, përmendet Aktgjykimi, para. 1859-1868.

¹⁵⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 250, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 18.

dhe nxori përfundimet e nevojshme në mbështetje të fajësisë së Gjorgjeviqit për përndjekje.¹⁵⁵⁹ Për më tepër, Prokuroria përgjigjet se përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi synimin kriminal të Gjorgjeviqit nuk janë të paqarta.¹⁵⁶⁰ Së fundi, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se veprimet e Gjorgjeviqit përmbushnin si elementët ligjor të kryerjes, po ashtu edhe të ndihmës dhe inkurajimit, dhe nxori përfundime mbi synimin e tij bazuar në dy format e përgjegjësisë.¹⁵⁶¹

2. Analizë

468. Dhoma e Apelit kujton se synimi kriminal i nevojshëm për përgjegjësi penale bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale është që i akuzuari të ketë të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë në NPK për kryerjen e krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët.¹⁵⁶² Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore përkufizoi saktësisht ligjin mbi ndërmarrjen e përbashkët kriminale¹⁵⁶³ dhe shtjelloi me hollësi faktet bazë lidhur me ekzistencën e NPK-së dhe qëllimin e saj.¹⁵⁶⁴ Përsa i përket synimit kriminal të Gjorgjeviqit, duke u mbështetur në veprimet e Gjorgjeviqit gjatë asaj periudhe dhe dijeninë e tij për krimet e kryera nga forcat serbe në Kosovë, Dhoma Gjyqësore u bind se ai “veproi me synimin e duhur”, të përbashkët me pjesëmarrësit e tjerë, të kryerjes së krimeve që ishin pjesë e NPK-së.¹⁵⁶⁵ Dhoma Gjyqësore konkretisht konkludoi se krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasjes dhe përndjekjes ishin instrument për realizimin e qëllimit të NPK-së.¹⁵⁶⁶ Duke qenë se Dhoma Gjyqësore identifikoi qartësisht krimet që ishin pjesë e NPK-së dhe më pas gjykoj se Gjorgjeviqi kishte synimin e nevojshëm për këto krime, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se përfundimin mbi synimin kriminal të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore e nxori pa analizuar nëse ai synoi krimet e përfshira në Aktakuzë.¹⁵⁶⁷

469. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore gjykon se Gjorgjeviqi gabon kur sugjeron se gjatë vlerësimit të synimit të tij kriminal lidhur me NPK-në, kushtëzohet me ligj që të ketë një përfundim se ai synoi dëbimin e *përhershëm* të popullatës shqiptare kosovare. Dhoma e Apelit kujton se synimi kriminal për krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e

¹⁵⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 250, përmendet Aktgjykimi, para. 1755, 2149, 2158.

¹⁵⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 246.

¹⁵⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 247.

¹⁵⁶² Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220, 228; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 707.

¹⁵⁶³ Aktgjykimi, para. 1864-1865, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 202-204, 220, 227-228.

¹⁵⁶⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2000-2157.

¹⁵⁶⁵ Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1999, 2128, 2193.

¹⁵⁶⁶ Aktgjykimi, para. 2135-2152, 2193.

¹⁵⁶⁷ Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277.

dhunshme) nuk kërkon ekzistencën e synimit të dëbimit të përhershëm.¹⁵⁶⁸ Rrjedhimisht, parashtrimi i Gjorgjeviqit hidhet poshtë.

470. Lidhur me parashtrimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk arriti të vërtetonte synimin e nevojshëm për fajësi për përndjekje bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Dhoma e Apelit kujton se synimi kriminal i krimit të përndjekjes kushtëzon ekzistencën e synimit për të diskriminuar mbi baza politike, racore ose fetare.¹⁵⁶⁹ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim të veçantë mbi synimin e Gjorgjeviqit në lidhje me secilin prej krimeve që ishin pjesë e NPK-së. Ndonëse një përfundim i tillë do të ndihmonte, Dhoma e Apelit gjithsesi gjykon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi “veproi me synimin e duhur” lidhur me krimet që ishin pjesë e NPK-së, duhet të kuptohet se përfshin edhe përfundimin se ai kishte synimin diskriminues të nevojshëm për krimin e përndjekjes.¹⁵⁷⁰ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore konkludoi qartësisht se “krimet e zhvendosjes së dhunshme, dëbimit dhe vrasjes përbënin përndjekje (si krim kundër njerëzimit) kundër popullatës shqiptare kosovare” dhe ishin pjesë e NPK-së.¹⁵⁷¹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se edhe përndjekja nëpërmjet shkatërrimit apo dëmtimit të objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë ishte pjesë e planit të përbashkët.¹⁵⁷² Për mendimin e Dhomës së Apelit, thelbi i NPK-së – qëllimi i përbashkët i së cilës ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës për të vendosur kontrollin serb mbi krahinën¹⁵⁷³ – ishte qartësisht diskriminues. Për këto arsye, Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore nuk identifikoi synimin e nevojshëm për fajësi për përndjekje bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁷⁴ Rrjedhimisht, parashtrimi i tij hidhet poshtë.

471. Tani Dhoma e Apelit tani do të analizojë parashtrimet e Gjorgjeviqit lidhur me përfundimin alternativ të Dhomës Gjyqësore mbi synimin e tij kriminal bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe përfundimin tjetër në lidhje me ndihmën dhe inkurajimin.¹⁵⁷⁵

472. Pasi konkludoi se Gjorgjeviqi mori pjesë në NPK,¹⁵⁷⁶ Dhoma Gjyqësore theksoi se:

Ndryshe, në qoftë se nuk do të ishte bindur se i Akuzuari veproi me synimin e duhur, Dhoma do të bindej se i Akuzuari veproi me synimin e kryerjes së

¹⁵⁶⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 206; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 278, 307; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 304. Shih gjithashtu më lart, para. 154.

¹⁵⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 111; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 109.

¹⁵⁷⁰ Aktgjykimi, para. 2149, 2152. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2193.

¹⁵⁷¹ Aktgjykimi, para. 2149, 2152. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2193.

¹⁵⁷² Aktgjykimi, para. 2151.

¹⁵⁷³ Aktgjykimi, para. 2128, 2158, 2193. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2213.

¹⁵⁷⁴ Krahajo Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277-281.

¹⁵⁷⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277-278; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 85.

¹⁵⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2158. Shih më lart, para. 461.

fushatës së terrorit dhe të dhunës së skajshme të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë dhe se ishte i vetëdijshëm se kishte të ngjarë që forcat serbe në Kosovë të kryenin krimet e vërtetuara në këtë Aktgjykim dhe në mënyrë të vetëdijshme e mori përsipër këtë rrezik.¹⁵⁷⁷

473. Gjorgjeviqi argumenton se me këto përfundime, Dhoma Gjyqësore vetëm sa “ngatërroi edhe më shumë çështjen” që për pasojë e bëri përfundimin mbi synimin kriminal bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale “palejueshmërisht të paqartë”.¹⁵⁷⁸

474. Për mendimin e Dhomës së Apelit, formulimi i Dhomës Gjyqësore mund të konsiderohet i paqartë. Një lexim i thjeshtë mund të sugjerojë se Dhoma Gjyqësore nxori përfundim mbi përgjegjësinë e Gjorgjeviqit bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pavarur nga përfundimi mbi synimin kriminal lidhur me kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Gjithsesi, Dhoma e Apelit kujton se synimi kriminal në lidhje me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale është i dyfishtë. Përfundimi se i akuzuari kishte synimin kriminal të nevojshëm për kryerjen e krimeve që ishin jashtë planit të përbashkët duhet të shoqërohet nga përfundimi mbi synimin bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵⁷⁹ Përfundimet plotësuese të Dhomës Gjyqësore të formuluar në gjuhën e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk pakësojnë vlerën e përfundimit të qartë të Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi mori pjesë në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale me synimin e nevojshëm.¹⁵⁸⁰ Dhoma e Apelit nuk mendon se përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi synimin kriminal bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale janë palejueshmërisht të paqarta, meqenëse Dhoma Gjyqësore nxori përfundimet e duhura.

475. Përsa i përket përfundimit të Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi mban fajësi edhe për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të vërtetuara,¹⁵⁸¹ Dhoma e Apelit gjykon se fakti që Dhoma Gjyqësore u bind se synimi kriminal i Gjorgjeviqit përmbushte kriteret e nevojshme për më shumë forma përgjegjësie nuk e pakëson vlerën e përfundimit se Gjorgjeviqi kishte synimin e nevojshëm për NPK.

476. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit gjykon se përfundimi alternativ i Dhomës Gjyqësore se synimi kriminal i Gjorgjeviqit gjithashtu plotësonte kushtet e përgjegjësisë penale sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, si dhe përfundimi tjetër i saj në lidhje me ndihmën dhe inkurajimin, nuk krijojnë paqartësi, e as ndikojnë mbi përfundimin e

¹⁵⁷⁷ Aktgjykimi, para. 2158.

¹⁵⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 277, përmendet Aktgjykimi, para. 2158.

¹⁵⁷⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204, 228; Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerët*, para. 83, sikurse përmendet në Aktgjykim, para. 1865.

¹⁵⁸⁰ Shih Aktgjykimi, para. 2193. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2158, 2213. Shih më lart, para. 463, 468.

Dhomës Gjyqësore në lidhje me synimin kriminal bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

477. Rrjedhimisht, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundimet e duhura lidhur me synimin kriminal bazuar në kategorinë e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, apo formuloi përfundime palejueshmërisht të paqarta. Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me arsyeshmërinë e këtyre përfundimeve.

C. Pretendim për gabime gjatë analizimit të synimit kriminal të Gjorgjeviqit

478. Duke u mbështetur në dijeninë e Gjorgjeviqit për krimet dhe veprimet e tij, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai “veproi me synimin e duhur”.¹⁵⁸² Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të krimeve të kryera nga forcat e MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë¹⁵⁸³ duke u bazuar në disa faktorë,¹⁵⁸⁴ ndër të cilët: (i) raportet për krimet që Gjorgjeviqi mori “në mënyra të tjera” nga raportimi i rregullt, si për shembull përmes telefonit ose kontakteve të drejtpërdrejta;¹⁵⁸⁵ (ii) urdhrat e Gjorgjeviqit më 1998 dhe 1999 për dislokimin e forcave të MPB-së në Kosovë;¹⁵⁸⁶ dhe (iii) raportet e mediave serbe dhe Human Rights Watch.¹⁵⁸⁷ Me këtë dijeni, Dhoma Gjyqësore gjykoj se Gjorgjeviqi: (i) mori pjesë në dislokimin e pjesëtarëve të një njësie paraushtarake për të ndihmuar forcat e SAJ-it gjatë operacioneve kundërterroriste;¹⁵⁸⁸ (ii) u përfshi në operacionet për fshehjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë anembanë Kosovës;¹⁵⁸⁹ dhe (iii) nuk formoi një komision apo organ që do të hetonte akuzat për krimet të kryera nga forcat e MPB-së në Kosovë.¹⁵⁹⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte synimin e njëjtë me anëtarët e tjerë të NPK-së të “kryerjes së krimeve dhe moshetimin e tyre”.¹⁵⁹¹

479. Gjorgjeviqi parashtron se nuk kishte prova të drejtpërdrejta se ai kishte synimin e realizimit të NPK-së.¹⁵⁹² Konkretisht, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi : (i) që nuk

¹⁵⁸¹ Shih Aktgjykimi, para. 2194. Më poshtë në këtë Aktgjykim, Dhoma e Apelit do të shtjellojë nëse Dhoma Gjyqësore gaboi kur shpalli fajësi të shumëfishtë (Shih më poshtë, para. 825-834).

¹⁵⁸² Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1983-1999.

¹⁵⁸³ Aktgjykimi, para. 1983-1999.

¹⁵⁸⁴ Aktgjykimi, para. 1985-1998. Përveç faktorëve që përmenden në tekstin kryesor, Dhoma Gjyqësore mori parasysh edhe pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, si edhe faktin se ai ishte në dijeni të Rezolutës 1160 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 31 mars 1998 ku ndër të tjera dënohej përdorimi i forcës së tepruar prej forcave policore serbe kundër civilëve (Aktgjykimi, para. 1988, 1990).

¹⁵⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1985-1987. Shih më lart, para. 250.

¹⁵⁸⁶ Aktgjykimi, para. 1989.

¹⁵⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1996-1998.

¹⁵⁸⁸ Aktgjykimi, para. 1993.

¹⁵⁸⁹ Aktgjykimi, para. 1994.

¹⁵⁹⁰ Aktgjykimi, para. 1999.

¹⁵⁹¹ Aktgjykimi, para. 1999.

¹⁵⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279.

mori parasysh pjesë të dëshmisë së tij në gjyq;¹⁵⁹³ (ii) kur vlerësoi dijeninë e tij për krimet;¹⁵⁹⁴ dhe (iii) deduktoi synimin nga veprimet e tij.¹⁵⁹⁵

480. Prokuroria përgjigjet se për nxjerrjen e përfundimit në lidhje me synimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjqësore u mbështet në prova rrethore dhe të drejtpërdrejta dhe vlerësoi drejtë se çfarë vlere do t'i akordonte secilës provë në bazë të tërësisë së provave.¹⁵⁹⁶

1. Pretendime për mosmarrjen parasysh të disa pjesëve të dëshmisë gojore të Gjorgjeviqit dhënë gjatë procesit gjyqësor

(a) Argumentet e palëve

481. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjqësore nuk analizoi pjesë të dëshmisë së tij gojore, e cila ishte provë e drejtpërdrejtë se ai nuk ishte në dijeni të ndonjë plani për dëbimin e popullatës shqiptare kosovare nga Kosova.¹⁵⁹⁷ Gjorgjeviqi u referohet dy deklaratave të bëra gjatë dëshmisë gojore, përkatësisht se ai: (i) “ asnjëherë nuk dëgjoji ministrin apo ndonjë zyrtar tjetër të lartë të japë ndonjë detyrë që nënkuptonte kryerje krimesh kundër popullatës civile shqiptare [kosovare], apo që do të nxiste pjesëtarët e MPB-së të kryenin krime ose që nënkuptonte se krimet e tyre do të toleroheshin”,¹⁵⁹⁸ dhe (ii) “nuk dëgjoji nga asnjë politikan për ndonjë synim, plan, veprim, ose person që duhej të zbatonte një plan të tillë, në qoftë se ka ekzistuar, lidhur me dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe Metohija”.¹⁵⁹⁹ Gjorgjeviqi argumenton se në vend që të merrte parasysh këtë dëshmi të drejtpërdrejtë, Dhoma Gjqësore u mbështet vetëm në deduksione.¹⁶⁰⁰ Lidhur me këtë, ai pranon se, megjithëse jurisprudenca parashtron se “synimi kriminal mund të deduktohet, *deduksioni duhet të jetë i vetmi përfundim i arsyeshëm nga provat*”.¹⁶⁰¹ Megjithatë, ai argumenton se Dhoma Gjqësore nuk veproi kështu, por shpërfilli “përfundime të tjera të arsyeshme që sugjeronin se ai nuk kishte synimin e nevojshëm të kategorisë I të NPK-së”.¹⁶⁰²

482. Në përgjigjen e saj, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjqësore kishte të drejtë të mos merrte parasysh dëshminë gojore të Gjorgjeviqit, dhe pretendon se Gjorgjeviqi nuk shpjegoi se pse Dhoma Gjqësore duhej të favorizonte dëshminë që ai përmend në dosjen e apelit

¹⁵⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279-280.

¹⁵⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 282-288.

¹⁵⁹⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 289-294.

¹⁵⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 248-249.

¹⁵⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 27 janar 2009, T. 238, Vllastimir Gjorgjeviqi, 14 dhjetor 2009, T. 10145.

¹⁵⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 27 janar 2009, T. 238.

¹⁵⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 14 dhjetor 2009, T. 10145.

¹⁶⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 280.

¹⁶⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 280, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 429.

¹⁶⁰² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279-280 (theksi i hequr), përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*. Aktgjykimi i Apelit, para. 237. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 83, 86.

përkundrejt “provave rrethore të hollësishme dhe përputhëse lidhur me synimin e tij, mbi të cilat Dhoma mbështeti përfundimet e veta”.¹⁶⁰³

(b) Analizë

483. Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi me të drejtë vëren se kur vlerësoi synimin e tij kriminal lidhur me NPK-në, Dhoma Gjyqësore nuk analizoi veçazi dy deklaratat e bëra gjatë dëshmisë së tij gojore.¹⁶⁰⁴ Gjithsesi, Dhoma e Apelit kujton se dhomat gjyqësore kanë kompetenca të brendaqenësishme për të vlerësuar dhe peshuar provat,¹⁶⁰⁵ dhe nuk janë të detyruara të citojnë çdo provë nga dokumentacioni gjyqësor i çështjes.¹⁶⁰⁶ Dhoma e Apelit më tej thekson se kur argumenton se Dhoma Gjyqësore u mbështet thjesht në deduksione, Gjorgjeviqi interpreton gabimisht arsyetimin dhe konkluzionet e Dhomës Gjyqësore. Gjatë shqyrtimit të synimit të tij kriminal, Dhoma Gjyqësore faktikisht mori parasysh prova të shumta, si të drejtpërdrejta, po ashtu rrethore, ndër të cilat edhe pjesë konkrete të dëshmisë së tij.¹⁶⁰⁷ Në veçanti, Dhoma mori parasysh dëshminë e tij se “për çdo gjë që ndodhte në organet e punëve të brendshme kryesisht informohesha nëpërmjet kanaleve të rregullta apo në ndonjë mënyrë tjetër”.¹⁶⁰⁸ Dhoma Gjyqësore gjykoj se kjo dëshmi në tërësi tregonte se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të situatës në terren, ndër të tjera, të krimeve që kryenin forcat e MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë.¹⁶⁰⁹ Duke pasur parasysh këtë dëshmi, së bashku me të gjitha provat e tjera lidhur me pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në NPK, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai “veproi me synimin e duhur”.¹⁶¹⁰

484. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk mori parasysh pjesë të dëshmisë së tij gojore në shqyrtimin e synimit të tij kriminal.

¹⁶⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 249.

¹⁶⁰⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 279, përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 27 janar 2009, T. 238, Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10145.

¹⁶⁰⁵ Shih *p.sh.* Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 30-32; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47.

¹⁶⁰⁶ Shih *p.sh.* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 498; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 39; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 382.

¹⁶⁰⁷ Aktgjykimi, para. 1984-1999. Shih *p.sh.* Aktgjykimi, para. 1986, (përmendet Vllastimir Gjorgjeviqi, 7 dhjetor 2009, T. 9703, Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10087), 1987 (përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9735-9739, Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 10020).

¹⁶⁰⁸ Aktgjykimi, para. 1986, përmendet Prova Materiale P1508, f. 5 (dëshmia e Gjorgjeviqit para Gjykatës së Beogradit). Shih Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10086-10087.

¹⁶⁰⁹ Aktgjykimi, para. 1983-1999, 2154-2158. Shih gjithashtu më lart, para. 478.

¹⁶¹⁰ Aktgjykimi, para. 2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1983-1999, 2154-2157.

2. Pretendim për gabime gjatë vlerësimit të dijenisë së Gjorgjeviqit

(a) Hyrje

485. Përfundimin se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të krimeve të forcave të MPB-së kundër civilëve shqiptarë kosovarë, Dhoma Gjyqësore e mbështeti në disa faktorë, ndër të cilët: (i) raportet për krimet që ai merrte nëpërmjet kanaleve të ndryshme;¹⁶¹¹ (ii) urdhrat e tij më 1998 dhe 1999 për dislokimin e forcave të MPB-së në Kosovë;¹⁶¹² dhe (iii) informacionin që mori nga mediat serbe dhe raportet e Human Rights Watch.¹⁶¹³

(b) Argumentet e palëve

486. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi të panevojshme dijenisë së tij për krimet e kryera më 1998 kur konkludoi se ai ishte në dijeni të krimeve të kryera më 1999.¹⁶¹⁴ Konkretisht, në lidhje me “strukturat raportuese”, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në rrethanat e vitit vitin 1998 “për të përfytyruar se çfarë informacioni ishte i disponueshëm më 1999”.¹⁶¹⁵ Ai parashtroi se duke vepruar kështu, Dhoma Gjyqësore nuk u kushtoi rëndësinë e duhur: (i) mosraportimit të krimeve përmes kanaleve të rregullta dhe pamundësisë së udhëtimit ose përdorimit të telefonave gjatë periudhës së Aktakuzës;¹⁶¹⁶ (ii) disa urdhra të tij;¹⁶¹⁷ dhe (iii) burimeve të mediave që kishte në dispozicion.¹⁶¹⁸

487. Prokuroria përgjigjet se parashtimet e Gjorgjeviqit duhen hedhur poshtë menjëherë meqenëse ai “përsërit parashtimet e pasuksesshme të bëra gjatë gjykimit dhe zëvendëson interpretimin e provave të Dhomës Gjyqësore me interpretimin e vet të provave, pa vërtetuar gabim”.¹⁶¹⁹ Prokuroria më tej argumenton se duke u mbështetur në burime të shumta, Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të krimeve të forcave serbe kundër civilëve të kryera gjerësisht në Kosovë më 1998, dhe se ai ishte i vetëdijshëm për rrezikun se këto forca do të kryenin krime të tjera në qoftë se do të dislokoreshin përsëri më 1999.¹⁶²⁰

¹⁶¹¹ Aktgjykimi, para. 1985-1987.

¹⁶¹² Aktgjykimi, para. 1989.

¹⁶¹³ Aktgjykimi, para. 1996-1998.

¹⁶¹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 282.

¹⁶¹⁵ Aktgjykimi, para. 283. Shih më lart, para. 293. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 80-81.

¹⁶¹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 283-286.

¹⁶¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 287. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 173.

¹⁶¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 283, 288.

¹⁶¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 251 (pa citimet).

¹⁶²⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 252-253. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se argumenti i Prokurorisë se në bazë të krimeve të kryera më 1998 ai ishte në dijeni të “rrezikut” se krimet do të vazhdonin edhe më 1999 është më i ngjashëm me përgjegjësinë penale sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, “por bie ndesh me argumentin e Prokurorisë se plani bazuar në kategorinë e parë të NPK-së u zbatua qëllimisht për të kryer krime kundër shqiptarëve kosovarë” (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 87).

488. Dhoma e Apelit do t'i shqyrtojë një nga një argumentet e Gjorgjeviqit në lidhje me parashtrimin e përgjithshëm të tij se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai ishte në dijeni të krimeve.

(c) Analizë

a. Mosraportimi

489. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi u informua për situatën në terren në Kosovë më 1998 dhe 1999, ndër të tjera përmes bisedave telefonike me vartësit e tij dhe kontakteve personale me disa shefa të SPB-ve në Kosovë dhe me shefin e Shtabit të MPB-së, Llukiqin.¹⁶²¹

490. Gjorgjeviqi parashtron se përfundimi i Dhomës Gjyqësore lë të kuptohet se ai nuk ishte në dijeni të përhapjes së veprimeve kriminale në Kosovë, meqenëse sistemet e komunikimit u dëmtuan rëndë pas datës 24 mars 1999 kur filluan bombardimet e NATO-s.¹⁶²² Ai po ashtu parashtron se edhe lidhur me periudhën para fillimit të bombardimeve, Dhoma Gjyqësore “thjesht supozoi se si dhe çfarë informacioni i kalohej atij”.¹⁶²³

491. Prokuroria përgjigjet se, kur konkludoi se Gjorgjeviqit iu raportuan krimet “nëpërmjet mënyrave të tjera”, Dhoma Gjyqësore ndër të tjera u mbështet në dëshminë e vetë Gjorgjeviqit, e cila “u analizua me kujdes” së bashku me dëshmitë e disa dëshmitarëve të tjerë.¹⁶²⁴

492. Dhoma e Apelit më herët konkludoi se në kontekst të analizës së sistemit raportues në MPB gjatë periudhës së Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi, duke u bazuar në tërësinë e provave, se Gjorgjeviqi vazhdoi të informohej për operacionet e MPB-së gjatë asaj kohe.¹⁶²⁵ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Gjorgjeviqit se ai nuk ishte në dijeni të përhapjes së veprimeve kriminale në Kosovë për shkak të dëmtimit të rëndë të sistemeve të komunikimit pas datës 24 mars 1999.

¹⁶²¹ Aktgjykimi, para. 1987.

¹⁶²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 284-285, përmendet Aktgjykimi, para. 1985-1987. Shih gjithashtu më lart, para. 251.

¹⁶²³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 286. Si ilustrim, Gjorgjeviqi thekson se nuk ka përfundime se çfarë informacioni ai mori “nëpërmjet mënyrave të tjera” dhe se si shefi i Shtabit të MPB-së Llukiqi “i raportonte rregullisht” atij (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 88).

¹⁶²⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 253-254, përmendet Aktgjykimi, para. 1897, 1986, sh. 6502, Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10086.

¹⁶²⁵ Shih më lart, para. 252.

b. Urdhrat e Gjorgjeviqit

493. Kur vlerësoi *dijeninë* e Gjorgjeviqit për situatën në terren në Kosovë, Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh disa “urdhra” që lëshoi Gjorgjeviqi më 1998 dhe 1999 për dislokimin e forcave të MPB-së në Kosovë.¹⁶²⁶

494. Gjorgjeviqi parashtron se “urdhrat” që mori parasysh Dhoma Gjyqësore në lidhje me synimin e tij kriminal ishin thjesht “telegrame”, dhe se ato nuk tregojnë ndonjë plan apo veprim konkret në terren në Kosovë, dhe nuk përmbajnë ndonjë detyrë konkrete, e as sugjerojnë ndonjë qëllim kriminal.¹⁶²⁷

495. Prokuroria përgjigjet se parashtrimi i Gjorgjeviqit është i pavend, meqenëse provat mbështesin konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se *dijenja* e tij për situatën në terren në Kosovë pasqyrohet në këto urdhra.¹⁶²⁸

496. Dokumentet që Dhoma Gjyqësore i quan “urdhra” përfshijnë informacion lidhur me dislokimin e forcave të MPB-së në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, dhe mbajnë nënshkrimin e Gjorgjeviqit.¹⁶²⁹ Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi mbi këtë bazë se Gjorgjeviqi ishte në *dijeni* të përmbajtjes së këtyre “urdhrave”. Gjorgjeviqi me të drejtë parashtron se këto dokumente janë “telegrame” dhe jo “urdhra”, dhe se ato nuk përmbajnë udhëzime konkrete për kryerje krimesh.¹⁶³⁰ Megjithatë, Dhoma e Apelit gjykon se në lidhje me aspektet e tjera Gjorgjeviqi interpreton gabimisht provat lidhur me këtë çështje. [Dhoma e Apelit] thekson se Dhoma Gjyqësore i mori parasysh këto “urdhra” së bashku me dëshmi të tjera përkatëse, kur përcaktoi *dijeninë* e Gjorgjeviqit për situatën në terren më 1999, ndër të tjera për krimet.¹⁶³¹ Përfundimin lidhur me synimin kriminal të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore e bazoi në këtë *dijeni* dhe provat për veprimet e tij.¹⁶³² Për këtë arsye, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore i vlerësoi gabimisht këto dokumente.

¹⁶²⁶ Aktgjykimi, para. 1989, përmendet Provat Materiale P136, P711, P1182, P1185, P1189. Shih gjithashtu Provat Materiale P1193, P1195, P1196, P1487, P1488.

¹⁶²⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 287. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 173.

¹⁶²⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 256. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 119-120.

¹⁶²⁹ Prova Materiale P136; P711; P1182; P1185; P1189.

¹⁶³⁰ Provat Materiale P136, P711, P1182, P1185, P1189 janë të gjitha “telegrame” të MPB-së lidhur me dislokimin e njërive të PJP-së.

¹⁶³¹ Aktgjykimi, para. 1983-1999.

¹⁶³² Aktgjykimi, para. 1983-1999, 2154-2158.

c. Mediat serbe dhe raportet ndërkombëtare

497. Dhoma Gjyqësore konstatoi se mediat serbe ishin burim informacioni për Gjorgjeviqin lidhur me krimet e kryera nga forcat serbe.¹⁶³³ Dhoma më tej konstatoi se mediat serbe hodhën poshtë pretendimet për krime të kryera prej forcave serbe në Kosovë.¹⁶³⁴ Duke u mbështetur në këto konstatime, Dhoma Gjyqësore konkludoi se, në qoftë se Gjorgjeviqi kishte lexuar vetëm burimet serbe në vitin 1999, siç dëshmoi vetë gjatë gjykimit, ai të paktën do të ishte informuar për akuza të tilla të raportuara në media.¹⁶³⁵ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se më 1998 dhe 1999, Human Rights Watch publikoi raporte dhe deklarata lidhur me krimet e kryera nga forcat e MPB-së, të cilat ia dërgoi me postë elektronike, midis të tjerëve, edhe MPB-së.¹⁶³⁶ Për këto arsye, dhe duke marrë parasysh pozitën e Gjorgjeviqit në MPB, Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranonte dëshminë e tij se ai nuk dinte gjë për akuzat e Human Rights Watch kundër MPB-së më 1998 dhe 1999.¹⁶³⁷

498. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore “çuditërisht” u mbështet në mediat ndërkombëtare dhe grupet për të drejtat e njeriut për të vërtetuar synimin e tij kriminal.¹⁶³⁸ Konkretisht, ai argumenton se: (i) Interneti nuk ishte gjerësisht i përdorshëm në atë kohë; (ii) ai nuk e kupton aspak anglishten; (iii) Dëshmitari Frederick Abrahams (“Dëshmitari Abrahams”) i Human Rights Watch pranoi se nuk kishte konfirmim se Human Rights Watch i dërgoi raporte MPB-së apo se MPB-ja i mori ato, e cila asokohe madje nuk kishte një adresë të postës elektronike, dhe asnjëra nga letrat e dërguara me postë elektronike nuk i drejtohej personalisht Gjorgjeviqit; dhe (iv) gjatë luftës ai lexonte çdo ditë gazetat vendore në të cilat nuk sugjerohej se në Kosovë po kryeshin krime.¹⁶³⁹

499. Prokuroria përgjigjet se, për vërtetimin e synimit kriminal të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore u mbështet në prova të shumta nga burime të ndryshme, ndër të cilat raportet e mediave dhe të Human Rights Watch.¹⁶⁴⁰ [Prokuroria] më tej argumenton se Dhoma Gjyqësore me arsye i cilësoi raportet e Human Rights Watch burim informacioni për Gjorgjeviqin në lidhje me krimet.¹⁶⁴¹ Parashtrohet se pavarësisht nëse raportet i drejtoheshin personalisht Gjorgjeviqit, duke pasur parasysh provat se Human Rights Watch ua dërgonte zyrrave të MPB-

¹⁶³³ Aktgjykimi, para. 1996.

¹⁶³⁴ Aktgjykimi, para. 1996.

¹⁶³⁵ Aktgjykimi, para. 1996, përmendet Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 9981, Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10078. Shih gjithashtu Vllastimir Gjorgjeviq, 14 dhjetor 2009, T. 10079-10082, 10087-10089.

¹⁶³⁶ Aktgjykimi, para. 1997.

¹⁶³⁷ Aktgjykimi, para. 1997. Shih Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 9981-9982.

¹⁶³⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 288; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 88.

¹⁶³⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 288.

¹⁶⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 257.

¹⁶⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 258, përmendet Aktgjykim, para. 1997.

së ku ishte i vendosur edhe vetë Gjorgjeviqi, Dhoma Gjyqësore me arsye hodhi poshtë pretendimin e tij se nuk ishte në dijeni të akuzave të Human Rights Watch kundër MPB-së.¹⁶⁴²

500. Dhoma e Apelit thekson se, sikurse argumenton me të drejtë Gjorgjeviqi, nuk ka konfirmim se raportet e Human Rights Watch iu dërguan MPB-së, dhe nuk ka prova e as përfundime të Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi personalisht i mori apo lexoi ato.¹⁶⁴³ Dhoma e Apelit gjykon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të deduktonte thjesht nga fakti se Human Rights Watch i dërgonte raporte MPB-së se Gjorgjeviq ishte në dijeni të tyre, meqenëse raportet e grupeve për të drejtat e njeriut nuk ishin pjesë e sistemit të brendshëm raportues të MPB-së.¹⁶⁴⁴ Për më tepër, Dhoma e Apelit merr parasysh argumentet e Gjorgjeviqit se Interneti nuk përdorej gjerësisht më 1999 dhe se ai nuk e kupton anglishten.¹⁶⁴⁵ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur deduktoi dijeninë e Gjorgjeviqit për krimet nga raportet e Human Rights Watch.¹⁶⁴⁶

501. Megjithatë, Dhoma e Apelit gjykon se pavarësisht nga ky gabim faktik, Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se Gjorgjeviq ishte në dijeni të krimeve. Siç u theksua më lart, përfundimi i Dhomës Gjyqësore u mbështet në disa faktorë, ndër të cilët: pozita e Gjorgjeviqit në MPB; roli i tij në negociatat me faktorin ndërkombëtar; pjesëmarrja e tij në mbledhjet e Komandës së Përbashkët dhe Kolegjiut të MPB-së; prania e tij në terren gjatë kohës që u kryen disa operacione; kontakti personal me Llukiqin; pjesëmarrja e tij në dislokimin e njërive paraushtarake dhe në operacionet për fshehjen e krimeve; dhe sistemi raportues i MPB-së.¹⁶⁴⁷

502. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore i konsideroi mediat burim plotësues të dijenisë së Gjorgjeviqit për krimet.¹⁶⁴⁸ Duke marrë parasysh përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me rolin e Gjorgjeviqit në ngjarjet në Kosovë, fakti se ai lexoi për akuza për krime të kryera në Kosovë në mediat e atjeshme serbe ishte i rëndësishëm për Dhomën Gjyqësore që ta konsideronte atë si tregues të dijenisë së tij për krimet. Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me arsye u mbështet në këto prova.

503. Për arsyet e lartpërmendura, parashtrimet e Gjorgjeviqit lidhur me mediat dhe raportet e organizatave ndërkombëtare hidhen poshtë.

¹⁶⁴² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 258.

¹⁶⁴³ Shih Aktgjykimi, para. 1997; krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 288.

¹⁶⁴⁴ Shih më lart, para. 247, 249.

¹⁶⁴⁵ Shih më lart, para. 498; Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 288.

¹⁶⁴⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1997.

¹⁶⁴⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1983-1999.

¹⁶⁴⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1996.

(d) Përfundim

504. Dhoma e Apelit më lart konkludoi se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur vlerësoi provat në lidhje me: (i) sistemin e raportimit më 1999; (ii) “urdhrat” e Gjorgjeviqit më 1998 dhe 1999; dhe (iii) informacionin për krimet nga mediat serbe.¹⁶⁴⁹ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh këto prova, së bashku me prova të tjera, kur konkludoi se Gjorgjeviqi ishte plotësisht në dijeni të ngjarjeve në Kosovë më 1999, duke përfshirë krimet që kryen forcat serbe.¹⁶⁵⁰ Dhoma e Apelit gjykon se përfundimin mbi dijeninë e Gjorgjeviqit për krimet Dhoma Gjyqësore e bazoi në një shumësi faktorësh dhe në tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e Dhomës Gjyqësore.

3. Pretendim për gabime në përfundimin se veprimet e Gjorgjeviqit vërtetuan se ai kishte synimin e duhur

(a) Hyrje

505. Dhoma Gjyqësore e mbështeti përfundimin e vet mbi synimin kriminal të Gjorgjeviqit në dijeninë e tij për krimet dhe veprimet e tij.¹⁶⁵¹ Konkretisht, [Dhoma Gjyqësore] mori parasysh: (i) implikimin e tij në operacionet për fshehjen e kufomave të shqiptarëve kosovarë të vrarë gjatë periudhës në fjalë; (ii) mosmarrjen e masave për hetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së në Kosovë; dhe (iii) pjesëmarrjen e tij në dislokimin e pjesëtarëve të njëjësive paraushtarake në Kosovë.¹⁶⁵²

(b) Argumentet e palëve

506. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur deduktoi synimin e tij për jetësimin e NPK-së nga: (i) kryerja e veprimeve *ex post facto*, ndër të cilat fshehja e krimeve të forcave serbe, dhe mosmarrja e masave për hetimin dhe ndëshkimin e pjesëtarëve të MPB-së për krimet në Kosovë; dhe (ii) dislokimi i njëjësive paraushtarake në Kosovë.¹⁶⁵³ Gjorgjeviqi argumenton se provat lidhur me “implikimin e tij në fshehjen e kufomave ishin reagime spontane, në bazë të mungesës së dijenisë paraprake” dhe, si rrjedhojë, “nuk zbuluan se ai kishte një qëllim të organikisht të lidhur, të përbashkët me të tjerët”.¹⁶⁵⁴ Ai më tej parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh provat se ai u “befasua” kur e kontaktuan lidhur me

¹⁶⁴⁹ Shih më lart, para. 492, 496, 500.

¹⁶⁵⁰ Aktgjykimi, para. 1985-1998.

¹⁶⁵¹ Aktgjykimi, para. 2154-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1983-1999.

¹⁶⁵² Aktgjykimi, para. 2154-2158.

¹⁶⁵³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 289-294. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 85-90, 172.

¹⁶⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 291.

zbulimin e kufomave në Serbi,¹⁶⁵⁵ dhe se kërkoi të kryhej hetim, por përpjekjet e tij i bllokoi ministri i Punëve të Brendshme.¹⁶⁵⁶ Përsa i përket angazhimit të njësisë paraushtarake, Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur deduktoi synimin e tij nga fakti se ai dislokoi “pjesëtarë të një njësie famëkeqe paraushtarake [në Podujevë] për t’i ndihmuar forcat e SAJ-it”, dhe pretendon se provat ishin të pamjaftueshme dhe nuk vërtetuan se ai synoi krimet e përmendura në Aktakuzë.¹⁶⁵⁷

507. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur arriti në përfundimin se Gjorgjeviqi synoi pjesëmarrjen në NPK,¹⁶⁵⁸ dhe thekson se ai thjesht përsërit argumente të parashtruara gjetkë në Dosjen e tij të Apelit dhe në Dosjen Përfundimtare.¹⁶⁵⁹ Sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore analizoi me kujdes implikimin e Gjorgjeviqit në operacionin për fshehjen e kufomave, dhe erdhi në përfundimin se ai luajti rol aktiv dhe të drejtpërdrejtë në këtë operacion.¹⁶⁶⁰ [Prokuroria] më tej argumenton se këto prova, së bashku me përfundimin e mëhershëm të Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të krimeve të kryera nga forcat serbe, çuan në konkluzionin e arsyeshëm të Dhomës Gjyqësore se ai kishte synimin e realizimit të qëllimit të përbashkët.¹⁶⁶¹ Në lidhje me hetimet, Prokuroria pretendon se kërkesa e Gjorgjeviqit për hetime nuk u bllokua,¹⁶⁶² dhe se përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me moskryerjen e hetimeve prej tij ishin të logjikshme dhe të bazuara në një analizë të hollësishme të provave.¹⁶⁶³ Për këto arsye, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se fakti që Gjorgjeviqi nuk mori masa për hetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së në Kosovë ishte “provë bindëse se ai kishte të njëjtin synim me anëtarët e tjerë të NPK-së”.¹⁶⁶⁴ Për më tepër, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore kishte kompetenca për të vlerësuar vërtetësinë e mohimit të Gjorgjeviqit lidhur me dijeninë e tij për krimet, dhe se duke marrë parasysh prova të tjera të cilat dukshëm bien ndesh me dëshminë e tij, Dhoma Gjyqësore me arsye hodhi poshtë dëshminë e tij.¹⁶⁶⁵ Në lidhje me dislokimin e njësisë paraushtarake, Prokuroria u referohet përfundimeve të Dhomës Gjyqësore se: (i) Gjorgjeviqi dislokoi në Kosovë njësi paraushtarake, ndër të cilat Akrepat, pa bërë verifikimin bazë të biografive të tyre dhe pavarësisht nga fakti se e kaluara kriminale e pjesëtarëve të kësaj njësie

¹⁶⁵⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 291, përmendet Aktgjykimi, para. 1301, Çasllav Golluboviq, 2 mars 2009, T. 1706-1707, Çasllav Golluboviq, 3 mars 2009, T. 1748-1749.

¹⁶⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 291, përmendet, ndër të tjera, Aktgjykimi, para. 1970, Vllastimir Gjorgjeviq, 7 dhjetor 2009, T. 9723-9724, 9729-9730, Vllastimir Gjorgjeviq, 11 dhjetor 2009, T. 9977, 10002-10003, 10009-10010.

¹⁶⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 293, përmendet Aktgjykimi, para. 1993. Shih më lart, para. 353.

¹⁶⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 259-262.

¹⁶⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 259-262.

¹⁶⁶⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 259, përmendet Aktgjykimi, Kapitulli VII, para. 1967-1982.

¹⁶⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 259, përmendet Aktgjykimin, para. 2158.

¹⁶⁶² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 260. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 232.

¹⁶⁶³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 261. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 234-242.

¹⁶⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 261, përmendet Aktgjykimi, para. 1999.

¹⁶⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 261, përmendet Aktgjykimi, para. 1985-1999.

njihej gjerësisht; (ii) pjesëtarët e kësaj njësie vranë 14 gra dhe fëmijë në Podujevë më 28 mars 1999; dhe (iii) Gjorgjeviqi, jo vetëm që nuk mori masa për hetimin e këtyre vrasjeve, por edhe miratoi ridislokimin e njësisë së Akrepave.¹⁶⁶⁶

(c) Analizë

508. Dhoma e Apelit vëren se në parashtrimet e tij, Gjorgjeviqi kryesisht përsërit argumente të bëra më herët në kuadër të pikës së nëntë të apelit të tij.¹⁶⁶⁷ Dhoma e Apelit kujton se la në fuqi përfundimet e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi: (i) fshehu krimet e forcave serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë; (ii) nuk mori masa për hetimin dhe ndëshkimin e pjesëtarëve të MPB-së për krimet në Kosovë; dhe (iii) mori pjesë dhe ishte në dijeni të dislokimit dhe angazhimit të njësisë paraushtarake në Kosovë.¹⁶⁶⁸

509. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi gabon kur parashtron se fshehja e krimeve, dislokimi i njësisë paraushtarake në Kosovë dhe moshetimi i krimeve përbëjnë veprime *ex post facto*. Dhoma Gjyqësore konkludoi se: (i) duke filluar nga marsi 1999, anëtarë të lartë të qeverisë së RFJ-së, ndër të cilët Gjorgjeviqi, kishin një plan për fshehjen e krimeve të kryera nga forcat serbe në Kosovë kundër civilëve shqiptarë kosovarë, përmes fshehjes së kufomave;¹⁶⁶⁹ (ii) në kuadër të praktikës së përgjithshme të mosraportimit, moshetimit dhe mosndëshkimit të krimeve të kryera nga forcat serbe në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, Gjorgjeviqi nuk siguroi kryerjen e hetimeve dhe pengoi hetimet që kishin filluar;¹⁶⁷⁰ dhe (iii) Gjorgjeviqi mori pjesë në dislokimin e njësisë paraushtarake në Kosovë duke filluar nga shkurti 1999.¹⁶⁷¹ Dhoma e Apelit i ka lënë në fuqi këto përfundime¹⁶⁷² dhe thekson se veprimet e lartpërshekruara të Gjorgjeviqit ndodhën para dhe/ose gjatë kryerjes së krimeve.¹⁶⁷³ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit më tej thekson se krimet e para për të cilat Gjorgjeviqi u shpall fajtor u kryen më 20 dhe 21 mars 1999,¹⁶⁷⁴ do të thotë pas ose në të njëjtën kohë me veprimet e Gjorgjeviqit ku u bazua Dhoma Gjyqësore kur nxori përfundimin lidhur me synimin e tij. Për këtë arsye, veprimet e Gjorgjeviqit lidhur me fshehjen e krimeve, dislokimin e njësisë

¹⁶⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 262, përmendet Aktgjykimi, para. 1956, 1966, 1993, 2188. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 118-122.

¹⁶⁶⁷ Shih më lart, para. 353, 364, 404, 436-439, 454.

¹⁶⁶⁸ Shih më lart, para. 355-362, 366-371, 378-384, 390, 395-399, 406-409, 413-415, 422-425, 428-431, 443-457.

¹⁶⁶⁹ Shih më lart, para. 372-431. Shih Aktgjykimi, para. 1980-1981, 2116-2117.

¹⁶⁷⁰ Shih më lart, para. 325-350, 434-457. Shih gjithashtu më lart, para. 380-429.

¹⁶⁷¹ Shih më lart, para. 363. Shih gjithashtu më lart, para. 351-371.

¹⁶⁷² Shih më lart, para. 372-431 (fshehje), 325-350, 434-457 (moshetim), 351-371 (dislokim paraushtarakësh).

¹⁶⁷³ Shih më lart, para. 379. Shih Aktgjykimi, para. 2099, 2146. Dhoma Gjyqësore konkludoi se pas zbulimit të kufomave në Tekija dhe zhvendosjes dhe varrosjes së tyre të mëpasshme, 296 shqiptarë kosovarë u vranë nga forcat serbe më 27-28 prill 1999 gjatë operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së me emrin e koduar "Operacioni Reka" (Aktgjykimi, para. 2099). Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se në vend që të hetonin këto vrasje, autoritetet serbe bënë përpjekje të bashkërenduara për fshehjen e krimeve, duke i zhvendosur dhe varrosur fshehtazi kufomat e viktimave (Aktgjykimi, para. 2146, 2163).

¹⁶⁷⁴ Aktgjykimi, para. 1702. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1639. Shih më poshtë, para. 619.

paraushtarake në Kosovë, dhe moshetimin e krimeve nuk ishin *ex post facto*, siç argumenton Gjorgjeviqi. Rrjedhimisht, argumenti i tij lidhur me këtë pikë hidhet poshtë.

510. Për më tepër, për mendimin e Dhomës së Apelit, parashtrimet e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh disa prova lidhur me varrosjen e kufomave dhe hetimin e krimeve janë të pabaza dhe thjesht përsëritje argumentesh të ngritura gjatë gjykimit. Së pari, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore faktikisht shqyrtoi dhe hodhi poshtë dëshminë se Gjorgjeviqi u “befasua” kur e kontaktuan lidhur me zbulimin e kufomave në Serbi.¹⁶⁷⁵ Dhoma e Apelit më tej thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi ishte “pika e parë dhe kryesore e kontaktit”, se ai merrte vendime dhe nxirrte urdhra me nismën e vet lidhur me “mbajtjen në fshehtësi të kufomave, transportimin dhe rivarrosjen e tyre”, dhe se ai “nuk ishte thjesht përçues i urdhrave të ministrit”.¹⁶⁷⁶ Së dyti, lidhur me dëshminë e Gjorgjeviqit se përpjekjet e tij për të kryer hetime u bllokuan nga ministri, Dhoma e Apelit thekson se ndonëse e la të hapur këtë mundësi,¹⁶⁷⁷ Dhoma Gjyqësore megjithatë konkludoi se Gjorgjeviqi i dha shëfit të SPB-së urdhra për varrosjen e kufomave në atë vend, për mosinformimin e mediave dhe për shkatërrimin e kamionit-frigorifer pas heqjes së kufomave, duke e shkelur kështu detyrimin e tij për të kryer hetime.¹⁶⁷⁸ Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto veprime ishin “hapat e para për pamundësimin e kryerjes së hetimit në lidhje me këto kufoma”.¹⁶⁷⁹ Dhoma e Apelit gjykon se ky përfundim është i arsyeshëm.

511. Së fundi, lidhur me dislokimin e njërive paraushtarake në Kosovë, ndër të cilat Akrepat, Dhoma Gjyqësore mori parasysh rolin e drejtpërdrejtë të Gjorgjeviqit në dislokimet, dhe prova të tjera që tregonin se me gjithë dijeninë e tij për krimet e kryera nga pjesëtarë të këtyre njërive, Gjorgjeviqi nuk mori kurrfarë masash për hetimin e tyre, por përkundrazi miratoi ridislokimin e tyre në Kosovë.¹⁶⁸⁰

512. Dhoma e Apelit kujton se synimi kriminal për pjesëmarrje në ndërmarrje të përbashkët kriminale mund të deduktohet nga dijenia si edhe nga vijimësia e pjesëmarrjes.¹⁶⁸¹ Dhoma e Apelit thekson se, kur nxori konkluzionin mbi kontributin e Gjorgjeviqit në NPK, Dhoma

¹⁶⁷⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1301, përmendet Çasllav Golluboviçin, 2 mars 2009, T. 1706-1707, Çasllav Golluboviç, 3 mars 2009, T. 1748-1749.

¹⁶⁷⁶ Aktgjykimi, para. 1969. Shih po ashtu më lart, para. 428.

¹⁶⁷⁷ Aktgjykimi, para. 1970, përmendet Vllastimir Gjorgjeviçin, 7 dhjetor 2009. T. 9723-9724, 9827. Dhoma Gjyqësore theksoi se “ndonëse mbetet e hapur çështja nëse ministri, siç sugjeroi i Akuzuari, e udhëzoi që të fshihte kufomat për t’i pamundësuar NATO-s që t’i përdorte për “qëllime propagandistike” dhe i tha se nuk duhej të merreshin masa të mëtejshme për zbulimin e prejardhjes së kufomave dhe si ishin vlarë, për mendimin e Dhomës kjo nuk e liron të Akuzuarin nga detyrimi i tij për të hetuar këtë incident” (Aktgjykimi, para. 1970). Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 291.

¹⁶⁷⁸ Aktgjykimi, para. 1970.

¹⁶⁷⁹ Aktgjykimi, para. 1970.

¹⁶⁸⁰ Aktgjykimi, para. 1966, 1993, 2155. Shih më lart, para. 353, 358-360.

Gjyqësore u mbështet në përfundimet se: (i) Gjorgjeviqi ishte plotësisht në dijeni të situatës në terren në Kosovë më 1998 dhe 1999, ndër të tjera të krimeve që po kryenin atje forcat serbe;¹⁶⁸² dhe se (ii) sjellja e Gjorgjeviqit në tërësi, siç shtjellohet në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore – duke përfshirë veprimet e tij për fshehjen e krimeve, mosmarrjen e masave hetimore dhe dislokimin e forcave paraushtarake në Kosovë – kontribuuan në NPK.¹⁶⁸³ Duke u bazuar në këto përfundime, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “veproi me synimin e duhur” kur fshehu krimet e forcave serbe, nuk mori masa për hetimin dhe ndëshkimin e pjesëtarëve të MPB-së dhe dislokoi forcave paraushtarake në Kosovë.¹⁶⁸⁴

513. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të deduktonte nga këto përfundime se ai kishte synimin kriminal për NPK.

D. Përfundim

514. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht pikën e dhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.

¹⁶⁸¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajshnik*, para. 697, ku Dhoma e Apelit la në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Krajshnik* lidhur me synimin kriminal të Krajshnikut (Shih Aktgjykimi *Krajshnik*, para. 890).

¹⁶⁸² Aktgjykimi, para. 2154. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1983-1999. Shih më lart, para. 483, 489, 493, 495-496.

¹⁶⁸³ Aktgjykimi, para. 2154-2157. Shih më lart, para. 209, 351, 356, 362, 366-431, 440, 454.

¹⁶⁸⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2158.

XII. PIKA E DYMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PËRKUFIZIMI I TERMIT “CIVIL”

A. Hyrje

515. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe kryen sulme kundër civilëve shqiptarë kosovarë të cilat patën për pasojë krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe krim kundër njerëzimit, si dhe dëbimin dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit.¹⁶⁸⁵ Në lidhje me krimin e vrasjes, Dhoma Gjyqësore konkludoi se pothuajse të gjithë të vrarët ishin të paarmatosur dhe mbaheshin nga forcat serbe.¹⁶⁸⁶ [Dhoma] konkludoi se kishte një “synim të hapët të forcave serbe për të vrarë shqiptarë kosovarë meshku”.¹⁶⁸⁷ Përsa u përket krimeve të dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “shkaku që banorët civilë (nëse nuk ishin vrarë) largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe i bashkoheshin masës së atyre që ishin shpërngulur në mënyrë të ngjashme, ishin sulmet konkrete të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë” dhe se “fushata e forcave serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë” ishte faktori “dominues dhe kryesor” i shpërnguljes së shqiptarëve kosovarë.¹⁶⁸⁸

B. Argumentet e palëve

516. Gjorgjeviqi parashtron se nuk del qartë nga Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore nëse konflikti i armatosur u cilësua konflikt i brendshëm apo ndërkombëtar.¹⁶⁸⁹ Ai argumenton se fakti që Dhoma Gjyqësore u mbështet në Protokollin Shtesë II sugjeron se mori parasysh standardet në lidhje me konfliktet e armatosura të brendshme të zbatueshme për konfliktin midis RFJ-së dhe UÇK-së.¹⁶⁹⁰ Për mendimin e tij, kjo ngre dy çështje parimore.¹⁶⁹¹

517. Fillimisht, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gabimisht konkludoi se pandehma e statusit civil vlen si për konfliktet e armatosura të brendshme, po ashtu për ato ndërkombëtare.¹⁶⁹² Ai argumenton se për shkak të këtij gabimi, Dhoma Gjyqësore zbatoi “një përkufizim tejet të gjerë të fjalës “civil”, sipas të cilit civilë u konsideruan edhe individë që nuk duhej të ishin konsideruar të tillë”.¹⁶⁹³ Ai argumenton se për rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore gabimisht konkludoi se sulmet e forcave serbe synonin popullatën civile, duk e detyruar atë të

¹⁶⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1697, 1701-1704 (dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)), 1753 (vrasje).

¹⁶⁸⁶ Aktgjykimi, para. 1707.

¹⁶⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1707.

¹⁶⁸⁸ Aktgjykimi, para. 1697.

¹⁶⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 305.

¹⁶⁹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 305.

¹⁶⁹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 306.

¹⁶⁹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para 307-309.

largohej.¹⁶⁹⁴ Në këtë mënyrë, sipas tij, Dhoma Gjyqësore ndryshoi kahun e detyrimit të provës dhe pa të drejtë e shpalli fajtor për krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe vrasjes.¹⁶⁹⁵

518. Së dyti, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur gjykoi se një individ konsiderohet pjesëmarrës aktiv në luftime vetëm në qoftë se ka një “rol të vazhdueshëm luftarak”¹⁶⁹⁶ dhe se arsyetimi i Dhomës Gjyqësore “u komprometua nga sugjerimi i saj se në një konflikt të armatosur të brendshëm një individ është i mbrojtur, përveç se kur roli i tij i vazhdueshëm është të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në luftime”.¹⁶⁹⁷ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore i kushtoi “rëndësi të tepruar” veshjeve të viktimave, mirëpo sipas tij, prova të tilla, nuk vërtetojnë domosdoshmërisht se viktimat ishin civilë e jo pjesëtarë të vrarë të UÇK-së.¹⁶⁹⁸ Ai gjithashtu parashtron se kur vlerësoi proporcionalitetin e sulmit, Dhoma Gjyqësore duhej të kishte marrë parasysh faktin se kishte shumë njerëz që ndihmonin UÇK-në, të cilët vetë nuk kishin një “rol të vazhdueshëm luftarak”.¹⁶⁹⁹ Ai pretendon se “nuk është kërkesë realiste” që të bëhet ‘dallim i qartë midis civilëve dhe luftëtarëve në një konflikt me terroristë, rebelë dhe forca jo të rregullta’.¹⁷⁰⁰

519. Gjorgjeviqi parashtron se këto gabime vënë në dyshim “përfundimet se ekzistonte një NPK dhe se sulmi i RFJ-së faktikisht synonte civilët dhe jo objektiva të ligjshme ushtarake”.¹⁷⁰¹

520. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi interpreton gabimisht përfundimet e Dhomës Gjyqësore dhe se parashtrimet e tij përlligjin rrëzim të menjëhershëm.¹⁷⁰² Sipas Prokurorisë, argumentet e Gjorgjeviqit kanë të bëjnë me “vërejtje rreth ligjit” të cilat nuk ishin përcaktuese për përfundimet e Dhomës Gjyqësore.¹⁷⁰³ Prokuroria më tej përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk mori të mirëqenë faktin se personat ishin civilë.¹⁷⁰⁴ Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe as nuk u përpoqën të bënin dallimin midis civilëve dhe pjesëtarëve të

¹⁶⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 308. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 315, 319; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 91-92, 95.

¹⁶⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 308, 316. Ai më tej parashtron se kjo pati për pasojë zbatimin e një standardi tejet të rreptë lidhur me objektivat ushtarake (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 316; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 93, 95).

¹⁶⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 305-307, 316-318; Kundërpërgjigjja e Gjorgjeviqit, para. 92-93.

¹⁶⁹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 310.

¹⁶⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 311.

¹⁶⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 312-313.

¹⁶⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 314; Kundërpërgjigjja e Gjorgjeviqit, para. 93-94.

¹⁷⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 312.

¹⁷⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 315.

¹⁷⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 275, 291.

¹⁷⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 276-277, 284. Prokuroria më tej pretendon se pandehma e statusit civil të personave duhet të vlejë edhe për konfliktet e armatosura jondërkombëtare (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 281-282).

¹⁷⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 280.

UÇK-së,¹⁷⁰⁵ dhe me të drejtë u kushtoi rëndësi provave rreth veshjeve të viktimave kur përcaktoi statusin e tyre si civilë.¹⁷⁰⁶

C. Analizë

521. Dhoma e Apelit vëren se megjithëse Dhoma Gjyqësore konkludoi se në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur midis UÇK-së dhe forcave serbe, ajo nuk përcaktoi qartë karakterin e këtij konflikti të armatosur.¹⁷⁰⁷ Nga ana tjetër, konfliktin midis RFJ-së dhe NATO-s shprehimisht e cilësoi ndërkombëtar.¹⁷⁰⁸ Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore zbatoi ligjin mbi konfliktet e armatosura të brendshme¹⁷⁰⁹ dhe veçazi konkludoi se “UÇK-ja zotëronte veçori të mjaftueshme të një force të armatosur të organizuar, e aftë të merrte pjesë në një konflikt të armatosur të brendshëm”.¹⁷¹⁰ Dhoma e Apelit kujton se një konflikt i armatosur i brendshëm mund të ekzistojë njëkohësisht me një konflikt të armatosur ndërkombëtar,¹⁷¹¹ dhe është e bindur se për këtë arsye konfliktin midis UÇK-së dhe forcave serbe Dhoma Gjyqësore e konsideroi konflikt të armatosur të brendshëm.¹⁷¹²

522. Dhoma e Apelit do të shqyrtojë pretendimin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore përkufizoi dhe zbatoi gabimisht statusin civil të individëve në një konflikt të armatosur të brendshëm. Gjorgjeviqi argumenton se Dhoma Gjyqësore ndryshoi kahun e detyrimit të provës kur gjykoi se pandehma e statusit civil të një individi, kodifikuar në Nenin 50(1) të Protokollit Shtesë I, vlen gjithashtu edhe në konfliktet e armatosura të brendshme, ndonëse Neni 13 i Protokollit Shtesë II nuk përmban të njëjtin tekst.¹⁷¹³ Dhoma e Apelit kujton se parimi i kodifikuar në Nenin 50(1) të Protokollit Shtesë I, se në rast dyshimi se një person mund të jetë civil, ai duhet konsideruar civil, vlen vetëm për *veprimin* që pritet të bëjë një ushtarak.¹⁷¹⁴ Nga ana tjetër, kur është fjala për *përgjegjësinë penale* të një të akuzuari, detyrimi i provës lidhur me statusin civil të viktimave i takon Prokurorisë.¹⁷¹⁵ Në parashtrimet e tij, Gjorgjeviqi nuk bën dallimin midis këtyre dy standardeve të ndryshme dhe për pasojë interpreton gabimisht dy kategori të ndryshme përfundimesh të Dhomës Gjyqësore: (i) përfundimet lidhur me përdorimin e forcës së tepruar prej forcave serbe si tregues i

¹⁷⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 279-280.

¹⁷⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 290.

¹⁷⁰⁷ Aktgjykimi, para. 1578-1579.

¹⁷⁰⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1580.

¹⁷⁰⁹ Shih Aktgjykimi, para. 1530, 2066.

¹⁷¹⁰ Aktgjykimi, para. 1578.

¹⁷¹¹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 84.

¹⁷¹² Krahaso Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 23.

¹⁷¹³ Aktgjykimi, para. 2066, sh. 7110.

¹⁷¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 48, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 111. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 60.

¹⁷¹⁵ Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 60; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 48, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 111.

ekzistencës së NPK-së¹⁷¹⁶ dhe (ii) përfundimet lidhur me kryerjen e krimeve prej këtyre forcave.¹⁷¹⁷ Kur analizoi kategorinë e parë të përfundimeve dhe përcaktoi nëse përdorimi i forcës së tepruar nga MPB-ja dhe UJ-ja ishte “një tregues i mëtejshëm se qëllimi i operacioneve ishte të vazhdoheshin krimet e provuara”,¹⁷¹⁸ Dhoma Gjyqësore theksoi se në një konflikt të armatosur të brendshëm, në rast dyshimi lidhur me statusin e një individi, ai duhet konsideruar se është civil.¹⁷¹⁹ Dhoma gjykoi se në bazë të këtij parimi, më së paku forcat sulmuese bëjnë një vlerësim për të përcaktuar nëse ekziston një dyshim në lidhje me statusin e objektivit që sulmohet.¹⁷²⁰ [Dhoma Gjyqësore] më pas konkludoi se shkalla e forcës së tepruar të përdorur nga forcat serbe tregoi se nuk ishte bërë asnjë vlerësim i tillë.¹⁷²¹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nuk e liroi Prokurorinë nga detyrimi i vërtetimit se viktimat ishin civilë apo persona të mbrojtur sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare, dhe nuk zbatoi një “përkufizim tejet të gjerë” të fjalës “civil”.¹⁷²² Dhoma e Apelit në vijim do të shqyrtojë nëse Dhoma Gjyqësore zbatoi drejtë standardin e detyrimit të provës kur konkludoi se forcat serbe kryen krimet e vrasjes, dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).

523. Lidhur me krimin e vrasjes, Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës vlen për konfliktet e armatosura të brendshme dhe garanton mbrojtjen e personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime.¹⁷²³ Dhoma e Apelit kujton se persona që nuk marrin pjesë aktive në luftime konsiderohen edhe personat e zënë rob¹⁷²⁴ dhe se “jurisprudenca e deritanishme e Tribunalit vazhdimisht ka theksuar se vetë Konventat e Gjenevës nuk mund të interpretohen në një mënyrë që ofron më pak mbrojtje për personat nga ajo e garantuar në Nenin e Përbashkët 3”.¹⁷²⁵ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore analizoi me hollësi rrethanat e vrasjeve dhe mori parasysh faktorë të ndryshëm në nxjerrjen e përfundimeve se shumica e viktimave ishin zënë rob, ishin të paarmatosur ose ndryshe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes së tyre.¹⁷²⁶ Rrjedhimisht,

¹⁷¹⁶ Aktgjykimi, para. 2064-2069.

¹⁷¹⁷ Aktgjykimi, para. 1707.

¹⁷¹⁸ Aktgjykimi, para. 2069.

¹⁷¹⁹ Aktgjykimi, para. 2066, sh. 7110.

¹⁷²⁰ Aktgjykimi, para. 2066.

¹⁷²¹ Aktgjykimi, para. 2066.

¹⁷²² Shih më poshtë, para. 523-526.

¹⁷²³ Aktgjykimi, para. 1530.

¹⁷²⁴ Neni i Përbashkët 3(1) i Konventave të Gjenevës.

¹⁷²⁵ *Prokurori k. Radovan Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5/18-AR72.5, Vendim mbi Apelin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Mocionin Paraprak për Heqjen e Pikës 11 të Aktakuzës, 9 korrik 2009, para. 23.

¹⁷²⁶ Dhoma e Apelit gjykon se pretendimi i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore bëri gabim lidhur me disa vende konkrete krimesh nuk mbështetet nga provat (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 318). Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se personat ishin zënë rob, ose ndryshe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes së tyre: Dhoma Gjyqësore konkludoi se në Bellacërkë, më 25 mars 1999, forcat e MPB-së vranë 13 shqiptarë kosovarë, ndër të cilët tri gra dhe shtatë fëmijë, të cilët po përpiqeshin të iknin nga forcat e MPB-së. Një djalë dyvjeçar ishte i vetmi që i mbijetoi ekzekutimit (Aktgjykimi, para. 464-466, 1393-1394, 1710). Pasi analizoi tërësinë e provave, Dhoma Gjyqësore konkludoi se këta persona nuk merrnin pjesë aktive në luftime (Aktgjykimi,

Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatës Tuzmukhamedovit, gjykon se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se viktimat kishin status të personave të mbrojtur bazuar në Nenin e Përbashkët 3(1) dhe Nenin 13(2) të Protokollit Shtesë II. Për këtë arsye, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nxori këtë përfundim.

524. Dhoma e Apelit gjithashtu është bindur se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se forcat serbe kryen krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme). Dhoma e Apelit e gjykon të arsyeshëm përfundimin e Dhomës Gjyqësore se nuk kishte prova që tregonin se granatimet, hapja e zjarrit dhe djegiet e shtëpive nga ana e forcave serbe synonin objektiva ushtarake. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe sulmuan qëllimisht persona të mbrojtur.¹⁷²⁷ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk

para. 465). Gjithashtu, nga fundi i marsit 1999, në një kanal në afërsi të urës së Belajës u gjetën gjashtë kufoma meshkujsh shqiptarë kosovarë. Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte prova që tregonin se këta gjashtë burra ishin të armatosur në kohën kur u hap zjarr kundër tyre, apo se ata merrnin pjesë aktive në luftime, ose se ishin anëtarë të UÇK-së. [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se ata u vranë nga forcat serbe, të cilat pak më parë kishin vranë burrat e ndaluar shqiptarë kosovarë tek ura e Belajës dhe lumi (Aktgjykimi, para. 468, 473, 1712). Lidhur me Krushën e Vogël, shih përfundimin e Dhomës së Apelit më poshtë në Aktgjykim (më poshtë, para. 662-667). Në Mejë, në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore përcaktoi statusin civil dhe rrethanat individuale të 281 viktimave vranë gjatë Operacionit Reka më 27 dhe 28 prill 1999, dhe konkludoi se forcat serbe ndanë nga kolona grupe burrash shqiptarë kosovarë, të cilët më pas i vranë, dhe se nuk kishte prova që tregonin se këta burra ishin të armatosur apo merrnin pjesë aktive në luftime në atë kohë, apo se asokohe kishte luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së në atë zonë, (Aktgjykimi, para. 962-963, 1739). Po ashtu, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte prova se Kolë Duzhmani ishte pjesëtar i UÇK-së në kohën kur u vra gjatë Operacionit Reka. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në momentin e vrasjes, ai ishte në duar të forcave serbe (Aktgjykimi, para. 1737). Lidhur me komunën e Vushtrrisë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se natën midis 2 dhe 3 majit 1999, forcat serbe vranë katër burra shqiptarë kosovarë të zënë rob (Aktgjykimi, para. 1187, 1742). Dhoma Gjyqësore gjykoj se në Kotlinë, më 24 mars 1999, forcat serbe arrestuan dhe vranë jo më pak se 22 burra shqiptarë të paarmatosur. Këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore e mbështeti në dëshminë e dëshmitarit okular Hazbi Loku, pasi shqyrtoi me kujdes besueshmërinë e tij dhe dëshminë se burrat “i detyruan të shkonin te pusët për t’i rrahur dhe pastaj për t’i hedhur brenda përpara se të aktivizonin lëndët shpërthyesë” (Aktgjykimi, para. 1125, 1431, 1744). Në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, përfundimin se më 13 prill 1999, në Sllatinë dhe Vataj, ushtarë të UJ-së kapën katër fshatarë shqiptarë kosovarë dhe më pas i vranë, Dhoma Gjyqësore e mbështeti jo vetëm në dëshminë dytësore të Sada Lamës. Faktikisht, [Dhoma Gjyqësore] konkludoi çfarë kishte dëgjuar [dëshmitari] u konfirmua nga: vendi ku u gjetën katër kufomat; fakti se dy prej tyre ishin gjymtuar; dhe fakti se katër burrat ishin me veshje civile dhe të paarmatosur. (Aktgjykimi, para. 1138, 1747).

¹⁷²⁷ Për shembull, lidhur me Bellacërkën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat e MPB-së dhe UJ-së ishin shkaku i largimit të fshatarëve shqiptarë kosovarë, se burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët, dhe se 65 prej këtyre burrave u vranë (Aktgjykimi, para. 1617-1618). Në lidhje me Krushën e Vogël, Dhoma Gjyqësore konkludoi se 400-500 banorë shqiptarë kosovarë u zhvendosën me dhunë më 25 mars 1999 pas granatimit të fshatit, plaçkitjes dhe djegies së shtëpive dhe vrasjes së burrave të fshatit (Aktgjykimi, para. 482-483, 1619-1620). Në lidhje me ngjarjet në Krushë të Madhe, një fshat shumë afër Krushës së Vogël, Dhoma Gjyqësore konkludoi se rreth 3.000-4.000 banorë u larguan nga fshati për shkak të pranisë gjithnjë e më të madhe dhe kërcënuesë të forcave serbe rreth fshatit; më pas forcat serbe dogjën shtëpi dhe shkatërruan xhaminë (Aktgjykimi, para. 503-506, 1622). Dhoma e Apelit vëren se në paragrafin 1622 të Aktgjykimit shkruhet “Krusha e Vogël” në vend të “Krusha e Madhe”. Gjithsesi, në bazë të fakteve të përshkruara në paragraf, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore aty shtjellon ngjarjet që ndodhën në Krushë të Madhe. Lidhur me Celinën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe granatuan fshatin, vranë banorë të fshatit, dogjën shtëpi dhe i zhvendosën me dhunë banorët shqiptarë kosovarë të fshatit më 25 mars 1999 (Aktgjykimi, para. 517-522, 1623). Dhoma Gjyqësore konkludoi shprehimisht se granatimi nuk synonte objektiva ushtarake (Aktgjykimi, para. 533, 1623) dhe se viktimat nuk kishin armë dhe nuk merrnin pjesë në luftime (Aktgjykimi, para. 522). Lidhur me Landovicën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se UJ-ja granatoi dhe dogji fshatin më 26 mars 1999, gjë që i detyroi banorët të largoheshin nga fshati. Njëmbëdhjetë nga trembëdhjetë fshatarët që u vranë ishin gra e fëmijë (Aktgjykimi, para. 588-594, 1628). Lidhur me Leçinën, Burojën dhe Izbicën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fund të marsit 1999, shqiptarët kosovarë u zhvendosën me dhunë, pasi forcat serbe zunë pozicione në Burojë dhe granatuan Leçinën

kishte prani të UÇK-së në zonat ku u kryen disa prej krimeve.¹⁷²⁸ Për më tepër, në rastet kur u vërtetua se kishte prani dhe veprimtari të UÇK-së në një zonë, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes nëse sulmet e forcave serbe kundër UÇK-së ishin të ligjshme.¹⁷²⁹ Gjorgjeviqi thjesht përmend granatime qytetesh dhe fshatrash, por nuk jep ndonjë shembull konkret të zbatimit të një përkufizimi “tejet të gjerë” të fjalës ‘civil’.¹⁷³⁰ Duke marrë parasysh provat e shumta për shpërnguljen e njerëzve nga qytete dhe fshatra të tëra, praktikën e përsëritur të sulmeve, dhe natyrën e bashkënduar të veprimeve të forcave serbe, Dhoma e Apelit konkludon se

dhe Izbicën, dhe se nuk kishte prova se granatimi synonte objektiva ushtarake. Forcat serbe gjithashtu dogjën shtëpi edhe rrugës, dhe gratë dhe fëmijët u urdhëruan që të largoheshin nga fshatrat e tyre dhe të shkonin për në Shqipëri (Aktgjykimi, para. 607, 1630-1631). Lidhur me Klladërnicën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se midis 10.000 dhe 12.000 shqiptarë kosovarë, kryesisht gra e fëmijë, i ikën granatimit të fshatit më 12 prill 1999. Forcat serbe ndanë 300-400 burra, dhe të tjerët i urdhëruan që të shkonin për në Shqipëri (Aktgjykimi, para. 647, 1634). Lidhur me Turiqecin dhe Tushilën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nga fundi i marsit/fillimi i prillit 1999, banorët shqiptarë kosovarë u larguan nga këto fshatra për shkak të veprimeve të forcave serbe; se ata u shoqëruan nga policia dhe se burrat u ndanë veç për t'u marrë në pyetje (Aktgjykimi, para. 635-639, 1632-1633), disa prej tyre u liruan, disa të tjerë u vranë (Aktgjykimi, para. 639). Lidhur me ngjarjet në Peqan, Dhoma Gjyqësore gjykoi konkretisht se pavarësisht se pothuajse çdo shtëpi kishte ndonjë anëtar të familjes në UÇK dhe se UÇK-ja vepronte në atë zonë, shpërnguljen e shkaktuan forcat serbe me granatimet e tyre, dhe këto granatime nuk synonin objektiva ushtarake (Aktgjykimi, para. 704-706, 1639). Lidhur me Bellanicën, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në këtë fshat, forcat serbe vranë tre burra më 1 prill 1999; u vunë zjarrin shtëpive; kërcënuan njerëzit; dhe vranë bagëtinë (Aktgjykimi, para. 715, 1641); Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se UÇK-ja ishte tërhequr nga kjo zonë (Aktgjykimi, para. 712), se fshatarët provuan t'u dorëzoheshin forcave serbe, dhe se forcat serbe drejtuan kolonën për në kufi me Shqipërinë (Aktgjykimi, para. 714, 716, 718, 1641). Lidhur me ngjarjet në Zhabar, Dhoma Gjyqësore theksoi se me mijëra banorë shqiptarë kosovarë u dëbuan më 17 prill 1999 pasi forcat serbe hapën zjarr me mitraloza, dhe se MPB-ja urdhëroi konkretisht popullatën që të largohej (Aktgjykimi, para. 1647-1648). Lidhur me ngjarjet në Lladovë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se banorë shqiptarë kosovarë u zhvendosën me dhunë pasi ishin larguar nga fshati për shkak të pranisë së ushtrisë serbe në afërsi; se fshatarët që provuan të ktheheshin në fshat – përfshirë edhe një grua – u vranë nga forcat serbe; dhe se ata fshatarë që nuk kishin ikur, u urdhëruan nga UJ-ja të largoheshin nga fshati, gjë që ata e bënë (Aktgjykimi, para. 1661). Lidhur me ngjarjet në Nosalë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në prill 1999, fshatarët shqiptarë kosovarë u sulmuan dhe u zhvendosën me dhunë nga forcat serbe (Aktgjykimi, para. 1662). Në Mirosalë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fillim të prillit 1999, 4.000 shqiptarë kosovarë u dëbuan nga forcat serbe, nga frika që kishin shkaktuar veprimet e forcave serbe në fshat dhe në fshatrat përreth (Aktgjykimi, para. 1667). Në Kotlinë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 24 mars 1999, granatimet e forcave serbe i detyruan burrat të iknin, kurse gratë, fëmijët dhe pleqtë u detyruan të hipnin në kamionë ushtarakë dhe u çuan në qytetin e Kaçanikut. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe hodhën në erë 22 burra të hedhur në puse të minuara. Nga frika, 48 fshatarët e mbetur u larguan nga fshati. Për më tepër, forcat serbe u dhanë grave dhe fëmijëve urdhra konkretë për t'u larguar (Aktgjykimi, para. 1669). Lidhur me Kaçanikun, Dhoma Gjyqësore gjykoi se më 27 dhe 28 mars 1999, banorët shqiptarë kosovarë u detyruan të largoheshin nga qyteti për shkak të granatimeve dhe krismave nga forcat serbe, dhe në këtë mënyrë u dëbuan. Nuk kishte prova se dikush iu përgjigj zjarrit. Një grua shtatzënë vdiq pasi u godit me plumb teksa ecte në oborrin e shtëpisë së saj (Aktgjykimi, para. 1127-1130, 1670). Lidhur me Studimen e Poshtme, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fund të marsit 1999, fshatarët shqiptarë kosovarë u larguan nga fshati për shkak të granatimeve të forcave serbe, se policia serbe u tha banorëve që kishin mbetur në fshat se kishin 15 minuta për t'u larguar, dhe se të shtënat ishin të drejtuara kundër shtëpive civile (Aktgjykimi, para. 1676).

¹⁷²⁸ Lidhur me Krushën e Madhe, Dhoma Gjyqësore konkludoi se 3.000-4.000 shqiptarë kosovarë u zhvendosën me dhunë më 25 mars 1999 (Aktgjykimi, para. 1622). Në Piranë, Dhoma Gjyqësore gjykoi se 2.700 shqiptarë kosovarë u zhvendosën me dhunë më 25 mars 1999 (Aktgjykimi, para. 582-586, 1628). Në Peqan, Dhoma Gjyqësore konkludoi se banorët shqiptarë kosovarë të këtij fshati u shpërngulën në mars 1999 (Aktgjykimi, para. 704-707, 1639). Në Vataj, Dhoma Gjyqësore konkludoi se banorët shqiptarë kosovarë të këtij fshati u dëbuan në prill 1999 (Aktgjykimi, para. 1671).

¹⁷²⁹ Në lidhje me praninë e forcave serbe në Vesekoc dhe granatimin prej tyre të fshatit Sllakoc më 1 maj 1999, Dhoma Gjyqësore konkludoi se një ditë më pas, një kolonë me jo më pak se 30.000 shqiptarë kosovarë u nis për në Vushtrri dhe u granatua nga serbët. Menjëherë më pas, forcat serbe e urdhëruan kolonën që të shkonte në kooperativën bujqësore në qytetin e Vushtrrisë. Dhoma Gjyqësore pranoi se UÇK-ja, e cila ishte e pranishme në atë zonë, u kishte thënë fshatarëve se nuk mund t'i mbronte më, por konkludoi se ishin forcat serbe ato që kishin urdhëruar kolonën që të shkonte në qytetin e Vushtrrisë, se ato granatuan kolonën dhe vranë disa burra (Aktgjykimi, para. 1677).

¹⁷³⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 316.

Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se objektivi i forcave serbe ishin civilët shqiptarë kosovarë, se sulmet e tyre ishin arsyeja “kryesore dhe bindëse” e largimit të civilëve dhe patën për pasojë krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).¹⁷³¹

525. Dhoma e Apelit e konsideron jobindës edhe argumentin e Gjorgjeviqit se vlerësimi i Dhomës Gjyqësore lidhur me “objektivin e sulmit” u “komprometua” nga nocioni i rolit të vazhdueshëm luftarak.¹⁷³² Ai pretendon se duke zbatuar këtë nocion, Dhoma Gjyqësore gabimisht i kushtoi rëndësi veshjes civile për të përcaktuar nëse një individ ishte civil.¹⁷³³ Sidoqoftë, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me të drejtë mori parasysh faktorë të shumtë, ndër të cilët veshjen civile, kur konkludoi se personat e vrarë nuk kishin rol luftarak në kohën e vdekjes së tyre.¹⁷³⁴ Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte as se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh “numrin e madh të njerëzve që luftuan për UÇK-në ose e ndihmuan atë, por që vetë nuk kishin rol të vazhdueshëm luftarak”.¹⁷³⁵ Në kundërshtim me këtë pretendim të

¹⁷³¹ Shih më lart, para. 173-176, 194-207.

¹⁷³² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 310-311.

¹⁷³³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 312-313.

¹⁷³⁴ Shih më lart, para. 522-523. Dhoma e Apelit më herët ka gjykuar se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur u mbështet në rrobat e një viktime për të përcaktuar se ai nuk kishte marrë pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes së tij (Shih Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 81) (“Dhoma e Apelit gjykon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se Rami Jusufi ishte ‘civil i paarmatosur’ që nuk merrte pjesë në luftime në kohën e vdekjes së tij u bazua në vlerësimin dhe analizën e kujdesshme të provave. Dhoma Gjyqësore shpjegoi [...] arsyet se pse u mbështet në disa pjesë të provave [...], dhe konkludoi, ndër të tjera, se Rami Jusufi ishte i veshur me rroba civile në kohën e vdekjes së tij” (pa citimet). Gjorgjeviqi gjithashtu nuk vërteton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur mori parasysh provat konkrete lidhur me komunat në vijim: Sllatinë: Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 13 prill 1999, ushtarë të UJ-së kapën dhe vranë Mahmut Cakën, Hebib Lamin, Brahim Lamin dhe Rraman Lamin; se dy nga kufomat ishin gjymtuar; dhe se ata ishin të paarmatosur (Aktgjykimi, para. 1138, 1747). Izbicë: Dhoma Gjyqësore konkludoi se provat mjekoligjore konfirmuan se viktimat që u vranë më 28 mars 1999 dhe u zhvarrosën në Qendrën e PJP-së në Petrovo Selo, kishin qenë në duar të forcave serbe në kohën e vdekjes së tyre (Aktgjykimi, para. 627, 633-634, 1727). Mejë dhe Korenicë: Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte prova që tregonin se personat që u vranë më 27-28 prill 1999 ishin të armatosur në atë kohë, apo se merrnin pjesë aktive në luftime, apo se kishte luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së (Aktgjykimi, para. 990-991, 1738-1739). U konkludua se katër civilët që u vranë gjatë Operacionit Reka në një fshat në afërsi të Ramocit kishin qenë të zënë rob nga forcat serbe (Aktgjykimi, para. 976, 992, 1738-1739). Tërnje: Dhoma Gjyqësore konkludoi se viktimat nuk ishin të armatosur apo pjesëmarrës në luftime kur u vranë në mars të vitit 1999 (Aktgjykimi, para. 708-709). Bellacërkë: Dhoma Gjyqësore konkludoi se rreth 40 persona të paarmatosur u vranë te Ura e Belasë në fund të marsit 1999 (Aktgjykimi, para. 472, 527, 1711). Reçak: Dhoma Gjyqësore konkludoi se rreth 20-24 nga 45 viktimat dukej se ishin qëlluar nga afër më 15 janar 1999; se një viktime i kishin prerë kokën; dhe se ndër viktimat kishte gra dhe një fëmijë (Aktgjykimi, para. 416, 1920). Lumi Danub: Dhoma Gjyqësore konkludoi se shumë prej kufomave që u gjetën në një kamion që pluskonte në Danub kishin shenja goditjesh me mjete jo të mprehta dhe me mjete të mprehta të mëdha; se duart e një kufome ishin të lidhura; dhe se midis kufomave kishte 10 gra dhe dy fëmijë (Aktgjykimi, para. 1300, 1305, 1311). Suharekë: Dhoma Gjyqësore konkludoi se në momentin kur e vranë, Jashar Berisha ishte i paarmatosur dhe në duar të forcave serbe (Aktgjykimi, para. 678, 683, 1720, 1723). Për më tepër, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 313, sh. 532), Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli atë fajtor për vrasjen e viktimave të mëposhtme, lidhur me të cilat u konkludua se ishin me rroba civile në kohën kur u vranë: Milaim Loku dhe Emërllah Kuçi (Aktgjykimi, para. 1111, 2096; Aktgjykimi, Shtojca H). Gjithashtu, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e: (i) viktimave në komunën e Prizrenit (Aktgjykimi, para. 1268, 1270, 1705); (ii) personave, kufomat e të cilëve u zhvarrosën nga Dëshmitari K72, në komunën e Gjakovës (Aktgjykimi, para. 1277-1278, 1281-1282, 1285); (iii) personave që u varrosën në dy varre të përbashkëta në Qendrën e PJP-së në Petrovo Selo në prill 1999 (Aktgjykimi, para. 1353, 1355, 1507, 1730-1741, 1753); (iv) personave që u vranë në Celinë (Aktgjykimi, para. 532, 1705); dhe (v) personave që u gjetën të vdekur në një kamion në zonën e Rahovecit (Aktgjykimi, para. 553, 1705, 1714-1719, 1753).

¹⁷³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 314.

Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore faktikisht pranoi se në radhët e UÇK-së kishte si pjesëtarë të përhershëm, po ashtu përkrahës të tjerë,¹⁷³⁶ por konkludoi se shumica dërrmuese e krimeve u kryen në situata ku kishte pak, ose aspak veprimtari të UÇK-së.¹⁷³⁷ Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se vështirësitë në dallimin e të dyshuarve si pjesëtarë të UÇK-së nga civilët, nuk arritën të shpjegonin shpërnguljen e dhunshme dhe dëbimin e fshatrave të tëra me shqiptarë kosovarë.¹⁷³⁸ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nuk bëri gabim në përcaktimin e statusit të mbrojtur të individëve dhe nuk vlerësoi gabimisht proporcionalitetin e sulmeve.¹⁷³⁹

526. Së fundi, Dhoma e Apelit e konsideron jobindës argumentin e Gjorgjeviqit se përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me përkufizimin e fjalës civil “vënë në dyshim konkluzionin se ekzistonte një NPK”.¹⁷⁴⁰ Siç është përsëritur më lart, Dhoma e Apelit gjykoi se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi një përkufizim tejet të gjerë të fjalës “civil”. Rrjedhimisht, [Dhoma Gjyqësore] nuk gaboi kur përcaktoi se viktimat kishin status të personave të mbrojtur dhe vlerësoi drejt proporcionalitetin e sulmeve.¹⁷⁴¹ Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore gjykon se Gjorgjeviqi nuk identifikoi asnjë gabim konkret lidhur me NPK-në dhe rrjedhimisht hedh poshtë argumentin e tij.

D. Përfundim

527. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit rrëzon pikën e dymbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.

XIII. PIKA E TREMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIM LIDHUR ME KRIMIN E DËBIMIT

A. Hyrje

528. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimet e dëbimit (Pika 1) dhe përndjekjes nëpërmjet dëbimit (Pika 5), si krime kundër njerëzimit.¹⁷⁴² Dhoma Gjyqësore konkludoi se midis 24 marsit dhe 20 qershorit 1999, të paktën 200.000 shqiptarë kosovarë u dëbuan nga shumë qytete dhe fshatra të Kosovës për në Shqipëri, IRJM dhe Mal të Zi.¹⁷⁴³ Kur nxori këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore ndër të tjera gjykoi se shpërngulja e shqiptarëve

¹⁷³⁶ Aktgjykimi, para. 2058, përmendet Aktgjykimi, para. 1539-1540. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2059-2061.

¹⁷³⁷ Aktgjykimi, para. 2065.

¹⁷³⁸ Aktgjykimi, para. 2067.

¹⁷³⁹ Shih gjithashtu më lart, para. 93, 97-99, 102, 107-109.

¹⁷⁴⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 315.

¹⁷⁴¹ Shih më lart, para. 522-525.

¹⁷⁴² Aktgjykimi, para. 1700-1701, 1704, 2193-2194, 2230.

¹⁷⁴³ Aktgjykimi, para. 1700.

kosovarë nga Peja më 27 dhe 28 mars 1999,¹⁷⁴⁴ dhe nga Mitrovica më 4 prill 1999,¹⁷⁴⁵ për në Mal të Zi, përbënte shpërngulje përtej kufirit *de facto* dhe rrjedhimisht plotësonte kushtet e dëbimit.¹⁷⁴⁶ Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoi se edhe shumë njerëz të tjerë që nuk e kaluan kufirin *de facto*, ishin viktimat të veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), dhe se këto veprime ishin po aq të rënda sa edhe veprimet e dëbimit.¹⁷⁴⁷

B. Argumentet e palëve

529. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se personat që u shpërngulën nga Kosova për në Mal të Zi kaluan përtej një kufiri *de facto*, që është kusht për vërtetimin e krimit të dëbimit.¹⁷⁴⁸ Ai argumenton se krimi i dëbimit realizohet vetëm në rastet kur personat shpërngulen me dhunë në një shtet tjetër apo territor të pushtuar,¹⁷⁴⁹ dhe kundërshton deklaratën e Dhomës Gjyqësore se “jurisprudenca e Tribunalit ka konkluduar bindshëm se vepra penale e dëbimit mund të provohet nëse shpërngulja realizohet përtej një kufiri *de facto*”.¹⁷⁵⁰ Gjorgjeviqi parashtron se thelbi i krimit të dëbimit qëndron në zhvendosjen e dhunshme të personave në territorin e një shteti tjetër, dhe se në çështjen aktuale, RFJ-ja thjesht lëvizi njerëzit brenda kufijve të saj.¹⁷⁵¹ Ai më tej pretendon se Dhoma Gjyqësore: (i) gaboi që mori parasysh disa faktorë kur konkludoi se ekzistonte një kufi *de facto*, ndër të cilët vështirësitë e mëdha dhe lehtësinë e kontrollit mbi Kosovën;¹⁷⁵² (ii) nuk mori parasysh faktin që RFJ-ja, e cila përbëhej nga Republika e Serbisë dhe e Malit të Zi, ishte vend sovran;¹⁷⁵³ dhe (iii) zbatoi gabimisht ligjin kur konkludoi se krimi i dëbimit mund të provohet nëse shpërngulja realizohet përtej një kufiri *de facto*.¹⁷⁵⁴ Gjorgjeviqi parashtron se ky gabim i Dhomës Gjyqësore përlligj shfuqizimin e verdiktit të fajësisë për krimin e dëbimit (Pika 1) dhe krimin e përndjekjes (Pika 5) lidhur me shpërnguljet nga Kosova për në Mal të Zi.¹⁷⁵⁵

530. Prokuroria përgjigjet se shpërngulja e dhunshme e civilëve nga Kosova për në Mal të Zi përbën dëbim.¹⁷⁵⁶ Parashtrrohet se përfundimet faktike të Dhomës Gjyqësore mbështesin përfundimin e saj se kufiri midis Kosovës dhe Malit të Zi ishte kufi *de facto* dhe rrjedhimisht

¹⁷⁴⁴ Aktgjykimi, para. 1642, 1701.

¹⁷⁴⁵ Aktgjykimi, para. 1646, 1701.

¹⁷⁴⁶ Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁴⁷ Aktgjykimi, para. 1702-1703.

¹⁷⁴⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 320-328.

¹⁷⁴⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 321; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 95-97, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 300.

¹⁷⁵⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 322, citon Aktgjykimin, para. 1683.

¹⁷⁵¹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 97, 99. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 328; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 97, 99; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 95, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 300.

¹⁷⁵² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 326.

¹⁷⁵³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 324-326; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 97; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 97-98.

¹⁷⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 322. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 320-321, 327.

¹⁷⁵⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 328.

plotësonte kushtin e dëbimit.¹⁷⁵⁷ Prokuroria argumenton se megjithëse Kuvendi i Serbisë zyrtarisht shfuqizoi statusin e Kosovës si krahinë autonome më 1990 dhe Kosova nuk u njoh ndërkombëtarisht si vend sovran, ajo mbeti një krahinë autonome *de facto* gjatë viteve ‘90.¹⁷⁵⁸ Prokuroria më tej argumenton se të njëjtat veprime bazë përbëjnë gjithashtu krime të veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe të përndjekjes.¹⁷⁵⁹ Rrjedhimisht, [Prokuroria] parashtron se ndryshe, në qoftë se do të miratojë pikën e apelit të Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit duhet të shpallë fajësi për krimet e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe përndjekjes.¹⁷⁶⁰ Për më tepër, Prokuroria thekson se lidhur me krimin e përndjekjes, nuk është me rëndësi nëse veprimi bazë përbën dëbim apo zhvendosje të dhunshme, përderisa është kryer me synimin e nevojshëm diskriminues, i cili u vërtetua në këtë çështje.¹⁷⁶¹

531. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se lidhur me shpërnguljen e popullsisë nga Kosova për në Mal të Zi në Aktakuzë nuk u pretenduan as krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), e as krimi i përndjekjes.¹⁷⁶² Për këtë arsye, ai parashtron se nuk duhet të shpallet fajtor për këto krime.¹⁷⁶³

C. Analizë

532. Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se në rrethana të caktuara, krimi i dëbimit mund të vërtetohet nëse shpërngulja realizohet përtej një kufiri *de facto*.¹⁷⁶⁴ Dhoma e Apelit në çështjen *Stakiq* gjykoi se “çështja nëse një kufi *de facto* është i mjaftueshëm për qëllimet e krimit të dëbimit duhet të shqyrtohet rast pas rasti në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare”.¹⁷⁶⁵

533. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore njohu sovranitetin territorial të RFJ-së dhe mungesën e një kufiri *de jure* midis Malit të Zi dhe Kosovës.¹⁷⁶⁶ Kur konkludoi se midis Malit të Zi dhe Kosovës ekzistonte një kufi *de facto*, Dhoma Gjyqësore mori parasysh: (i) shkallën e autonomisë së Kosovës; (ii) statusin e Malit të Zi si republikë në kuadër të RFJ-së; dhe (iii) ekzistencën e “një konflikti të armatosur midis forcave të RFJ-së dhe Serbisë, nga njëra anë,

¹⁷⁵⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 292, 294.

¹⁷⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 295, përmendet Aktgjykimi, para. 21-30. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 293-294.

¹⁷⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 295.

¹⁷⁵⁹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 134.

¹⁷⁶⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 133-134, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 321.

¹⁷⁶¹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 134, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 154.

¹⁷⁶² Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 169-170.

¹⁷⁶³ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 169-170.

¹⁷⁶⁴ Aktgjykimi, para. 1604, citohet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 278, 288-303, Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 304.

¹⁷⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 300. Shih Aktgjykimi, para. 1604.

¹⁷⁶⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1683.

dhe UÇK-së nga ana tjetër”.¹⁷⁶⁷ Dhoma Gjyqësore gjithashtu gjykoi se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë nga Kosova në Mal të Zi do të shkaktonte “vështirësi serioze” sikurse edhe shpërngulja përtej kufijve shtetërorë, dhe se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë jashtë Kosovës e bënte më të lehtë kontrollin e krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë.¹⁷⁶⁸

534. Megjithatë, kur konkludoi se midis Malit të Zi dhe Kosovës ekzistonte një kufi *de facto*, Dhoma Gjyqësore nuk identifikoi bazën në të drejtën zakonore ndërkombëtare mbi të cilën u mbështet kur konkludoi se në rrethana të tilla mund të vërtetohej ekzistenca e kufirit *de facto*.¹⁷⁶⁹ Dhoma e Apelit e konsideron gabim ligjor. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do të vlerësojë nëse, në bazë të së drejtës zakonore ndërkombëtare, rrethanat e çështjes mbështesin përfundimin se brenda territorit të RFJ-së, midis Kosovës dhe Malit të Zi ekzistonte një kufi *de facto*.

535. Dhoma e Apelit në çështjen *Stakiq* paraprakisht analizoi pjesët e të drejtës zakonore ndërkombëtare lidhur me krimin e dëbimit. Megjithatë, burimet e shqyrtuara në çështjen *Stakiq* nuk japin asnjë shembull kur shpërngulja e njerëzve nga një krahinë autonome e një shteti federal në një republikë brenda federatës së njëjtë përbën dëbim.¹⁷⁷⁰ Analiza të tjera të së drejtës zakonore ndërkombëtare lidhur me krimin e dëbimit u bënë edhe në Mendimin Pjesërisht Mospajtues të gjykatësit Schomburg në Aktgjykimin e Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq* dhe në Mendimin Pjesërisht Mospajtues të Gjykatësit Shahabuddeen në Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*.¹⁷⁷¹ Megjithatë, edhe burimet e cituara në këto dy analiza nuk trajtojnë çështjen e shpërnguljes së dhunshme të njerëzve brenda kufijve të një shteti sovran nga vetë qeveria e atij shteti, por kanë të bëjnë me praninë e një force pushtuese apo me një kufi të kontestuar midis dy shteteve.¹⁷⁷² Dhoma e Apelit thekson se çështja aktuale nuk ka të bëjë me praninë e një force pushtuese apo me një kufi të kontestuar midis dy shteteve.¹⁷⁷³

¹⁷⁶⁷ Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁶⁹ Aktgjykimi, para. 1683. Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 300.

¹⁷⁷⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 290-302. Dhoma e Apelit përkufizoi kufirin *de facto* duke përjashtuar çfarë nuk është kufi *de facto*, dhe konkludoi se “vijat vazhdimisht të ndryshueshme të frontit [...] nuk janë as kufij shtetëror *de jure* e as kufij *de facto* të territorit të pushtuar, të cilët automatikisht do të mjaftonin për dëbim sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare” (Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 301) (pa citimet).

¹⁷⁷¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues dhe i Veçantë i Gjykatësit Schomburg, para. 3-33; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 19-76.

¹⁷⁷² Shih Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues dhe i Veçantë i Gjykatësit Schomburg, para. 12, citon çështjen *RuSHA*, f. 126-127, 139. Dhoma e Apelit më tej vëren se në Mendimin e tij Pjesërisht Mospajtues, Gjykatësi Shahabuddeen përmendet çështjen *Qiproja k. Turqisë/ Cyprus v. Turkey* case që sugjeron se kalimi i një vije fronti mund të përbëjë dëbim sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare (Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 23, citon *Cyprus v. Turkey*, European Commission of Human Rights, European Human Rights Reports, Vol. 4 (1982), f. 482-528 (“çështja *Qiproja k. Turqisë*”), f. 520). Megjithatë, çështja *Qiproja k. Turqisë* gjithashtu ka të bëjë me forca pushtuese, gjë që e dallon atë nga çështja aktuale (Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 23).

¹⁷⁷³ Shih Aktgjykimi, para. 1683.

Dhoma e Apelit gjykon se e drejta zakonore ndërkombëtare nuk mbështet tezën se brenda kufijve të një shteti sovran mund të ekzistojë një kufi *de facto*, madje edhe nëse pjesë të shtetit në fjalë gëzojnë njëfarë autonomie. Rrjedhimisht, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ekzistonte një kufi *de facto*, të cilin [Dhoma Gjyqësore] e bazoi në faktin se Kosova kishte njëfarë autonomie, ose në faktin se Mali i Zi kishte statusin e republikës në kuadër të RFJ-së, nuk gjen mbështetje në të drejtën humanitare ndërkombëtare.¹⁷⁷⁴

536. Për më tepër, edhe faktorët e tjerë që mori parasysh Dhoma Gjyqësore nuk mbështesin përfundimin për ekzistencën e kufirit *de facto* sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare. Dhoma e Apelit nuk synon të zhvlerësojë “vështirësitë serioze”¹⁷⁷⁵ me të cilat u përballën shqiptarët kosovarë që u shpërngulën me dhunë nga Kosova për në Mal të Zi, siç gjykoi Dhoma Gjyqësore, e as të mohojë ekzistencën e një konflikti të armatosur apo përfundimin e Dhomës Gjyqësore se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë jashtë Kosovës e bënte më të lehtë kontrollin e krahinës prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë.¹⁷⁷⁶ Megjithatë, Dhoma e Apelit nuk gjeti asnjë bazë në të drejtën zakonore ndërkombëtare, e as në materialet që u shqyrtuan në Aktgjykimin e Apelit *Stakiq* apo në Mendimin Pjesërisht Mospajtues të gjykatësit Schomburg dhe atë të gjykatësit Shahabuddeen, nga e cila do të mund të deduktohej ekzistenca e një kufiri *de facto* në rrethanat e kësaj çështjeje.¹⁷⁷⁷

537. Për këto arsye, Dhoma e Apelit nuk është bindur se shqiptarët kosovarë kaluan një kufi *de facto* kur u shpërngulën me dhunë nga Kosova për në Mal të Zi, dhe gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se u krye krimi i dëbimit. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit përmbys përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me përgjegjësinë penale të Gjorgjeviqit për krimet e dëbimit (Pika 1) dhe përndjekjes nëpërmjet dëbimit (Pika 5) në lidhje me shpërnguljet e civilëve nga Peja më 27 dhe 28 mars 1999,¹⁷⁷⁸ dhe nga Mitrovica më 4 prill 1999, për në Mal të Zi.¹⁷⁷⁹

538. Më tej, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë parashtrimin e Prokurorisë se, në qoftë se Dhoma e Apelit do të miratojë pikën e trembëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit, [Dhoma] duhet të konkludojë se shpërngulja e civilëve nga Kosova për në Mal të Zi përbën krim të veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe krim të përndjekjes.¹⁷⁸⁰ Dhoma e Apelit kujton se sikurse dëbimi, po ashtu edhe zhvendosja e dhunshme “ka të bëjë me shpërnguljen e

¹⁷⁷⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁷⁵ Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁷⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1683.

¹⁷⁷⁷ Shih më lart, para. 535.

¹⁷⁷⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1642, 1701.

¹⁷⁷⁹ Aktgjykimi, para. 1649, 1701.

¹⁷⁸⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 133-134. Shih më lart, para. 530.

dhunshme të njerëzve nga një zonë ku ata janë të pranishëm ligjërisht, e pabazuar në të drejtën ndërkombëtare”¹⁷⁸¹ por në kontekst të shpërnguljeve brenda kufijve shtetëror.¹⁷⁸²

539. Dhoma e Apelit vëren se përsa u përket shembujve të veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), në paragrafin 73 të Aktakuzës përmenden konkretisht vetëm shpërnguljet *brenda territorit të Kosovës*.¹⁷⁸³ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se shpërngulja e dhunshme e njerëzve nga Kosova për në Mal të Zi nuk u pretendua në Aktakuzë si veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2). Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk mund të shpallë fajësi për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2).

540. Lidhur me krimin e përndjekjes, Dhoma e Apelit gjykon se veprimi bazë i shpërnguljes së dhunshme i kryer me synim diskriminues mund të përbëjë krim të përndjekjes.¹⁷⁸⁴ Në Aktakuzë, krimi i përndjekjes nëpërmjet zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit si veprime bazë pretendohet lidhur me të gjitha vendndodhjet e përmendura në paragrafin 72 të Aktakuzës.¹⁷⁸⁵ Në këtë kontekst, Aktakuza nuk e kufizon shprehimisht zhvendosjen e dhunshme vetëm në shpërngulje “*brenda territorit të Kosovës*” siç e bën këtë lidhur me krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2).¹⁷⁸⁶

541. Megjithëse në paragrafin 29 të Aktakuzës përgjithësisht përmenden shpërnguljet në Shqipëri, IRJM dhe Mal të Zi,¹⁷⁸⁷ Mali i Zi nuk përmendet shprehimisht lidhur me ndonjë nga vendndodhjet e përmendura aty.¹⁷⁸⁸ Për më tepër, në Dosjen Paragjyqësore, Prokuroria nuk

¹⁷⁸¹ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 308.

¹⁷⁸² Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 317.

¹⁷⁸³ “Lidhur me shqiptarët kosovarë të zhvendosur në brendësi të vendit *brenda territorit të Kosovës*, Prokurori riparaqet akuzat dhe përfshin nëpërmjet referencës paragrafët 16-33, 60-64, dhe 71-72 të Aktakuzës” (Aktakuza, para. 73) (theksi i shtuar).

¹⁷⁸⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*, para. 109; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 320, 454; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 131; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 113.

¹⁷⁸⁵ Aktakuza, para. 76-77. Shih më poshtë, para. 692-694.

¹⁷⁸⁶ Aktakuza, para. 76-77. *Krahaso* Aktakuza, para. 73.

¹⁷⁸⁷ Aktakuza, para. 29. Në pjesën përkatëse të paragrafit 29 të Aktakuzës thuhet:

Disa prej personave të shpërngulur brenda vendit, mbetën brenda krahinës së Kosovës gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, dhe shumë persona vdiqën si pasojë e kushteve të ashpra të motit, ushqimit të pamjaftueshëm, kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor dhe rraskapitjes. Të tjerët më në fund kaluan kufirin e Kosovës me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi ose kaluan kufirin krahinor midis Kosovës dhe Serbisë. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjet e shumë shqiptarëve të Kosovës të shpërngulur brenda vendit derisa në fund ata u dëbuan nga Kosova.

¹⁷⁸⁸ Aktakuza, para. 29. Në pjesën përkatëse të paragrafit 29 të Aktakuzës thuhet:

Disa prej personave të shpërngulur brenda vendit, mbetën brenda krahinës së Kosovës gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, dhe shumë persona vdiqën si pasojë e kushteve të ashpra të motit, ushqimit të pamjaftueshëm, kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor dhe rraskapitjes. Të tjerët më në fund kaluan kufirin e Kosovës me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi ose kaluan kufirin krahinor midis Kosovës dhe Serbisë. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjet e shumë shqiptarëve të Kosovës të shpërngulur brenda vendit derisa në fund ata u dëbuan nga Kosova.

shtjelloi hollësisht këtë pretendim të përgjithshëm.¹⁷⁸⁹ Pjesët e Aktakuzës lidhur me Pejën dhe Mitrovicën për të cilat Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishin kryer shpërngulje për në Mal të Zi, janë pikat e dhe f të paragrafit 72 të Aktakuzës.¹⁷⁹⁰ Në këta paragrafë përshkruhen shpërnguljet në kufirin me Shqipërinë, por nuk përmenden konkretisht shpërnguljet në Mal të Zi, e as përgjithësisht shpërnguljet jashtë Kosovës.¹⁷⁹¹ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se në Aktakuzë nuk janë paraqitur faktet juridikisht thelbësore lidhur me shpërnguljet në Mal të Zi. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se shpërnguljet në Mal të Zi nuk figurojnë si akuzë në Aktakuzë. Dhoma e Apelit vë në dukje se jurisprudenca ka përcaktuar se “dosja përfundimtare apo argumentet përmblylëse në disa raste mund të ndihmojnë për të gjykuar se në çmasë u informua i akuzuari për provat e Prokurorisë”.¹⁷⁹² Megjithëse në Dosjen e tij Përfundimtare Gjorgjeviqi përmendi shpërnguljen e popullatës civile kosovare, ndër të tjera për në Mal të Zi,¹⁷⁹³ ai e bëri këtë në kontekst të kundërshtimit të tij ndaj ekzistencës së një plani të përbashkët për “ndryshimin e përbërjes etnike” në Kosovë dhe pjesëmarrjen e tij në këtë plan.¹⁷⁹⁴ Në këto rrethana, Dhoma e Apelit konkludon se nuk ka prova se Gjorgjeviqi u njoftua për akuzat për krimin e dëbimit lidhur me Malin e Zi.

D. Përfundim

542. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit miraton pikën e trembëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit dhe përmbys përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me përgjegjësinë penale të Gjorgjeviqit për krimin e dëbimit (Pika 1) dhe përndjekjes nëpërmjet dëbimit (Pika 5) në lidhje me shpërnguljen e civilëve nga Peja më 27 dhe 28 mars 1999,¹⁷⁹⁵ dhe nga Mitrovica më 4 prill 1999,¹⁷⁹⁶ për në Mal të Zi. Ndikimi i mundshëm i këtij përfundimi mbi dënimin do të shqyrtohet më vonë në Aktgjykim.¹⁷⁹⁷

¹⁷⁸⁹ Shih Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 230-231.

¹⁷⁹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1642, 1646, 1701.

¹⁷⁹¹ Aktakuza, para. 72(e) dhe (f).

¹⁷⁹² Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 64.

¹⁷⁹³ Dosja Përfundimtare e Gjorgjeviqit, para. 690-694.

¹⁷⁹⁴ Dosja Përfundimtare e Gjorgjeviqit, para. 692.

¹⁷⁹⁵ Shih Aktgjykimi, para. 1642, 1701.

¹⁷⁹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1646, 1701.

¹⁷⁹⁷ Shih më poshtë, para. 976-980.

XIV. PIKA E KATËRMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT: PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME SYNIMIN KRIMINAL TË VRASJES

543. Dhoma Gjyqësore konkludoi se u vërtetua krimi i vrasjes, si krim kundër njerëzimit (Pika 3) dhe si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (Pika 4).¹⁷⁹⁸ Dhoma Gjyqësore përcaktoi dhe zbatoi elementët e mëposhtëm të krimit të vrasjes bazuar në Nenin 3 dhe Nenin 5 të Statutit:

- a) vdekja e viktimës (veprimi i fajshëm), ndonëse nuk është e nevojshme të vërtetohet se kufoma e viktimës është gjetur;
- b) vdekja ishte pasojë e një veprimi apo mosveprimi të autorit të krimit; mjafton të provohet që “sjellja e autorit të krimit kontribuoi ndjeshëm në vdekjen e personit”; dhe
- c) në kohën e veprimit ose mosveprimit autori i krimit synonte ta vriste viktimën ose në mungesë të synimit konkret, e dinte se kishte të ngjarë që veprimi ose mosveprimi të shkaktonte vdekjen (synimi kriminal). Është konkluduar se pakujdesia dhe pakujdesia flagrante nuk janë pjesë e synimit të tërthortë.¹⁷⁹⁹

A. Argumentet e palëve

544. Gjorgjeviqi parashtron se sipas ligjit, për vërtetimin e synimit kriminal për vrasje bazuar në Nenin 3 dhe 5 të Statutit është i nevojshëm elementi i paramendimit.¹⁸⁰⁰ Ai parashtron se ka një mospërputhje midis përdorimit të termit “vrasje” në versionin në anglisht të Nenit 5 të Statutit dhe termit “*assassinat*” në versionin në frëngjisht.¹⁸⁰¹ Sipas Gjorgjeviqit, kjo mospërputhje duhet zgjidhur duke zbatuar metodën që përdorën disa dhoma gjyqësore të TPNR-së, sipas të cilës për vërtetimin e vrasjes si krim kundër njerëzimit është i nevojshëm elementi i paramendimit.¹⁸⁰² Gjorgjeviqi pretendon se i njëjti standard duhet të zbatohet edhe lidhur me vrasjen si “krim lufte”.¹⁸⁰³ Ai pranon gjykimin e Dhomës Gjyqësore se ekzistenca e paramendimit u vërtetua në lidhje me disa vendndodhje të krimeve, por parashtron se ky element nuk u vërtetua lidhur me disa vendndodhje të tjera krimesh.¹⁸⁰⁴ Për këtë arsye, ai

¹⁷⁹⁸ Aktgjykimi, para. 1753. Shih Aktgjykimi, para. 1709-1752.

¹⁷⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1708 (pa citimet).

¹⁸⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 330-331. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 332-342; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 101.

¹⁸⁰¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 330-331.

¹⁸⁰² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 335-337, 341, përmendet Aktgjykimi *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 137-140; Aktgjykimi *Muhimana*, para. 569; Aktgjykimi *Semanza*, para. 334-339; Aktgjykimi *Bagilishema*, para. 84.

¹⁸⁰³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 331.

¹⁸⁰⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 342-343.

kërkon që Dhoma e Apelit të shfuqizojë fajësinë e tij lidhur me vendndodhjet e krimeve për të cilat nuk u vërtetua elementi i paramendimit, dhe rrjedhimisht të ulë dënimin e tij.¹⁸⁰⁵

545. Prokuroria përgjigjet se sipas jurisprudencës së Tribunalit, elementi i paramendimit nuk është i domosdoshëm për vërtetimin e synimit kriminal të vrasjes sipas Nenit 3 dhe Nenit 5 të Statutit.¹⁸⁰⁶ Ajo parashtron se Dhoma e Apelit ka lënë të pandryshuar një “numër të konsiderueshëm” aktgjykimesh të shkallës së parë ku për vërtetimin e krimit të vrasjes sipas Nenit 5(a) të Statutit nuk ishte i domosdoshëm elementi i paramendimit.¹⁸⁰⁷ Pavarësisht se disa dhoma gjyqësore të TPNR-së kanë përfshirë paramendimin në elementët e domosdoshëm të synimit kriminal të vrasjes si krim kundër njerëzimit, Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi nuk vërteton asnjë gabim ligjor, e as nuk paraqet arsye bindëse që Dhoma e Apelit të devijojë nga jurisprudenca e Tribunalit.¹⁸⁰⁸

B. Analizë

546. Fillimisht, Dhoma e Apelit thekson se krimi i vrasjes si krim kundër njerëzimit është përfshirë si në Statutin e TPNJ-së, po ashtu në Statutin e TPNR-së.¹⁸⁰⁹ Neni 5 dhe Neni 3 i versioneve në frëngjisht të këtyre dy Statuteve përmend “*assassinat*” si një prej krimeve bazë që përbën krim kundër njerëzimit, kurse në versionin në anglisht thuhet “vrasje”.¹⁸¹⁰ Dhoma e Apelit kujton se termi “*assassinat*” ka “një kuptim të përcaktuar saktësisht në ligjin francez” dhe kushtëzon ekzistencën e elementit të paramendimit,¹⁸¹¹ kurse termi vrasje “kuptohet dhe është i përkufizuar qartë në ligjin e çdo shteti” dhe nuk kërkon shpjegime të mëtejshme.¹⁸¹² Në lidhje me vrasjen si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, Dhoma e Apelit thekson se Neni 4 i Statutit të TPNR-së ndalon “dhunën ndaj jetës [...], dhe posaçërisht vrasjen”, dhe në versionin francez përdoret termi “*meurtre*”.¹⁸¹³ Nga ana tjetër, Neni 3 i Statutit të TPNJ-së nuk

¹⁸⁰⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 342-343. Gjorgjeviqi argumenton se nuk pati prova për paramendim në lidhje me vendet e krimeve në vijim: (i) Bellacërkë më 25 mars 1999; (ii) Krushë e Vogël më 25 mars 1999; (iii) qyteti i Suharekës më 26 mars 1999; (iv) Gjakovë më 1-2 prill 1999; dhe (v) Korenicë dhe Mejë më 27-28 prill 1999 (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 342).

¹⁸⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 296, 298, 302.

¹⁸⁰⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 299-300.

¹⁸⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 302.

¹⁸⁰⁹ Neni 5 i Statutit të TPNJ-së; Neni 3 i Statutit të TPNR-së.

¹⁸¹⁰ Neni 5 i Statutit të TPNJ-së; Neni 3 i Statutit të TPNR-së.

¹⁸¹¹ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 216; sh. 414, citon Nenin 221-3 të Kodit Penal Francez i cili përkufizon “*assassinat*” si “*meurtre commis avec préméditation/vrasje e kryer me paramendim*”.

¹⁸¹² 1996 ILC Report, f. 48. Shih Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, sh. 821, para. 560; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 217; Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, sh. 316. Dhoma e Apelit thekson se historia e përpilimit të Kartës së TUN-së tregon se delegacioni francez nuk propozoi përfshirjen e termit “*assassinat*” gjatë negocimit të juridiksionit të TUN-së (Shih “Observations of the French Delegation on American Draft, 28 qershor, 1945”, në Robert H. Jackson, *Report of Robert H. Jackson, United States Representative to International Conference on Military Trials* (U.S. Department of State, 1949) (“Jackson Report”), f. 89-91; “Draft Article on Definition of ‘Crimes’, Submitted by the French Delegation, 19 korrik 1945” në Jackson Report, f. 293; “Revised Definition of ‘Crimes’, Prepared by British Delegation and Accepted by French Delegation, 28 korrik 1945” në Jackson Report, f. 390-391).

¹⁸¹³ Neni 4 i Statutit të TPNR-së.

përmend shprehimisht vrasjen si një prej shkeljeve të ligjeve ose zakoneve të luftës.¹⁸¹⁴ Megjithatë, jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar qartë se Neni 3 i Statutit të TPNJ-së përfshin vrasjen.¹⁸¹⁵

547. Dhoma e Apelit thekson se termat “*meurtre*” dhe “*assassinat*” në frëngjisht janë shqyrtuar me hollësi në shumë aktgjykime të mëparshme.¹⁸¹⁶ Për shembull, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Jelisiq* konkludoi se përdorimi i termit “vrasje” në versionin në anglisht ishte me vend, meqenëse “ky term është i pranuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare”.¹⁸¹⁷ Këtë përfundim [Dhoma Gjyqësore] e formuloi pasi kishte analizuar çështjen *Akayesu*, Nenin 7(1)(a) të Statutit të GJPN-së, dhe Nenin 18 të Kodit të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare për Krimet kundër Paqes dhe Sigurisë së Njerëzimit; në të gjitha këto dokumente përmendet termi vrasje (“*meurtre*”).¹⁸¹⁸ Pas analizës së të njëjtave burime, edhe Dhoma Gjyqësore në çështjen *Bllashkiq* konkludoi në formë të ngjashme se vrasja, dhe jo vrasja me paramendim, është ajo që përbën shkeljen bazë të krimeve kundër njerëzimit sipas Statutit të TPNJ-së.¹⁸¹⁹ Në çështjen *Kordiq dhe Çerkez*, Dhoma Gjyqësore, duke iu referuar çështjes *Bllashkiq*, theksoi se:

Megjithëse në jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar ka pasur mospajtime rreth rëndësisë që duhet t’i kushtohet mospërputhjes midis përdorimit të fjalës “vrasje” në versionin në anglisht të Statutit dhe fjalës “*assassinat*” në versionin në frëngjisht, tashmë është qartësuar se paramendimi nuk është element i domosdoshëm.¹⁸²⁰

548. Megjithëse Dhoma e Apelit nuk shqyrtoi shprehimisht termat “*meurtre*” dhe “*assassinat*”, jurisprudenca e Tribunalit ka qenë vazhdimisht përputhëse në mosvënien e kushtit të elementit të paramendimit lidhur me krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit.¹⁸²¹ Elementët e vrasjes si krim lufte bazuar në Nenin 3 të Statutit janë përcaktuar nga Dhoma e Apelit e TPNJ-së si në vijim: (i) vdekja e një viktime që nuk merr pjesë aktivisht në luftime; (ii) vdekja ishte pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të autorit/autorëve të krimit apo e një ose më shumë personave për të cilët i

¹⁸¹⁴ Neni 3 i Statutit të TPNJ-së.

¹⁸¹⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 136; Vendimi *Tadiq*, tetor 1995, mbi Apelimin e Juridiksionit, para. 87, 89. Dhoma e Apelit vëren se Neni 2 i Statutit të TPNJ-së përmend “vrasjen e qëllimshme” si shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndaluar sipas Statutit, e cila në frëngjisht përkthehet si “*homicide intentionel*”.

¹⁸¹⁶ Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 235; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 216; Aktgjykimi *Jelisiq*, para. 51; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 484-485, sh. 1119; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 386, sh. 911-912.

¹⁸¹⁷ Aktgjykimi *Jelisiq*, para. 51.

¹⁸¹⁸ Aktgjykimi *Jelisiq*, para. 51, përmendet Aktgjykimi *Akayesu*, para. 588, Statuti i GJPN-së, Neni 7(1)(a), Projekt Kodi i Krimeve kundër Paqes dhe Sigurisë së Njerëzimit, në *1996 ILC Report*, Neni 18.

¹⁸¹⁹ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 216. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 235-236.

¹⁸²⁰ Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 235, përmendet Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 216. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 236.

¹⁸²¹ Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 108-109; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 261; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 37, 113; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 423.

akuzuari mban përgjegjësi penale; dhe (iii) autori i krimit synoi vrasjen e viktimës, ose dëmtim apo lëndim të rëndë të qëllimshëm, duke pasur dijeni të arsyeshme se sulmi me gjasë do të shkaktonte vdekjen e viktimës.¹⁸²² Është provuar se këta elementë janë të njëjtë me elementët e nevojshëm për vrasje si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5 të Statutit, me kusht që të jenë plotësuar kushtet *ombrellë* për secilin prej tyre.¹⁸²³

549. Dhoma e Apelit më tej thekson se vijimësisht ka lënë në fuqi verdiktet e fajësisë për vrasje në rastet kur dhomat gjyqësore nuk kanë kushtëzuar ekzistencën e paramendimit për vërtetimin e elementëve të bazuar në Nenin 3 dhe Nenin 5 të Statutit.¹⁸²⁴ Në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit në çështjen *Kupreshkiq dhe të tjerët* konfirmoi fajësinë për vrasje si krim kundër njerëzimit në bazë të synimit kriminal që nuk kërkonte elementin e paramendimit.¹⁸²⁵ Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kupreshkiq dhe të tjerët* shpjegoi se “njihen elementët përbërës të vrasjes bazuar në Nenin 5(a) të Statutit”¹⁸²⁶ dhe theksoi se “synimi kriminal i nevojshëm për vrasje sipas Nenit 5(a) është synimi për të vrarë apo shkaktuar lëndime të rënda, duke shpërfillur papërgjegjshmërisht jetën e njeriut”.¹⁸²⁷ Në përcaktimin e elementëve ligjorë, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kupreshkiq dhe të tjerët* theksoi se vrasja e qëllimshme dhe me paramendim ishte shtjelluar nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kayishema*.¹⁸²⁸ Gjithsesi, [Dhoma] nuk caktoi paramendimin si kriter kur zbatoi standardin ligjor lidhur me vrasjen bazuar në Nenin 5 të Statutit.¹⁸²⁹

550. Dhoma e Apelit e TPNR-së ka përcaktuar të njëjtët elementët si Dhoma e Apelit e TPNJ-së në lidhje me krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës.¹⁸³⁰ Rrjedhimisht, paramendimi *nuk* është element i vrasjes si krim lufte bazuar në Nenin 4 të Statutit të TPNR-së.¹⁸³¹ Në disa çështje, Dhoma e Apelit e TPNR-së ka konfirmuar verdikte fajësie për vrasje si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 3 të Statutit të TPNR-së, pa

¹⁸²² Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 261; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 37; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 423.

¹⁸²³ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 113, citohet Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 236.

¹⁸²⁴ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, f. 128; Aktgjykimi *D. Millosheviq*, para. 931; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, f. 295-297; Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 236; Aktgjykimi i Apelit *Staqiq*, f. 142; Aktgjykimi *Staqiq*, para. 587; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, f. 169; Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerët*, para. 486; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, f. 242; *Kvoçka dhe të tjerët* Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 132; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, f. 170-171; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 560-561; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, f. 87; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 485; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, f. 116; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerët*, para. 241.

¹⁸²⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, f. 170-171.

¹⁸²⁶ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 560.

¹⁸²⁷ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 561, citohet Aktgjykimi *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 139.

¹⁸²⁸ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 561, citohet Aktgjykimin *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 139.

¹⁸²⁹ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 818, 820, 822. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 235 (përfshirë referencat).

¹⁸³⁰ Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 257.

¹⁸³¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 257.

kushtin e paramendimit.¹⁸³² Gjithsesi në disa çështje të tjera, [Dhoma e Apelit e TPNR-së] ka konfirmuar verdikte fajësie në bazë të standardit që kushtëzon ekzistencën e elementit të paramendimit.¹⁸³³ Pavarësisht nga dallimet në standardin e zbatuar në *disa* aktgjykime të para të TPNR-së, Dhoma e Apelit kujton se nuk është e detyruar të zbatojë vendimet e dhomave gjyqësore.¹⁸³⁴ Megjithëse Gjorgjeviqi sugjeron miratimin e standardit të synimit kriminal që kërkon ekzistencën e elementit të paramendimit, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk identifikoi asnjë arsye bindëse që do të përlligjte devijimin nga jurisprudenca e deritanishme e Tribunalit e cila në vijimësi ka konfirmuar verdikte fajësie për vrasje, pa kushtin e paramendimit, si në bazë të Nenit 3, po ashtu edhe në bazë të Nenit 5 të Statutit.

551. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit gjykon se jurisprudenca e Tribunalit nuk kërkon elementin e paramendimit në përmbushjen e elementit të synimit kriminal për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës bazuar në Nenin 3, apo si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5(a) të Statutit.

C. Përfundim

552. Meqenëse Gjorgjeviqi nuk identifikoi asnjë arsye bindëse që do të justifikonte devijim nga jurisprudenca e deritanishme e Tribunalit, Dhoma e Apelit konfirmon jurisprudencën e deritanishme se paramendimi nuk është element i domosdoshëm i krimit të vrasjes. Duke pasur parasysh se paramendimi nuk përbën element të detyrueshëm ligjor, rrëzohen kundërshtimet e

¹⁸³² Për shembull, Dhoma e Apelit në çështjen *Akayesu* nuk e ndryshoi verdiktin e fajësisë së *Akayesu-s* për vrasje si krim kundër njerëzimit (Aktgjykimi i Apelit *Akayesu*, f. 143), i cili bazohej në standard që nuk kërkonte elementin e paramendimit (Shih Aktgjykimi *Akayesu*, para. 588, ku Dhoma Gjyqësore thekson: “E drejta zakonore ndërkombëtare dikton se krim kundër njerëzimit përbën veprimi i ‘vrasjes’, dhe jo ‘*assassinat*’ (vrasje me paramendim)”). Dhoma e Apelit në çështjen *Rutaganda* shfuqizoi verdiktin e fajësisë së *Rutaganda-s* për vrasje si krim kundër njerëzimit duke u bazuar në të njëjtin standard (Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, f. 168. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Rutaganda*, para. 79-81, 426, 433). Në çështjen *Musema*, Dhoma e Apelit la në fuqi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se *Musema* nuk ishte fajtor për vrasje si krim kundër njerëzimit në bazë të të njëjtit standard (Aktgjykimi i Apelit *Musema*, para. 958, f. 130. Shih Aktgjykimi *Musema*, para. 955. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Musema*, para. 214-215 ku Dhoma Gjyqësore përmend Aktgjykimin *Akayesu* dhe *Semanza*, dhe shpjegoi se e drejta zakonore ndërkombëtare përcakton se krim kundër njerëzimit përbën “vrasja”, dhe jo “*assassinat* (vrasje me paramendim)”).

¹⁸³³ Dhoma e Apelit në çështjen *Muhimana* dhe *Semanza* lanë fuqi verdiktet e fajësisë për vrasje si krim kundër njerëzimit në bazë të standardit që kushtëzon ekzistencën e elementit të paramendimit (Aktgjykimi i Apelit *Muhimana*, para. 228, f. 81; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, f. 126). Dhoma Gjyqësore në çështjen *Muhimana* u pajtua me konkluzionin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Semanza* se vrasja me paramendim, (*assassinat*) përbën krim kundër njerëzimit, Aktgjykimi *Muhimana*, para. 569, citon Aktgjykimin *Semanza*, para. 339. Shih gjithashtu Aktgjykimi *Semanza*, para. 334-338. Dhoma e Apelit thekson se në çështjen *Bagilishema*, Dhoma e Apelit konfirmoi pafajësinë e *Bagilishema-s* bazuar në standardin që zbatoi Dhoma Gjyqësore, i cili kushtëzonte ekzistencën e elementit të paramendimit (Aktgjykimi i Apelit *Bagilishema*, f. 57. Shih Aktgjykimi *Bagilishema*, para. 84-85, f. 340). Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kayishema dhe Ruzindana* gjykoj se koncepti i vrasjes dhe ai i *assassinat* duhen marrë parasysh së bashku, dhe se standardi i synimit kriminal të nevojshëm për vrasje si krim kundër njerëzimit është vrasja e qëllimshme dhe me paramendim (Aktgjykimi *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 138. Shih Aktgjykimi *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 137, 139-140). Gjithsesi në çështjen *Kayishema dhe Ruzindana*, Dhoma Gjyqësore konkludoi se vrasja si krim kundër njerëzimit ishte plotësisht e inkuadruar në pikat e Nenit 2 të Statutit të TPNR-së (Gjenocid) dhe nuk nxori verdikte fajësie për vrasje (Aktgjykimi *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 576-578).

¹⁸³⁴ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 114.

Gjorgjeviqit ndaj vlerësimeve të Dhomës Gjyqësore mbi paramendimin në lidhje me vende konkrete krimesh. Rrjedhimisht, pika e katërbëdhjetë e apelit të Gjorgjeviqit hidhet poshtë.

**XV. PIKA E PESËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT PJESËRISHT:
PRETENDIM PËR GABIME LIDHUR ME SHKATËRRIMIN E OBJEKTEVE TË
RËNDËSISHME FETARE OSE KULTURORE**

A. Hyrje

553. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me rëndësi fetare ose kulturore u vërtetua lidhur me xhamitë në Celinë, Bellacërkë, Landovicë, Suharekë (Xhamia e Bardhë), Gjakovë (Xhamia e Hadumit), Rogovë, Llashticë, dhe Vushtrri (Xhamia e Çarshisë) (“Tetë Xhamitë”).¹⁸³⁵

554. Gjorgjeviqi parashton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor lidhur me standardin e synimit kriminal të nevojshëm për krimin e përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve fetare, dhe gabim faktik në përfundimet mbi synimin kriminal lidhur me Xhaminë e Hadumit, Xhaminë e Çarshisë, dhe xhamitë në Llashticë dhe Landovicë (“Katër Xhamitë”).¹⁸³⁶ Ai më tej parashton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur zbatoi standardin sipas të cilit veprimet e përndjekjes duhet të kenë të njëjtën peshë ose rrezikshmëri si krimet e tjera të renditura në Nenin 5 të Statutit.¹⁸³⁷

B. Synimi kriminal i nevojshëm për përndjekje nëpërmjet shkatërrimit pa shkak

1. Argumentet e palëve

555. Gjorgjeviqi parashton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor me konkluzionin se një veprim shkatërrimi ose dëmtimi i kryer me papërgjegjshmëri “është i mjaftueshëm për vërtetimin e shkatërrimit pa shkak me synim përndjekës”.¹⁸³⁸ Ai parashton se jurisprudenca nuk është shumë e qartë lidhur me shkatërrimin e pronës si krim lufte dhe përndjekjen nëpërmjet shkatërrimit të pronës si krim kundër njerëzimit bazuar përkatësisht në Nenin 3 dhe

¹⁸³⁵ Aktgjykimi, para. 1854. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1811, 1819, 1825, 1832, 1837, 1841, 1850. Xhamia në Suharekë njihet edhe si Xhamia e Bardhë (Aktgjykimi, para. 690, 1820). Xhamia në Gjakovë njihet edhe si Xhamia e Hadumit apo Xhamia e Hadum Sulejman Agës (Aktgjykimi, para. 863). Kompleksi i xhamisë së tregut në Vushtrri njihet edhe si Xhamia e Çarshisë apo Tash Xhamia (Aktgjykimi, para. 1849).

¹⁸³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 344-347. Argumenti shtesë i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk bëri lidhjen midis xhamive të shkatërruara dhe sulmeve sistematike dhe të përhapura gjerësisht kundër popullatës civile, apo NPK-në (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 344, 350), është shqyrtuar në lidhje me pikën e shtatë të apelit të tij (shih më lart, para. 198-200, 204, 207). Kundërshtimet e tij lidhur me provat ku mbështeten përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi shkatërrimin e xhamive në Landovicë, Gjakovë (Xhamia e Hadumit), Llashticë (shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347) shqyrtohen në lidhje me pikën 17 të apelit (Shih më poshtë, para. 803-815, 816-822).

¹⁸³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 344, 348-349.

¹⁸³⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 345, përmendet Aktgjykimi, para. 1773.

Nenin 5 të Statutit.¹⁸³⁹ Pavarësisht nga konkluzioni i Dhomës Gjyqësore në çështjen *Bërgjanin* se kushti i synimit kriminal të nevojshëm për krimet nga Neni 4 përmbushet me elementin e “shpërfilljes së papërgjegjshme”, Gjorgjeviqi pretendon se ky konkluzion nuk vlen për paragrafin h të Nenit 5(h).¹⁸⁴⁰ Ai argumenton se krimi i përndjekjes kërkon ekzistencën e “synimit konkret” dhe për këtë arsye krimi duhet të jetë kryer me synimin për të diskriminuar.¹⁸⁴¹ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi këtë “kriter”.¹⁸⁴² Gjorgjeviqi më tej parashtron se fakti që Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e shpërfilljes së papërgjegjshme lidhur me Katër Xhamitë nënkupton se “[Dhoma Gjyqësore] nuk ishte në gjendje të provonte nëse autorët e krimit konkretisht synuan të sulmonin xhaminë”.¹⁸⁴³

556. Prokuroria përgjigjet se: (i) Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi standardin e shpërfilljes së papërgjegjshme; (ii) Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet konkrete të Dhomës Gjyqësore; dhe (iii) parashtrimet e tij duhen rrëzuar menjëherë.¹⁸⁴⁴ Për më tepër, Prokuroria parashtron se edhe sikur provat lidhur me katër Xhamitë të kishin plotësuar vetëm kriterin e “shpërfilljes së papërgjegjshme”, Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se kushti i synimit kriminal të nevojshëm u plotësua lidhur me krimin e përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të këtyre xhamive.¹⁸⁴⁵ [Prokuroria] argumenton se veprimet e kryera me “vetëdijen për gjasën e konsiderueshme të shkatërrimit ose dëmtimit të objekteve kulturore” mund të përmbushin elementin e synimit kriminal të krimit të shkatërrimit ose dëmtimit të qëllimshëm sipas paragrafit d të Nenit 3 të Statutit.¹⁸⁴⁶ Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi nuk argumenton se pse

¹⁸³⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 346. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 102.

¹⁸⁴⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 346, përmendet Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 599, 1021-1024. Gjorgjeviqi thekson se Dhoma Gjyqësore iu referua Aktgjykimit *Krajishnik* në mbështetje të konkluzionit të vet se shpërfillja e papërgjegjshme plotëson kushtin e synimit kriminal të shkatërrimit të objekteve fetare si veprim bazë i krimit të përndjekjes (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 346, përmendet Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 782). Megjithatë, ai argumenton se në asnjë prej burimeve të cituara në [Aktgjykimin] *Krajishnik* nuk sugjerohet se shpërfillja e papërgjegjshme është kriteri i duhur për përndjekje nëpërmjet shkatërrimit sipas paragrafit h të Nenit 5, por përkundrazi “vënë në pah nevojën për të zbuluar ‘synimin e nevojshëm diskriminues’” (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 346, përmendet Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 206-207, 362, Aktgjykimi *Staqiq*, para. 765-767, Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 599, 1021, 1023, Aktgjykimi *Strugar*, para. 308-311).

¹⁸⁴¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 345; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 102. Gjorgjeviqi më tej parashtron se ndonëse Prokuroria mbështetet në Aktgjykimin *Strugar*, “një krahasim me atë çështje do të ishte i dobishëm. Sikur një nga predhat të kishte goditur një kishë në Qytetin e Vjetër të Dubrovnikut, apo të kishte shkatërruar një zjarr që do të përhapej dhe kaplonte kishën, kjo nuk do të thotë se do të rezultonte domosdoshmërisht në verdikt fajësie për përndjekje fetare” (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 103). Ai më tej parashtron se “Gjithashtu, Prokuroria do të duhej të vërtetonte se kisha u godit me synimin e diskriminimit bazuar në një prej arsyeve të parashkruara” (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 103).

¹⁸⁴² Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 105.

¹⁸⁴³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 104, 106.

¹⁸⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 303, përmendet Aktgjykimi, para. 1817-1819, 1830-1832, 1838-1841, 1848-1850, 2025, 2151.

¹⁸⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 304.

¹⁸⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 304, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 277.

duhet të zbatohet një kriter i ndryshëm për të njëjtin krim bazuar në paragrafin h të Nenit 5 të Statutit.¹⁸⁴⁷

2. Analizë

557. Dhoma Gjyqësore shpjegoi se krimi i përndjekjes përfshin një veprim ose mosveprim që: (i) diskriminon faktikisht dhe shkel një të drejtë themelore të sanksionuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare, ose në të drejtën e traktateve (veprimi i fajshëm); dhe (ii) kryhet qëllimisht me synimin e diskriminimit për një nga arsyet e renditura, konkretisht për arsye racore, fetare ose politike.¹⁸⁴⁸ [Dhoma Gjyqësore] më tej gjykoi se synimi kriminal i veprimit bazë të shkatërrimit të objekteve fetare vërtetohet në qoftë se keqbërësi “veproi me synimin për shkatërrimin ose dëmtimin e pronës ose me shpërfillje të papërgjegjshme për gjasën thelbësore të shkaktimit të shkatërrimit ose dëmtimit”.¹⁸⁴⁹

558. Kur argumenton se standardi i synimit kriminal të përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve të rëndësishme fetare ose kulturore është synimi konkret (diskriminues), Gjorgjeviqi me sa duket shpërfill faktin se synimi kriminal i krimit të përndjekjes është i dyfishtë: ai kushtëzon ekzistencën e synimit kriminal të veprimit bazë dhe të synimit konkret për të diskriminuar mbi baza politike, racore apo fetare.¹⁸⁵⁰ Për të vërtetuar krimin e përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me rëndësi fetare ose kulturore, një dhomë gjyqësore duhet të bindet se: (i) është provuar synimi kriminal i shkatërrimit të objekteve me rëndësi fetare ose kulturore; dhe (ii) shkatërrimi është kryer me synim diskriminues.

559. Dhoma e Apelit gjykon se shkatërrimi i objekteve me rëndësi fetare ose kulturore si veprim bazë i krimit të përndjekjes është i njëjtë me “shkatërrimin ose dëmtimin e qëllimshëm të institucioneve fetare [ose objekteve të tjera kulturore]”; shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas paragrafit d të Nenit 3 të Statutit.¹⁸⁵¹ Në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, elementi i synimit kriminal për të dy veprimet është i njëjtë.¹⁸⁵² Dhoma e Apelit kujton se elementi i synimit kriminal të shkatërrimit të institucioneve fetare apo të objekteve të tjera kulturore bazuar në paragrafin (d) të Nenit 3 “plotësohet nëse veprimet e shkatërrimit ose dëmtimit ishin të qëllimshme, do të thotë u kryen ose qëllimisht, ose me shpërfillje të

¹⁸⁴⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 304, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 108, Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 144-149, Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 206.

¹⁸⁴⁸ Aktgjykimi, para. 1755.

¹⁸⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1773.

¹⁸⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 328.

¹⁸⁵¹ Krahaso Aktgjykimi, para. 1770-1771, përmendet Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 206. Neni 3(d) i Statutit përmend “shkatërrim, ose dëmtim i qëllimshëm i institucioneve fetare, bamirëse, arsimore, artistike dhe shkencore, i monumenteve historike dhe i veprave të artit dhe të shkencës”.

¹⁸⁵² Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 782; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 765-767; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 596-599, 1021, 1023. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1773.

papërgjegjshme, kundër” objektit.¹⁸⁵³ Për këtë arsye, Gjorgjeviqi nuk arriti të provonte se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur gjykoi se shpërfillja e papërgjegjshme është e mjaftueshme për përmbushjen e elementit të synimit kriminal për shkatërrimin e objekteve me rëndësi fetare ose kulturore si veprim bazë i përndjekjes. Rrjedhimisht, nuk qëndron argumenti i tij se keqbërësit duhen të kishin “synuar konkretisht” xhamitë. Për këtë arsye, hidhet poshtë argumenti i Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi kur zbatoi standardin e shpërfilljes së papërgjegjshme në lidhje me Katër Xhamitë.

560. Në vijim, Dhoma e Apelit do të analizojë argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi elementin e synimit konkret të nevojshëm për përndjekjen.¹⁸⁵⁴ Dhoma Gjyqësore me të drejtë gjykoi se krimi i përndjekjes kushtëzon ekzistencën e elementit të synimit konkret, do të thotë synimit për të diskriminuar për arsye politike, racore ose fetare.¹⁸⁵⁵ Më pas [Dhoma Gjyqësore] nxori një përfundim të përgjithshëm se “shkatërrimi i gjerë [i objekteve fetare shqiptare kosovare] u krye me synimin e përndjekjes si simbole të trashëgimisë dhe identitetit shqiptar kosovar”.¹⁸⁵⁶ Dhoma Gjyqësore gjithashtu analizoi veçazi elementin e synimit diskriminues lidhur me xhamitë e Celinës, Bellacërkës, dhe Rogovës.¹⁸⁵⁷ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se në lidhje me secilën prej tyre ishte vërtetuar krimi i përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit pa shkak.¹⁸⁵⁸ Edhe përse u përket Katër Xhamive dhe Xhamisë së Bardhë në Suharekë, ndonëse nuk analizoi veçazi elementin e synimit diskriminues për secilën prej tyre,¹⁸⁵⁹ Dhoma Gjyqësore gjithsesi konkludoi se ishte vërtetuar krimi i përndjekjes meqenëse ato ishin shkatërruar ose kishin pësuar dëmtime.¹⁸⁶⁰

561. Siç u theksua më lart, Dhoma Gjyqësore nxori përfundim të përgjithshëm nëse shkatërrimi pa shkak apo dëmtimi i objekteve fetare u krye me synim diskriminues.¹⁸⁶¹ Meqenëse ky përfundim ka të bëjë me të gjitha xhamitë e dëmtuara, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar që të përcaktonte për secilën xhami veç e veç nëse ishte shkatërruar me synim diskriminues. Megjithatë, do të kishte qenë më mirë sikur Dhoma Gjyqësore të kishte zbatuar një metodë të njëtrajtshme për të gjitha xhamitë, në vend të shqyrtonte vetëm të disa prej tyre. Dhoma e Apelit gjykon se përfshirja e një përfundimi ligjor

¹⁸⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 277, me referenca të tjera.

¹⁸⁵⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 345; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 105.

¹⁸⁵⁵ Aktgjykimi, para. 1755.

¹⁸⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2151. Ky përfundim është në pjesën e Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore ku shtjellohet nëse krimet e vërtetuara në Aktgjykim ishin pjesë e një plani të përbashkët (Aktgjykimi, Ndarja XII.B.2(b)).

¹⁸⁵⁷ Aktgjykimi, para. 1810, 1836. Ky diskutim gjendet në pjesën e Aktgjykimit në lidhje me krimin e përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit ose dëmtimit pa shkak të objekteve fetare (Aktgjykimi, Ndarja XI.C.2(d)).

¹⁸⁵⁸ Aktgjykimi, para. 1811, 1837.

¹⁸⁵⁹ Shih Aktgjykimi, Ndarja XI.C.2(d).

¹⁸⁶⁰ Aktgjykimi, para. 1819, 1825, 1832, 1841, 1850. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1854.

¹⁸⁶¹ Aktgjykimi, para. 2151.

në një aktgjykim nuk ka rëndësi juridikisht thelbësore dhe është brenda kompetencave të një dhoma gjyqësore, me kusht që përfundimi të jetë i qartë dhe gjithëpërfshirës.

562. Në këto rrethana, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin e duhur se shkatërrimi ose dëmtimi i xhamive u krye me synim diskriminues. Për këtë arsye, Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi dhe rrjedhimisht argumenti i tij hidhet poshtë.

C. Pesha e barabartë

1. Argumentet e palëve

563. Sipas Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se shkatërrimi i Tetë Xhamive përbënte përndjekje, meqenëse zbatoi gabimisht kushtin e peshës së barabartë.¹⁸⁶² Gjorgjeviqi pajtohet me mendimin e Dhomës Gjyqësore se lloji dhe masa e shkatërrimit përcakton nëse veprimi përkatës përmbush kushtin e peshës së barabartë.¹⁸⁶³ Ai argumenton se duke qenë se Dhoma Gjyqësore “pranoi se shkatërrimi i objekteve fetare ‘mund’ të përbëjë (dhe jo domosdoshmërisht përbën) veprim përndjekës”,¹⁸⁶⁴ duhej të kishte përcaktuar në qoftë se ishte plotësuar kushti i peshës së barabartë në lidhje me secilën prej xhamive.¹⁸⁶⁵ Për mendimin e tij, Dhoma Gjyqësore duhej të kishte vlerësuar “rëndësinë e objekteve të kultit për një bashkësi të veçantë”, dhe mungesa e një analize të tillë përbën gabim.¹⁸⁶⁶

564. Në përgjigje, Prokuroria parashton se nga arsyetimi i Dhomës Gjyqësore del qartë se kushti i peshës së barabartë plotësohet atëherë kur një objekt ka karakter fetar, pa qenë e nevojshme të vërtetohet vlera e objektit për bashkësinë përkatëse.¹⁸⁶⁷

2. Analizë

565. Në parashtrimin e ligjit mbi krimin e përndjekjes nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me rëndësi fetare apo kulturore, Dhoma Gjyqësore theksoi se:

Kushti i peshës së barabartë në lidhje me shkatërrimin e pronës varet prej llojit dhe masës së shkatërrimit. Disa Dhoma Gjyqësore kanë vënë në dukje se shkatërrimi i objekteve fetare përbën sulm “kundër vetë identitetit fetar të një populli” dhe rrjedhimisht është “shprehje thujse e qartë” e konceptit të krimeve kundër njerëzimit. [...] Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar, Raporti i ILC-së i vitit 1991, dhe gjykatat shtetërore, ndër të tjera, kanë veçuar shkatërrimin e ndërtesave fetare si rast i qartë përndjekjeje dhe si krim kundër

¹⁸⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 348-349.

¹⁸⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 348, përmendet Aktgjykimi, para. 1771.

¹⁸⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 348.

¹⁸⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 348-349.

¹⁸⁶⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 349.

¹⁸⁶⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 310.

njerëzimit. Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se shkatërrimi dhe dëmtimi i qëllimshëm i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë të marrë së bashku me synimin e nevojshëm diskriminues, *mund* të përbëjnë veprim përndjekës.¹⁸⁶⁸

566. Dhoma Gjyqësore konkludoi se përgjithësisht, kushti i peshës së barabartë në lidhje me shkatërrimin e pronës varet prej llojit dhe masës së shkatërrimit.¹⁸⁶⁹ Më tej. [Dhoma Gjyqësore] analizoi shkatërrimin e *objekteve fetare* dhe konkludoi se shkatërrimi ose dëmtimi i qëllimshëm i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë “mund” të përbëjë veprim përndjekës.¹⁸⁷⁰ Nëpërmjet përdorimit të foljes ndihmëse “mund”, Dhoma Gjyqësore pranoi se megjithëse shkatërrimi i objekteve fetare plotëson kushtin e peshës së barabartë lidhur me krimet e përmendura në Nenin 5 të Statutit, ai nuk përbën vetvetiu krim të përndjekjes si krim kundër njerëzimit. [Në lidhje me këtë] duhen përmbushur kushte të tjera plotësuese të cilat Dhoma Gjyqësore i analizoi në paragrafët vijues.¹⁸⁷¹

567. Dhoma e Apelit nuk e ka shqyrtuar më parë problemin e peshës së barabartë, konkretisht lidhur me përndjekjen nëpërmjet shkatërrimit të objekteve me rëndësi fetare ose kulturore. Dhoma e Apelit gjykon se shkatërrimi i objekteve fetare plotëson kushtin e peshës së barabartë, meqenëse përbën “sulm kundër vetë identitetit fetar të një populli” dhe si i tillë është “shprehje thuajse e qartë” e konceptit të krimeve kundër njerëzimit, sikurse kanë konkluduar edhe disa dhoma gjyqësore.¹⁸⁷² Vërtetimi i faktit se një objekt i kushtohet besimit fetar përmbush kushtin e peshës së barabartë, pa qenë e nevojshme të vlerësohet rëndësia e objektit konkret fetar për një bashkësi të veçantë.¹⁸⁷³ Ky aspekt e dallon shkatërrimin e objekteve fetare nga shkatërrimi i pronës private, i cili jodomosdoshmërisht mund të ketë ndikim mjaftueshmërisht të madh për të përbërë krim kundër njerëzimit.¹⁸⁷⁴

568. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se nuk ishte e domosdoshme që Dhoma Gjyqësore të vlerësonte lidhur me secilën prej xhamive nëse shkatërrimi plotësonte

¹⁸⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1771 (theksi i shtuar; pa citimet).

¹⁸⁶⁹ Aktgjykimi, para. 1771.

¹⁸⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1771. Shih Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 204-205; Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 202, 206-207; Aktgjykimi *Staqiq*, para. 766-768; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 780-783.

¹⁸⁷¹ Aktgjykimi, para. 1772 (prona e shkatërruar nuk duhet të jetë përdorur për qëllime ushtarake), 1773 (elementët e përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit; synimi kriminal konkret për përndjekje; veprimi i fajshëm dhe synimi kriminal për shkatërrimin e objekteve fetare). Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1770.

¹⁸⁷² Shih Aktgjykimi, para. 1771; Aktgjykimi *Millutinoviqi dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 205; Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 202, 206-207; Aktgjykimi *Staqiq*, para. 766-768; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 780-783. Në Raportin e ILC-së të vitit 1991 shkatërrimi i objekteve fetare përmendet si shembull i përndjekjes si krim kundër njerëzimit (1991 ILC Report, vëll. II, pjesa. 2, f. 104). Po ashtu, edhe në aktgjykimet e çështjeve të Pasluftës së Dytë Botërore, shkatërrimi i objekteve fetare konsiderohet përndjekje si krim kundër njerëzimit (Aktgjykime të TUN-ve, f. 248, 302; *Israel v. Adolph Eichmann*, District Court of Jerusalem, Judgement of 12 December 1961/*Izraeli k. Adolph Eichmann-it*, Gjykata e Qarkut të Jerusalemit, Aktgjykim i datës 12 dhjetor 1961, 36 *International Law Reports* 5, para. 57).

¹⁸⁷³ Shih Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 202, 206-207; Aktgjykimi *Staqiq*, para. 766-768; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 780-783.

¹⁸⁷⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 146, citon dhe pajtohet me mendimin në Aktgjykimin *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 631.

kushtin e peshës së barabartë. Rrjedhimisht, Gjorgjeviqi nuk provoi asnjë gabim të Dhomës Gjyqësore dhe argumenti i tij hidhet poshtë.

D. Përfundim

569. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit hedh poshtë pjesërisht pikën e pesëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.¹⁸⁷⁵

¹⁸⁷⁵ Dhoma e Apelit do ta analizojë pjesën tjetër të kësaj pike apeli në pjesën lidhur me pikën 17 të apelit. Shih më poshtë, Kapitulli IX dhe XIX.

**XVI. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT:
PRETENDIM PËR VERDIKTE FAJËSIE LIDHUR ME KRIME QË NUK
FIGUROJNË SI AKUZA NË AKTAKUZË**

A. Argumentet e palëve

570. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krime që nuk ishin përfshirë në Aktakuzë.¹⁸⁷⁶ Ai argumenton se disa verdikte fajësie lidhur me krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) përndjekjes si krim kundër njerëzimit, dhe vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit, duhen shfuqizuar për arsye se disa vendndodhje apo ngjarje lidhur me këto krime nuk u përmendën në Aktakuzë.¹⁸⁷⁷ Ai kërkon ulje dënimi në përputhje me si më sipër.¹⁸⁷⁸

571. Prokuroria përgjigjet se: (i) kjo pikë e apelit meriton rrëzim të menjëhershëm meqenëse Gjorgjeviqi e ngre për herë të parë në apel, dhe duke mos kundërshtuar provat e paraqitura gjatë gjykimit, ai hoqi dorë nga e drejta për të ngritur këtë çështje në apel;¹⁸⁷⁹ (ii) Gjorgjeviqi u njoftua me kohë për faktet juridikisht thelbësore,¹⁸⁸⁰ Aktakuza përfshin të gjitha vendndodhjet dhe krimet që ai apelon;¹⁸⁸¹ dhe (iii) në qoftë se do të konkludojë se disa nga incidentet nuk u përmendën në Aktakuzë, Dhoma e Apelit nuk duhet të përmbysë automatikisht verdiktet përkatëse të fajësisë,¹⁸⁸² por duhet të gjykojë nëse mangësitë u korrigjuan përmes dhënies së informacionit të qartë, përputhës dhe në kohë nga ana e Prokurorisë në Dosjen Paragjyqësore dhe përmbledhjet lidhur me dëshmitarët bazuar në Rregullën 65ter,¹⁸⁸³ në provat e bëra publike,¹⁸⁸⁴ dhe nga vetë parashtrimet e Gjorgjeviqit gjatë procesit gjyqësor.¹⁸⁸⁵

¹⁸⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 352; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99-102.

¹⁸⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 352-360, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*. Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 110-111.

¹⁸⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 361.

¹⁸⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 313. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 320, 322, 325, 327-328, 333, 335-336, 340-344, 346-347; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 150-151.

¹⁸⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 314; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 149-151.

¹⁸⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 314-315, 319, 321, 323-324, 326, 328-332, 334, 336-339, 341, 343-344,

347-348; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 149-157.

¹⁸⁸² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 316, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 238, Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 195.

¹⁸⁸³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 316, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Simi*, para. 23-24, Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 26, 33, 61-65, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 34, 44, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 142, 165. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 149-150.

¹⁸⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 316, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 117-120, Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 197, Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana dhe Ntakirutimana*, para. 48, *Gacumbitsi* Aktgjykimi i Apelit, para. 57-58.

¹⁸⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 316, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Simi*, para. 24, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 52-53. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 318, ku Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi “mori në pyetje dëshmitarët e Prokurorisë në lidhje me ngjarjet që ai i apelon dhe nuk ka provuar efekt negativ thelbësor ndaj mbrojtjes së vet”.

572. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se ky nuk është problem i heqjes dorë të së drejtës prej tij, meqenëse ai u informua për disa krime të tjera vetëm kur Dhoma Gjyqësore publikoi Aktgjykimin.¹⁸⁸⁶ Gjorgjeviqi shprehimisht thekson se ai nuk parashtron që Aktakuza ishte e paqartë.¹⁸⁸⁷ Për më tepër, ai i kërkon Dhomës së Apelit që të mos mbështetet në përmbledhjet e dëshmitarëve apo deklaratat e dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, duke pretenduar se Prokuroria përpiket që t'i zgjerojë akuzat kundër tij dhe t'i atribuojë përgjegjësi penale për sulme të tjera që nuk u përfshinë në Aktakuzë.¹⁸⁸⁸

B. Analizë

1. Hyrje

573. Së pari, Dhoma e Apelit thekson se kundërshtimet në lidhje me mangësi të një aktakuze zakonisht shqyrtohen nga një dhomë gjyqësore në fazën paragjyqësore, ose, në rast miratimi të një kërkesë për apelim të ndërkohshëm bazuar në Rregullën 72(B)(ii) të Rregullores, ato shqyrtohen nga Dhoma e Apelit.¹⁸⁸⁹ Në çështjen aktuale, Dhoma e Apelit përballet me një skenar krejtësisht tjetër, duke qenë se Gjorgjeviqi e ngre këtë problem në fazën e apelit dhe parashtrimi i tij ka të bëjë me krime të cilat, sipas tij, nuk u përmendën në Aktakuzë dhe lidhur të cilat ai u informua vetëm pas daljes së Aktgjykimit.¹⁸⁹⁰ Për këtë arsye, ky parashtrim mund të merret parasysh vetëm në lidhje me sjelljen kriminale për të cilën Gjorgjeviqi u shpall përfundimisht fajtor.¹⁸⁹¹ Rrjedhimisht, në këto rrethana, nuk është me rëndësi nëse Gjorgjeviqi ia paraqiti kundërshtimet e tij Dhomës Gjyqësore, meqenëse këtu nuk bëhet fjalë për heqjen dorë nga e drejta e ngritjes së problemeve.¹⁸⁹² Gjithsesi, duke qenë se Gjorgjeviqi ngre problemin e mangësive të Aktakuzës për herë të parë në apel, ai ka detyrimin të provojë së këto mangësi kufizuan thelbësisht përgatitjen e mbrojtjes së tij.¹⁸⁹³

574. Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore mund ta shpallë një të akuzuar fajtor vetëm për krime të pretenduara në Aktakuzë.¹⁸⁹⁴ Jurisprudenca e Dhomës së Apelit ka përcaktuar qartë se, në përputhje me Statutin e Tribunalit, akuzat kundër një të akuzuari dhe

¹⁸⁸⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 107.

¹⁸⁸⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 108.

¹⁸⁸⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 109, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi II*, para. 28. Dhoma e Apelit vëren se me sa duket Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi II* përmendet gabimisht në vend të Aktgjykimit të Apelit *Muvunyi I* që për mendimin e Dhomës së Apelit është referenca e saktë.

¹⁸⁸⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 79.

¹⁸⁹⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 352, 354; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 107.

¹⁸⁹¹ Shih *Kupreshkiq dhe të tjerët* Aktgjykimi i Apelit, para. 79.

¹⁸⁹² *Krahaso* Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 313. Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 107.

¹⁸⁹³ Shih Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 142; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 25; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 35; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 31; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 200. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 51.

faktet në mbështetje të tyre duhet të parashtrohen me saktësi të mjaftueshme në Aktakuzë.¹⁸⁹⁵ Gjithsesi, jurisprudenca e TPNR-së ka qartësuar se mungesa e një akuze për një krim të pretenduar në aktakuzë në një anë dhe paqartësia e shtjellimit të fakteve juridikisht thelbësore që pretendohen në aktakuzë nga ana tjetër, janë dy probleme të ndryshme.¹⁸⁹⁶ Faktikisht, duhet të bëhet një dallim midis “pikave ose akuzave” dhe “fakteve juridikisht thelbësore”.¹⁸⁹⁷ Mangësitë që janë pasojë e mospërfshirjes së një “pikë ose akuze” në aktakuzë mund të korrigjohen vetëm përmes një ndryshimi zyrtar të Aktakuzës në përputhje me Rregullën 50 të Rregullores.¹⁸⁹⁸ Gjithsesi, të metat lidhur me paqartësi në aktakuzë si për shembull mospërmendja e një fakti juridikisht thelbësor ku bazohet një akuzë, në rrethana të caktuara dhe përmes dhënies në kohë të informacionit të qartë dhe përputhës, mund të korrigjohen në dokumentet pas aktakuzës, si për shembull në dosjet paragjyqësore, përmbledhjet për dëshmitarët dhe deklaratat e dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter.¹⁸⁹⁹ Kur kundërshtimet lidhur me aktakuzën ngrihen në fazën e apelit, Dhoma e Apelit duhet të përcaktojë nëse gabimi i procedimit penal të një të akuzuari mbi bazën e një aktakuze të mangët “zhvlerëson vendimin” e fajësisë, duke qenë se aktakuza nuk mund të ndryshohet më.¹⁹⁰⁰

575. Dhoma e Apelit kujton se një fakt mund të konsiderohet thelbësor për një akuzë varësisht nga natyra e argumenteve të Prokurorisë.¹⁹⁰¹ Cilësimi prej Prokurorisë i veprimeve kriminale të pretenduara dhe lidhjes së të akuzuarit me krimet bazë janë faktorë përcaktues të shkallës së

¹⁸⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 36; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 46; Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi I*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 28.

¹⁸⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 162; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 20; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 27; Aktgjykimi i Apelit, para. 88; *Ntabakuze* Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Bagosora dhe Nsengiyumva*, para. 96; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 200; Neni 21 i Statutit.

¹⁸⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Ntabakuze*, para. 30, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bagosora dhe Nsengiyumva*, para. 96, Aktgjykimi i Apelit *Ntawukulilyayo*, para. 189, Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 32.

¹⁸⁹⁷ *Prokurori k. Bagosora-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-98-41-AR73, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Aloys Ntabakuze-s lidhur me Çështje të Ligjit që dalin nga Vendimi i Dhomës Gjyqësore I i datës 29 qershor 2006 mbi Mocionin për Mospërfshirje të Provave, 18 shtator 2006 (“Vendimi *Bagosora* i datës 18 shtator 2006”), para. 19, përmendet *Prokurori k. Tharcisse Muvunyi-it*, Lënda Nr. ICTR-00-55A-AR73, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë të Vendimit të Dhomës Gjyqësore II të datës 23 shkurt 2005”, 12 maj 2005 (“Vendimi *Muvunyi*”). “Pika ose akuza është karakterizimi ligjor i fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet pika ose akuza. Në shtjellimin e aktakuzës, Prokuroria duhet të konkretizojë shkeljen e ndëshkueshme me ligj (pikën ose akuzën) dhe veprimet ose mosveprimet e të Akuzuarit të cilat janë bazë e pretendimit për shkeljen e ndëshkueshme me ligj (faktet thelbësore)” (Vendimi *Muvunyi*, para. 19).

¹⁸⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Ntabakuze*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Bagosora dhe Nsengiyumva*, para. 96; Vendimi *Bagosora* i datës 18 shtator 2006, para. 29; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 295-296. Shih Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 128; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1027-1028; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 32; Rregulla 50 e Rregullores.

¹⁸⁹⁹ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 163; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 114.

¹⁹⁰⁰ Neni 25(1)(a) i Statutit; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 34.

¹⁹⁰¹ Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 292; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 322; Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 17.

qartësisë së nevojshme për paraqitjen në Aktakuzë të fakteve juridikisht thelbësore për çështjen e Prokurorisë, në mënyrë që i akuzuari të informohet në kohë lidhur me to.¹⁹⁰² Në rastet kur për shkak të shkallës së gjerë të krimeve Prokuroria nuk është në gjendje t'i paraqesë të gjitha faktet thelbësore në Aktakuzë, mund të pranohet edhe informacion jo i plotë.¹⁹⁰³ Megjithatë, edhe kur paraqitja e informacionit të hollësishëm për një fakt juridikisht thelbësor është e pazbatueshme ose e pamundur, Prokuroria duhet të tregojë se zotëron një vizion më se të qartë në argumentet e veta kundër të akuzuarit dhe gjykimi duhet të nisë vetëm kur të akuzuarit i është siguruar e drejta për të qenë i informuar për çështjen kundër tij dhe për të përgatitur mbrojtjen e vet.¹⁹⁰⁴ Prej Prokurorisë pritet që të njohë provat kundër të akuzuarit/akuzuarve përpara fillimit të gjykimit dhe nuk duhet të mbështetet në mangësitë e hetimit të kryer prej saj për të përpunuar akuzat kundër të akuzuarit/akuzuarve gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.¹⁹⁰⁵

576. Një Aktakuzë është e mangët kur nuk parashtron faktet juridikisht thelbësore konkrete në mbështetje të akuzave kundër një të akuzuari.¹⁹⁰⁶ Dhoma e Apelit ka konkluduar se “një aktakuzë mund të jetë e mangët edhe kur faktet juridikisht thelbësore parashtrohen pa hollësitë e mjaftueshme, si për shembull, me përjashtim të rrethanave të posaçme, kur kuadri kohor është shumë i gjerë, kur vendndodhjet përmenden vetëm përgjithësisht, dhe viktimat janë identifikuar në terma të përgjithshme.”¹⁹⁰⁷ Sikurse theksohet më lart, efekti negativ i një aktakuze të mangët mund të “eliminohet” vetëm nëse Prokuroria i mundëson të akuzuarit me kohë informacion të qartë dhe përputhës i cili zgjidh ose sqaron paqartësitë dhe në këtë mënyrë kompenson mangësinë e Aktakuzës në mosdhënien e informacionit të duhur për akuzat.¹⁹⁰⁸ Megjithatë, në disa rrethana, vënia në dispozicion e fakteve juridikisht thelbësore përmes informacionit pas Aktakuzës mund të ndikojë në mundësinë e të akuzuarit për t'u njohur me akuzat kundër tij dhe për të përgatitur mbrojtjen e tij.¹⁹⁰⁹ Në rrethana të tilla, mundësia për

¹⁹⁰² Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 28; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 89. At ku pretendohet se i akuzuari planifikoi, nxiti, urdhëroi, ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e pretenduara, Prokuroria ka për detyrë t'i identifikojë “veprimet konkrete” apo “mënyrën konkrete të veprimit” të të akuzuarit mbi të cilat mbështetet akuza në fjalë (Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 24); Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, para. 213; Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 53; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 292; Aktgjykimi i Apelit *Seromba*, para. 27, citohet Aktgjykimi i Apelit *Nagerura dhe të tjerët*, para. 25.

¹⁹⁰³ Dhoma e Apelit ka gjykuar se “në disa raste ‘shkalla e madhe e krimeve të pretenduara e bën të pamundur konkretësinë më të imtësishme të fakteve, si identiteti i viktimave dhe koha e kryerjes së krimeve” (Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq*, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Muhimana*, para. 79, citohet Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 50 (pa citimet)).

¹⁹⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 30.

¹⁹⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 92.

¹⁹⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 28; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 114; Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 55; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 293; Aktgjykimi i Apelit *Nagerura dhe të tjerët*, para. 22; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para. 195; Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 36; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanziira*, para. 46; Aktgjykimi i Apelit *Rukundo*, para. 29.

¹⁹⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 31.

¹⁹⁰⁸ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 163; Aktgjykimi i Apelit *Simiç*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 26; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 114.

¹⁹⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*, para. 128.

korrigjimin e mangësive të aktakuzës është e kufizuar. Për shembull, zgjerimi i akuzave përmes përfshirjes së fakteve të reja thelbësore nuk duhet të çojë drejt një “transformimi radikal” të çështjes së Prokurorisë që mund të rezultojë në padrejtësi dhe paragjykim ndaj të akuzuarit.¹⁹¹⁰ Në rastet kur “faktet e reja juridikisht thelbësore janë të tilla që në vetvete mund të shërbejnë si bazë për akuza të tjera”,¹⁹¹¹ duhet të bëhet ndryshim zyrtar i Aktakuzës në përputhje me Rregullën 50 të Aktakuzës.¹⁹¹² Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit gjykon se kur aktakuza është shumë e hollësishme dhe e qartë në parashtrimin e pretendimeve për krime konkrete – për shembull, kur ofron një listë të plotë të vendndodhjeve apo përcakton saktë periudhën kohore kur kanë ndodhur krimet në ato vendndodhje – përfshirja e fakteve të reja thelbësore nga ana e Prokurorisë, si për shembull, krim i kryer në një vend dhe/apo kohë që nuk është pretenduar qartë në aktakuzë, përbën zgjerim akuzash që mund të rezultojë në padrejtësi ndaj të akuzuarit.¹⁹¹³

577. Për të përcaktuar nëse Dhoma Gjyqësore gaboi në verdiktet e fajësisë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse ngjarjet e apeluara nga Gjorgjeviqi ishin përfshirë në akuzat e Prokurorisë. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do të vlerësojë nëse: (i) Aktakuza ishte e mangët; (ii) nëse mangësia mund të korrigjohej dhe nëse u korrigjua; dhe (iii) nëse Gjorgjeviqit iu bë padrejtësi. Në kundërshtim me pretendimet e Gjorgjeviqit,¹⁹¹⁴ Dhoma e Apelit mund të marrë parasysht, ndër të tjera, informacionin e përfshirë në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë dhe në përmbledhjet dhe deklaratat e dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter.¹⁹¹⁵

578. Dhoma Gjyqësore do t’i shqyrtojë parashtrimet e Gjorgjeviqit në lidhje me çdo krim si në vijim: (i) dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme); (ii) vrasje; dhe (iii) përndjekje.

2. Dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit

579. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për dëbim (Pika 1) dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2) si krime kundër njerëzimit, të kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë, në lidhje me trembëdhjetë komuna në Kosovë.¹⁹¹⁶

¹⁹¹⁰ Shih Vendimi *Bagosora* i datës 18 shtator 2006, para. 30, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 121, Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 28.

¹⁹¹¹ Vendimi *Bagosora* i datës 18 shtator 2006, para. 30, përmendet Vendimi *Muvunyi*, para. 33, 35.

¹⁹¹² Vendimi *Bagosora* i datës 18 shtator 2006, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi I*, para. 20. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 296; Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi I*, para. 161.

¹⁹¹³ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Muvunyi I*, para. 89-100.

¹⁹¹⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 109.

¹⁹¹⁵ Më lart, para. 574.

¹⁹¹⁶ Aktgjykimi, para. 1703-1704. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimet e kryera në komunat në vijim: Rahovec; Prizren; Skënderaj; Suharekë; Pejë; Mitrovicë; Prishtinë; Gjakovë; Gjilan; Ferizaj; Kaçanik; Deçan; dhe Vushtrri (Aktgjykimi, para. 1615-1702).

580. Gjorgjeviqi apelon verdiktet e fajësisë kundër tij për dëbim dhe/ose veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me incidentet në disa vendndodhje konkrete në nëntë prej komunave,¹⁹¹⁷ duke pretenduar se këto vendndodhje nuk u përmendën në Aktakuzë.¹⁹¹⁸ Dhoma e Apelit do të shqyrtojë parashtrimet e tij lidhur me komunat përkatëse.

(a) Komuna e Prizrenit

581. Lidhur me komunën e Prizrenit, Gjorgjeviqi apelon verdiktet e fajësisë për dëbim në lidhje me incidentet në Dushanovë¹⁹¹⁹ dhe fshatin Sërbicë;¹⁹²⁰ dhe për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në Landovicë.¹⁹²¹

a. Dushanovë

582. Dhoma Gjyqësore konkludoi se “më 28 mars 1999, forcat serbe u futën në lagjen Dushanovë të Prizrenit dhe detyruan rreth 4.000-5.000 banorë të largoheshin për në Shqipëri.¹⁹²² [Dhoma Gjyqësore] më tej konkludoi se Dushanova është lagje e jashtme Prizrenit, në veri të qendrës së qytetit.¹⁹²³

583. Në Aktakuzë pretendohet se duke filluar nga 28 marsi 1999, shqiptarët kosovarë u urdhëruan që të largoheshin nga “qyteti i Prizrenit” dhe u detyruan që të shkonin drejt kufirit me Shqipërinë.¹⁹²⁴

584. Dhoma e Apelit thekson se fjala “lagje e jashtme” përgjithësisht nënkupton një “pjesë periferike të një qyteti”, “një zonë e banuar ngjitur me qytetin apo shumë afër qytetit”, ose “zonë që i përket një qyteti dhe shtrihet menjëherë jashtë mureve ose kufijve të tij”.¹⁹²⁵ Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore qartësisht e konsideroi Dushanovën si pjesë e qytetit të Prizrenit “në veri të qendrës së qytetit” dhe se Gjorgjeviqi nuk e kundërshton këtë konstatim në apel.¹⁹²⁶ Dhoma e Apelit veçanërisht thekson dëshminë e Dëshmitarit Rexhep Krasniqi, i cili dëshmoi se Dushanova dhe Prizreni ishin “të bashkuara”.¹⁹²⁷

¹⁹¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357-358. Parashtrimet e Gjorgjeviqit janë në lidhje me komunat në vijim: Prizren; Skënderaj; Gjakovë; Suharekë; Gjilan; Ferizaj; Rahovec; Pejë; dhe Deçan.

¹⁹¹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 352, 356.

¹⁹¹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 356, 357(a)(i), përmendet Aktgjykimi, para. 1626-1627, 1701, 1704.

¹⁹²⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 356, 357(a)(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 1629, 1701, 1704.

¹⁹²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 356, 358(b), përmendet Aktgjykimi, para. 1628, 1702-1704.

¹⁹²² Aktgjykimi, para. 1626.

¹⁹²³ Aktgjykimi, para. 565.

¹⁹²⁴ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹²⁵ Shih *Merriam-Webster Dictionary Online*, Unabridged (Merriam-Webster, Incorporated, 2013); *Oxford English Dictionary Online* (Oxford University Press, 2013).

¹⁹²⁶ Aktgjykimi, para. 565. Dhoma e Apelit thekson se në mbështetje të kësaj deklaratë, Dhoma Gjyqësore citon deklaratën e dëshmitarit Hysni Kryeziu, i cili përmend “fshatin” Dushanovë të komunës së Prizrenit (Prova materiale P876, f. 2). Dhoma e Apelit më tej vëren se kur përshkroi ngjarjet, Dëshmitar Krasniqi qartësisht e

585. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit është bindur se Dushanova është pjesë e qytetit të Prizrenit. Duke pasur parasysh se në Aktakuzë pretendohen faktet thelbësore në mbështetje të akuzës për dëbim nga “qyteti i Prizrenit”, Dhoma e Apelit rrjedhimisht konkludon se pretendimi për dëbim nga Dushanova përfshihet në Aktakuzë. Gjorgjeviqi nuk ka arritur të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e dëbimit lidhur me Dushanovën më 28 mars 1999.

b. Sërbicë

586. Dhoma Gjyqësore konkludoi se midis 25 dhe 30 marsit 1999, disa fshatra në komunën e Prizrenit u sulmuan dhe fshatarët u detyruan që të strehoheshin në Sërbicë, prej ku më pas, midis 9 e 16 prillit 1999 u dëbuan për në kufirin me Shqipërinë.¹⁹²⁸ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se ishte vërtetuar krimi i dëbimit nga Sërbica për periudhën 9-16 prill 1999.¹⁹²⁹

587. Në Aktakuzë pretendohet se më 25 mars 1999, disa fshatra në komunën e Prizrenit u sulmuan, dhe për pasojë, disa fshatarë u larguan në drejtim të Sërbicës.¹⁹³⁰ Në vijim theksohet: “Më pas, forcat e RFJ-së dhe Serbisë filluan një ofensivë në rrethinën e Sërbicës duke granatuar fshatrat Reti e Ulët, Reti, dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë kosovarë u përzunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë.”¹⁹³¹

588. Dhoma e Apelit kujton se Aktakuza duhet të interpretohet si një tërësi.¹⁹³² Rrjedhimisht, [Dhoma e Apelit] gjykon se në Aktakuzë pretendohen fakte juridikisht thelbësore për akuzën për dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga zona e Sërbicës pas sulmit kundër këtij fshati, i cili ishte vijim i sulmeve kundër disa fshatrave të tjera në komunën e Prizrenit të kryera disa ditë më parë që patën për pasojë largimin e shqiptarëve kosovarë. Përfundimet në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore përputhen me këtë pretendim.

589. Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka arritur të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e dëbimit lidhur me ngjarjet në Sërbicë midis 9 dhe 16 prillit 1999.

c. Landovicë

konsideron Dushanovën si pjesë e Prizrenit: “Rreth 4-5 mijë njerëz u dëbuan nga qyteti ynë. Ishte një kolonë njerëzish, si zinxhir, e gjatë rreth 19 kilometra, prej Prizrenit deri në kufi.” (Prova Materiale P848, f. 2).

¹⁹²⁷ Shih Aktgjykimi, para. 565, sh. 2088, përmendet Prova Materiale P850, f. 4922.

¹⁹²⁸ Aktgjykimi, para. 599, 1628-1629.

¹⁹²⁹ Aktgjykimi, para. 1629.

¹⁹³⁰ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³¹ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³² Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 138, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 123.

590. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua në bazë të ngjarjeve që u zhvilluan më 26 mars 1999 kur banorët e Landovicës ikën në veriperëndim dhe në jugperëndim të fshatit si pasojë e një sulmi të forcave serbe kundër këtij fshati.¹⁹³³

591. Në Aktakuzë pretendohet se më 25 mars 1999, fshatrat Piranë dhe Landovicë në komunën e Prizrenit u sulmuan dhe u dogjën.¹⁹³⁴ Konkretisht, në Aktakuzë pretendohet se “në fshatin Landovicë, një xhami e vjetër u dogj dhe u dëmtua rëndë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.”¹⁹³⁵ Në pjesët në vijim thuhet: “Disa prej shqiptarëve të Kosovës, që po iknin në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët”,¹⁹³⁶ “më pas, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një ofensivë në rrethinën e Sërbicës”,¹⁹³⁷ dhe “fshatarët shqiptarë kosovarë u përzhunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë”.¹⁹³⁸ Më tej në paragrafin 72 të Aktakuzës pretendohet se u krijua një atmosferë frike dhe shtypjeje me qëllim mundësimin e dëbimeve dhe shpërnguljeve nëpërmjet “përdorimit të forcës, kërcënimit me forcë dhe veprimeve të dhunshme” të përshkruara me hollësi në paragrafët 25-32 të Aktakuzës, ndër të tjera “djegia dhe shkatërrimi i pronave, ndër të cilat [...] i monumenteve kulturore dhe objekteve fetare”.¹⁹³⁹

592. Dhoma e Apelit gjykon se në Aktakuzë janë paraqitur pretendimet për faktet juridikisht thelbësore lidhur me krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në Landovicë. Akuza e përgjithshme në lidhje me Landovicën duhet të shqyrtohet në kuadër të Aktakuzës si tërësi ku përshkruhen një varg ngjarjesh duke filluar nga sulmet kundër fshatrave anembanë komunës së Prizrenit më 25 mars 1999 e deri tek zhvendosja e dhunshme e fshatarëve shqiptarë kosovarë në drejtim të Sërbicës.¹⁹⁴⁰ Rrjedhimisht, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se më 26 mars 1999 u krye zhvendosje e dhunshme, është në përputhje me Aktakuzën. Dhoma e Apelit më tej thekson se Landovica ndodhet në komunën e Prizrenit,¹⁹⁴¹ dhe përmendet konkretisht në Aktakuzë si një nga fshatrat që u sulmuan dhe u granatuan më 25 mars.¹⁹⁴² Gjithashtu, shkatërrimi i xhamisë në Landovicë përshkruhet në Aktakuzë si një prej “veprimeve të dhunshme” që u përdorën për “mundësimin e dëbimit” nga kjo komunë.¹⁹⁴³

¹⁹³³ Aktgjykimi, para. 1628.

¹⁹³⁴ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³⁵ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³⁶ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³⁷ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³⁸ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹³⁹ Aktakuza, para. 72. Shih Aktakuza, para. 25-32.

¹⁹⁴⁰ Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹⁴¹ Aktgjykimi, para. 588. Shih Prova Materiale P349.

¹⁹⁴² Aktakuza, para. 72(b).

¹⁹⁴³ Aktakuza, para. 72.

593. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në lidhje me Landovicën më 26 mars 1999.

(b) Komuna e Skënderajt

594. Në lidhje me komunën e Skënderajt, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë së tij për krimin e dëbimit mbi bazën e ngjarjeve në Klladërnice midis 12 dhe 15 prillit 1999;¹⁹⁴⁴ dhe verdiktin e fajësisë për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) mbi bazën e ngjarjeve në Burojë midis 25 dhe 26 marsit 1999,¹⁹⁴⁵ dhe Tushilë, më 29 mars 1999.¹⁹⁴⁶

a. Klladërnice

595. Dhoma Gjyqësore konkludoi se si pasojë e sulmeve më 25 dhe 26 mars 1999 kundër fshatrave të komunës së Skënderajt, ndër të cilët edhe Klladërnica, një grup prej 5.000 shqiptarësh kosovarë u strehuan në Izbicë, dhe që andej, gratë dhe fëmijët u dërguan në drejtim të Shqipërisë.¹⁹⁴⁷ Dhoma Gjyqësore gjykoi se ishte vërtetuar krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me Izbicën më 28 mars 1999 u vërtetua, por nuk u bind se ishte vërtetuar krimi i dëbimit, meqenëse provat nuk konfirmuan se gratë dhe fëmijët mbërritën në kufirin me Shqipërinë.¹⁹⁴⁸ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më 12 prill 1999, Klladërnica u granatua përsëri, gjë që pati për pasojë strehimin e rreth 10.000-12.000 njerëzve në shkollën e fshatit.¹⁹⁴⁹ Forcat serbe më pas i urdhëruan fshatarët që të shkonin për në Shqipëri.¹⁹⁵⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte vërtetuar krimi i dëbimit lidhur me Klladërnice më 12 prill 1999.¹⁹⁵¹

596. Gjorgjeviqi apelon vetëm fajësinë lidhur me dëbimin nga Klladërnica më 12 prill 1999.¹⁹⁵²

597. Në Aktakuzë pretendohet se “duke filluar më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date”, disa fshatra në komunën e Skënderajt, ndër të cilat edhe Klladërnica, u sulmuan dhe u

¹⁹⁴⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357(b), përmendet Aktgjykimi, para. 1634, 1701, 1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

¹⁹⁴⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(c)(i), përmendet Aktgjykimi, para. 1631, 1702-1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

¹⁹⁴⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(c)(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 1632, 1702-1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

¹⁹⁴⁷ Aktgjykimi, para. 1630-1631.

¹⁹⁴⁸ Aktgjykimi, para. 1631.

¹⁹⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1634.

¹⁹⁵⁰ Aktgjykimi, para. 1634.

¹⁹⁵¹ Aktgjykimi, para. 1634.

¹⁹⁵² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357(b), përmendet Aktgjykimi, para. 1634, 1701, 1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

shkatërruan.¹⁹⁵³ Më tej pretendohet se pas këtyre sulmeve, “më 28 mars 1999 apo rreth kësaj date, së paku 4.500 shqiptarë kosovarë prej këtyre fshatrave u mblohdën në fshatin Izbicë.”¹⁹⁵⁴ Forcat serbe i çuan gratë dhe fëmijët me dhunë si grup në drejtim të Klinës, Gjakovës dhe më në fund në kufirin me Shqipërinë.¹⁹⁵⁵

598. Dhoma e Apelit gjykon se Aktakuza përfshin faktet juridikisht thelbësore për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe dëbimit të shqiptarëve kosovarë nga fshatrat e komunës së Skënderajt, që ishin pasojë e sulmeve që filluan më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date. Megjithatë, Dhoma e Apelit thekson se përfundimet në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore lidhur me Klladërnica kanë të bëjnë me dy situata konkrete që ishin pasojë e dy incidenteve konkrete: (i) zhvendosja e dhunshme nga Izbica më 28 mars 1999 e cila ishte pasojë e sulmeve të kryera midis 25 dhe 26 marsit 1999 kundër disa fshatrave, ndër të cilat edhe Klladërnica; dhe (ii) dëbimi nga Klladërnica më 12 prill 1999 që ishte pasojë e një sulmi tjetër kundër Klladërnices që u krye tri javë më pas.¹⁹⁵⁶ Për mendimin e Dhomës së Apelit, akuza e përgjithshme në Aktakuzë ka të bëjë vetëm me përfundimin e Dhomës Gjyqësore lidhur me veprimet e tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) e rreth 5.000 shqiptarëve kosovarë nga Izbica më 28 mars 1999, dhe jo me përfundimin mbi dëbimin e rreth 10.000-12.000 shqiptarëve kosovarë nga Klladërnica më 12 prill që ndodhi në rrethana të tjera dhe u shkaktua nga një sulm i mëposhëm i forcave serbe kundër këtij fshati.

599. Për më tepër, në kundërshtim me sugjerimin e Prokurorisë, Dhoma e Apelit gjykon se thjesht argumentimi i një praktike të përsëritur ngjarjesh anëmbanë territorit të Kosovës është i pamjaftueshëm si bazë për akuzën e dëbimit në Klladërnice.¹⁹⁵⁷ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se megjithëse faktet juridikisht thelbësore lidhur me situatën e parë u parashtruan siç duhej në Aktakuzë, për rastin e dytë mungonte konkretësia e mjaftueshme. Rrjedhimisht, Aktakuza është e mangët për sa i përket dëbimit të rreth 10.000- 12.000 shqiptarëve kosovarë nga Klladërnica më 12 prill.

600. Dhoma e Apelit thekson se përmbledhjet dhe deklaratat e dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter ofrojnë njëfarë informacioni lidhur me dëshminë e një dëshmitari për një sulm kundër

¹⁹⁵³ Aktakuza, para. 72(c).

¹⁹⁵⁴ Aktakuza, para. 72(c).

¹⁹⁵⁵ Aktakuza, para. 72(c).

¹⁹⁵⁶ Krahaso Aktgjykimi, para. 1630-1631 (përmenden 5.000 shqiptarë kosovarë që u strehuan në Izbicë pas sulmeve mbi fshatra të ndryshme midis 25 dhe 26 marsit 1999) me Aktgjykimi, para. 1634 (përmenden 10.000-12.000 fshatarë që u strehuan në shkollën e Klladërnices pas sulmit kundër Klladërnices atë ditë).

¹⁹⁵⁷ Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 321, sh. 1069. Në mbështetje të argumentit të vet se dëbimi nga Klladërnica përfshihet në paragrafin 72(c) të Aktakuzës, Prokuroria parashtron se paragrafët 25-30 të Aktakuzës “identifikojnë praktikën e ngjarjeve në Kosovë: pas një sulmi të forcave serbe kundër një fshati shqiptar kosovar, fshatarët dhe personat e zhvendosur dëboheshin në kolona dhe urdhëroheshin të lëviznin drejt kufijve të Kosovës. [...] këta paragrafë u përfshinë si në pikat lidhur me dëbimin, po ashtu edhe në pikat lidhur me zhvendosjen e

fshatit Klladernicë, të kryer pas datës 28 mars 1999, si pasojë e të cilit të zhvendosurit që ishin strehuar në shkollën e fshatit u detyruan të largoheshin dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë, rreth datës 15 prill 1999.¹⁹⁵⁸ Megjithatë, Dhoma e Apelit gjykon se përmbajtja e përmbledhjeve dhe deklaratave të dëshmitarëve lidhur me këtë dëshmitar nuk ishte e mjaftueshme për ta informuar në kohë, me qartësi dhe në mënyrë përputhëse Gjorgjeviqin për fakte të reja juridikisht thelbësore që Prokuroria synonte t'i provonte në gjyq.¹⁹⁵⁹ Rrjedhimisht, mangësitë e Aktakuzës nuk u korrigjuan përmes dhënies të dokumentacionit pas aktakuzës. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi vërtetoi se aftësia e tij për të përgatitur mbrojtjen u dëmtua thelbësisht dhe se si pasojë ndaj tij u bë padrejtësi.

601. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimin e dëbimit lidhur me incidentin në Klladërnice midis 12 dhe 15 prillit 1999.

b. Burojë dhe Tushilë

602. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe kryen krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në Burojë dhe Tushilë midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999.¹⁹⁶⁰ Buroja dhe Tushila janë në komunën e Skënderajt.¹⁹⁶¹

603. Lidhur me komunën e Skënderajt, në Aktakuzë pretendohet se “duke filluar më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe shkatërruan me anë të granatimeve dhe djegies fshatrat Vojnikë, Leçinë, Klladernicë, Turiçec dhe Izbicë” dhe se “më 28 mars 1999 apo rreth kësaj date, së paku 4.500 shqiptarë kosovarë prej këtyre fshatrave u mblodhën në fshatin Izbicë nga ku gratë dhe fëmijët u largua me dhunë.”¹⁹⁶²

604. Dhoma e Apelit thekson se fshatrat e komunës së Skënderajt që u sulmuan dhe prej ku fshatarët u larguan për në Izbicë përmenden konkretisht në Aktakuzë. Aktakuza përfshin një listë të plotë fshatrash, por Buroja dhe Tushila nuk janë në mesin e tyre.¹⁹⁶³ Gjithashtu Aktakuza nuk paraqet një akuzë të përgjithshëm për sulme dhe dëbime “anëmbanë komunës”,

dhunshme (Pika 1 dhe 2)” (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 321, sh. 1069). Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 151.

¹⁹⁵⁸ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Nr. 45; Prova Materiale P. 281 (Sadik Januzi), f. 2; Prova Materiale P. 282 (Sadik Januzi), f. 7-8.

¹⁹⁵⁹ Shih *më lart*, para. 576.

¹⁹⁶⁰ Aktgjykimi, para. 1630-1632.

¹⁹⁶¹ Shih Aktgjykimi, para. 604-644, 1630-1634.

¹⁹⁶² Aktakuza, para. 72(c).

¹⁹⁶³ Shih Aktakuza, para. 72(c).

e as bën të ditur se vendndodhjet e identifikuara janë vetëm shembuj të fshatrave në komunën e Skënderajt që u sulmuan nga forcat serbe.¹⁹⁶⁴ Për këto arsye, Aktakuza ka mangësi.

605. Dhoma e Apelit vëren se, as në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë, e as në Listën e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, nuk figuron akuzë për zhvendosje të dhunshme në Burojë. Lidhur me Tushilën, në përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter përmendet informacion lidhur me një dëshmitare e cila shkoi në Tushilë pasi forcat serbe kishin granatuar fshatin e saj më 26 mars 1999, dhe më pas, së bashku me fshatarë të tjerë që ishin mbledhur në Tushilë, atë e larguan me dhunë për në Klinë, dhe më pas për në Gjakovë.¹⁹⁶⁵ Pavarësisht nga ky informacion, Dhoma e Apelit mendon se mangësitë e Aktakuzës lidhur me Burojën dhe Tushilës nuk mund të korrigjohen. Në rastin konkret, në përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter zgjerohen akuzat e parashtruara në Aktakuzë. Përfshirja e një fakti të ri juridikisht thelbësor lidhur me një fshat që nuk përmendet konkretisht në Aktakuzë çon drejt një “shndërrimi radikal” të çështjes së Prokurorisë. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi vërtetoi se aftësia e tij për të përgatitur mbrojtjen u dëmtua thelbësisht dhe se si pasojë ndaj tij u shkaktua padrejtësi.

606. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me ngjarjet në Burojë midis 25 dhe 26 marsit 1999 dhe në Tushilë më 29 mars 1999.

(c) Komuna e Gjakovës

607. Lidhur me komunën e Gjakovës, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) të bazuar në incidentet në Zhub në fillim të prillit 1999 dhe midis 27 dhe 28 prillit 1999.¹⁹⁶⁶

608. Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte vërtetuar krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me disa fshatra të komunës së Gjakovës, ndër të cilat Zhubi, në fillim të prillit 1999, kur forcat e UJ-së shkuan derë më derë në disa fshatra shqiptare kosovare në komunën e Gjakovës, “duke u thënë njerëzve të largoheshin brenda dy orësh”.¹⁹⁶⁷ Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte vërtetuar edhe krimi i dëbimit lidhur me ngjarjet më 27 dhe 28 prill 1999 në disa fshatra të komunës, përfshirë Zhubin.¹⁹⁶⁸

¹⁹⁶⁴ Shih Aktakuza, para. 72(c).

¹⁹⁶⁵ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Nr. 32.

¹⁹⁶⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365, 357(c); 358(d), përmendet Aktgjykimi, para. 1655, 1701-1704.

¹⁹⁶⁷ Aktgjykimi, para. 1655.

¹⁹⁶⁸ Aktgjykimi, para. 984, 1656-1657, ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i dëbimit u vërtetua lidhur me: Junikun, Dobroshin, Ramocin, Mejën, Orizen, Korenicën, Guskën, “dhe fshatra të tjera në këtë zonë”;

609. Në aktakuzë pasqyrohet akuza për dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) të kryera gjatë periudhës 2-4 prill 1999 në lidhje me “mijëra shqiptarë kosovarë, banorë të qytetit të Gjakovës dhe të fshatrave përreth”.¹⁹⁶⁹ Për më tepër, në Aktakuzë theksohet se “në fund të marsit dhe në prill të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i dëbuan me dhunë banorët shqiptarë kosovarë të shumë fshatrave të komunës së Gjakovës, duke përfshirë fshatrat Dobrosh, Korenicë dhe Mejë”.¹⁹⁷⁰ Aty më tej përshkruhet se si shumë prej këtyre njerëzve u urdhëruan apo u lejuan që të ktheheshin në shtëpitë e tyre, prej ku u dëbuan përsëri më 27 prill 1999 ose rreth kësaj date.¹⁹⁷¹

610. Dhoma e Apelit thekson se Zhubi është në jug të qytetit Gjakovës, në komunën e Gjakovës.¹⁹⁷² Dhoma e Apelit gjykon se dëbimi dhe veprimet e tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) kundër banorëve të Zhubit në fillim të prillit 1999 dhe më 27 dhe 28 prill 1999, figurojnë si akuzë në Aktakuzë aty ku përmendet shpërngulja e dhunshme e “banorëve shqiptarë kosovarë nga shumë fshatra të komunës së Gjakovës”.¹⁹⁷³ Aktakuza nuk ofron një listë gjithëpërfshirëse të vendndodhjeve, meqenëse fshatrat që përmenden aty janë vetëm shembuj të vendndodhjeve nga kjo komunë ku pretendohet se u kryen krime.

611. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimet e dëbimit të kryera midis 27 dhe 28 prillit 1999, dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në fillim të prillit 1999, në lidhje me fshatin Zhub.

(d) Komuna e Suharekës

612. Lidhur me komunën e Suharekës, Gjorgjeviqi apelon verdiktet e fajësisë për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) më 3 prill 1999,¹⁹⁷⁴ dhe dëbim midis 7 dhe 21 majit 1999,¹⁹⁷⁵ në qytetin e Suharekës; dhe fajësinë për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me ngjarjet në Peqan midis 21 dhe 22 marsit 1999.¹⁹⁷⁶

Aktgjykimi, para. 1701, ku përmendet edhe Zhubi si një prej vendeve në komunën e Gjakovës lidhur me të cilat u vërtetua krimi i dëbimit.

¹⁹⁶⁹ Aktakuza, para. 72(h)(i).

¹⁹⁷⁰ Aktakuza, para. 72(h)(ii).

¹⁹⁷¹ Aktakuza, para. 72(h)(ii). Në Aktakuzë pretendohet se: Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999, filloi një sulm masiv në atë zonë, ndër të tjera kundër “banorëve të mbetur të fshatrave të lartpërmendura. [...] Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkoheshin disa kolonave të refugjatëve [...] dhe më në fund kaluan në Shqipëri” (Aktakuza, para. 72(h)(ii)).

¹⁹⁷² Aktgjykimi, para. 935.

¹⁹⁷³ Aktakuza, para. 72(h)(ii).

¹⁹⁷⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(e)(i), përmendet Aktgjykimi, para. 1637, 1702-1704.

¹⁹⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357(d), përmendet Aktgjykimi, para. 1638, 1701, 1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

¹⁹⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(e)(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 1639, 1702-1704.

a. Qyteti i Suharekës

613. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) ishte pasojë e vrasjeve dhe shkatërrimit të ndërtesave në qytetin e Suharekës të kryera gjatë dy sulmeve të ndryshme: së pari më 27 dhe 28 mars 1999, pas vrasjes së të paktën 41 anëtarëve të familjes Berisha dhe shkatërrimit të xhamisë së qytetit; dhe së dyti, më 3 prill 1999, pas të shtënave dhe djegieve të shtëpive në lagjen e Gashëve në qytetin e Suharekës.¹⁹⁷⁷ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më 7 maj 1999, forcat serbe u kthyen në qytetin e Suharekës dhe plaçkitën e dogjën shtëpi.¹⁹⁷⁸ Më 21 maj 1999, forcat serbe i urdhëruan banorët e qytetit të Suharekës që të largoheshin në kolonë për në Shqipëri ngjarje për të cilën Dhoma Gjyqësore konkludoi se përbënte dëbim.¹⁹⁷⁹

614. Në Aktakuzë pretendohet se në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës, dhe “gjatë ditëve që pasuan” policët kërcënuan, sulmuan dhe vranë banorët shqiptarë kosovarë, dhe shumë prej tyre u nxorën me dhunë nga shtëpitë e tyre,¹⁹⁸⁰ dhe se shqiptarët kosovarë nga qyteti i Suharekës “u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkio drejt kufirit me Shqipërinë”.¹⁹⁸¹

615. Dhoma e Apelit gjykon se faktet juridikisht thelbësore për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe dëbimin lidhur me qytetin e Suharekës pretendohen në Aktakuzë si pjesë e fushatës së përgjithshme që synonte dëbimin e fshatarëve shqiptarë kosovarë nga komuna e Suharekës.¹⁹⁸² Megjithatë, Dhoma e Apelit vëren se megjithëse në Aktakuzë thuhet se këto ngjarje kishin ndodhur gjatë ditëve pas 25 marsit 1999 kur forcat serbe kishin rrethuar qytetin, përfundimet e Dhomës Gjyqësore përvijojnë qartësisht dy situata konkrete që rezultuan nga dy incidente të ndryshme, të cilat ndodhën brenda një intervali prej një muaji e gjysmë nga njëri-tjetri. Së pari, Dhoma Gjyqësore konkludoi se zhvendosja e dhunshme nga qyteti i Suharekës u krye më 27 dhe 28 mars¹⁹⁸³ dhe më 3 prill 1999,¹⁹⁸⁴ pas sulmeve të forcave serbe kundër qytetit. Së dyti, Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëbimi u krye midis 7 dhe 21 majit 1999, kur forcat serbe u kthyen në qytetin e Suharekës me synimin

¹⁹⁷⁷ Aktgjykimi, para. 1635-1637. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 687-695.

¹⁹⁷⁸ Aktgjykimi, para. 1638.

¹⁹⁷⁹ Aktgjykimi, para. 1638, 1701. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 700-702. Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se shpërngulja që përbënte dëbim të shqiptarëve kosovarë nga qyteti i Suharekës më 21 maj 1999 “u shkaktua nga urdhra konkretë të forcave serbe dhënë popullatës për t’u larguar dhe nga frika që shkaktuan veprimet e forcave serbe në ditët e mëparshme” (Aktgjykimi, para. 1638). Në fund, Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i dëbimit lidhur me qytetin e Suharekës u krye “midis 7 dhe 21 majit 1999” (Aktgjykimi, para. 1701).

¹⁹⁸⁰ Aktakuza, para. 72(d).

¹⁹⁸¹ Aktakuza, para. 72(d).

¹⁹⁸² Shih Aktakuza, para. 72(d).

¹⁹⁸³ Aktgjykimi, para. 1635-1636.

¹⁹⁸⁴ Aktgjykimi, para. 1637.

për t'i urdhëruar ata që kishin mbetur në qytet që të largoheshin në drejtim të Shqipërisë.¹⁹⁸⁵ Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kohën e gjatë që kishte kaluar midis dy ngjarjeve, Dhoma e Apelit gjykon se pretendimet në Aktakuzë lidhur me sulmet dhe dëbimet më 25 mars 1999 dhe ditët që pasuan, mbulojnë përfundimin e parë të Dhomës Gjyqësore lidhur me zhvendosjen e dhunshme të kryer midis 27 dhe 28 marsit 1999 dhe më 3 prill 1999. Mirëpo, ato jodomsdoshmërisht përfshijnë edhe përfundimin e dytë të Dhomës Gjyqësore lidhur me dëbimin midis 7 dhe 21 majit 1999.

616. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Aktakuza ka mangësi përse i përket dëbimit nga Suhareka midis 7 dhe 21 majit 1999.

617. Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë dhe përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter} i referohen informacionit të një dëshmitari mysliman, banor i qytetit të Suharekës në atë kohë, të cilit një polic serb i kishte thënë që të largohej nga shtëpia dhe të shkonte për në Shqipëri më 21 maj 1999.¹⁹⁸⁶ Megjithatë, Dhoma e Apelit mendon se ky informacion ishte i pamjaftueshëm për ta informuar Gjorgjeviqin me kohë dhe në mënyrë të saktë dhe të besueshme lidhur me faktet e reja juridikisht thelbësore që Prokuroria synonte t'i provonte gjatë procesit.¹⁹⁸⁷ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi arriti të vërtetonte se aftësia e tij për të përgatitur mbrojtjen u dëmtua thelbësisht dhe se për pasojë atij iu bë padrejtësi.

618. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimin e dëbimit të kryer në qytetin e Suharekës midis 7 dhe 21 majit 1999.

b. Peqan

¹⁹⁸⁵ Aktgjykimi, para. 1638.

¹⁹⁸⁶ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter}, Nr. 10.

¹⁹⁸⁷ Shih më lart, para. 576.

619. Dhoma Gjyqësore konkludoi se si rezultat i sulmeve të forcave serbe kundër shumë fshatrave në komunën e Suharekës rreth 20-21 marsit 1999, shumica e civilëve që ishin larguar nga shtëpitë e tyre u mbledhën në Bellanicë.¹⁹⁸⁸ Konkretisht, u konkludua se rreth 20-21 marsit 1999, forcat serbe granatuan fshatin me synimin e shpërngulja e popullatës së fshatit; për pasojë, popullata civile u shpërngul.¹⁹⁸⁹

620. Në Aktakuzë pretendohet se “deri më 31 mars 1999, rreth 80.000 shqiptarë kosovarë të shpërngulur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mbledhën afër Bellanicës.”¹⁹⁹⁰

621. Dhoma e Apelit gjykon se në Aktakuzë pretendohet shpërngulja nga fshatrat e komunës së Suharekës.¹⁹⁹¹ [Dhoma e Apelit] gjithashtu thekson se fshati Peqan gjendet në komunën e Suharekës, rreth dy kilometra larg qytetit të Suharekës.¹⁹⁹²

622. Për këto arsye, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me Peqanin, midis 20 dhe 21 marsit 1999.

(e) Komuna e Gjilanit

623. Lidhur me komunën e Gjilanit, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për dëbimin në Llashticë më 6 prill 1999.¹⁹⁹³

624. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 6 prill 1999, pjesëtarë të forcave serbe hynë në fshatin Llashticë, i detyruan banorët të dilnin nga shtëpitë e tyre, plaçkitën shtëpitë, dhe u vunë zjarrin.¹⁹⁹⁴ Xhamia u dëmtua rëndë dhe biblioteka e saj u shkatërrua.¹⁹⁹⁵ Në periudhën prej 6 deri më 11 prill 1999, banorët e Llashticës u shpërngulën dhunshëm përtej kufirit të Kosovës me Serbinë dhe përfundimisht në IRJM..¹⁹⁹⁶ Dhoma Gjyqësore konkludoi se kjo përbënte dëbim.¹⁹⁹⁷

625. Në Aktakuzë pretendohen disa sulme dhe dëbime të dhunshme të shqiptarëve kosovarë të kryera nga forcat serbe në vende të ndryshme anembanë komunës së Gjilanit, të cilat filluan më 6 prill 1999 ose rreth kësaj date.¹⁹⁹⁸ Konkretisht, në Aktakuzë pretendohet se “në tërë komunën e Gjilanit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht dogjën dhe shkatërruan shtëpi,

¹⁹⁸⁸ Aktgjykimi, para. 1640.

¹⁹⁸⁹ Aktgjykimi, para. 1639.

¹⁹⁹⁰ Aktakuza, para. 72(d)(i).

¹⁹⁹¹ Shih Aktakuza, para. 72(d)(i).

¹⁹⁹² Aktgjykimi, para. 704.

¹⁹⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357(e), përmendet Aktgjykimi, para. 1663, 1701, 1704.

¹⁹⁹⁴ Aktgjykimi, para. 1663

¹⁹⁹⁵ Aktgjykimi, para. 1663.

¹⁹⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1054-1061, 1663.

¹⁹⁹⁷ Aktgjykimi, para. 1663.

dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë një xhami në Llashticë”.¹⁹⁹⁹ Aty më tej pretendohet se shumica e të shpërngulurve nga Gjilani kaluan kufirin e Kosovës me Serbinë dhe më në fund shkuan në IRJM.²⁰⁰⁰ Për më tepër, në paragrafin 72, duke iu referuar paragrafëve 25-32 të Aktakuzës, pretendohet se “për kryerjen më lehtë të këtyre dëbimeve dhe shpërnguljeve, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit me forcë dhe veprimeve të dhunshme”, ndër të tjera “djegies dhe shkatërrimit të pronave, përfshirë [...] monumentet kulturore dhe objektet fetare”.²⁰⁰¹

626. Dhoma e Apelit gjykon se akuza për dëbim nga komuna e Gjilanit në Aktakuzë ngrihet në kontekstin e shpërnguljes së shqiptarë kosovarë të cilët e kaluan kufirin e Serbisë për shkak të sulmeve të ndryshme të forcave serbe në gjithë komunën e Gjilanit. Për më tepër, lidhur me sulmin kundër xhamisë në Llashticë, Dhoma e Apelit gjykon se ky është një shembull “veprimesh të dhunshme” që synonin “të lehtësonin kryerjen e dëbimeve dhe shpërnguljeve”, sikurse pretendohet në Aktakuzë.²⁰⁰²

627. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e dëbimit të kryer në Llashticë më 6 prill 1999.

(f) Komuna e Ferizajt

628. Lidhur me komunën e Ferizajt, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për krimin e dëbimit të kryer në qytetin e Ferizajt më 27 prill 1999.²⁰⁰³

629. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i dëbimit u vërtetua lidhur me ngjarjet e 27 prillit 1999, kur shqiptarët kosovarë që ishin në Ferizaj u larguan nga qyteti në drejtim të IRJM-së “sepse qëndrimi në Ferizaj ishte me shumë rrezik” dhe atyre nuk u kishte mbetur “ndonjë mundësi tjetër” përveçse të shkonin në vendin e sigurt më të afërt që ishte IRJM-ja, përtej kufirit.²⁰⁰⁴

630. Në Aktakuzë pretendohet se si pasojë e sulmeve kundër fshatrave të komunës së Ferizajt të kryera në periudhën midis 24 marsit dhe 14 prillit 1999, “personat e shpërngulur

¹⁹⁹⁸ Aktakuza, para. 72(i).

¹⁹⁹⁹ Aktakuza, para. 72(i).

²⁰⁰⁰ Aktakuza, para. 72(i).

²⁰⁰¹ Aktakuza, para. 26, 72. Shih gjithashtu Aktakuza, para. 25-32.

²⁰⁰² Aktakuza, para. 72(i), përmendet Aktakuza, para. 25-32.

²⁰⁰³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357(f), përmendet Aktgjykimi, para. 1665, 1701, 1704.

²⁰⁰⁴ Aktgjykimi, para. 1665, 1668.

shkuan në qytetin e Ferizajt, ku shumica hipën në trena të cilët i çuan në vendkalimin kufitar me Maqedoninë [IRJM].²⁰⁰⁵

631. Dhoma e Apelit thekson se në Aktakuzë akuza për dëbim nga qyteti i Ferizajt figuron si pasojë e sulmeve të kryera në të gjithë komunën e Ferizajt midis 24 marsit dhe 14 prillit 1999, dhe gjykon se kjo akuzë përputhet me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se më 27 prill 1999, në Ferizaj u krye dëbim.²⁰⁰⁶

632. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për dëbim duke u mbështetur në ngjarjet në qytetin e Ferizajt më 27 prill 1999.

(g) Komuna e Rahovecit

633. Lidhur me komunën e Rahovecit, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në lidhje me Bellacërkën,²⁰⁰⁷ Krushën e Vogël,²⁰⁰⁸ dhe Krushën e Madhe²⁰⁰⁹ më 25 mars 1999.

634. Dhoma Gjyqësore konkludoi se si pasojë e sulmeve të forcave serbe kundër fshatrave Bellacërkë, Krushë e Vogël dhe Krushë e Madhe më 25 mars 1999, banorët shqiptarë kosovarë u detyruan të largoheshin nga këto fshatra, dhe se kjo përbënte veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).²⁰¹⁰

635. Në Aktakuzë pretendohet se më 25 mars 1999, forcat serbe sulmuan fshatrat e komunës së Rahovecit, dhe për pasojë, gjatë ditëve që vijuan fshatarët u dëbuan me dhunë “në tërë komunën”.²⁰¹¹ Për më tepër, dhe konkretisht lidhur me Bellacërkën dhe Krushën e Madhe, në Aktakuzë pretendohet se “gjatë dëbimeve, në tërë komunën e Rahovecit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike dogjën shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve kosovarë.”²⁰¹² Ndër këto veprime të dhunshme ishte edhe shkatërrimi i xhamive në Bellacërkë dhe Krushë të Madhe më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date.²⁰¹³

636. Dhoma e Apelit thekson se Bellacërka, Krusha e Vogël dhe Krusha e Madhe janë në komunën e Rahovecit. Në Aktakuzë pretendohen dëbime të dhunshme “në tërë komunën” që do të thotë se aty përfshihen edhe këto fshatra.

²⁰⁰⁵ Aktakuza, para. 72(j).

²⁰⁰⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1665, 1668.

²⁰⁰⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(a)(i), përmendet Aktgjykimi, para. 1618, 1702-1704.

²⁰⁰⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(a)(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 1619-1621, 1702-1704.

²⁰⁰⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(a)(iii), përmendet Aktgjykimi, para. 1622, 1702-1704.

²⁰¹⁰ Aktgjykimi, para. 1618-1620, 1622.

²⁰¹¹ Aktakuza, para. 72(a)(i).

637. Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me këto fshatra.

(h) Komuna e Pejës

638. Lidhur me komunën e Pejës, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) kryer në Qyshk më 14 maj 1999.²⁰¹⁴

639. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 14 maj 1999, forcat serbe i detyruan fëmijët dhe gratë shqiptare kosovare që të hipnin nëpër traktorë dhe i çuan nga fshati Qyshk për në Pejë, dhe se kjo përbënte krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).²⁰¹⁵

640. Në Aktakuzë thuhet:

Pejë: Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth këtyre datave, *në qytetin e Pejës*, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkuan shtëpi më shtëpi duke detyruar shqiptarë kosovarë të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri. Në çdo rrugë u vendosën ushtarë dhe policë të cilët i drejtonin shqiptarët kosovarë drejt qendrës së qytetit. Kur njerëzit erdhën në qendrën e qytetit, ata pa vetura apo mjete transporti u detyruan të hipnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit dhe pastaj drejt kufirit me Shqipërinë. Në dalje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët kosovarë u detyruan të zbrisnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 15 kilometra deri te kufiri me Shqipërinë, ku, para se të kalonin kufirin, u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.²⁰¹⁶

641. Dhoma e Apelit vëren se pretendimi në Aktakuzë lidhur me komunën e Pejës nuk përmend fshatin Qyshk, por vetëm qytetin e Pejës.²⁰¹⁷ Megjithatë, Prokuroria parashton se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), bazuar në ngjarjet në Qyshk, akuzohet në paragrafët 25-32 dhe në paragrafin 72(e) të Aktakuzës, meqenëse Pika 2 (veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)) dhe Pika 5 (përndjekje) i përfshijnë këta paragrafë.²⁰¹⁸ Prokuroria më tej argumenton se Gjorgjeviqi u njoftua me kohë dhe mori informacion të qartë dhe përputhës nga përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas

²⁰¹² Aktakuza, para. 72(a)(i).

²⁰¹³ Aktakuza, para. 72(a)(i).

²⁰¹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(f), përmendet Aktgjykimi, para. 1643-1644, 1702-1704; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 99-100. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

²⁰¹⁵ Aktgjykimi, para. 1643-1644.

²⁰¹⁶ Aktakuza, para. 72(e) (theksi i shtuar).

²⁰¹⁷ Shih Aktakuza, para. 72(e).

²⁰¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 334, përmendet Aktakuza para. 73-76. Prokuroria më tej pretendon se “si rrjedhim, për të informuar për akuzën e zhvendosjes së paligjshme, do të ishte e mjaftueshme vënia në dijeni për zhvendosjen e dhunshme si shkelje bazë e përndjekjeve, dhe anasjelltas” (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 334, citon Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 54). Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 153.

Rregullës 65ter dhe nga dëshmitë e mëparshme të dëshmitarëve se Prokuroria do të bazohej në ngjarjet në Qyshk në mbështetje të paragrafëve 25-32 të Aktakuzës.²⁰¹⁹

642. Dhoma e Apelit vëren se Pika 2 përfshin përmes referencave paragrafët 25-32 të Aktakuzës.²⁰²⁰ Megjithatë, këta paragrafë nuk përmbajnë akuza për krimet në Qyshk apo gjetkë në komunën e Pejës. Gjithashtu, në Aktakuzë akuzohet në terma të përgjithshme për dëbime dhe shpërngulje të përhapura gjerësisht dhe sistematike “në të gjitha viset e krahinës së Kosovës”.²⁰²¹ Gjithsesi, Dhoma e Apelit gjykon se një akuzë e tillë është shumë e gjerë dhe e përgjithshme dhe nuk e informon Gjorgjeviqin në mënyrën e duhur. Po ashtu, Dhoma e Apelit vëren se ka një ndryshim prej më shumë se një muaj midis datës në Aktakuzë lidhur me ngjarjet në komunën e Pejës dhe datës në përfundimin e Dhomës Gjyqësore lidhur me fshatin Qyshk.²⁰²² Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Aktakuza ka mangësi përsa i përket krimet të veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me fshatin Qyshk.

643. Dhoma e Apelit vëren se në përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter është përfshirë informacion lidhur me ngjarjet në Qyshk nga mesi i majit 1999, i cili ndër të tjera tregon zhvendosjen e dhunshme të kryer nga forcat serbe.²⁰²³ Në përmbledhjet përmendet sulmi i forcave serbe mbi këtë fshat rreth datës 14 maj 1999, të cilat hapën zjarr dhe dogjën shtëpi, si dhe ndanë burrat nga gratë.²⁰²⁴ Duke paraqitur fakte të reja juridikisht thelbësore për ngjarjet në Qyshk në maj 1999, Prokuroria zgjeroi akuzën. Pavarësisht nga ky informacion, Dhoma e Apelit gjykon se është e pamundur që të korrigjohet mangësia e Aktakuzës lidhur me fshatin Qyshk. Paraqitja e një fakti të ri thelbësor lidhur me një fshat që nuk përmendet konkretisht në Aktakuzë, përbën “shndërrim radikal” të akuzave të Prokurorisë. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi vërtetoi se mundësia e tij për të përgatitur mbrojtjen u cenua thelbësisht dhe për pasojë atij iu bë padrejtësi.

644. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me ngjarjet në Qyshk më 14 maj 1999.

²⁰¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 334.

²⁰²⁰ Shih Aktakuza, para. 73, ku pretendohet se: “Lidhur me ata shqiptarë kosovarë të cilët u shpërngulën brenda territorit të Kosovës, Prokurori përsërit akuzat përmes përfshirjes së paragrafëve 16-33, 60-64, dhe 71-72, duke iu referuar atyre”; Aktakuza, para. 76, ku theksohet se: “Prokurori përsërit akuzat përmes përfshirjes së paragrafëve 16-33, 60-64, 72 dhe 75, duke iu referuar atyre.”

²⁰²¹ Aktakuza, para. 25.

²⁰²² Aktgjykimi, para. 1643-1644.

²⁰²³ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Nr. 11 dhe 73.

²⁰²⁴ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Nr. 11 dhe 73.

(i) Komuna e Deçanit

645. Lidhur me komunën e Deçanit, Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë për veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) të kryera në Drenoc më 26 mars 1999.²⁰²⁵

646. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe sulmuan Drenocin më 26 mars 1999, dhe se për pasojë, fshatarët e Drenocit u larguan dhe shkuan në fshatin Beleg aty afër.²⁰²⁶ Kjo përbënte veprime të tjera njerëzore (zhvendosje e dhunshme).²⁰²⁷ Dhoma Gjyqësore gjithashtu theksoi se fshati Drenoc shtrihej në pjesën qendrore të komunës së Deçanit, në afërsi të fshatit Beleg.²⁰²⁸

647. Në pjesën përkatëse të Aktakuzës pretendohen sulme të ndryshme të kryera nga forcat serbe kundër Belegut “dhe fshatrave përreth në komunën e Deçanit”.²⁰²⁹ Aty më tej pretendohet se pas këtyre sulmeve, fshatarëve u thanë që të largoheshin nga shtëpitë e tyre, të cilat më pas u plaçkitën dhe dogjën.²⁰³⁰ Shumë burra, gra e fëmijë u mblodhën në një fushë afër fshatit Beleg.²⁰³¹

648. Duke marrë parasysh se Drenoci ndodhet në pjesën qendrore të komunës së Deçanit,²⁰³² Dhoma e Apelit konkludon se vepra penale e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) kundër fshatarëve të Drenocit, ashtu sikurse konkludoi edhe Dhoma Gjyqësore, përfshihet në pretendimet në Aktakuzë se sulmet kundër “fshatrave të tjera përreth” në komunën e Deçanit i detyruan fshatarët “që të largoheshin nga shtëpitë e tyre”.²⁰³³

649. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) lidhur me ngjarjet në Drenoc më 26 mars 1999.

3. Vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit

650. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe për vrasje si krim kundër njerëzimit (Pika 3 dhe Pika 4), për vrasjet e

²⁰²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 358(g), përmendet Aktgjykimi, para. 1672, 1702-1704.

²⁰²⁶ Aktgjykimi, para. 1144, 1672.

²⁰²⁷ Aktgjykimi, para. 1672.

²⁰²⁸ Aktgjykimi, para. 1142.

²⁰²⁹ Aktakuza, para. 72(l).

²⁰³⁰ Aktakuza, para. 72(l).

²⁰³¹ Aktakuza, para. 72(l).

²⁰³² Shih Aktgjykimi, para. 1142, 1144.

²⁰³³ Aktakuza, para. 72(l).

shqiptarëve kosovarë të kryera nga forcat serbe në vende të ndryshme në shtatë komuna të Kosovës.²⁰³⁴

651. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për vrasje lidhur me katër vende konkrete krimesh: (i) qyteti i Gjakovës, më 1 prill 1999; (ii) qyteti i Podujevës më 28 mars 1999; (iii) Krushë e Vogël, më 25 mars 1999; dhe (iv) qyteti i Suharekës, më 26 mars 1999.²⁰³⁵

(a) Qyteti i Gjakovës, komuna e Gjakovës

652. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e 20 civilëve shqiptarë kosovarë në rrugën Millosh Giliq nr. 157, dhe të katër anëtarëve të familjes Cana në rrugën Millosh Giliq nr. 80, në qytetin e Gjakovës, të kryer prej forcave të MPB-së natën e 1 prillit 1999.²⁰³⁶

653. Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë lidhur me vrasjen e katër anëtarëve të familjes Cana në rrugën Millosh Giliq nr. 80.²⁰³⁷

654. Në Aktakuzë pretendohet se në mbrëmjen e 1 prillit 1999 u krye një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës, gjatë të cilit forcat serbe “hynë me forcë në shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në lagjen Qerimi, vranë banorët dhe u vunë zjarr shtëpive”.²⁰³⁸ Më tej në Aktakuzë theksohet se “mbi 50 persona u vranë” dhe si shembull përmendet vrasja e 20 shqiptarëve kosovarë në një shtëpi në rrugën Millosh Giliq nr. 157, emrat e të cilëve janë renditur në Shtojcën G të Aktakuzës.²⁰³⁹

655. Dhoma e Apelit thekson se në Aktakuzë pretendohet se nëpër “shtëpi të ndryshme në lagjen Qerimi” më 1 prill 1999 u vranë mbi 50 persona. Rrjedhimisht, [Dhoma e Apelit] gjykon se megjithëse në Shtojcën G të Aktakuzës përmenden emrat e vetëm 20 personave, të vrarë në rrugën Millosh Giliq nr. 157, përmendja e “mbi 50 persona” të vrarë në lagjen Qerimi përfshin edhe anëtarët e familjes Cana që u vranë në rrugën Millosh Giliq nr. 80, e cila gjithashtu ndodhet në lagjen Qerimi të Gjakovës.

²⁰³⁴ Aktgjykimi, para. 1753, 2193-2195. Këto vende janë: Bellacërka dhe Krusha e Vogël (komuna e Rahovecit); komuna e Suharekës; Izbica (komuna e Skënderajt); Gjakova dhe Meja (komuna e Gjakovës); komuna e Vushtrisë; Kotlina, Sllatina, Vataj, dhe Lisnaja (komuna e Kaçanikut); komuna e Podujevës (Shih Aktgjykimi, para. 1709-1752).

²⁰³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 359, përmendet Aktgjykimi, para. 1715, 1719, 1721, 1732, 1734, 1751-1753, 1956, 2143. Në lidhje me vrasjet në Podujevë dhe Krushë të Vogël, shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 100. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

²⁰³⁶ Aktgjykimi, para. 1732, 1734, 1753, 2193-2195. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 886-889, 891-892.

²⁰³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 359(a).

²⁰³⁸ Aktakuza, para. 75(g).

²⁰³⁹ Aktakuza, para. 75(g).

656. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për vrasjen e katër anëtarëve të familjes Cana në rrugën Millosh Giliq nr. 80, më 1 prill 1999.

(b) Qyteti i Podujevës në komunën e Podujevës

657. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin përgjegjës për vrasjen e dy të moshuarve shqiptarë kosovarë, Hamdi Duriqi dhe Selmon Gashi, në qytetin e Podujevës, më 28 mars 1999.²⁰⁴⁰ Ajo konkludoi se dy të moshuarit u qëlluan dhe u vranë nga forcat serbe në një kafene jashtë oborrit ku pak më vonë u vranë 14 gra e fëmijë.²⁰⁴¹ Dhoma Gjyqësore pranoi se dy burrat e moshuar “nuk ishin përmendur me emër në Aktakuzë”,²⁰⁴² por gjithsesi konkludoi se vrasja e tyre ishte pjesë e ngjarjeve që pretendohet se ndodhën në oborr më 28 mars 1999.²⁰⁴³

658. Në Aktakuzë pretendohet vrasja e “të paktën 14 anëtarëve të familjeve Bogujevci, Duriqi dhe Llugaliu, që të gjithë gra e fëmijë, në oborrin e një shtëpie në qytetin e Podujevës” më 28 mars 1999.²⁰⁴⁴ Në Aktakuzë më tej theksohet se “personat e vrarë, emrat e të cilëve dihen, përmenden në Shtojcën L.”²⁰⁴⁵ Në Shtojcën L gjenden emrat e 14 viktimave, të gjitha gra e fëmijë.²⁰⁴⁶

659. Dhoma e Apelit thekson konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se vrasja e dy burrave të moshuar, emrat e të cilëve Dhoma Gjyqësore pranoi se nuk ishin përmendur në Aktakuzë, ishte pjesë e ngjarjeve që pretendohet se ndodhën në oborrin e një shtëpie në qytetin e Podujevës më 28 mars 1999, meqenëse provat vërtetuan se vrasja kishte ndodhur jashtë oborrit ku më vonë atë ditë, forcat serbe vranë gratë dhe fëmijët.²⁰⁴⁷ Gjithsesi, Dhoma e Apelit vëren se në Aktakuzë konkretisht pretendohet se të vrarët në oborrin e një shtëpie në qytetin e Podujevës më 28 mars 1999 ishin “që të gjithë gra e fëmijë” dhe nuk përmendet vrasje burrash.²⁰⁴⁸ Duke marrë parasysh se Aktakuza përmend qartë gjininë dhe moshën e viktimave, për mendimin e Dhomës së Apelit, vrasja e dy burrave të moshuar nuk figuron si akuzë. Për këtë arsye, Aktakuza ka mangësi.

²⁰⁴⁰ Aktgjykimi, para. 1751-1753, 1956, 2143.

²⁰⁴¹ Aktgjykimi, para. 1751-1753.

²⁰⁴² Aktgjykimi, para. 1751.

²⁰⁴³ Aktgjykimi, para. 1751.

²⁰⁴⁴ Shih Aktakuza, para. 75(l).

²⁰⁴⁵ Aktakuza, para. 75(l).

²⁰⁴⁶ Aktakuza, Shtojca L, Persona të Identifikuar me Emër dhe Mbiemër, të Vrarë në Podujevë – 28 mars 1999.

²⁰⁴⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1751 (Dhoma Gjyqësore konkludoi se dy burra “u qëlluan dhe u vranë nga forcat serbe në një kafene jashtë oborrit, ku pak më vonë u qëlluan dhe u vranë 14 gratë dhe fëmijët”).

²⁰⁴⁸ Aktakuza, para. 75(l).

660. Në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë dhe në përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter} përfshihet informacion lidhur me ngjarjet që pretendohet se ndodhën në Podujevë më 28 mars 1999, i cili bazohet në dëshmitë e tre dëshmitarëve.²⁰⁴⁹ Megjithatë, për mendimin e Dhomës së Apelit, ky informacion nuk ofron hollësi konkrete të mjaftueshme në lidhje me vrasjen e dy burrave të moshuar. Për shembull, Dëshmitare Saranda Bogujevci përmendi “vëllain” e saj dhe “të afërmit e tjerë” të cilët u qëlluan dhe u vranë,²⁰⁵⁰ por meqenëse mosha e tyre dhe gjinia e “të afërmeve të tjerë” janë të papërcaktuara, ekziston mundësia që të kenë qenë gra e fëmijë, në përputhje me pretendimin në Aktakuzë. Gjithashtu, Dëshmitar Stopariqi përmendi vrasjet në Podujevë dhe tha se viktimat ishin “pothuajse të gjithë” gra e fëmijë, por ai nuk bëri të ditur kohën e këtyre ngjarjeve.²⁰⁵¹ Duke marrë parasysh se Aktakuza është mjaft konkrete lidhur me këtë pretendim – kur përmend vrasjet në oborrin e një shtëpie në qytetin e Podujevës më 28 mars 1999 dhe se viktimat ishin “që të gjithë gra e fëmijë”²⁰⁵² – Dhoma e Apelit nuk mund të konkludojë se Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë e informoi Gjorgjeviqin në masë të mjaftueshme, me kohë dhe qartësisht për faktet e reja juridikisht thelbësore që Prokuroria synonte t’i provonte gjatë procesit në lidhje me vrasjen e dy burrave të moshuar.²⁰⁵³ Për këto arsye, mangësitë e Aktakuzës nuk u korrigjuan. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi vërtetoi se mundësia e tij për të përgatitur mbrojtjen u cenua thelbësisht dhe për pasojë atij iu bë padrejtësi.

661. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e dy të moshuarve shqiptarë kosovarë, Hamdi Duriqi dhe Selmon Gashi, në Podujevë, më 28 mars 1999.

(c) Krushë e Vogël, komuna e Rahovecit

662. Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë ditës së 25 marsit 1999, forcat serbe dogjën të gjallë në shtëpitë e tyre në Krushë të Vogël nëntë fshatarë shqiptarë kosovarë që kishin refuzuar të largoheshin prej shtëpive të tyre pas një sulmi të forcave serbe.²⁰⁵⁴ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se më pas, forcat serbe detyruan një grup të madh burrash shqiptarë kosovarë që të hynin në hambarin e Batushës që ndodhej në periferi të Krushës së

²⁰⁴⁹ Dosja Paragjyqësore, para. 240, përmenden dëshmitarët Fatos Bogujevci, Saranda Bogujevci dhe Goran Stopariqi.

²⁰⁵⁰ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter}, Nr.15; Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 240.

²⁰⁵¹ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter}, Nr. 115; Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 240.

²⁰⁵² Aktakuza, para. 75(l).

²⁰⁵³ Shih më lart, para. 576.

²⁰⁵⁴ Aktgjykimi, para. 485, 1715.

Vogël, ku ata u qëlluan dhe u vranë, ose u dogjën të gjallë kur hambarit iu vu zjarri.²⁰⁵⁵ Ky operacion pati për pasojë vdekjen e 104 personave.²⁰⁵⁶

663. Në Aktakuzë pretendohet se më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat serbe sulmuan fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël, dhe sistematikisht plaçkitën dhe dogjën shtëpitë.²⁰⁵⁷ Pas sulmit, fshatarët u strehuan në shtëpinë e Sejdi Batushës e cila ndodhej në periferi të Krushës së Vogël.²⁰⁵⁸ Në mëngjesin e 26 marsit 1999, forcat serbe i gjetën fshatarët, i ndanë burrat nga gratë, dhe i mblodhën burrat dhe djemtë në këtë shtëpi.²⁰⁵⁹ Në Aktakuzë pretendohet se nga të shtënat me armë zjarri dhe djegia u vranë 105 burra dhe djem shqiptarë kosovarë.²⁰⁶⁰

664. Dhoma e Apelit vëren se kur nxori përfundimin lidhur me vrasjen e nëntë burrave, Dhoma Gjyqësore pranoi se këta persona nuk u vranë në hambarin e Batushës, sikurse pretendohet në Aktakuzë. Gjithsesi, [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se këto vrasje u kryen gjatë sulmit të forcave serbe kundër fshatit Krushë e Vogël më 25 mars 1999.²⁰⁶¹ Sidoqoftë, Dhoma e Apelit gjykon se megjithëse në Aktakuzë pretendohet qartë vrasja e rreth 105 personave më 26 mars 1999, aty nuk përmenden vrasje të kryera më 25 mars 1999 gjatë sulmit të forcave serbe kundër fshatrave Krushë e Vogël dhe Krushë e Madhe.²⁰⁶² Në aktakuzë pretendohet se më 25 mars 1999 u kryen vetëm plaçkitje dhe djegie shtëpish.²⁰⁶³

665. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykon se emrat e tre nga nëntë burrat për të cilët u vërtetua se u vranë më 25 mars 1999 përmenden në Shtojcën C të Aktakuzës e cila përmban emrat e viktimave të ngjarjeve që ndodhën më 26 mars 1999,²⁰⁶⁴ dhe jo më 25 mars 1999. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se këta tre burra pretendohet se ishin midis 105 viktimave që u vranë në hambarin e Batushës më 26 mars 1999, megjithëse në Aktakuzë nuk ka akuzë se ata u vranë më 25 mars 1999 gjatë sulmit të forcave serbe kundër fshatrave Krushë e Vogël dhe Krushë e Madhe. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se Aktakuza ka mangësi lidhur me vrasjen e nëntë burrave në Krushë të Vogël më 25 mars 1999.

666. Megjithëse në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë dhe në Listën e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65^{ter} përmendet vrasja e mbi 100 burrave dhe djemve shqiptarë kosovarë në

²⁰⁵⁵ Aktgjykimi, para. 1717.

²⁰⁵⁶ Aktgjykimi, para. 1717.

²⁰⁵⁷ Aktakuza, para. 75(c).

²⁰⁵⁸ Aktakuza, para. 75(c).

²⁰⁵⁹ Aktakuza, para. 75(c).

²⁰⁶⁰ Aktakuza, para. 75(c).

²⁰⁶¹ Aktgjykimi, para. 1715. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 485.

²⁰⁶² Shih Aktakuza, para. 75(c).

²⁰⁶³ Aktakuza, para. 75(c).

hambarin e Batushës, aty nuk është përfshirë informacion lidhur me vrasjen e nëntë burrave shqiptarë kosovarë në shtëpitë e tyre në Krushë të Vogël më 25 mars 1999.²⁰⁶⁵ Për këtë arsye, mangësitë e Aktakuzës nuk u korrigjuan. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi arriti të vërtetonte se mundësia e tij për përgatitjen e mbrojtjes së tij u cenua thelbësisht dhe për pasojë atij iu bë padrejtësi.

667. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e nëntë burrave në Krushë të Vogël më 25 mars 1999.²⁰⁶⁶

(d) Qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës

668. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 26 mars 1999, forcat e MPB-së vranë gjashtë anëtarë të familjes Berisha në afërsi të shtëpive të familjes Berisha në qytetin e Suharekës.²⁰⁶⁷ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se dy të moshuar të familjes Berisha u qëlluan dhe vranë nga forcat e MPB-së teksa po iknin nga vendi i vrasjeve.²⁰⁶⁸

669. Gjorgjeviqi apelon verdiktin e fajësisë lidhur me vrasjen e dy anëtarëve të moshuar të familjes Berisha.²⁰⁶⁹

670. Në aktakuzë përmendet vrasja e së paku 47 civilëve gjatë një aksioni të forcave serbe më 26 mars 1999, gjatë të cilit këto forca rrethuan “nga afër shtëpitë e familjes Berisha në qytetin e Suharekës”.²⁰⁷⁰ Konkretisht, në Aktakuzë pretendohet se: gjashtë anëtarë të familjes Berisha u vranë jashtë shtëpisë së tyre; anëtarët e tjerë së bashku me “tre grupe të familjes së gjerë të Berishëve” u vranë brenda në kafene; dhe “një anëtar tjetër i kësaj familjeje u soll më vonë në kafene dhe u vra.”²⁰⁷¹

671. Dhoma e Apelit vëren se vrasja e dy të moshuarve të familjes Berisha, ashtu sikurse konkludoi Dhoma Gjyqësore, ndodhi në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend që përshkruhet në Aktakuzë, ku pretendohet se “të paktën 47 civilë” u vranë gjatë këtij aksioni të kryer nga forcat serbe në afërsi të shtëpive të familjes Berisha.²⁰⁷² Rrjedhimisht, në aspektin ligjor nuk përbën element thelbësor fakti që në Aktakuzë nuk përshkruhen rrethanat e këtyre vrasjeve

²⁰⁶⁴ Shih Aktgjykimi, para. 485 (përmendet Sali Shehu, Demir Rashkaj dhe Nexhat Shehu), sh. 6121 (përmendet Aktgjykimi, Shtojcë Lista e Viktimave); Aktakuza, Shtojca C, Persona të njohur me Emër të Vrarë në Krushë të Vogël –Krushë të Madhe – 26 mars 1999.

²⁰⁶⁵ Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, para. 224.

²⁰⁶⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1715, 1717.

²⁰⁶⁷ Aktgjykimi, para. 1721.

²⁰⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1721.

²⁰⁶⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 359(d).

²⁰⁷⁰ Aktakuza, para. 75(d).

²⁰⁷¹ Aktakuza, para. 75(d).

²⁰⁷² Aktakuza, para. 75(d).

konkrete, sikurse konkludoi edhe Dhoma Gjyqësore; përkatësisht se dy të moshuarit u vranë ndërsa po iknin nga vendi i vrasjeve.²⁰⁷³

672. Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për vrasjen e dy të moshuarve të familjes Berisha në afërsi të shtëpive të familjes Berisha më 26 mars 1999.

4. Përndjekjet

673. Në Pikën 5, Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për përndjekje si krim kundër njerëzimit, të kryer nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë kosovarë gjatë periudhës së Aktakuzës, nëpërmjet veprimeve bazë të zhvendosjes së dhunshme, dëbimit, vrasjes dhe shkatërrimit të objekteve të rëndësishme fetare ose kulturore.²⁰⁷⁴

674. Gjorgjeviqi parashtroi se gabimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me krimin e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe vrasjes, vlejné edhe lidhur me verdiktet e fajësisë për krimin e përndjekjes të kryer përmes veprimeve bazë të lartpërmendura.²⁰⁷⁵ Ai gjithashtu paraqet tre pretendimet shtesë, gjegjësisht se Dhoma Gjyqësore gaboi: (i) kur e shpalli fajtor për përndjekje përmes vrasjeve kryer në Pastasellë;²⁰⁷⁶ (ii) kur përfshiu në Pikën 5 vrasje që nuk pretendohen në Pikat 3 dhe 4;²⁰⁷⁷ dhe (iii) kur e shpalli fajtor për përndjekje përmes zhvendosjes së dhunshme, duke qenë se kjo akuzë nuk ishte në Aktakuzë.²⁰⁷⁸

675. Prokuroria kërkon që Dhoma e Apelit t'i rrëzojë menjëherë pretendimet shtesë të Gjorgjeviqit si të pashtjelluara dhe të pavlera.²⁰⁷⁹

(a) Pretendim për gabime të Dhomës Gjyqësore në verdiktet e fajësisë për përndjekje lidhur me vendndodhje që nuk përmenden në Aktakuzë

676. Dhoma e Apelit konstaton se faktet juridikisht thelbësore në mbështetje të akuzës për përndjekje përmes veprimeve bazë të dëbimit, zhvendosjes së dhunshme dhe vrasjes (Pika 5) janë të njëjta me faktet që janë bazë e akuzës për dëbim (Pika 1), veprime të tjera çnjerëzore

²⁰⁷³ Aktgjykimi, para. 1721.

²⁰⁷⁴ Aktgjykimi, para. 1856. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1774-1855, 2193-2195.

²⁰⁷⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(a), përmendet Aktgjykimi, para. 1774-1783, 1789-1790, 1856.

²⁰⁷⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(b), përmendet Aktgjykimi, para. 541, 1779-1784, 1790, 1856; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 111.

²⁰⁷⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(c), përmendet Aktgjykimi, para. 1264, 2232, sh. 4872.

²⁰⁷⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(d), përmendet Aktgjykimi, para. 1763, 1775-1778, 1856; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 112.

²⁰⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 345. Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 346-348.

(zhvendosje e dhunshme) (Pika 2), dhe vrasje (Pikat 3 dhe 4).²⁰⁸⁰ Rrjedhimisht, verdiktet e fajësisë për krimet e përndjekjes përmes veprimeve bazë të lartpërmendura bazohen në të njëjtat fakte thelbësore si verdiktet e fajësisë për krimet e dëbimit, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), dhe vrasje.²⁰⁸¹ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit kujton përfundimin e saj se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për: (i) dëbim në lidhje me Klladërnican²⁰⁸² dhe Suharekën;²⁰⁸³ (ii) veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), lidhur me fshatrat Burojë dhe Tushilë,²⁰⁸⁴ dhe fshatin Qyshk;²⁰⁸⁵ dhe (iii) vrasje lidhur me ngjarjet në Podujevë²⁰⁸⁶ dhe Krushë të Vogël.²⁰⁸⁷ Dhoma e Apelit gjykon se këto gabime automatikisht ndikojnë në verdiktin e fajësisë për krimin e përndjekjes, për arsye se bazohet në njëjtat fakte thelbësore të Aktakuzës.

677. Si rrjedhojë, në bazë të të njëjtit arsyetim, Dhoma e Apelit rikonfirmon dhe zbaton këto përfundime lidhur me verdiktet e fajësisë për përndjekje përmes të njëjtave veprime bazë. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për përndjekje në lidhje me incidentet e lartpërmendura.

(b) Pretendim për verdikt të gabuar fajësie të Dhomës Gjyqësore për përndjekje nëpërmjet vrasjeve në Pastasellë të komunës së Rahovecit

678. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përfshiu ngjarjet në Pastasellë në përfundimet e saj lidhur me krimin e përndjekjes përmes veprimit bazë të vrasjes.²⁰⁸⁸

679. Prokuroria parashtron se vrasjet në Pastasellë lidheshin me akuzën e përndjekjes nga Pika 5.²⁰⁸⁹ Më tej argumentohet se në fund të fundit, Gjorgjeviqi u informua në mënyrën e duhur për këto vrasje nëpërmjet deklaratave dhe përmbledhjeve të dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, dhe ai nuk ngriti kundërshtime ndaj këtyre provave gjatë procesit gjyqësor.²⁰⁹⁰

680. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 31 mars 1999, forcat serbe vranë 106 burra në fshatin Pastasellë, në komunën e Rahovecit.²⁰⁹¹ Megjithëse pranoi se vrasja e këtyre njerëzve nuk ishte ndër akuzat e Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore e konsideroi këtë incident “të

²⁰⁸⁰ Shih Aktakuza, para. 77(a) dhe (b) (Në mbështetje të akuzës për përndjekje përmes dëbimit, zhvendosjes së dhunshme dhe vrasjes, në Pikën 5, Aktakuza u referohet paragrafëve të njëjtë të shtjelluar në mbështetje të Pikës 1 (dëbim), Pikës 2 (veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)), Pikave 3-4 (vrasje)).

²⁰⁸¹ Shih Aktgjykimi, para. 1774-1790, 1856.

²⁰⁸² Shih më lart, para. 595-601.

²⁰⁸³ Shih më lart, para. 613-618.

²⁰⁸⁴ Shih më lart, para. 602-606.

²⁰⁸⁵ Shih më lart, para. 638-644.

²⁰⁸⁶ Shih më lart, para. 657-661.

²⁰⁸⁷ Shih më lart, para. 662-667.

²⁰⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(b), përmendet Aktgjykimi, para. 541, 1779-1784, 1790, 1856; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 100. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 101-102.

²⁰⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 346; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 154.

²⁰⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 346; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 154-155.

rëndësishëm në lidhje me aspekte të tjera dhe në lidhje me akuzën për përndjekje të paraqitur në Pikën 5 të Aktakuzës”.²⁰⁹² Rrjedhimisht, [Dhoma Gjyqësore] e përfshiu incidentin e Pastasellës të datës 31 mars 1999 në përfundimet e veta lidhur me krimin e përndjekjes përmes vrasjes, në bazë të provave për veprimet diskriminuese të forcave serbe gjatë këtyre vrasjeve.²⁰⁹³

681. Dhoma e Apelit gjykon se vrasjet në Pastasellë më 31 mars 1999 nuk u përfshinë as në akuzat për vrasje (Pikat 3 dhe 4),²⁰⁹⁴ e as në pikën për përndjekje (Pika 5)²⁰⁹⁵, sikurse pranoi edhe Dhoma Gjyqësore. Për këtë arsye, Aktakuza ka mangësi.

682. Megjithatë, Dhoma e Apelit vëren se lidhur me vrasjen (Pikat 3-4) dhe përndjekjet (Pika 5), Aktakuza përmban një listë jogjithpërfshirëse të incidenteve të vrasjeve masive të cilat pretendohet se u kryen gjatë periudhës së Aktakuzës.²⁰⁹⁶ [Dhoma e Apelit] më tej thekson se në Listën e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter dhe në disa deklaratatë të dëshmitarëve është përfshirë informacion i hollësishëm dhe përputhës lidhur me vrasjen e 106 burrave shqiptarë kosovarë në Pastasellë më 31 mars 1999.²⁰⁹⁷ Dhoma e Apelit gjykon se ky informacion ishte i mjaftueshëm, i qartë dhe përputhës për Gjorgjeviqin në lidhje me faktet e reja juridikisht thelbësore që Prokuroria synonte t’i provonte gjatë procesit. Çfarëdo padrejtësie shkaktuar ndaj Gjorgjeviqit u korrigjuan me dokumentet pas aktakuzës dhe rrjedhimisht mangësitë e aktakuzës u korrigjuan.

683. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për përndjekje nëpërmjet vrasjes, duke u bazuar në vrasjet në Pastasellë më 31 mars 1999.

(c) Pretendim për gabim në përfshirjen e vrasjeve në Pikën 5

684. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore “gabimisht dhe pa arsye” përfshiu në pretendimet për përndjekje në Pikën 5 “vrasje të tjera përveç atyre të përfshira në Pikat 3 dhe 4”, dhe pretendon se këto vrasje të tjera nuk u pretenduan në Aktakuzë.²⁰⁹⁸ Gjorgjeviqi i

²⁰⁹¹ Aktgjykimi, para. 541, 546.

²⁰⁹² Aktgjykimi, para. 541, përmendet Aktgjykimi, para. 1784. Dhoma Gjyqësore përdori shprehjen “nuk akuzohet”, por në përputhje me terminologjinë e deritanishme, Dhoma e Apelit preferon shprehjen “nuk pretendohet”.

²⁰⁹³ Aktgjykimi, para. 541, 1779-1784, 1790.

²⁰⁹⁴ Aktgjykimi, para. 541. Shih Aktakuza, para. 74-75.

²⁰⁹⁵ Shih Aktakuza, para. 76-77.

²⁰⁹⁶ Aktakuza, para. 75. Shih gjithashtu Aktakuza, para. 76-77, ku nëpërmjet referencës përfshihet, ndër të tjerë, para. 75.

²⁰⁹⁷ Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Lista Nr. 76 dhe 89; Provat Materiale P908; P987; P988; D226. Shih gjithashtu Lista e Dëshmitarëve sipas Rregullës 65ter, Lista Nr. 35.

²⁰⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(c), përmendet Aktgjykimi, para. 1264, 2232, sh. 4872.

referohet përfundimit të Dhomës Gjyqësore se “gjatë periudhës së Aktakuzës, forcat serbe kryen vrasje në të paktën 14 komuna anembanë Kosovës”.²⁰⁹⁹

685. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shpërfill faktin se Pika 5 përfshin pretendime konkrete lidhur me NPK-në në paragrafët 16-33 të Aktakuzës dhe pretendime të përgjithshme lidhur me veprime të dhunshme sistematike dhe të përhapura gjerësisht, ndër të cilat vrasje, kundër shqiptarëve kosovarë në të gjithë territorin e Kosovës.²¹⁰⁰

686. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se Prokuroria “me sa duket dëshiron të ketë dorë të lirë, të pretendojë se çdo vrasje, dhe madje çdo krim, mund të përfshihet në Pikën 5”.²¹⁰¹

687. Dhoma e Apelit thekson se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se vrasje u kryen në së paku 14 komuna në mbarë Kosovën, të cilin Gjorgjeviqi e kundërshton, u nxor në kontekst të “fshehjes së kufomave”.²¹⁰² Ky përfundim nuk u përdor si bazë për konkluzionet ligjore mbi vrasjen²¹⁰³ apo përndjekjen përmes vrasjes.²¹⁰⁴ Gjorgjeviqi përfundimisht u shpall fajtor për përndjekje përmes vrasjes nga Pika 5 vetëm për vrasjet e pretenduara konkretisht si vrasje të paligjshme në Pikat 3 dhe 4. I vetmi përjashtim është incidenti në Pastasellë më 31 mars 1999, i cili u shtjellua më lart.²¹⁰⁵

688. Për më tepër, Dhoma e Apelit mendon se Gjorgjeviqi gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi edhe kur përfshiu viktimat të tjera në “Listat e Viktimave”.²¹⁰⁶ Dhoma e Apelit e gjykon të pavend këtë parashtrim. Në qoftë se Gjorgjeviqi synoi ta shfrytëzonte këtë përfundim në mbështetje të pretendimit të tij se Dhoma Gjyqësore “gabimisht dhe pa arsye” përfshiu vrasje të tjera në Pikën 5, përveç atyre të parashtruara në Pikat 3 dhe 4, atëherë ai duhej të kishte identifikuar viktimat dhe incidentet konkrete, të cilat sipas tij nuk përmendeshin në Aktakuzë, ashtu siç veproi lidhur me parashtrimet e tjera në këtë pikë të apelit të tij.²¹⁰⁷ Thjesht duke iu referuar një deklaratë të përgjithshme nga Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, ai nuk arrin të vërë bë dyshim asnjë përfundim faktik konkret dhe nuk identifikon gabimin e

²⁰⁹⁹ Aktgjykimi, para. 1264.

²¹⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 347.

²¹⁰¹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 111.

²¹⁰² Aktgjykimi, para. 1264.

²¹⁰³ Shih Aktgjykimi, para. 1709-1753.

²¹⁰⁴ Shih Aktgjykimi, para. 1779-1790.

²¹⁰⁵ Shih më lart, para. 678-683.

²¹⁰⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(c), përmendet Aktgjykimi, para. 2232. “Dhoma Gjyqësore ka shtuar dy kategori të tjera viktimash në Listat e Viktimave, përveç viktimave emrat e të cilëve përmenden në Aktakuzë. këto dy kategori të tjera janë: ‘Viktima të identifikuar me emër por që nuk janë përfshirë në Shtojcën e Aktakuzës’, dhe ‘Viktima që nuk njihen me emër dhe që nuk janë përfshirë në Shtojcën e Aktakuzës’” (Aktgjykimi, para. 2232).

²¹⁰⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 357-359, 360(a-b).

pretenduar të Dhomës Gjyqësore.²¹⁰⁸ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit hedh poshtë pretendimin e tij.

689. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për përndjekje përmes vrasjes bazuar në Pikën 5 të Statutit.

(d) Pretendim për verdikte të gabuara fajësie për përndjekje përmes zhvendosjes së dhunshme

690. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për përndjekje përmes zhvendosjes së dhunshme.²¹⁰⁹ Në mbështetje të këtij parashtrimi, ai argumenton se paragrafi 77(a) i Aktakuzës përfshin paragrafin 72 (dëbim)²¹¹⁰ përmes referencave, por nuk përfshin paragrafin 73 (veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)).²¹¹¹ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore “shpërfilli këtë kufizim”.²¹¹²

691. Prokuroria përgjigjet se argumenti i Gjorgjeviqit është i gabuar, meqenëse në paragrafin 77 të Aktakuzës, përndjekja pretendohet si përmes zhvendosjes së dhunshme, po ashtu edhe përmes dëbimit, dhe përfshin paragrafët ku janë paraqitur faktet juridikisht thelbësore, përkatësisht paragrafët 25-32 dhe 72. Rrjedhimisht, [Prokuroria] argumenton se “nuk është e domosdoshme që përmes referencave në Aktakuzë të përfshihet karakterizimi ligjor i fakteve në Pikën 2 (zhvendosje e dhunshme) dhe paragrafi 73, i cili përfshin gjithashtu përmes referencës, ndër të tjerë edhe paragrafët 25-32, dhe 72.”²¹¹³

692. Dhoma e Apelit thekson se në paragrafin 77(a) të Aktakuzës pretendohet krimi i përndjekjes përmes zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit.²¹¹⁴ Lidhur me faktet juridikisht thelbësore të paraqitura në mbështetje të kësaj akuze, në paragrafin 77(a) përmendet, ndër të tjerë, paragrafi 72 (dëbim) por nuk përmendet paragrafi 73 (veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)). Megjithatë, Dhoma e Apelit vëren se faktet juridikisht thelbësore të paraqitura në paragrafin 72 në mbështetje të Pikës 1 (dëbim)²¹¹⁵ janë të njëjta me faktet e

²¹⁰⁸ Shih më lart, para. 20.

²¹⁰⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(d).

²¹¹⁰ Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, sh. 1148. Prokuroria thekson se në paragrafin 360(d) të Dosjes së Apelit të Gjorgjeviqit ka një gabim shtypi, ku në vend të “paragrafi 7” duhet të jetë “paragrafi 72”. Dhoma e Apelit vëren se në Dosjen e Kundërpërgjigjes, Gjorgjeviqi nuk e përmend këtë.

²¹¹¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(d).

²¹¹² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 360(d).

²¹¹³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 348.

²¹¹⁴ Aktakuza, para. 77(a), ku thuhet “zhvendosja e dhunshme dhe dëbimi nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë i rreth 800.000 civilëve shqiptarë kosovarë, përshkruar në paragrafët 25-32, dhe 72.”

²¹¹⁵ Aktakuza, para. 71-72. “Prokurori përsërit akuzat përmes përfshirjes së paragrafëve 16-33 dhe 60-64, duke iu referuar atyre.” (Aktakuza, para. 71).

paraqitura në paragrafin 73 në mbështetje të Pikës 2 (veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme)), për arsye se paragrafi 73 përfshin nëpërmjet referencës paragrafin 72.²¹¹⁶

693. Dhoma e Apelit thekson se në paragrafin 77(a) të Aktakuzës pretendohet krimi i përndjekjes përmes “zhvendosjes së dhunshme dhe dëbimit nga ana e forcave të RFJ-së dhe Serbisë e rreth 800.000 civilëve shqiptarë kosovarë”.²¹¹⁷ Sidoqoftë, Dhoma e Apelit kujton se krimi i përndjekjes kushtëzon që një “veprim ose mosveprim” – dhe jo “krim”²¹¹⁸ – i cili përbën shkelje të një prej të drejtave themelore të përcaktuara në të drejtën zakonore ndërkombëtare, të jetë kryer me synim diskriminues.²¹¹⁹ Dhoma e Apelit gjithashtu citon përfundimin në Aktgjykimin e Apelit *Kërnojelac* se “veprimet e shpërnguljes së dhunshme si veprime bazë të krimit të përndjekjes, të ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) të Statutit, nuk përfshijnë vetëm shpërnguljet përtej një kufiri shtetëror”.²¹²⁰ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit gjykon se paragrafi 77(a) i Aktakuzës u referohet “zhvendosjes së dhunshme” dhe “dëbimit” si terma të përgjithshme për veprimet e “shpërnguljes së dhunshme”.²¹²¹ Mospërmendja e paragrafit 73 në paragrafin 77 të Aktakuzës nuk ndikon në pretendimet. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se faktet juridikisht thelbësore të parashtruara lidhur me krimin e përndjekjes janë përshkruar me hollësi në paragrafin 72 të Aktakuzës.

694. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arriti të provonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli fajtor për përndjekje lidhur me veprimet e shpërnguljes të akuzuara në Aktakuzë.²¹²²

C. Përfundim

695. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht pikën e gjashtëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit lidhur me:

– Dëbim (Pika 1) në:

- Klladërnice, në komunën e Skënderajt, midis 12 dhe 15 prillit 1999;²¹²³
dhe

²¹¹⁶ Aktakuza, para. 73, ku thuhet se “Lidhur me ata shqiptarë kosovarë të cilët u shpërngulën brenda territorit të Kosovës, Prokurori përsërit akuzat përmes përfshirjes së paragrafëve 16-33, 60-64, dhe 71-72, duke iu referuar atyre.”

²¹¹⁷ Aktakuza, para. 77(a).

²¹¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 322-323; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 296.

²¹¹⁹ Aktgjykimi *Deronjiq*, para. 109; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 320, 454; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 131; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 113.

²¹²⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 218.

²¹²¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 213-216.

²¹²² Dhoma e Apelit kujton se të gjitha përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përndjekjen përmes veprimeve të shpërnguljes bazohen në veprimet e pretenduara në Aktakuzë, me përjashtim të disa vendndodhjeve të shtjelluara më poshtë, Shih më lart, para. 595-601, 602-606, 613-618, 638-644, 657-661, 662-667

- qytetin e Suharekës, midis 7 dhe 21 majit 1999;²¹²⁴
- Veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2) në:
 - Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999;²¹²⁵ dhe
 - Qyshk, në komunën e Pejës, më 14 maj 1999;²¹²⁶
- Vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit (Pikat 3 dhe 4) në lidhje me:
 - dy burrat e moshuar shqiptarë kosovarë në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999;²¹²⁷
 - nëntë burrat në Krushë të Vogël, në komunën e Rahovecit, më 25 mars 1999;²¹²⁸
 - Përndjekje (Pika 5) kryer përmes:
 - *dëbimit* në Klladërnice, në komunën e Skënderajt, midis 12 dhe 15 prillit 1999;²¹²⁹ dhe në qytetin e Suharekës, midis 7 dhe 21 majit 1999;²¹³⁰
 - *zhvendosjes së dhunshme* në Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999;²¹³¹ në Qyshk, në komunën e Pejës, më 14 maj 1999;²¹³²
 - *vrasjes* në lidhje me dy burrat e moshuar shqiptarë kosovarë në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999;²¹³³ nëntë burrat në Krushë të Vogël, në komunën e Rahovecit, më 25 mars 1999.²¹³⁴

²¹²³ Shih më lart, para. 595-601.

²¹²⁴ Shih më lart, para. 613-618.

²¹²⁵ Shih më lart, para. 602-606.

²¹²⁶ Shih më lart, para. 638-644.

²¹²⁷ Shih më lart, para. 657-661.

²¹²⁸ Shih më lart, para. 662-667.

²¹²⁹ Shih më lart, para. 595-601, 676-677.

²¹³⁰ Shih më lart, para. 613-618, 676-677.

²¹³¹ Shih më lart, para. 602-606, 676-677.

²¹³² Shih më lart, para. 662-667, 676-677.

²¹³³ Shih më lart, para. 662-667, 676-677.

²¹³⁴ Shih më lart, para. 678-683, 676-677.

696. Dhoma e Apelit përmbys përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë e Gjorgjeviqit për incidentet e lartpërmendura, por lë në fuqi verdiktet e fajësisë së tij për krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasjes dhe përndjekjes. Ndikimi i këtij vendimi të Dhomës së Apelit mbi dënimin shtjellohet në pjesën e këtij Aktgjykimi lidhur me dënimin.²¹³⁵ Dhoma e Apelit hedh poshtë pjesën tjetër të pikës së gjashtëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.

²¹³⁵ Shih më poshtë, Kapitulli XX.

**XVII. PIKA E SHTATËMBËDHJETË DHE PJESËRISHT PIKA E
PEËMBËDHJETË E AELIT TË GJORGJEVIQIT: KRIMET E
DËBIMIT, VEPRIMEVE TË TJERA ÇNJERËZORE (ZHVENDOSJE E
DHUNSHME), VRASJES DHE PËRNDJEKJES LIDHUR ME DISA
VENDE KRIMESH**

A. Hyrje

697. Dhoma Gjyqësore konkludoi se u vërtetuan krimet e dëbimit (Pika 1), përndjekjes (përmes dëbimit, shpërnguljes së dhunshme, vrasjes dhe shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore) (Pika 5), dhe veprimeve të tjera çnjerezore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit (Pika 2), dhe vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe krim kundër njerëzimit (Pikat 3 dhe 4).²¹³⁶

698. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma a Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimet e dëbimit, përndjekjes, veprimeve të tjera çnjerezore (zhvendosje e dhunshme) dhe vrasjes u vërtetuan në lidhje me disa vendndodhje.²¹³⁷ Argumenti kryesor i tij është se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh konkluzione të tjera të mundshme dhe se për këtë arsye përfundimet e Dhomës Gjyqësore nuk ishin përfundimet e vetme të arsyeshme.²¹³⁸

699. Prokuroria përgjigjet se asnjë nga kundërshtimet e Gjorgjeviqit nuk plotëson kushtin e rishikimit, dhe se “disa argumente duhen rrëzuar menjëherë, meqenëse nuk mbështeten nga provat dhe janë të pashtjelluara dhe të mjegullta”.²¹³⁹ [Prokuroria] më tej shton se Gjorgjeviqi shpërfill disa përfundime faktike dhe “ofron interpretimin e tij të provave në vend të interpretimit që bëri Dhoma Gjyqësore”.²¹⁴⁰

²¹³⁶ Aktgjykimi, para. 1704, 1753, 1856.

²¹³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 364-379.

²¹³⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347(g), 362-379. Dëbim: Bellanicë, komuna e Suharekës më 1 prill 1999 dhe Vataj, komuna e Kaçanikut, më 14 prill 1999. Veprime të tjera çnjerezore (zhvendosje e dhunshme): Leçinë, komuna e Skënderajt më 25 dhe 26 mars 1999; Guskë, komuna e Gjakovës, më 27 mars 1999; Përlepticë, komuna e Gjilanit, më 6 prill 1999; Nosalë, komuna e Gjilanit, më 6 prill 1999. Vrasje: Krushë e Vogël, komuna e Rahovecit, më 25 dhe 26 mars 1999; qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës, më 26 mars 1999; Mejë, komuna e Gjakovës, më 27-28 prill 1999; komuna e Vushtrrisë, më 2/3 maj 1999; Kotlinë, komuna e Kaçanikut, më 24 mars 1999; Vataj dhe Sllatinë, komuna e Kaçanikut, më 13 prill 1999. Përndjekje: Celinë dhe Bellacërkë, komuna e Rahovecit, dhe Rogovë, komuna e Gjakovës, më 28 mars 1999; Landovicë më 26 dhe 27 mars; Xhamia e Hadumit, komuna e Gjakovës, më 24/25 mars 1999; dhe Xhamia e Llashticës, komuna e Gjilanit, më 6 mars 1999.

²¹³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 351, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365-366, 368-370, 372-375, 376(iii), 377.

²¹⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 351, përmendet Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365-366, 368-370, 372-375, 376(iii), 377.

B. Analizë

700. Dhoma e Apelit kujton se në apel, palët duhet të provojnë se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të nxirrte vendimin përkatës bazuar në provat e administruara nga Dhoma Gjyqësore.²¹⁴¹ Dhoma e Apelit kujton se “parimisht nuk është gabim në qoftë se akuzat penale provohen përmes provave rrethamore”.²¹⁴² Megjithatë, kur një pikë e apelit është kundër një deduksioni të nxjerrë për të vërtetuar një fakt mbi të cilin mbështetet verdikti i fajësisë, standardi i duhur përmbushet vetëm nëse deduksioni në fjalë ishte i *vetmi* rrjedhim i arsyeshëm që mund të nxirrej nga provat e paraqitura.²¹⁴³ Në raste të tilla, Dhoma e Apelit duhet të përcaktojë nëse dhoma gjyqësore veprimi në mënyrë të arsyeshme kur përjashtoi apo shpërfilli rrjedhime të tjera që çonin në konkluzionin se nuk ishte provuar një element krimi.²¹⁴⁴

701. Në mbështetje të argumentit të vet, Gjorgjeviqi shpesh u referohet përfundimeve në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* për të treguar se Dhoma Gjyqësore mund të kishte nxjerrë edhe rrjedhime të tjera të arsyeshme.²¹⁴⁵ Dhoma e Apelit kujton se dy gjykues të arsyeshëm faktesh mund të nxjerrin përfundime të ndryshme, por logjikisht të barazvlershme, mbi bazën e të njëjtave prova.²¹⁴⁶ Një gabim nuk mund të vërtetohet vetëm duke theksuar se dhoma të tjera gjyqësore kanë ushtruar kompetencat e tyre të brendaqenësishme në një mënyrë të ndryshme.²¹⁴⁷ Gjithsesi, Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë parashtrimet konkrete të Gjorgjeviqit dhe do të vlerësojë nëse përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin të arsyeshme në bazë të dokumentacionit gjyqësor të kësaj çështjeje.

1. Pretendim për gabime lidhur me krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit

702. Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentet e Gjorgjeviqit lidhur me krimin e dëbimit, i cili u vërtetua në lidhje me (i) Bellanicën, komuna e Suharekës; dhe (ii) Vatajn, komuna e Kaçanikut.²¹⁴⁸ Dhoma e Apelit gjithashtu do të shqyrtojë argumentet e Gjorgjeviqit lidhur me krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në: (i) Leçinë, komuna e

²¹⁴¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 10; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 9; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 9.

²¹⁴² Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 218. Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 303.

²¹⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 220; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458.

²¹⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 18.

²¹⁴⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 363, 365, 366, 369, 370(ii), 372, 376; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 113.

²¹⁴⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 12.

²¹⁴⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 12.

Skënderajt; (ii) Guskë, komuna e Gjakovës; (iii) Përlepnice, komuna e Gjilanit; dhe (iv) Nosalë, komuna e Gjilanit.²¹⁴⁹

703. Para se të shqyrtojë apelimet konkrete të Gjorgjeviqit në lidhje me krimet e dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), Dhoma e Apelit do të analizojë disa argumente të përgjithshme të Gjorgjeviqit që kanë të bëjnë me përkufizimin ligjor të këtyre krimeve.²¹⁵⁰ Gjorgjeviqi e arsyeton pretendimin e tij se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shpërfilli deduksione të tjera të mundshme, me argumentin se Prokuroria nuk arriti të vërtetonte se UÇK-ja nuk ishte në afërsi²¹⁵¹ dhe se nuk ishte sulm legjitim me objektiv UÇK-në.²¹⁵² Sipas, Gjorgjeviqit, mbetet të konkludohej se popullata u largua për arsye të ligjshme.²¹⁵³

704. Më poshtë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë parashtrimet e Gjorgjeviqit në lidhje me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ekzistonte një plan i përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës me qëllim që të sigurohej kontrolli serb mbi gjithë territorin e krahinës, përfundim ky që u confirmua nga Dhoma e Apelit.²¹⁵⁴ Ky synim do të realizohej përmes terrorizimit të popullatës shqiptare kosovare për ta bërë që të largohej nga Kosova, me anë të një fushate terrori e cila, për të cilën Dhoma Gjyqësore konkludoi se u zbatua nga forcat serbe, ndër të cilat MPB-ja dhe forcat e tjera vartëse.²¹⁵⁵ Pikërisht, sulmet e forcave serbe ishin instrumenti që u përdor për kryerjen e krimit të dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në përputhje me planin e përbashkët.²¹⁵⁶ Për këtë arsye, natyra e këtyre sulmeve nuk duhet analizuar ndaras por në kontekst të praktikës së përdorimit të forcës së tepruar nga ana e forcave serbe gjatë sulmeve kundër fshatrave, sikurse u shtjellua me hollësi nga Dhoma Gjyqësore dhe u la në fuqi nga Dhoma e Apelit.²¹⁵⁷ Pavarësisht nga ligjshmëria apo paligjshmëria e tyre, këto sulme ishin instrumenti për zbatimin e planit të përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës.²¹⁵⁸

705. Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se elementët e përbashkët të dëbimit dhe veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) janë: (i) shpërngulja e detyruar e individëve; (ii) të

²¹⁴⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 364-366.

²¹⁴⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 367-370.

²¹⁵⁰ Gjorgjeviqi parashtron këtë argument lidhur me krimin e dëbimit në: Bellanicë, komuna e Suharekës (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365); Vataj, komuna e Kaçanikut (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 366). Ai më pas e parashtron këtë argument edhe lidhur me krimin e veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në: Leçinë, komuna e Skënderajt, (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 368); Përlepnice, komuna e Gjilanit (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 370(i)).

²¹⁵¹ Shih p.sh. Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 115.

²¹⁵² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 366.

²¹⁵³ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365-366, 368, 370(i); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 116.

²¹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 1683, 2005, 2025. Shih Aktgjykimi, para. 1631, 1641, 1653, 1658, 1662, 1671.

²¹⁵⁵ Aktgjykimi, para. 2025.

²¹⁵⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1697, 2007, 2026, 2131-2152, 2193, 2213, 2131-2152. Shih më lart, Kapitulli X-XI.

²¹⁵⁷ Shih më lart, para. 97-98, 173-208, 515-527.

²¹⁵⁸ Shih më lart, para. 97-98, 138-139, Kapitulli X.

cilët ndodhen në mënyrë të ligjshme në zonën nga e cila më pas shpërngulen; (iii) e drejta ndërkombëtare nuk ofron arsye lejuese për shpërnguljen; dhe (iv) kryhet qëllimisht.²¹⁵⁹ Dhoma e Apelit thekson se Prokuroria duhet të provojë elementët e krimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, ndër të tjera se shpërngulja u krye për arsye të palejueshme sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare. Gjithsesi, nuk ekziston detyrim ligjor që të provohet se sulmi që shkaktoi shpërnguljen ishte i paligjshëm, apo se UÇK-ja nuk ishte e pranishme në atë zonë. Megjithëse shpërnguljet e detyruara në disa raste mund të përlligjen në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, rrethana të tilla janë të kufizuara.²¹⁶⁰ Dhoma e Apelit do t'i marrë parasysh këto përfundime gjatë shtjellimit të parashtrimeve të Gjorgjeviqit lidhur me çdo vendndodhje dhe për çdo rast do të zbatojë parimet ligjore të lartpërmendura.

(a) Bellanicë, komuna e Suharekës

706. Dhoma Gjyqësore u bind se krimi i dëbimit u vërtetua në lidhje me Bellanicën, në komunën e Suharekës, më 1 prill 1999, nga veprimet e forcave serbe të cilat vranë tre burra në fshat, kërcënuan fshatarët, dogjën shtëpitë dhe vranë bagëtitë.²¹⁶¹

707. Gjorgjeviqi parashtron se, duke marrë parasysh urdhrin e UÇK-së për evakuim sipas të cilit popullata civile duhej të tërhiqej së bashku me UÇK-në në male, asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të mund të bënte veprimet e forcave serbe shkakuar të lëvizjes së njerëzve.²¹⁶² Ai më tej pretendon se UÇK-ja “ishte e pranishme në Bellanicë dhe/ose në afërsi të saj”.²¹⁶³

708. Në përgjigjen e vet, Prokuroria argumenton se provat mbështesin përfundimin e Dhomës Gjyqësore se popullata u largua nga Bellanica për shkak të veprimeve të forcave serbe.²¹⁶⁴ Prokuroria më tej parashtron se argumentet e Gjorgjeviqit duhen rrëzuar menjëherë,

²¹⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 304; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 278, 307. Shih Aktgjykimi, para. 1604, 1613. Shih gjithashtu më lart, para. 532-538. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore gabimisht theksoi se elementët e krimit të zhvendosjes së dhunshme kushtëzojnë që “shpërngulja e dhunshme e njerëzve të ndodhë brenda kufijve shtetërorë” (Aktgjykimi, para. 1613, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 317, përmendet Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 521, Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 474, 476). Faktikisht, jurisprudenca ka përcaktuar se shpërngulja mund të ndodhë brenda kufijve shtetërorë, por nuk është aq e kufizuar (Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 317).

²¹⁶⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 284-285, 287. E drejta humanitare ndërkombëtare përcakton se shpërnguljet mund të përlligjen: (i) “për arsye që lidhen me konfliktin” në raste kur, ndër të tjera, “siguria e civilëve në fjalë apo nevojat e domosdoshme ushtarake diktojnë shpërngulje” (Neni 17 i Protokollit Shtesë II); (ii) kur forcat pushtuese bëjnë evakuimin e plotë apo të pjesshëm të një zone për shkak të sigurisë së popullatës apo nevojave të domosdoshme ushtarake (Neni 49 i Konventës së Gjenevës IV); dhe (iii) kur ka të bëjë me largimin e robërve të luftës nga zona e luftimeve dhe në objekte internimi, në varësi të kushteve të shumta (Neni 19 i Konventës së Gjenevës III).

²¹⁶¹ Aktgjykimi para. 716, 1641, 1701, 1704. Shih Aktgjykimi, para. 710-726.

²¹⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365.

²¹⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 365.

²¹⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 352.

meqenëse ai thjesht përsërit parashtrime të pasuksesshme të paraqitura gjatë gjyqimit dhe shpërfill përfundimet faktike përkatëse.²¹⁶⁵

709. Në nxjerrjen e përfundimit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh provat konkrete që sugjeronin se UÇK-ja lëshoi një urdhër evakuimi për popullatën civile “për arsye sigurie” me qëllim që civilët “të mos mbeteshin në mes të luftimeve”.²¹⁶⁶ Megjithatë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se fshatarët nuk iu bindën këtij urdhri dhe se në të kundërt, ata iu dorëzuan forcave serbe të cilat i urdhëruan që t’i bashkoheshin kolonës së drejtuar prej forcave serbe për në kufi me Shqipërinë, se ndryshe do të vriteshin.²¹⁶⁷ Gjorgjeviqi i shpërfill këto përfundime dhe nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore bëri interpretim të gabuar të urdhrin të UÇK-së për evakuim. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se thjesht duke deklaruar se UÇK-ja ishte në Bellanicë dhe/ose në afërsi të saj, Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë gabim të Dhomës Gjyqësore.²¹⁶⁸

710. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si Dhoma Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i dëbimit u vërtetua në lidhje me Bellanicën.

(b) Vataj, komuna e Kaçanikut

711. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i dëbimit u vërtetua në lidhje me Vatajn, në komunën e Kaçanikut, më 14 prill 1999.²¹⁶⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe mbërritën në Vataj më 13 prill 1999 dhe hapën zjarr kundër fshatit duke i frikësuar fshatarët të cilët nga frika fillimisht ikën në malet e Lubotenit dhe më pas në IRJM.²¹⁷⁰ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se banorët e fshatit u larguan edhe për arsye se kishin parë kufomat e Mahmut Cakës, Hebib Lamit, Brahim Lamit, dhe Rraman Lamit, dy nga të cilat ishin gjymtuar keqazi.²¹⁷¹ Dhoma Gjyqësore gjykoi se katër viktimat ishin kapur në Vataj, ishin zënë rob, ishin ndaluar dhe ishin nxjerrë në tërë fshatin si robër më herët atë ditë dhe më pas ata u vranë nga forcat serbe në Sllatinë.²¹⁷²

²¹⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 352.

²¹⁶⁶ Aktgjykimi, para. 716. Shih Aktgjykimi, para. 1641.

²¹⁶⁷ Aktgjykimi, para. 716, 1641.

²¹⁶⁸ Shih më lart, para. 700, 704.

²¹⁶⁹ Aktgjykimi, para. 1138-1139, 1671, 1701, 1704. Shih Aktgjykimi, para. 1747.

²¹⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1138, 1671, 2048.

²¹⁷¹ Aktgjykimi, para. 1138, 1671, 1747.

²¹⁷² Aktgjykimi, para. 1671, 1747. Dhoma e Apelit vëren se Gjorgjeviqi apelon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se këta katër burra ishin të ndaluar kur u vranë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 376(iv), përmendet Aktgjykimin, para. 1747, 1138-1139. Dhoma e Apelit do ta shqyrtojë këtë kundërshtim më poshtë (Shih më poshtë, para. 783-790).

712. Gjorgjeviqi parashtron se nuk kishte prova se sulmi kundër fshatit Vataj nuk ishte i ligjshëm dhe kundër UÇK-së, apo se kufomat për të cilat Dhoma Gjyqësore gjykoi se ishin arsyeja e largimit të fshatarëve, ishin kufoma civilësh të vrarë nga forcat serbe.²¹⁷³

713. Prokuroria përgjigjet se parashtrimet e Gjorgjeviqit duhen rrëzuar menjëherë, meqenëse ai shpërfill përfundimet faktike përkatëse, si për shembull përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ushtarët e UÇK-së u larguan nga fshati Vataj një ditë para se fshati të sulmohej nga forcat serbe.²¹⁷⁴

714. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se mbetet konkluzioni që UÇK-ja të ketë qenë e pranishme, pavarësisht se “UÇK-ja mund të ishte larguar nga fshati pak para fillimit të sulmit të forcave serbe”.²¹⁷⁵

715. Dhoma e Apelit gjykon se thjesht duke deklaruar se nuk kishte prova që vërtetonin se sulmi kundër Vatajt ishte i ligjshëm dhe kishte objektiv UÇK-në, Gjorgjeviqi nuk vërteton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim. Gjithashtu, Dhoma e Apelit thekson se sulmi kundër Vatajt ishte vetëm një nga sulmet e shumta që ishin pjesë e planit të përbashkët për ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës, ndër të tjera përmes shpërnguljes së shqiptarëve kosovarë.²¹⁷⁶

716. Gjorgjeviqi gjithashtu sugjeron se katër burrat që u vranë ishin luftëtarë dhe rrjedhimisht objektiva të ligjshme.²¹⁷⁷ Ai më tej argumenton se konkluzioni se popullata u largua nga frika nuk mbështetet nga provat.²¹⁷⁸ Dhoma e Apelit e gjykon jovendimtar aspektin nëse këta katër persona ishin civilë apo luftëtarë. Dhoma Gjyqësore me arsye gjykoi se kufomat e gjymtuara të burrave të veshur me rroba civile të cilët paraprakisht ishin parë të gjallë dhe ishin nxjerrë nëpër fshat, ndikuan në frikësimin e popullatës dhe e bënë që të largohej nga fshati.²¹⁷⁹ Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se pamjet e kufomave të gjymtuara ishte vetëm një prej faktorëve që mori parasysh Dhoma Gjyqësore. Konkretisht, Dhoma Gjyqësore gjykoi se popullata civile u largua në male edhe nga frika e shkaktuar nga krismat e forcave serbe kur mbërritën në fshatin Vataj.²¹⁸⁰ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore arriti në

²¹⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 366.

²¹⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 353.

²¹⁷⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 115.

²¹⁷⁶ Shih më lart, para. 173 (përfshirë referencat), 202-203.

²¹⁷⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 366; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 115. Kur konkludoi se katër burrat shqiptarë kosovarë nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u vranë, Dhoma Gjyqësore mori parasysh provat që dëshmonin se ata ishin shqiptarë kosovarë “të veshur me veshje civile dhe të paarmatosur” (Aktgjykimi, para. 1138-1139). Dhoma e Apelit kujton se veshja e viktimave mund të merret parasysh kur përcaktohet nëse një viktimitë konkrete ka marrë pjesë në luftime në kohën e vdekjes (Shih Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 81; Shih më lart, para. 525).

²¹⁷⁸ Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 115.

²¹⁷⁹ Aktgjykimi, para. 1138, 1671, 1747. Dhoma e Apelit thekson se kundërshtimet e Gjorgjeviqit në lidhje me marrjen parasysh prej Dhomës Gjyqësore të dëshmisë së Sada Lamës për këtë incident do të shqyrtohen më poshtë (Shih më poshtë, para. 783-790).

²¹⁸⁰ Aktgjykimi, para. 1137-1138.

konkluzionin e arsyeshëm se popullata civile u largua nga frika e shkaktuar nga të shtënat e forcave serbe teksa hynë në Vataj dhe nga pamjet e kufomave të gjymtuara.

717. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si Dhoma Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se në lidhje me fshatin Vataj u vërtetua krimi i dëbimit.

(c) Leçinë, komuna e Skënderajt

718. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua lidhur me fshatin Leçinë të komunës së Skënderajt më 25 dhe 26 mars 1999, si pasojë e të shtënave, granatimeve dhe djegies së shtëpive nga forcat serbe.²¹⁸¹

719. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh ose përjashtoi rrjedhimin se UÇK-ja ishte e pranishme në fshat dhe përbënte objektiv të ligjshëm për forcat serbe.²¹⁸²

720. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shpërfill provat në lidhje me sulmin e forcave serbe kundër Leçinës.²¹⁸³

721. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se, meqenëse Prokuroria nuk vërtetoi se në Leçinë nuk kishte prani të UÇK-së apo të paktën se nuk besohej se kishte prani të UÇK-së në fshat, mbetet mundësia që ai të lirohej nga fajësia për këtë incident.²¹⁸⁴

722. Sikurse u theksua më lart, thjesht sugjerimi i Gjorgjeviqit se UÇK-ja ishte e pranishme dhe ishte objektiv i ligjshëm, nuk provon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përjashtoi deduksionin e mundshëm se popullata në Leçinë u largua për arsye të ligjshme.²¹⁸⁵

723. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e njëjtë me atë të Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se lidhur me Leçinën u vërtetua krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme).

²¹⁸¹ Aktgjykimi, para. 607, 1630-1631, 1702, 1704.

²¹⁸² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 368.

²¹⁸³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 355.

²¹⁸⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 116.

²¹⁸⁵ Shih më lart, para. 700, 704.

(d) Guskë, komuna e Gjakovës

724. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua lidhur me Guskën, komuna e Gjakovës, më 27 mars 1999.²¹⁸⁶ U konkludua se forcat e UJ-së “dëbuan banorët e fshatit Guskë dhe i detyruan t’i bashkoheshin një kolone prej rreth 1.000 shqiptarësh kosovarë që ishin dëbuar nga fshatrat fqinje”.²¹⁸⁷

725. Gjorgjeviqi parashtroi se meqenëse nuk kishte prova lidhur me përdorimin e dhunës apo forcës kundër popullatës civile në Guskë, mbetet të deduktohej se këta persona nuk u “dëbuan” por u “evakuuan” nga zona e luftimeve.²¹⁸⁸

726. Prokuroria përgjigjet se nuk ka nevojë të vërtetohet se u ushtrua dhunë apo forcë, dhe se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se forcat serbe dëbuan banorët e Guskës.²¹⁸⁹

727. Dhoma e Apelit kujton se shpërngulja e detyruar kushtëzon, ndër të tjera, mungesën e lirisë së njëmendtë të zgjedhjes për viktimat,²¹⁹⁰ e cila “përveç forcës fizike përfshin edhe kërcënimin për përdorimin e forcës ose shtrëngimit si ajo e shkaktuar nga frika nga dhuna, shtrëngimi, arrestimi, dhuna psikologjike apo shpërdorimi i pushtetit ndaj një personi ose personave të tillë, apo ndaj një personi tjetër, ose duke përfituar nga rrethanat shtrënguese”.²¹⁹¹ Megjithëse frika nga dhuna, apo përdorimi i forcës dhe rrethana të tjera të ngjashme mund të krijojnë një atmosferë të tillë ku nuk ka zgjidhje tjetër përpos largimit, duke shkaktuar si rrjedhojë shpërngulje të detyruar, për të përcaktuar nëse të zhvendosurit kanë pasur liri të njëmendtë zgjedhjeje, duhen marrë parasysh rrethanat e çështjes konkrete.²¹⁹²

728. Për nxjerrjen e përfundimit të vet, Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se forcat serbe fillimisht u thanë banorëve të fshatit të shkonin në Shqipëri, por pastaj i nisën në drejtim të Korenicës ku ata ndenjën një javë dhe më pas u urdhëruan që të largoheshin dhe t’i bashkoheshin kolonës prej rreth 1.000 shqiptarësh kosovarë të cilët ishin dëbuar nga fshatrat fqinje.²¹⁹³ E gjithë kjo ndodhi pas vrasjes së disa civilëve në fshatrat fqinje më 25 mars prej të njëjtave forca të cilat më pas, më 27 mars, mbërritën në Guskë dhe i dëbuan fshatarët.²¹⁹⁴ Gjorgjeviqi nuk identifikon asnjë provë apo përfundim të Dhomës Gjyqësore në mbështetje të argumentit të tij, por thjesht spekulon se mund të nxirrej përfundimi se banorët e fshatit u

²¹⁸⁶ Aktgjykimi, para. 1653, 1702, 1704.

²¹⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1653. Shih Aktgjykimi, para. 930.

²¹⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 369; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 117.

²¹⁸⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 356.

²¹⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 279, 282; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 229.

²¹⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 281, përmendet Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 475.

²¹⁹² Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 281-282.

²¹⁹³ Aktgjykimi, para. 930, 1653.

²¹⁹⁴ Aktgjykimi, para. 927-928, 930.

“evakuuan” dhe nuk u “dëbuan”. Spekulimi për një përfundim tjetër nuk plotëson standardin e nevojshëm të rishqyrtimit.²¹⁹⁵

729. Për këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim me atë të Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua lidhur me fshatin Guskë.

(e) Përlepticë, komuna e Gjilanit

730. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua lidhur me ngjarjet në fshatin Përlepticë të komunës së Gjilanit më 6 prill 1999.²¹⁹⁶ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se 3.000 fshatarë shqiptarë kosovarë dhe romë u larguan nga fshati pasi forcat serbe i kishin kërcënuar se fshati do të minohej dhe i kishin urdhëruar që të largoheshin, kurse rreth pesë ose gjashtë familje serbe nuk u larguan por mbetën në Përlepticë.²¹⁹⁷

731. Gjorgjeviqi parashtron se mund të nxirrej përfundimi se fshatarët nga Përlepnica u “evakuuan” dhe nuk u “dëbuan”.²¹⁹⁸ Ai më tej i referohet përfundimit të Dhomës Gjyqësore se në atë zonë kishte prani të UÇK-së.²¹⁹⁹

732. Prokuroria përgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i logjikshëm.²²⁰⁰ Argumentohet se thjesht duke përsëritur argumente të dështuara të paraqitura në gjykim, Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore gaboi.²²⁰¹ Prokuroria thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se vetëm shqiptarët kosovarë dhe romët e fshatit u urdhëruan të largoheshin, kurse fshatarët serbë qëndruan në Përlepticë.²²⁰²

733. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se vetëm fshatarët shqiptarë kosovarë dhe romë u urdhëruan të largoheshin nga fshati, ndërsa familjet serbe mbetën në fshat, nuk është vendimtar.²²⁰³ Ai pretendon se mund të konkludohej se fshatarët shqiptarë kosovarë dhe romë “ndihmuan materialisht dhe përkrahën UÇK-në në atë zonë”.²²⁰⁴

²¹⁹⁵ Shih më lart, para. 700, 704.

²¹⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1658, 1702, 1704.

²¹⁹⁷ Aktgjykimi, para. 1015, 1022, 1024, 1658, 1702, 1704. Shih Aktgjykimi, para. 1016-1023.

²¹⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 370(i).

²¹⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 370(i).

²²⁰⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 357.

²²⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 357, përmendet Dosja Përfundimtare të Gjorgjeviqit, para. 847-848.

²²⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 357.

²²⁰³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 118.

²²⁰⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 118.

734. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi argumentin e Gjorgjeviqit të parashtruar gjatë gjykimit se fshatarët u evakuuan nga Përlepnica për hir të sigurisë së tyre, por konkludoi se provat nuk mbështesnin konkluzionin se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë apo “minimi i fshatit do të bëheshin duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare.”²²⁰⁵ Dhoma Gjyqësore gjykoi se forcat serbe i kërcënuan fshatarët se fshati do të minohej dhe se vetëm shqiptarët kosovarë dhe romët u larguan nga fshati, kurse “familjet serbe vendase qëndruan në Përlepticë”.²²⁰⁶ Megjithëse shpërnguljet mund të jenë të justifikueshme në qoftë se kryhen për sigurinë e popullatës civile,²²⁰⁷ sikur të kishte ekzistuar me të vërtetë shqetësim për sigurinë e fshatarëve, do të ishin evakuuar edhe pesë-gjashtë familjet serbe që jetonin asokohe në Përlepticë.²²⁰⁸ Dhoma e Apelit rrjedhimisht konkludon se Dhoma Gjyqësore me arsye përjashtoi rrjedhimin se ekzistonte shqetësim i sinqertë për mirëqenien e popullatës civile.

735. Dhoma e Apelit gjithashtu mendon se pretendimi i Gjorgjeviqit se në afërsi të fshatit kishte prani të UÇK-së dhe se ka të ngjarë që fshatarët ta kenë ndihmuar materialisht dhe përkrahur moralisht sugjeron se vendosja e minave ishte e ligjshme, dhe se rrjedhimisht shpërngulja e 3.000 banorëve ishte e lejueshme sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare, për të provuar se përfundimi i Dhomës Gjyqësore nuk ishte i arsyeshëm.²²⁰⁹ Gjorgjeviqi nuk e mbështet këtë pretendim në fakte. Dhoma e Apelit thekson se edhe sikur të vërtetohej se civilët e ndihmuar materialisht dhe moralisht UÇK-në, kjo nuk do ndryshonte automatikisht statusin e mbrojtur të tyre. Për më tepër, edhe sikur disa fshatarë të kenë qenë me të vërtetë anëtarë të UÇK-së, për arsyet e lartpërmendura, kjo nuk do të mund të justifikonte shpërnguljen e 3.000 banorëve shqiptarë kosovarë dhe romë nga fshati Përlepticë.²²¹⁰

736. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua në lidhje me Përlepticën.

(f) Nosalë, komuna e Gjilanit

737. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua në lidhje me ngjarjet më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date në fshatin

²²⁰⁵ Aktgjykimi, para. 1658.

²²⁰⁶ Aktgjykimi, para. 1022, 1024.

²²⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 284-285, citon Protokollin Shtesë II, Neni 17.

²²⁰⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1015, 1017.

²²⁰⁹ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 370(i).

²²¹⁰ Shih më lart, para. 704-705.

Nosalë, në komunën e Gjilanit.²²¹¹ U konkludua se forcat serbe sulmuan Nosalën që pati për pasojë largimin e banorëve të fshatit.²²¹²

738. Gjorgjeviqi parashtron se nuk ka prova se “çfarë dhe nëse ndodhi diçka” në Nosalë.²²¹³

739. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shtrembëron dokumentacionin gjyqësor kur parashtron se nuk ka prova, dhe parashtron se argumentet e tij duhen rrëzuar menjëherë duke qenë se ai nuk identifikon asnjë gabim.²²¹⁴

740. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim se shpërngulja e shqiptarëve kosovarë ishte pasojë e sulmit kundër fshatit Nosalë dhe nuk mori parasysh “çfarë ndodhi në fshat”.²²¹⁵

741. Në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova të shumta lidhur me rrethanat në Nosalë kur konkludoi se u vërtetua krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme). Dhoma Gjyqësore konkludoi se UJ-ja, MPB-ja dhe forcat paraushtarake “morën pjesë në operacione që patën për pasojë shpërnguljen e banorëve shqiptarë kosovarë” nga disa fshatra në komunën e Gjilanit, ndër të cilat fshati Nosalë, midis marsit dhe fillimit të majit 1999, dhe se forcat serbe vranë shumë njerëz.²²¹⁶ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat serbe sulmuan Nosalën dhe fshatrat përreth²²¹⁷ në komunën e Vitisë, dhe Lladovën në komunën e Gjilanit, dhe për pasojë rreth 20.000 banorë të këtyre fshatrave shkuan në Stubëll të Poshtme.²²¹⁸ Dhoma më tej theksoi se 1.500 prej të zhvendosurve në Stubëll të Poshtme u kthyen në fshatrat në komunën e Vitisë, kurse të tjerët ikën në IRJM në grupe prej 500 deri 1.000 vetë çdo ditë nga frika se mos sulmoheshin nga forcat serbe.²²¹⁹ Pikërisht mbi këtë bazë Dhoma Gjyqësore konkludoi konkretisht se “banorët e këtyre fshatrave u shpërngulën dhunshëm nga shtëpitë e tyre për shkak të sulmeve të forcave serbe”.²²²⁰

742. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi i keqkupton përfundimet e Dhomës Gjyqësore kur pretendon se nuk pati prova lidhur me çfarë ndodhi në Nosalë dhe se Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se shpërngulja ishte pasojë e sulmit të forcave serbe kundër Nosalës.

²²¹¹ Aktgjykimi, para. 1662, 1702, 1704. Shih Aktgjykimi, para. 1042.

²²¹² Aktgjykimi, para. 1662.

²²¹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 370(ii); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 119.

²²¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 358, përmendet Aktgjykimi, para. 1042, 1662.

²²¹⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 119.

²²¹⁶ Aktgjykimi, para. 2046.

²²¹⁷ Fshatrat Ribnik, Burrkë e Epërme dhe Mogillë (Aktgjykimi, para. 1042, 1662).

²²¹⁸ Aktgjykimi, para. 1042, 1662.

²²¹⁹ Aktgjykimi, para. 1662.

²²²⁰ Aktgjykimi, para. 1662. Shih Aktgjykimi, para. 1042.

743. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk vërtetoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) u vërtetua në lidhje me Nosalën.

2. Vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit

744. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit u vërtetua në lidhje me vendet në vijim: (i) Krushë e Vogël, komuna e Rahovecit; (ii) qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës; (iii) Mejë, komuna e Gjakovës; (iv) komuna e Vushtrrisë; (v) Kotlinë, komuna e Kaçanikut; dhe (vi) Vataj dhe Sllatinë, komuna e Kaçanikut.²²²¹

745. Përpara se të shqyrtojë kundërshtimet konkrete të Gjorgjeviqit lidhur me krimin e vrasjes, Dhoma e Apelit do të analizojë argumentin e tij bazë. Gjorgjeviqi parashtron se rrjedhimi i duhur ishte se viktimat ishin luftëtarë që u sulmuan ligjërisht, duke sugjeruar se viktimat ishin pjesëtarë të UÇK-së dhe si të tillë pjesëmarrës aktivë në luftime.²²²²

746. Dhoma e Apelit kujton elementët e krimit të vrasjes, konkretisht: (i) vdekja e një viktime që nuk merr pjesë aktivisht në luftime; (ii) vdekja ishte pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të autorit/autorëve të krimit apo e një ose më shumë personave për të cilët i akuzuari mban përgjegjësi penale; dhe (iii) autori synoi vrasjen e viktimës ose ta dëmtonte ose t'i shkaktonte lëndime të rënda me vullnet të plotë, duke pasur dijeni të arsyeshme se sulmi me gjasë do të shkaktonte vdekjen e viktimës.²²²³ Duke qenë se vrasja mund të provohet vetëm kur viktimat nuk ka marrë pjesë aktivisht në luftime, statusi i viktimës në kohën e vdekjes është përcaktues për vërtetimin e krimit të vrasjes.²²²⁴

747. Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit kujton se përveç civilëve që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime, viktimë e vrasjes si krim luftime bazuar në Nenin 3 të Statutit konsiderohet edhe çdo individ që nuk merr pjesë aktivisht në luftime, “duke përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, lëndimeve, arrestimit apo ndonjë arsyeje tjetër”.²²²⁵ Lidhur me vrasjen si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5 të Statutit, megjithëse kushtet ombrellë kërkojnë ekzistencën e provave se veprimi i autorit të krimit ishte pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur apo sistematik “kundër cilëndo

²²²¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 371-376.

²²²² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 372(i).

²²²³ Dhoma e Apelit thekson se elementët e vrasjes si krim luftime sipas Nenit 3 dhe si krim kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit janë të njëjtë, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e përgjithshme ombrellë për secilin prej tyre (shih më lart, para. 548).

²²²⁴ Shih më lart, para. 548.

²²²⁵ Neni i Përbashkët 3. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit Çelebiqi, para. 420.

popullate civile”,²²²⁶ kjo nuk do të thotë se viktimat e krimeve kundër njerëzimit domosdoshmërisht duhen të jenë civilë.²²²⁷ Viktima të vrasjes si krim kundër njerëzimit mund të jenë edhe persona jashtë luftimeve, me kusht që ata të kenë qenë viktimë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile dhe të jenë plotësuar të gjithë elementët e krimit.²²²⁸ Për këtë arsye, edhe nëse disa prej viktimave ishin pjesëtarë të UÇK-së, siç sugjeron Gjorgjeviqi, në qoftë se i kishin dorëzuar armët në kohën e vrasjes, ata nuk përbënin objektiva të ligjshme.

748. Në vijim, Dhoma e Apelit do të analizojë argumentet konkrete të Gjorgjeviqit për krimin e vrasjes në lidhje me disa vendndodhje.

(a) Krushë e Vogël , komuna e Rahovecit

a. 25 mars 1999

749. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i vrasjes u vërtetua lidhur me ngjarjet në Krushë të Vogël, në komunën e Rahovecit.²²²⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë një sulmi kundër fshatit, forcat serbe të ndihmuara nga fshatarë serbë vendës, dogjën të gjallë nëntë civilë shqiptarë kosovarë brenda shtëpive të tyre, të cilët nuk merrnin pjesë aktive në luftime.²²³⁰

750. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se vdekja e nëntë civilëve shqiptarë kosovarë përbënte vrasje, meqenëse nuk u paraqitën prova lidhur me rrethanat e vdekjes së tyre, nëse vdekja e tyre ishte e paramenduar, dhe nëse ata ishin pjesëtarë të UÇK-së.²²³¹

751. Prokuroria përgjigjet se “Gjorgjeviqi nuk provon asnjë gabim, por thjesht i kërkon Dhomës së Apelit të zgjedhë interpretimin e tij të provave”.²²³²

752. Dhoma e Apelit e konsideron argumentin e Prokurorisë të tepërt duke marrë parasysh përfundimin e saj të mëparshëm se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e nëntë burrave në Krushë të Vogël më 25 mars 1999²²³³.

²²²⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 93, 95-97; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 98; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 85. Po ashtu, prania e ushtarëve nuk e privon automatikisht popullatën civile prej karakterit të saj civil (Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 144; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 115. Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 50).

²²²⁷ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 308.

²²²⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 307, 311, 313; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 29, 33. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 303-306, 308, 318-319, 346, 355.

²²²⁹ Aktgjykimi, para. 1715.

²²³⁰ Aktgjykimi, para. 485, 1715.

²²³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 372(i). Shih Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 120.

²²³² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 359.

²²³³ Shih *më lart*, para. 667.

b. 26 mars 1999

753. Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë sulmit të forcave serbe në Krushë të Vogël më 26 mars 1999, Hysni Hajdari u qëllua dhe u vra nga forcat e MPB-së, ose kur ndodhej në hambarin e Batushës, ose pasi kishte ikur nga hambari i Batushës në drejtim të bjeshkëve.²²³⁴

754. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Hysni Hajdari u vra nga forcat e MPB-së, meqenëse nuk kishte prova lidhur me rrethanat e vdekjes së tij.²²³⁵

755. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi gabon kur parashtroi se nuk kishte prova.²²³⁶

756. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se Gjorgjeviqi shtrembëron përfundimet e Dhomës Gjyqësore. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat e MPB-së detyruan një grup prej afërsisht 114 burrash dhe djemsh shqiptarë kosovarë të hynin në hambarin e Batushës.²²³⁷ Forcat e MPB-së hapën zjarr kundër këtyre burrave dhe djemve dhe më pas i vunë zjarrin hambarit.²²³⁸ Dhjetë prej këtyre burrave shqiptarë kosovarë arritën të iknin²²³⁹ kurse 104 të tjerë vdiqën ose prej të shtënave, ose prej djegies së hambarit të Batushës.²²⁴⁰ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se dy prej burrave të cilët arritën të iknin nga hambari që po digjej, më pas u qëlluan dhe u vranë nga forcat e MPB-së.²²⁴¹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se Mehmet Krasniqi, njëri nga dhjetë personat që ia dolën të iknin nga hambari, pa kufomën e Hysni Hajdarit, i cili nuk ishte i armatosur dhe kishte plagë të shkaktuara nga armë zjarri.²²⁴²

757. Në bazë të këtyre përfundimeve, Dhoma Gjyqësore konkludoi se i vetmi rrjedhim i arsyeshëm ishte se Hysni Hajdari vdiq nga plagë nga armë zjarri të shkaktuara prej forcave të MPB-së, ose gjatë kohës që kishte qenë brenda në hambarin e Batushës, ose ndërsa po përpiquej të ikte nga hambari.²²⁴³ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi në mënyrë të arsyeshme prova të shumta lidhur me rrethanat e vdekjes së Hysni Hajdarit. Gjorgjeviqi thjesht sugjeron se mund të konkludohej se pas ikjes nga hambari i Batushës, më të njëjtën ditë Hysni Hajdari u anëtarësua në UÇK dhe ka të ngjarë të jetë vrarë në luftime, por nuk citon asnjë provë në

²²³⁴ Aktgjykimi, para. 493, 1402, 1718.

²²³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 372(ii). Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi tërhoqi apelin e tij lidhur me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Hysen Ramadani dhe një person tjetër u vranë (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 372(ii), përmendet Aktgjykimi, para. 1716, 1718).

²²³⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 360, përmendet Aktgjykimi, para. 490, 493, 1718, Mehmet Krasniqi, 12 shkurt 2009, T. 991, Mehmet Krasniqi, 13 shkurt 2009, T. 1009, Prova Materiale P305, f. 14, P312.

²²³⁷ Aktgjykimi, para. 490, 493, 1395.

²²³⁸ Aktgjykimi, para. 490, 493, 1395, 1717.

²²³⁹ Aktgjykimi, para. 1717.

²²⁴⁰ Aktgjykimi, para. 490, 1717.

²²⁴¹ Aktgjykimi, para. 491, 1718.

²²⁴² Aktgjykimi, para. 493.

mbështetje të kësaj teze, apo nuk përvijon asnjë gabim.²²⁴⁴ Rrjedhimisht, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte asnjë gabim.

758. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim me atë të Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Hysni Hajdari u qëllua dhe u vra nga forcat e MPB-së.

(b) Qyteti i Suharekës, komuna e Suharekës

759. Dhoma Gjyqësore konkludoi se në lidhje me Afrim, Arta, Hamdi dhe Zana Berishën të cilët u vranë nga forcat serbe më 26 mars 1999 në qytetin e Suharekës, në komunën e Suharekës, u vërtetua krimi i vrasjes.²²⁴⁵ Dhoma Gjyqësore konkludoi se “pavarësisht nga mungesa e provave mjekoligjore mbi shkakun e vdekjes së tyre”,²²⁴⁶ Afrim, Arta, Hamdi, dhe Zana Berisha u vranë nga forcat serbe, “bazuar në tërësinë e provave dhe praktikën e sulmeve të forcave serbe në Suharekë”.²²⁴⁷ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 26 mars 1999, policia qëllloi dhe vrau: (i) Bujar, Nexhat, Faton, Fatime, Sedat, dhe Nexhmedin Berishën, në afërsi të shtëpive të familjes Berisha; (ii) një burrë dhe një grua të moshuar teksa po iknin nga shtëpitë e familjes Berisha; (iii) 32 anëtarë të tjerë të familjes Berisha të cilët kishin ikur nga shtëpitë e familjes Berisha dhe ishin strehuar në një piceri në qendrën e afërt tregtare; dhe (iv) Jashar Berishën në afërsi të picerisë.²²⁴⁸

760. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Afrim, Arta, Hamdi dhe Zana Berisha u vranë nga forcat serbe në mungesë të provave rreth shkakut të vdekjes së tyre.²²⁴⁹

761. Në përgjigje, Prokuroria argumenton se Gjorgjeviqi pa të drejtë parashtron se nuk u paraqitën prova rreth shkakut të vdekjes së katër anëtarëve të familjes Berisha, dhe se ai nuk vërtetoi ndonjë gabim.²²⁵⁰

762. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se fakti që viktimat në fjalë ishin anëtarë të familjes Berisha “nuk vërteton domosdoshmërisht se ata u vranë së bashku me anëtarët e tjerë të familjes Berisha”.²²⁵¹

²²⁴³ Aktgjykimi, para. 493, 1718.

²²⁴⁴ Shih më lart, para. 700.

²²⁴⁵ Aktgjykimi, para. 1491, 1720, 1724.

²²⁴⁶ Aktgjykimi, para. 683, 1724.

²²⁴⁷ Aktgjykimi, para. 683, 1724.

²²⁴⁸ Shih Aktgjykimi, para. 672, 674, 676, 678, 683, 1721-1723.

763. Dhoma e Apelit kujton se konkluzioni jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se një person është vrarë, mund të nxirret edhe nga provat rrethore që disponon dhoma gjyqësore.²²⁵² Kur konkludoi se Afrim, Arta, Hamdi, dhe Zana Berisha u vranë, Dhoma Gjyqësore mori parasysh se më të njëjtën ditë në Suharekë, forcat serbe vranë të paktën 41 anëtarë të tjerë të familjes Berisha, ndër të cilët gra, fëmijë dhe pleq.²²⁵³

764. Konkretisht, në bazë të dëshmisë së drejtpërdrejtë të një dëshmitareje okulare që mbeti gjallë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 26 mars 1999, forcat e MPB-së iu afruan shtëpisë së Vesel Berishës, thirrën Bujar Berishën të dilte jashtë, dhe e qëlluan dhe vranë atë së bashku me pesë anëtarë të tjerë të familjes Berisha teksa po largoheshin me vrap nga shtëpia.²²⁵⁴ Në bazë të dëshmisë së një dëshmitari tjetër okular, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se u qëlluan dhe u vranë edhe një burrë dhe një grua e moshuar teksa po largoheshin nga shtëpitë e familjes Berisha.²²⁵⁵ Të shtënat u intensifikuan dhe 35 anëtarë të familjes Berisha u larguan me vrap nga shtëpia në drejtim të qendrës tregtare dhe hynë në një piceri.²²⁵⁶ Më pas, pjesëtarë të policisë vendëse iu afruan picerisë, thyen xhamin, hodhën dy bomba dore brenda dhe qëlluan me armë zjarri 35 anëtarët e familjes Berisha që ishin grumbulluar brenda në piceri, duke i vrarë që të gjithë, me përjashtim të tre personave.²²⁵⁷ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se policët vendës kapën Jashar Berishën, e çuan në piceri dhe pastaj e qëlluan me armë zjarri në shpinë.²²⁵⁸

765. Në bazë të provave mjekoligjore, Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se kufomat dhe sendet personale të disa prej 41 anëtarëve të lartpërmendur të familjes Berisha, si dhe ato të anëtarëve të tjerë të familjes Berisha, më vonë u gjetën në tri vendndodhje: (i) në varrezat e Suharekës; (ii) në poligonin e qitjes të UJ-së që gjithashtu përmendet si “Kroji i Popit”; dhe (iii) në një varr të përbashkët në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, në Serbi.²²⁵⁹ Lidhur me këtë,

²²⁴⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 373. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 121.

²²⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 361.

²²⁵¹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 121.

²²⁵² Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerët*, para. 260.

²²⁵³ Aktgjykimi, para. 672, 674, 676, 678, 683, 1721-1723.

²²⁵⁴ Aktgjykimi, para. 669-671.

²²⁵⁵ Aktgjykimi, para. 672. Provat nuk zbuluan emrin e gruas së moshuar dhe të burrit të moshuar dhe për këtë arsye ata nuk përmenden në Shtojcën e Aktakuzës (Aktgjykimi, para. 672).

²²⁵⁶ Aktgjykimi, para. 670, 674. Vendi i kësaj ngjarjeje, siç theksoi edhe Dhoma Gjyqësore, përmendet herë si kafene, e herë si piceri. Megjithëse dëgjoi dëshmi se anëtarë të familjes Berisha kishin hyrë në piceri dhe ishin mbyllur aty me çelës, si dhe dëshmi se policia u tha atyre që të hynin në kafene dhe të uleshin, Dhoma Gjyqësore gjykoj se kjo mospërputhje nuk kishte ndonjë rëndësi thelbësore, duke pasur parasysh “ngjarjet që pasuan dhe akuzat e Aktakuzës” (Aktgjykimi, para. 674).

²²⁵⁷ Aktgjykimi, para. 675-676.

²²⁵⁸ Aktgjykimi, para. 678.

²²⁵⁹ Aktgjykimi, para. 1403-1406, 1720, 1724. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 683-684, 1377, 1484-1491. Kufomat e anëtarëve të familjes Berisha u mblodhën dhe u transportuan me kamion tek Kroji i Popit ku i varrosën për një kohë të shkurtër, pastaj i zhvarrosën, duke lënë pas sendet e tyre personale të cilat u identifikuan nga dy anëtarë të familjes Berisha që shoqëruan ekipin mjekoligjor britanik në vendndodhje. Kufomat më pas u varrosën në një varr të përbashkët në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë (Aktgjykimi, para. 679-681).

Dhoma e Apelit thekson se kufomat e Afrim, Artë, Hamdi, dhe Zanë Berishës ishin midis kufomave të 24 anëtarëve të familjes Berisha që u zhvarrosën nga një varr i përbashkët në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë.²²⁶⁰ Për më tepër, tek Kroji i Popit ku u gjetën kufomat dhe sendet personale të anëtarëve të tjerë të familjes Berisha të vranë atë ditë, disa sende personale u identifikuan se i përkisnin Afrim Berishës.²²⁶¹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se përfundimin e vet se Afrim, Arta, Hamdi, dhe Zana Berisha u vranë nga forcat serbe, Dhoma Gjyqësore nuk e mbështeti vetëm në faktin se ata ishin pjesëtarë të familjes Berisha, por e mbështeti në prova mjekoligjore dhe në mënyrën se si forcat serbe sulmuan familjen Berisha atë ditë në qytetin e Suharekës.²²⁶²

766. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim me atë të Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Afrim, Arta, Hamdi, dhe Zana Berisha u vranë nga forcat serbe më 26 mars 1999 në Suharekë.

(c) Mejë, komuna e Gjakovës

767. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 27-28 prill 1999, në kuadër të një operacioni të madh dhe të bashkërenduar të UJ-së dhe MPB-së të njohur me emrin “Operacioni Reka”, forcat serbe qëlluan dhe vranë 281 shqiptarë kosovarë në fshatin Mejë.²²⁶³

768. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se gjatë “operacionit Reka” u vranë 281 persona,²²⁶⁴ dhe parashtron se duke marrë parasysh përfundimin e Dhomës Gjyqësore se kishte prani të UÇK-së në afërsi, është i mundur përfundimi se të vranët u vranë gjatë luftimeve.²²⁶⁵

769. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi shpërfill përfundimet e Dhomës Gjyqësore dhe nuk vërteton asnjë gabim.²²⁶⁶

770. Në nxjerrjen e përfundimit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se më 27 prill 1999 në Mejë hynë forca të mëdha serbe të cilat filluan të shtinin jashtë shtëpive dhe i urdhëruan banorët që t’i bashkoheshin kolonës për në Shqipëri.²²⁶⁷ Më pas, forcat serbe morën grupe të

²²⁶⁰ Aktgjykimi, para. 1491, 1724.

²²⁶¹ Aktgjykimi, para. 683. Të gjitha sendet personale iu treguan pjesëtarëve të familjeve për identifikim, shumë prej tyre u identifikuan si sende që u përkisnin pjesëtarëve të ndryshëm të familjes Berisha dhe një dëshmitar okular identifikoi disa prej këtyre sendeve se ishin të pjesëtarëve të familjes Berisha që ishin vranë tek piceria (Aktgjykimi, para. 683, 1406).

²²⁶² Shih Aktgjykimi, para. 669-683, 1403-1406.

²²⁶³ Aktgjykimi, para. 1738-1739.

²²⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 374.

²²⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 374; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 122.

²²⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 362.

²²⁶⁷ Shih Aktgjykimi, para. 958, 961.

shumta burrash shqiptarë kosovarë nga kolona dhe i pushkatuan në vende të ndryshme.²²⁶⁸ Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh një listë me emrat e 344 personave, të cilët konsideroheshin të zhdukur dhe ishin parë të gjallë për herë të fundit në Mejë më 27 dhe 28 prill 1999, të përfshirë si viktimat në Shtojcën H të Aktakuzës.²²⁶⁹ Dëshmitarët okularë identifikuan me emër 15 persona nga kjo listë si të vrarë nga forcat serbe pasi ishin marrë nga shtëpitë dhe pushkatuar.²²⁷⁰ Kufomat e 281 personave u zhvarrosën nga një varr i përbashkët në Batajnicë dhe u identifikuan se ishin personat e renditur në Shtojcën H të Aktakuzës.²²⁷¹ Megjithëse provat mjekoligjore vërtetuan se vetëm 172 nga 281 viktimat vdiqën nga plagë të shkaktuara nga armë zjarri, shkak i vdekjes lidhur me 109 viktimat e tjera nuk u përcaktua.²²⁷² Megjithatë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se i vetmi rrjedhim i arsyeshëm ishte se edhe 109 viktimat e tjera u vranë nga forcat serbe gjatë “Operacionit Reka” në rrethana të ngjashme me ato që u vërtetuan lidhur me 172 viktimat për të cilat u konkludua se u pushkatuan pasi ishin marrë nga kolona.²²⁷³

771. Me gjithë pretendimin e Gjorgjeviqit se mund të konkludohej se 281 burrat u vranë në luftime, Dhoma e Apelit i referohet përfundimit të Dhomës Gjyqësore se nuk kishte prova lidhur me luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së në atë zonë në kohën e ngjarjeve në Mejë, “me përjashtim të shkëmbimit të paplanifikuar të shkurtër të zjarrit në fshatin Ramoc më 27 prill të vitit 1999 midis luftëtarëve të UÇK-së dhe anëtarëve të një njësie të UJ-së”.²²⁷⁴ Nga ana tjetër kishte prova se një numër i madh burrash në Mejë u detyruan t’i bashkoheshin një kolone, dhe shumë prej tyre më pas u vranë.²²⁷⁵ Dhoma Gjyqësore konkludoi shprehimisht se nuk kishte prova se ndonjë nga personat e vrarë në Mejë ishte i armatosur në atë kohë, apo se merrte pjesë në luftime.²²⁷⁶ Dhoma Gjyqësore gjithashtu hodhi poshtë argumentin e Gjorgjeviqit se veprimet e forcave serbe ishin kundër terroristëve.²²⁷⁷ Për nxjerrjen e këtij përfundimi Dhoma Gjyqësore ndër të tjera mori parasysh faktin se viktimat e zhvarrosura “aty

²²⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1738. Shih Aktgjykimi, para. 967-979, 985-995.

²²⁶⁹ Aktgjykimi, para. 990.

²²⁷⁰ Aktgjykimi, para. 955-962, 1735-1737. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 990.

²²⁷¹ Aktgjykimi, para. 990. Dhoma Gjyqësore mori parasysh prova që tregonin se kufomat e viktimave të vrara gjatë operacionit Reka u zhvarrosën nga vendet ku ishin varrosur fillimisht dhe u transportuan dhe rivarrosën në varre të përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë (Aktgjykimi, para. 985-989).

²²⁷² Aktgjykimi, para. 1738. Shih Aktgjykimi, para. 990.

²²⁷³ Aktgjykimi, para. 1738. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore theksoi se nuk kishte të dhëna për fatin e 48 personave të tjerë të shënuar si të zhdukur nga Meja në Listën Përmbledhëse të Personave të Zhdukur të ZPZHML-së, të cilët figurojnë edhe në Shtojcën H të Aktakuzës. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk ishte në gjendje të nxirrte përfundim nëse ata u vranë, megjithëse ishte e mendimit se “ka të ngjarë që edhe këta persona të jenë vrarë gjatë Operacionit Reka” (Aktgjykimi, para. 993).

²²⁷⁴ Aktgjykimi, para. 980, 1739. Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh pretendimin e Gjorgjeviqit se aksionet e forcave serbe ishin kundër terroristëve shqiptarë kosovarë, por konkludoi se nuk kishte prova që sugjerinin se të vrarët kishin marrë pjesë, apo po merrnin pjesë në veprimtari terroriste (Aktgjykimi, para. 1739).

²²⁷⁵ Aktgjykimi, para. 958, 961, 967-979, 985-995, 1738.

²²⁷⁶ Aktgjykimi, para. 1739.

²²⁷⁷ Aktgjykimi, para. 1739.

ku mund të përcaktohej – ishin të veshur me tesha civile”,²²⁷⁸ faktor ky që sipas Dhomës së Apelit mund të merret parasysh gjatë nxjerrjes së përfundimit nëse një viktimë konkrete mori pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes.²²⁷⁹

772. Në këto rrethana, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajimit të gjykatësit Güney dhe gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se Gjorgjeviqi nuk provoi se konkluzioni i mundshëm që ai sugjeroi – se të vranët u vranë në luftime – u përjashtua pa arsye nga Dhoma Gjyqësore.²²⁸⁰ Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se 281 shqiptarët kosovarë u qëlluan dhe u vranë nga forcat serbe gjatë “Operacionit Reka” më 27-28 prill 1999, në Mejë.

(d) Komuna e Vushtrrisë

773. Dhoma Gjyqësore u bind se Hysni Bunjaku, Haki Gërzhaliu, Miran Xhafa, dhe Veli Xhafa u ndaluan dhe vranë nga forcat serbe më 2-3 maj 1999, ndërsa po udhëtonin bashkë me një kolonë në komunën e Vushtrrisë.²²⁸¹

774. Gjorgjeviqi parashtron se provat nuk vërtetuan se Hysni Bunjaku, Haki Gerzhaliu, Miran Xhafa dhe Veli Xhafa u ndaluan, dhe thekson se “Dhoma Gjyqësore konkludoi se në kolonë kishte pjesëtarë të UÇK-së”.²²⁸² Ai argumenton se sikur këta katër burra të mos jenë ndaluar, atëherë do të mund të konkludohej se ata ishin objektiva legjitime, dhe se për këtë arsye nuk do të vijonte një përfundim për vrasje.²²⁸³

775. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk provoi se përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin të paarsyeshme.²²⁸⁴ Ajo pretendon se parashtrimi i Gjorgjeviqit se provat nuk vërtetuan se këta katër persona u ndaluan nga forcat serbe është i pashtjelluar dhe duhet hedhur poshtë.²²⁸⁵

776. Për mendimin e Dhomës së Apelit, lidhur me këtë pikë nuk ka rëndësi nëse Hysni Bunjaku, Haki Gerzhaliu, Miran Xhafa dhe Veli Xhafa u ndaluan, apo nëse kishte ushtarë të UÇK-së në kolonën e të shpërngulurve që po udhëtonin në drejtim të Vushtrrisë. Dhoma e Apelit thekson se rrethanat e vdekjes së këtyre burrave ashtu siç gjykoi Dhoma Gjyqësore, vërtetojnë se që të katër burrat ishin jashtë luftimeve, nuk merrnin pjesë aktive në luftime në

²²⁷⁸ Aktgjykimi, para. 990. Dhoma Gjyqësore theksoi se dy nga kufomat e gjetura në varrin e përbashkët në Batajnicë ishin kufoma femrash dhe se viktimat ishin të moshave të ndryshme.

²²⁷⁹ Shih më lart, para. 525.

²²⁸⁰ Shih më lart, para. 700.

²²⁸¹ Aktgjykimi, para. 1184-1185, 1191-1192, 1197, 1742-1743.

²²⁸² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 375, përmendet Aktgjykimi, para. 1197-1199, 1742-1743.

²²⁸³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 123.

²²⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 363.

²²⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 363.

atë kohë, dhe rrjedhimisht nuk përbënin objektiv legjitim sulmi.²²⁸⁶ Për shembull, Dhoma Gjyqësore shprehimisht theksoi se Hysni Bunjaku ishte i paarmatosur, shofer i një traktori në kolonën e personave të zhvendosur, kur forcat serbe iu afruan dhe i kërkuan disa herë t'u jepte para, dhe e zbritën me forcë nga traktori.²²⁸⁷ Megjithëse babai i tij iu lut të mos ia vrisnin të birin, forcat serbe e qëlluan dhe e vranë Hysni Bunjakun.²²⁸⁸ Thuajse e njëjta gjë ndodhi edhe me Haki Gerxhaliun dhe familjen e tij.²²⁸⁹ Haki Gerxhaliu po udhëtonte bashkë me familjen dhe u qëllua nga forcat serbe me të zbritur nga traktori.²²⁹⁰ Më tej, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Miran Xhafa, i cili asokohe ishte 71 vjeç dhe i paarmatosur, u tërhoq zvarrë nga traktori me të cilin familja e tij po udhëtonte bashkë me kolonën, pasi një polic i drejtoi mitralozin gruas së tij.²²⁹¹ Pas tri të shtënave nga ana e policëve, Miran Xhafa ra përtokë, dhe nuk kaloi shumë kohë kur u dëgjua një e shtënë e katërt.²²⁹² Dhoma Gjyqësore konkludoi se Miran Xhafa vdiq gjatë këtij incidenti.²²⁹³ Së fundi, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Veli Xhafa u pa tek dergjej i vdekur në traktorin e tij.²²⁹⁴

777. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtimit të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshem faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se Hysni Bunjaku, Haki Gerxhaliu, Miran Xhafa dhe Veli Xhafa u vranë.

(e) Kotlinë, komuna e Kaçanikut

778. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 24 mars 1999, forcat serbe kapën dhe më pas vranë të paktën 22 burra në pusët e Kotlinës, në komunën e Kaçanikut.²²⁹⁵ Kur nxori këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e Hazbi Lokut ("Dëshmitar Loku"), i cili i pa ngjarjet me dylbi gjahu nga një faqe kodre në një largësi prej më pak se 600 metra.²²⁹⁶ Konkretisht, [Dhoma Gjyqësore] mori parasysh dëshminë e tij se forcat serbe kapën jo më pak se 20 burra dhe i detyruan të ecnin me duar mbi kokë në vendim ku ishin dy puse të tharë.²²⁹⁷

²²⁸⁶ Dhoma e Apelit vëren se në pjesën përkatëse të Aktgjykimit që përmend Gjorgjeviqi, thuhet se në komunën e Vushtrrisë në atë kohë zhvilloheshin luftime midis UÇK-së dhe forcave serbe, dhe jo se kishte pjesëtarë të UÇK-së në kolonë (Aktgjykimi, para. 1199. Shih Aktgjykimi, para. 1197-1199, 1742-1743, siç përmendet në Dosjen e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 375).

²²⁸⁷ Aktgjykimi, para. 1184.

²²⁸⁸ Aktgjykimi, para. 1184.

²²⁸⁹ Aktgjykimi, para. 1185.

²²⁹⁰ Aktgjykimi, para. 1185.

²²⁹¹ Aktgjykimi, para. 1191.

²²⁹² Aktgjykimi, para. 1191.

²²⁹³ Aktgjykimi, para. 1191.

²²⁹⁴ Aktgjykimi, para. 1192.

²²⁹⁵ Aktgjykimi, para. 1126, 1744. Shih Aktgjykimi, para. 1116, 1120, 1428, 1431, 1433-1436.

²²⁹⁶ Aktgjykimi, para. 1115-1116, 1125-1126, 1428, sh. 4336.

²²⁹⁷ Aktgjykimi, para. 1115-1116, 1125-1126, 1428, sh. 4336.

Gjithashtu [Dhoma Gjyqësore] pranoi dëshminë e tij se “ai i kishte parë të gjithë burrat ‘të ekzekutoheshin dhe masakroheshin’”.²²⁹⁸

779. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Lokut për të konkluduar se 22 burrat ishin në duart e forcave serbe kur u vranë, duke marrë parasysh largësinë nga e cila pa ngjarjet.²²⁹⁹

780. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk provon se përfundimet e Dhomës Gjyqësore ishin të paarsyeshme.²³⁰⁰ Më tej argumentohet se parashtrimet e Gjorgjeviqit duhen hedhur poshtë meqenëse ai thjesht përsërit argumente që nuk u pranuan gjatë gjykimit dhe përpiqet të zëvendësojë interpretimin prej Dhomës Gjyqësore të provave me një interpretim të vetin.²³⁰¹

781. Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore gëzon kompetenca të gjera në përcaktimin e peshës dhe besueshmërisë së dëshmisë së një dëshmitari,²³⁰² dhe mund të mbështetet në dëshminë e pakonfirmuar të një dëshmitari të vetëm.²³⁰³ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh dhe shqyrtoi me kujdes argumentin e Gjorgjeviqit se, për shkak të largësisë së tij nga pusët në Kotlinë, Dëshmitar Loku nuk mund të ketë parë gjithë çfarë përshkroi lidhur me rrethanat e vdekjes së këtyre personave.²³⁰⁴ Megjithatë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitar Loku kishte pamje të papenguar të puseve nga një vend më i lartë në majë të një kodre, dhe pavarësisht se mund t’i shihte ngjarjet me sytë e vet, ai kishte përdorur edhe dylbi gjahu.²³⁰⁵ Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Lokut se 22 burrat i kishin duart e ngritura mbi kokë kur u vranë, sidomos duke pasur parasysh dëshminë se Dëshmitar Loku përdori dylbi gjahu dhe se mund t’i shihte ngjarjet madje edhe me sytë e vet.²³⁰⁶ Për më tepër, Dhoma e Apelit mendon se Dhoma Gjyqësore me arsye u mbështet në këtë dëshmi kur konkludoi se 22 burrat ishin të paarmatosur dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u vranë, dhe se “edhe sikur ndonjëri prej tyre të kishte qenë anëtar i UÇK-së, ata ishin jashtë luftimeve.”²³⁰⁷ Për këtë arsye, nuk është me rëndësi nëse këta persona ishin pjesëtarë të UÇK-së në kohën kur u vranë.

782. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin

²²⁹⁸ Aktgjykimi, para. 1125.

²²⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 376(iii); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 124.

²³⁰⁰ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 364.

²³⁰¹ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, para. 364, përmendet Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 871.

²³⁰² Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 129. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 114; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 194.

²³⁰³ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 65.

²³⁰⁴ Aktgjykimi, para. 1125, sh. 4327, 4336, 4342. Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 871.

²³⁰⁵ Aktgjykimi, para. 1115-1116, 1125-1126, 1428, sh. 4327, 4336, 4342.

²³⁰⁶ Aktgjykimi, para. 1112, 1115-1116, sh. 4237.

përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se forcat serbe vranë të paktën 22 burra në pusët e Kotlinës, në komunën e Kaçanikut.

(f) Vataj, komuna e Kaçanikut

783. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Mahmut Caka, Hebib Lami, Brahim Lami, dhe Rraman Lami nga fshati Vataj u zunë rob, u nxorën nëpër fshat dhe më pas u qëlluan dhe vranë nga forcat serbe në Vataj të komunës së Kaçanikut më 13 prill 1999.²³⁰⁸ Kur nxori këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Sada Lamës (“Dëshmitar Lama”), si dhe në provat mjekoligjore se të katër burrat vdiqën nga plagë të shkaktuara nga armë zjarri.²³⁰⁹

784. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur i kushtoi rëndësi përcaktuese dëshmisë dytësore të Dëshmitar Lamës në mbështetje të pretendimit se katër të vdekurit shqiptarë kosovarë ishin në duart e forcave serbe para se të vriteshin.²³¹⁰

785. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë dhomë e arsyeshme gjyqësore nuk do të mbështetej në dëshmi të dorës së dytë, të konfirmuar nga dëshmi të tjera, në mbështetje të përfundimeve të veta faktike.²³¹¹

786. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se vdekjet e këtyre personave nuk konfirmojnë dëshminë e Dëshmitar Lamës se ata mbaheshin nga forcat serbe.²³¹²

787. Për mendimin e Dhomës së Apelit, argumenti i Gjorgjeviqit nënkupton se përfundimi i Dhomës Gjyqësore sipas të cilit katër burrat ishin në duart e forcave serbe, është thelbësor për krimin e vrasjes, meqenëse sikur të mos ishin ndaluar nga forcat serbe, atëherë mbetej rrjedhimi se ata ishin vranë në mënyrë të ligjshme dhe për rrjedhojë vrasja e tyre nuk do të përbënte vrasje të paligjshme.

788. Dëshmia e Dëshmitar Lama është dëshmi e drejtpërdrejtë kur ai përshkruan incidentin ashtu siç e kishte parë me sytë e vet, dhe dëshmi e dorës së dytë lidhur me çfarë i tregoi gruaja e vet e cila i kishte parë ngjarjet nga një vend ku ishte fshehur, rreth 300 metra më larg.²³¹³ Dhoma e Apelit thekson se dëshmia dytësore e Dëshmitar Lamës se katër burrat ishin kapur nga forcat serbe ishte e vetmja dëshmi që dëgjoi Dhoma Gjyqësore lidhur me këtë. Dhoma e

²³⁰⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1744.

²³⁰⁸ Aktgjykimi, para. 1747. Shih Aktgjykimi, para. 1138-1139, 1447.

²³⁰⁹ Aktgjykimi, para. 1138-1139, 1447-1449, 1747.

²³¹⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 376(iv).

²³¹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 365.

²³¹² Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 125.

Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se katër burrat ishin jashtë luftimit dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në atë kohë.²³¹⁴

789. Për nxjerrjen e këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore nuk u mbështet vetëm në dëshmi të dorës së dytë, por kryesisht në dëshminë e drejtpërdrejtë të Dëshmitar Lamës i cili rrëfeu se i kishte parë kufomat e Mahmut Cakës, Hebib Lamit, Brahim Lamit dhe Rraman Lamit në një shteg sipër një gryke, pasi më herët atë ditë i kishin detyruar të ecnin në këmbë poshtë e lart nëpër fshat.²³¹⁵ Dëshmitar Lama veçanërisht theksoi se që të katër viktimat ishin me veshje civile dhe nuk kishin armë.²³¹⁶ Dhoma e Apelit kujton se veshja e civilëve mund të merret parasysh gjatë nxjerrjes së përfundimit nëse një viktimë mori pjesë aktivisht në luftime në kohën e vdekjes.²³¹⁷ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore me arsye u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Lamës kur konkludoi se viktimat ishin jashtë luftimeve dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes së tyre.²³¹⁸ Rrjedhimisht, në këtë rast nuk ka rëndësi nëse Mahmut Caka, Hebib Lami, Brahim Lami, dhe Rraman Lami ishin zënë rob ose jo, meqenëse përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ata ishin jashtë luftimeve dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes së tyre ishte gjithsesi i arsyeshëm.

790. Bazuar në sa më sipër, Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se forcat serbe në Vataj vranë Mahmut Cakën, Hebib Lamin, Brahim Lamin, dhe Rraman Lamin.

3. Përndjekja si krim kundër njerëzimit

791. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i përndjekjes përmes shkatërrimit të objekteve fetare ose me vlerë kulturore u vërtetua lidhur me xhamitë në Celinë, Bellacërkë, Landovicë, Suharekë (Xhamia e Bardhë), Gjakovë (Xhamia e Hadumit), Rogovë, Llashticë, dhe Vushtrri (Xhamia e Çarshisë).²³¹⁹

792. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjes përmes shkatërrimit të objekteve fetare u vërtetua lidhur me: (i) xhamitë në Celinë, Bellacërkë,

²³¹³ Aktgjykimi, para. 1138, sh. 4410.

²³¹⁴ Aktgjykimi, para. 1747.

²³¹⁵ Aktgjykimi, para. 1138, sh. 4410. Shih Sada Lama, 24 prill 2009, T. 3722-3724.

²³¹⁶ Aktgjykimi, para. 1138, sh. 4410. Shih Sada Lama, 24 prill 2009, T. 3722-3724.

²³¹⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 81. Shih më lart, para. 525.

²³¹⁸ Aktgjykimi, para. 1139, 1747.

²³¹⁹ Aktgjykimi, para. 1811, 1819, 1825, 1832, 1837, 1841, 1850, 1854, 1856, 2033.

dhe Rogovë; (ii) xhaminë në Landovicë; (iii) Xhaminë e Hadumit; dhe (iv) xhaminë në Llashticë.²³²⁰

793. Prokuroria përgjigjet se Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë se përfundimi i Dhomës Gjyqësore është i gabuar.²³²¹

(a) Xhamia në Celinë dhe xhamia në Bellacërkë, në komunën e Rahovecit, dhe xhamia në Rogovë në komunën e Gjakovës

794. Dhoma Gjyqësore konkludoi se xhamia në Celinë dhe xhamia në Bellacërkë, në komunën e Rahovecit, si dhe xhamia në Rogovë, në komunën e Gjakovës, u shkatërruan me lëndë shpërthyesë të vendosura dhe shpërthyerë nga forcat serbe më 28 mars 1999.²³²² Duke u mbështetur në dëshminë e drejtpërdrejtë të dëshmitarit Sabri Popaj (“Dëshmitar Popaj”), e cila u konfirmua nga dëshmia dytësore e Dëshmitarit Agim Jemini (“Dëshmitar Jemini”), Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe hynë në xhaminë e fshatit Celinë, dhe më pas aktivizuan lëndë shpërthyesë që shkaktuan shkatërrimin e saj.²³²³ Dhoma Gjyqësore u mbështet, ndër të tjera, edhe në dëshminë e Dëshmitar Popajt lidhur me xhaminë në Celinë kur konkludoi se xhamia në Bellacërkë dhe ajo në Rogovë u shkatërruan në mënyrë të ngjashme njëra pas tjetrës, brenda disa minutave, me eksplozivë që u vendosën dhe u shpërthyen prej forcave serbe.²³²⁴

795. Gjorgjeviqi kundërshton faktin që Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Popajt, meqenëse sipas tij, ky dëshmitar ishte “i pasigurt gjatë dëshmisë”, “i njëanshëm si përkrahës i UÇK-së”, dhe dëshmia e tij binte ndesh me dëshminë e Dëshmitar Jeminit.²³²⁵ Ai më tej parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Popajt lidhur me shkatërrimin e xhamisë në Celinë për nxjerrjen e konkluzionit se edhe xhamitë në Bellacërkë dhe Rogovë u shkatërruan nga forcat serbe.²³²⁶ Së fundi, Gjorgjeviqi parashtron se nuk pati dëshmi nga dëshmitarë okularë që do të mbështesnin përfundimet se xhamia e Bellacërkës dhe ajo e Rogovës u shkatërruan nga forcat serbe.²³²⁷

²³²⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347(f), 347(g), 377. Përfundimi se shkatërrimi i objekteve fetare shqiptare kosovare ishte pjesë e planit të përbashkët, si dhe pretendimet për gabime ligjore lidhur me përfundimin për përndjekje në lidhje me xhaminë në Landovicë, Xhaminë e Hadumit dhe Xhaminë e Llashticës, janë shqyrtuar përkatësisht në pikën e shtatë dhe pesëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit. Në pikën e shtatë të apelit, Gjorgjeviqi apelon vetëm bazën faktike mbi të cilën u mbështet përfundimi për veprimin e fajshëm (Shih më lart, para. 198-200, 204, 557-562, 565-569).

²³²¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 366-368.

²³²² Aktgjykimi, para. 477, 528, 931, 933, 1804, 1806, 1808, 1811, 1836-1837.

²³²³ Aktgjykimi, para. 1804, përmendet Agim Jemini, 21 prill 2009, T. 3542, 3544, Prova Materiale P638.

²³²⁴ Aktgjykimi, para. 478, 528, 931, 933.

²³²⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(a).

²³²⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(a).

²³²⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(a).

796. Prokuroria përgjigjet se kundërshtimet e Gjorgjeviqit lidhur me besueshmërinë e Dëshmitar Popajt u shqyrtuan gjatë gjykimit dhe Dhoma Gjyqësore me arsye u mbështet në dëshminë e tij.²³²⁸ Prokuroria më tej parashtron se Gjorgjeviqi nuk provoi se asnjë dhomë gjyqësore e arsyeshme nuk do të mund të konkludonte se forcat serbe shkatërruan xhaminë e Bellacërkës dhe atë të Rogovës.²³²⁹

797. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes parashtrimet e Gjorgjeviqit lidhur me besueshmërinë e Dëshmitar Popajt, ndër të tjera edhe mospërputhjet midis dëshmisë së tij dhe dëshmisë së Dëshmitar Jeminit dhe u bind se dëshmia e tij lidhur me ngjarjet në fshatin Bellacërkë dhe rrethinë ishte e besueshme.²³³⁰ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore ka kompetenca të gjera në përcaktimin e rëndësisë që do t'i kushtojë dëshmisë së një dëshmitari.²³³¹ Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se zakonisht mund të ndodhë që të ketë mospërputhje të vogla në dëshminë e një dëshmitari të cilat nuk e bëjnë të pabesueshme dëshminë.²³³² Është brenda kompetencave të brendaqenësishme të dhomës gjyqësore që t'i vlerësojë mospërputhje të tilla dhe ta konsiderojë një dëshmi në tërësi të besueshme, pa e shpjeguar në hollësi vendimin e saj.²³³³

798. Dhoma Gjyqësore analizoi dëshminë e Dëshmitar Popajt i cili tha se nga vendi ku po qëndronte ai në faqen e malit, ai ishte në gjendje të shihte fshatrat Celinë, Bellacërkë dhe Rogovë, të cilët “ishin afër njëri-tjetrit”.²³³⁴ Konkretisht, Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se Dëshmitar Popaj pa policët kur erdhën në xhaminë në Celinë, ku qëndruan një orë, dhe më pas dëgjoji një shpërthim të fuqishëm dhe pa se xhamia u shkatërrua.²³³⁵ Megjithëse dëshmia e Dëshmitar Popajt ishte e vetmja dëshmi e drejtpërdrejtë okulare sipas të cilës policët hynë në xhami, vendosën dhe shpërthyen lëndë plasëse, Dhoma Gjyqësore mori parasysh edhe dëshminë e Dëshmitar Jeminit, “i cili atë mbrëmje e pa xhaminë tërësisht të shkatërruar”.²³³⁶

²³²⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 366.

²³²⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 366.

²³³⁰ Aktgjykimi, para. 456, 528, sh. 1934. Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 744, 980. Dhoma e Apelit thekson se gjatë procesit gjyqësor, Gjorgjeviqi kundërshtoi dëshminë e dëshmitarit Popaj i cili tha se xhamia e Celinës u shkatërrua më 28 mars 1999, në kundërshtim me dëshminë e dëshmitar Jeminit lidhur me datën. Megjithëse Dhoma Gjyqësore dëgjoji dëshminë e dëshmitarit Jemini se xhamia u hodh në erë më 30 ose 31 mars 1999, dëshmitar Popaj shpjegoi pasaktësinë e kësaj deklarate, duke qenë se dëshmitar Jemini nuk e kishte parë shpërthimin (Aktgjykimi, sh. 1934). Dhoma Gjyqësore pranoi datën 28 mars 1999 duke u mbështetur në faktin se dëshmitar Popaj e kishte parë shkatërrimin e xhamisë dhe forcat e implikuara në fshatin Celinë. (Aktgjykimi, sh. 1934).

²³³¹ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 129. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 114; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 194.

²³³² Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 23, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 481, 498, Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 31.

²³³³ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 23, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 481, 498, Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 31.

²³³⁴ Aktgjykimi, para. 1833.

²³³⁵ Aktgjykimi, para. 528, 1804, 1833.

²³³⁶ Aktgjykimi, para. 1804.

Dhoma Gjyqësore u mbështet pikërisht në këto dëshmi kur konkludoi se xhamia u shkatërrua me lëndë shpërthyesë të vendosura dhe të komanduara nga larg nga pjesëtarë të MPB-së.

799. Kur konkludoi se edhe xhamia në Bellacërkë u shkatërrua në mënyrë të ngjashme, Dhoma Gjyqësore mori parasysh faktin se shumë pak kohë pas shkatërrimit të xhamisë në Celinë, Dëshmitar Popaj dëgjoi një shpërthim tjetër që vinte nga Bellacërka, pas të cilit ai pa se xhamia e këtij fshati ishte shembur.²³³⁷ Dëshmitar Popaj më pas dëgjoi dhe pa shpërthimin e xhamisë në Rogovë.²³³⁸

800. Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh dëshminë e Dëshmitarit Andrés Riedlmayer (“Dëshmitari Riedlmayer”) se minarja e xhamisë në Rogovë “u hodh në erë me eksplozivë të vendosur poshtë shkallëve, që e shkatërroi atë krejtësisht” dhe konkludoi se ajo nuk përputhej me dëshminë se policia vendosi lëndë shpërthyesë brenda në tri xhamitë para se të largohej dhe t’i shpërthente ato, duke shkaktuar kështu shkatërrimin e tyre.²³³⁹ Për përfundimin e Dhomës Gjyqësore domethënës ishte fakti se tre xhamitë, të cilat ndodheshin në fshatra mjaft afër njëri-tjetrit, u shkatërruan njëra-pas tjetrës, në të njëjtën ditë dhe me metoda të ngjashme.²³⁴⁰

801. Duke marrë parasysh mënyrën si u shkatërruan tri xhamitë, faktin se ato ndodheshin në fshatra mjaft afër njëri-tjetrit dhe u shkatërruan njëra-pas tjetrës brenda disa minutash, si dhe dëshmitë e Dëshmitar Jemini dhe Dëshmitar Riedlmayer-it, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se edhe xhamitë në Bellacërkë dhe Rogovë u shkatërruan nga forcat serbe, në një mënyrë të ngjashme me xhaminë në Celinë.

802. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjes u vërtetua në lidhje me xhamitë në Celinë, Bellacërkë dhe Rogovë.

(b) Xhamia në Landovicë, komuna e Prizrenit

803. Dhoma Gjyqësore u bind se më 26 mars 1999, forcat serbe i vunë zjarrin pjesës së brendshme të xhamisë në Landovicë, në komunën e Prizrenit, dhe më 27 mars 1999 shkaktuan

²³³⁷ Aktgjykimi, para. 477, 1806, 1833.

²³³⁸ Aktgjykimi, para. 931, 1833.

²³³⁹ Aktgjykimi, para. 932.

²³⁴⁰ Aktgjykimi, para. 1836.

shkatërrim të ndjeshëm në minaren dhe strukturën e brendshme të xhamisë me anë të lëndëve shpërthyesë.²³⁴¹

804. Gjorgjeviqi parashtron se asnjë dhomë gjyqësore e arsyeshme nuk do të mund të mbështet vetëm në dëshminë e Halil Morinës (“Morina”) e pranuar sipas Rregullës 92^{quater} për nxjerrjen e konkluzionit se xhamisë në Landovicë ia vunë zjarrin forcat serbe.²³⁴²

805. Prokuroria përgjigjet se përfundimi i Dhomës Gjyqësore nuk u mbështet vetëm në dëshminë e marrë sipas Rregullës 92^{quater}, por në faktin se ajo u konfirmua nga dëshmia e Dëshmitar Riedlmayer-it i cili pa xhaminë pas dëmtimit të pësuar.²³⁴³ Prokuroria më tej parashtron se Gjorgjeviqi thjesht përsërit argumente që nuk u pranuan gjatë gjykimit, pa vërtetuar gabim të Dhomës Gjyqësore.²³⁴⁴

806. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se Prokuroria nuk shpjegon se si dëshmia e Dëshmitar Riedlmayer-it konfirmon dëshminë e Morinës se dëmtimet i shkaktuan forcat serbe.²³⁴⁵

807. Dëshmia e Morinës e cila përfshin deklaratën e tij të dëshmitarit dhe dëshminë e tij gojore në një çështje tjetër, u pranua në çështjen aktuale bazuar në Rregullën 92^{quater} të Rregullores.²³⁴⁶ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit kujton se verdikti i fajësisë jodomosdoshmërisht mbështetet vetëm apo kryesisht në dëshminë e një dëshmitari i cili nuk është marrë në pyetje nga i akuzuari.²³⁴⁷ Në çështjen *Galiq*, Dhoma e Apelit përcaktoi se kur një dëshmi është thelbësore për Prokurorisë dhe “ka të bëjë me vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së vartësve të drejtpërdrejtë të të akuzuarit”, ajo duhet të konfirmohet nga dëshmi të tjera.²³⁴⁸ Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e Morinës – se forcat serbe i vunë zjarrin pjesës së brendshme të xhamisë në Landovicë dhe shkaktuan shkatërrim të ndjeshëm në minaren dhe strukturën e brendshme të xhamisë me anë të lëndëve shpërthyesë – është element kyç i akuzës së Prokurorisë dhe lidhja thelbësore për vërtetimin e përgjegjësisë së Gjorgjeviqit për shkatërrimin e xhamisë nga ana e forcave serbe. Për këtë arsye, Dhoma e Apelit duhet të përcaktojë nëse verdikti i fajësisë për përndjekje përmes shkatërrimit të xhamisë në Landovicë u bazua vetëm apo kryesisht në dëshminë e Morinës.

²³⁴¹ Aktgjykimi, para. 1819.

²³⁴² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(b). Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347(i).

²³⁴³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 367.

²³⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 367.

²³⁴⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 127, përmendet Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 367.

²³⁴⁶ Aktgjykimi, para. 1817, përmendet Prova Materiale P283, f. 3-4, P284, f. 896-897.

²³⁴⁷ *Prokurori k. Jadranko Përliqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim mbi Apelimin e Vendimit për Pranimin si Provë të Transkriptit të Marrjes në Pyetje të Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007, para. 53, 58.

²³⁴⁸ Vendimi i Apelit *Galiq* në lidhje me Rregullën 92^{bis}(C) i datës 7 qershor 2002, para. 13, 18-19. Dhoma e Apelit konkludoi se deklarata e dëshmitarit sipas të cilës topi i komanduar prej një vartësi të të akuzuarit lëshoi një predhë e cila shkaktoi humbje të mëdha, ishte lidhje thelbësore me akuzën e Prokurorisë, dhe për këtë arsye duhej të konfirmohej nga prova të tjera përpara se të pranohej si provë bazuar në Rregullën 92^{bis} të Rregullores (Vendimi i Apelit *Galiq* lidhur me Rregullën 92^{bis}(C) i datës 7 qershor 2002, para. 18-19).

808. Për nxjerrjen e përfundimit në fjalë, Dhoma Gjyqësore gjithashtu u mbështet në dëshminë e Dëshmitar Riedlmayer-it i cili raportoi për shkatërrimet që kishte pësuar xhamia, dhe konkludoi se dëshmia e tij lidhur me llojin dhe mënyrën e shkatërrimit të dëmtimit “përputhet në aspektet juridikisht thelbësore me vëzhgimet e dëshmitarit dhe shërben si konfirmim i pavarur i dëshmisë së tij”.²³⁴⁹ Dhoma e Apelit vëren se dëshmia e Dëshmitar Riedlmayer-it nuk e konfirmon drejtpërsëdrejti dëshminë e Morinës se forcat serbe shkaktuan shkatërrimin e xhamisë në Landovicë. Megjithatë, Dhoma e Apelit citon konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se, duke filluar më 24 mars 1999, forcat serbe zbatuan një praktikë të përsëritur sulmesh, duke hyrë nëpër qytete dhe fshatra në këmbë, dhe duke u vënë zjarrin shtëpive dhe plaçkitur gjërat me vlerë.²³⁵⁰ Konkretisht u konkludua se “ e njëjta praktikë u përsërit edhe gjatë ditëve në vijim, më 26 mars 1999 në Landovicë.”²³⁵¹ Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se praktika e sulmeve të forcave serbe konfirmon dëshminë e Morinës në deklaratën dhe transkriptin e dëshmisë së tij gojore të marra si provë, se forcat serbe i vunë zjarrin pjesës së brendshme të xhamisë në Landovicë. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se përfundimi i Dhomës Gjyqësore nuk mbështetet vetëm apo kryesisht në dëshminë e Morinës të marrë sipas Rregullës 92^{quater}, meqenëse verdikti i fajësisë së Gjorgjeviqit për krimin e përndjekjes përmes shkatërrimit të xhamisë në Landovicë mbështetet edhe nga prova të tjera.²³⁵²

809. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjes u vërtetua lidhur me xhaminë në Landovicë.

(c) Xhamia e Hadumit dhe biblioteka e bashkëngjitur në qytetin e Gjakovës

810. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimi i përndjekjes u vërtetua lidhur me shkatërrimin e Xhamisë së Hadumit dhe bibliotekës ngjitur me të në natën e 24-25 marsit 1999.²³⁵³ Konkretisht, u konkludua se Xhamia e Hadumit u shkatërrua nga zjarri që shkaktuan policia

²³⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1818-1819. Dhoma e Apelit kujton se dëshmitë e bazuara në rrëfimet e të tjerëve në parim janë të pranueshme, megjithëse kur përcaktohet vlera e tyre provuese duhen marrë parasysh rrethanat (Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 656, sh. 1374. Shih *Prokurori k. Zlatko Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë lidhur me Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, para. 15. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 85-86).

²³⁵⁰ Aktgjykimi, para. 2027.

²³⁵¹ Aktgjykimi, para. 2027.

²³⁵² Shih Aktgjykimi *Popoviq dhe të tjerët*, para. 63.

²³⁵³ Aktgjykimi, para. 1831. Shih Aktgjykimi, para. 870, 872.

serbe, “ka të ngjarë në bashkëpunim me forcat paraushtarake”.²³⁵⁴ Megjithëse shqyrtoi argumentin e Gjorgjeviqit se Xhamia e Hadumit u shkatërrua nga goditjet ajrore të NATO-s, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “dëmtimet e xhamisë dhe ndërtesave përreth nuk përputhen me dëmtime të shkaktuara nga goditjet ajrore të NATO-s”.²³⁵⁵

811. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përjashtoi mundësinë që NATO-ja të kishte shkaktuar shkatërrimin e xhamisë duke u mbështetur në faktin se kazerma e UJ-së nuk ndodhej në qendrën historike të qytetit.²³⁵⁶ Ai më tej parashtroi se Dhoma Gjyqësore pa arsye u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit Abrahams se ndërtesave u ishte vënë zjarri nga brenda.²³⁵⁷

812. Prokuroria përgjigjet se kundërshtimi i Gjorgjeviqit duhet hedhur poshtë, meqenëse ai thjesht përsërit argumentet që nuk u pranuan gjatë gjykimit dhe shpërfill arsyetimin e Dhomës Gjyqësore.²³⁵⁸

813. Në nxjerrjen e konkluzionit se forcat serbe dogjën qëllimisht qendrën historike të qytetit të Gjakovës, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes, por gjithsesi hodhi poshtë argumentin e Gjorgjeviqit se dëmtimet e Xhamisë së Hadumit ishin pasojë e goditjeve ajrore të NATO-s.²³⁵⁹ Në kundërshtim me parashttrimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore nuk e përjashtoi NATO-n si shkaktar të mundshëm të shkatërrimit thjesht duke e bazuar në faktin se kazerma e UJ-së nuk ndodhej në pjesën e vjetër historike të qytetit.²³⁶⁰ Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore mori parasysh një raport të Shtabit të MPB-së ku thuhej se gjatë natës së 24 marsit dhe herët në mëngjesin e 25 marsit 1999, avionë të NATO-s qëlluan me predha të cilat goditën qendrën historike të qytetit, por “nuk ishte në gjendje të pranonte këtë raport si të besueshëm” duke marrë parasysh ndryshimin midis këtij raporti dhe provave në vijim:²³⁶¹ (i) ditarët e luftës të njëjstëve të UJ-së të pranishme në qytet, ku nuk është regjistruar një bombardim i tillë i qytetit të vjetër;²³⁶² (ii) faktin se asnjë prej dëshmitarëve në terren në zonat përkatëse në kohën në fjalë nuk ka dëshmuar se NATO-ja bombardoi pjesën e vjetër të qytetit apo zona të tjera civile në qytet;²³⁶³ (iii) dëshmia e Dëshmitarit Abrahams, studiues nga Human Rights Watch, i cili pa se xhamisë i ishte vënë zjarri nga brenda, meqenëse muret e xhamisë vazhdonin të qëndronin, kurse çatitë e xhamisë ishin të djegura;²³⁶⁴ (iv) dëshmia e dëshmitarit

²³⁵⁴ Aktgjykimi, para. 1831. Shih Aktgjykimi, para. 870, 872.

²³⁵⁵ Aktgjykimi, para. 1831. Shih Aktgjykimi, para. 870, 872.

²³⁵⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(c).

²³⁵⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(c).

²³⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 368, përmendet Aktgjykimi, para. 866-870, 1830-1832.

²³⁵⁹ Aktgjykimi, para. 865-870, 1830-1832. Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 1005-1008.

²³⁶⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(c).

²³⁶¹ Aktgjykimi, para. 866.

²³⁶² Aktgjykimi, para. 867.

²³⁶³ Aktgjykimi, para. 868.

²³⁶⁴ Aktgjykimi, para. 869.

Riedlmayer se “pjesët e brendshme të ndërtesave ishin të djegura plotësisht deri në çati” dhe se “nuk kishte shenja të ndonjë dëmtimi të shkaktuar nga shpërthimet” që mund të pritej në rast goditjesh nga ajri;²³⁶⁵ dhe (v) edhe një fotografi ajrore apo satelitore nga Departamenti amerikan i Mbrojtjes e cila tregon xhaminë e paprekur ndërsa pazarin aty afër duke u djegur.²³⁶⁶ Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëmtimet e xhamisë dhe ndërtesave ngjitur me të “nuk përputheshin me dëm të shkaktuar nga bombardim nga ajri”.²³⁶⁷ Dhoma e Apelit konkludon se në bazë të këtyre faktorëve, Dhoma Gjyqësore me arsye përjashtoi NATO-s si shkaktar të shkatërrimit të Xhamisë së Hadumit dhe bibliotekës ngjitur me të.

814. Përsa i përket kundërshtimit të Gjorgjeviqit në lidhje me mbështetjen e Dhomës Gjyqësore në dëshminë e Dëshmitarit Abrahams,²³⁶⁸ Dhoma e Apelit thekson se dëshmia e tij se dukej se ndërtesave u ishte vënë zjarr nga brenda përputhej me dëshminë e Dëshmitarit Riedlmayer, i cili raportoi se pjesët e brendshme të ndërtesave “ishin të djegura plotësisht deri në çati” dhe se “nuk kishte shenja të ndonjë dëmtimi të shkaktuar nga shpërthimet, që mund të priten nëse pazari do të ishte goditur nga ajri”.²³⁶⁹ Ndonëse nuk ka nevojë për konfirmim përpara pranimit të dëshmisë së një dëshmitari, Dhoma e Apelit thekson se dëshmia e Dëshmitarit Riedlmayer, jo vetëm që konfirmon dëshminë e Dëshmitarit Abrahams, por edhe përputhet me përjashtimin e mundësisë se shkatërrimi u shkaktua nga NATO-ja.²³⁷⁰

815. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjes u vërtetua në lidhje me Xhaminë e Hadumit dhe bibliotekën islamike ngjitur me të.

(d) Xhamia në Llashticë, komuna e Gjilanit

816. Dhoma Gjyqësore u bind se xhamia në Llashticë, në komunën e Gjilanit, u dëmtua rëndë dhe biblioteka e saj u shkatërrua nga forcat serbe të cilët i vunë zjarrin xhamisë më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date.²³⁷¹ Dhoma Gjyqësore theksoi se forcat serbe hynë në fshat dhe dogjën shtëpi të fshatit, dhe se xhamia a Llashticës ishte ndërtesa e parë që u dogj.²³⁷²

²³⁶⁵ Aktgjykimi, para. 869.

²³⁶⁶ Aktgjykimi, para. 869.

²³⁶⁷ Aktgjykimi, para. 1831.

²³⁶⁸ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 377(c).

²³⁶⁹ Aktgjykimi, para. 869, përmendet Prova Materiale P1098, f. 6, 50, P1137, f. 173, P1105, f. 1, P1106, Andrés Riedlmayer, 16 korrik 2009, T. 7509-7511.

²³⁷⁰ Shih Aktgjykimi, para. 869.

²³⁷¹ Aktgjykimi, para. 1055, 1841.

²³⁷² Aktgjykimi, para. 1055, 1838.

817. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se xhamia e Llashticës ishte ndërtesa e parë që u dogj nga forcat serbe, duke u mbështetur në dëshminë e pakonfirmuar të Dëshmitarit K81, i cili i pa ngjarjet nga një largësi nga mali.²³⁷³

818. Prokuroria përgjigjet se argumenti i Gjorgjeviqit meriton rrëzim të menjëhershëm.²³⁷⁴

819. Dhoma e Apelit vëren se e vetmja dëshmi e drejtpërdrejtë se xhamia ishte ndërtesa e parë që u dogj nga forcat serbe vjen nga Dëshmitari K81.²³⁷⁵ Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore mund të mbështetet në dëshminë e një dëshmitari të vetëm lidhur me një fakt juridikisht thelbësor, pa qenë e nevojshme që ajo të konfirmohet nga prova të tjera,²³⁷⁶ dhe ka kompetenca të brendaqenësishme për të përcaktuar se çfarë rëndësie dhe besueshmërie do t'i kushtojë dëshmisë së një dëshmitari.²³⁷⁷ Dhoma e Apelit thekson se nga dëshmia e Dëshmitarit K81 rezulton se ai ishte në majë të malit kur i pa forcat serbe duke i vënë zjarrin xhamisë dhe se kjo nuk u përmend shprehimisht nga Dhoma Gjyqësore. Gjithsesi, dëshmia e Dëshmitarit K81 tregon se ai i vëzhgoi ngjarjet nga një largësi të cilën ai e përshkroi si “mjaf afër sa unë mund t'i shikoja ngjarjet”,²³⁷⁸ dhe se ai kishte dylbi.²³⁷⁹

820. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se dëshmia e Dëshmitarit K81 se xhamia u shkatërrua nga zjarri përputhet me dëshminë e Dëshmitarit Riedlmayer i cili, në bazë të analizës së një fotografie që i kishte dhënë bashkësia islame, konstatoi se xhamia e Llashticës ishte “dëmtuar rëndë” nga një zjarr i fuqishëm.²³⁸⁰ Rrjedhimisht, bazuar në vendin nga i cili Dëshmitari K81 i vëzhgoi ngjarjet dhe përputhshmërinë e dëshmisë së tij me dëshminë e Dëshmitarit Riedlmayer, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore veproi në mënyrë të arsyeshme brenda kompetencave të veta duke u mbështetur në dëshminë e Dëshmitarit K81.

821. Gjithsesi, dëshmia e Dëshmitarit Riedlmayer nuk konfirmon dëshminë e Dëshmitarit K81 se xhamia ishte ndërtesa e parë të cilës forcat serbe i vunë zjarrin. Dhoma e Apelit gjykon se në këto rrethana, konfirmimi nuk është i domosdoshëm dhe fakti nëse xhamia në Llashticë ishte ndërtesa e parë që u shkatërrua nuk ndikon aspak në përfundimin e arsyeshëm të Dhomës Gjyqësore se xhamia u dëmtua nga zjarri që shkaktuan forcat serbe.

²³⁷³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347(g); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 106(b).

²³⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 307.

²³⁷⁵ K81, 15 maj 2009, T. 4535. Shih Aktgjykimi, para. 1055, 1838.

²³⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 375; Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 78; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 203; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 274; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 506; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 65.

²³⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 86, 235, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47, Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 116, Aktgjykimi i Apelit *Nahimanadhe të tjerët*, para. 194.

²³⁷⁸ Prova Materiale P791, deklaratë e datës 30 maj 1999, f. 3.

²³⁷⁹ Shih K81, 15 maj 2009, T. 4535.

²³⁸⁰ Aktgjykimi, para. 1838, citon Prova Materiale P1125.

822. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në të njëjtin përfundim si ai i Dhomës Gjyqësore, dhe rrjedhimisht nuk provoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i përndjekjes u vërtetua në lidhje me shkatërrimin e xhamisë së Llashticës më 6 prill 1999, ose rreth kësaj date.

C. Përfundim

823. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përfundoi se u vërtetuan krimet e dëbimit, përndjekjes, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit.

824. Dhoma e Apelit rrëzon tërësisht pikën e shtatëmbëdhjetë dhe pjesërisht pikën e pesëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.²³⁸¹

²³⁸¹ Pjesa tjetër e pikës së pesëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit është hedhur poshtë (më lart, Kapitulli XV).

**XVIII. PIKA E TETËMBËDHJETË E APELIT TË GJORGJEVIQIT:
PRETENDIM PËR GABIME LIGJORE LIDHUR ME FAJËSINË E
SHUMËFISHTË**

**A. Pretendim për gabime ligjore lidhur me verdikte fajësie në bazë të ndërmarrjes së
përbashkët kriminale dhe ndihmës e inkurajimit**

825. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për krimet e vrasjes, dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) dhe përndjekjes (nëpërmjet dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjes dhe shkatërrimit të objekteve fetare ose kulturore), bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit, për pjesëmarrje në NPK²³⁸² dhe njëkohësisht për ndihmë dhe inkurajim të këtyre krimeve.²³⁸³ Dhoma Gjyqësore më tej theksoi se “format e përgjegjësisë sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, dhe është e mundur që një i akuzuar të shpallet fajtor për më shumë forma të përgjegjësisë në lidhje me një krim, në qoftë se kjo do të pasqyroste më mirë tërësinë e sjelljes së tij.”²³⁸⁴ Dhoma më tej theksoi se faktet e çështjes ishin “mjafat bindëse” për konfirmimin e fajësisë së tij për ndihmë dhe inkurajim, si dhe fajësisë për pjesëmarrje si anëtar në NPK, “me qëllim që të pasqyrohet tërësia e sjelljes kriminale të të Akuzuarit”.²³⁸⁵

1. Argumentet e palëve

826. Gjorgjeviqi parashtroi se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur e shpalli fajtor dy herë për të njëjtat krime: një herë për kryerjen e krimeve nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale; dhe të dytën herë për ndihmë dhe inkurajim të të njëjtave krime.²³⁸⁶ Sipas Gjorgjeviqit, fajësi të tilla të dyfishta sipas paragrafit 1 të Nenit 7 të Statutit janë “të palejueshme dhe logjikisht të papajtueshme me njëra-tjetrën”,²³⁸⁷ dhe mjegullojnë dallimin e përcaktuar me përpikmëri midis këtyre dy formave të përgjegjësisë.²³⁸⁸ Gjorgjeviqi më tej parashtroi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në jurisprudencën që as nuk trajton çështjen e fajësisë së njëkohshme për “kryerje përmes pjesëmarrjes në NPK” dhe për ndihmë dhe inkurajim, dhe se ndihma dhe inkurajimi gjithsesi nuk rezultojnë në fajësi të njëkohshme.²³⁸⁹ Gjorgjeviqi argumenton se kur nxirret përfundimi për kryerje përmes

²³⁸² Aktgjykimi, para. 2193, 2230. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2213.

²³⁸³ Aktgjykimi, para. 2164, 2194, 2230. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2214.

²³⁸⁴ Aktgjykimi, para. 2194.

²³⁸⁵ Aktgjykimi, para. 2194.

²³⁸⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 380-381; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 103-104, 110.

²³⁸⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 380. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 104.

²³⁸⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 392. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 387-391.

²³⁸⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 382; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 105. Gjorgjeviqi argumenton se çështjet e cituara nga Dhoma Gjyqësore, konkretisht *Nahimana*, *Ndindabahizi*, dhe *Kamuhanda*, nuk janë udhërrëfyese, sepse ato nuk trajtojnë çështjen e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (Seanca e Apelit, 13 maj

pjesëmarrjes në ndërmarrje të përbashkët kriminale, të gjitha format e tjera të akuzuara të përgjegjësive “bien”.²³⁹⁰ Ai parashtrohet se është e logjikshme që “autori kryesor i krimit nuk mund të jetë bashkautor i të njëjtit krim, ashtu sikurse bashkautorit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe autor kryesor i krimit”.²³⁹¹ Gjorgjeviqi më tej argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk ofroi arsytim se pse fajësia e tij për dy forma të përgjegjësive pasqyron më së miri tërësinë e sjelljes së tij kriminale.²³⁹² Për mendimin e tij, mungesa e një arsytimi të qartë nga ana e Dhomës Gjyqësore e bën të pavlefshëm gjithë Aktgjykimin dhe përligj shfuqizim e të gjitha verdiketeve të fajësive, apo më së paku të fajësive sipas njërës nga këto dy forma të përgjegjësive, dhe si rrjedhojë uljen përkatëse të dënimit.²³⁹³ Së fundi, Gjorgjeviqi parashtrohet se ai pësoi padrejtësi, duke qenë se Dhoma Gjyqësore, ndër të tjera, “nuk përcaktoi qartë përgjegjësinë e tij penale”,²³⁹⁴ dhe se atij iu dha dënim më i rëndë si pasojë e fajësive së dyfishtë.²³⁹⁵

827. Në përgjigjen e vet, Prokuroria parashtrohet se një person mund të kryejë një krim të vetëm në më shumë mënyra, dhe se në raste të tilla, dhoma gjyqësore gëzon kompetencë të shpallë fajësi të njëkohshme.²³⁹⁶ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore veprroi në mënyrë të arsyeshme kur duke shfrytëzuar kompetencën në fjalë, shpalli fajësi të njëkohshme

2013, AT. 105). Gjorgjeviqi gjithashtu parashtrohet se kjo jurisprudencë “e ka zanafillën në” Aktgjykimin *Akayesu* ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se shpallja e një të akuzuari fajtor nuk përligjet në rastet kur “një shkelje përbën akuzë si bashkëfajtor, dhe një tjetër si autor kryesor” në lidhje me të njëjtat fakte (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 383; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 105, citon Aktgjykimin *Akayesu*, para. 468). Gjorgjeviqi më tej argumenton se gjuha e përdorur nga Dhoma Gjyqësore se “sjellja e tij ishte e tillë që kërkon dënim dhe ndëshkim edhe për ndihmë e inkurajim të shkeljeve të provuara” e dallon çështjen e tij nga çështja *Gatete*, ku Dhoma e Apelit e TPNR-së konkludoi se “thjesht përmendja e kategorive të tjera të përgjegjësive nuk përbën verdikte të tjera fajësie” (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 103-104, përmendet Aktgjykimi, para. 2214, Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 235).

²³⁹⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 106. Gjorgjeviqi u referohet aktgjykimeve të kohëve të fundit ku dhomat gjyqësore i përmbahen praktikës së mosshpalljes së fajësive për forma të tjera të përgjegjësive në qoftë se kanë nxjerrë përfundimin për ndërmarrjen të përbashkët kriminale (Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 106, përmendet Aktgjykimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*, vëll. 2, para. 529, 780, Aktgjykimi *Gotovina dhe të tjerët*, vëll. 2, para. 2375, 2587, Aktgjykimi *Tolimir*, para. 1174, sh. 4509).

²³⁹¹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 106. Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 105, përmendet Aktgjykimi *Akayesu*, para. 468.

²³⁹² Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 107-111. Kur parashtrohet se Dhoma Gjyqësore nuk ofroi arsytim, Gjorgjeviqi i referohet Aktgjykimit të Apelit *Gotovina dhe Markaç*, ku Dhoma e Apelit theksoi qartësisht se “përfundimi për kontribut të konsiderueshëm nuk është i njëjtë me përfundimin për kontribut thelbësor të nevojshëm për fajësi për ndihmë dhe inkurajim” (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 107-108, citon Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*, para. 149). Gjorgjeviqi parashtrohet se Dhoma Gjyqësore nuk shpjegoi se si konkluzioni se ai mori pjesë në NPK “në një farë mënyre transformohet në ndikim thelbësor [...] apo se si ai ndihmoi thelbësisht” (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 108, përmendet Aktgjykimi, para. 2158, 2163, 2194).

²³⁹³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 380, 398. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 393.

²³⁹⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 393-395; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 110, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 217, Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 169.

²³⁹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 396-397; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 103-104; 110-111. Gjorgjeviqi argumenton se shihet qartë se ai u shpall fajtor dy herë për të njëjtat veprime (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 103-104, përmendet Aktgjykimi, para. 2214).

²³⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 369, 373. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 371; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 137-139, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*. Prokuroria i referohet konkretisht Aktgjykimit të Apelit *Ndindabahizi* dhe argumenton se, në kundërshtim me parashttrimin e Gjorgjeviqit, ai ka të bëjë me çështjen aktuale meqenëse trajton fajësinë

për të pasqyruar plotësisht veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të Gjorgjeviqit.²³⁹⁷ Prokuroria gjithashtu përgjigjet se sjellja për të cilën Gjorgjeviqi u shpall përgjegjës nuk është plotësisht e njëjtë sipas dy formave të përgjegjësisë.²³⁹⁸ Konkretisht, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore u mbështet në katër forma të kontributit në NPK: (i) roli i Gjorgjeviqit në planifikimin dhe bashkërendimin e operacioneve të MPB-së; (ii) roli i Gjorgjeviqit në dislokimin e Akrepave dhe njërive të tjera vullnetare; (iii) roli i tij në fshehjen e kufomave; (iv) dhe mosmarrja prej tij e masave për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve.²³⁹⁹ Megjithatë, sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore u mbështet vetëm në tri format e fundit të kontributit në NPK kur konkludoi se Gjorgjeviqi gjithashtu ndihmoi dhe inkurajoi krimet.²⁴⁰⁰ Për mendimin e Prokurorisë, kjo tregon se Dhoma Gjyqësore u përqendrua në këtë aspekt të veçantë të sjelljes së tij.²⁴⁰¹ Prokuroria më tej parashtron se në kundërshtim me pretendimin e Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore faktikisht nxori nga një verdikt fajësie për çdo pikë²⁴⁰² dhe se dënimi u bazua në tërësinë e veprimeve të tij.²⁴⁰³ Rrjedhimisht, fajësia e njëkohshme nuk ndikoi aspak në dënimin e Gjorgjeviqit.²⁴⁰⁴ Prokuroria kërkon që Dhoma e Apelit të rrëzojë menjëherë argumentin e Gjorgjeviqit “si kundërshtim teorik i ligjit mbi fajësinë e njëkohshme”.²⁴⁰⁵

828. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se një i akuzuar nuk mund të kryejë një krim të vetëm në më shumë mënyra, në qoftë se bëhet fjalë për synim kriminal dhe/ose veprim të fajshëm të ndryshëm në të njëjtën kohë.²⁴⁰⁶ Ai thekson se argumenti i tij është faktikisht thelbësor dhe jo thjesht teorik, meqenëse Dhoma Gjyqësore shpalli fajësi për të dy format e përgjegjësisë faktor që ndikoi në dënimin e tij.²⁴⁰⁷

“përmes formave të njëkohshme të kryerjes, ndihmës dhe inkurajimit dhe nxitjes” në lidhje me veprime pjesërisht të përputhshme (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 138; krahaso Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 105).

²³⁹⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 373-376, 385-386. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 370-371; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136-137, 141. Për më tepër, përse i përket argumentit të Gjorgjeviqit në lidhje me Aktgjykimin *Akayesu*, Prokuroria qartëson se në atë çështje, Dhoma Gjyqësore trajtoi fajësinë e shumëfishtë dhe gjykoj se nuk ishte e drejtë që të shpallej fajësi si për gjenocid, po ashtu edhe për bashkëfajësi në kryerjen e gjenocidit, ndërkohë që çështja aktuale ka të bëjë me fajësi përmes formave të përgjegjësisë së njëkohshme (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 141; krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 383; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 105-106, citon Aktgjykimin *Akayesu*, para. 468).

²³⁹⁸ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136.

²³⁹⁹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136.

²⁴⁰⁰ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136.

²⁴⁰¹ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136.

²⁴⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 371, 381; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 139-141. Sipas Prokurorisë, fajësia a shpallur në bazë të më shumë formave të përgjegjësisë nuk rezulton në një fajësi të dyfishtë për të njëjtin krim (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 139, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Schomburg, para. 389).

²⁴⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 371-372, 382-386; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 140-141, përmendet Aktgjykimin, para. 2214.

²⁴⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 372, 382, 386.

²⁴⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 372. Shih Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 380-386.

²⁴⁰⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 129, citon Dosjen e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 369.

²⁴⁰⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 131.

2. Analizë

829. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore shpalli verdikte fajësie kundër Gjorgjeviqit për secilin nga krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasjes dhe përndjekjes, si në bazë të pjesëmarrjes së tij në NPK,²⁴⁰⁸ po ashtu dhe për ndihmë dhe inkurajim të të njëjtave krime.²⁴⁰⁹ Kjo del qartë nga formulimi i përfundimeve ligjore të Dhomës Gjyqësore²⁴¹⁰ dhe nga Vendimi në Aktgjykimin e saj.²⁴¹¹

830. Për të konkluduar nëse Gjorgjeviqi mund të shpallej fajtor edhe për ndihmë dhe inkurajim të krimeve, Dhoma Gjyqësore u mbështet në të njëjtat veprime bazë që përcaktonin pjesëmarrjen e tij në NPK.²⁴¹² [Dhoma Gjyqësore] u bind se veprimet e Gjorgjeviqit “ndikuan thelbësisht në kryerjen e krimeve të vrasjes, dëbimit dhe përndjekjes në Kosovë më 1999, nga forcat e MPB-së” dhe se ai ishte “i vetëdijshëm se veprimet e tij ndihmonin kryerjen e këtyre krimeve”.²⁴¹³ Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se:

Në këtë çështje, roli drejtues i të Akuzuarit në përpjekjet e MPB-së për fshehjen e vrasjeve të civilëve shqiptarë kosovarë dhe të personave të tjerë që nuk merrnin pjesë aktive në luftimet, nëpërmjet organizimit të transportimit të fshehtë të kufomave të personave të vrarë prej forcave serbe në Kosovë për në varre të përbashkëta që ndodheshin në objekte që ishin pronë e MPB-së në Serbi, së bashku me masat që ai ndërmoi për parandalimin e çdo hetimi të mundshëm të rrethanave të këtyre vrasjeve, dhe duke qenë se si shef i RJB-së ai nuk mori masat e nevojshme për raportimin dhe hetimin e të gjitha shkeljeve të kryera prej forcave të MPB-së, të gjithë këta faktorë kontribuan thelbësisht në kryerjen e këtyre krimeve. Këto fakte janë mjaft bindëse për konfirmimin e fajësisë për ndihmë dhe inkurajim, si dhe fajësisë për pjesëmarrje si anëtar në NPK, me qëllim që të pasqyrohet tërësia e sjelljes kriminale të të Akuzuarit.²⁴¹⁴

831. Dhoma e Apelit kujton se dhomave gjyqësore nuk u ndalohet automatikisht të shpallin fajësi për një krim mbi bazën e më shumë formave të përgjegjësisë, në qoftë se është e nevojshme për të pasqyruar tërësinë e sjelljes kriminale të një të akuzuari.²⁴¹⁵ Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore parashtrroi siç duhej ligjin përkatës lidhur me verdiktet e fajësisë

²⁴⁰⁸ Aktgjykimi, para. 2159, 2193, 2230.

²⁴⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2194, 2214, 2230. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2164.

²⁴¹⁰ Lidhur me pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në NPK, Dhoma Gjyqësore theksoi shprehimisht se “do të shpallë fajësi mbi këtë bazë” (Aktgjykimi, para. 2159). Megjithatë nuk bëri një deklaratë të tillë lidhur me ndihmën dhe inkurajimin, formulimi gjuhësor gjetkë në Aktgjykim qartë tregon se Dhoma Gjyqësore synonte të shpallte fajësi për çdo krim edhe mbi bazën e kësaj forme përgjegjësie: “Dhoma është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe e shpall Vllastimir Gjorgjeviqin fajtor për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të dëbimit, shpërnguljes së dhunshme, vrasjes dhe përndjekjes të vërtetuara në këtë Aktgjykim” (Aktgjykimi, para. 2164); “Këto fakte janë mjaft bindëse për konfirmimin e fajësisë për ndihmë dhe inkurajim, si dhe fajësisë për pjesëmarrje si anëtar në NPK, me qëllim që të pasqyrohet tërësia e sjelljes kriminale të të Akuzuarit” (Aktgjykimi, para. 2194); Gjithsesi, siç u shpjegua në këtë Aktgjykim, sjellja e të Akuzuarit ishte e tillë që kërkon dënim dhe ndëshkim edhe për ndihmë e inkurajim të shkeljeve të provuara” (Aktgjykimi, para. 2214).

²⁴¹¹ Aktgjykimi, para. 2230.

²⁴¹² Aktgjykimi, para. 2154-2158, 2162-2163. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2194.

²⁴¹³ Aktgjykimi, para. 2163.

²⁴¹⁴ Aktgjykimi, para. 2194.

²⁴¹⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 483; Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122; Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 77. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 274.

bazuar në forma të shumëfishta të përgjegjesisë.²⁴¹⁶ Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se kuadri i përgjegjesisë penale të një personi të shpallur fajtor duhet të përcaktohet qartësisht²⁴¹⁷ dhe se dhoma gjyqësore duhet të “identifikojë qartësisht format e përgjegjesisë për të cilat një i akuzuar shpallet fajtor, si dhe lidhjen midis tyre”.²⁴¹⁸ Dhoma e Apelit thekson se nuk ka rëndësi nëse konsiderohen të përshtatshme një apo më shumë forma të përgjegjesisë, meqenëse është krimi, dhe jo forma e përgjegjesisë, baza e verdiktit të fajësisë së një të akuzuari.²⁴¹⁹ Rrjedhimisht, çdo dënim që cakton një dhomë gjyqësore duhet të pasqyrojë tërësinë e sjelljes kriminale të personit të shpallur fajtor, dhe personi i shpallur fajtor nuk duhet të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën sjellje kriminale.²⁴²⁰ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor vetëm një herë për krimet bazuar në dy forma të përgjegjesisë, dhe jo dy herë për të njëjtat krime, siç pretendon ai.²⁴²¹ Për këtë arsye, Dhoma e Apelit konkludon se, në përputhje me ligjin, Dhoma Gjyqësore kishte kompetenca për të shpallur fajësi bazuar në më shumë forma të përgjegjesisë.

832. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se, në kundërshtim me parashtrimin e Prokurorisë,²⁴²² sjellja kriminale që Dhoma Gjyqësore mori parasysh kur vërtetoi fajësinë e Gjorgjeviqit për ndihmë dhe inkurajim të krimeve është pasqyruar tërësisht në sjelljen kriminale që mori parasysh kur vërtetoi pjesëmarrjen e tij në NPK, dhe se Dhoma Gjyqësore nuk bëri dallim midis veprimeve që kreu Gjorgjeviqi në lidhje me dy format e përgjegjesisë.²⁴²³ Në këto rrethana, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se “këto fakte janë mjaft bindëse për konfirmimin e fajësisë për ndihmë dhe inkurajim, [...] me qëllim që të pasqyrohet tërësia e sjelljes kriminale të Gjorgjeviqit” nuk shpjegon lidhjen midis dy formave të përgjegjesisë.²⁴²⁴ Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk arriti të shpjegonte se pse ishin të nevojshme dy format e përgjegjesisë për të pasqyruar tërësinë e sjelljes së tij,²⁴²⁵ sidomos duke pasur parasysh përfundimin e saj të

²⁴¹⁶ Aktgjykimi, para. 2194, citon Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 483; Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122-123; Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 77.

²⁴¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122.

²⁴¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 123. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122.

²⁴¹⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, Mendim i Veçantë dhe Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 405.

²⁴²⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*, para. 122. Shih gjithashtu *Prokurori k. Millorad Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-PT, Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes në lidhje me Formën e Aktakuzës, 24 shkurt 1999, para. 10. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, Mendim i Veçantë i Gjykatësit Wolfgang Schomburg, para. 389.

²⁴²¹ Shih Aktgjykimi, para. 2194, 2230. Krahaso Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 380-381.

²⁴²² Shih më lart, para. 827; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 136. Dhoma e Apelit e gjykon jobindës argumentin e Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore u mbështet në veprime pjesërisht të ndryshme kur nxori përfundimin për ndihmë dhe inkurajim. Prokuroria citon një paragraf përmbledhës mbi përgjegjësinë penale të Gjorgjeviqit dhe shpërfill përfundimet e tjera të Dhomës Gjyqësore lidhur me ndihmën dhe inkurajimin (krahaso Aktgjykimin, para. 2194 me Aktgjykimin, para. 2160-2164).

²⁴²³ Krahaso Aktgjykimin, para. 2154-2158 me Aktgjykimin, para. 2160-2164. Dhoma e Apelit veçanërisht vë në dukje arsyetimin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me mosmarrjen prej Gjorgjeviqit të masave për parandalimin dhe hetimin e krimeve, rolin e tij aktiv në angazhimin e njëjësive vullnetare dhe paraushtarake, dhe rolin e tij udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për fshehjen e vrasjeve (Shih Aktgjykimi, para. 2154-2156, 2163).

²⁴²⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2194.

²⁴²⁵ Shih Aktgjykimi, para. 2194.

qartë se “përgjegjësia kryesore penale e Gjorgjeviqit në këtë çështje konkretizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tij [...] në ndërmarrjen e përbashkët kriminale”.²⁴²⁶ Për mendimin e Dhomës së Apelit, kjo përbën mosdhënie të një mendimi të arsyetuar, dhe rrjedhimisht gabim ligjor të Dhomës Gjyqësore.²⁴²⁷

833. Si pasojë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse verdiktet e fajësisë bazuar në ndihmë dhe inkurajim dhe në kryerje përmes NPK-së janë të nevojshme për të pasqyruar tërësinë e sjelljes kriminale të Gjorgjeviqit. Duke pasur parasysh faktin se dy format e përgjegjësisë u vërtetuan mbi bazën e të njëjtës sjellje kriminale,²⁴²⁸ Dhoma e Apelit gjykon se fajësia në bazë të të dy formave të përgjegjësisë nuk është e domosdoshme për të pasqyruar tërësinë e sjelljes së Gjorgjeviqit. Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma e Apelit është e të njëjtit mendim me Dhomën Gjyqësore se “përgjegjësia kryesore penale” e Gjorgjeviqit konkretizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në NPK.²⁴²⁹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se tërësia e sjelljes kriminale të Gjorgjeviqit është pasqyruar plotësisht në verdiktin e fajësisë të bazuar vetëm në pjesëmarrjen e tij në NPK.

834. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht nënplikën 18(A) të apelit të Gjorgjeviqit, shfuqizon përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me Pikat 1-5 përsa i përket ndihmës dhe inkurajimit, dhe hedh poshtë pjesën tjetër të nënplikës 18(A) të apelit të Gjorgjeviqit. Duke marrë parasysh këtë vendim të Dhomës së Apelit, nuk është i nevojshëm shtjellimi i pikës 11 të apelit të Gjorgjeviqit ku ai pretendon gabime lidhur me ndihmën dhe inkurajimin.²⁴³⁰ Ndikimi i mundshëm i këtij vendimi dhe pyetja nëse Gjorgjeviqit iu dha një dënim më i ashpër si pasojë e “fajësisë së dyfishtë”,²⁴³¹ do të shtjellohen në pjesën lidhur me dënimin në këtë Aktgjykim.²⁴³²

B. Pretendim për gabime ligjore në shpalljen e fajësisë së shumëfishtë prej Dhomës Gjyqësore bazuar në Nenin 5 të Statutit

835. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor, bazuar në Nenin 5 të Statutit të Tribunalit, për dëbim (Pika 1), veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2), dhe vrasje (Pika 3), dhe për përndjekje (Pika 5) nëpërmjet krimeve të njëjta bazë.²⁴³³ Ajo

²⁴²⁶ Aktgjykimi, para. 2213 (theksi i shtuar).

²⁴²⁷ Shih më lart, para. 14-15.

²⁴²⁸ Aktgjykimi, para. 2154-2158, 2162-2163.

²⁴²⁹ Aktgjykimi, para. 2213.

²⁴³⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 296-303.

²⁴³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 396.

²⁴³² Shih më poshtë, para. 976-980.

²⁴³³ Aktgjykimi, para. 2202, 2230. Shih gjithashtu Aktgjykimi para. 2196-2201.

konkludoi se këto krime përmbanin elementë juridikisht të dallueshëm dhe se rrjedhimisht shpallja e fajësisë së shumëfishtë ishte e lejueshme.²⁴³⁴

1. Argumentet e palëve

836. Gjorgjeviqi parashtroi se fajësia e tij e shumëfishtë për krimet e dëbimit, zhvendosjes së dhunshme dhe vrasjes, dhe për përndjekje përmes të njëjtës sjellje kriminale bazuar në Nenin 5 të Statutit ishte e padrejtë dhe paragjyquese.²⁴³⁵ Sipas tij, “Dhoma Gjyqësore nuk dha një shpjegim të përshtatshëm se çfarë elementësh juridikisht të dallueshëm përmbajnë, apo pse pikat fillestare nuk përfshihen në krime më konkrete si për shembull përndjekja”.²⁴³⁶ Gjorgjeviqi më tej parashtroi se ekzistojnë “arsye bindëse për të korrigjuar këtë aspekt dhe për tu mbështetur në jurisprudencën burimore e cila nuk lejon fajësi të shumëfishtë bazuar në Nenin 5”, duke marrë parasysh mendime të ndryshme mospajtuese lidhur me këtë aspekt në aktgjykimet e apelit, si dhe aktgjykimin e paradokohshëm të ECCC-së (“*Duch Trial Judgment*”).²⁴³⁷ Rrjedhimisht, Gjorgjeviqi kërkon që Dhoma e Apelit të shfuqizojë verdiktet e fajësisë së tij bazuar në Nenin 5 të Statutit, meqenëse bëhet fjalë për fajësi të shumëfishtë e cila pasqyron të njëjtën sjellje kriminale.²⁴³⁸

837. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore kishte kompetencë për të shpallur Gjorgjeviqin fajtor për krimet e dëbimit, vrasjes dhe zhvendosjes së dhunshme dhe për krimin e përndjekjes përmes këtyre veprimeve.²⁴³⁹ [Prokuroria] më tej parashtroi se Dhoma Gjyqësore zbatoi jurisprudencën ekzistuese e cila lejon fajësi të shumëfishtë kur krimet nga Neni 5 përmbajnë elementë juridikisht të dallueshëm, dhe thekson se precedentë të tillë nuk mund të anashkalohen pa arsye të fortë.²⁴⁴⁰ Së fundi, Prokuroria parashtroi se Gjorgjeviqi nuk shpjegon se si Dhoma Gjyqësore nuk arsyetoi mjaftueshëm vlerësimin e saj, apo për çfarë arsye jurisprudenca ekzistuese mund të karakterizohet në zhvillim e sipër.²⁴⁴¹

²⁴³⁴ Aktgjykimi, para. 2198-2201.

²⁴³⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 399, 405; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 110, përmendet Aktgjykimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*, vëll. 2, para. 912.

²⁴³⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 405.

²⁴³⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 402-403, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, Mendim i Përbashkët Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Mospajtuës i Gjykatësit Güney lidhur me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, Mendim i Përbashkët Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, Mendim Pjesërisht Mospajtuës i Gjykatësit Güney. *Prokurori k. Guek Eav Kaing i njohur si “Duch”*, Lënda Nr. 001/18-07-2007/ECCC/TC, Aktgjykim, 26 korrik 2010, para. 563-565. Gjorgjeviqi parashtroi se krimet bazë të vrasjes, dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme “pasqyrohen në verdiktin e fajësisë për përndjekje përmes këtyre krimeve” (Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 136).

²⁴³⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 406.

²⁴³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 387.

²⁴⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 387-389.

²⁴⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 390, citon Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 399, 405.

838. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se praktika e shpalljes së fajësisë së shumëfishtë “filloi të zbatohet në fund të vitit 2004, me një vendim të një shumice të ngushtë prej 3:2, i cili ndryshoi praktikën shumëvjeçare të deriatëhershme”.²⁴⁴²

2. Analizë

839. Tribunali ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me çështjen e fajësisë së shumëfishtë. Dhoma e Apelit në çështjen *Çelebiqi* gjykoj se fajësia e shumëfishtë është e lejueshme në bazë të dispozitave të ndryshme statutoare për ndëshkimin e të njëjtës sjellje kriminale në qoftë se “çdo dispozitë statutoare përkatëse përmban një element juridikisht të ndryshëm nga tjetra”.²⁴⁴³ Si rrjedhojë, standardi që ka zbatuar Tribunali nga kjo çështje e më pas “përqendrohet në elementët ligjorë të çdo krimi që mund të jetë baza e fajësisë së shumëfishtë dhe jo në sjelljen bazë të të akuzuarit.”²⁴⁴⁴ Që një element të konsiderohet juridikisht i dallueshëm, “është e nevojshme të provohet një fakt që nuk është përcaktues për elementin tjetër”.²⁴⁴⁵ Dhoma e Apelit në çështjen *Kordiq dhe Çerkez* gjykoj se “standardi i fajësisë së shumëfishtë ka dy qëllime: të sigurojë se i akuzuari do të shpallet fajtor vetëm për shkelje të ndryshme, dhe njëkohësisht të sigurojë se verdiktet e fajësisë pasqyrojnë plotësisht sjelljen e tij kriminale.”²⁴⁴⁶ Kur ky kriter nuk përmbushet në lidhje me dy shkelje, Dhoma duhet të shpallë fajësinë në bazë të dispozitës më konkrete.²⁴⁴⁷

840. Dhoma e Apelit kujton se fajësia e shumëfishtë për të njëjtën sjellje kriminale bazuar në Nenin 5 të Statutit është gjykuar e lejueshme lidhur me krimet e dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjes dhe përndjekjes si krime kundër njerëzimit.²⁴⁴⁸ Dhoma e Apelit në çështjen *Kordiq dhe Çerkez* konkludoi se përndjekja si krim kundër njerëzimit përmban një element juridikisht të dallueshëm nga dëbimi, veprimet e tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), dhe vrasja si krime kundër njerëzimit, për arsye se krimi i përndjekjes kërkon të vërtetohet se veprimi ose mosveprimi ishte faktikisht diskriminues dhe se veprimi ose mosveprimi u krye

²⁴⁴² Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 135.

²⁴⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 412. Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 386; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 355; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1032-1033; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 173; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 82. Shih Aktgjykimi i Apelit *Gatete*, para. 259.

²⁴⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 387, citon Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 356. Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1039-1043.

²⁴⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 412-413. Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 386; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 355; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1032-1033; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 173; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 82.

²⁴⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1033.

²⁴⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 355-356; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1032-1033; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 412-413; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 78-79.

²⁴⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 391; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 367.

me synimin konkret diskriminues.²⁴⁴⁹ Dhoma e Apelit nuk bindet nga argumenti i Gjorgjeviqit se Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez* zbaton gabimisht standardin *Çelebiqui*, dhe kujton se Dhoma e Apelit në çështjen *Kordiq dhe Çerkez* “shpjegoi qartësisht arsyet që përlligjën ndryshimin e qëndrimit të saj nga çështjet e mëparshme”.²⁴⁵⁰ Aktgjykimet e mëpasme të Apelit në çështjet *Stakiq, Naletiliq dhe Martinoviq*, dhe në çështjen *Nahimana dhe të tjerët* konfirmojnë praktikën e zbatuar në çështjen *Kordiq dhe Çerkez*.²⁴⁵¹

841. Dhoma e Apelit e gjykon jobindës sugjerimin e Gjorgjeviqit se “mendimet e vazhdueshme mospajtuese lidhur me këtë çështje” dhe Aktgjykimi *Duch* përbëjnë arsye “bindëse” për rishikimin e jurisprudencës së Tribunalit.²⁴⁵² Në disa mendime mospajtuese, ndër të tjera edhe në Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, gjykatësi Schomburg dhe gjykatësi Güney kanë argumentuar se verdiktet e fajësisë për përndjekje bazuar në Nenin 5 janë palejueshmërisht të njëkohshme me krimet e tjera kundër njerëzimit.²⁴⁵³ Ky argument gjen mbështetje edhe në Aktgjykimin *Duch*.²⁴⁵⁴ Gjithsesi, Dhoma e Apelit thekson se as mendimet mospajtuese, e as Aktgjykimi *Duch* nuk janë detyruese për Dhomën e Apelit. Për më tepër, siç u theksua më sipër, Dhoma e Apelit në çështjen *Kordiq dhe Çerkez* shpjegoi qartësisht arsyet e interpretimit të saj të standardit të përcaktuar në çështjen *Çelebiqui*,²⁴⁵⁵ dhe Aktgjykimet e mëpasme të Apelit kanë konfirmuar praktikën e zbatuar në *Kordiq dhe Çerkez*.²⁴⁵⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk gjen asnjë arsye bindëse për të devijuar nga jurisprudence e deritanishme.

842. Dhoma e Apelit gjithashtu është bindur se verdikte fajësie në bazë të veprimeve të njëjta mund të shpallen për krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasje, dhe përndjekje sipas Nenit 5 të Statutit. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk bëri gabim ligjor kur shpalli fajësi të shumëfishtë për këto krime.

²⁴⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 389, 391; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 359-362; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1041-1042.

²⁴⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 389, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1040.

²⁴⁵¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 1026-1027; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 587-591; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 355-367.

²⁴⁵² Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 399, 403.

²⁴⁵³ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, Mendim i Përbashkët Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Mospajtuës i Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, Mendim i Përbashkët Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, Mendim Pjesërisht Mospajtuës i Gjykatësit Güney.

²⁴⁵⁴ Aktgjykimi *Duch*, para. 565.

²⁴⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 389, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1040. Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 230-233; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 144-146; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 188.

²⁴⁵⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 1026-1027; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 587-591; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 355-367.

843. Për arsyet e lartpërmendura Dhoma e Apelit hedh poshtë tërësisht nënpikën 18(B) të apelit të Gjorgjeviqit.

XIX. PIKA E PARË E APELIT TË PROKURORISË: PËRGJEGJËSI PENALE PËR PËRNDJEKJE PËRMES DHUNËS SEKSUALE

A. Hyrje

844. Dhoma Gjyqësore konkludoi se dy të reja, Dëshmitarja K14 (në qytetin e Prishtinës) dhe Dëshmitarja K20 (në fshatin Beleg të komunës së Deçanit), u përdhunuan dhe se lidhur me to u vërtetua dhuna seksuale.²⁴⁵⁷ Dhoma Gjyqësore nuk u bind se u vërtetuan incidentet e tjera të pretenduara të dhunës seksuale.²⁴⁵⁸ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se vepra penale e përndjekjes nëpërmjet dhunës seksuale nuk u vërtetua lidhur me dy incidentet e vërtetuara të dhunës seksuale, meqenëse gjykoi se ato nuk u kryen me synimin e duhur diskriminues.²⁴⁵⁹ Meqenëse në Aktakuzë dhuna seksuale akuzohet vetëm si veprim bazë i përndjekjes, Dhoma Gjyqësore nuk nxori verdikte fajësie për dhunë seksuale.²⁴⁶⁰

845. Në pikën e parë të apelit të vet, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk nxori konkluzionin se: (i) u krye dhunë seksuale kundër një të reje shqiptare²⁴⁶¹ në një kolonë në komunën e Prishtinës, dhe dy të rejave shqiptare kosovare në Beleg, në komunën e Deçanit; (ii) u vërtetua vepra penale e përndjekjes nëpërmjet dhunës seksuale kundër këtyre tri të rejave dhe kundër Dëshmitares 14 dhe Dëshmitares 20; dhe (iii) Gjorgjeviqi ishte fajtor për këto krime bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁴⁶² Prokuroria kërkon nga Dhoma e Apelit që të nxjerrë verdikte fajësie për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit, dhe të zgjasë dënimin e Gjorgjeviqit.²⁴⁶³ Gjorgjeviqi argumenton se Prokuroria nuk arriti të identifikonte asnjë gabim në pjesët e apeluara të

²⁴⁵⁷ Aktgjykimi, para. 838, 1151, 1791, 1793. Dhoma e Apelit vëren se në këto përfundime, Dhoma Gjyqësore i identifikoi dy femrat që ishin përdhunuar si vijon: “policët morën një shqiptare kosovare të re nga shtëpia e saj në komunën e Prishtinës dhe e çuan në një hotel” dhe “një shqiptare kosovare e re u përdhunua shumë herë nga ushtarë të UJ-së ndërsa policët bënë roje, natën e 29/30 marsit 1999 në fshatin Beleg” (Aktgjykimi, para. 1791, 1793). Gjithsesi, nga konteksti del qartë se Dhoma Gjyqësore e kishte fjalën për Dëshmitaren K14 dhe Dëshmitaren K20 (Shih Aktgjykimi, para. 833, 838, 1151, 1791, 1793, dhe referencat e cituara). Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do t’u referohet dy të rejave me pseudonimet e tyre.

²⁴⁵⁸ Aktgjykimi, para. 832, 1792, 1794-1795.

²⁴⁵⁹ Aktgjykimi, para. 1796-1797.

²⁴⁶⁰ Shih Aktakuza, para. 72-73, 75, 77. Në Pikën 5 të Aktakuzës pretendohet se Gjorgjeviqi është penalisht përgjegjës për përndjekje përmes dhunës seksuale të kryer nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë (Aktakuza, para. 77(c)).

²⁴⁶¹ Femrën nga kolona, Dhoma Gjyqësore kryesisht e përmend si vajzë. Mirëpo, nuk ka prova që tregojnë moshën e saj të saktë dhe nëse ajo duhet të quhet vajzë apo grua e re. Dhoma e Apelit vëren se në dëshminë e saj, Dëshmitarja K14 herë e quan vajzë, e here grua (Shih K14, 24 shtator 2009, T. 8997-8998, 9024-9025 (seancë e mbyllur); Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4; P1326 (konfidenciale), f. 1426). Në këtë Aktgjykim Dhoma e Apelit do të përdorë fjalën “vajzë”, dhe nuk do të zëvendësojë atë me “grua e re”, por thekson se kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se sjellja ndaj saj gjatë ngjarjeve të pretenduara është më e rëndë.

²⁴⁶² Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1, 4-56; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 176-191, 199-206.

²⁴⁶³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 56; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 178, 206.

Aktgjykimit, dhe se sido që të jetë, Dhoma e Apelit nuk ka kompetenca për shpalljen e verdikteve të reja të fajësisë në apel, apo të zgjasë dënimin kur nuk ekziston mundësi për apelim të mëtejshëm.²⁴⁶⁴ Dhoma e Apelit do t'i shqyrtojë këto parashtrime një nga një.

B. Pretendime për gabime në përfundimet mbi dhunën seksuale

1. Hyrje

846. Dhoma Gjyqësore konkludoi se për shkak të mungesës së provave të drejtpërdrejta nuk u vërtetuan dhuna seksuale kundër vajzës shqiptare kosovare në një kolonë në Prishtinë dhe të dy të rejave kosovare në Beleg.²⁴⁶⁵

847. Prokuroria parashtron se nëpërmjet kushtit për prova të drejtpërdrejta, Dhoma Gjyqësore i vlerësoi gabimisht të pamjaftueshme provat që dispononte për vërtetimin e dhunës seksuale në fjalë.²⁴⁶⁶ Prokuroria argumenton se i vetmi konkluzion i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat është se vajza shqiptare kosovare në kolonë dhe dy të rejat në fshatin Beleg u dhunuan seksualisht dhe se si rrjedhojë Dhoma Gjyqësore gabimisht arriti në konkluzion tjetër.²⁴⁶⁷

848. Gjorgjeviqi përgjigjet se Prokuroria “thjesht riparaqiti të njëjtat prova” duke mos provuar se Dhoma Gjyqësore nuk i mori parasysh.²⁴⁶⁸ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore veproi brenda kompetencave të veta kur nuk pranoi të mbështetej vetëm në prova rrethore ose të tërthorta.²⁴⁶⁹

849. Në këtë nënpjesë, fillimisht Dhoma e Apelit do të përcaktojë elementët e dhunës seksuale dhe më pas do të shqyrtojë parashtrimet lidhur me pretendimet për dhunë seksuale kundër vajzës nga kolona në komunën e Prishtinës dhe dy të rejave në Beleg.

2. Përkufizimi dhe elementët e dhunës seksuale

850. Dhoma e Apelit kujton se përkufizimi dhe elementët e dhunës seksuale janë diskutuar me më shumë, ose më pak hollësi nga disa dhoma gjyqësore.²⁴⁷⁰ Dhomat gjyqësore kanë gjykuar se dhuna seksuale nuk kufizohet vetëm në përdhunim dhe përfshin “të gjitha format e rënda të keqtrajtimit seksual ushtruar ndaj paprekshmërisë fizike dhe morale të një personi

²⁴⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 3-6, 54.

²⁴⁶⁵ Aktgjykimi, para. 1792, 1794. Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se dhuna seksuale e pretenduar në komunën e Skënderajt dhe të Prizrenit nuk ishte provuar (Aktgjykimi, para. 1795). Prokuroria nuk e ka apeluar këtë përfundim.

²⁴⁶⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 5, 18.

²⁴⁶⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 5, 18, 22, 24, 34, 39.

²⁴⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 33, 35.

²⁴⁶⁹ Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 33-34.

nëpërmjet shtrëngimit, kërcënimit me dhunë ose frikësimit në një mënyrë poshtëruese dhe ulëse ndaj dinjitetit të viktimës”.²⁴⁷¹ Dhoma e Apelit thekson se pas një analize të hollësishme, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* përcaktoi elementët e dhunës seksuale si në vijim:

- (a) Shkelësi fizik kryen një veprim të natyrës seksuale ndaj një tjetri duke kërkuar ndër të tjera që ai person të kryejë veprim të ngjashëm.
- (b) Veprimi cenon paprekshmërinë fizike të viktimës ose përbën dhunim të dinjitetit personal të viktimës.
- (c) Viktima nuk jep pëlqimin për veprimin.
- (d) Shkelësi fizik e kryen qëllimisht veprimin.
- (e) Shkelësi fizik është i vetëdijshëm se veprimi ndodhi pa pëlqimin e viktimës.²⁴⁷²

851. Dhoma e Apelit në çështjen aktuale bazohet në këtë përkufizim.²⁴⁷³ Ndonëse është bindur se përkufizimi i mësipërm pasqyron drejt elementët e dhunës seksuale (forma të tjera nga përdhunimi), Dhoma e Apelit gjykon se një shpjegim i mëtejshëm do të ishte i dobishëm në këtë rast.

852. Për ekzistencën e dhunës seksuale, vetëkuptohet se duhet të ndodhë veprim i natyrës seksuale. Dhoma e Apelit thekson se një veprim i tillë gjithsesi duhet të përbëjë cenim të paprekshmërisë fizike apo morale të viktimës.²⁴⁷⁴ Shpesh bëhen objekt, apo sulmohen pjesët e trupit që zakonisht lidhen me seksualitetin e njeriut. Megjithatë, që një veprim të cilësohet i natyrës seksuale, nuk është i domosdoshëm kontakti fizik midis keqbërësit dhe viktimës.²⁴⁷⁵ Mjafton që një person të shtrëngohet që të kryejë ose të shohë veprimet në fjalë me kusht që këto veprime të poshtërojnë dhe/ose ulin dinjitetin e viktimës në aspektin seksual.²⁴⁷⁶ Për më tepër, Dhoma e Apelit pajtohet me mendimin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* se “do të ishte e papërshtatshme që në përkufizimin e “dhunës seksuale” t’i mëshohej kënaqësisë seksuale të keqbërësit [...]. Në kuadrin e një konflikti të armatosur, poshtërimi dhe çnderimi seksual i viktimës ka më shumë rëndësi se kënaqësia e keqbërësit”

²⁴⁷⁰ Shih Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 195-201; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186.

²⁴⁷¹ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186 (në këto çështje, përkufizimi i dhunës seksuale nuk u kundërshtua në apel). Shih Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 180, përmendet Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688 (përkufizimi i dhunës seksuale përsëri nuk u kundërshtua në apel). Shih Aktgjykimi *Akayesu*, ku Dhoma Gjyqësore gjykoi se “dhunë seksuale, ku përfshihet edhe përdhunimi, është çdo veprim i natyrës seksuale i kryer kundër një personi në rrethana shtrënguese. Ajo nuk kufizohet në dhunimin fizik të trupit të njeriut dhe mund të përfshijë veprime të tjera që nuk kanë të bëjnë me penetrim apo me kontakt fizik” (*Akayesu* Aktgjykimi, para. 688. Edhe ky përkufizim nuk u kundërshtua në apel).

²⁴⁷² Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 201.

²⁴⁷³ Aktgjykimi, para. 1768.

²⁴⁷⁴ Shih Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186.

²⁴⁷⁵ Shih Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 199; Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688.

meqenëse pikërisht poshtërimi dhe çnderimi seksual “përcakton veçantinë e shkeljes”.²⁴⁷⁷ Lidhur me pëlqimin, Dhoma e Apelit gjykon se çfarëdo forme shtrëngimi, ndër të cilat dhuna ose kërcënimi për dhunë (fizike ose psikologjike), keqpërdorimi i pozitës apo çfarëdo forme tjetër detyrimi dhe përgjithësisht rrethanat mbytëse mund të përbëjnë prova të mungesës së pëlqimit dhe zakonisht janë tregues të mungesës së pëlqimit.²⁴⁷⁸ Për më tepër, mbajtja kundër dëshirës, veçanërisht gjatë një konflikti të armatosur, zakonisht e zhvlerëson pëlqimin.²⁴⁷⁹

3. Vajza shqiptare kosovare nga kolona në komunën e Prishtinës

853. Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë e Dëshmitares K14 se dikur në prill 1999, një vajzë shqiptare kosovare e cila po udhëtonte me persona të tjerë të zhvendosur në një kolonë nga Grashtica në komunën e Prishtinës drejt qytetit të Prishtinës, u mor nga një traktor në Llukar nga dy burra, njëri prej të cilëve mbante thika dhe ishte i veshur me pantallona kamuflimi.²⁴⁸⁰ Burri me pantallona kamuflimi e çoi vajzën në pyll, ndërsa tjetri i identifikuar si polic i bënte roje.²⁴⁸¹ Kur ky i pari doli nga pylli, polici hyri në pyll me vajzën.²⁴⁸² Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë e Dëshmitares K14 se kolona dëgjoji vajzën që po bërtiste dhe qante gjatë kohës që ishte në pyll, dhe se kur e kthyen te kolona pas afërsisht gjysmë ore, ajo ishte skuqur nga të qarët.²⁴⁸³ Dhoma Gjyqësore gjithashtu theksoi se kur e kishin çuar në pyll, vajza kishte qenë e veshur, kurse kur e kthyen te kolona “ajo ishte zbathur, e mbështjellë me një batanije dhe dukej se ishte lakuriq”.²⁴⁸⁴ Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk ishte në gjendje të nxirrte përfundim se kjo vajzë pësoi dhunë seksuale, për shkak të provave të pamjaftueshme lidhur me këtë pretendim, duke theksuar veçanërisht mungesën e provave të drejtpërdrejta në lidhje me ngjarjet në pyll.²⁴⁸⁵

(a) Argumentet e palëve

854. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur arriti në përfundimin se vajza e marrë nga kolona nuk pësoi dhunë seksuale.²⁴⁸⁶ Sipas Prokurorisë, Dëshmitarja K14 pa se vajza pësoi dhunë seksuale nga dy burra: një polic dhe një burrë që mbante thika dhe i veshur

²⁴⁷⁶ Shih Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 199; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186.

²⁴⁷⁷ Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 199.

²⁴⁷⁸ Shih Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 200.

²⁴⁷⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 396; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 132-133; Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 1, para. 200.

²⁴⁸⁰ Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁸¹ Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁸² Aktgjykimi, para. 832.

²⁴⁸³ Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁸⁴ Aktgjykimi, para. 832, 1792, me referenca të mëtejshme.

²⁴⁸⁵ Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁸⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 18-24; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179.

me pantallona kamuflimi.²⁴⁸⁷ [Prokuroria] argumenton se synimi i dy burrave ishte i qartë kur ata i thanë vajzës se ishte e bukur dhe e tërhoqën zvarrë nga kolona dhe çuan në pyll.²⁴⁸⁸ Sipas Prokurorisë, rrethanat konkrete të këtij incidenti konfirmojnë edhe më shumë se vajza pësoi dhunë seksuale, ndër të tjera, fakti se burrat shkuan me radhë në pyll me vajzën dhe i bënë roje njëri-tjetrit, vajza u kthye e mbështjellë me një batanije dhe dukej se ishte lakuriq pas incidentit, kurse kur e kishin çuar në pyll, ajo kishte qenë e veshur, dhe “nuk kishte mavijosje apo gjakderdhje që do të mund të kishin qenë shkak i britmave të saj.”²⁴⁸⁹

855. Gjorgjeviqi përgjigjet se askush nuk pa se çfarë i ndodhi vajzës në pyll dhe ajo nuk i tregoi askujt se çfarë i ndodhi.²⁴⁹⁰ Ai parashtron se dëshmia e vetme lidhur me këtë incident është supozimi i Dëshmitares K14 se “çfarë mund t’i kishte ndodhur vajzës” që u mor nga kolona, dhe se Dhoma Gjyqësore veprroi brenda kompetencave të veta të brendaqenësishme kur nuk pranoi të mbështetej vetëm në prova rrethanore kur arriti në përfundimin se nuk ishte vërtetuar dhunë seksuale.²⁴⁹¹

(b) Analizë

856. Dhoma e Apelit kujton se dhomat gjyqësore gëzojnë kompetenca të gjera në vlerësimin e provave.²⁴⁹² Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk i ndryshon përfundimet faktike të dhomës gjyqësore pa pasur arsye të forta.²⁴⁹³ Kjo mund të ndodhë vetëm kur Dhoma e Apelit gjykon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të arrinte në përfundimin e apeluar.²⁴⁹⁴ Më poshtë Dhoma e Apelit do të analizojë nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se provat ishin të pamjaftueshme për nxjerrjen e përfundimit mbi dhunën seksuale ndaj vajzës në kolonë.

857. Lidhur me mungesën e provave të drejtpërdrejta që theksoi Dhoma Gjyqësore, Dhoma e Apelit kujton se një dhomë gjyqësore mund të deduktojë ekzistencën e një fakti konkret për fajësinë e të akuzuarit nga prova rrethanore, në qoftë se është deduksioni i vetëm i arsyeshëm

²⁴⁸⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 18, 20.

²⁴⁸⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 20-22, përmendet Aktgjykimi, para. 832, Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4.

²⁴⁸⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 20-22. Prokuroria i referohet konkretisht faktit se britmat e vajzës dëgjoheshin deri tek kolona dhe se ajo ishte skuqur nga të qarët kur u kthye në kolonë (Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 20-22, përmendet Aktgjykimi, para. 832, Prova Materiale P1325 (konfidenciale), K14, 24 shtator 2009, T. 8997-8998 (seancë e mbyllur).

²⁴⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁴⁹¹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 33-34.

²⁴⁹² Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 30-32; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 47.

²⁴⁹³ Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 14; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 11. Shih gjithashtu *më lart*, para. 17.

²⁴⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 12; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 13; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 15; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 13. Shih gjithashtu *më lart*, para. 16.

që mund të nxirret nga provat e paraqitura.²⁴⁹⁵ Kjo gjithashtu do të thotë se nuk është e domosdoshme që viktima e pretenduar të dëshmojë vetë në një çështje në mënyrë që dhoma gjyqësore të mund të konkludojë se është kryer një krim. Në lidhje me pretendimin se vajza nga kolona pësoi dhunë seksuale, Dhoma e Apelit gjykon se fakti që kolona dëgjoi britmat dhe të qarët e saj, dhe se kur e kthyen te kolona ajo ishte skuqur nga të qarët,²⁴⁹⁶ tregon qartë se ajo ishte keqtrajtuar ndërsa ishte në duart e dy burrave në pyll. Për më tepër, siç theksoi Dhoma Gjyqësore, kur e kishin çuar në pyll, vajza kishte qenë e veshur, kurse kur e kthyen e mbështjellë me batanije dhe dukej se ishte lakuriq.²⁴⁹⁷ Dhoma e Apelit gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm në rrethana kur një vajzë e re merret nga burra dhe çohet në një vend që nuk mund të shihet nga të tjerët, dëgjohen britmat dhe të qarët e saj, dhe ajo kthehet në dukje lakuriq, është se ka pësuar keqtrajtim seksual.²⁴⁹⁸ Ky përfundim gjithashtu mbështetet nga: (i) komenti domethënës i njërit prej burrave kur e mori vajzën nga kolona,²⁴⁹⁹ (ii) fakti se burrat shkuan me radhë në pyll për të qenë vetë me vajzën dhe i bënë roje njëri-tjetrit,²⁵⁰⁰ (iii) fakti se vajza ishte dukshëm e tronditur shpirtërisht kur e kthyen te kolona, edhe pse nuk kishte shenja të dukshme dhune në trup si mavijosje apo gjakderdhje, që ndryshe do të mund të kishin shkaktuar britmat dhe të qarët e saj,²⁵⁰¹ dhe (iv) dëshmia e Dëshmitares K14 se burri që mbante thika dhe kishte veshur pantallona kamuflimi të gjelbra njëhej “për gjëra të tilla”.²⁵⁰² Dhoma e Apelit gjykon se mbi bazën e kësaj dëshmie asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të mos konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se ndaj vajzës ishte kryer veprim i natyrës seksuale i cili cenoi paprekshmërinë fizike të saj dhe/ose përbënte dhunim të dinjitetit të saj personal. Për më tepër, rrethanat, ndër të cilat fakti se vajza u “u

²⁴⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 218; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 458; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 303; Aktgjykimi i Apelit *Muhimana*, para. 49.

²⁴⁹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁹⁷ Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁴⁹⁸ Krahaso Aktgjykimi *Muhimana*, para. 32, ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se: “Megjithëse Dëshmitarja AP nuk ishte dëshmitare okulare e përdhunimit të Goretti-it dhe Languida-s, Dhoma konkludon se i Akuzuari i përdhunoi ato në bazë të këtyre faktorëve: dëshmitarja e pa të Akuzuarin duke i çuar vajzat në shtëpinë e tij; ajo i dëgjoi viktimat duke bërë titur dhe përmendur emrin e të Akuzuarit, duke i thënë se ‘nuk kishin pritur prej tij t’ua bënte këtë gjë’; së fundi, dëshmitarja e pa të Akuzuarin teksa po i nxirrte vajzat nga shtëpia, të zhveshura lakuriq, dhe vuri re se ato po ecnin ‘me këmbët hapur’” (Aktgjykimi *Muhimana*, para. 32). Dhoma e Apelit konfirmoi se në bazë të kësaj dëshmie, Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se vajzat u përdhunuan (Aktgjykimi i Apelit *Muhimana*, para. 50). Megjithatë, Dhoma e Apelit nuk la në fuqi përfundimin se i akuzuari personalisht kreu përdhunimin (Aktgjykimi i Apelit *Muhimana*, para. 51-52).

²⁴⁹⁹ Shih Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4; P1326 (konfidenciale), f. 1426; K14, 24 shtator 2009, T. 8997, 9024 (seancë e mbyllur). Sipas Dëshmitares K14, njëri nga burrat i tha vajzës “Eja këtu me mua, je shumë e bukur” (Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3; P1326 (konfidenciale), f. 1426; K14, 24 shtator 2009, T. 8997, 9024 (seancë e mbyllur)). Krahaso Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 22.

²⁵⁰⁰ Shih Aktgjykimi, para. 832, përmendet Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4, K14, 24 shtator 2009, T. 9024-9026 (seancë e mbyllur).

²⁵⁰¹ Shih Aktgjykimi, para. 832 (përmendet Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4, K14, 24 shtator 2009, T. 8997 (seancë e mbyllur)), 1792. Sipas Dëshmitares K14, vajza nuk kishte shenja mavijosjeje apo gjakderdhjeje, por dukej “krejtësisht ndryshe” kur e kthyen në kolonë, e skuqur në fytyrë nga të qarët (Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4; K14, 24 shtator 2009, T. 8997 (seancë e mbyllur)).

²⁵⁰² Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4.

tërhoq zvarrë” deri në pyll nga dy burrat dhe se u dëgjuan britmat dhe të qarët e saj, konfirmojnë se vajza nuk kishte dhënë pëlqimin e saj dhe se dy burrat e dinin këtë gjë.²⁵⁰³

858. Dhoma e Apelit gjykon se argumenti i Gjorgjeviqit se dëshmia e vetme lidhur me këtë sulm vjen nga Dëshmitarja K14 dhe është e pakonfirmuar, nuk ndikon në përfundimin e vet.²⁵⁰⁴ Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit kujton se dëshmia e një dëshmitari të vetëm mund të pranohet pa kurrfarë konfirmimi, madje edhe është në lidhje me një fakt juridikisht thelbësor.²⁵⁰⁵ Për më tepër, ndonëse Dëshmitarja K14 nuk pa me sytë e saj se çfarë i bënë dy burrat vajzës së re në pyll, Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e saj nuk bazohet thjesht në “supozim” sikurse parashtron Gjorgjeviqi.²⁵⁰⁶ Përkundrazi, dëshmia e Dëshmitares K14 bazohet në çfarë pa dhe dëgjoi vetë para, gjatë dhe pas çuarjes së vajzës në pyll.²⁵⁰⁷ Për më tepër, Dhoma e Apelit citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se dëshmia e Dëshmitares K14 ishte e besueshme.²⁵⁰⁸ As Gjorgjeviqi nuk e ka kundërshtuar besueshmërinë e Dëshmitares K14.

859. Për këto arsye, Dhoma e Apelit gjykon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se provat ishin të pamjaftueshme për të vërtetuar se vajza shqiptare kosovare nga kolona pësoi dhunë seksuale nga dy burra, njëri prej të cilëve ishte polic. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore bëri interpretim të gabuar të provave. Më poshtë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentin e Prokurorisë se dhuna seksuale në rastin e mësipërm përbën përndjekje.²⁵⁰⁹

4. Dy të rejat shqiptare kosovare në Beleg

860. Dy të rejat shqiptare kosovare në Beleg u ndaluan natën midis 29 dhe 30 marsit 1999 së bashku me një grup grash dhe fëmijësh, ndër të cilët Dëshmitarja K20 dhe Dëshmitarja K58.²⁵¹⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitarja K20 atë natë u përdhunua

²⁵⁰³ Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4; K14, 24 shtator 2009, T. 8997 (seancë e mbyllur).

²⁵⁰⁴ Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁵⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 219; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 65; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 62; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 492, 506; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 154. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 215 (ku theksohet se “asgjë nuk e ndalon Dhomës Gjyqësore që të mbështetet në prova të pakonfirmuara nga prova të tjera; Dhoma Gjyqësore gëzon të drejtën që duke u bazuar në rrethanat e çdo rasti, të vendosë nëse konfirmimi është i domosdoshëm apo nëse do të mbështetet në dëshmi të pakonfirmuara dëshmitarësh, por gjithsesi të besueshme”).

²⁵⁰⁶ Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁵⁰⁷ Prova Materiale P1325 (konfidenciale), P1326 (konfidenciale); K14, 24 shtator 2009, T. 8997-8998, 9024, 9026 (seancë e mbyllur).

²⁵⁰⁸ Dhoma Gjyqësore theksoi se kishte marrë parasysh ndryshimet në dëshminë e dëshmitares lidhur me disa aspekte, por konkludoi se këto ndryshime nuk ndikonin në besueshmërinë e dëshmisë së saj (Aktgjykimi, para. 833, sh. 3209).

²⁵⁰⁹ Shih më poshtë, Pjesa XIX.C.3.

²⁵¹⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1149-1152, me referenca plotësuese.

nga pjesëtarë të forcave serbe.²⁵¹¹ Gjatë shqyrtimit të akuzave për dhunë seksuale kundër dy të rejave të tjera, Dhoma Gjyqësore citoi dëshminë e Dëshmitares K58:

ushtarët veçuan dhe morën edhe të reja të tjera shqiptare kosovare për periudha të gjata kohore gjatë natës së 29/30 marsit 1999 në Beleg. Kur të rejat u kthyen, ato qanin dhe flokët i kishin të shprishur. Njëra prej tyre u dëgjua kur i tha nënës së vet se ajo ishte përdhunuar.²⁵¹²

Dhoma Gjyqësore konkludoi se “në mungesë të provave të tjera, Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë se dy gratë e lartpërmendura pësuan dhunë seksuale.”²⁵¹³

(a) Argumentet e palëve

861. Prokuroria parashtroi se Dhoma Gjyqësore nxori përfundimin e gabuar se dy të rejat shqiptare kosovare nuk pësuan dhunë seksuale gjatë natës së 29/30 marsit 1999, duke mos marrë parasysh dëshminë përkatëse të Dëshmitares K20.²⁵¹⁴ Prokuroria argumenton se sikur të kishte marrë parasysh të gjitha provat përkatëse ndër të cilat dëshmia e Dëshmitares K20, Dhoma Gjyqësore do të kishte konkluduar se dy të rejat pësuan dhunë seksuale.²⁵¹⁵ Sipas Prokurorisë, provat tregojnë se dy të rejat u çuan në një shtëpi të djegur së bashku me Dëshmitaren K20,²⁵¹⁶ e cila pa njërin prej tyre kur u mor nga forcat serbe dhe u çua në një dhomë dhe dëgjoi ulërimat e të dyjave.²⁵¹⁷ Prokuroria parashtroi se përfundimi se dy të rejat pësuan dhunë seksuale mbështetet gjithashtu nga fakti se po atë natë, edhe të reja të tjera shqiptare kosovare pësuan dhunë seksuale.²⁵¹⁸

862. Gjorgjeviqi përgjigjet se provat e paraqitura lidhur me pretendimin se dy të rejat në Beleg pësuan dhunë seksuale mbështeten në dëshmi dytësore dhe të pakonfirmuara.²⁵¹⁹ Ai parashtroi se dëshmia e Dëshmitares K58 lidhur me incidentin është e dorës së dytë, meqenëse ajo kishte dëgjuar një vajzë duke i treguar të ëmës se e kishin përdhunuar.²⁵²⁰ Ai shton se Dëshmitarja K58 nuk e njihte vajzën që i tregoi të ëmës se e kishin përdhunuar.²⁵²¹ Për këtë arsye, ka mundësi që Dëshmitarja K58 të ketë dëgjuar Dëshmitaren K20, lidhur me të cilën u

²⁵¹¹ Aktgjykimi, para. 1151, 1793. Shih gjithashtu më poshtë, Pjesa XIX.C.

²⁵¹² Aktgjykimi, para. 1794 (pa citimet). Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1152, përmendet Prova Materiale P1080, f. 6, P1081, f. 7468, K58, 13 korrik 2009, T. 7299.

²⁵¹³ Aktgjykimi, para. 1794.

²⁵¹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 5, 34, përmendet Aktgjykimi, para. 1794, Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5-6, P1281 (konfidenciale), f. 2532; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 10. Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179, 182.

²⁵¹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 34; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 10.

²⁵¹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 34-35.

²⁵¹⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 36; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 182.

²⁵¹⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37. Prokuroria u referohet dëshmimeve se atë natë, ushtarët serbë morën edhe femra të tjera në grupe të vogla dhe i mbajtën gjatë, të cilat kur u kthyen ishin duke qarë dhe flokët i kishin të shprishura, dhe njëra prej tyre u dëgjua kur tregoi se ishte përdhunuar (Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 37, përmendet Aktgjykimi, para. 1151-1152, 1794). Shih Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 182.

²⁵¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁵²⁰ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34, përmendet Aktgjykimi, para. 1794.

²⁵²¹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34, përmendet Prova Materiale P1080, f. 9.

vërtetua dhuna seksuale, kur i tregoi të ëmës se e kishin përdhunuar.²⁵²² Gjorgjeviqi më tej argumenton se dy të rejat i thanë Dëshmitares K20 se nuk ishin përdhunuar dhe se rrjedhimisht, supozimi i Dëshmitares K20 është baza e vetme për konkluzionin se ato pësuan dhunë seksuale.²⁵²³ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore ushtroi të drejtën e vet kur nuk u mbështet vetëm në këtë dëshmi të tërthortë për të nxjerrë përfundim për dhunë seksuale në këtë incident.²⁵²⁴

(b) Analizë

863. Konkluzionin se lidhur me dy të rejat në Beleg nuk ishte vërtetuar dhunë seksuale, Dhoma Gjyqësore e mbështeti vetëm në dëshminë e Dëshmitares K58.²⁵²⁵ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh dëshminë e Dëshmitares K20 lidhur me këtë incident, edhe pse e kishte shqyrtuar më herët në kontekst të ngjarjeve në Beleg, dhe e konsideronte Dëshmitaren K20 të besueshme e u mbështet në dëshminë e saj kur konkludoi se ajo u përdhunua.²⁵²⁶

864. Dhoma e Apelit kujton se megjithëse dhomat gjyqësore nuk janë të detyruara t'i referohen çdo prove të administruar, mosshqyrtimi i provave që kanë rëndësi të dukshme për një përfundim, përbën gabim ligjor.²⁵²⁷ Dëshmitarja K20 i njihte dy të rejat e tjera.²⁵²⁸ Tre të rejat u morën bashkë nga dhoma ku po mbaheshin nga pjesëtarë të forcave serbe dhe u çuan në një shtëpi aty afër në të cilën Dëshmitarja K20 u përdhunua, kurse për dy të rejat e tjera pretendohet se pësuan dhunë seksuale në po atë kohë.²⁵²⁹ Duke marrë parasysh dëshminë qartësisht të rëndësishme të Dëshmitares K20 për përfundimin e Dhomës Gjyqësore mbi pretendimin për dhunë seksuale kundër dy të rejave të tjera, mosmarrja parasysh e kësaj dëshmie nga Dhoma Gjyqësore përbën gabim ligjor.

²⁵²² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁵²³ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 34, përmendet Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6.

²⁵²⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 33.

²⁵²⁵ Aktgjykimi, para. 1794. Dhoma Gjyqësore përmendi dëshminë e Dëshmitares K58 se gjatë natës ushtarët veçuan dhe morën nga dhoma disa të reja, dhe se kur u kthyen, ato qanin dhe flokët i kishin të shprishur; njëra prej tyre u dëgjua kur i tha nënës së vet se e kishin përdhunuar. Dhoma Gjyqësore theksoi se nuk u paraqitën prova të tjera (Aktgjykimi, para. 1794, përmendet Aktgjykimi, para. 1152).

²⁵²⁶ Aktgjykimi, para. 1148-1151, 1793, përfshirë referencat e cituara.

²⁵²⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 23; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 498; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 39; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 382. Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se supozohet se dhoma gjyqësore i ka shqyrtuar vlerësoi të gjitha dëshmitë e paraqitura, në qoftë se nuk rezulton se dhoma gjyqësore shpërfilli plotësisht një prove të caktuar (Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 23).

²⁵²⁸ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, p. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2513, 2527.

²⁵²⁹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4-6; P1280, f. 4-6; P1281 (konfidenciale), f. 2526-2527, 2558; P1282 (konfidenciale), f. 10063-10064; K20, 27 gusht 2009, T. 8494, 8502-8503 (seancë e mbyllur). Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1150-1151; Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468, 7476-7477; K58, 13 korrik 2009, T. 7299, 7329-7330, 7343.

865. Duke mbajtur parasysh këtë gabim, në vijim Dhoma e Apelit do të shqyrtojë dëshminë e Dëshmitares K20 në lidhje me pretendimin për dhunë seksuale kundër dy të rejave të tjera, të cilat u morën nga pjesëtarë të forcave serbe së bashku me Dëshmitaren K20 dhe u çuan në një shtëpi. Dhoma e Apelit do të gjykojë nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nga provat e disponueshme se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se dy të rejat pësuan dhunë seksuale.²⁵³⁰

866. Gjatë natës së 29/30 marsit 1999, pjesëtarë të forcave serbe shkuan në dhomën ku po mbaheshin dy të rejat së bashku me një grup grash dhe fëmijësh të tjerë shqiptarë kosovarë.²⁵³¹ Ata u thanë njerëzve në dhomë se u duheshin njerëz për t'i ndihmuar të pastronin dhe disa gra më në moshë u shprehën të gatshme që të shkonin me ushtarët për të pastruar.²⁵³² Megjithatë, ushtarët u thanë të qëndronin në dhomë.²⁵³³ Pastaj ata "kontrolluan fytyrat e njerëzve që ishin në dhomë me anë të një drite dore" dhe morën me vete Dëshmitaren K20 dhe dy të rejat e tjera.²⁵³⁴ Ato u çuan në një shtëpi aty pranë në tri dhoma të ndryshme.²⁵³⁵ Dëshmitarja K20 filloi të ulërinte kur një ushtar po e zhvishte.²⁵³⁶ Një polic i cili fliste shqip dhe bënte roje te dera tha: "Pse ulërin? A nuk janë edhe këto të tjerat vajza?"²⁵³⁷ Më pas, ushtari e çoi Dëshmitaren K20 në një banjë ku ajo u përdhunua nga më shumë ushtarë.²⁵³⁸ Sipas Dëshmitares K20, ndërsa ishte në atë shtëpi, ajo dëgjoji ulërimat e dy grave të tjera dhe ulërima e njëres prej tyre dëgjohej shumë qartë, meqenëse ajo mbahej në dhomën pranë banjës ku Dëshmitarja K20 ishte përdhunuar.²⁵³⁹ Dëshmitarja K20 deklaroi se: "Ajo që më ndodhi mua, me siguri u ndodhi edhe atyre. Ulërimat ishin të njëjta me ulërimën time kur më përdhunuan."²⁵⁴⁰ Kur u kthyen në dhomën ku mbaheshin gratë dhe fëmijët, njëra nga dy të rejat i tha Dëshmitares K20 se kishte pastruar, kurse të dyja i thanë Dëshmitares K20 se ushtarët nuk u kishin bërë gjë.²⁵⁴¹ Dhoma e Apelit thekson se ky është pikërisht shpjegimi për të cilin

²⁵³⁰ Shih më lart, para. 15. Krahaso Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 34-39.

²⁵³¹ Aktgjykimi, para. 1149-1150; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2526-2527, 2558; P1282 (konfidenciale), f. 10063-10064; K20, 27 gusht 2009, T. 8494 (seancë e mbyllur). Shih gjithashtu Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468, 7477-7478; K58, 13 korrik 2009, T. 7299, 7329-7330, 7343.

²⁵³² Aktgjykimi, para. 1150; Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 6; P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2558; K58, 13 korrik 2009, T. 7299, 7343.

²⁵³³ Aktgjykimi, para. 1150; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4.

²⁵³⁴ Aktgjykimi, para. 1149-1150; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2526-2527, 2558; P1282 (konfidenciale), f. 10063-10064; K20, 27 gusht 2009, T. 8494 (seancë e mbyllur). Shih gjithashtu Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468, 7477-7478; K58, 13 korrik 2009, T. 7299, 7329-7330, 7343.

²⁵³⁵ Aktgjykimi, para. 1151; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5; K20, 27 gusht 2009, T. 8503 (seancë e mbyllur).

²⁵³⁶ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5; P1281 (konfidenciale), f. 2529. Shih Aktgjykimi, para. 1151.

²⁵³⁷ Prova Materiale P1281 (konfidenciale), f. 2529-2530. Shih Aktgjykimi, para. 1151.

²⁵³⁸ Aktgjykimi, para. 1151, 1793; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5; P1281 (konfidenciale), f. 2529-2532.

²⁵³⁹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

²⁵⁴⁰ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

²⁵⁴¹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

ushtarët udhëzuan që Dëshmitarja K20 t'i jepte familjes së saj pasi e kishin përdhunuar.²⁵⁴² Dhoma e Apelit gjithashtu konstaton se sipas dëshmisë së Dëshmitares K20, njëra nga vajzat dukej “paksa e humbur” kur e kthyen, dhe se kur ishin në shtëpinë me ushtarët, Dëshmitarja K20 i dëgjoi që të dyja duke ulëritur.²⁵⁴³ Dhoma e Apelit konkludon se shihet qartë që kjo dëshmi është e kundërta e pretendimit të dy grave se ushtarët nuk u kishin bërë gjë.²⁵⁴⁴ Përfundimi se dy gratë pësuan të njëjtin fat si Dëshmitarja K20 konfirmohet edhe nga komenti që bëri polici që fliste shqip para përdhunimit të Dëshmitares K20. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se nuk është e pazakontë që gratë të mbajnë brenda vetes dhunën e përjetuar seksuale, ndër të tjera për shkak të ndjenjës së turpits dhe frikës, botëkuptimeve fetare, rrethanave të tyre shoqërore dhe kulturore, dhe shpeshësisë dhe ashpërsisë së dhunës.²⁵⁴⁵

867. Dhoma e Apelit më tej thekson se gjatë natës së këtyre ngjarjeve, Dëshmitarja K58 mbahej në të njëjtën dhomë me Dëshmitaren K20, dy të reja të tjera, dhe grupin e grave dhe fëmijëve.²⁵⁴⁶ Dhoma e Apelit konstaton se dëshmia e Dëshmitares K58 konfirmon dëshminë e Dëshmitares K20. Konkretisht, sipas Dëshmitares K58, gjatë asaj nate, u zgjodhën disa herë “vajza të reja” dhe rreth 20 prej tyre u morën në grupe të vogla nga ushtarët dhe u mbajtën për një kohë më të gjatë, me pretendimin për të pastruar.²⁵⁴⁷ Kur i kthyen në dhomë, ato ishin duke qarë dhe flokët i kishin të shprishura.²⁵⁴⁸ Dhoma e Apelit thekson se Dëshmitarja K58 dëgjoi një të njërit prej tyre kur i tha nënës së vet se e kishin përdhunuar.²⁵⁴⁹ Dhoma e Apelit citon argumentin e Gjorgjeviqit se Dëshmitarja K58 nuk e njihte gruan që i tregoi të ëmës se e kishin përdhunuar, dhe se kjo grua mund të ketë qenë Dëshmitarja K20.²⁵⁵⁰ Sidoqoftë, Dhoma e Apelit kujton deklaratën e Dëshmitares K58 se ajo dëgjoi një nënë duke pyetur të bijën: “Çfarë të bënë?” dhe e bija u përgjigj, ‘Nënë, na përdhuan’.²⁵⁵¹ Kjo nuk përputhet me dëshminë e Dëshmitares K20 se çfarë i tha të ëmës. Dëshmitarja K20 dëshmoi se: “Nëna ime

²⁵⁴² Shih Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5; K20, 27 gusht 2009, T. 8504 (seancë e mbyllur).

²⁵⁴³ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

²⁵⁴⁴ Shih Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

²⁵⁴⁵ Shih K.G. Weiss, “Too ashamed to report: Deconstructing the shame of sexual victimization”, *Feminist Criminology*, vëll. 5(3) (korrik 2010), f. 286-310; S.G. Smith, “The Process and Meaning of Sexual Assault Disclosure”, *Psychology Dissertation*, paper 7 (2005), f. 19, 23, 31. Shih gjithashtu P.L. Fanflik, *Victim Responses to Sexual Assault: Counter-Intuitive or Simply Adaptive* (National District Attorneys Association American Prosecutors Research Institute, Special Topic Series, Aug 2007), f. 4-5. Dhoma e Apelit gjithashtu vëren se në çështjen *Kvoçka dhe të tjerët* Dhoma Gjyqësore konkludoi se “fakti që Dëshmitarja K nuk ia përmendi një gazetari rastin e përdhunimit të saj më 1993 është i parëndësishëm, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën seksuale dhe tejet personale të krimit” (Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 552 (theksi i shtuar)).

²⁵⁴⁶ Aktgjykimi, para. 1149-1150; Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468; P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2526, 2558; P1282 (konfidenciale), f. 10064; K58, 13 korrik 2009, T. 7299, 7329-7330, 7343; K20, 27 gusht 2009, T. 8494 (seancë e mbyllur).

²⁵⁴⁷ Aktgjykimi, para. 1152. Shih gjithashtu Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468; K58, 13 korrik 2009, T. 7298-7299.

²⁵⁴⁸ Aktgjykimi, para. 1152, 1794; Prova Materiale P1080, f. 6; P1081, f. 7468.

²⁵⁴⁹ Aktgjykimi, para. 1152, 1794. Shih gjithashtu Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 6; P1080, f. 6; P1081, f. 7468.

²⁵⁵⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 34.

²⁵⁵¹ Prova Materiale P1081, f. 7468.

sigurisht që e kuptoi se çfarë më kishte ndodhur. Më pyeti: ‘Sa vetë?’, dhe unë u përgjigja: ‘Katër’. Kaq i tregova nënës sime.”²⁵⁵² Rrjedhimisht, argumenti i Gjorgjeviqit nuk qëndron.

868. Për mendimin e Dhomës së Apelit, këto dëshmi mbështesin konkluzionin se përveç Dëshmitares K20, dhunë seksuale pësuan edhe dy të rejtat e tjera kur atë natë ushtarët i çuan në shtëpinë e afërme. Duke marrë parasysh provat në tërësi, Dhoma e Apelit konkludon se i vetmi rrjedhim i arsyeshëm është se dy të rejtat iu nënshtruan një veprimi të natyrës seksuale i cili cenoi paprekshmërinë fizike të tyre dhe/ose përbënte dhunim të dinjitetit të tyre personal. Për më tepër, rrethanat, ndër të tjera fakti se ushtarët i morën dy të rejtat dhe Dëshmitaren K20 nga dhoma ku ato mbaheshin dhe i çuan në një shtëpi tjetër, nga e cila u dëgjuan ulërimat e tyre, konfirmojnë se ato nuk dhanë pëlqimin e tyre dhe ushtruesit e dhunës seksuale ishin të vetëdijshëm për këtë gjë.

869. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se i vetmi rrjedhim i arsyeshëm është se dy të rejtat shqiptare kosovare në Beleg, të cilat u morën së bashku me Dëshmitaren K20, pësuan dhunë seksuale nga pjesëtarë të forcave serbe. Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria vërtetoi se Dhoma Gjyqësore bëri interpretim të gabuar të provave. Më poshtë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse këto veprime përbënin përndjekje, sikurse pretendon Prokuroria.²⁵⁵³

C. Pretendim për gabime lidhur me përfundimet mbi përndjekjen nëpërmjet dhunës seksuale

1. Hyrje

870. Dhoma e Apelit kujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Dëshmitarja K20²⁵⁵⁴ dhe Dëshmitarja K14 u përdhunuan,²⁵⁵⁵ dhe se lidhur me këto dy të reja u vërtetua dhuna seksuale.²⁵⁵⁶ Megjithatë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se këto veprime nuk u kryen me synim diskriminues dhe rrjedhimisht nuk përbënin përndjekje.²⁵⁵⁷ Prokuroria e apelon këtë përfundim, duke argumentuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktik.²⁵⁵⁸ Dhoma e Apelit gjithashtu kujton përfundimin e vet se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se vajza shqiptare kosovare nga kolona në komunën e Prishtinës dhe dy të rejtat shqiptare kosovare në Beleg që u mbajtën së bashku me dëshmitaren K20, pësuan dhunë seksuale.²⁵⁵⁹

²⁵⁵² Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6.

²⁵⁵³ Shih më poshtë, Pjesa XIX.C.3.

²⁵⁵⁴ Aktgjykimi, para. 1793. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1150-1152.

²⁵⁵⁵ Aktgjykimi, para. 1791. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 833-838.

²⁵⁵⁶ Aktgjykimi, para. 1791, 1793.

²⁵⁵⁷ Aktgjykimi, para. 1796-1797.

²⁵⁵⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1, 4-6, 8-17, 25-33, 40-41, 56.

²⁵⁵⁹ Shih më lart, para. 859, 869.

Prokuroria parashtron se dhuna seksuale në këto raste u krye me synimin për të diskriminuar dhe përbënte përndjekje.²⁵⁶⁰

871. Fillimisht, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë pretendimin për gabim ligjor.

2. Pretendim për gabim ligjor në vlerësimin e provave të rëndësishme për përcaktimin e synimit diskriminues në lidhje me përdhunimin e Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14

(a) Hyrje

872. Dhoma Gjyqësore u shpreh se:

Për asnjë nga incidentet [e dhunës seksuale kundër K14-ës dhe K20-ës] nuk janë paraqitur prova që vërtetojnë se keqbërësit vepruan me synimin për të diskriminuar. Megjithëse viktimat në secilin prej këtyre incidenteve ishin shqiptarë kosovarë dhe keqbërësit ishin pjesëtarë të forcave serbe, duke marrë parasysh numrin e kufizuar të incidenteve që janë marrë për të provuar këtë veprim bazë të përndjekjes, Dhoma gjykon se vetëm përkatësia etnike e dy viktimave nuk është arsye e mjaftueshme për të vërtetuar se keqbërësit vepruan me synim diskriminues.²⁵⁶¹

(b) Argumentet e palëve

873. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur analizoi veçazi dhunën seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14, duke marrë parasysh vetëm disa nga provat përkatëse.²⁵⁶² Argumentohet se, në kundërshtim me përfundimin e Dhomës Gjyqësore, “përkatësia etnike e viktimave nuk ishte e vetmja provë që u paraqit për të vërtetuar se keqbërësit vepruan me synim diskriminues”.²⁵⁶³ Sipas Prokurorisë, kur konkludoi se “nuk u paraqit asnjë provë konkrete” që vërtetonte se ushtruesit e dhunës seksuale vepruan me synim konkret, Dhoma Gjyqësore “kufizoi padrejtësisht kuadrin e provave që i gjykoi të rëndësishme”.²⁵⁶⁴ Prokuroria parashtron se jurisprudenca ka përcaktuar se provat e ekzistencës së synimit nuk kufizohen vetëm në faktet konkrete të krimit të marrë veçazi, por përfshijnë edhe kontekstin e rrethanat e kryerjes së krimit.²⁵⁶⁵ [Prokuroria] argumenton se mosshqyrtimi i dhunës seksuale brenda kontekstit më të gjerë të rrethanave në të cilat ndodhi, gjegjësisht në kuadrin e fushatës së dhunshme përndjekëse kundër shqiptarëve kosovarë, e çoi Dhomën Gjyqësore në gabim ligjor.²⁵⁶⁶

²⁵⁶⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1, 18-24, 34-39.

²⁵⁶¹ Aktgjykimi, para. 1796.

²⁵⁶² Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40-41.

²⁵⁶³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40.

²⁵⁶⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179.

²⁵⁶⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 41; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179, 191, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184, 188. Sipas Prokurorisë, nëse rrethanat e krimeve konkrete përputhen me sulmin më të gjerë diskriminues, synimi diskriminues mund të deduktohet nga faktorët rrethorë (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 191).

²⁵⁶⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 40-41; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1, 4, 6, 8, 17, 25, 33; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 2.

874. Prokuroria më tej parashtron se Dhoma Gjyqësore shpërfilli kontekstin dhe rrethanat e dhunës seksuale, ndërkohë që faktorë të tillë rrethorë i konsideroi si prova të synimit diskriminues lidhur me veprime të tjera bazë të përndjekjes.²⁵⁶⁷ Sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor edhe për faktin se përfundimin se nuk ishte vërtetuar krimi i përndjekjes, e bazoi në një numër të kufizuar incidentesh.²⁵⁶⁸

875. Gjorgjeviqi përgjigjet se Dhoma Gjyqësore arriti në konkluzionin e arsyeshëm se nuk kishte prova të mjaftueshme për vërtetimin e ekzistencës së synimit diskriminues në ushtrimin e dhunës seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14.²⁵⁶⁹ Ai parashtron se gabimi që pretendon Prokuroria “duket se qëndron vetëm në pretendimin e përsëritur të saj” se Dhoma Gjyqësore artificialisht ndau incidentet dhe i shqyrtoi veçazi.²⁵⁷⁰ Sipas Gjorgjeviqit, synimi diskriminues mund të deduktohet vetëm nga konteksti i një sulmi që përbën krim kundër njerëzimit, në qoftë se faktehet nga rrethanat e kryerjes së krimit.²⁵⁷¹ Ai argumenton se vlerësimi i synimit subjektiv të keqbërësit nuk varet vetëm nga konteksti rrethor i sulmit, dhe se nga përfundimet e Dhomës Gjyqësore del qartë se i kishte analizuar të gjitha faktet përkatëse.²⁵⁷² Gjorgjeviqi pretendon se Prokuroria nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh kontekstin e përgjithshëm të secilit prej rasteve kur konkludoi se nuk u vërtetua se keqbërësit kryen dhunë seksuale kundër grave “*për shkak se* ishin shqiptare kosovare”.²⁵⁷³ Gjorgjeviqi më tej shton se në përgjithësi, provat e paraqitura nuk mbështesin përfundimin se në pesë rastet e pretenduara dhuna seksuale u krye me synim diskriminues.²⁵⁷⁴ Ai argumenton se Prokuroria thjesht përpiket “të deduktojë synimin nga konflikti në tërësi, dhe jo synimin konkret prej dhunës seksuale konkrete”.²⁵⁷⁵ Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se “përkimi midis

²⁵⁶⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 41; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179-183, 189-190, 200-201, 204, 206, përmendet Aktgjykimi, para. 618, 720, 824, 1192, 1701, 1751, 1774, 1777, 1781, 1783-1789, 1855.

²⁵⁶⁸ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 177, 183-184, 205. Prokuroria parashtron se ligji nuk kushtëzon që të plotësohet një kufi numerik i caktuar në mënyrë që veprimet të përbëjnë përndjekje, dhe se një veprim i vetëm mund të përbëjë përndjekje (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 177, 183-184, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 102, Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135, Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 153, 155).

²⁵⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 10-11, 24; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 192-196.

²⁵⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 18.

²⁵⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 19-20, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 129, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 460, Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164, Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184. Gjorgjeviqi pretendon se çështjet e përmendura nga Prokuroria dallojnë nga çështja aktuale, meqenëse rrethanat e atyre çështjeve përfshinin krime kundër të burgosurve për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo fetare dhe se “synimi diskriminues u provua nga fakti i pranisë së disa keqbërësve brenda të njëjtit grup” Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 20, përmendet Dosja e Apelit të Prokurorisë, sh. 140).

²⁵⁷² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 22; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 194-196. Gjorgjeviqi veçanërisht argumenton se fakti që Dhoma Gjyqësore përmend “numrin e kufizuar të incidenteve në mbështetje” të pretendimeve për përndjekje përmes dhunës seksuale, tregon qartë se Dhoma i analizoi të gjitha faktet përkatëse (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 22).

²⁵⁷³ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 21-22 (theksi në origjinal).

²⁵⁷⁴ Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 10-11, 35; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 193.

²⁵⁷⁵ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 21.

përkatësisë etnike dhe krimin në bazë të fakteve të paraqitura lidhur me këto incidente, nuk vërtetoi se këto gra u përdhunuan *për shkak të përkatësisë së tyre etnike*”.²⁵⁷⁶

(c) Analizë

876. Dhoma e Apelit kujton se krimi i përndjekjes “kushtëzon ekzistencën e provave të synimit konkret për të diskriminuar mbi baza politike, racore dhe fetare dhe se detyrimi i vërtetimit se veprimet përkatëse u kryen me synimin e nevojshëm diskriminues i takon Prokurorisë”.²⁵⁷⁷ Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se synimi i nevojshëm diskriminues nuk mund të deduktohet prej karakterit të përgjithshëm diskriminues të një sulmi të cilësuar krim kundër njerëzimit, mirëpo ai “mund të deduktohet prej këtij konteksti në qoftë se bazuar në faktet e çështjes, rrethanat e kryerjes së veprimeve të pretenduara vërtetojnë ekzistencën e synimit”.²⁵⁷⁸ Ndër rrethanat që mund të merren parasysh janë funksionimi i një burgu (veçanërisht natyra sistematike e krimeve të kryera kundër një grupi racor apo fetar në burg) dhe qëndrimi i përgjithshëm i autorit të pretenduar të shkeljes i pasqyruar në sjelljen e tij.²⁵⁷⁹ Dhoma e Apelit më tej kujton se, në qoftë se nga një grup personash të zgjedhur në bazë të përkatësisë së tyre racore, fetare ose politike, veçohen vetëm persona të caktuar të cilët i nënshtrohen keqtrajtimit, një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të deduktojë se keqtrajtimi i tyre u krye mbi baza diskriminuese.²⁵⁸⁰

877. Në nxjerrjen e përfundimeve mbi synimin diskriminues, Dhoma Gjyqësore theksoi se nuk u paraqitën “prova konkrete” dhe se, “duke marrë parasysh numrin e kufizuar të incidenteve”, “vetëm përkatësia etnike e dy grave” nuk ishte arsye e mjaftueshme për të vërtetuar se keqbërësit vepruan me synim diskriminues.²⁵⁸¹ Dhoma e Apelit gjykon se kur nxori këtë përfundim, Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi rrethanat e dhunës seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14 dhe kontekstin më të gjerë në të cilin ajo u krye.²⁵⁸²

²⁵⁷⁶ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 22 (theksi në origjinal).

²⁵⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184.

²⁵⁷⁸ Aktgjykimi, para. 1759-1760. Shih Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164, citon Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 110.

²⁵⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184. Aty, Dhoma e Apelit konkludoi se në rrethana kur në një burg vetëm të burgosurit joserbë ishin rrahur dhe kishin bërë punë të detyruar, ishte i logjikshëm përfundimi se këto veprime ishin kryer për shkak të përkatësisë politike apo fetare të viktimave, dhe se ishin kryer me synimin e nevojshëm diskriminues (Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 186, 201-202, Shih gjithashtu para. 236-237 lidhur me shpërnguljen e dhunshme).

²⁵⁸⁰ Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 572, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, ku Dhoma e Apelit konkludoi se në rrethana kur të gjithë rojet e burgut janë të një përkatësie etnike, kurse të gjithë të burgosurit të një përkatësie tjetër etnike, është i logjikshëm përfundimi se këta të fundit janë të diskriminuar (Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 950); Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, ku Dhoma e Apelit theksoi se meqenëse thaujse të gjithë të burgosurit ishin joserbë, ishte i logjikshëm përfundimi se ata mbaheshin në burg për shkak se i përkisnin atij grupi, dhe për këtë arsye burgosja e tyre kishte karakter diskriminues (Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 366).

²⁵⁸¹ Aktgjykimi, para. 1796 (theksi i shtuar).

²⁵⁸² Sikurse u theksua më lart, synimi diskriminues mund të deduktohet nga konteksti i sulmit, në qoftë se faktotet prej rrethanave të veprimeve bazë të krimin të përndjekjes (Shih Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 129; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184).

Për shembull, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh se këto krime ndodhën gjatë shpërnguljes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare që kryen forcat serbe në jetësimin e NPK-së.²⁵⁸³ [Dhoma Gjyqësore] nuk mori parasysh as faktin se NPK-ja u jetësua përmes një fushate sistematike terrori dhe dhune, e cila synonte të detyronte shqiptarët kosovarë të largoheshin nga Kosova për të garantuar kontrollin serb mbi krahinën.²⁵⁸⁴ Për mendimin e Dhomës së Apelit, mosmarrja parasysh e këtyre faktorëve së bashku me kushtin e “provave konkrete” që formuloi, tregojnë se Dhoma Gjyqësore, zbatoi në mënyrë të gabuar standardin ligjor përkatës dhe për pasojë bëri gabim ligjor.

878. Për shkak të këtij gabimi ligjor, Dhoma e Apelit do të zbatojë standardin e duhur lidhur me provat dhe do të gjykojë nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14 u krye me synim diskriminues dhe nëse përbënte përndjekje si krim kundër njerëzimit.

879. Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit gjithashtu kujton përfundimin e vet të mëparshëm se vajza shqiptare kosovare nga kolona në komunën e Prishtinës dhe dy të rejtat e tjera shqiptare kosovare në Beleg pësuan dhunë seksuale,²⁵⁸⁵ dhe mban parasysh parashtrimin e Prokurorisë se dhuna seksuale në rastin e tyre përbënte përndjekje.²⁵⁸⁶

880. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do ta shqyrtojë dhunën seksuale që pësuan këto pesë të reja bashkërisht dhe do të konkludojë nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se veprime të tilla përbënin përndjekje.

3. A përbënte përndjekje dhuna seksuale e lartpërmendur

(a) Argumentet e palëve

881. Lidhur me Dëshmitaren K20, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shpërfilli rrethanat në të cilat ajo u përdhunua dhe anashkaloi provat e drejtpërdrejta të synimit diskriminues.²⁵⁸⁷ Argumentohet se dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20 u krye në kohën e shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga Belegu, gjatë së cilës ata u plaçkitën, rrahën, vranë, ndaluan dhe iu nënshtruan veprimeve të ndryshme diskriminuese të forcave

²⁵⁸³ Shih Aktgjykimi, para. 817-832, 834-835, 1142-1160, 1617-1679, 1791, 1793, 2007, 2034-2035, 2126, 2128-2130, 2136.

²⁵⁸⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2007, 2035, 2126, 2128, 2130-2131. Shih gjithashtu më lart, para. 116-120, 153-159.

²⁵⁸⁵ Shih më lart, para. 859, 869.

²⁵⁸⁶ Shih më lart, para. 870.

²⁵⁸⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25-33; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179-180.

serbe.²⁵⁸⁸ Prokuroria gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh provat e drejtpërdrejta të synimit diskriminues, domethënë komentet përndjekëse të keqbërësve.²⁵⁸⁹

882. Lidhur me Dëshmitaren K14, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktik kur konkludoi se nuk ishte paraqitur asnjë provë konkrete që do të vërtetonte se përdhunuesit e saj vepruan me synim diskriminues.²⁵⁹⁰ Prokuroria parashtron se para se të përdhunohej, Dëshmitarja K14 përjetoi një sërë veprimesh përndjekëse për shkak se ishte shqiptare kosovare.²⁵⁹¹ Prokuroria thekson se Dëshmitarja K14 dhe familja e saj ishin ndër shqiptarët kosovarë të qytetit të Prishtinës të cilët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u larguan nga qyteti nën përcjelljen e forcave serbe; se ajo dhe familja e saj u detyruan vazhdimisht të shkonin nga një fshat në një tjetër për t'i ikur sulmeve të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë, dhe se në fund, pas përdhunimit të saj Dëshmitarja K14 dhe motra e saj nga frika u larguan në IRJM.²⁵⁹² Sipas Prokurorisë, përdhunimi i Dëshmitares K14 “nuk mund të shkëputet nga zinxhiri i veprimeve diskriminuese” që ajo përjetoi para largimit të saj.²⁵⁹³

883. Lidhur me dy të rejat shqiptare kosovare në Beleg të cilat u mbajtën së bashku me Dëshmitaren K20, si dhe lidhur me vajzën shqiptare kosovare nga kolona, Prokuroria parashtron se dhuna seksuale kundër tyre u krye gjatë fushatës së dhunës përndjekëse që kryen forcat serbe me synimin e largimit të popullatës shqiptare kosovare nga Kosova, ishte pjesë e kësaj fushate dhe përbën përndjekje.²⁵⁹⁴ Prokuroria parashtron se do të ishte “thjesht gabim” që veprimet e dhunës seksuale të shkëputen nga veprimet e tjera përndjekëse që këto të reja përjetuan.²⁵⁹⁵ Prokuroria argumenton se dhuna seksuale që pësuan dy të rejat në Beleg u krye në kohën e shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve kosovarë nga Belegu, gjatë së cilës ata u plaçkitën, rrahën, vranë, ndaluan dhe iu nënshtruan veprimeve të ndryshme diskriminuese të forcave serbe.²⁵⁹⁶ Gjatë këtyre ngjarjeve, gratë, ndër të cilat edhe dy të rejat në fjalë, ishin veçanërisht të pambrojtura meqenëse para ndalimit të tyre ato u ndanë nga burrat.²⁵⁹⁷ Prokuroria gjithashtu u referohet provave të drejtpërdrejta të synimit diskriminues, domethënë komenteve përndjekëse të autorëve të dhunës seksuale kundër këtyre dy të rejave.²⁵⁹⁸ Në lidhje me vajzën shqiptare kosovare nga kolona, Prokuroria veçanërisht thekson se forcat serbe krijuan atmosferë terrori që i detyroi shqiptarët kosovarë duke përfshirë edhe këtë vajzë, të

²⁵⁸⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25-26, 28, 33; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 180.

²⁵⁸⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25, 28-29, 31-33; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 180-182, 204.

²⁵⁹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 8. Shih Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 9-17.

²⁵⁹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 10-11, 15-17; Seanca e Apelit 13 maj 2013, AT. 182-183.

²⁵⁹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 10-11, 15; Seanca e Apelit 13 maj 2013, AT. 182-183.

²⁵⁹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 16.

²⁵⁹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 6, 18, 23-24, 38; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 179-180, 182, 184.

²⁵⁹⁵ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 182-183, 190.

²⁵⁹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 38. Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 26; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 180, 182, 201.

²⁵⁹⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 38.

²⁵⁹⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 25, 28-29, 33.

largoheshin në kolona të tëra.²⁵⁹⁹ Sipas Prokurorisë, në rrethana të tilla, personat e zhvendosur ishin të pambrojtur nga keqtrajtimet e forcave serbe të cilat vijuan t'i shqetësonin dhe keqtrajtonin personat e zhvendosur, ndër të tjerë edhe personat nga e njëjta kolonë me vajzën.²⁶⁰⁰ Në rrethana të tilla, “vajzat shqiptare kosovare ishin thuajse të pambrojtura.”²⁶⁰¹

884. Prokuroria gjithashtu argumenton se edhe në qoftë se motivi i autorëve të dhunës seksuale ishte krejtësisht seksual, kjo nuk e përjashton përfundimin se ata vepruan me synim diskriminues.²⁶⁰²

885. Gjorgjeviqi përgjigjet se dhuna seksuale që pësuan Dëshmitarja K20 dhe Dëshmitarja K14 nuk lidhej me ndonjë “plan përndjekës” por u krye nga “kriminelë që vepronin në arenën e luftës nën mbulesën e errësirës”.²⁶⁰³ Në përgjigjen e tij, ai gjithashtu parashtron se megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk iu referua komenteve përndjekëse të keqbërësve në dëshminë e Dëshmitares K20, nga Aktgjykimi del qartë se [Dhoma Gjyqësore] shtjelloi me imtësi dëshminë e Dëshmitares K20 për nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me krimet në Beleg, që do të thotë se “duhet të ketë marrë parasysh” edhe dëshminë e saj lidhur me komentet e keqbërësve.²⁶⁰⁴ Ai gjithashtu parashtron se “të gjitha komentet [të cilat sipas Prokurorisë tregojnë synimin diskriminues] kishin të bënin thjesht me aeroplanët e ‘NATO-s’ (ushtri e aleatëve) që fluturonin lart dhe ‘UÇK-në’ (organizatë terroriste), dhe nuk ishin deklarata përndjekëse lidhur me përkatësinë etnike”.²⁶⁰⁵

(b) Analizë

a. Synimi diskriminues

i. Hyrje

886. Për të konkluduar se dhuna seksuale kundër pesë vajzave të reja përbën përndjekje, Dhoma e Apelit duhet të bindet se i vetmi rrjedhim i arsyeshëm është se dhuna seksuale u krye me synimin për të diskriminuar mbi baza politike, racore ose fetare.²⁶⁰⁶ Lidhur me këtë, Dhoma

²⁵⁹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 19; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 183.

²⁶⁰⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 20, 23.

²⁶⁰¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 23.

²⁶⁰² Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 184, 189, 206, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 153, 155. Në përgjithësi, Prokuroria argumenton se dhuna seksuale nuk duhet të trajtohet ndryshe nga veprimet e tjera të dhunshme thjesht për shkak të elementit seksual (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 176).

²⁶⁰³ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 25-30. Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se nuk mjafton që një i akuzuar të jetë i vetëdijshëm se faktikisht, ai vepron në një mënyrë diskriminuese, por duhet të synojë diskriminimin me vetëdije të plotë (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 193-194, përmendet Aktgjykimi, para. 1759, Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 996, Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*, para. 217).

²⁶⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 29, përmendet, ndër të tjera, Aktgjykimi, sh. 4463-4480.

²⁶⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 28 (pa citimet).

²⁶⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*, para. 109; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 131; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185. Shih Aktgjykimi, para. 1755.

e Apelit kujton se synimi i nevojshëm diskriminues nuk mund të deduktohet drejtpërsëdrejti prej karakterit të përgjithshëm diskriminues të një sulmi të cilësuar krim kundër njerëzimit,²⁶⁰⁷ mirëpo ai mund të deduktohet prej kontekstit të sulmit në qoftë se, bazuar në faktet e çështjes, rrethanat e kryerjes së krimit faktojnë ekzistencën e një synimi të tillë.²⁶⁰⁸ Për më tepër, jurisprudenca ka përcaktuar se fakti që krimi ka ndodhur në kohën kur, për arsye diskriminuese viktimat u dëbuan, apo u ndaluan para dëbimit të tyre, është marrë parasysh për të deduktuar synimin diskriminues nga rrethanat.²⁶⁰⁹

887. Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se motivet personale nuk përjashtojnë mundësinë që keqbërësi të ketë vepruar me synimin konkret të nevojshëm.²⁶¹⁰ Dhoma e Apelit thekson se e njëjta gjë vlen edhe për krimet seksuale, të cilat në këtë kontekst nuk duhen trajtuar ndryshe nga veprimet e tjera të dhunshme thjesht për shkak të elementit seksual. Rrjedhimisht, një keqbërës mund të jetë i motivuar nga dëshira seksuale, por njëkohësisht të ketë synimin për të diskriminuar viktimën për arsye politike, racore ose fetare.²⁶¹¹ Për më tepër, Dhoma e Apelit kujton se ndonëse krimi i përndjekjes shpesh ka të bëjë me një sërë sulmesh, përndjekje mund të cilësohet edhe një veprim i vetëm në qoftë se kryhet qëllimisht me synimin për të diskriminuar për një nga arsyet e lartpërmendura.²⁶¹²

888. Siç u theksua më lart, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale me qëllimin e përbashkët diskriminues të ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës, për të garantuar kontrollin serb mbi krahinën.²⁶¹³ Dhoma e Apelit citon përfundimin e Dhomës Gjyqësore se në kuadër të NPK-së, gjatë periudhës mars-qershor 1999, forcat serbe kryen “një fushatë terrori dhe dhune të skajshme në Kosovë kundër shqiptarëve

²⁶⁰⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 366. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164, citon Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 110.

²⁶⁰⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 366. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164, citon Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 110.

²⁶⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185-186; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 950; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 462-463; Aktgjykimi i Apelit *Naleteliq dhe Martinoviç*, para. 572.

²⁶¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 463; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 49.

²⁶¹¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 370 (ku Dhoma e Apelit gjykoi se Dhoma Gjyqësore kishte arritur në konkluzionin e arsyeshëm se Radiqi veprroi me synimin e nevojshëm diskriminues kur përdhanoi dhe kreu dhunë seksuale kundër femrave joserbe “pavarësisht nga motivet e tij personale për kryerjen e këtyre veprimeve” (Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 370). Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 153 (ku Dhoma e Apelit gjykoi se edhe nëse motivimi kryesor i keqbërësit është krejtësisht seksual, kjo nuk do të thotë se keqbërësi nuk ka synimin e kryerjes së veprimit të torturës (Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerët*, para. 153)); Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 49 (ku Dhoma e Apelit gjykoi se autori i krimit të gjenocidit mund të veprojë me synimin e realizimit të përfitimeve materiale apo politike, ose të ndonjë forme tjetër pushteti, por kjo nuk e përjashton mundësinë që ai të ketë synimin konkret për gjenocid (Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 49)).

²⁶¹² Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 102, citon Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviç*, para. 113.

²⁶¹³ Aktgjykimi, para. 2007. Shih gjithashtu më lart, para. 86.

kosovarë”.²⁶¹⁴ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se “dëbimet, vrasjet, shpërnguljet e dhunshme dhe përndjekjet ishin karakteristika tipike të kësaj fushate” dhe se veprimet e forcave serbe: “synonin terrorizimin e popullatës shqiptare kosovare, duke vrrarë shumë prej tyre dhe duke i bërë ata që kishin mbetur të largoheshin nga Kosova, e në këtë mënyrë e gjithë popullsia shqiptare apo një pjesë e konsiderueshme e saj të mos jetonte më në Kosovë”.²⁶¹⁵ Dhoma Gjyqësore konkludoi se një fushatë e tillë u krye edhe në komunën e Deçanit dhe Prishtinës, ku gjatë të njëjtës periudhë ndodhën dhe pesë incidentet konkrete të dhunës seksuale.²⁶¹⁶ Më poshtë, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë një nga një incidentet e dhunës seksuale për të përcaktuar nëse u kryen me synimin e nevojshëm diskriminues.

ii. Dëshmitarja K20 dhe dy të rejat e tjera shqiptare kosovare në Beleg

889. Dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe dy të rejave të tjera shqiptare kosovare u krye në Beleg, në komunën e Deçanit.²⁶¹⁷ Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 29 mars 1999, forcat serbe në Beleg i larguan shqiptarët kosovarë me dhunë nga shtëpitë e tyre, i kontrolluan dhe i rrahën, u morën dokumentet e identifikimit, i rrethuan dhe mbajtën me roje gjatë natës dhe më në fund, më 30 mars 1999, i dëbuan për në Shqipëri.²⁶¹⁸ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se gjatë këtyre ngjarjeve në Beleg, forcat serbe plaçkitën dhe u vunë zjarrin shtëpive të shqiptarëve kosovarë.²⁶¹⁹

890. Dëshmitarja K20 dhe familja e saj, si dhe dy të rejat e tjera ishin ndër njerëzit që u sulmuan nga forcat serbe në Beleg.²⁶²⁰ Dëshmitarja K20 dëshmoi se në mëngjesin e datës 29 mars 1999, ajo dhe familja e saj u dëbuan nga shtëpia e tyre dhe u çuan në një bodrum ku ishin edhe familje të tjera.²⁶²¹ Gjatë kohës që po mbaheshin në bodrum, pjesëtarët e forcave serbe ndër të tjera u thanë: “Ju e kërkuat NATO-n, tani le të vijë t’ju shpëtojë. Mos qani, s’ka dasmë pa mish, vetë e kërkuat!” dhe “Pse qani? Duhet ta kishit menduar më herët se tani jeni në luftë me shtetin. Le të vijë NATO t’ju ndihmojë.”²⁶²² Më vonë atë ditë, Dëshmitaren K20 e çuan në një shtëpi tjetër ku ajo së bashku me të ëmën, motrat, dhe një grup grash dhe fëmijësh shqiptarë

²⁶¹⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2130. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1597-1601, 1617-1679, 2007, 2027-2029, 2034-2035, 2126, 2128-2130.

²⁶¹⁵ Aktgjykimi, para. 2035, 2130.

²⁶¹⁶ Aktgjykimi, para. 817-832, 834-835, 1142-1160, 1649-1650, 1672-1673, 1791, 1793, 2027, 2029, 2034-2035, 2129-2130; më lart, para. 859, 869.

²⁶¹⁷ Aktgjykimi, para. 1793; më lart, para. 866-869.

²⁶¹⁸ Aktgjykimi, para. 1144-1149, 1153-1156, 1159, 1673, 1774, 2027.

²⁶¹⁹ Aktgjykimi, para. 1148, 1155, 1160, 2027.

²⁶²⁰ Aktgjykimi, para. 1145-1153; Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 2-6; P1280, f. 2-6.

²⁶²¹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 2-3; P1280, f. 2-3. Shih Aktgjykimi, para. 1146; K20, 27 gusht 2009, T. 8490-8492.

²⁶²² Prova Materiale P1279, f. 3 (konfidenciale); P1280, f. 3; P1281 (konfidenciale), f. 5221-2522. Shih Aktgjykimi, para. 1146.

kosovarë, ndër të cilët Dëshmitarja K58, dhe dy të rejat e tjera, u mbajtën nga forcat serbe.²⁶²³ Atë natë, pjesëtarë të forcave serbe morën Dëshmitaren K20 dhe dy të rejat e tjera dhe i çuan në një oborr me pretekstin se u duheshin gra për të pastruar.²⁶²⁴ Ndërsa tri të rejat po qëndronin në oborr, ushtarët shanin aeroplanët e NATO-s që fluturonin lart mbi kokë: “U qifshim nënat NATO-s” dhe ngrinin gishtin e madh në drejtim të aeroplanëve.²⁶²⁵ Më pas, Dëshmitarja K20 dhe dy të rejat e tjera u çuan në një shtëpi tjetër.²⁶²⁶ Dëshmitarja K20 kishte shumë frikë sepse “e dinte se çfarë do të ndodhte” sepse kishte dëgjuar se “serbët po përdhunonin vajzat dhe gratë kosovare”.²⁶²⁷ Faktikisht, ashtu sikurse konkludoi Dhoma Gjyqësore, Dëshmitarja K20 u përdhunua nga disa ushtarë serbë.²⁶²⁸ Kur ajo bërtiti, një prej ushtarëve e kërcënoi dhe i tha që të mos ulërinte se ndryshe do t’ia “qinte nënën”.²⁶²⁹ Gjatë përdhunimit të Dëshmitares K20, i njëjti polic që më herët atë ditë kishte dëbuar Dëshmitaren K20 dhe familjen e saj nga shtëpia po bënte roje para derës së dhomës, dhe pas tij, ajo pa ushtarë të tjerë duke pritur në korridor.²⁶³⁰ Më pas, polici i tha: “UÇK-ja ka bërë edhe më keq se këta, ti mund t’i përballosh.”²⁶³¹ Dhoma e Apelit ka konkluduar se si Dëshmitarja K20, po ashtu edhe dy të rejat e tjera pësuan dhunë seksuale nga pjesëtarë të forcave serbe atë natë, gjatë kohës që ishin në duart e forcave serbe.²⁶³² Për më tepër, ka dëshmi se më të njëjtën natë në Beleg, nga dhoma ku mbaheshin Dëshmitarja K20 dhe grupi i grave dhe fëmijëve, ushtarët sistematikisht veçuan dhe morën njëzet të reja shqiptare kosovare.²⁶³³ Kur i kthyen në dhomë, ato ishin duke qarë dhe flokët i kishin të shprishura, dhe njëra prej tyre u dëgjua kur i tha të ëmës se e kishin përdhunuar.²⁶³⁴ Të nesërmen në mëngjes, Dëshmitarja K20, Dëshmitarja K58, dy të rejat dhe grupi i grave dhe fëmijëve u urdhëruan që të niseshin për në Shqipëri.²⁶³⁵ Atyre u thanë: “Amerika po ju pret. Do të jetoni si në Amerikë.”²⁶³⁶

²⁶²³ Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 5-6; P1080, f. 5-6; P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2525-2526. Shih Aktgjykimi, para. 1149; më lart, para. 866-867.

²⁶²⁴ K20, 27 gusht 2009, T. 8494 (seancë e mbyllur); Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4; P1281 (konfidenciale), f. 2527. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1150; K58, 13 korrik 2009, T. 7299; Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 6; P1080, f. 6.

²⁶²⁵ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4.

²⁶²⁶ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4; P1280, f. 4.

²⁶²⁷ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4-5; P1280, f. 4-5.

²⁶²⁸ Aktgjykimi, para. 1151, 1793. Shih Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5; P1281 (konfidenciale), f. 2529-2532.

²⁶²⁹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5.

²⁶³⁰ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4-5; P1280, f. 4-5.

²⁶³¹ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 5; P1280, f. 5.

²⁶³² Shih më lart, para. 869.

²⁶³³ Aktgjykimi, para. 1152; K58, 13 korrik 2009, T. 7298-7299; Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 6; P1080, f. 6; P1081, f. 7467-7468;.

²⁶³⁴ Aktgjykimi, para. 1152, 1794; Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 6; P1080, f. 6; P1081, f. 7468.

²⁶³⁵ K58, 13 korrik 2009, T. 7300; Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 7; P1080, f. 7; P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6; P1281 (konfidenciale), f. 2533. Shih Aktgjykimi, para. 1153.

²⁶³⁶ Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 6; P1280, f. 6; P1281 (konfidenciale), f. 2533. Dëshmitari K58 deklaroi se atyre u thanë “shkoni në Shqipëri. E kërkuat vetë NATO-n.” (Prova Materiale P1079 (konfidenciale), f. 7; P1080, f. 7; K58, 13 korrik 2009, T. 7300).

891. Përveç rrethanave konkrete të lartpërmendura, Dhoma e Apelit gjithashtu merr parasysh kontekstin më të gjerë të kryerjes së dhunës seksuale. Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit gjykon se përdhunimi i Dëshmitares K20 ndodhi gjatë një fushate sistematike terrori dhe dhune, gjatë së cilës u kryen veprime të shumta përndjekëse kundër shqiptarëve kosovarë²⁶³⁷ e cila synonte t'i detyronte të largoheshin nga Kosova.²⁶³⁸ Dëshmitarja K20 pësoi dhunë seksuale pak para se të dëbohej.²⁶³⁹ Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dëshmitarja K20 ishte shqiptare kosovare dhe keqbërësit ishin pjesëtarë të forcave serbe, të cilët gjithashtu kryen sulmin e përgjithshëm kundër popullatës shqiptare kosovare.²⁶⁴⁰

892. Dhoma e Apelit gjykon se dëshmia e drejtpërdrejtë e Dëshmitares K20 lidhur me përdhunimin e saj, siç përshkruhet në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, së bashku me rrethanat e përdhunimit dhe kontekstin më të gjerë në të cilin ai ndodhi, çojnë pa mëdyshje në përfundimin se Dëshmitarja K20 u sulmua për shkak të përkatësisë etnike të saj dhe se ajo u përdhunua me synim diskriminues. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se edhe në rast se do të supozohej se keqbërësit ishin të motivuar nga dëshira seksuale kur përdhunuan Dëshmitaren K20, vendimi i tyre për të përdhunuar ishte rezultat i synimit të tyre për ta diskriminuar mbi baza etnike.

893. Siç u theksua më lart, dy të rejat e tjera nga Belegu u mbajtën në të njëjtën shtëpi me Dëshmitaren K20 dhe Dëshmitaren K58, dhe u çuan në një shtëpi aty pranë së bashku me Dëshmitaren K20 natën kur ndodhi dhuna seksuale.²⁶⁴¹ Rrethanat e dhunës seksuale kundër dy të rejave rrjedhimisht janë të njëjta me rrethanat e përdhunimit të Dëshmitares K20. Këtu përfshihen, ndër të tjera, dëshmitë lidhur me: (i) komentet diskriminuese të pjesëtarëve të forcave serbe ndaj tri të rejave kur ato ishin në oborr, (ii) komentet ndaj grupit të grave dhe fëmijëve, (iii) fakti se keqbërësit ishin pjesëtarë të forcave serbe të cilat u implikuan edhe në zhvendosjen e dhunshme të shqiptarëve kosovarë, (iv) fakti se të dy gratë ishin shqiptare kosovare, dhe (v) fakti se dhuna seksuale që pësuan ato ndodhi gjatë shpërnguljes së tyre të dhunshme.²⁶⁴² Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat është se keqbërësit vepruan me synim diskriminues kur kryen dhunë seksuale kundër dy të rejave të tjera. Sikurse me keqbërësit në rastin e Dëshmitares K20, fakti se ata mund të kenë

²⁶³⁷ Shih Aktgjykimi, para., 1145-1154, 1672-1673, 1777-1778, 1781, 1783, 1790, 1811, 1819, 1825, 1832, 1837, 1841, 1850, 1854-1856, 2027-2035, 2129-2130. Shih më lart, Pjesa XVI.B, XVII.B. Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se gjatë fushatës, shqiptarët kosovarë u sulmuan pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare (Shih Aktgjykimi, para. 1649-1650, 1777-1778, 1781, 1783).

²⁶³⁸ Aktgjykimi, para. 2007, 2035, 2126, 2128-2130, 2143-2144.

²⁶³⁹ Aktgjykimi, para. 1151, 1153, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁰ Aktgjykimi, para. 1151, 1597-1598, 1601, 1791, 1793, 2027-2029, 2036-2051.

²⁶⁴¹ Shih më lart, para. 866, 890.

²⁶⁴² Shih më lart, para. 866-869, 889-891; Aktgjykimi, para. 1150-1151.

pasur edhe motive të natyrës personale, nuk ndikon në përfundimin se ata vepruan me synimin për të diskriminuar.

iii. Dëshmitarja K14

894. Përsa i përket Dëshmitares K14, ajo dhe familja e saj ishin ndër shqiptarët e shumtë kosovarë që forcat serbe i dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe qyteti i Prishtinës në fund të marsit 1999.²⁶⁴³ Në fund të marsit 1999, ata u nisën në kolonë në drejtim të Grashticës.²⁶⁴⁴ Forcat serbe i shanë shqiptarët kosovarë të kolonës dhe u thanë të shkonin tek “vëllezërit e tyre në Shqipëri” dhe t’i kërkonin ndihmë NATO-s.²⁶⁴⁵ Pas dy-tri javësh, Dëshmitarja K14 dhe familja e saj u detyruan përsëri të largoheshin në kolonë së bashku me shumë shqiptarë kosovarë të tjerë dhe u kthyen në Prishtinë, me shpresë se atje do të ishin më të sigurtë.²⁶⁴⁶ Përgjatë rrugës për në Prishtinë kishte forca serbe.²⁶⁴⁷ Pas kthimit në Prishtinë, një mëngjes të muajit maj 1999, gjashtë policë serbë shkuan në shtëpinë ku ishin vendosur Dëshmitarja K14 me familjen.²⁶⁴⁸ Ata u dhanë Dëshmitares K14 dhe anëtarëve të familjes së saj kartela të gjelbra për t’i plotësuar dhe u thanë se do të vinin të nesërmen që t’i çonin në hotelin Bozhur për t’u vënë vulën.²⁶⁴⁹ Kur e dëgjuan këtë gjë, Dëshmitarja K14 dhe familja e saj u frikësuan, meqenëse hoteli Bozhur njihej si vend ku i keqtrajtonin njerëzit.²⁶⁵⁰ Të nesërmen, dy nga të njëjtët policë erdhën përsëri të shoqëruar nga një person i tretë, dhe i detyruan Dëshmitaren K14 dhe motrën e saj që të dilnin jashtë me ta deri tek një makinë.²⁶⁵¹ Motrën e Dëshmitares K14 e lejuan që të kthehej brenda në shtëpi, kurse Dëshmitaren K14 e çuan në hotel Bozhur.²⁶⁵² Atje kishte shumë shqiptarë kosovarë që kishin formuar një rresht.²⁶⁵³ Sidoqoftë, Dëshmitaren K14 e çuan në një dhomë të hotelit ku njëri nga dy policët e përdhunoi.²⁶⁵⁴ Polici tjetër u orvat të hynte brenda në dhomë, por polici i parë nuk e lejoi pasi Dëshmitarja K14 i kishte premtuar se do të shkonte përsëri me të dhe se do të sillte edhe të motrën për policin tjetër.²⁶⁵⁵ Në ditët që vijuan, policët vazhduan të shqetësonin dhe frikësonin Dëshmitaren K14

²⁶⁴³ Aktgjykimi, para. 823-824, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁴ Aktgjykimi, para. 823-824, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁵ Aktgjykimi, para. 823-824, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁶ Aktgjykimi, para. 824, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁷ Aktgjykimi, para. 824, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁸ Aktgjykimi, para. 833, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁴⁹ Aktgjykimi, para. 833, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁵⁰ Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4.

²⁶⁵¹ Aktgjykimi, para. 834, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁵² Aktgjykimi, para. 834, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁵³ Aktgjykimi, para. 835; Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 5.

²⁶⁵⁴ Aktgjykimi, para. 835, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁵⁵ Aktgjykimi, para. 835, përfshirë referencat e cituara.

dhe familjen e saj.²⁶⁵⁶ Nga frika se do pësonte përsëri dhunë seksuale, Dëshmitarja K14 së bashku me të motrën shkuan në IRJM pak ditë më pas, më 24 maj 1999.²⁶⁵⁷

895. Dhoma e Apelit gjykon se përdhunimi i Dëshmitares K14, po ashtu si në rastin e Dëshmitares K20 dhe dy të rejave të tjera në Beleg, ndodhi gjatë një fushate sistematike terrori dhe dhune gjatë së cilës u kryen veprime të shumta përndjekëse kundër shqiptarëve kosovarë,²⁶⁵⁸ që synonin të krijonin atmosferë terrori dhe frike që do të detyronte shqiptarët kosovarë të largoheshin nga Kosova.²⁶⁵⁹ Dhoma e Apelit thekson se Dëshmitarja K14 faktikisht u largua si rezultat i përdhunimit, nga frika se do të pësonte përsëri dhunë seksuale.²⁶⁶⁰ Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dëshmitarja K14 ishte shqiptare kosovare dhe autorët e dhunës seksuale kundër saj ishin persona me pushtet dhe pjesëtarë të forcave serbe të cilat kryen sulmin e përgjithshëm kundër shqiptarëve kosovarë.²⁶⁶¹ Duke marrë parasysh rrethanat konkrete dhe kontekstuale të përdhunimit të Dëshmitares K14, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, është bindur se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se keqbërësit vepruan me synim diskriminues. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjykon se edhe në rast se do të supozohej se policët ishin të motivuar nga dëshira seksuale, vendimi për të përdhunuar Dëshmitaren K120 ishte rezultat i synimit të tyre për ta diskriminuar mbi baza etnike.

iv. Vajza shqiptare kosovare në një kolonë në komunën e Prishtinës

896. Dhoma e Apelit thekson se vajza shqiptare kosovare në kolonë po largohej së bashku me të zhvendosur të tjerë shqiptarë kosovarë në kolona nga Grashtica në drejtim të qytetit të Prishtinës, në përpjekje për të qenë më të sigurtë për jetën e tyre.²⁶⁶² Gjatë rrugës, vajza dhe të tjerët në kolonë u sulmuan dhe u keqtrajtuuan nga forcat serbe për shkak të përkatësisë etnike.²⁶⁶³ Përgjatë rrugës ku kaloi kolona e vajzës kishte forca serbe. Ata ndaluan dhe rrahën

²⁶⁵⁶ Aktgjykimi, para. 838, përfshirë referencat e cituara. Gjatë ditëve pas incidentit, policët erdhën disa herë me makinë para shtëpisë së K14-ës dhe i ranë borisë (Aktgjykimi, para. 838).

²⁶⁵⁷ Aktgjykimi, para. 838, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁵⁸ Shih Aktgjykimi, para. 817-832, 1649-1650, 1777-1778, 1790, 1811, 1819, 1825, 1832, 1837, 1841, 1850, 1854-1856, 2027-2035, 2129-2130; më lart, para. 866-869, 889-891. Shih më lart, Pjesa XVI.B, XVII.B. Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se gjatë kësaj fushate, shqiptarët kosovarë u sulmuan pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare (Shih Aktgjykimi, para. 1649-1650, 1777-1778, 1781, 1783).

²⁶⁵⁹ Aktgjykimi, para. 1649-1650, 1791, 1793, 2007, 2035, 2126, 2128-2130, 2143-2144.

²⁶⁶⁰ Aktgjykimi, para. 838, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁶¹ Aktgjykimi, para. 834-835, 1597-1598, 1601, 1791, 1793, 2027-2029, 2036-2051.

²⁶⁶² Aktgjykimi, para. 824, 832, përfshirë referencat e cituara.

²⁶⁶³ Aktgjykimi, para. 824, 832, përfshirë referencat e cituara, 1776-1778, 2136; më lart, para. 856-859; Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3; P1326 (konfidenciale), f. 1421-1425; K14, 24 shtator 2009, T. 8993-8996, 9016, 9022-9023 (seancë e mbyllur). Dhoma e Apelit përgjithësisht vëren se në Prishtinë, siç u përshkrua më herët në lidhje me dhunën seksuale kundër Dëshmitares K14, shqiptarët kosovarë u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe u dhunuan e u keqtrajtuuan nga forcat serbe (Aktgjykimi, para. 805-840, 1649, 2029; Shih më lart, para. 894-895).

disa shqiptarë kosovarë dhe u morën makinat.²⁶⁶⁴ Dhoma e Apelit gjithashtu citon dëshminë e dëshmitares K14 se ajo kishte dëgjuar që pjesëtarë të forcave serbe kishin marrë gra shqiptare kosovare nga kolona.²⁶⁶⁵ Dhoma e Apelit më herët konkludoi se edhe kjo vajzë shqiptare kosovare u mor nga kolona dhe u çua në pyll, ku pësoi dhunë seksuale nga një polic dhe një burrë tjetër i cili mbante thika dhe kishte veshur pantallona kamuflimi të gjelbra.²⁶⁶⁶

897. Dhuna seksuale kundër vajzës shqiptare kosovare ndodhi gjatë një fushate sistematike terrori dhe dhune gjatë së cilës u kryen veprime të shumta përndjekëse kundër shqiptarëve kosovarë,²⁶⁶⁷ dhe që synonte dëbimin e tyre nga Kosova.²⁶⁶⁸ Vajza nga kolona pësoi dhunë seksuale në kohën kur ajo dhe shqiptarë kosovarë të tjerë po përpiqeshin të gjenin siguri për jetën e tyre dhe po udhëtonin në kolonë përgjatë një rruge ku kishte forca serbe.²⁶⁶⁹ Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se rrethanat konkrete dhe kontekstuale të dhunës seksuale në rastin e saj tregojnë se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se dhuna seksuale e lartpërmendur u krye me synim diskriminues. Këtë përfundim nuk e ndryshon as mundësia që autorët e krimit të kenë vepruar thjesht nga dëshira seksuale. Dhoma e Apelit veçanërisht thekson se vajza ishte duke udhëtuar në kolonë me shqiptarë kosovarë të tjerë të zhvendosur të cilët u keqtrajtuuan sistematikisht nga forcat serbe përgjatë rrugës nga kaloi kolona. Dhuna seksuale që pësoi vajza nuk mund të trajtohet ndaras nga këto rrethana.

898. Pasi ka konkluduar se dhuna seksuale kundër pesë grave u krye me synim diskriminues, Dhoma e Apelit më tej do të shqyrtojë nëse janë përmbushur elementët e tjerë të përndjekjes si krim kundër njerëzimit.

²⁶⁶⁴ Aktgjykimi, para. 824, 832, përfshirë referencat e cituara. Shih gjithashtu Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4.

²⁶⁶⁵ Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4.

²⁶⁶⁶ Shih *më lart*, para. 859. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 832; Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 3-4.

²⁶⁶⁷ Shih Aktgjykimi, para. 817-832, 1649-1650, 1777-1778, 1790, 1811, 1819, 1825, 1832, 1837, 1841, 1850, 1854-1856, 2027-2035, 2129-2130; më lart, para. 859. Shih më lart, Pjesa XVI.B, XVII.B. Dhoma e Apelit vë në dukje përfundimin e Dhomës Gjyqësore se gjatë kësaj fushate, shqiptarët kosovarë u sulmuan pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare (Shih Aktgjykimi, para. 1649-1650, 1777-1778, 1781, 1783).

²⁶⁶⁸ Aktgjykimi, para. 1649-1650, 1791, 1793, 2007, 2035, 2126, 2128-2130, 2143-2144.

²⁶⁶⁹ Aktgjykimi, para. 817-832, 1597-1598, 1601, 1792, 2027-2029, 2036-2051; më lart, para. 857, 859.

b. Kushtet ombrellë dhe pesha e barabartë

899. Dhoma e Apelit kujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se në kohën kur ndodhi dhuna seksuale, ekzistonte konflikt i armatosur dhe po kryhej sulm sistematik kundër popullatës civile shqiptare kosovare.²⁶⁷⁰ Përsa i përket kushtit të ekzistencës së lidhjes, Dhoma e Apelit gjykon se provat e shtjelluara më lart, të marra si tërësi dhe së bashku me përfundimet e Dhomës Gjyqësore,²⁶⁷¹ provojnë se dhuna seksuale në të pesë rastet ishte pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër civilëve shqiptarë kosovarë dhe se keqbërësit e dinin se veprimet e tyre ishin pjesë e këtij sulmi.

900. Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se për t'u cilësuar përndjekje si krim kundër njerëzimit, veprimet bazë duhet të kenë peshë ose ashpërsi të barabartë me veprimet e tjera të renditura në Nenin 5 të Statutit.²⁶⁷² Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit i referohet përfundimit të Dhomës Gjyqësore se Dëshmitarja K20 dhe Dëshmitarja K14 u përdhunuan, shkelje e cila cilësohet krim kundër njerëzimit në pikën g të Nenit 5 të Statutit.²⁶⁷³ Dhoma e Apelit konkludoi se vajza shqiptare kosovare në kolonë dhe dy të rejat në Beleg pësuan dhunë seksuale,²⁶⁷⁴ që në Statut nuk cilësohet krim kundër njerëzimit. Megjithatë, Dhoma e Apelit kujton se dhuna seksuale mund të ndëshkohet si formë përndjekjeje bazuar në të drejtën penale ndërkombëtare, “në qoftë se ka të njëjtën peshë si krimet e tjera kundër njerëzimit të cilësuar në Nenin 5 të Statutit”.²⁶⁷⁵ Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se dhuna seksuale përkufizohet si cenim i paprekshmërisë fizike dhe morale të një personi.²⁶⁷⁶ Për më tepër, Dhoma e Apelit kujton se dhuna seksuale në rastet konkrete u krye kundër vajzave të reja nga disa keqbërës dhe në një atmosferë frike, kërcënimesh dhe keqtrajtimesh.²⁶⁷⁷ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është

²⁶⁷⁰ Aktgjykimi, para. 1595-1600.

²⁶⁷¹ Shih Aktgjykimi, para. 1595-1601, 1649-1650, 1672-1673. Lidhur me Dëshmitaren K20, Gjorgjeviqi argumenton se dhuna seksuale kundër saj “nuk u miratua” prej forcave serbe, dhe se nuk u provua se keqbërësit “u orvatën të kryenin përndjekje si pjesë e një plani”, duke parashtruar se përkundrazi, “ata ishin kriminelë që vepronin në arenën e luftës nën mbulesën e errësirës” (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 27-30). Lidhur me K14-ën, Gjorgjeviqi parashtron se rrethanat e dhunës kundër saj “nuk zbulojnë synim përndjekës, porse me sa duket krimi është kryer nga kriminelë rastësorë” (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 25). Në mbështetje, të këtij parashtrimi, ai i referohet dëshmisë se autori i përdhunimit të saj e pagoi “romin” që e kishte ndihmuar atë për ta çuar Dëshmitaren K14 në hotelin Bozhur ku ajo u përdhunua, thekson se përshtkrimi i automjetit të keqbërësit nuk përputhet me automjetet e rregullta të forcave të MPB-së, dhe argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk analizoi hollësisht nëse personat, përfshirë personin që përdhunoi K14-ën dhe që shkoi në shtëpinë e K14-ës një ditë para përdhunimit të saj, faktikisht ishin forca serbe “legjitime”, duke mbajtur parasysh vështirësitë e K14-ës në identifikimin e uniformave (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 25). Gjorgjeviqi thjesht përsërit argumentet e ngritura dhe të hedhura poshtë gjatë procesit gjyqësor, pa ngritur ndonjë problem të ri apo pa identifikuar gabim (Shih Dosja Përmbyllëse e Gjorgjeviqit, para. 951-952, 957-974).

²⁶⁷² Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 177; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 199, 221.

²⁶⁷³ Aktgjykimi, para. 1791, 1793.

²⁶⁷⁴ Shih më lart, para. 859, 869.

²⁶⁷⁵ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012. Shih Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 296; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 177; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 574; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 102-103.

²⁶⁷⁶ Shih më lart, para. 850-852.

²⁶⁷⁷ Shih Aktgjykimi, para. 824, 832, 1145-1156, 1649-1650, 1673.

bindur se dhuna seksuale e lartpërmendur kishte të njëjtën peshë si krimet e tjera të përcaktuara në Nenin 5.

(c) Përfundim

901. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se krimi i përndjekjes si krim kundër njerëzimit është vërtetuar nëpërmjet dhunës seksuale kundër Dëshmitares K20, dy të rejave të tjera në Beleg, Dëshmitares K14, dhe vajzës shqiptare kosovare nga kolona.

D. Përgjegjësia e Gjorgjeviqit

1. Hyrje

902. Dhoma Gjyqësore konkludoi se në udhëheqjen politike, ushtarake dhe policore të RFJ-së dhe Serbisë ekzistonte një plan i përbashkët i cili synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës.²⁶⁷⁸ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët dhe kishte të njëjtin synim për realizimin e tij.²⁶⁷⁹ Dhoma e Apelit i konfirmoi këto përfundime të Dhomës Gjyqësore.²⁶⁸⁰ Më tej, Dhoma e Apelit shfuqizoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14 nuk përbënte përndjekje si krim kundër njerëzimit.²⁶⁸¹ Dhoma e Apelit gjithashtu konkludoi se dhuna seksuale kundër vajzës shqiptare kosovare nga kolona dhe dy të rejave të tjera në Beleg përbënte përndjekje si krim kundër njerëzimit.²⁶⁸²

903. Para se të analizojë argumentin e Prokurorisë se Gjorgjeviqi duhet të shpallet fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit, bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale,²⁶⁸³ paraprakisht Dhoma e Apelit do të shqyrtojë dy probleme ligjore të ngritura nga Gjorgjeviqi në përgjigjen e tij lidhur me kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

2. Probleme ligjore të ngritura nga Gjorgjeviqi

(a) Standardi i synimit kriminal në kuadrin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

a. Argumentet e palëve

²⁶⁷⁸ Aktgjykimi, para. 2007-2008, 2126-2130.

²⁶⁷⁹ Aktgjykimi, para. 2154-2158, 2193. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1981.

²⁶⁸⁰ Shih më lart, Kapitujt IV-VII, X-XI.

²⁶⁸¹ Shih më lart, para. 877, 901.

²⁶⁸² Shih më lart, para. 901.

²⁶⁸³ Shih më poshtë, Pjesa XIX.D.3.

904. Gjorgjeviqi parashtron se Prokuroria sugjeron një standard të gabuar të përgjegjësive penale sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁶⁸⁴ Sipas tij, Prokuroria zbaton një standard tejet të gjerë kur pretendon se ai ishte i vetëdijshëm për “mundësinë” e kryerjes së dhunës seksuale.²⁶⁸⁵ Gjorgjeviqi parashtron se synimi kriminal i nevojshëm për përgjegjësi penale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale kushtëzon që mundësia e kryerjes së një krimi të jetë “në atë masë që e bën të parashikueshme për të akuzuarin”.²⁶⁸⁶

905. Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi interpreton gabimisht standardin e parashikueshmërisë për përgjegjësi penale sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe orvatet që standardin e mundësisë ta ngrejë në mundësi thelbësore.²⁶⁸⁷

b. Analizë

906. Dhoma e Apelit kujton se një i akuzuar mund të ngarkohet me përgjegjësi penale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për një krim jashtë qëllimit të përbashkët, në qoftë se në rrethanat e çështjes: (i) ishte e parashikueshme se një krim i tillë mund të kryhej nga një apo më shumë persona të përdorur prej tij (ose ndonjë anëtar tjetër i ndërmarrjes së përbashkët kriminale) me qëllim kryerjen e veprimit të fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët; dhe (ii) i akuzuari mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë (domethënë, i akuzuari mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale i vetëdijshëm se një krim i tillë ishte pasojë e mundshme e saj).²⁶⁸⁸

907. Dhoma e Apelit kujton se standardi i synimit kriminal për përgjegjësi penale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk kushtëzon që i akuzuari të jetë i

²⁶⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 37, 39-40. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 49, 53.

²⁶⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 39-40, përmendet Dosja e Apelit e Prokurorisë, para. 42, Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 49. Gjorgjeviqi përsërit kundërshtimet e përgjithshme ndaj kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale si formë përgjegjësie penale e përdorur në Tribunal, duke argumentuar se nuk mbështetet nga e drejta zakonore ndërkombëtare (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 41; Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 68-71). Gjorgjeviqi gjithashtu përsërit kundërshtimin e tij lidhur me zbatimin e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në lidhje me krimet me synim konkret (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 38; Shih gjithashtu Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 155). Dhoma e Apelit I hodhi poshtë këto argumente në kuadër të pikës së dytë dhe pikës së tetë të apelit të tij, dhe rrjedhimisht nuk do t'i shqyrtojë këtu (Shih më lart, Pjesa III. C. III. E).

²⁶⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 39, përmendet Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18.

²⁶⁸⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 13-15. Sipas Prokurorisë, një standard i tillë i lartë është më afër standardit të “gjasës” apo të standardit të “gjasës së konsiderueshme se do të ndodhë” të cilët më pare nuk janë pranuar nga Dhoma e Apelit (Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 14, përmendet Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 15-18, Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33).

²⁶⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 411; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228.

vetëdijshëm për “gjasën” e kryerjes së krimit.²⁶⁸⁹ Faktikisht, një i akuzuar mund të ngarkohet me përgjegjësi penale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në qoftë se është i vetëdijshëm se kryerja e krimit është pasojë e *mundshme* e zbatimit të qëllimit të përbashkët.²⁶⁹⁰ Gjithsesi, Dhoma e Apelit kujton se “standardi i mundësisë”:

nuk plotësohet nga skenarë tejet të pamundshëm. I krahasuar me një spektër gjasash, standardi i synimit kriminal për NPK-në III nuk është i barabartë me *gjasën* e kryerjes së një krimi; gjithsesi kërkohet që mundësia e kryerjes së një krimi të jetë e konsiderueshme në atë masë sa të jetë e parashikueshme për të akuzuarin.²⁶⁹¹

908. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit do të zbatojë këtë standard për të gjykuar nëse Gjorgjeviqi është penalisht përgjegjës për krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

(b) Lidhja midis NPK-së dhe autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve të parashikueshme

a. Argumentet e palëve

909. Gjorgjeviqi parashtron se për tu shpallur penalisht përgjegjës për një krim bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duhet të vërtetohet se njëri nga anëtarët e NPK-së përdori autorët e drejtpërdrejtë për të kryer krime të parashikueshme me qëllim realizimin e planit të përbashkët.²⁶⁹²

910. Prokuroria parashtron se argumenti i Gjorgjeviqit se autorët fizikë nuk u përdorën *për të kryer dhunë seksuale* interpreton gabimisht apelin e Prokurorisë.²⁶⁹³ [Prokuroria] argumenton se Gjorgjeviqi gabimisht sugjeron se jurisprudenca e Tribunali ka përcaktuar se një anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale duhet të përdorë një keqbërës për të kryer një krim të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁶⁹⁴

b. Analizë

²⁶⁸⁹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 1061, 1272, 1525, 1557-1558; Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 411; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228.

²⁶⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 411; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228.

²⁶⁹¹ Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18 (theksi në origjinal). Shih Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 1081, 1538, 1575.

²⁶⁹² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 42-45, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 119-120, Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220.

²⁶⁹³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 20.

²⁶⁹⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 20-22.

911. Dhoma e Apelit kujton se sipas kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, një i akuzuar mund të shpallet penalisht përgjegjës për krime të kryera nga joanëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁶⁹⁵ Jurisprudenca ka përcaktuar se në rrethana të tilla:

i akuzuari mund të shpallet penalisht përgjegjës në qoftë se ai mori pjesë në qëllimin e përbashkët kriminal me synimin e duhur dhe, në rrethanat e çështjes, (i) ishte e parashikueshme mundësia e kryerjes së krimit nga një apo më shumë persona të përdorur nga i akuzuari (apo nga një anëtar tjetër i NPK-së) për të zbatuar veprimin e fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët; dhe (ii) i akuzuari e mori këtë rrezik me vullnet të lirë. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykoi se anëtarët e NPK-së mund të shpallen fajtorë për krime të kryera nga autorë të drejtpërdrejtë të cilët vetë nuk ishin anëtarë të NPK-së, në qoftë se vërtetohet se krimet mund t'i atribuohen të paktën një anëtari të NPK-së i cili kur përdori një autor të drejtpërdrejtë, veprroi në përputhje me planin e përbashkët.²⁶⁹⁶

912. Për këto arsye, Dhoma e Apelit hedh poshtë argumentin e Gjorgjeviqit se atij nuk mund t'i atribuohet dhuna seksuale si pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së meqenëse nuk u vërtetua se një nga anëtarët e NPK-së përdori autorët e drejtpërdrejtë për të kryer dhunë seksuale gjatë jetësimit të NPK-së.²⁶⁹⁷ Kur krimet janë kryer nga joanëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duhet të vërtetohet se një apo më shumë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (gjatë jetësimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale) përdorën joanëtarë për të kryer veprimin e fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët.²⁶⁹⁸ Në qoftë se joanëtarët e përdorur nga një apo më shumë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale kryejnë krime që janë jashtë qëllimit të përbashkët, edhe këto krime mund t'u atribuohen anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale kur janë pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁶⁹⁹ Në rrethana të tilla, lidhja e nevojshme është vërtetuar dhe anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale mund të mbajnë përgjegjësi penale për krimet që janë jashtë qëllimit të përbashkët bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁷⁰⁰

913. Në këtë çështje, Prokuroria i kërkon Dhomës së Apelit që të shpallë Gjorgjeviqin fajtor për krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁷⁰¹ [Prokuroria] nuk pretendon se dhuna seksuale ishte pjesë e planit të përbashkët. Për këtë arsye, Prokuroria nuk është e detyruar të provojë se një nga anëtarët e NPK-së përdori keqbërësit për të kryer përndjekje përmes dhunës seksuale. Faktikisht, duhet provuar se këto krime u kryen nga një person i cili u përdor nga një anëtar i NPK-së për të

²⁶⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 411, 431.

²⁶⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168 (pa citimet). Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 411, 413, 430.

²⁶⁹⁷ Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 42-45.

²⁶⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410, 413. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225.

²⁶⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 411.

²⁷⁰⁰ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 411.

²⁷⁰¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42-56. Dhoma e Apelit vëren se Aktakuza nuk përfshin përndjekjen përmes dhunës seksuale ndër krimet që ishin pjesë e NPK-së (Aktakuza, Pika 5, para. 21, 27, 72, 76-77).

kryer veprimin e fajshëm të krimeve të cilat *ishin* pjesë e qëllimit të përbashkët. Në vijim, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse është plotësuar ky kusht.²⁷⁰²

3. Pretendim për përgjegjësi penale të Gjorgjeviqit për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

(a) Argumentet e palëve

914. Prokuroria parashtron se Gjorgjeviqi duhet të shpallet fajtor për përndjekje përmes dhunës seksuale, meqenëse dhuna seksuale ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së, se ai e dinte këtë gjë dhe mori me vullnet të lirë këtë rrezik kur mori pjesë në NPK dhe veproi për realizimin e qëllimit të përbashkët.²⁷⁰³

915. Prokuroria parashtron se ishte e parashikueshme mundësia e kryerjes së krimeve që ishin jashtë qëllimit të përbashkët ndër të cilat dhuna seksuale, në kuadër të fushatës së terrorit dhe dhunës së skajshme të forcave serbe kundër popullatës shqiptare kosovare.²⁷⁰⁴ [Prokuroria] gjithashtu argumenton se nuk ka nevojë të vërtetohet se dhuna seksuale ishte e përhapur në mënyrë që të ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e qëllimit të përbashkët.²⁷⁰⁵ Prokuroria më tej parashtron se dihet përgjithësisht dhe është fakt nga historia se gjatë fushatave të tilla të dhunshme dhe përndjekëse, gratë pësojnë dhunë seksuale.²⁷⁰⁶

916. Përsa i përket parashikueshmërisë së dhunës seksuale për Gjorgjeviqin, Prokuroria parashtron se ai ishte anëtar i rëndësishëm i NPK-së.²⁷⁰⁷ Prokuroria gjithashtu argumenton se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të shpërnguljes në masë të civilëve, vrasjeve dhe krimeve të tjera të dhunshme kundër shqiptarëve kosovarë të kryera gjatë fushatës së forcave serbe, për shkak të pozitës së tij eprore, pranisë dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në operacionet në terren, dhe raporteve që merrte nga burime të ndryshme.²⁷⁰⁸ Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi ishte në dijeni të kryerjes së dhunës kundër shqiptarëve kosovarë që në vitin 1998 dhe vazhdoi të informohej lidhur me të edhe më 1999.²⁷⁰⁹ Prokuroria parashtron se në këto rrethana, Gjorgjeviqi ishte i vetëdijshëm për mundësinë se gjatë fushatës përndjekëse gratë shqiptare mund të pësonin

²⁷⁰² Shih më poshtë, para. 927.

²⁷⁰³ Shih Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42-55; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 178, 184-188, 201.

²⁷⁰⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42-43, 45-46; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 13-15; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 185, 187-188, 201-202. Prokuroria argumenton se jurisprudenca e Tribunalit ka konfirmuar rëndësinë e këtyre faktorëve në vlerësimin e parashikueshmërisë së krimeve (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 187, përmendet Aktgjykimin *Kërstiq*, para. 616, Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 149, Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 327, Aktgjykimi i Apelit *Staqiq*, para. 93, 95; Aktgjykimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*, vëll. 2, para. 525-526, 776). Prokuroria më tej parashtron se Dhoma Gjyqësore u mbështet në të njëjtët faktorë kur nxori përfundimin alternativ se vrasja ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 187-188, përmendet Aktgjykimi, para. 2139, 2141, 2145).

²⁷⁰⁵ Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 177.

²⁷⁰⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 44.

²⁷⁰⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 42.

²⁷⁰⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 44, 47-50, 53; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 185-186.

dhunë seksuale.²⁷¹⁰ Argumentohet se duke qenë i vetëdijshëm për këtë mundësi, Gjorgjeviqi e mori me vullnet të lirë këtë rrezik kur mori pjesë në NPK.²⁷¹¹

917. Gjorgjeviqi përgjigjet se dhuna seksuale nuk ishte e parashikueshme për të.²⁷¹² Sipas tij, dijenia për kryerjen e krimeve të përgjithshme më 1998 nuk vërteton se ai mund të parashikonte se dhuna seksuale në veçanti ishte “mundësi mjaftueshmërisht thelbësore”.²⁷¹³ Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se nuk ka prova që vërtetojnë se gjatë periudhës përkatëse ai u informua për urdhërimin apo kryerjen e dhunës seksuale, që do ta kishte bërë të vetëdijshëm për mundësinë e kryerjes së krimeve të tilla.²⁷¹⁴

918. Në kundërpërgjigjen ndaj argumentit të Gjorgjeviqit se dijenia për krimet e përgjithshme nuk ishte e mjaftueshme për ta bërë atë të vetëdijshëm për mundësinë e kryerjes së dhunës seksuale, Prokuroria parashtron se Dhoma e Apelit asnjëherë nuk ka gjykuar se krimet janë të parashikueshme për një të akuzuar vetëm në qoftë se ai ka dijeni për krime të ngjashme të kryera më parë.²⁷¹⁵ Prokuroria më tej shton se elementët e kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale janë vërtetuar, meqenëse dhuna seksuale u krye nga pjesëtarë të forcave serbe të cilët komandoheshin dhe përdoreshin nga anëtarët e NPK-së për zbatimin e planit të përbashkët.²⁷¹⁶

(b) Analizë

919. Dhoma e Apelit kujton se kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ka të bëjë me përgjegjësinë penale për krime të kryera jashtë qëllimit të përbashkët, por që janë

²⁷⁰⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 47-53; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 186.

²⁷¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 44, 46, 51; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 13-15; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 185-186. Prokuroria më tej parashtron se për të qenë dhuna seksuale e parashikueshme për Gjorgjeviqin, nuk është e domosdoshme që ai të ketë pasur paraprakisht dijeni për veprime të njëjta, të kryera më herët (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 202).

²⁷¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 7, 42, 46, 52, 55; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 188.

²⁷¹² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 36, 46-52, 54; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 196, 198. Ai argumenton se çështjet që citon Prokuroria në mbështetje të përfundimit për parashikueshmërinë, duhen dalluar nga çështja aktuale meqenëse ato kanë të bëjnë me kampe apo me rrethanat konkrete të Srebrenicës (Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 196-197).

²⁷¹³ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 46. Shih gjithashtu Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 47. Gjorgjeviqi më tej parashtron se “dijenia e përgjithshme për mundësinë e krimit në rrethana lufte është e pamjaftueshme për të plotësuar kushtet e synimit konkret të synimit për përndjekje” (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 46).

²⁷¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 50; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 198-199. Ai argumenton se “përdhunimi është i mundshëm në çdo luftë, dhe në të vërtetë edhe në kohë paqeje, dhe incidentet e izoluar të dhunës seksuale në vetvete nuk vërtetojnë se përsëritja e përdhunimeve është konsiderueshmërisht e mundshme” (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 50 (pa citimet); Shih gjithashtu Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 196). Gjorgjeviqi më tej parashtron se asnjë prej rasteve konkrete të dhunës seksuale nuk u “sanksionua, miratua, lejua, apo ishte në dijeni të eprorëve” por, përkundrazi “ndodhën në rrethana të fshehta ose krejtësisht të parregullta”, dhe për këtë arsye nuk ishin të parashikueshme (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 51).

²⁷¹⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 16; Seanca e Apelit, 13 maj 2013, AT. 185, përmendet Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 616-617, Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 149, Aktgjykimi *Kvoçka*, para. 327; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 86. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 17-18.

²⁷¹⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 21, 23.

pasoje e natyrshme dhe e parashikueshme e qëllimit të përbashkët.²⁷¹⁷ Dhoma e Apelit më tej kujton se kur krimi i parashikueshëm i pretenduar është krim me synim konkret, si për shembull përndjekja, duhet të vërtetohet se mundësia e kryerjes së krimit ishte e parashikueshme për të akuzuarin,²⁷¹⁸ edhe pse nuk është e nevojshme të vërtetohet se vetë i akuzuari kishte synimin konkret.²⁷¹⁹

920. Për të përcaktuar parashikueshmërinë e dhunës seksuale, Dhoma e Apelit së pari do të shqyrtojë kontekstin e përgjithshëm në të cilin u kryen veprime të tilla. Më pas, Dhoma e Apelit do të analizojë provat përkatëse për të gjykuar nëse ishte e parashikueshme, veçanërisht për Gjorgjeviqin, se dhuna seksuale ishte pasoje e mundshme e zbatimit të NPK-së.

921. Dhoma Gjyqësore konkludoi se ekzistonte një plan i përbashkët i udhëheqjes së RFJ-së dhe Serbisë që synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës.²⁷²⁰ Ajo gjithashtu gjykoi se “elementi thelbësor i planit të përbashkët ishte krijimi i atmosferës së dhunës dhe frikës ose terrorit ndërmjet shqiptarëve kosovarë në mënyrë që nga frika ata të largoheshin nga [...] dhe Kosova.”²⁷²¹ Zakonisht, forcat serbe granatonin zonën e një fshati dhe/ose shtinin me armë në drejtim të shtëpive, duke e detyruar popullatën të largohet, dhe më pas hynin në fshat në këmbë, u vinin zjarrin shtëpive, dëmtonin pronat, plaçkitnin, vrisnin banorët, i dëbonin njerëzit me dhunë nga shtëpitë e tyre, e kërcënonin dhe keqtrajtonin fizikisht popullatën.²⁷²² Në disa raste, përveç vrasjes së një numri të madh burrash dhe djemsh të rinj, ata sulmuan dhe vranë edhe gra me synimin e frikësimit të popullatës shqiptare kosovare dhe për ta detyruar atë popullatë të largohet.²⁷²³ Të dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe nga frika për jetën dhe mirëqenien personale, shqiptarët kosovarë të zhvendosur u larguan në kolona të shumta nga qytetet dhe fshatrat e tyre në drejtim të Shqipërisë dhe IRJM-së, shpesh nën drejtimin apo përcjelljen e forcave serbe, të cilat vijuan t’i frikësonin dhe keqtrajtonin.²⁷²⁴ Duke marrë parasysh këto rrethana, Dhoma e Apelit gjykon se shqiptarët kosovarë ishin krejtësisht të rrezikuar dhe të pambrojtur nga abuzimet dhe keqtrajtimet e efektivave të forcave serbe.

²⁷¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204.

²⁷¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 1456; Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18. Shih gjithashtu Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i datës 19 mars 2004, para. 5-6.

²⁷¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 1456; Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i datës 19 mars 2004, para. 5-6. Shih gjithashtu më lart, Pjesa III. E.

²⁷²⁰ Aktgjykimi, para. 2007, 2126-2130.

²⁷²¹ Aktgjykimi, para. 2143. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2007, 2035, 2152.

²⁷²² Shih Aktgjykimi, para. 1617-1624, 1626-1674, 1676-1679, 2027, 2029. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2133-2137.

²⁷²³ Shih Aktgjykimi, para. 1636, 1652, 2137, 2139-2140. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2143-2145.

²⁷²⁴ Aktgjykimi, para. 1626, 1633, 1646, 1649, 1652, 1656, 1657, 1659, 1668, 1677, 2030-2031.

922. Dhoma e Apelit thekson se burrat shqiptarë kosovarë shpesh ndaheshin nga gratë dhe fëmijët.²⁷²⁵ Në shumë raste, pasi ishin veçuar nga gratë dhe fëmijët, ata u vranë nga forcat serbe.²⁷²⁶ Ndonjëherë forcat serbe i mbanin gratë dhe fëmijët veç nga burrat, përpara se t'i detyronin të shpërnguleshin.²⁷²⁷ Dhoma e Apelit gjykon se kështu të ndara nga meshkujt e familjes, gratë shqiptare kosovare ishin veçanërisht të rrezikuara dhe të pambrojtura nga sulmet dhe dhuna e forcave serbe për shkak të përkatësisë së tyre etnike, ndër të tjera edhe nga dhuna seksuale si një prej formave më zhvlerësuese dhe poshtëruese të dhunës.²⁷²⁸ Civilët e pambrojtur shqiptarë kosovarë u përballën me forcat serbe që e dinin se mund të vepronin pothuajse pa kurrfarë frike nga ndëshkimi. Dhoma e Apelit nuk ka asnjë dyshim se në rrethana të tilla, dhuna seksuale ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme.

923. Për përgjegjësi penale për përndjekje përmes dhunës seksuale bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhuna seksuale duhet të ketë qenë e parashikueshme konkretisht për Gjorgjeviqin.²⁷²⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se si “një nga zyrtarët më të lartë të MPB-së, ai ishte i informuar në hollësi për ngjarjet në terren dhe luajti rol kyç në koordinimin e punës së forcave të MPB-së në Kosovë më 1998 dhe 1999”.²⁷³⁰ Dhoma Gjyqësore veçanërisht theksoi se Gjorgjeviqi: (i) ishte anëtar i Komandës së Përbashkët dhe i Kolegjiumit të MBP-së dhe mori pjesë rregullisht në mbledhjet e këtyre dy organeve si dhe në mbledhjet e Shtabit të MPB-së; (ii) kishte kontakte të drejtpërdrejta dhe të menjëhershme me shefin e Shtabit të MPB-së, Llukiqin, dhe me disa shefa të SPB-ve në Kosovë; (iii) mori pjesë në negociatat ndërkombëtare si anëtar i delegacionit të Serbisë, dhe (iv) ishte në terren në Kosovë më 1998 dhe 1999, ndër të tjera edhe gjatë operacioneve të UJ-së dhe MPB-së.²⁷³¹

924. Përmes rolit dhe pjesëmarrjes së tij në operacionet në Kosovë, Gjorgjeviqi ishte mjaft i informuar jo vetëm në lidhje me kryerjen e operacioneve dhe situatën e përgjithshme të

²⁷²⁵ Aktgjykimi, para. 1617, 1619, 1624, 1630, 1634, 1643, 1656, 1669, 1678-1679, 2028. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2136-2137.

²⁷²⁶ Aktgjykimi, para. 1617-1620, 1630, 1643, 1656, 1669, 2028. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2136-2137; *më lart*, para. 770, 772.

²⁷²⁷ Shih Aktgjykimi, para. 1149, 1153.

²⁷²⁸ Dhoma e Apelit gjithashtu citon dëshminë e Dëshmitares K20 se, kur u mor nga pjesëtarë të forcave serbe, ajo “e dinte se çfarë do të ndodhte...meqenëse kishte dëgjuar se serbët po i përdhunonin gratë dhe vajzat kosovare” (Prova Materiale P1279 (konfidenciale), f. 4-5; P1280, f. 4-5). Dhoma e Apelit më tej citon dëshminë e Dëshmitares K14 se burri me thikat dhe me pantallona kamuflimi i cili mori vajzën shqiptare kosovare “njihej për punë të tilla” (Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4); se ajo dëgjoi nga të tjerët se “ata morën më shumë gra” nga kolona (Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 4); dhe se, kur në natën e përdhunimit të saj K14-ta i tregoi një shoqeje se çfarë i kishte ndodhur, shoqja i tregoi në mirëbesim se “e njëjta gjë i kishte ndodhur edhe asaj. Atë e kishin përdhunuar katër burra dhe e kishin kthyer pas dy ditësh” (Prova Materiale P1325 (konfidenciale), f. 6-7).

²⁷²⁹ Shih Vendim mbi Apelin *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, 25 qershor 2009, para. 18; Vendimi i Apelit *Bërgjanin* i datës 19 mars 2004, para. 6. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 65; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 86.

²⁷³⁰ Aktgjykimi, para. 2154.

²⁷³¹ Aktgjykimi, para. 1897-1898, 1900-1903, 1916-1917, 1919, 1925, 1985-1998, 2154, 2158, 2162, 2178.

sigurisë në terren në Kosovë, por edhe lidhur me kryerjen e krimeve të rënda, si plaçkitjet, djegiet e shtëpive, përdorimin e forcës së tepruar, dhe vrasjet (ndër të tjera të grave dhe fëmijëve) nga ana e forcave serbe gjatë operacioneve më 1998 dhe 1999.²⁷³² Për më tepër, pavarësisht se dinte se disa njësi kishin kryer krime të dhunshme kundër civilëve shqiptarë kosovarë si më 1998, po ashtu edhe më 1999, dhe se krimet e tyre nuk u ndëshkuan, Gjorgjeviqi autorizoi ridërgimin në Kosovë të disa prej këtyre njësive më 1999 në rrethana shpërthyes.²⁷³³

925. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte synimin e NPK-së dhe qëllimin e përbashkët të ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës.²⁷³⁴ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se si anëtar i NPK-së, ai ishte plotësisht i vetëdijshëm se ky qëllimi i përbashkët do të realizohej përmes krijimit të një atmosfere terrori dhe frike që do t'i detyronte shqiptarët kosovarë të largoheshin, ndër të tjera përmes përndjekjes së tyre me anë të metodave të ndryshme.²⁷³⁵ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai ishte i vetëdijshëm për shpërnguljen në masë të civilëve shqiptarë kosovarë, duke qenë se pa mijëra personave të zhvendosur më 1998 dhe merrte raporte të rregullta të MPB-së gjatë gjithë periudhës mars-qershor 1999 ku raportojë për numrin gjithnjë e më të madh të shqiptarëve kosovarë që po kalonin kufirin e Kosovës për në Shqipëri dhe IRJM.²⁷³⁶ Ai gjithashtu u informua për rrethanat humanitare, si dhe për vrasjet dhe krimet të tjera të dhunshme kundër shqiptarëve kosovarë, nga burime të ndryshme, ndër të cilat mediat.²⁷³⁷

926. Në këto rrethana, Dhoma e Apelit konkludon se mundësia e kryerjes së krimeve të natyrës seksuale ishte e parashikueshme për Gjorgjeviqin. Dhoma e Apelit kujton se mijëra civilë shqiptarë kosovarë u shpërngulën me dhunë dhe u keqtrajtuan gjerësisht nga forcat serbe të cilat vepronin thujse pa frikë nga ndëshkimi, dhe se gratë shpesh ndaheshin nga burrat, që i bënte ato veçanërisht të pambrojtura. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se në rrethana të tilla, mundësia e kryerjes së dhunës seksuale ishte thelbësore në atë masë sa e bënte të parashikueshme për Gjorgjeviqin, i cili e mori këtë rrezik me vullnet të lirë kur mori pjesë në NPK. Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, gjithashtu bindet se duke marrë parasysh dijeninë e tij për natyrën përndjekëse të fushatës, mundësia e kryerjes së dhunës seksuale me synimin e nevojshëm diskriminues ishte e parashikueshme për Gjorgjeviqin.

²⁷³² Shih Aktgjykimi, para. 1900-1907, 1918, 1920-1924, 1957-1958, 1961, 1963, 1981, 1985-1995, 2154-2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2178-2184.

²⁷³³ Aktgjykimi, para. 1258, 2155, 2179-2180, 2185. Shih gjithashtu më lart, para. 355-357, 360-362.

²⁷³⁴ Shih Aktgjykimi, para. 2158. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1999, 2128, 2130, 2154-2157, 2193; më lart, Kapitulli XI.

²⁷³⁵ Aktgjykimi, para. 2127-2128, 2130, 2135-2137, 2143, 2151-2152, 2158.

²⁷³⁶ Aktgjykimi, para. 1903, 1990, 2178, 2182. Shih më lart, para. 247-252, 489-492.

²⁷³⁷ Aktgjykimi, para. 1996-1998, 2183. Shih më lart, para. 497-500.

927. Dhoma e Apelit gjykoi se Dhoma Gjyqësore nuk gabo i kur konkludoi se anëtarët e NPK-së përdorën forcat serbe për të zbatuar veprimin e fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët të NPK-së.²⁷³⁸ Të njëjtat forca serbe kryen dhunë seksuale kundër Dëshmitares K20, dy të rejave të tjera në Beleg, dhe Dëshmitares K14.²⁷³⁹ Lidhur me vajzën nga kolona, Dhoma e Apelit thekson se identiteti i njërit prej keqbërësve, gjegjësisht burrit që mbante thika dhe që kishte veshur pantallona kamuflimi, është i paqartë.²⁷⁴⁰ Gjithsesi, identiteti i tij nuk është aq me rëndësi meqenëse u konkludua se burri tjetër që kreu dhunë seksuale kundër saj ishte polic, pra pjesëtar i forcave serbe.²⁷⁴¹ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, bindet se është vërtetuar lidhja e nevojshme midis krimeve dhe Gjorgjeviqit si anëtar i NPK-së. Në këto rrethana, Dhoma e Apelit konkludon se këto krime mund t'i ngarkohen Gjorgjeviqit.

928. Së fundi, duke mbajtur parasysh përfundimin e mësipërm, Dhoma e Apelit kujton se, në kundërshtim me parashtrimin e Gjorgjeviqit,²⁷⁴² Dhoma e Apelit mund të shpall verdikte të reja fajësie në fazën e apelit. Në paragrafin 2 të Nenit 25 të Statutit thuhet se Dhoma e Apelit “mund të konfirmojë, shfuqizojë ose ndryshojë vendimet e Dhomës Gjyqësore”. Për më tepër, Dhoma e Apelit ka ushtruar disa herë të drejtën e saj të brendaqenësishme duke shpallur verdikte të reja fajësie në apel²⁷⁴³ dhe Gjorgjeviqi nuk paraqiti asnjë arsye bindëse që do të justifikonte devijim nga kjo praktikë.²⁷⁴⁴

E. Përfundim

929. Dhoma e Apelit ka arritur në konkluzionet vijuese: (i) Dhoma Gjyqësore gabo i kur konkludoi se nuk ishte vërtetuar dhunë seksuale kundër vajzës shqiptare kosovare nga kolona

²⁷³⁸ Shih më lart, para. 171.

²⁷³⁹ Shih më lart, para. 866-869; Aktgjykimi, para. 1150-1151, 1791, 1793.

²⁷⁴⁰ Sipas përshkrimit, ky njeri “mbante thika dhe [...] ishte me këmishë të zeze pa mëngë dhe pantallona kamuflimi të gjelbra. Kokën e kishte të rruar dhe të lidhur me shami dhe në njërin vesh kishte tre vathë.” (Aktgjykimi, para. 832). Gjetkë në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “kishte gjithashtu edhe burra të tjerë midis forcave serbe, [përgjatë rrugës për në Prishtinë nga kaloi kolona], të cilët ishin të veshur me pantallona të gjelbra, me shami në kokat e rruara dhe me thika. Provat e shqyrtuara në pjesë të tjera të këtij Aktgjykimi tregojnë se një veshje e tillë përkon me atë të disa njërive paraushtarake serbe, por nuk ka prova të mjaftueshme për nxjerrjen e një konkluzioni të saktë mbi identitetin e këtyre forcave” (Aktgjykimi, para. 824).

²⁷⁴¹ Shih më lart, para. 859. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 832, 1792.

²⁷⁴² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 4.

²⁷⁴³ Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 103, f. 169; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 172, 180, 188, 207, 247, f. 114; Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 262, 301; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, para. 124, 207.

²⁷⁴⁴ Gjorgjeviqi parashtron se e drejta e tij për apelimin e vendimit të fajësisë do të shkelej nëse Dhoma e Apelit do të nxirrte verdikte të reja fajësie kundër tij, dhe lidhur me këtë i referohet Mendimit Mospajtues të Gjykatësit Pocar bashkëngjitur Aktgjykimi i Rishikuar *Shlivançanin* (Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 4). Gjorgjeviqi nuk paraqet ndonjë argument të ri që nuk është shqyrtuar më parë (Shih p.sh. Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin* (krahaso mendimin e shumicës, para. 103, f. 169, me Mendimin Pjesërisht Mospajtues të Gjykatësit Pocar, para. 2); Aktgjykimi i Apelit *Setako* (krahaso mendimin e shumicës, para. 262, f. 85 me Mendimin Pjesërisht Mospajtues të Gjykatësit Pocar, para. 2). Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se mendimet mospajtuese nuk janë të detyrueshme për Dhomën e Apelit (Shih më lart, para. 841).

dhe dy të rejave shqiptare kosovare në Beleg;²⁷⁴⁵ (ii) Dhoma Gjyqësore gabo i kur konkludoi se dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20 dhe Dëshmitares K14 nuk u krye me synim diskriminues;²⁷⁴⁶ (iii) dhuna seksuale kundër Dëshmitares K20, dy grave të tjera në Beleg, Dëshmitares K14, dhe vajzës nga kolona faktikisht u krye me një synim të tillë dhe përbën përndjekje si krim kundër njerëzimit,²⁷⁴⁷ dhe (iv) këto veprime ishin të parashikueshme për Gjorgjeviqin, dhe ai e mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë kur mori pjesë në NPK.²⁷⁴⁸ Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov, konkludon se Gjorgjeviqi është penalisht përgjegjës për përndjekje përmes dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe e shpall atë fajtor. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton tërësisht pikën e parë të apelit të Prokurorisë. Ndikimi i këtij përfundimi, si dhe pjesa e mbetur e pikës së parë të apelit të Prokurorisë, do të shqyrtohen veçazi në kapitullin XX.²⁷⁴⁹

²⁷⁴⁵ Shih më lart, para. 859, 869.

²⁷⁴⁶ Shih më lart, para. 877-878, 892, 895.

²⁷⁴⁷ Shih më lart, para. 892-893, 895, 897, 901.

²⁷⁴⁸ Shih më lart, para. 926-927.

²⁷⁴⁹ Shih më poshtë, Kapitulli XX.

XX. DËNIMI

A. Hyrje

930. Dhoma Gjyqësore e dënoi Gjorgjeviqin me një dënim të vetëm me 27 vjet burgim për fajësinë e tij për dëbim (Pika 1), veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2), vrasje (Pika 3), dhe përndjekje (përmes dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjes, dhe shkatërrimit të objekteve me vlerë fetare dhe kulturore) mbi baza racore (Pika 5), si krime kundër njerëzimit; dhe vrasje (Pika 4), si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës.²⁷⁵⁰ Si Gjorgjeviqi, po ashtu edhe Prokuroria, e apeluan dënimin.²⁷⁵¹ Para se të analizojë pikat e apelit të Gjorgjeviqit dhe Prokurorisë, Dhoma e Apelit do të parashtrojë ligjin përkatës, Dhoma e Apelit kujton se ka përmbysur disa përfundime të Dhomës Gjyqësore dhe shpalli fajësi lidhur me krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale,²⁷⁵² dhe rrjedhimisht do të vlerësojë ndikimin e këtyre vendimeve mbi dënimin e Gjorgjeviqit.

B. Ligji përkatës dhe standardi i rishikimit

931. Në përputhje me Nenin 24 të Statutit dhe Rregullën 101 të Rregullores, gjatë përcaktimit të dënimit të duhur, dhoma gjyqësore duhet të marrë parasysh: peshën e shkeljes, rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor; praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë; rrethanat rënduese; dhe çfarëdo rrethane lehtësuese.²⁷⁵³ Për shkak të detyrimit që ka për individualizimin e dënimit në përputhje me rrethanat e të akuzuarit dhe peshën e krimit, Dhoma Gjyqësore gëzon kompetencë të gjerë në përcaktimin e dënimit të duhur.²⁷⁵⁴

932. Apelimet e dënimeve janë apelime *stricto sensu*; ata kanë një natyrë korrigjuese dhe nuk janë gjykime *de novo*.²⁷⁵⁵ Dhoma e Apelit ndryshon një dënim vetëm në rast se Dhoma Gjyqësore ka kryer një “gabim të dukshëm” në ushtrimin e kompetencës së saj gjyqësore, apo në rast se nuk i është përmbajtur ligjit përkatës.²⁷⁵⁶ Është detyrë e palës që apelon dënimin të

²⁷⁵⁰ Aktgjykimi, para. 2230-2231.

²⁷⁵¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-426; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 137-143; Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 57-96; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 25-33.

²⁷⁵² Shih më lart, para. 542, 695, 834, 877-878, 901.

²⁷⁵³ Neni 24 i Statutit; Rregulla 101(B) e Rregullores.

²⁷⁵⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 297; Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 224; Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 141; Aktgjykimi i Apelit *Nchamihigo*, para. 384; Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 352; Aktgjykimi i Apelit *Karera*, para. 385; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 336; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç dhe Kubura*, para. 302; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviç dhe Jokiç*, para. 137, 321; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 1037; Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 306; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*, para. 429; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 312; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiç*, para. 680. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 321, citon Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *M. Jokiç*, para. 8.

²⁷⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 321, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734.

²⁷⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 321, citon Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734.

provojë se Dhoma Gjyqësore ka bërë gabim të dukshëm.²⁷⁵⁷ Për të provuar se Dhoma Gjyqësore bëri një gabim të dukshëm në ushtrimin e kompetencës së saj gjyqësore, apeluesi duhet të provojë se dhoma gjyqësore: u kushtoi rëndësi faktorëve të jashtëm apo të parëndësishëm; nuk u kushtoi rëndësinë e mjaftueshme faktorëve të rëndësishëm; bëri një gabim të dukshëm në lidhje me faktet për të cilët ushtroi kompetencën gjyqësore; apo, mori një vendim kaq të paarsyeshëm apo krejtësisht të padrejtë saqë Dhoma e Apelit mund të deduktojë se Dhoma Gjyqësore nuk ushtroi në mënyrën e duhur kompetencën e saj gjyqësore.²⁷⁵⁸

C. Pika e nëntëmbëdhjetë e apelit të Gjorgjeviqit: pretendim për gabime lidhur me përcaktimin e dënimit

933. Gjorgjeviqi ka paraqitur katër argumente.²⁷⁵⁹ Ai parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur: (i) e konsideroi pozitën e tij eprore si faktor rëndues; (ii) shpërfilli disa rrethana lehtësuese; (iii) vlerësoi rolin e tij në krahasim me të akuzuarit në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*; dhe (iv) nuk mori parasysh praktikën e dënimeve me burgim në RFJ.²⁷⁶⁰ Dhoma e Apelit do t'i shqyrtojë këto argumente një nga një.

1. Pretendim për gabime në konsiderimin e pozitës eprore të Gjorgjeviqit si faktor rëndues

(a) Argumentet e palëve

934. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësori bëri gabim ligjor kur “llogariti dyfish” rolin dhe pozitën e tij si shef i RJB-së.²⁷⁶¹ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e vlerësoi rolin dhe pozitën e tij si faktor rëndues, duke përdorur të njëjtat përfundime: (i) si bazë për fajësinë e tij; dhe (ii) gjatë vlerësimit të peshës së krimeve.²⁷⁶² Ai parashtron se një rrethanë që konsiderohet element i një shkeljeje, apo që merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së krimeve, nuk mund të konsiderohet edhe faktor rëndues.²⁷⁶³ Ai gjithashtu parashtron se grada apo pozita e tij e lartë në vetvete nuk përlligj dhënien e një dënimi më të rëndë, dhe argumenton se vetëm në rastet kur provohet shpërdorimi i pozitës, mund të bëhet fjalë “për rrethana rënduese sipas Nenit 7(3), në bazë të pozitës ose rolit në formën e përgjegjësisë penale sipas

²⁷⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 321, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 734.

²⁷⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 321-322; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 297.

²⁷⁵⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-426.

²⁷⁶⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-426.

²⁷⁶¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-408; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 139. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 409-411.

²⁷⁶² Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-411. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 137-139.

²⁷⁶³ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 408, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 408, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1089, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*, para. 206, Aktgjykimi *Llukiq dhe Llukiq*, para. 1050, Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 1149. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 139, përmendet Aktgjykimin, para. 2210.

Nenit 7(1)”²⁷⁶⁴ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi nëse ai shpërdori pozitën e tij.²⁷⁶⁵

935. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore mori parasysh pozitën eprore të Gjorgjeviqit *vetëm* si faktor rëndues dhe nuk e ‘llogariti dyfish’ këtë faktor, si bazë për fajësinë e tij dhe si faktor gjatë vlerësimit të peshës së krimeve”.²⁷⁶⁶ Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore shpalli fajësi *vetëm* bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit dhe rrjedhimisht nuk “llogariti dyfish” rolin e tij si bazë për fajësinë e tij.²⁷⁶⁷ Prokuroria më tej shton se gjatë përcaktimit të peshës së krimeve, Dhoma Gjyqësore iu referua “rolit udhëheqës dhe të rëndësishëm” të Gjorgjeviqit lidhur me “veprimet dhe kontributin e tij në NPK, dhe jo lidhur me pozitën e tij eprore”.²⁷⁶⁸ Prokuroria gjithashtu parashtron se Gjorgjeviqi shtrembëron jurisprudencën e Tribunalit në lidhje me shpërdorimin e pozitës eprore.²⁷⁶⁹

(b) Analizë

936. Fillimisht, Dhoma e Apelit kujton se në kontekstin e përcaktimit të dënimit, llogaritja e dyfishtë e një faktori është e palejueshme.²⁷⁷⁰ Rrjedhimisht, një faktor që dhoma gjyqësore e konsideron element krimi nuk mund të merret parasysh edhe si rrethanë rënduese.²⁷⁷¹ Ngjashmërisht, faktori që dhoma gjyqësore merr parasysh për të përcaktuar “peshën e krimit nuk mund të konsiderohet njëkohësisht rrethanë e veçantë rënduese, dhe anasjelltas”.²⁷⁷²

937. Dhoma e Apelit fillimisht thekson se Gjorgjeviqi u shpall fajtor për pjesëmarrje në NPK, bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit.²⁷⁷³ Megjithëse Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi rolit dhe pozitës së Gjorgjeviqit gjatë analizimit të sjelljes së tij dhe për nxjerrjen e

²⁷⁶⁴ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 408, 410, 411. Gjorgjeviqi argumenton se “përkundrazi, thjesht dhe *vetëm* në bazë të pozitës së tij u konkludua se ai kishte kryer veprimin e fajshëm të pjesëmarrjes në NPK.” (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 410). Dhoma e Apelit e shqyrtoi këtë argument në kuadër të pikës së nëntë të apelit të Gjorgjeviqit (Shih më lart, para. 225-230, 235-239, 242-243, 257-265, 275-277, 315-324, 355-362, 366-370, 372-431, 454-456). Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 137-138.

²⁷⁶⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 411.

²⁷⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 391-393, 397.

²⁷⁶⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 391-392.

²⁷⁶⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 396, përmendet Aktgjykimi, para. 2195, 2220, 2214 (pa citimet).

²⁷⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 395. Parashtrohet se një dhomë gjyqësore mund ta konsiderojë pozitën eprore të të akuzuarit si faktor rëndues “atëherë kur akuzat për përgjegjësi penale si në bazë të paragrafit 1, po ashtu edhe në bazë të paragrafit 3 të nenit 7, janë brenda të njëjtës pikë, dhe përmbushen kushtet ligjore të të dy formave të përgjegjësisë”, mirëpo dhoma shpall fajësi *vetëm* në bazë të paragrafit 1 të nenit 7 (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 395, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 91, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 34, Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 302, sh. 873).

²⁷⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 143; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*, para. 107; Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 306, 309.

²⁷⁷¹ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 408; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 1089; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 693.

²⁷⁷² Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 306, 309, citon Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *M. Nikoliq*, para. 58; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*, para. 107; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 143.

²⁷⁷³ Aktgjykimi, para. 2164, 2193-2194. Megjithëse e shpalli Gjorgjeviqin penalisht përgjegjës në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit, Dhoma Gjyqësore me të drejtë shpalli verdikt fajësie në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 (Aktgjykimi, para. 2195).

konkluzionit se ai dha kontribut të konsiderueshëm në NPK,²⁷⁷⁴ Dhoma e Apelit kujton se roli dhe pozita e një të akuzuari nuk është element i domosdoshëm për vërtetimin e përgjegjësisë penale për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.²⁷⁷⁵ Për këtë arsye, ishte brenda kompetencave të brendaqenësishme të Dhomës Gjyqësore që të konsideronte rolin dhe pozitën e tij si rrethanë rënduese.

938. Në përcaktimin e peshës së veprave penale, Dhoma Gjyqësore mori parasysh “veprimet dhe sjelljen” e Gjorgjeviqit si anëtar i NPK-së.²⁷⁷⁶ Gjatë përcaktimit të peshës së veprave penale, Dhoma Gjyqësore theksoi se veprimet e Gjorgjeviqit “mbështetën dhe ishin jetike për ndërmarrjen e përbashkët”.²⁷⁷⁷ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte pikërisht “roli udhëheqës dhe i rëndësishëm i tij në NPK” që “meriton[te] ndëshkim”.²⁷⁷⁸ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore e konsideroi rolin udhëheqës dhe kontributin e Gjorgjeviqit në NPK faktor të rëndësishëm në përcaktimin e peshës së veprave penale.²⁷⁷⁹

939. Në vijim, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentin e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet në pozitën e tij eprore, pa analizuar nëse ai e shpërdori atë.²⁷⁸⁰ Kur e shpalli fajtor për pjesëmarrje në NPK, Dhoma Gjyqësore shpjegoi saktë se “kur përgjegjësitë sipas paragrafit 1 dhe paragrafit 3 të Nenit 7 figurojnë brenda së njëjtës pikë të akuzës, dhe kur përmbushen kriteret ligjore në lidhje me këto dy përgjegjësi, Dhoma Gjyqësore duhet të shpallë fajësinë vetëm në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 dhe ta konsiderojë pozitën eprore të të akuzuarit si faktor rëndues në përcaktimin e dënimit.”²⁷⁸¹ Dhoma Gjyqësore konsideroi faktor rëndues, ndër të tjera, “rolin e Gjorgjeviqit, i cili si shef i RJB-së kishte pozitë komanduese dhe kontroll efektiv mbi forcat e MPB-së, me përjashtim të RDB-së, të cilat ishin ndër autorët e krimeve”.²⁷⁸² Megjithatë, në pjesën e Aktgjykimit lidhur me dënimin,

²⁷⁷⁴ Aktgjykimi, para. 2158. Shih Aktgjykimi, para. 2154-2157. Shih gjithashtu më lart, para. 209-461.

²⁷⁷⁵ Dhoma e Apelit kujton përfundimin e mëhershëm të saj se Dhoma Gjyqësore përcaktoi drejtë elementët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (më lart, para. 468. përmendet Aktgjykimi, para. 1864-1865, citon Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 202-204, 220, 227-228). Shih Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 408.

²⁷⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2210. Dhoma Gjyqësore gjykoj se Gjorgjeviqi “luajti rol të drejtpërdrejtë dhe udhëheqës në përpjekjet për fshehjen e krimeve për të cilat ishte përgjegjëse ndërmarrja e përbashkët kriminale, dhe ai nuk zbatoi detyrimin e tij për të mundësuar raportimin dhe hetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së për realizimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale” (Aktgjykimi, para. 2211).

²⁷⁷⁷ Aktgjykimi, para. 2210.

²⁷⁷⁸ Aktgjykimi, para. 2214. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para., 2211, 2213.

²⁷⁷⁹ Aktgjykimi, para. 2210. Dhoma Gjyqësore gjykoj se Gjorgjeviqi “luajti rol të drejtpërdrejtë dhe udhëheqës në përpjekjet për fshehjen e krimeve për të cilat ishte përgjegjëse ndërmarrja e përbashkët kriminale, dhe ai nuk zbatoi detyrimin e tij për të mundësuar raportimin dhe hetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së për realizimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale” (Aktgjykimi, para. 2211).

²⁷⁸⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 410; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 138.

²⁷⁸¹ Aktgjykimi, para. 1891, citon Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 91, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 34. Shih Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 183; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 745. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2192, 2195.

²⁷⁸² Aktgjykimi, para. 2220.

Dhoma Gjyqësore nuk qartësoi se në bazë të jurisprudencës, pozita eprore në vetvete nuk përbën rrethanë rënduese, porse shpërdorimi i saj mund të konsiderohet rrethanë rënduese.²⁷⁸³

940. Duke mos përcaktuar nëse Gjorgjeviqi shpërdori pozitën e tij eprore, Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm.²⁷⁸⁴ Për pasojë, gjatë shqyrtimit të rrethanave rënduese lidhur me këtë çështje, Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi aspekteve të jashtme. Dhoma e Apelit do të marrë parasysh këtë gabim kur të përcaktojë përfundimisht dënimin e Gjorgjeviqit.

2. Pretendim për mosmarrje parasysh të rrethanave lehtësuese

(a) Argumentet e palëve

941. Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh si faktorë lehtësues: (i) sjelljen e tij gjatë procesit gjyqësor dhe paraburgimit; (ii) bashkëpunimin me Prokurorinë, punën e bërë në vërtetimin e fakteve të pranuar nga palët, dhe ndihmën e tij përmes dhënies së dëshmisë para gjykatave serbe; (iii) pendimin dhe keqardhjen e tij për viktimat; (iv) ndikimin e urdhrave të eprorëve në rrethana shtrënguese; dhe (v) “atmosferën e ashpër” të konfliktit të armatosur.²⁷⁸⁵

942. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore mori parasysh rrethanat lehtësuese përkatëse, dhe se Gjorgjeviqi nuk ka identifikuar asnjë gabim në vlerësimin e Dhomës Gjyqësore.²⁷⁸⁶ [Prokuroria] argumenton se gjatë procesit gjyqësor Gjorgjeviqi nuk paraqiti asnjë rrethanë konkrete lehtësuese dhe e ngre këtë problem për të parën herë në apel, që nuk është instanca e duhur.²⁷⁸⁷ Prokuroria më tej shton se Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë se marrja parasysh e rrethanave lehtësuese që ai pretendon do të kishte çuar në ulje të dënimit të tij.²⁷⁸⁸

943. Gjorgjeviqi kundërpërgjigjet se një dhomë gjyqësore ka për detyrë të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe se “jurisprudenca ka dëshmuar se kështu është vepruar rregullisht, edhe kur palët nuk kanë paraqitur ndonjë apo asnjë” prej tyre.²⁷⁸⁹

²⁷⁸³ Aktgjykimi, para. 2217-2224; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, para. 320; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 411; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Babiq*, para. 80; Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, para. 347; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 183; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana dhe Ntakirutimana*, para. 563; Aktgjykimi i Apelit *Simba*, para. 285; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 358–359.

²⁷⁸⁴ Shih më lart, para. 931-932.

²⁷⁸⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 414.

²⁷⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 398.

²⁷⁸⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 399.

²⁷⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 400.

²⁷⁸⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 140, përmendet Aktgjykimin *D. Millosheviq*, para. 1003; Aktgjykimi *Haradinaj dhe të tjerët*, para. 495; Aktgjykimi *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 601; Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 1178-1179.

(b) Analizë

944. Dhoma e Apelit kujton se “as Statuti, e as Rregullorja nuk përcaktojnë të gjithë faktorët” që mund të merren parasysh në zbutjen e dënimit²⁷⁹⁰ dhe se një dhomë gjyqësore gëzon kompetencë të konsiderueshme për të gjykuar se çfarë mund të përbëjë rrethanë lehtësuese dhe çfarë rëndësie mund t’i kushtohet një faktori të tillë.²⁷⁹¹ Dhoma Gjyqësore konkludoi:

në favor të të Akuzuarit se, duke u nisur nga pozita e tij në MPB, ai nuk është dënuar më parë për ndonjë shkelje të rëndë dhe se ka qenë me karakter të mirë para ngjarjeve që akuzohen në Aktakuzë. Nuk është paraqitur asnjë argument tjetër që do të justifikonte zbutje të dënimit.²⁷⁹²

945. Dhoma e Apelit më tej kujton se në përputhje me Rregullën 86(C) të Rregullores, gjatë argumenteve përmbyllëse trajtohen edhe parashtrime lidhur me dënimet.²⁷⁹³ Rregulla 85(A)(vi) e Rregullores parashtron se Dhoma Gjyqësore do të marrë parasysh çdo informacion përkatës që mund ta ndihmojë në përcaktimin e dënimit të duhur,²⁷⁹⁴ gjithsesi, jurisprudenca ka përcaktuar se një dhomë gjyqësore nuk është “e detyruar të kërkojë informacion që palët nuk ia kanë paraqitur në kohën e duhur”.²⁷⁹⁵ Për më tepër, faza e apelit nuk është instanca e duhur për të ngritur probleme të tilla për herë të parë.²⁷⁹⁶

946. Dhoma e Apelit gjykon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm kur nuk mori parasysh pesë rrethanat lehtësuese të cilat ai i paraqiti për herë të parë në apel.²⁷⁹⁷

3. Pretendim për gabim në vlerësimin e rolit të Gjorgjeviqit krahasuar me rolin e të dënuarve në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët*

(a) Argumentet e palëve

947. Gjorgjeviqi parashtron se dënimi i tij me 27 vjet burgim është “i pamenduar dhe i tepruar” në krahasim me ata që u dënuan me 22 vjet burgim në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerët* për pjesëmarrje në të njëjtën NPK.²⁷⁹⁸ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk arsyetoi

²⁷⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Babiq*, para. 43.

²⁷⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 647; Aktgjykimi i Apelit *Ntabakuze*, para. 264; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 715, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 780.

²⁷⁹² Aktgjykimi, para. 2224.

²⁷⁹³ Rregulla 86(C) e Rregullores.

²⁷⁹⁴ Rregulla 85(A)(vi) e Rregullores.

²⁷⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 414. Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 674.

²⁷⁹⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 414. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 674.

²⁷⁹⁷ Shih gjithashtu më lart, para. 941-943.

²⁷⁹⁸ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 416-418, përmendet Aktgjykimi, para. 2227; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 142.

se pse gjykoi se ai luajti rol më të rëndësishëm krahasuar me pjesëmarrësit e tjerë në të njëjtën NPK dhe rrjedhimisht meritonte një dënim më të rëndë.²⁷⁹⁹ Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk ofroi një mendim të arsyetuar se si arriti në përfundimin se ai luajti rol “më të rëndësishëm” se të akuzuarit në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, dhe argumenton se provat tregojnë se ai luajti një rol shumë më pak të rëndësishëm.²⁸⁰⁰

948. Në përgjigje Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhej dënimet e dhëna nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, dhe se Gjorgjeviqi nuk arrin të vërtetojë se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të paarsyeshme shqiptoi për të një dënim më të gjatë nga dënimet në atë çështje.²⁸⁰¹ Prokuroria parashtron se ngjashmëria e çështjeve gjyqësore nuk shërben si model ligjërishit i detyrueshëm dënimesh, por mund të ndihmojë në përcaktimin e dënimit në qoftë se bëhet fjalë për krime të njëjta të kryera në rrethana thelbësisht të ngjashme.²⁸⁰² Prokuroria argumenton se roli i Gjorgjeviqit nuk ishte dytësor krahasuar me rolin e të akuzuarve në *Millutinoviq dhe të tjerët*;²⁸⁰³ përkundrazi, kontributi i tij ishte vendimtar për realizimin e NPK-së.²⁸⁰⁴ Sipas Prokurorisë, Gjorgjeviqi nuk vërteton se si Dhoma Gjyqësore tejkaloi kompetencat e brendaqenësishme të saj kur e dënoi me 27 vjet burgim.²⁸⁰⁵

(b) Analizë

949. Fillimisht, Dhoma e Apelit kujton se dhomat gjyqësore mund të marrin parasysh dënimet e mëparshme të Tribunalit të shqiptuara në çështje të ngjashme.²⁸⁰⁶ Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore ishte brenda kompetencës së vet të brendaqenësishme kur mori parasysh dënimet e shqiptuara nga Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, duke u bazuar në faktin se kjo çështje ka të bëjë me krime të ngjashme të kryera në rrethana thelbësisht të ngjashme. Gjithsesi, dënimet e shqiptuara në çështje të mëparshme nuk janë detyruese për dhomat gjyqësore në çështje të mëpasshme, meqenëse çdo dënim duhet të

²⁷⁹⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 416, 420. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 141.

²⁸⁰⁰ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 419-420. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 141.

²⁸⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 402, 404.

²⁸⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 401, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 348, Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 330, Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 250.

²⁸⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 403.

²⁸⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 403. Prokuroria pretendon se Gjorgjeviqi: (i) ishte në terren në Kosovë më 1998 dhe 1999, dhe luajti rol të drejtpërdrejtë në operacionet e MPB-së; (ii) mori pjesë në planifikimin në nivelet më të larta të operacioneve të MPB-së; (iii) dislokoi PJP-në dhe SAJ-in në Kosovë; dhe (iv) orkestrroi fshehjen e krimeve të NPK-së duke i fshehur kufomat e civilëve shqiptarë kosovarë në Serbi (Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 403).

²⁸⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 405.

²⁸⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 376, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 348; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 19, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 681; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 250. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 721.

përcaktohet në përputhje me rrethanat individuale të çështjes në fjalë.²⁸⁰⁷ Për më tepër, ndryshimet midis dënimeve të shqiptuara në çështje të ngjashme mund të konsiderohen “të pamenduara apo të tepruara”, në atë masë sa do të përlligjinin ndërhyrjen e Dhomës së Apelit, vetëm “në qoftë se janë shpërpjesimisht të paarsyeshme krahasuar me dënimet e shqiptuara në rrethana të ngjashme lidhur me të njëjtat krime”.²⁸⁰⁸

950. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes dënimet e pesë të akuzuarve në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* dhe theksoi se ata u shpallën fajtorë për “rolet e tyre të ndryshme në kryerjen e veprave penale kryesisht të njëjta” si veprat penale për të cilat akuzohet Gjorgjeviqi.²⁸⁰⁹ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu gjykoi se asnjë anëtar tjetër i NPK-së, ndër të tjerë as individët e shpallur fajtorë në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, nuk dha kontribut më të rëndësishëm për realizimin e qëllimit të NPK-së se Gjorgjeviqi.²⁸¹⁰ Dhoma e Apelit më tej vëren se Dhoma Gjyqësore në çështjen aktuale e shpalli Gjorgjeviqin fajtor edhe për vrasjen e 14 grave dhe fëmijëve shqiptarë kosovarë në Podujevë.²⁸¹¹ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se, ndër të tjera, Gjorgjeviqi kishte kontroll efektiv mbi forcat që kryen krimet.²⁸¹² Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se roli i Gjorgjeviqit ishte më i rëndësishëm dhe se për rrjedhojë përlligjte një dënim më të rëndë.²⁸¹³ Dhoma e Apelit gjykon se krahasimi me çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* e ndihmoi Dhomën Gjyqësore që të dallonte rolin e Gjorgjeviqit. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit gjykon se ndryshimi midis dënimeve nuk është shpërpjesimisht i paarsyeshëm dhe se krahasimi me çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* e ndihmoi Dhomën Gjyqësore që të zbatonte një praktikë të njëtrajtshme dënimesh.

951. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm në ushtrimin e kompetencës së vet të brendaqenësishme.

²⁸⁰⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*, para. 376, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 348; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 135, Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Joki*, para. 333; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 19, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 681; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 250; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 719, 721. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Musema*, para. 387.

²⁸⁰⁸ Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 135 (theksi i shtuar); Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 19; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 681; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 96.

²⁸⁰⁹ Aktgjykimi, para. 2227.

²⁸¹⁰ Aktgjykimi, para. 2211. Shih Aktgjykimi, para. 2213.

²⁸¹¹ Aktgjykimi, para. 2188, 2227. Shih më lart, para. 351, 362, 371.

²⁸¹² Aktgjykimi, para. 2210-2211.

²⁸¹³ Aktgjykimi, para. 2227.

4. Pretendim për gabim lidhur me praktikën e dënimeve me burgim në RFJ

952. Në përcaktimin e dënimit të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në RFJ, veçanërisht faktin se dënimi me 20 vjet burgim konsiderohej si dënimi maksimal në lidhje me krime të kryera para vitit 2002.²⁸¹⁴

(a) Argumentet e palëve

953. Gjorgjeviqi parashtron se duke dhënë një dënim më të rëndë se dënimi maksimal me 20 vjet burgim, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh si duhej praktikën e dënimeve me burgim në RFJ.²⁸¹⁵ Ai më tej argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk shpjegoi se pse devijoi nga praktika e dënimeve me burgim e RFJ-së.²⁸¹⁶ Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se Dhoma Gjyqësore iu referua dispozitave të gabuara statutore në lidhje me praktikën e dënimeve me burgim në RFJ.²⁸¹⁷

954. Në përgjigjen e vet, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhej praktikën e dënimeve me burgim në RFJ.²⁸¹⁸ [Prokuroria] më tej shton se ligji lidhur me praktikën e dënimeve me burgim në RFJ nuk ishte detyrues për Dhomën Gjyqësore,²⁸¹⁹ dhe se dhomat gjyqësore kanë të drejtë të shqiptojnë dënime më të rënda nga dënimet e parashikuara prej ligjit të lartpërmendur.²⁸²⁰

(b) Analizë

955. Në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 24 të Statutit dhe Rregullën 101(B)(iii) të Rregullores, në përcaktimin e dënimit, një dhomë gjyqësore duhet të marrë parasysh praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e RFJ-së. Gjithsesi, një dhomë gjyqësore nuk është e detyruar të ndjekë praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e RFJ-së.²⁸²¹ Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore mori parasysh shprehimisht praktikën e dënimeve me burgim të RFJ-së, duke shqyrtuar si dispozitat statutore, po ashtu edhe jurisprudencën përkatëse.²⁸²²

²⁸¹⁴ Aktgjykimi, para. 2225-2226, përmendet Kodi Penal i RSFJ-së, Neni 38.

²⁸¹⁵ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 422.

²⁸¹⁶ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 423-424.

²⁸¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 425.

²⁸¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 406.

²⁸¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 407.

²⁸²⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para. 407.

²⁸²¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 212; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 681; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 811; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *M. Jokiq*, para. 38; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 398; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 69; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 813 Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Bikindi*, para. 154; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 1063.

²⁸²² Shih Aktgjykimi, para. 2226, sh. 7433-7434. Meqenëse, sikurse sugjeron edhe vetë Gjorgjeviqi, Dhoma Gjyqësore mori parasysh të njëjtin dënim maksimal me 20 vjet burgim, Dhoma e Apelit e gjykon të

956. Gjatë shqyrtimit të praktikave të përgjithshme të dënimeve me burgim në ish-Jugosllavi, Dhoma Gjyqësore iu referua dënimeve të përcaktuara në nenet përkatëse të Kodit Penal të RSFJ-së dhe konstatoi se atje parashikoheshin dënime me jo më shumë se 15 vjet burgim, me përjashtim të krimeve të ndëshkueshme me dënim me vdekje për të cilat parashikohej dënim me jo më shumë se 20 vjet burgim.²⁸²³ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore u shpreh qartësisht se nuk kishte “ekuivalentë të saktë për shkeljet” për të cilat do të dënohej Gjorgjeviqi dhe mori parasysh “disa shkelje të ngjashme”.²⁸²⁴ Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhej praktikat e përgjithshme të dënimeve me burgim në ish-Jugosllavi dhe kishte kompetencë për të shqiptuar një dënim më të rëndë se dënimi maksimal me 20 vjet burgim që parashikonte Kodi Penal i RSFJ-së.²⁸²⁵

957. Gjorgjeviqi nuk identifikoi asnjë gabim të dukshëm në shqyrtimin prej Dhomës Gjyqësore të praktikës së përgjithshme të dënimeve me burgim në ish-Jugosllavi. Argumentet e Gjorgjeviqit lidhur me këtë pikë hidhen poshtë.

5. Përfundim

958. Dhoma e Apelit konkludoi se Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm kur e konsideroi pozitën eprore të Gjorgjeviqit si rrethanë rënduese dhe jo si shpërdorim të pozitës.²⁸²⁶ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit miraton pjesërisht pikën e nëntëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit. Ndikimi i mundshëm i këtij përfundimi do të shqyrtohet më poshtë në këtë Aktgjykim.²⁸²⁷ Dhoma e Apelit hedh poshtë pjesën tjetër të pikës së nëntëmbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit.

D. Pika e dytë e apelit të Prokurorisë: Dënimi i Gjorgjeviqit me 27 vjet burgim është qartazi i pamjaftueshëm

1. Argumentet e palëve

959. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore ushtroi gabimisht kompetencën e vet me dhënien e një dënimi që nuk pasqyronte peshën e krimeve dhe rolin e shkallën e pjesëmarrjes

parëndësishëm në aspektin juridik, nëse Dhoma Gjyqësore citoi gabimisht Kodin Penal të RSFJ-së në vend të Kodit Penal të RFJ-së (Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 425; Aktgjykimi, para. 2225-2226).

²⁸²³ Aktgjykimi, para. 2226.

²⁸²⁴ Aktgjykimi, para. 2226, përmendet Kodi Penal i RSFJ-së, Nenet 141-145, 151. Gjorgjeviqi pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përmendi “Kodi Penal i Republikës së Serbisë” që sipas tij nuk trajton llojet e krimeve të pretenduara në këtë çështje (Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 425).

²⁸²⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 816; Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 262; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 681; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 398; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 749-750.

²⁸²⁶ Shih më lart, para. 940

²⁸²⁷ Shih më poshtë, Pjesa XX.E.

së Gjorgjeviqit në kryerjen e tyre.²⁸²⁸ Argumentohet se dënimi është qartazi i pamjaftueshëm dhe kërkon që Dhoma e Apelit ta dënojë Gjorgjeviqin me burgim të përjetshëm.²⁸²⁹

960. Prokuroria parashtron se krimet e kryera në zbatim të NPK-së ishin të një natyre sistematike, u kryen në një shkallë masive, dhe patën një shtrirje të gjerë gjeografike dhe kohore.²⁸³⁰ Më tej argumentohet se krimet ishin veçanërisht të neveritshme meqenëse bazoheshin në fanatizëm etnik dhe, për më tepër, u kryen në një mënyrë “jashtëzakonisht mizore”.²⁸³¹ Përveç shpërnguljes me dhunë të qindra mijëra shqiptarëve kosovarë nga vatrat e tyre,²⁸³² Prokuroria vë në pah vrasjen e 724 burrave, grave dhe fëmijëve të paarmatosur.²⁸³³ Prokuroria argumenton se pasojat e këtyre krimeve janë të rënda, dhe se ata që i shpëtuan dhunës vuajnë pasoja fizike, psikike, shoqërore dhe ekonomike.²⁸³⁴

961. Prokuroria argumenton se postet e larta shtetërore të Gjorgjeviqit i mundësuan atij kompetenca *de jure* dhe *de facto* për bashkërendim të operacioneve të MPB-së në Kosovë dhe për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi autorët kryesorë të krimeve.²⁸³⁵ Për më tepër, Gjorgjeviqi kreu mospërbushje të qëllimshme të detyrimeve të tij kur organizoi zhvarrosjen, transportimin dhe rivarrosjen e fshehtë të shqiptarëve kosovarë në Serbi.²⁸³⁶

962. Prokuroria thekson se për përcaktimin e dënimit të Gjorgjeviqit, Dhoma Gjyqësore mori parasysh dënimet e shqiptuara në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*.²⁸³⁷ [Prokuroria] parashtron se në rast se Dhoma e Apelit do të jepte dënime më të rënda në atë çështje, atëherë do të duhet të japë dënim më të rëndë edhe për Gjorgjeviqin, për të “ruajtur përkimin me ato dënime”.²⁸³⁸

²⁸²⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 59, 96.

²⁸²⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 59, 75, 96-97.

²⁸³⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 57, 60, 62.

²⁸³¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 64-65. Prokuroria jep tre shembuj që ilustrojnë natyrën veçanërisht të neveritshme të krimeve (Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 68-74).

²⁸³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 58, 61.

²⁸³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 61, përmendet Aktgjykimi, para. 1715, 1717, 1728, 1731.

²⁸³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 75.

²⁸³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 83. Prokuroria citon shembuj sesi Gjorgjeviqi përdori postet e larta shtetërore si shef i RJB-së dhe ndihmësministër i Brendshëm për të realizuar NPK-në. Gjorgjeviqi inkuadroi në SAJ një grup famëkeq paraushtarak, Akrepat, dhe më pas i hoqi nga juridiksioni i tij pasi ata vranë 14 gra e fëmijë, e në këtë mënyrë e mbrojti këtë grup nga hetimet. Për më tepër, Gjorgjeviqi ishte anëtar i Kolegjiut të MPB-së dhe Komandës së Përbashkët, ku takohej rregullisht me anëtarë të tjerë për planifikimin e operacioneve të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë (Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 83-86).

²⁸³⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 87. Gjorgjeviqi luajti rol kyç në mundësimin e operacioneve të fshehta për transportimin e kufomave të shqiptarëve kosovarë për në varret e përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë dhe në Qendrën e PJP-së në Petrovo Selo (Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 89, 91).

²⁸³⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 94, përmendet Aktgjykimi, para. 2227 (ku theksohet se në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, pesë nga të akuzuarit u shpallën fajtorë për rolet e tyre të ndryshme në disa prej shkeljeve për të cilat akuzohej edhe Gjorgjeviqi. Dhoma Gjyqësore konkludoi se roli i Gjorgjeviqit ishte më i rëndësishëm se ai i të akuzuarve në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, dhe se për këtë arsye ai meritonte dënim më të rëndë se dënimet e shqiptuara në atë çështje).

²⁸³⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 94.

963. Gjorgjeviqi përgjigjet se kjo pikë e apelit të Prokurorisë duhet hedhur poshtë tërësisht.²⁸³⁹ Ai parashtron se vetë kërkesa nuk përputhet me parimet e të drejtës humanitare ndërkombëtare lidhur me dënimet²⁸⁴⁰ dhe se Dhoma e Apelit nuk ka kompetencë për të shqiptuar një dënim më të rëndë kur nuk ekziston e drejta e apelimit të mëtejshëm.²⁸⁴¹ Për më tepër, ai parashtron se Prokuroria nuk arriti të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore ushtroi gabimisht apo shpërdori kompetencën e saj.²⁸⁴² Sipas tij, Prokuroria thjesht u referohet përfundimeve faktike të cilat Dhoma Gjyqësore mori parasysh kur përcaktoi dënimin.²⁸⁴³

964. Gjorgjeviqi gjithashtu parashtron se argumenti i Prokurorisë për një dënim më të rëndë bazuar në peshën e krimeve nuk “merr parasysh” të gjithë faktorët që konsideroi Dhoma Gjyqësore në përcaktimin e dënimit të tij.²⁸⁴⁴ Ai më tej parashtron se duke kërkuar dënim me burgim të përjetshëm në apel, Prokuroria nuk merr parasysh detyrimin e Dhomës Gjyqësore për të shqiptuar një dënim në përputhje me rrethanat individuale të të akuzuarit.²⁸⁴⁵ Për më tepër, dënimi me 27 vjet burgim është “një dënim mjaft i rëndë”.²⁸⁴⁶

965. Në lidhje me pretendimin për rolin e tij në NPK, Gjorgjeviqi këmbëngul se Prokuroria bëri “pretendime të pasakta”, sidomos lidhur me: pushtetin e tij në RJB; dijeninë e tij për krimet e kryera nga MPB-ja; anëtarësinë e tij në Kolegjiumin e MPB-së dhe në Komandën e Përbashkët; faktet në lidhje me ngjarjet në Podujevë; dhe, faktet në lidhje me fshehjen e kufomave.²⁸⁴⁷ Gjorgjeviqi thekson se Dhoma Gjyqësore nuk arriti në përfundimin se ai planifikoi apo urdhëroi ndonjë nga krimet, apo se ishte autor i drejtpërdrejtë i tyre.²⁸⁴⁸ Gjithashtu, sipas tij Dhoma Gjyqësore konkludoi se përgjegjësia penale kryesore e tij qëndronte në pjesëmarrjen e tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me udhëheqës dhe zyrtarë të tjerë të lartë serbë, dhe se pozita e lartë në vetvete nuk kushtëzon një dënim më të rëndë.²⁸⁴⁹

966. Së fundi, Gjorgjeviqi kundërshton “kërkesën kategorike të Prokurorisë për një dënim më të rëndë në qoftë se do të jepeshin dënime më të rënda” në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*.²⁸⁵⁰ Ai parashtron se zgjatja e dënimit duhet të bëhet vetëm gjatë gjykimit, ku ekziston

²⁸³⁹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 81.

²⁸⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 76, 78.

²⁸⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 4.

²⁸⁴² Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 60.

²⁸⁴³ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 59, 63, citon Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 323.

²⁸⁴⁴ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 69.

²⁸⁴⁵ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 69, përmendet Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 327.

²⁸⁴⁶ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 68-69.

²⁸⁴⁷ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 72.

²⁸⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 74 (pa citimet), përmendet Aktgjykimi, para. 2167-2168, 2213.

²⁸⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 74. Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 407-411.

²⁸⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 80, përmendet Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 94.

mekanizmi i rishikimit dhe vetëm në bazë të fakteve të paraqitura para gjykuesit përkatës të fakteve.²⁸⁵¹

967. Prokuroria kundërpërgjigjet se Dhoma e Apelit ka kompetenca për të zgjatur dënime, edhe kur nuk ekziston mundësi për apelim të mëtejshëm.²⁸⁵² Prokuroria gjithashtu parashtron se ka të drejtë të bazohet në përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi peshën e krimeve dhe rolin e Gjorgjeviqit për të treguar pamjaftueshmërinë e qartë të dënimit aktual.²⁸⁵³ Së fundi, Prokuroria thekson se Gjorgjeviqi nuk arrin të hedhë poshtë me kundërprova argumentet e saj dhe nuk i pranon kundërshtimet e tij lidhur me pretendimet e saj të shtjelluara në Dosjen e Apelit.²⁸⁵⁴

2. Analizë

968. Së pari, Dhoma e Apelit kujton se edhe kur përfundimet faktike në një çështje mbeten të pandryshuara, është e mundur të konstatohet një gabim i dukshëm i dhomës gjyqësore në dhënien e dënimit.²⁸⁵⁵

969. Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se pesha e shkeljes është faktori më i rëndësishëm në përcaktimin e dënimit.²⁸⁵⁶ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu theksoi se gjatë vlerësimit të peshës së shkeljes, dhoma gjyqësore mund të marrë parasysh llojin e krimit, shtrirjen dhe mizorinë e krimit, rolin e të akuzuarit dhe pasojat e përgjithshme të krimit mbi viktimat dhe familjet e tyre.²⁸⁵⁷

970. Dhoma Gjyqësore gjykoi se plani i përbashkët i NPK-së, i cili synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës, u zbatua përmes një “fushate sistematike terrori dhe dhune” dhe konkludoi se krimet e kryera për realizimin e këtij plani ishin të rënda.²⁸⁵⁸ Për nxjerrjen e këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore mori parasysh mënyrën e dhunshme dhe pa kufizim që përdorën forcat serbe gjatë sulmeve kundër fshatrave shqiptare kosovare, vështirësitë, privimin dhe

²⁸⁵¹ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 80.

²⁸⁵² Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 1, përmendet Neni 25 i Statutit. Prokuroria gjithashtu jep shembuj të çështjeve ku Dhoma e Apelit shqiptoi dënime më të rënda: Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, f. 185 (Vendimi); Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 264; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 186, f. 80 (Vendimi) (Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 1).

²⁸⁵³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 26, përmendet Aktgjykimi i Apelit *D. Milloseviq*, para. 297, Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 455.

²⁸⁵⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 28-29. Shih gjithashtu Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 31-32.

²⁸⁵⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 455 (ku thuhet se “megjithëse nuk gaboi në përfundimet e veta faktike dhe mori parasysh si duhej parimet lidhur me dënimet, Dhoma Gjyqësore gaboi në përfundimin se dënimi i dhënë pasqyronte siç duhej peshën e krimeve të kryera nga Galiqi dhe shkallën e pjesëmarrjes së tij”).

²⁸⁵⁶ Aktgjykimi, para. 2207, përmendet Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *M. Nikoliq*, para. 11; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 182; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 731; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerët*, para. 442; Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683.

²⁸⁵⁷ Aktgjykimi, para. 2207, përmendet Aktgjykimi i Dënimit *Rajiq*, para. 83-95. Shih Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 182; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 683.

²⁸⁵⁸ Aktgjykimi, para. 2210, 2212.

keqtrajtimin e shqiptarëve kosovarë që u dëbuan nga shtëpitë e tyre, si dhe rrahjet, keqtrajtimet dhe vrasjet e burrave, grave dhe fëmijëve.²⁸⁵⁹

971. Dhoma Gjyqësore konkludoi se krimet kishin pasoja të konsiderueshme, dhe ndonjëherë të pariparueshme për viktimat.²⁸⁶⁰ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se për qindra viktima që vdiqën pasojat ishin “fatale”, kurse ata që mbetën gjallë u detyruan të përballeshin me vdekjen e të dashurve të tyre.²⁸⁶¹ [Dhoma Gjyqësore] i kushtoi rëndësi jo vetëm dhunës fizike që përjetuan shqiptarët kosovarë, por edhe vuajtjeve mendore dhe humbjeve financiare që pësuan.²⁸⁶² Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësinë e duhur peshës së krimeve të kryera dhe rrjedhimisht konkludon se Prokuroria nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore vlerësoi gabimisht peshën e krimeve në fjalë.

972. Në lidhje me rolin dhe pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në kryerjen e krimeve, Dhoma e Apelit kujton se gjatë vlerësimit të peshës së shkeljes, një dhomë gjyqësore mund të marrë parasysh pozitën eprore të një personi, dhe dënimi i dhënë duhet të pasqyrojë përgjegjësinë e keqbërësit për krimet e kryera.²⁸⁶³ Dhoma e Apelit thekson përfundimin e Dhomës Gjyqësore se përveç Millosheviqit dhe Stojilkoviqit, asnjë anëtar tjetër i NPK-së “nuk ka dhënë kontribut më të rëndësishëm për realizimin e qëllimit të saj” se Gjorgjeviqi.²⁸⁶⁴ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu mori parasysh faktin se Gjorgjeviqi komandonte forcat e MPB-së (të cilat ishin autorët kryesorë të krimeve), rolin e tij udhëheqës në përpjekjet për fshehjen e krimeve, dhe mosraportimin dhe moshetimin e krimeve të kryera nga forcat e MPB-së.²⁸⁶⁵ Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është bindur se Dhoma Gjyqësore mori parasysh mjaftueshmërisht rolin e

²⁸⁵⁹ Aktgjykimi, para. 2212. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe shpesh dëbuan shqiptarët kosovarë me dhunë. Shqiptarët kosovarë u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre nga frika për jetën. Për pasojë, shumë shqiptarë kosovarë u shpërngulën brenda Kosovës, ose u detyruan ta kalonin kufirin me Shqipërinë, IRJM-në apo Malin e Zi. Gjatë udhëtimeve të detyrueshme për në kufi, forcat serbe i keqtrajtuuan, rrahën dhe vranë shqiptarët kosovarë. Veprimet e tilla të forcave serbe u shkaktuan shqiptarëve kosovarë vuajtje dhe humbje të mëdha. Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh faktin se rreth 724 banorë shqiptarë kosovarë u vranë dhe se qindra mijëra të tjerë u shpërngulën brenda Kosovës apo përtej kufijve. Për realizimin e këtij qëllimi, forcat serbe zakonisht sulmonin me tanke dhe armë të rënda, lagje, fshatra ose qytete të banuara kryesisht me shqiptarë kosovarë. Pas granatimit të UJ-së, forcat e MPB-së hynin në fshat, qytet ose lagje, i dëbonin banorët nga shtëpitë e tyre dhe u vinin zjarrin shtëpive dhe ndërtesave të tjera. Në disa raste u shkatërruan apo dëmtuan xhami dhe objekte të tjera kulturore ose fetare të shqiptarëve kosovarë. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore gjykoi se në shumë raste, forcat serbe, e në veçanti PJP-ja dhe SAJ-i, ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët, i keqtrajtuuan dhe në fund i vranë. Në disa raste forcat serbe vranë edhe gra e fëmijë (Aktgjykimi para. 2212).

²⁸⁶⁰ Aktgjykimi, para. 2215. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2212.

²⁸⁶¹ Aktgjykimi, para. 2215.

²⁸⁶² Aktgjykimi, para. 2215.

²⁸⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 353; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, para. 609-613, 625-626; Aktgjykimi i Apelit *Musema*, para. 382-383; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 774; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, para. 1038; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerët*, para. 133; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 409; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 375, 380; Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Dragan Nikoliq*, para. 18; Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 185.

²⁸⁶⁴ Aktgjykimi, para. 2211. Dhoma Gjyqësore theksoi se Vllastimir Gjorgjeviqi nuk ishte autori fizik i krimeve; përgjegjësia penale e tij konkretizohet me pjesëmarrjen e tij në NPK që synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës (Aktgjykimi, para. 2213).

²⁸⁶⁵ Aktgjykimi, para. 2210, 2211, 2214.

Gjorgjeviqit dhe shkallën e pjesëmarrjes së tij në krimet, dhe konkludon se Prokuroria nuk vërtetoi se vlerësimi i Dhomës Gjyqësore ishte i gabuar.

973. Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dhoma Gjyqësore me të drejtë mori parasysh dënimet e dhëna në çështje të tjera të Tribunalit, duke përfshirë çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*.²⁸⁶⁶ Megjithatë, Dhoma e Apelit gjykon se ndryshimi i dënimeve në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët* nuk mund të vërtetohet se Dhoma Gjyqësore ushtroi gabimisht kompetencën gjykuese të saj, meqenëse çdo çështje duhet të analizohet në bazë të fakteve të çështjes.²⁸⁶⁷

974. Së fundi, Dhoma e Apelit thekson se dënimi me 27 vjet burgim është “një dënim mjaft i rëndë”, veçanërisht duke pasur parasysh moshën e Gjorgjeviqit,²⁸⁶⁸ dhe gjykon se ky dënim pasqyron peshën e krimeve për të cilat Gjorgjeviqi mban përgjegjësi. Për më tepër, në kundërshtim me parashtrimin e Prokurorisë,²⁸⁶⁹ Dhoma e Apelit është bindur se dënimi pasqyron indinjatën e bashkësisë ndërkombëtare dhe është i mjaftueshëm për të parandaluar kryerjen e krimeve të ngjashme në të ardhmen. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit gjykon se dënimi nuk është qartazi i pamjaftueshëm.

3. Përfundim

975. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore kreu gabim gjatë ushtrimit të kompetencës së vet të brendaqenësishme duke shqiptuar një dënim qartazi të pamjaftueshëm. Dhoma e Apelit hedh poshtë pikën e dytë të apelit të Prokurorisë.

E. Ndikimi i konkluzioneve të Dhomës së Apelit në dënimin e Gjorgjeviqit

976. Dhoma e Apelit kujton se miratoi pikën e parë të apelit të Prokurorisë dhe shpalli Gjorgjeviqin përgjegjës për përndjekje përmes dhunës seksuale të ushtruar kundër pesë femrave, si krim kundër njerëzimit (Pika 5) bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁸⁷⁰

977. Dhoma e Apelit gjithashtu kujton se i pranoi argumentet e Gjorgjeviqit të paraqitura në pikën trembëdhjetë dhe pikën gjashtëmbëdhjetë të apelit të tij, dhe rrjedhimisht përmbysi përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përgjegjësinë penale e Gjorgjeviqit për kryerjen

²⁸⁶⁶ Aktgjykimi, para. 2227.

²⁸⁶⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Munyakazi*, para. 186.

²⁸⁶⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 782. Dhoma e Apelit vëren se Gjorgjeviqi ishte 62 vjeç kur u dënua me 27 vjet burgim. Në qoftë se ai do të vuajë të gjithë dënimin, dhe duke marrë parasysh kohën që ka kaluar deri tani në paraburgim, ai do të jetë 85 vjeç kur të lirohet (Shih Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 68).

²⁸⁶⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, para. 31.

²⁸⁷⁰ Shih më lart, para. 929.

e krimeve të: (i) dëbimit si krim kundër njerëzimit (Pika 1) në Klladërnice, në komunën e Skënderajt midis 12 dhe 15 prillit 1999, në qytetin e Suharekës midis 7 dhe 21 majit 1999, në Pejë më 27 dhe 28 mars 1999, dhe në Mitrovicë më 4 prill 1999;²⁸⁷¹ (ii) veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krim kundër njerëzimit (Pika 2) në lidhje me fshatrat Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999, fshatin Qyshk, në komunën e Pejës, më 14 maj 1999;²⁸⁷² (iii) vrasjes, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit (Pikat 3 dhe 4), së dy burrave të moshuar shqiptarë kosovarë në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999, dhe të nëntë burrave në Krushë të Vogël më 25 mars 1999;²⁸⁷³ (iv) përndjekjes si krim kundër njerëzimit (Pika 5) nëpërmjet: (a) vrasjes, bazuar në vrasjen e dy burrave të moshuar në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999, dhe të nëntë burrave në Krushë të Vogël, në komunën e Rahovecit më 25 mars 1999;²⁸⁷⁴ (b) dëbimit nga Peja më 27 dhe 28 mars 1999, nga Mitrovica më 4 prill 1999, nga Klladërnica, komuna e Skënderajt, midis 12 dhe 15 prillit 1999, dhe nga qyteti i Suharekës midis 7 dhe 21 maj 1999;²⁸⁷⁵ dhe (c) veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) në Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, më 25-26 dhe 29 mars 1999, dhe në Qyshk, në komunën e Pejës më 14 maj 1999.²⁸⁷⁶

978. Dhoma e Apelit gjithashtu pranoi argumentet e Gjorgjeviqit të paraqitura në pikën e tetëmbëdhjetë të apelit dhe rrjedhimisht përmbysi të gjitha përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me përgjegjësinë penale e Gjorgjeviqit për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të dëbimit (Pika 1), veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2), vrasjes (Pika 3), dhe përndjekjes (përmes dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjes, dhe shkatërrimit objekteve me vlerë fetare dhe kulturore) (Pika 5), si krim kundër njerëzimit; dhe vrasjes (Pika 4), si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës.²⁸⁷⁷

979. Dhoma e Apelit më tej kujton përfundimin e vet se Dhoma Gjyqësore kreu gabim të dukshëm kur e vlerësoi pozitën eprore të Gjorgjeviqit si rrethanë rënduese, dhe jo si shpërdorim të pozitës zyrtare.²⁸⁷⁸

980. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit gjykon se dënimi i Gjorgjeviqit duhet të ulet. Konkretisht, Dhoma e Apelit gjykon se verdiktet e fajësisë që shpalli Dhoma Gjyqësore, të cilat tashmë janë përmbysur në apel, peshojnë më shumë se verdiktet e fajësisë që shpalli Dhoma e Apelit – jo vetëm për sa i përket numrit të viktimave, por edhe shkallës së

²⁸⁷¹ Shih më lart, para. 541-542, 695-696.

²⁸⁷² Shih më lart, para. 695-696.

²⁸⁷³ Shih më lart, para. 695-696.

²⁸⁷⁴ Shih më lart, para. 695-696.

²⁸⁷⁵ Shih më lart, para. 541-542, 695-696.

²⁸⁷⁶ Shih më lart, para. 695-696.

²⁸⁷⁷ Shih më lart, para. 834.

përgjegjesisë penale të Gjorgjeviqit.²⁸⁷⁹ Sidoqoftë, Dhoma e Apelit në asnjë mënyrë nuk nënkupton se krimet për të cilat Gjorgjeviqi u shpall fajtor në apel nuk janë të rënda. Për arsyet e lartpërmendura, dhe duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, ndër të tjera moshën e Gjorgjeviqit, Dhoma e Apelit ul dënimin e tij me 9 vjet dhe urdhëron një dënim me 18 vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimit kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores.

²⁸⁷⁸ Shih më lart, para. 940, 958.

²⁸⁷⁹ Lidhur me verdiktet e reja të fajësisë, Dhoma e Apelit thekson se Gjorgjeviqi u shpall penalisht përgjegjës në bazë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

XXI. VENDIM

981. Për arsyet e lartpërmendura, **DHOMA E APELIT**,

BAZUAR NË Nenin 25 të Statutit dhe Rregullën 117 dhe Rregullën 118 të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimet me shkrim të palëve dhe argumentet e tyre gojore të paraqitura në seancën e apelit më 13 maj 2013;

MBLEDHUR në seancë publike;

NË LIDHJE ME APELIN E GJORGJEVIQIT:

MIRATON pikën e trembëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit, dhe **SHFUQIZON** fajësinë e tij për dëbim (Pika 1) dhe përndjekje nëpërmjet dëbimit (Pika 5) në lidhje me shpërnguljen e njerëzve nga Peja për në Mal të Zi më 27 dhe 28 mars 1999, dhe nga Mitrovica më 4 prill 1999;

MIRATON pjesërisht, pikën e gjashtëmbëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit, **SHFUQIZON** fajësinë e tij, në lidhje me:

- Dëbim (Pika 1) në Klladërnice, në komunën e Skënderajt, midis 12 dhe 15 prillit 1999 dhe në qytetin e Suharekës, midis 7 dhe 21 majit 1999;
- Veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) (Pika 2) në Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999, dhe në Qyshk në komunën e Pejës më 14 maj 1999;
- Vrasje, si krim kundër njerëzimit dhe si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (Pika 3 dhe 4), të dy burrave të moshuar në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999, dhe të nëntë burrave në Krushë të Vogël në komunën e Rahovecit, më 25 mars 1999;
- Përndjekje (Pika 5) të kryer përmes:
 - dëbimit në Klladërnice, në komunën e Skënderajt, midis 12 dhe 15 prillit 1999 dhe në qytetin e Suharekës midis 7 dhe 21 maj 1999;
 - zhvendosjes së dhunshme në Burojë dhe Tushilë, në komunën e Skënderajt, midis 25 dhe 26 marsit dhe më 29 mars 1999, dhe në Qyshk në komunën e Pejës më 14 maj 1999; dhe

- vrasjes së dy burrave të moshuar në qytetin e Podujevës, në komunën e Podujevës, më 28 mars 1999, dhe të nëntë burrave në Krushë të Vogël, në komunën e Rahovecit, më 25 mars 1999; dhe

MIRATON pjesërisht, pikën e tetëmbëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit, **SHFUQIZON** fajësinë e tij për Pikat 1 - 5 në lidhje me ndihmë dhe inkurajim, dhe si rrjedhojë **SHPALL TË PANEVOJSHME** pikën e njëmbëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit;

MIRATON pjesërisht, pikën e nëntëmbëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit dhe konkludon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur cilësoi si faktor rëndues pozitiv të Gjorgjeviqit si epror;

RRËZON pjesën e mbetur të apelit të Gjorgjeviqit, me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatësit Güney në lidhje me pikën e shtatëmbëdhjetë të Apelit të Gjorgjeviqit, dhe të mendimit mospajtues të gjykatësit Tuzmukhamedov në lidhje me nënpikat 9(E), (F), dhe (G), dhe pjesërisht mospajtues në lidhje me pikën e dymbëdhjetë, të pesëmbëdhjetë dhe të shtatëmbëdhjetë të Apelit;

LË NË FUQI të gjitha verdiktet e tjera të fajësisë për Pikën 1- 5;

NË LIDHJE ME APELIN E PROKURORISË:

MIRATON, me përjashtim të mendimit pjesërisht mospajtues të gjykatësit Güney dhe gjykatësit Tuzmukhamedov pikën e parë të Apelit të Prokurorisë, dhe në bazë të Nenit 5 dhe Nenit 7 (1) të Statutit, **SHPALL** Gjorgjeviqin fajtor për krimin e përndjekjes nëpërmjet dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit (Pika 5), sipas kategorisë III të ndërmarrjes së përbashkët kriminale në lidhje me dhunën seksuale kundër dëshmitares K20 dhe dy të rejave të tjera në Beleg, dëshmitares K14 dhe vajzës shqiptare kosovare në një kolonë, dhe rrjedhimisht **NDRYSHON** verdiktin e fajësisë së Gjorgjeviqit në lidhje me Pikën 5;

RRËZON pikën e dytë të Apelit të Prokurorisë;

ANULON dënimin me 27 vjet burgim dhe **URDHËRON** një dënim me 18 vjet burgim, duke llogaritur brenda kohëzgjatjes së dënimit, kohën që ai ka qenë në paraburgim, në bazë të Rregullës 101(C) të Rregullores;;

Në përputhje me Rregullën 103(C) dhe Rregullën 107 të Rregullores **URDHËRON** që Gjorgjeviqi të mbahet në paraburgim prej Tribunalit deri në finalizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

Gjykatësi Güney bashkëngjit një Mendim Pjesërisht Mospajtues dhe të Veçantë.

Gjykatësi Tuzmukhamedov bashkëngjit Mendim Mospajtues.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

Gjykatësi Carmel Agius, Kryegjykatës

Gjykatësi Patrick Robinson

Gjykatësi Mehmet Güney

Gjykatësja Khalida Rachid Khan

Gjykatësi Bakhtiyar Tuzmukhamedov

Sot më 27 janar 2014,
Në Hagë,
Holandë

[Vula e Tribunalit]

XXII. MENDIM PJESËRISHT MOSPAJTUES DHE I VEÇANTË I GJYKATËSIT MEHMET GÜNEY

1. Me respekt shpreh mendimin tim mospajtuës me përfundimet vijuese nga Aktgjykimi i Apelit: (i) lënia në fuqi e përfundimit se vrasja e 281 shqiptarëve kosovarë gjatë operacionit Reka përbënte vrasje si krim kundër njerëzimit;¹ (ii) verdiktet e reja të fajësisë të shqiptuara në apel për krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale.² Paraqes gjithashtu mendimin tim të veçantë në lidhje me përfundimet vijuese të Dhomës së Apelit: (i) se Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar që të analizonte veprimet apo të shqyrtonte synimin e anëtarëve të tjerë të NPK-së;³ (ii) mospranimin e parashtrimeve të Gjorgjeviqit lidhur me fajësinë e shumëfishtë sipas Nenit 5 të Statutit.⁴

1. Vrasja e 281 shqiptarëve Kosovarë gjatë Operacionit Reka

2. Dhoma Gjyqësore konkludoi se forcat serbe qëlluan me armë dhe vranë 281 shqiptarë kosovarë në Mejë, në komunën e Gjakovës, në kuadër të një operacioni të përbashkët dhe të bashkërenduar të MPB-së dhe UJ-së të njohur me emrin “Operacioni Reka”, të kryer më 27-28 prill 1999.⁵ Përfundimet e veta, Dhoma Gjyqësore i mbështeti në provat në vijim: (i) se kufomat u varrosën në varre të përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë;⁶ (ii) se viktimat ishin me tesha civile në kohën e vdekjes së tyre;⁷ se ata kishin vdekur si rrjedhojë e plagëve të shkaktuara me armë zjarri.⁸ Shumica lë në fuqi këtë përfundim duke u bazuar në faktin se: (i) Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte të dhëna për luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së në atë zonë në kohën kur ndodhën ngjarjet në Mejë, “me përjashtim të shkëmbimit të paplanifikuar të shkurtër të zjarrit në fshatin Ramoc më 27 prill të vitit 1999 midis luftëtarëve të UÇK-së dhe anëtarëve të një njësie të UJ-së”;⁹ (ii) kishte prova se një numër i madh burrash në Mejë u detyruan t’i bashkoheshin një kolone, dhe shumë prej tyre më pas u vranë;¹⁰ (iii) duke u bazuar në provat mjekoligjore se viktimat e zhvarrosura ishin me tesha civile, Dhoma

¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 772.

² Aktgjykimi i Apelit, para. 981.

³ Aktgjykimi i Apelit, para. 138-144.

⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 843.

⁵ Aktgjykimi, para. 1738-1739.

⁶ Aktgjykimi, para. 991.

⁷ Aktgjykimi, para. 990.

⁸ Aktgjykimi, para. 991.

⁹ Aktgjykimi, para. 980, 1739. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi kundërshtimin e Gjorgjeviqit se aksionet e forcave serbe ishin kundër terroristëve shqiptarë kosovarë, por konkludoi se nuk kishte prova që sugjerorin se të vrarët kishin marrë pjesë apo po merrnin pjesë në veprimtari terroriste (Aktgjykimi, para. 1739).

¹⁰ Aktgjykimi, para. 958, 961, 967-979, 985-995, 1738.

Gjyqësore me arsye hodhi poshtë argumentet e Gjorgjeviqit se veprimet e forcave serbe ishin të drejtuara kundër veprimtarisë terroriste.¹¹

3. Me respekt unë shpreh mospajtimin tim me këtë përfundim. Siç theksoi Shumica, gjatë përcaktimit të përgjegjësisë penale, detyrimi i provës se viktimat ishin civilë ose jashtë luftimeve në kohën e vdekjes së tyre i takon Prokurorisë.¹² Për mendimin tim, rrethanat e vdekjes së këtyre individëve mbeten në fushën e spekulimit.¹³ Mendoj se provat rrethore që u morën parasysh në nxjerrjen e përfundimit se të 281 viktimat ishin civilë apo nuk merrnin pjesë në luftim mund të çojnë edhe në përfundime të tjera, dhe për këtë arsye, përfundimi i Dhomës Gjyqësore nuk ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.

4. Në fakt, sikurse argumenton bindshëm kolegu im, gjykatësi Tuzmukhamedov, në mendimin e tij mospajtues, duke marrë parasysh provat se (i) viktimat e zhvarrosura nga ai varr i përbashkët ishin meshkuj me prejardhje nga Gjakova;¹⁴ dhe (ii) u pranua se luftëtarët paraushtarakë shqiptarë futeshin në radhët e popullatës civile dhe vishnin tesha civile, si pjesë e taktikës që përdori UÇK-ja gjatë gjithë konfliktit,¹⁵ unë mendoj se gjatë zbatimit të standardit të duhur ligjor, Dhoma Gjyqësore e kishte logjikisht mundësinë që të konkludonte se në mungesë të provave të tjera lidhur me këtë çështje, 281 viktimat në fjalë varrosur në varrin e përbashkët në Batajnicë mund të kenë qenë edhe objektiva të ligjshme ushtarake në kohën e vdekjes së tyre. Rrjedhimisht, unë do ta shfuqizoja verdiktin e fajësisë së tij në lidhje me këto viktima.

2. Verdikte të reja fajësie në apel në lidhje me krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale

5. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin të pafajshëm në lidhje me krimin e përndjekjes përmes dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit të pretenduar në Aktakuzë, për shkak të mungesës së provave për synimin diskriminues të nevojshëm për përndjekje.¹⁶ Dhoma e Apelit, me shumicë, miraton pikën e apelit të Prokurorisë dhe shfuqizon verdiktet e

¹¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 771.

¹² Aktgjykimi i Apelit, para. 522, citon Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 60; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 48, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 111.

¹³ Përfundimin e saj, Dhoma Gjyqësore mbështetet në: (i) aktekspertizat mjekoligjore të 109 prej 281 viktimave të zhvarrosura, ku konkludohet se viktimat vdiqën prej lëndimeve të shkaktuara nga armë zjarri; (ii) faktin se 15 viktima të zhvarrosura nga varri i përbashkët në Batajnicë u vranë nga forcat serbe pasi që ishin marrë nga shtëpitë e tyre dhe qëlluar me armë. *Shih* Aktgjykimi, para. 955-962, 1735-1737.

¹⁴ Aktgjykimi, para. 990. Me përjashtim të dy viktimave që u identifikuan se ishin femra.

¹⁵ Aktgjykimi, para. 944. Theksoj veçanërisht provat se 200 luftëtarë të UÇK-së shtireshin se ishin persona të zhvendosur në fshatrat e kësaj zone.

¹⁶ Aktgjykimi, para. 1791-1797, 2230. Aktakuza, para. 77 (c).

pafajësisë.¹⁷ Theksoj se të njëjtin qëndrim mori edhe shumica në çështjen *Shainoviq dhe të tjerët*.¹⁸

6. Unë i qëndroj mendimit tim të shprehur në çështjen *Shainoviq dhe të tjerët* se duke marrë parasysh akuzat dhe rrethanat e kësaj çështjeje, në apel nuk duhet te jepen verdikte të tilla fajësie. Faktikisht, Dhoma e Apelit gëzon të drejtën për të dhënë ose mos dhënë verdikte të reja fajësie në apel, dhe për mendimin tim, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, verdiktet e reja të fajësisë duhet të shënohen, por jo të shpallen si verdikte të reja fajësie në apel.¹⁹ Për këtë arsye, me respekt shpreh mendimin tim mospajtues me shumicën rreth kësaj çështjeje.

3. Fajësi e shumëfishtë në lidhje me Nenin 5

7. Sikurse kam theksuar disa herë në të kaluarën, unë i qëndroj mendimit se një i akuzuar nuk mund të shpallet fajtor për përndjekje, si krim kundër njerëzimit bazuar në Nenin 5 të Statutit, nëse është shpallur fajtor për një shkelje tjetër në kuadër të Nenit 5 të Statutit, në qoftë se të dy verdiktet e fajësisë bazohen në të njëjtin veprim kriminal.²⁰ Gjithsesi, unë pajtohem se kjo tashmë është bërë pjesë e jurisprudencës në fuqi të Tribunalit dhe formalisht nuk do të shpreh mendim mospajtues me vendimin e Dhomës së Apelit që la në fuqi verdiktet e fajësisë të shpallura nga Dhoma Gjyqësore në bazë të veprimeve të njëjta për krimet e dëbimit, veprimeve të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme), vrasje dhe përndjekje sipas Nenit 5 të Statutit.²¹

4. Anëtarët e tjerë të NPK-së

8. Dhoma e Apelit konkludoi se “Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar që të analizonte veprimet e secilit anëtar të NPK-së apo të shqyrtonte me hollësi synimin e tyre.”²² Ndonëse pajtohem se Tribunali e ka zbatuar vijimësisht këtë parim, mendoj se në rrethanat e kësaj çështjeje pasojat janë të padëshirueshme dhe mund të ishin shmangur.

9. Së pari, mendoj se dosja e çështjes *Millutinoviq dhe të tjerët* ka qenë më ndryshe, dhe me gjasë më e plotë, në lidhje me disa prej “anëtarëve të tjerë të NPK-së”, përfshirë Llazareviqin dhe Ojdaniqin, krahasuar me dokumentacionin në dispozicion të Dhomës Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq*. Nuk mund të pritet që Gjorgjeviqi të ketë paraqitur të njëjtat

¹⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 929, 981.

¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 600.

¹⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*, para. 1604.

²⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq and Çerkez*, Mendim i Përbashkët Mospajtues i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, Mendim Mospajtues i Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, Mendim i Përbashkët Mospajtues i Gjykatësit Schomburg dhe Gjykatësit Güney në lidhje me Fajësinë e Shumëfishtë, Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerët*, Mendim Pjesërisht Mospajtues i Gjykatësit Güney.

²¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 846.

prova të mbrojtjes si Llazareviqi dhe Ojdaniqi në proceset e tyre gjyqësore. Për mendimin tim, këto rrethana pashmangshmërisht çuan në përfundime të ndryshme të dy dhomave gjyqësore, me pasoja të ndryshme.

10. Për mendimin tim, fakti që Dhoma Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq* nuk ishte e detyruar të “shqyrtonte me hollësi” veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të anëtarëve të tjerë të NPK-së, mund të çojë në këto pasoja të padëshirueshme: (i) pas analizimit të provave në lidhje me synimin kriminal dhe veprimin e fajshëm, Llazareviqi/Ojdaniqi u shpallën të pafajshëm për krimet në lidhje me NPK-në në proceset e tyre gjyqësore;²³ nga ana tjetër (ii) Dhoma Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq* arriti në përfundimin “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm” se Llazareviqi dhe Ojdaniqi ishin anëtarë të NPK-së, pa qenë e detyruar të analizonte konkretisht dhe ligjërisht nëse Llazareviqi/Ojdaniqi kishin synimin kriminal dhe veprimin e fajshëm të nevojshëm;²⁴ (iii) Gjorgjeviqi mund të shpallet penalisht përgjegjës për veprimet e kryera nga Llazareviqi/Ojdaniqi, për të cilat ata vetë u shpallën të pafajshëm pasi Dhoma Gjyqësore në atë çështje kishte shqyrtuar me hollësi synimin kriminal dhe veprimet e fajshme të tyre. Rrjedhimisht, unë pajtohem me parashtrimet e Gjorgjeviqit se kjo përbën zbatim të një standardi të dyfishtë.

11. Për t’iu shmangur një situatë të tillë, të paktën brenda juridiksionit të Tribunalit, mendoj se do të kishte qenë e këshillueshme që Dhoma Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq* të kishte marrë parasysh përfundimet e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*. Për mendimin tim, megjithëse nuk ishte e detyruar të ndiqte përfundimet e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Gjorgjeviq* gjithsesi nuk e kishte të ndaluar që t’i merrte në konsideratë. Dhe në fakt, për arsye të paqarta, disa herë edhe e bëri këtë.²⁵ Mendoj se do të kishte qenë e drejtë që mbi këtë problem të vendosej para fillimit të gjykimit dhe të adoptohej një linjë arsyetimi e njëtrajtshme me çështjen *Millutinoviq dhe të tjerët*, në mënyrë që të mundësohej njëtrajtshmëri në Aktgjykimin *Gjorgjeviq* dhe të shmangej çdo kundërshti e mundshme dhe e panevojshme në juridiksionin e TPNJ-së. Gjithsesi, duke qenë se konkluzioni përfundimtar ka të bëjë me faktin nëse Gjorgjeviqi bashkëveproi me të tjerët, pafajësia e Llazareviqit dhe Ojdaniqit nuk cenojnë përfundimin e Dhomës Gjyqësore .

²² Aktgjykimi i Apelit, para. 138.

²³ Shih Aktgjykimi *Millutinoviq dhe të tjerët*, vëll. 3, para. 1209, 1211.

²⁴ Aktgjykimi, para. 2127.

²⁵ Për shembull, *shih* Aktgjykimi, para. 2120 ku Dhoma Gjyqësore konkretisht theksoi se nuk do të paraqiste përfundime “në lidhje me implikimin apo dijeninë e gjeneral Sreten Llukiqit për fshehjen e kufomave.” [Dhoma Gjyqësore] theksoi se Llukiqi u gjykua në Tribunal në lidhje me të njëjtat ngjarje dhe se ishte në pritje të Apelit. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 2211 ku Dhoma Gjyqësore gjithashtu mori parasysh Aktgjykimin e çështjes *Millutinoviq dhe të tjerët* në tërësi dhe shprehu mendimin se “asnjë anëtar tjetër i ndërmarrjes së përbashkët kriminale [përveç Gjorgjeviqit] nuk ka dhënë kontribut më të rëndësishëm për realizimin e qëllimit të saj.”

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht, ku teksti në anglisht ka përparësi.

Gjykatës Mehmet Güney

Sot më 27 janar 2014, në Hagë, Holandë.

[Vula e Tribunalit]

XXIII. MENDIM MOSPAJTUES I GJYKATËSIT TUZMUKHAMEDOV

A. Hyrje

1. Në këtë Aktgjykim, Dhoma e Apelit la në fuqi verdiktin e fajësisë së Gjorgjeviqit bazuar në kategorinë I të NPK-së për dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) vrasje, përndjekje (përmes dëbimit, zhvendosjes së dhunshme, vrasjes, dhe shkatërrimit të objekteve me vlerë kulturore ose fetare) si krime kundër njerëzimit, dhe për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës.¹ Shumica gjithashtu konkludoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin të pafajshëm për përndjekje, përmes dhunës seksuale, si krim kundër njerëzimit, të kryer nga forcat serbe kundër pesë femrave shqiptare kosovare, dhe shpalli verdikte të reja fajësie kundër Gjorgjeviqit për këto krime bazuar në kategorinë III të NPK-së.²

2. Me respekt shpreh mendimin tim pjesërisht mospajtues me arsyetimin dhe përfundimet e Shumicës lidhur me kontributin e Gjorgjeviqit në planin e përbashkët. Për më tepër, gjykoj se disa nga krimet bazë të vrasjes si krim kundër njerëzimit dhe shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, dhe përndjekjes përmes shkatërrimit apo dëmtimit të objekteve fetare si krim kundër njerëzimit, logjikisht nuk mund t'i atribuoheshin Gjorgjeviqit. Unë gjithashtu nuk mund të pajtohem me mendimin e Shumicës se ekziston arsye e mjaftueshme për përgjegjësi penale të Gjorgjeviqit për përndjekje përmes dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit.

B. Kontributi i Gjorgjeviqit në planin e përbashkët

3. Për arsyet e mëposhtme, nuk pajtohem me arsyetimin dhe përfundimet e Shumicës lidhur me pretendimin se Gjorgjeviqi kontribuoi në planin e përbashkët, dhe rrjedhimisht mban përgjegjësi penale bazuar në NPK-në, nëpërmjet implikimit të tij në dislokimin e njërive paraushtarake në Kosovë dhe ndihmës së tij në fshehjen e krimeve të forcave serbe.

1. Dislokimi i paraushtarakëve

4. Në procesin e analizimit të pjesëmarrjes së Gjorgjeviqit në planin e përbashkët, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai kontribuoi në dislokimin e njërive paraushtarake në Kosovë më 1999.³ Lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore theksoi se në shkurt 1999, Gjorgjeviqi “mori masa për zbatimin e vendimit për angazhimin e vullnetarëve dhe njërive paraushtarake duke u dërguar të gjitha SPB-ve në Serbi një telegram me kërkesë që ato të vendosnin kontroll të plotë

¹ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 458-462, f. 381.

² Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 846-929, f. 381.

³ Aktgjykimi, para. 2155.

mbi vullnetarët dhe njësitë paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre”.⁴ [Dhoma Gjyqësore] gjithashtu gjykoi se Gjorgjeviqi personalisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mori pjesë në përfshirjen e pjesëtarëve të Akrepave në forcat rezerviste të MPB-së, në bashkimin zyrtar të tyre me SAJ-in dhe dislokimin e tyre në Podujevë në mars 1999, dhe se më pas Gjorgjeviqi autorizoi ridislokimin e pjesëtarëve të së njëjtës njësi në Kosovë.⁵

5. Shumica hodhi poshtë tërësisht apelimet e Gjorgjeviqit lidhur me këto përfundime.⁶ Me respekt shpreh mospajtimin tim me këtë vendim të Shumicës, për arsye se mendoj se Shumica nuk i kushtoi vëmendjen e duhur faktit se aspekti i kontributit të ndjeshëm të Gjorgjeviqit në planin e përbashkët përmes implikimit të tij në dislokimin e paraushtarakëve në Kosovë duhet të zgjidhet duke u bazuar në jurisprudencën e Tribunalit për ngarkimin me përgjegjësi penale të anëtarëve të NPK-së për krime të kryera nga persona që nuk ishin anëtarë të NPK-së. Në vijim, së pari do të bëj një përmbledhje të shkurtër të kësaj jurisprudence dhe do të shpjegoj se pse ajo lidhet me pretendimet kundër Gjorgjeviqit. Më pas do të shtjelloj konkretisht nëse një gjykes i arsyeshëm faktesh do të mund të konkludonte se Gjorgjeviqi mori pjesë në dislokimin e njësive paraushtarake (të tjera nga Akrepat) në Kosovë dhe se ai kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët kur dislokoj dhe ridislokoj Akrepat në Kosovë.

(a) Konstatime të përgjithshme: kontributi në planin e përbashkët përmes dislokimit të personave që nuk ishin anëtarë të NPK-së

6. Doktrina e NPK-së kushtëzon që i akuzuari të ketë kontribuar ndjeshëm në krimet për të cilat është shpallur fajtor.⁷ Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim se njësitë paraushtarake që vepruan në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës ishin anëtarë të NPK-së.⁸ Për mendimin tim, ky është një fakt kyç për të vlerësuar nëse Dhoma Gjyqësore mund të kishte konkluduar logjikisht se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët përmes pjesëmarrjes së tij në dislokimin e paraushtarakëve. Për të nxjerrë një përfundim të tillë, për mendimin tim duhet të vërtetohet se: (i) njësitë paraushtarake kryen krime të cilat mund t’u ngarkoheshin anëtarëve të NPK-së, për arsye se anëtarët e NPK-së “përdorën” këto njësi për kryerjen e krimeve për realizimin e planit të përbashkët; dhe (ii) përmes implikimit të tij në dislokimin e paraushtarakëve, Gjorgjeviqi, ose “përdori” personalisht këto njësi për kryerjen e krimeve për të realizuar planin e përbashkët, ose kontribuoi ndjeshëm në një mënyrë tjetër në përdorimin e këtyre njësive. Në rast se nuk vërtetohet kriteri i parë, sjellja e paraushtarakëve në Kosovë në atë kohë nuk ka ndikuar ndjeshëm në realizimin e planit të përbashkët, dhe për këtë arsye të

⁴ Aktgjykimi, para. 2155.

⁵ Shih Aktgjykimi, para. 2155. Shih gjithashtu po aty, para. 1934-1943, 1953.

⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 351-371.

⁷ Shih, p.sh., Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 215; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2126-2128. Shih gjithashtu po aty, para. 191-216.

vetme nuk mund të ketë qenë e rëndësishme për përgjegjësinë penale të Gjorgjeviqit bazuar në NPK-në. Në qoftë se nuk vërtetohet kriteri i dytë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludonte logjikisht se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët përmes implikimit të tij në dislokimin e paraushtarakëve në Kosovë.

7. Sipas jurisprudencës së Tribunalit, krimet e kryera nga joanëtarë mund t'u ngarkohen të gjithë anëtarëve të NPK-së në qoftë se të paktën njëri prej tyre "përdori" autorët fizikë të krimeve për kryerjen e kimit në fjalë dhe rrjedhimisht veproi në përputhje me planin e përbashkët.⁹ Ekzistenca e një lidhjeje të tillë duhet përcaktuar rast pas rasti.¹⁰ Ndër faktorët që mund të merren parasysh në këtë aspekt janë bashkëpunimi i ngushtë i kujtdo prej anëtarëve të NPK-së me autorët e drejtpërdrejtë të krimeve me qëllim realizimin e planit të përbashkët, ose dijenia e autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve për ekzistencën e NPK-së.¹¹ Lidhja e nevojshme mund të ekzistojë edhe kur një anëtar i NPK-së drejtpërsëdrejti ose tërthorazi i kërkoi një joanëtarin të kryente krimin, ose nxiti, urdhëroi, inkurajoi ose ndryshe e përdori atë për të kryer krimin.¹² Për mendimin tim, kjo jurisprudencë është e vlefshme edhe kur një i akuzuar, në këtë rast Gjorgjeviqi, mund të konsiderohet se ka kontribuar ndjeshëm në planin e përbashkët përmes përfshirjes së tij në operacione të kryera nga joanëtarë të NPK-së.

(b) Implikimi i Gjorgjeviqit në dislokimin e njësive të tjera paraushtarake në Kosovë, përveç Akrepave

8. Si përfundimi i Dhomës Gjyqësore lidhur me pjesëmarrjen e Gjorgjeviqit në planin e përbashkët përmendur më lart, po ashtu edhe arsytimi i Shumicës në këtë Aktgjykim, krijojnë përshtypjen se Gjorgjeviqi u implikua në dislokimin e më shumë njësive paraushtarake në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës.¹³ Prova kryesore është telegrami i Gjorgjeviqit i datës 18 shkurt 1999, ku kërkohet që të "vendosej kontroll i plotë mbi njësitë vullnetare dhe paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre".¹⁴

⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413, 430. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 225, 235; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 171-172.

¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413; Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 226.

¹¹ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410.

¹² Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 226. Më tej theksoj se pushteti dhe kontrolli i një anëtarin të NPK-së mbi joanëtarët konsiderohet faktor kryesor në konkluzionin nëse krimet e joanëtarëve mund t'u ngarkohen anëtarëve të NPK-së. Shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 238-282; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 187, 192, 195, 200, 205, 210.

¹³ Shih Aktgjykimi, para. 2155, 2158; Aktgjykimi i Apelit, para. 371 (ku u konkludua se Dhoma Gjyqësore nxori konkluzionin e arsyeshëm se Gjorgjeviqi "mori pjesë dhe ishte në dijeni të dislokimit të njësive paraushtarake në Kosovë, duke përfshirë dislokimin e Akrepave në Podujevë, së bashku me forcat e MPB-së dhe RJB-së, dhe kjo ishte pjesë e kontributit të tij të konsiderueshëm në NPK.") (pa citimet e brendshme, theksi i shtuar).

¹⁴ Shih Aktgjykimi, para. 195, 926, 1929 (sh. 6616), 2021, 2155; Aktgjykimi i Apelit, para. 363, 367.

9. I referohem përfundimit të Dhomës Gjyqësore se gjatë periudhës së Aktakuzës, në Kosovë vepronin grupe të ndryshme paraushtarake.¹⁵ [Dhoma Gjyqësore] konstatoi se UJ-ja dhe MPB-ja “përdorën” grupe të tilla,¹⁶ dhe se në radhët e forcave rezerviste të MPB-së “u përfshinë” shumë pjesëtarë të grupeve paraushtarake,¹⁷ dhe se paraushtarakët “shërbyen” rregullisht në Kosovë gjatë asaj periudhe.¹⁸ Konkretisht lidhur me “Tigrat e Arkanit”, Dhoma Gjyqësore theksoi se pjesëtarët e kësaj njësie iu bashkuan dhe “ishin të lidhur me” RDB-në, dhe se ata “luajtën një rol aktiv” në operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë.¹⁹ Lidhur me “Shqiponjat e Bardha”, Dhoma Gjyqësore theksoi se ky grup paraushtarak ishte “i lidhur” me Vojislav Sheshelin, zëvendëskryeministrin e Serbisë, dhe se pjesëtarët e këtij grupi “morën pjesë në bashkërendim me” MPB-në në operacionet e zhvilluara në Kosovë më 1999.²⁰ Dhoma Gjyqësore gjithashtu theksoi se njësia paraushtarake e Merimangave (Pauk) “u përfshi në UJ”.²¹

10. Gjithsesi, nga arsyetimi në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, unë nuk e kam të qartë nëse këto grupe paraushtarake faktikisht u dislokuan si pasojë e telegramit të Gjorgjeviqit të datës 18 shkurt 1999.²² Aktgjykimi gjithashtu nuk bën të qartë nëse Gjorgjeviqi bashkëpunoi personalisht me njësitë paraushtarake gjatë periudhës së Aktakuzës, u dha atyre udhëzime konkrete për të kryer krime, apo se kishte pushtet mbi këto grupe. Në këto rrethana, mendoj se Dhoma Gjyqësore nuk shpjegoi si duhej se pse konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët përmes pjesëmarrjes së tij në dislokimin e njësive paraushtarake (përveç Akrepave) në Kosovë.²³ Fatkeqësisht, Shumica nuk e ka marrë në konsideratë këtë çështje edhe pse Gjorgjeviqi ka ngritur argumente të ngjashme.²⁴ Përkundrazi, thjesht është përsëritur interpretimi i Dhomës Gjyqësore për telegramin e Gjorgjeviqit të datës 18 shkurt 1999, përmenden provat e marra parasysht nga Dhoma Gjyqësore në nxjerrjen e konkluzionit se Gjorgjeviqi ishte në dijeni se paraushtarakët vepronin në Kosovë më 1998 dhe 1999, dhe

¹⁵ Shih Aktgjykimi, para. 195-216.

¹⁶ Aktgjykimi, para. 195-196.

¹⁷ Aktgjykimi, para. 196.

¹⁸ Aktgjykimi, para. 202.

¹⁹ Shih Aktgjykimi, para. 209-210.

²⁰ Shih Aktgjykimi, para. 212, 214.

²¹ Aktgjykimi, para. 216.

²² Theksoj përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ministër Stojilkoviqi dhe Gjorgjeviqi bënë përgatitjet për përfshirjen e njësive paraushtarake në radhët e njësive të MPB-së në fillim të vitit 1999, dhe se telegrami i Gjorgjeviqit i datës 18 shkurt 1999 “ishte qartazi udhëzim për zbatimin e urdhrin të ministrit për ‘angazhimin e vullnetarëve’”. Shih Aktgjykimi, para. 196, 2021. Shih gjithashtu po aty, para. 1929, ku Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi “ishte në dijeni dhe kishte të njëjtin synim si MPB-ja për angazhimin e paraushtarakëve në operacionet kundërterroriste para fillimit të luftës”.

²³ Shih Aktgjykimi, para. 2155, 2158.

²⁴ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 234. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 364.

citohen përfundimet në Aktgjykim se grupet paraushtarake bashkëvepruan me njësitë e MPB-së në Kosovë dhe se Gjorgjeviqi dislokoj Akrepat në Podujevë.²⁵

(c) Implikimi i Gjorgjeviqit në dislokimin e Akrepave

11. Sikurse u theksua më lart, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët përmes dislokimit të pjesëtarëve të Akrepave në Podujevë më 28 mars 1999 dhe ridislokimin e pjesëtarëve të së njëjtës njësi gjetkë në Kosovë, vetëm disa ditë më pas.²⁶ Kujtoj konstatimin tim të mësipërm se Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim nëse paraushtarakët, ndër të tjerë edhe Akrepat, të cilët vepruan në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës, ishin anëtarë të NPK-së. Rrjedhimisht, duhej të ishte vërtetuar se Akrepat, ose njësitë të cilave ata iu bashkuan, kryen krime të cilat mund t'u ngarkoheshin anëtarëve të NPK-së, dhe se Gjorgjeviqi "përdori" personalisht këta individë për kryerjen e krimeve për të realizuar planin e përbashkët, ose kontribuoi ndjeshëm në një mënyrë tjetër në përdorimin e tyre.

12. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Akrepat vranë 14 gra e fëmijë në një oborr në Podujevë më 28 mars 1999, dhe lidhur me këto ngjarje e shpalli Gjorgjeviqin fajtor bazuar në kategorinë I të NPK-së për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit.²⁷ Mund të argumentohet se ky fakt marrë së bashku me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Gjorgjeviqi personalisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mori pjesë në përfshirjen e pjesëtarëve të Akrepave në forcat rezerviste të MPB-së, në bashkimin zyrtar të tyre me SAJ-in dhe dislokimin e tyre në Kosovë,²⁸ lë të kuptohet se për mendimin e Dhomës Gjyqësore, ai "përdori" Akrepat për të kryer vrasjet në Podujevë më 28 mars 1999, apo të paktën kontribuoi për përdorimin e tillë të tyre.

13. Mirëpo, ashti sikurse argumenton edhe Gjorgjeviqi në apelin e tij, nuk pati prova se ai urdhëroi Akrepat që të kryenin krime në Podujevë.²⁹ Dhoma Gjyqësore theksoi se *rrugës* për në Podujevë, pjesëtarët e kësaj njësie u ngarkuan me detyrën që "të spastronin" pjesë të qytetit

²⁵ Shih Aktgjykimin i Apelit, para. 366-367.

²⁶ Shih Aktgjykimin, para. 2155, 2158. Në këtë kontekst, mund të jetë e dobishme që të kujtoj se sipas dëshmive që dëgjoi Dhoma Gjyqësore, njësia e SAJ-it që veproi në Podujevë më 28 mars 1999 përfshinte, ndër të tjerë, edhe ish-pjesëtarë të Akrepave. Shih, posaçërisht, Aktgjykimin, para. 1238, 1934-1945. Dhoma Gjyqësore më tej konkludoi se Akrepat u dislokuan përsëri në Kosovë, me miratimin e Gjorgjeviqit. Shih Aktgjykimin, para. 1946-1948.

²⁷ Shih Aktgjykimin, para. 1243-1245, 1247-1252, 1750, 1944, 2155, f. 883. Shih gjithashtu po aty, para. 1258. Theksoj se Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor edhe për vrasjen e dy të moshuarve nga forcat serbe në Podujevë më 28 mars 1999, meqenëse këto vrasje nuk u shtjelluan siç duhej në Aktakuzë. Shih Aktgjykimin i Apelit, para. 659-661.

²⁸ Shih Aktgjykimin, para. 2155.

²⁹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 229; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 69-70. Shih gjithashtu Aktgjykimin i Apelit, para. 353.

të Podujevës.³⁰ Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranoi se Gjorgjeviqi u informua për krimet e kryera në Podujevë pas kryerjes së tyre.³¹ Ndonëse Shumica i anashkaloi këto aspekte si të parëndësishme,³² unë i konsideroj të rëndësishme për arsye se vënë në dyshim nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të mund të konkludonte se Gjorgjeviqi veprroi me synimin e realizimit të planit të përbashkët kur mori vendimin për dislokimin e Akrepave në Podujevë.

14. Lidhur me ridislokimin e njësisë të cilës iu bashkua njësia e Akrepave, theksoj se Dhoma Gjyqësore pranoi se: (i) më 30 mars 1999 u krye një hetim në vendngjarje lidhur me vrasjet në Podujevë;³³ (ii) fillimisht njësia u tërhoq pas asaj që kishte ndodhur në këtë vend;³⁴ (iii) Gjorgjeviqi urdhëroi komandantin e atëhershëm të SAJ-it Zhivko Trajkoviqin,³⁵ që ta kthente njësinë në Beograd, t'i çarmatoste pjesëtarët e saj dhe t'i dërgonte në shtëpi;³⁶ dhe (iv) Gjorgjeviqi i kërkoi Trajkoviqit që të përgatiste një raport lidhur me ngjarjet në Podujevë, të cilin Trajkoviqi e dorëzoi më 13 maj 1999, kurse Gjorgjeviqi më pas ia kaloi ministër Stojilkoviqit.³⁷

15. Shumica i konsideroi këto fakte “të panevojshme” duke qenë se Gjorgjeviqi më pas autorizoi ridislokimin e Akrepave në Kosovë.³⁸ Shumica gjithashtu i referohet përfundimit në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore se autorët e krimeve në Podujevë nuk u proceduan penalisht dhe nuk u dënuan.³⁹ Shumica më tej sugjeron se përfundimi Dhomës Gjyqësore se ridislokimi “dëshmoi përsëri kontributin e Gjorgjeviqit në realizimin e NPK-së” nuk u ndikua nga fakti se disa prej autorëve të krimeve në Podujevë mund të jenë hequr nga njësia para ridislokimit të saj.⁴⁰

16. Gjithsesi, fakti që pjesëtarë të Akrepave u ridislokuan në Kosovë në vetvete nuk provon automatikisht se Gjorgjeviqi personalisht “përdori” këta persona për të kryer krime me qëllim realizimin e planit të përbashkët, apo se ai kontribuoi ndjeshëm në përdorimin e tyre në një mënyrë tjetër. Për më tepër, e konsideroj të rëndësishme në këtë kontekst nëse Gjorgjeviqi mori masa *bona fide* lidhur me çfarë ndodhi në Podujevë më 28 mars 1999. Në dallim nga Shumica, mendoj se largimi i autorëve të krimeve në Podujevë nga njësia para ridislokimit të saj në Kosovë ka rëndësi për të përcaktuar nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të mund të konkludonte se Gjorgjeviqi veprroi për realizimin e planit të përbashkët kur organizoi

³⁰ Shih Aktgjykimin, para. 1238, 1938. Shih gjithashtu po aty, para. 2144; Aktgjykimin i Apelit, para. 358.

³¹ Aktgjykimin, para. 1258, 1943.

³² Shih Aktgjykimin i Apelit, para. 358.

³³ Aktgjykimin, para. 1258, 1261, 1959.

³⁴ Shih Aktgjykimin, para. 1943, 1963.

³⁵ Aktgjykimin, para. 1260.

³⁶ Aktgjykimin, para. 1943, 1945, 1963.

³⁷ Aktgjykimin, para. 1260, 1961.

³⁸ Aktgjykimin i Apelit, para. 358.

³⁹ Aktgjykimin i Apelit, para. 359.

⁴⁰ Aktgjykimin i Apelit, para. 360.

ridislokimin.⁴¹ Për këtë arsye, problemi nëse Dhoma Gjyqësore me arsye hodhi poshtë provat që sugjeronin se të gjithë autorët e krimeve në Podujevë më 28 mars 1999 u hoqën nga njësia e Akrepave para ridislokimit të saj në Kosovë duhej të ishte shtjelluar drejtpërsëdrejti në këtë Aktgjykim.⁴² Për më tepër, meqenëse nga Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore nuk del qartë nëse Gjorgjeviqi kishte ndonjë ndikim mbi procedurat gjyqësore në atë kohë, unë nuk jam bindur se ai me arsye mund të fajësohej për mungesën e procedimeve penale në lidhje me ngjarjet në Podujevë.⁴³

(d) Përfundim

17. Për arsyet e lartpërmendura, unë nuk pajtohem me vendimin e Shumicës për mospranimin e argumentit të Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët përmes implikimit të tij në dislokimin e njësive paraushtarake në Kosovë.⁴⁴

2. Ngjarjet në Reçak

18. Në analizimin e pjesëmarrjes së Gjorgjeviqit në planin e përbashkët, Dhoma Gjyqësore gjykoj se ai luajti “rol udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për të kufizuar çdo hetim të pavarur të vrasjes të jo më pak se 45 burrave në Reçak, në janar 1999”.⁴⁵ Shumica hedh poshtë kundërshtimet e Gjorgjeviqi lidhur me këtë përfundim.⁴⁶ Unë nuk pajtohem me këtë vendim të Shumicës për arsyet e mëposhtme.

19. Dhoma Gjyqësore theksoi se operacioni në Reçak filloi rreth orës 6 apo 7 të mëngjesit më 15 janar 1999 kur forcat e UJ-së hapën zjarr kundër fshatit.⁴⁷ Më pas, ndërsa UJ-ja po vazhdonte me granatimet, forca të MPB-së hynë në fshat dhe filluan të kontrollonin të gjitha shtëpitë.⁴⁸ Dhoma Gjyqësore u bind se Gjorgjeviqi mbërriti në stacionin e policisë në Shtime

⁴¹ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 360.

⁴² Shih Aktgjykimi, para. 1964.

⁴³ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 359.

⁴⁴ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 362, 371.

⁴⁵ Aktgjykimi, para. 2154. Gjetkë në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Gjorgjeviqi kishte informacion të plotë rreth operacionit në Reçak më 15 janar 1999 dhe “mori përsipër një rol organizues në lidhje me veprimet e policisë në terren.” Shih Aktgjykimi, para. 1923. Shih gjithashtu po aty, para. 425. Gjithsesi, meqenëse këto përfundime nuk përmenden në konkluzionet rreth pjesëmarrjes së Gjorgjeviqin në NPK (Shih Aktgjykimi, para. 2154-2158), mendoj se përfundimisht, Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se Gjorgjeviqi kontribuoi në NPK përmes rolit të tij në ngjarjet në Reçak. Megjithatë, parashatroj se shpjegimet e mia në vijim gjithashtu tregojnë se asnjë gjykes i arsyeshem faktesh nuk do të mund të konkludonte se kishte prova të mjaftueshme për nxjerrjen e përfundimit se Gjorgjeviqi luajti rol aktiv në vetë operacionin në Reçak. Për këto arsye, mendoj se vlerësimi i ngjarjeve në Reçak ka të bëjë me pretendimin se Gjorgjeviqi kontribuoi në planin e përbashkët përmes fshehjes së krimeve.

⁴⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 344-350.

⁴⁷ Aktgjykimi, para. 257, 1920. Dhoma Gjyqësore gjykoj se veprimet bashkërenduese të MPB-së në lidhje me operacionin u kryen në stacionin e afërt policor që në orën 06:30 – 07:00 të mëngjesit. Shih Aktgjykimi, para. 397.

⁴⁸ Aktgjykimi, para. 257, 1920.

(që ndodhej rreth një kilometër larg Reçakut) në orën 08:30 apo 09:00, ndenji atje për më shumë se një orë, dhe gjatë asaj kohe foli dy herë me telefon me zëvendëskryeministrin e RFJ-së, Nikolla Shainoviqin.⁴⁹ Operacioni me sa duket zgjati deri në orën 15:00 apo 16:00, dhe Dhoma Gjyqësore konkludoi se bashkërendimi i ngushtë midis forcave të UJ-së dhe MPB-së bënte të qartë se operacioni “kontrollohej nga një komandant i vetëm në terren”.⁵⁰ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore e konsideroi të rremë mohimin e mëvonshëm të përfshirjes së UJ-së në këtë operacion.⁵¹

20. Dhoma Gjyqësore gjithashtu theksoi se vëzhguesit e MVK-së filluan hetimin në Reçak në mëngjesin e 16 janarit 1999.⁵² Vëzhguesit e MVK-së panë policë dhe pjesëtarë të UJ-së në atë zonë.⁵³ Në fshat, verifikuesit panë rreth 45 kufoma shqiptarësh kosovarë të cilët dukej se ishin ekzekutuar.⁵⁴ Më vonë atë ditë, fshatarët i çuan kufomat në xhaminë e Reçakut.⁵⁵ Rreth të njëjtës kohë, gjykatësja hetuese Marinkoviq bëri disa përpjekje për të hyrë në Reçak për të kryer hetim në vendngjarje, por pa rezultat për arsye se kundër saj dhe ekipit të saj u hap zjarr.⁵⁶

21. Gjykatësja hetuese Marinkoviq, së bashku me zëvendësprokurorin publik dhe inspektorë të SPB-së, më në fund hynë në Reçak më 18 janar 1999.⁵⁷ Pak para kësaj, ajo kishte takuar Gjorgjeviqin në stacionin e policisë në Shtime.⁵⁸ Dhoma Gjyqësore theksoi se policia e informoi gjykatësen Marinkoviq se në xhami kishte kufoma. Në xhami ajo pa 40 kufoma. Të gjitha, me përjashtim të njëjës, ishin kufoma meshkujsh. Kufomat kishin këpucë që u ngjanin çizmeve ushtarake dhe rroba të tjera ushtarake.⁵⁹

22. Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjithë çfarë iu tregua gjykatëses Marinkoviq ishte një vend krimi i përgatitur nga MPB-ja, dhe se Gjorgjeviqi personalisht mbante “përgjegjësinë më të madhe” dhe kryesoi përpjekjet e MPB-së për të fshehur provat e forcës së tepruar të përdorur nga ana e policisë gjatë operacionit në Reçak.⁶⁰

23. Theksoj se në Aktgjykim nuk përmenden prova lidhur me çfarë ndodhi në Reçak midis vizitës së vëzhguesve të MVK-së më 16 janar 1999 dhe vajtjes së gjykatëses Marinkoviq në fshat dy ditë më pas. Faktikisht, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se MPB-ja dhe konkretisht

⁴⁹ Aktgjykimi, para. 398, 1921.

⁵⁰ Aktgjykimi, para. 257, 397, 1920.

⁵¹ Aktgjykimi, para. 406.

⁵² Aktgjykimi, para. 405.

⁵³ Aktgjykimi, para. 407.

⁵⁴ Aktgjykimi, para. 405, 407.

⁵⁵ Aktgjykimi, para. 408.

⁵⁶ Shih Aktgjykimi, para. 411.

⁵⁷ Aktgjykimi, para. 412.

⁵⁸ Aktgjykimi, para. 424.

⁵⁹ Aktgjykimi, para. 412.

Gjorgjeviqi përgatitën vendin e krimit që iu tregua gjykatëses Marinković u bazua në prova rrethanore dhe për pasojë duhej të ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm i mundshëm.⁶¹

24. Lidhur me këtë, vërej se me sa duket Dhoma Gjyqësore pranoi se përveç forcave “policore” në zonën përreth Reçakut më 16 janar 1999 kishte edhe prani të UJ-së,⁶² dhe se prania e UÇK-së në këtë vend ishte e dukshme më 17 janar 1999.⁶³ Këto prova tregojnë se MPJ-ja nuk ishte e vetmja forcë që vepronte në zonën e Reçakut në atë kohë. Për mendimin tim, pikërisht për këtë arsye Dhoma Gjyqësore e kishte për detyrë të shpjegonte se mbi çfarë baze gjykoi se ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se MPB-ja përgatiti vendin e krimit që iu tregua gjykatëses Marinković dhe se pas këtyre veprimeve qëndronte Gjorgjeviqi.

25. Në Aktgjykim nuk ofrohet shpjegim se si saktësisht Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se MPB-ja ishte përgjegjëse për provat e inskenuara që iu treguan gjykatëses Marinković.⁶⁴ Për më tepër, kur konkludoi se Gjorgjeviqi personalisht u implikua në fshehjen e krimeve të kryera në këtë vend, Dhoma Gjyqësore thjesht arsyetoi se “prania e Gjorgjeviqit në stacionin e policisë në Shtime së paku më 15 janar 1999, konfirmon se ai ishte në dijeni të operacionit të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në Reçak më 15 janar dhe të rëndësisë së këtij operacioni, dhe zbulon përgjegjësinë e tij për ngjarjet në Reçak, duke përfshirë paraqitjen e kufomave të tjera dhe inskenimin e rrethanave që iu treguan ekipit të gjykatëses Marinković dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe mediave më 18 janar 1999”.⁶⁵

26. Megjithatë, në Aktgjykim nuk përmenden prova se çfarë bëri saktësisht Gjorgjeviqi gjatë qëndrimit të tij njëorësh në stacionin e policisë në Shtime mëngjesin e datës 15 janar 1999. Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se ai u dha udhëzime forcave të MPB-së lidhur me pjesëmarrjen e tyre në operacionin në Reçak.⁶⁶ Përveç dy bisedave telefonike të Gjorgjeviqit me Shainovićin gjatë qëndrimit të tij në stacionin e policisë në Shtime, me sa duket nuk ka prova të tjera lidhur me çfarë diskutuan ata.⁶⁷ Konkretisht nuk ka prova dhe Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim, se vendimi për fshehjen e krimeve të kryera gjatë operacionit në Reçak

⁶⁰ Shih Aktgjykimi, para. 415, 425, 1924, 2084.

⁶¹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 149; Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 99.

⁶² Shih Aktgjykimi, para. 407.

⁶³ Shih Aktgjykimi, para. 410. Me sa duket, Dhoma Gjyqësore pranoi se më 17 janar 1999, MVK-ja e paralajmëroi gjykatësen Marinković se nuk mund të garantonte sigurinë e saj në qoftë se ajo këmbëngulte të hynte në fshat me prani të madhe të MPB-së. Shih Aktgjykimi, para. 410.

⁶⁴ Shih, posaçërisht, Aktgjykimi, para. 415, 425, 1924.

⁶⁵ Aktgjykimi, para. 425.

⁶⁶ Lidhur me këtë, kujtoj se kur Gjorgjeviqi mbërriti në stacionin policor në Shtime, operacioni tashmë kishte filluar. Shih Aktgjykimi, para. 257, 397, 1920-1921.

⁶⁷ Shih Aktgjykimi, para. 398, 1921.

ishte marrë në atë kohë.⁶⁸ Në Aktgjykim nuk përmenden as prova që tregojnë mënyrën, kohën dhe veprimet e ndërmarra nga Gjorgjeviqi për fshehjen e këtyre krimeve.⁶⁹

27. Për arsyet e lartpërmendura, mendoj se, në bazë të provave të shtjelluara në Aktgjykim asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte me siguri të plotë se MPB-ja inskenoi rrethanat që iu treguan gjykatësës Marinković dhe se Gjorgjeviqi qëndronte pas këtyre veprimeve. Fatkeqësisht, në vend që t'i trajtonte drejtpërsëdrejti këto çështje, Shumica kryesisht përsërit konstatimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me ngjarjet në Reçak, dhe u referohet përfundimeve në Aktgjykim lidhur me “praktikën e përgjithshme të përdorimit të forcës së tepruar nga ana e forcave serbe gjatë ‘operacioneve’ të përbashkëta ‘kundërterroriste’ të MPB-së dhe UJ-së” dhe “praktikës së moskryerjes së hetimeve dhe të fshehjes së krimeve më 1998 dhe 1999”.⁷⁰ Mbi këtë bazë, Shumica konkludon se Gjorgjeviqi nuk arriti të vërtetonte se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se ai kryesoi përpjekjet “për fshehjen e përdorimit të forcës së tepruar nga ana e forcave serbe gjatë operacioneve të përbashkëta”.⁷¹ Gjithsesi, me këto deklarata të përgjithshme lidhur me rolin e Gjorgjeviqit në fshehjen e sjelljes së përgjithshme kriminale të forcave serbe në Kosovë, Shumica lë të hapur pyetjen nëse Dhoma Gjyqësore me arsye konkludoi se Gjorgjeviqi ishte personalisht përgjegjës për ngjarjet në Reçak. Rrjedhimisht, me respekt shpreh mospajtimin tim me arsyetimin dhe përfundimin e Shumicës lidhur me këtë pikë.

3. Fshehja e krimeve

28. Duke u bazuar në analizën e pjesëmarrjes së Gjorgjeviqit në planin e përbashkët, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai luajti rol udhëheqës në përpjekjet e MPB-së për fshehjen e krimit të vrasjes së civilëve shqiptarë kosovarë dhe të tjerëve që nuk morën pjesë aktive në luftime gjatë periudhës së Aktakuzës.⁷² Lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore theksoi se Gjorgjeviqi dha udhëzime për varrosjen e fshehtë të kufomave të gjetura në lumin Danub dhe në liqenin e Peruqacit.⁷³ Ajo gjykoi se këto veprime dhe transportimi i kufomave nga Kosova në qendrat në Batajnicë dhe Petrovo Sello u ndërmorën “në kuadër të operacionit të koordinuar

⁶⁸ Theksoj se gjetkë në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “operacioni për fshehjen e kufomave u planifikua që nga fillimi i operacioneve të forcave serbe në Kosovë më 24 mars 1999.” Shih Aktgjykimi, para. 2118. Kur diskutoi provat në mbështetje të këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore nuk i përmendi ngjarjet në Reçak në janar 1999. Shih Aktgjykimi, para. 2109-2117.

⁶⁹ Lidhur me këtë, theksoj se, megjithëse Dhoma Gjyqësore nuk e pranoi dëshminë e Gjorgjeviqit se kishte qenë në mbledhje në Prizren dhe Pejë më 15 dhe 16 janar 1999, dhe më pas në një udhëtim për të bërë ski, i cili kishte zgjatur deri më 17 janar 1999 (shih Aktgjykimi, para. 425), në Aktgjykim nuk përmendet ndonjë dëshmi që vërteton se Gjorgjeviqi faktikisht ishte në një vend tjetër gjatë kësaj kohe, dhe sidomos jo në afërsi të Reçakut.

⁷⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 348-349.

⁷¹ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 349.

⁷² Aktgjykimi, para. 2156.

⁷³ Aktgjykimi, para. 2156.

për fshirjen e gjurmëve të krimeve të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës”.⁷⁴

29. Në apel, Gjorgjeviqi, ndër të tjera, parashtron se përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me fshehjen e kufomave në asnjë mënyrë nuk mbështesin përfundimin e saj se veprimet e tij kontribuuan ndjeshëm në planin e përbashkët, por thjesht përmbushin elementët e Nenit 7(3) të Statutit.⁷⁵ Për mendimin tim, ky kundërshtim duhej të ishte analizuar hollësisht. Konkretisht, mendoj se nga pikëpamja ligjore duhej të ishte shpjeguar se në çfarë mënyre operacionet e fshehjes mund të përbëjnë kontribut në planin e përbashkët, në mënyrë që të mund të shpallet fajësi për kryerje bazuar në NPK-në. Për më tepër, duhej të ishte vlerësuar nëse Dhoma Gjyqësore arsyetoi mjaftueshëm konkluzionin e saj se fshehja e vrasjeve kontribuoi ndjeshëm në planin e përbashkët i cili synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës përmes një fushate terrori dhe dhune të forcave serbe kundër shqiptarëve kosovarë.⁷⁶ Meqenëse Shumica nuk i shtjelloi këto çështje, me respekt shpreh mospajtimin tim me vendimin e saj për të hedhur poshtë apelin e Gjorgjeviqit lidhur me këtë pikë.⁷⁷

C. Krimet bazë

1. Vrasje

(a) Hyrje

30. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasje si krim kundër njerëzimit dhe si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës për vrasjen e “jo më pak se 724 shqiptarëve kosovarë”.⁷⁸ Ajo gjykoi se këto krime u kryen nga forcat serbe në disa komuna anembanë Kosovës midis marsit dhe qershorit 1999.⁷⁹ Në apel, Gjorgjeviqi parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se krimi i vrasjes u vërtetua lidhur me disa incidente, dhe në thelb argumenton se nuk kishte prova të mjaftueshme mbi të cilat do të mund të nxirrej një përfundim i sigurt se viktimat kishin statusin e personave të mbrojtur sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare.⁸⁰ Shumica hedh poshtë tërësisht parashtrimet e Gjorgjeviqit.⁸¹ Unë nuk pajtohem plotësisht me arsyetimin dhe konkluzionet e Shumicës për arsyet e mëposhtme:

⁷⁴ Aktgjykimi, para. 2156.

⁷⁵ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 240. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 375.

⁷⁶ Aktgjykimi, para. 2007, 2131.

⁷⁷ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 384.

⁷⁸ Shih Aktgjykimi, para. 2230. Shih gjithashtu po aty, para. 2212.

⁷⁹ Shih përgjithësisht Aktgjykimi, para. 1709-1752.

⁸⁰ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 304-315, 317-376.

⁸¹ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 522-523, 749-790.

(b) Konstatime lidhur me ligjin përkatës

31. Sipas Dhomës së Apelit, Dhoma Gjyqësore e konsideroi konfliktin e atëhershëm në Kosovë midis UÇK-së dhe forcave serbe konflikt të armatosur të brendshëm.⁸² Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se duke filluar nga maji i vitit 1998, UÇK-ja ishte një “grup i armatosur i organizuar”.⁸³ Për të kuptuar ndikimin e këtyre përfundimeve mbi verdiktet e fajësisë së Gjorgjeviqit për vrasje, e shoh të dobishme të bëj disa shpjegime lidhur me ligjin mbi konfliktet e armatosura të brendshme.

32. Në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, çdo pjesëtar i forcave të armatosura të palëve në konflikt konsiderohet luftëtar.⁸⁴ Ky status i akordon luftëtarit njëfarë mbrojtjeje. Sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare, një luftëtar i lejohet të marrë pjesë në luftime të armatosura dhe ai nuk mban përgjegjësi penale për pjesëmarrje në qoftë se nuk ka shkelur rregullat përkatëse, si për shembull kryerje e një sulmi të qëllimshëm kundër civilëve.⁸⁵ Kur bie në duart e armikut, luftëtar i bëhet rob lufte dhe ka status të personit të mbrojtur bazuar në Konventën III të Gjenevës.⁸⁶ Rrjedhojë e logjikshme e këtyre privilegjeve është se një luftëtar mund të konsiderohet dhe objektiv i ligjshëm sulmi, përveçse kur ai ka dorëzuar armët dhe ka shprehur qartë synimin e tij për t’u dorëzuar, ose është jashtë luftimeve.⁸⁷ Tribunali ka pranuar se kjo nënkupton se një luftëtar i cili nuk është jashtë luftimeve mund të sulmohet në mënyrë të ligjshme edhe në qoftë se është i paarmatosur dhe nuk merr pjesë drejtpërsëdrejti në luftime në kohën e sulmit.⁸⁸ I njëjti parim zbatohet edhe për anëtarët e grupeve të organizuara të rezistencës.⁸⁹

33. Në konfliktet e armatosura të brendshme, mbrojtja e personave përcaktohet në Nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe në Protokollin Shtesë II. Sipas Nenit të përbashkët 3 Konventave të Gjenevës, status të personave të mbrojtur kanë “personat që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime, ndër të cilët anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata jashtë luftimit për shkak sëmundjeje, lëndimesh, ndalim ose për shkaqe të tjera.” Shpjeguesi i KNKK-së për Protokollin Shtesë II të Konventave të Gjenevës thekson se anëtarët

⁸² Aktgjykimi i Apelit, para. 521.

⁸³ Aktgjykimi, para. 1578. Shih gjithashtu po aty, para. 1522.

⁸⁴ Shih Protokollin Shtesë I i Konventave të Gjenevës, Neni 43(2).

⁸⁵ Shih Protokollin Shtesë I i Konventave të Gjenevës, Neni 43(2), 44(2). Shih gjithashtu KNKK, Shpjeguesi i Protokolleve Shtesë, para. 1679.

⁸⁶ Shih Konventa III e Gjenevës, Neni 4.

⁸⁷ *Krahaso* Protokollin Shtesë I i Konventave të Gjenevës, Neni 43(2), 51(2).

⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 114; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 51.

⁸⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 113. Jurisprudenca e Tribunalit gjithashtu vë në dukje se vrasja e një luftëtar i cili nuk është *hors de combat* nuk i përmbush kriteret e vrasjes si krim kundër njerëzimit. Shih Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 306-314; Shih Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 113-114. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 747.

e grupeve të armatosura të organizuara “mund të sulmohen në çdo kohë”.⁹⁰ Kjo sugjeron se, parimisht, në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, anëtarët e grupeve të armatosura të organizuara gëzojnë mbrojtje kundër lëndimit ose vrasjes e ngjashme me mbrojtjen që gëzojnë luftëtarët në konflikte të armatosura ndërkombëtare. Rrjedhimisht, vrasja e anëtarëve të grupeve të armatosura të organizuara në konflikte të armatosura jondërkombëtare mund të përbëjë krim lufte apo krim kundër njerëzimit vetëm nëse vërtetohet se personat në fjalë kishin dorëzuar armët apo kishin shprehur qartë synimin e tyre për t’u dorëzuar, ose ishin jashtë luftimeve në kohën e sulmit.

34. Jurisprudenca e Tribunalit mbështet këtë interpretim. Në çështjen *Strugar*, Dhoma e Apelit shpjegoi se “parimi i pjesëmarrjes në luftime [sipas kuptimit të Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës] ka rëndësi themelore për të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe lidhet ngushtësisht me parimin e dallimit midis luftëtarëve dhe civilëve.”⁹¹ [Dhoma e Apelit] konkludoi se:

Për të vërtetuar nëse është kryer shkelje e Nenit të Përbashkët 3 bazuar në Nenin 3 të Statutit, një Dhomë Gjyqësore duhet të bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se viktimat e shkeljes së pretenduar nuk merrte pjesë në veprime luftarake të cilat për nga natyra ose qëllimi i tyre synojnë t’i shkaktojnë dëm efektivit apo pajisjeve të forcave të armatosura të armikut. Një analiza e tillë duhet bërë në bazë të rrethanave të çështjes, duke mbajtur parasysh rrethanat individuale të viktimës në kohën e shkeljes së pretenduar. Meqenëse kuadri kohor i pjesëmarrjes individuale në luftime mund të jetë me shkëputje dhe jo i vazhdueshëm, fakti nëse një viktimë ka marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e veprës penale varet nga lidhja midis veprimtarive të viktimës në kohën e veprës penale dhe të çdo veprimi luftarak që për nga vetë natyra apo qëllimi i tij synon t’i shkaktojë dëm konkret efektivit apo pajisjeve të palës kundërshtarë.⁹²

Lidhur me këtë, Dhoma e Apelit në çështjen *Strugar* gjithashtu theksoi se “mund të jetë e nevojshme që një Dhomë Gjyqësore të bindet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se shkelja e pretenduar e kryer kundër një viktime, ndryshe nuk ishte e ligjshme sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare”, dhe se në rast se viktimat ishin luftëtar, “lëndimi apo vdekja e tij nuk përbënin shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare, edhe në qoftë se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e shkeljes së pretenduar.”⁹³

35. Së fundi, theksoj se, në jurisprudencën e Tribunalit është pranuar shprehimisht se për vërtetimin e përgjegjësisë penale individuale të një të akuzuari për krimin e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, detyrimi i provës lidhur me statusin civil të viktimës i takon Prokurorisë.⁹⁴ Për mendimin tim kjo rregull përgjithësisht çon në pasojat vijuese: (i) kur është e

⁹⁰ KNKK, Shpjegues i Protokolleve Shtesë, para. 4789.

⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 174 (theksi i shtuar).

⁹² Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 178 (pa citimet e brendshme).

⁹³ Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 179 (pa citimet e brendshme; theksi i shtuar).

⁹⁴ Shih Aktgjykimi i Apelit *D. Millosheviq*, para. 60; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 48. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 522. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 178, ku Dhoma e

qartë se personi i vrarë ishte civil, duhet të vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes; (ii) kur ekziston dyshim nëse një person ishte civil ose luftëtar, apo pjesëtar i një grupi të organizuar të armatosur, Prokuroria duhet të provojë se personi në fjalë kishte dorëzuar armët dhe kishte bërë të qartë synimin e tij për t'u dorëzuar, apo se ai ishte jashtë luftimeve në kohën kur ishte vrarë.

36. Nuk kam dyshim se Dhoma Gjyqësore ishte në dijeni të ligjit përkatës.⁹⁵ Gjithsesi, mendoj se [Dhoma Gjyqësore] e zbatoi gabimisht ligjin në lidhje me incidentet e mëposhtme.

(c) Bellacërkë (komuna e Rahovecit)

37. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për vrasjen e Sedat Popajt, Irfan Popajt, Hajrulla Begajt, Hysni Zhuniqit, Mehdi Zhuniqit, dhe Agim Zhuniqit në zonën e Bellacërkës më 25 mars 1999.⁹⁶ Në apel, Gjorgjeviqi parashtron se për shkak se “e liroi Prokurorinë nga detyrimi për të vërtetuar statusin civil” të këtyre viktimave, Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli atë fajtor për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit lidhur me këtë ngjarje.⁹⁷ Shumica hedh poshtë kundërshtimet e Gjorgjeviqit.⁹⁸

38. Gjithsesi, prova bazë për këto vrasje ishte dëshmia e Dëshmitarit Sabri Popaj. Ai dëshmoi se më 25 mars 1999, pak pas vrasjes së një grupi civilësh tek ura e Belajës, forcat serbe vazhduan përgjatë përroit në drejtim të Celinës.⁹⁹ Pesë minuta më vonë, dëshmitari dëgjoi të shtëna të tjera që vinin nga drejtimi nga ishin nisur pjesëtarët e policisë, por nuk mund të shihte se çfarë po ndodhte.¹⁰⁰ Më 28 mars 1999, Dëshmitari Popaj gjeti kufomat e Sedat Popajt, Irfan Popajt, Hajrulla Begajt, Hysni Zhuniqit, Mehdi Zhuniqit, dhe Agim Zhuniqit në një kanal në afërsi të urës së Belajës.¹⁰¹ Dhoma Gjyqësore gjykoj se ky vend përputhej me vendin nga i cili Dëshmitari Popaj kishte dëgjuar të shtëna të tjera më 25 mars 1999 dhe konkludoi se këta gjashtë persona ishin vrarë nga forcat serbe.¹⁰² Dhoma Gjyqësore

Apelit gjykoj se në qoftë se ekziston dyshimi i arsyeshëm lidhur me ekzistencën e lidhjes midis viktimës dhe veprimeve të luftës, një i akuzuar nuk mund të shpallet fajtor sipas Nenit 3 të Statutit.

⁹⁵ Veçanërisht theksoj komentet e Dhomës Gjyqësore lidhur me ligjin përkatës në kontekst të vlerësimit të saj të përgjegjësisë së Gjorgjeviqit sipas NPK-së. Shih Aktgjykimi, para. 2054. Për më tepër, kur analizoi raste konkrete vrasjesh, Dhoma Gjyqësore shpesh konkludoi se viktimat përkatëse nuk merrnin pjesë aktive në luftime. Shih, p.sh., Aktgjykimi, para. 1715, 1721, 1723, 1739, 1745, 1751, 1790. Shih gjithashtu po aty, para. 1707, 2065.

⁹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 473, 1712.

⁹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 318.

⁹⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit, sh. 1726. Theksoj se, në dallim nga incidentet e tjera të shtjelluara më poshtë, Shumica trajton vrasjen e Sedat Popajt, Irfan Popajt, Hajrulla Begajt, Hysni Zhuniqit, Mehdi Zhuniqit, dhe Agim Zhuniqit në lidhje me pikën e dymbëdhjetë të apelit të Gjorgjeviqit. Megjithatë, unë mendoj se parashtrimet e Gjorgjeviqit në këtë pikë të apelit ndërthuren me Kapitullin XVII të Aktgjykimit të Apelit dhe rrjedhimisht duhen analizuar së bashku.

⁹⁹ Aktgjykimi, para. 470.

¹⁰⁰ Aktgjykimi, para. 470.

¹⁰¹ Aktgjykimi, para. 473. Megjithëse në këtë kontekst Dhoma Gjyqësore përmendi 26 marsin 1999 si datë të vrasjeve, me sa duket ngjarja faktikisht ndodhi një ditë më parë. Shih Aktgjykimi, para. 459-470.

¹⁰² Aktgjykimi, para. 473.

gjithashtu theksoi se nuk kishte prova që sugjeronin se viktimat ishin të armatosur, merrnin pjesë në luftime, apo ishin anëtarë të UÇK-së në kohën e vrasjes së tyre.¹⁰³

39. Theksoj se nuk ka prova se çfarë ishin duke bërë viktimat në kohën e vrasjes së tyre dhe në çfarë rrethanash vdiqën. Duke pasur parasysh këto fakte, mendoj se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm nga provat ishte se këta persona ishin civilë dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime, ose ishin jashtë luftimeve në kohën kur u sulmuan. Për këtë arsye, me respekt shpreh mospajtimin tim me vendimin e Shumicës për konfirmimin e fajësisë së Gjorgjeviqit për vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit lidhur me këtë incident.¹⁰⁴

(d) Krushë e Vogël (komuna e Rahovecit)

40. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin penalisht përgjegjës për vrasjen e Hysni Hajdarit, i cili vdiq gjatë sulmit të forcave serbe kundër Krushës së Vogël më 26 mars 1999.¹⁰⁵ Shumica hedh poshtë parashtrimet e Gjorgjeviqit se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se, lidhur me këtë incident ishte vërtetuar krimi i vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit, duke qenë se nuk pati prova të mjaftueshme për të konkluduar se Hysni Hajdari u vra nga forcat e MPB-së, dhe asnjë provë në lidhje me rrethanat e vdekjes së tij.¹⁰⁶ Nuk pajtohem me përfundimet e Shumicës për këto arsye.

41. Për nxjerrjen e konkluzionit se Hysni Hajdari u vra nga forcat e MPB-së, Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit Mehmet Krasniqi. Ky dëshmitar ishte ndër 114 burrat shqiptarë kosovarë të cilët më 26 mars 1999 u detyruan të hynin në hambarin e Batushës që ndodhej në periferi të Krushës së Vogël. Forcat serbe shtinë kundër hambarit dhe më pas i vunë zjarrin.¹⁰⁷ Dëshmitari Krasniqi arriti të dilte nga hambari dhe dëshmoi se u nis për në mal ku pa kufomën e Hysni Hajdarit, i cili gjithashtu, sipas dëshmitarit, kishte ikur nga hambari i Batushës.¹⁰⁸ Dëshmitari Krasniqi më tej tha se Hysni Hajdari kishte plagë nga armë zjarri.¹⁰⁹ Në bazë të kësaj dëshmie, Dhoma Gjyqësore konkludoi se, megjithëse kufoma e Hysni Hajdarit nuk u gjet kurrë, përfundimi i vetëm i arsyeshëm në këtë rast ishte se ai “vdiq nga plagë prej armëve të zjarrit të shkaktuara prej forcave të MPB-së gjatë kohës që kishte

¹⁰³ Aktgjykimi, para. 473, 1712.

¹⁰⁴ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, sh. 1726.

¹⁰⁵ Shih Aktgjykimi, para. 493, 1402, 1718.

¹⁰⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 757-762.

¹⁰⁷ Shih Aktgjykimi, para. 490, 493. Shih gjithashtu po aty, para. 1717.

¹⁰⁸ Aktgjykimi, para. 493. Shih gjithashtu po aty, para. 1718.

¹⁰⁹ Aktgjykimi, para. 493. Shih gjithashtu po aty, para. 1718.

qenë brenda në hambarin e Batushës, apo se ai u vra nga forcat e MPB-së në atë zonë gjatë kohës që po përpiquej të ikte nga hambari i Batushës pasi forcat e MPB-së i vunë zjarrin.”¹¹⁰

42. Meqenëse Dëshmitari Krasniqi thjesht u shpreh se fillimisht Hysni Hajdari u detyrua të hynte në hambarin e Batushës dhe se më pas ai pa kufomën e tij në male, nuk ka prova se saktësisht kush, ku, kur dhe si e vrau Hysni Hajdarin. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim nëse Hysni Hajdari i cili sipas listës së viktimave bashkëngjitur Aktgjykimit ishte 21 vjeç, do të thotë, i aftë për shërbimin ushtarak,¹¹¹ në kohën e vdekjes së tij ishte jashtë luftimeve apo civil që nuk merrte pjesë aktive në luftime. Në këto rrethana, mendoj se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se i vetmi përfundim i mundshëm nga dëshmia e Dëshmitarit Krasniqi ishte se Hysni Hajdari u vra nga forcat e MPB-së dhe se vrasja e tij përbënte vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe si krim kundër njerëzimit.¹¹²

(e) Operacioni Reka (komuna e Gjakovës)

43. Dhoma Gjyqësore konkludoi se Operacioni Reka u krye në luginën e Carragojit, Erenikut dhe Travës nga mëngjesi i 27 prillit deri në mbrëmjen e 28 prillit 1999.¹¹³ [Dhoma Gjyqësore] konkludoi se gjatë këtij operacioni, forcat serbe vranë jo më pak se 296 persona.¹¹⁴ Në këtë shifër u përfshinë 15 personat e identifikuar me emër nga dëshmitarë okularë si persona të vrarë më 27 prill 1999 në Mejë dhe Korenicë,¹¹⁵ dhe 281 shqiptarët kosovarë të cilët sipas të dhënave zyrtare, u zhdukën “nga Meja” më 27-28 prill 1999, dhe kufomat e tyre u zhvarrosën në vitin 2001 nga varret e përbashkëta në Qendrën e SAJ-it në Batajnicë, në Serbi.¹¹⁶

44. Në apel, Gjorgjeviqi kundërshton përfundimet e Dhomës Gjyqësore lidhur me 281 personat, kufomat e të cilëve u zhvarrosën nga varret e përbashkëta në Batajnicë.¹¹⁷ Unë nuk pajtohem me arsyetimin dhe vendimin e Shumicës për të hedhur poshtë parashtrimet e Gjorgjeviqit.¹¹⁸ Për mendimin tim, Shumica shpërfill faktin se nuk pati prova lidhur me rrethanat e vdekjes së këtyre personave. [Shumica] kryesisht përmend përfundimet nga Aktgjykimi lidhur me vrasjen e 15 viktimave të lartpërmendura,¹¹⁹ dhe vrasjen e personave të

¹¹⁰ Aktgjykimi, para. 493. Shih gjithashtu po aty, para. 1402, 1718.

¹¹¹ Shih Aktgjykimi, f. 893.

¹¹² Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 756-758.

¹¹³ Shih Aktgjykimi, para. 938, 950. Shih gjithashtu po aty, para. 1738.

¹¹⁴ Shih Aktgjykimi, para. 995, 1741.

¹¹⁵ Shih Aktgjykimi, para. 955-964, ku shtjellohet vrasja e pesë anëtarëve të familjeve Malaj dhe Kabashi në Korenicë, vrasja e nëntë anëtarëve të familjeve Dedaj dhe Markaj në Mejë, dhe vrasja e Kolë Duzhmanit në Mejë.

¹¹⁶ Shih Aktgjykimi, para. 990. Shih gjithashtu po aty, para. 992, 995, 1738.

¹¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 374, Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 122.

¹¹⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 770-772.

¹¹⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 770.

paarmatosur të përshkruar nga disa dëshmitarë gjatë gjykimit.¹²⁰ Megjithatë, siç u theksua më lart, përveç 15 personave të identifikuar me emër nga dëshmitarë okularë si persona të vrarë në Mejë dhe Korenicë më 27 prill 1999, në numrin e përgjithshëm të të vrarëve Dhoma Gjyqësore përfshiu edhe 281 personat e zhvarrosur nga varret e përbashkëta në Batajnicë.¹²¹ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore nuk nxori përfundim të prerë nëse personat e tjerë të paidentifikuar vrasjen e të cilëve e panë dëshmitarë gjatë operacionit Reka, ishin ndër 281 personat e zhvarrosur nga varret e përbashkëta në Batajnicë.¹²²

45. Theksoj përfundimin e Dhomës Gjyqësore se gjatë Operacionit Reka, forcat serbe vranë të 281 personat e zhvarrosur nga varret e përbashkëta në Batajnicë, e cila arsyetoi se ky ishte deduksioni i vetëm i arsyeshëm “bazuar në dëshmitë e qarta dhe të gjithanshme për ngjarjet në zonë ato ditë, në faktin se këto kufoma u varrosën të gjithë në varre të përbashkëta në qendrën e SAJ-it në Batajnicë dhe se, aty ku mund të përcaktohej [...], të gjithë ata ishin vrarë me armë zjarri”.¹²³ Dhoma Gjyqësore më tej theksoi se, “aty ku mund të përcaktohej”, viktimat ishin me tesha civile.¹²⁴ Gjetkë në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore theksoi se nuk kishte prova se ndonjëri nga shqiptarët kosovarë të vrarë gjatë Operacionit Reka ishte “i armatosur në atë kohë apo se merrte pjesë aktive në luftime” dhe se “në fakt, nuk ka prova mbi luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së në atë zonë, në kohën e këtyre ngjarjeve.”¹²⁵

¹²⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 770-711, përmendet Aktgjykimi, para. 967-979, 985-995, 1738. Theksoj se këta paragrafë të Aktgjykimit i referohen konkretisht: (i) dëshmisë së Dëshmitarit K90 se më 27 prill 1999, ai pa: (a) forcat serbe teksa po çonin të paktën tre apo katër grupe burrash shqiptarë kosovarë nga fshatrat në zonën e Korenicës, secili prej tyre me nga pesë në më shumë se dhjetë persona, tek oborri i shtëpive ku kishte forca të PJP-së, dhe aty i qëlluan me armë zjarri (po aty, para. 967); (b) të paktën katër kufoma përgjatë rrugës në hyrje të Korenicës (po aty, para. 968); dhe (c) një grup prej rreth tetë deri në dhjetë meshkujsh që shoqëroheshin nga policë prej Mejës drejt një oborri ku u qëlluan me armë zjarri (po aty, para Aktgjykimi, para. 969); (ii) dëshminë e Dëshmitarit Nikë Peraj se më 27 prill 1999, ai: (a) pa katër kufoma në bar pas nevojtove të shkollës përballë postbllokut në Mejë (Shih po aty, para. 970); (b) dëgjoi nga familjet shqiptare kosovare për të vrarët në afërsi të shtëpisë së Hasanajve në Mejë dhe pak më pas gjeti kufomat e 20 burrave të vdekur që dergjeshin në një lëndinë në afërsi të kësaj shtëpie (Shih po aty, para. 970, 971); dhe (c) rrugës për në fshatin Madanaj, ai pa kufomat e njëmbëdhjetë burrave të vdekur, rreth 600 metra larg lëndinës së Shyt Hasanajt, dhe një kufomë që dergjej në afërsi të shtëpisë së kunatit të Perajt (Shih po aty, para. 973); (iii) dëshmisë së Dëshmitarit K73 se PJP-ja vrau katër civilë shqiptarë të zënë nga UJ-ja (Shih po aty, para. 975-976); dhe (iv) dëshmisë së Dëshmitarit Martin Pnishi se shtatë të rinj shqiptarë u rreshtuan dhe u ekzekutuan nga forcat serbe në anën e urës së Travës ku ndodhej Meja më 27 prill 1999 (Shih po aty, para. 986; Shih gjithashtu po aty, para. 966). Theksoj se numri i gjithsejtë i viktimave të këtyre incidenteve ishte të paktën rreth 70 deri në 97.

¹²¹ Aktgjykimi, para. 990, 992, 995.

¹²² Shih Aktgjykimi, para. 967-979, 985-995, 1738. Veçanërisht theksoj se Aktgjykimi përfshin një listë me emrat e 281 personave kufomat e të cilëve u zhvarrosën në Batajnicë në vitin 2001, dhe se lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore theksoi se, përveç përfundimeve të veta për vrasjet konkrete të diskutuara më sipër, ajo u bind se personat nga lista u vranë gjatë Operacionit Reka. Shih Aktgjykimi, para. 992. Njëkohësisht, Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjatë Operacionit Reka, forcat serbe vranë 296 njerëz, dhe theksoi se provat nuk i mundësonin që të konkludonte se edhe 48 viktimat e tjera, të evidentuara në Shtojcën H të Aktakuzës, u vranë në të njëjtën kohë. Shih Aktgjykimi, para. 995, 1740-1741. Kujtoj se numri i gjithsejtë i viktimave nga incidentet e përshkruara në paragrafët 967-979, 986 të Aktgjykimit, arrinte në rreth të paktën 70 deri në 97 njerëz.

¹²³ Shih Aktgjykimi, para. 991.

¹²⁴ Aktgjykimi, para. 990

¹²⁵ Aktgjykimi, para. 1739.

46. Me respekt shpreh mospajtimin tim me këtë arsytim. Formulimi i përgjithshëm “ngjarjet në zonë ato ditë” që përdor Dhoma Gjyqësore për mendimin tim është tejet i vagullt për të konkluduar në mënyrë të arsyeshme se të gjithë viktimat e zhvarrosura nga varret e përbashkëta në Batajnicë u vranë nga forcat serbe, dhe të gjithë ishin civilë dhe nuk merrnin pjesë aktive në luftime, apo ishin jashtë luftimeve në kohën kur u vranë. Një përfundim i tillë nuk mund të ishte logjikisht as rrjedhojë e faktit se kufomat u varrosën në varre të përbashkëta në Batajnicë, apo se disa nga viktimat vdiqën nga plagë të shkaktuara me armë zjarri. Për më tepër, theksoj se, me përjashtim të dy personave, kufomat e gjetura në vendin e varreve të përbashkëta në Batajnicë ishin kufoma meshkujsh të moshave të ndryshme, dhe shkaku i vdekjes u përcaktua vetëm për 172 nga 281 viktimat e zhvarrosura.¹²⁶ Dhoma Gjyqësore gjithashtu pranoi se gjatë operacionit Reka, njërive të UJ-së u ishte thënë se pjesëtarë të UÇK-së kishin hedhur armët dhe uniformat dhe fshiheshin midis popullsisë civile, të veshur me tesha civile.¹²⁷ [Dhoma Gjyqësore] pranoi edhe se UÇK-ja e përdori këtë metodë gjatë gjithë konfliktit në Kosovë.¹²⁸ Në këto rrethana, mendoj se Dhoma Gjyqësore u bazua pa arsye në faktin që disa nga kufomat e gjetura në vendin e varreve të përbashkëta në Batajnicë ishin të veshur me tesha civile, si provë se ata ishin civilë.¹²⁹ Po kështu, mendoj se nuk është vendimtar as fakti nëse viktimat ishin të armatosur apo nëse kishte luftime me UÇK-në në kohën e Operacionit Reka.

47. Për këto arsye, mendoj se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se lidhur me 281 personat e zhvarrosur nga vendi i varreve të përbashkëta në Batajnicë ishte vërtetuar vrasja si krim lufte dhe krim kundër njerëzimit.

(f) Komuna e Vushtrrisë

48. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 2 maj 1999, forcat serbe vranë Hysni Bunjakun, Haki Gërxxhaliun, Miran Xhafën, dhe Veli Xhafën, ndërsa po udhëtonin në një kolonë shqiptarësh kosovarë nga Sllakoci në drejtim të qytetit të Vushtrrisë.¹³⁰ Gjorgjeviqi parashtron se në kolonë kishte pjesëtarë të UÇK-së dhe se provat nuk vërtetuan se katër të vrarët u

¹²⁶ Aktgjykimi, para. 990. Shih gjithashtu po aty, para. 1738.

¹²⁷ Aktgjykimi, para. 944.

¹²⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1562, 2065.

¹²⁹ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 771. Theksoj se gjetkë, Shumica konstaton se “Dhoma e Apelit më herët ka pranuar se një dhomë gjyqësore mund të mbështetet në teshat e viktimës për të konkluduar se viktima nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes.” Shih Aktgjykimi i Apelit, sh. 1737, përmendet Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 81. Megjithatë, për mendimin tim, kjo referencë është e pavend, meqenëse lidhur me incidentin që diskutohet këtu, Dhoma e Apelit gjithashtu pranoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se viktima nuk ishte anëtar i një grupi të organizuar (UÇK /Ushtria Çlirimtare Kombëtare/). Shih Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçullovski*, para. 81.

¹³⁰ Shih Aktgjykimi, para. 1180, 1184-1185, 1191-1192, 1197, 1742.

ndaluan, duke lënë kështu të hapur mundësinë për konkluzionin se ata u sulmuan në mënyrë të ligjshme.¹³¹

49. Në lidhje me Xhafën, vërej se Dhoma Gjyqësore theksoi kalimthi se gjatë kohës që kolona po ecte, “një dëshmitare pa shtatë apo tetë kufoma” dhe se “ndër ta, ajo njohu kushëririn e saj, Veli Xhafën, i cili dergjej i vdekur në traktorin e tij”.¹³² Në mungesë të provave lidhur me rrethanat e vdekjes së Veli Xhafës, mendoj se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se vrasja e tij përbënte vrasje si krim lufte dhe krim kundër njerëzimit dhe mund t’i atribuohet Gjorgjeviqit. Rrjedhimisht, nuk pajtohem me përfundimin e kundërt të Shumicës.¹³³

2. Shkatërrimi i xhamisë në Landovicë (Përndjekje)

50. Dhoma Gjyqësore e shpalli Gjorgjeviqin penalisht përgjegjës për përndjekje përmes shkatërrimit apo dëmtimit të objekteve me vlerë fetare ose kulturore si krim kundër njerëzimit, ndër të tjera, lidhur me xhaminë në Landovicë (komuna e Prizrenit).¹³⁴ Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 26 mars 1999, forcat serbe i vunë zjarrin pjesës së brendshme të xhamisë dhe më 27 mars 1999 shkaktuan shkatërrim të ndjeshëm në minaren dhe strukturën e brendshme të xhamisë me anë të lëndëve shpërthyesë.¹³⁵ Në mbështetje të këtij përfundimi, Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshminë e Dëshmitarit Halil Morina, e cila u mor në bazë të Rregullës 92^{quater} të Rregullores, dhe në dëshminë e Dëshmitarit Andrés Riedlmayer.¹³⁶

51. Në apel, Gjorgjeviqi kryesisht parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u mbështet vetëm në dëshminë e Dëshmitarit Morina për nxjerrjen e konkluzionit se shkatërrimin e xhamisë në Landovicë e shkaktuan forcat serbe.¹³⁷ Shumica në fund hodhi poshtë kundërshtimin e Gjorgjeviqit.¹³⁸ Nuk pajtohem me këtë vendim për arsyt e mëposhtme.

52. Në rrethana të caktuara, Rregulla 92 ^{quater} e Rregullores lejon pranimin e dëshmisë së një dëshmitari në formë të një deklarate me shkrim apo transkripti, në qoftë se dëshmitari nuk është në dispozicion për të dëshmuar në gjykatë. Jurisprudenca e Tribunalit ka konfirmuar se dëshmi thelbësore të pranuar në bazë të Rregullës 92 ^{quater} të Rregullores mund të përdoren në mbështetje të verdiktit të fajësisë vetëm kur ato konfirmohen nga dëshmi të tjera.¹³⁹

¹³¹ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 375; Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 123.

¹³² Aktgjykimi, para. 1192.

¹³³ Krahaso Aktgjykimi i Apelit, para. 767-777.

¹³⁴ Aktgjykimi, para. 1819, 2030.

¹³⁵ Aktgjykimi, para. 1819.

¹³⁶ Shih Aktgjykimi, para. 1817-1819.

¹³⁷ Shih Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, para. 347(i), 377(b); Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit, para. 127.

Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 804, 806.

¹³⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 807-809.

¹³⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 570 me referencat plotësuese.

Dëshmitë lidhur me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit apo të vartësve të drejtëpërdrejtë të tij pa dyshim që janë dëshmi thelbësore.¹⁴⁰

53. Theksoj se dëshmia e Dëshmitarit Morina në bazë të Rregullës 92 *quater* është e prova e vetme që përmendet në Aktgjykim e cila në mënyrë të drejtëpërdrejtë implikon forcat serbe në shkatërrimin e xhamisë në Landovicë.¹⁴¹ Nga ana tjetër, Dëshmitari Riedlmayer thjesht raportoi konstatimet e tij në lidhje me dëmtimet e pësuar nga xhamia.¹⁴² Shumica pajtohet se: (i) verdikti i fajësisë nuk mund të mbështetet vetëm apo në një masë përcaktuese në dëshminë e marrë bazuar në Rregullën 92 *quater*, meqenëse të akuzuarit duhet t'i mundësohet marrja në pyetje e dëshmitarit që jep dëshminë kyçe;¹⁴³ (ii) dëshmia e Dëshmitarit Morina në bazë të Rregullës 92 *quater* ishte “element thelbësor i tezës së Prokurorisë dhe hallka kyçe që provonte përgjegjësinë penale të Gjorgjeviqit në shkatërrimin e xhamisë së Landovicës nga forcat serbe”;¹⁴⁴ dhe (iii) dëshmia e Dëshmitarit Riedlmayer “nuk konfirmon drejtpërsëdrejti” dëshminë e Dëshmitarit Morina se xhaminë në Landovicë e shkatërruan forcat serbe.¹⁴⁵ Megjithatë, Dhoma e Apelit i referohet përfundimit të Dhomës Gjyqësore gjetkë në Aktgjykim se “duke filluar nga marsi 1999, forcat serbe sulmuan sipas një praktike të përsëritur, duke hyrë nëpër qytete dhe fshatra në këmbë, dhe duke u vënë zjarrin shtëpive dhe plaçkitur gjërat me vlerë” në Kosovë, dhe se “e njëjta praktikë u përsërit edhe gjatë ditëve në vijim, më 26 mars 1999 në Landovicë”.¹⁴⁶ Mbi këtë bazë, Shumica gjykon se verdikti i fajësisë së Gjorgjeviqit për krimin e përndjekjes përmes shkatërrimit të xhamisë në Landovicë mbështetet edhe nga prova të tjera, dhe se përfundimi i Dhomës Gjyqësore lidhur me këtë pikë “nuk mbështetet vetëm apo kryesisht në dëshminë e Morinës të marrë në bazë të Rregullës 92*quater*”.¹⁴⁷

54. Për mendimin tim, Shumica shpërfill faktin se askund në Aktgjykim nuk del qartë se Dhoma Gjyqësore u mbështet në praktikën e përsëritur të sulmeve të forcave serbe gjithandej në Kosovë apo konkretisht në Landovicë në atë kohë, për të përcaktuar nëse dëshmia e Dëshmitarit Morina në bazë të Rregullës 92 *quater* konfirmohej mjaftueshëmrisht nga prova të tjera. Përkundrazi, lidhur me këtë Dhoma Gjyqësore gjykoi se “lloji dhe mënyra e shkaktimit të dëmtimit të xhamisë, siç është sugjeruar nga Andrés Riedlmayer-i, përputhen në aspektet juridikisht thelbësore me vëzhgimet e dëshmitarit dhe shërbejnë si konfirmim i pavarur i dëshmisë së tij.”¹⁴⁸

¹⁴⁰ Shih Vendimi i Apelit *Galiq* lidhur me Rregullën 92 bis(C), i datës 7 qershor 2002, para. 13, 15-16.

¹⁴¹ Shih Aktgjykimi, para. 1817.

¹⁴² Shih Aktgjykimi, para. 1818.

¹⁴³ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 807.

¹⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 808.

¹⁴⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 808.

¹⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 808, përmendet Aktgjykimin para. 2027.

¹⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 808.

¹⁴⁸ Shih Aktgjykimi, para. 1819 (theksi i shtuar).

55. Gjithsesi, siç u shpjegua më lart dhe siç pranoi Shumica, Dëshmitari Riedlmayer nuk i implikoi forcat serbe në shkatërrimin e xhamisë në Landovicë. Për këtë arsye mendoj se Dhoma Gjyqësore nuk pati një arsye për të konkluduar se dëshmia e Dëshmitarit Morina e marrë në bazë të Rregullës 92 *quater* ishte konfirmuar mjaftueshëm nga prova të tjera për vërtetimin e fajësisë së Gjorgjeviqit për këtë ngjarje. Duke qenë se Dëshmitari Morina nuk erdhi për të dëshmuar në gjyq, Gjorgjeviqi nuk pati mundësinë që të verifikonte akuzën kyçe se xhamia u shkatërrua nga forcat serbe. Marrja në pyetje e Dëshmitarit Riedlmayer lidhur me këtë çështje nuk do të kishte vlerë meqë ky dëshmitar nuk ishte në gjendje të komentonte lidhur me identitetin e keqbërësve.

56. Për më tepër, nuk e kam të qartë se si përmes marrjes në pyetje të dëshmitarit, Gjorgjeviqi do të mund të rrëzonte lidhjen midis provave të përgjithshme rrethore lidhur me praktikën e përsëritur të sulmeve të forcave serbe në zonë në atë kohë dhe shkatërrimit konkret të xhamisë në Landovicë. Rrjedhimisht, mendoj se prova të tilla të përgjithshme nuk mund të shërbejnë si prova konfirmuese për dëshmi kyçe të marra në bazë të Rregullës 92 *quater*. Rrjedhimisht, mendoj se duke u bazuar në prova të tilla, Shumica anashkaloj të drejtën themelore të Gjorgjeviqit për të marrë në pyetje dëshmitarë lidhur me aspekte thelbësore të akuzave kundër tij.¹⁴⁹

57. Për arsyet e lartpërmendura, gjykoj se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për shkatërrimin e xhamisë në Landovicë dhe nuk pajtohem me mendimin e Shumicës për lënien në fuqi të fajësisë së tij.

D. Përgjegjësia penale e Gjorgjeviqit për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale

58. Në Aktakuzë, Gjorgjeviqi akuzohet për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit të kryer në disa vende në Kosovë më 1999.¹⁵⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitarja K14 dhe Dëshmitarja K20 u përdhunuan nga forcat serbe në Prishtinë dhe Beleg.¹⁵¹ Megjithatë, Dhoma Gjyqësore gjykoi se nuk ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se autorët fizikë të këtyre krimeve vepruan me synimin e nevojshëm diskriminues që do të përmbushte elementët e krimit të përndjekjes.¹⁵² Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për të konkluduar se një vajzë shqiptare kosovare e cila udhëtonte së bashku me persona të tjerë të zhvendosur në një kolonë drejt

¹⁴⁹ Krahaso Vendimi i Apelit *Galiq* lidhur me Rregullën 92 bis(C) i datës 7 qershor 2002, para. 13. Theksoj se Dhoma e Apelit pranoi mbështetjen e Dhomës Gjyqësore në prova thelbësore bazuar në Rregullën 92 *quater* vetëm atëherë kur provat në fjalë u konfirmuan nga dëshmitarë të cilët dëshmuuan në gjyq dhe u morën në pyetje nga i akuzuari. Shih Aktgjykimi i Apelit *Llukiq dhe Llukiq*, para. 570; Vendimi i Apelit *Galiq* lidhur me Rregullën 92 bis(C) i datës 7 qershor 2002, para. 18-20.

¹⁵⁰ Aktakuza, para. 77(c). Shih gjithashtu po aty, para. 27, 72.

¹⁵¹ Aktgjykimi, para. 1791, 1793. Shih gjithashtu po aty, para. 833-836, 1151.

¹⁵² Aktgjykimi, para. 1796.

Prishtinës, dhe dy femra të tjera shqiptare kosovare në Beleg pësuan dhunë seksuale nga forcat serbe.¹⁵³ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit.¹⁵⁴

59. Prokuroria i apeloj këto përfundime me arsyetimin se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se pesë viktimat e lartpërmendura pësuan dhunë seksuale nga forcat serbe, se këto krime u kryen me synim diskriminues dhe ishin të parashikueshme për Gjorgjeviqin, dhe rrjedhimisht duhej të shpallej fajësi në bazë të kategorisë III të NPK-së.¹⁵⁵ Shumica e miratoi këtë pikë të apelit të Prokurorisë dhe e shpalli Gjorgjeviqin fajtor për përndjekje nëpërmjet dhunës seksuale në bazë të kategorisë III të NPK-së lidhur me të pesë viktimat.¹⁵⁶ Për disa arsye, me respekt shpreh mospajtim me këtë vendim të Shumicës.

60. Fillimisht, nuk pajtohem me arsyetimin dhe përfundimin e Shumicës se u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se autorët fizikë të të pesë akteve të dhunës seksuale vepruan me synim diskriminues.¹⁵⁷ Lidhur me këtë, Shumica kryesisht mbështetet në faktin se në atë kohë ekzistonte një NPK, e cila kishte “synimin e përbashkët diskriminues të ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës për të garantuar kontrollin serb mbi krahinën,” dhe për këtë qëllim, forcat serbe kryen fushatë terrori dhe dhunë të skajshme kundër popullatës shqiptare kosovare, e cila përfshinte, ndër të tjera, përndjekjen, dhe synonte largimin me dhunë të shqiptarëve kosovarë nga krahina.¹⁵⁸ Mirëpo, sipas mendimit tim, këto konstatime kanë të bëjnë më shumë me natyrën e përgjithshme diskriminuese të sulmeve kundër popullatës shqiptare në atë kohë, dhe theksoj se është pranuar se synimi diskriminues në lidhje me një krim konkret nuk mund të deduktohet drejtpërsëdrejti nga rrethana të tilla të përgjithshme.¹⁵⁹

¹⁵³ Aktgjykimi, para. 1792, 1794.

¹⁵⁴ Aktgjykimi, para. 2230.

¹⁵⁵ Shih Dosja e Apelit të Prokurorisë, para. 1-56.

¹⁵⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 870-929.

¹⁵⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 881-903. Theksoj se lidhur me përdhunimin e Dëshmitares K14 dhe Dëshmitares K20, Shumica konkludon se Dhoma Gjyqësore zbatoi gabimisht ligjin kur konkludoi se nuk iu paraqitën “prova konkrete” që do të vërtetonin se autorët fizikë të këtyre krimeve vepruan me synim diskriminues, dhe se lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi “rrethanat” e krimeve dhe “kontekstin më të gjerë” në të cilin ato u kryen. Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 877, përmendet Aktgjykimi, para. 1796. Për mendimin tim, deklarata e Dhomës Gjyqësore se “për asnjë nga dy incidentet nuk janë paraqitur prova që vërtetojnë se keqbërësit vepruan me synimin për të diskriminuar” (Shih Aktgjykimi, para. 1796) nuk tregon se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh faktorët rrethorë mbi të cilët mbështetet Shumica. Për më tepër, mendoj se edhe sikur të supozohej se Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh sa duhej provat rrethore, unë nuk kuptoj se për çfarë arsye ky mund të përbëjë një gabim tjetër, përveçse një gabim faktik, i cili prapëseprapë e detyron Dhomën e Apelit që në një farë mase t’u japë përparësi konkluzioneve kryesore të Dhomës Gjyqësore. Duke konkluduar se është bërë gabim ligjor, Shumica në mënyrë oportune i jep vetes kompetencën e një gjykuesi faktesh për të përcaktuar nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se krimet u kryen me synim diskriminues. Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 878.

¹⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 888. Shih gjithashtu *po aty*, para. 891, 895, 897.

¹⁵⁹ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka*, para. 366; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit, para. 886.

61. Shumica gjykon se ekzistojnë rrethana të tjera konkrete të cilat mundësojnë përfundimin e vetëm të arsyeshëm se që të pesë viktimat pësuan dhunë seksuale për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Lidhur me Dëshmitaren K20 dhe dy femrat e tjera të përdhunara në Beleg, Shumica gjykon se ato ishin në duart e forcave serbe në kohën e përdhunimit dhe se autorët e dhunës seksuale kundër tyre ishin pjesëtarë të forcave serbe të cilët gjithashtu po kryenin fushatën e përgjithshme të zhvendosjes së dhunshme të popullatës shqiptare kosovare, dhe se krimet ndodhën para shpërnguljes së dhunshme të Dëshmitares K20 dhe dy femrave të tjera.¹⁶⁰ Për më tepër, Shumica merr parasysh disa komente të bëra para dhe pas dhunës seksuale nga ana e “pjesëtarëve të forcave serbe”, “ushtarëve”, dhe policit që bënte roje para derës në kohën kur Dëshmitarja K14 u përdhunua.¹⁶¹ Lidhur me dëshmitaren K14, Shumica thekson se kjo viktimë ishte shqiptare kosovare dhe u përdhunua nga persona “në pozitë pushteti” të cilët ishin pjesëtarë të forcave serbe që kryen sulmin e përgjithshëm kundër popullatës shqiptare kosovare në atë kohë.¹⁶² Në lidhje me vajzën nga kolona, arsyetimi i Shumicës në thelb mbështetet në faktin se ajo pësoi dhunë seksuale ndërsa ajo dhe shqiptarë kosovarë të tjerë po përpiqeshin të shpëtonin jetën e tyre dhe po udhëtonin në kolonë përgjatë një rruge, nga të dyja anët e së cilës kishte forca serbe.¹⁶³

62. Vërej se Shumica vazhdimisht i referohet përkatësisë etnike të viktimave dhe keqbërësve. Në fakt, lidhur me Dëshmitaren K14 dhe vajzën nga kolona, duket se Shumica kryesisht mbështetet në faktorë të tillë si edhe në rrethanat e përgjithshme të sulmit të gjithandejmë kundër popullatës shqiptare kosovare në atë kohë. Gjithsesi, po të ndiqej kjo mënyrë arsyetimi, çdo krim i kryer gjatë një sulmi të përgjithshëm kundër një popullate automatikisht do të mund të konsiderohej përndjekje.¹⁶⁴ Në lidhje me Dëshmitaren K20 dhe dy femrat e tjera në Beleg, unë nuk dyshoj aspak se komentet që përmend Shumica ishin diskriminuese. Megjithatë, theksoj se nuk ka asnjë provë se personat që kryen dhunë seksuale kundër këtyre viktimave bënë komente të ngjashme. Gjithashtu, unë nuk jam plotësisht i bindur nga rëndësia që Shumica i kushton faktit të ndalimit dhe mbajtjes së viktimave. Në këtë kontekst, Shumica i referohet jurisprudencës¹⁶⁵ lidhur me krimet e mbajtjes së paligjshme ose çnjerëzore,¹⁶⁶ apo përmend rrethana të tjera që me gjasë provojnë se ndaj të ndaluarve u kryen

¹⁶⁰ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 890-891, 893.

¹⁶¹ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 890. Shih gjithashtu Aktgjykimi, para. 1146.

¹⁶² Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 895.

¹⁶³ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 897.

¹⁶⁴ Theksoj se Dhoma Gjyqësore mori parasysh qartësisht përkatësinë etnike të Dëshmitareve K20 dhe K14 dhe faktin që autorët e dhunës seksuale kundër tyre ishin pjesëtarë të forcave serbe, por konkludoi se ky fakt në vetvete dhe si i tillë nuk vërtetonte se këto krime u kryen me synimin e përndjekjes. Shih Aktgjykimi, para. 1796.

¹⁶⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 886, sh. 2625.

¹⁶⁶ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 950; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët*, para. 462-463.

krime për arsye diskriminuese.¹⁶⁷ Kjo jurisprudencë jodomosdoshmërisht tregon se krimet e kryera kundër një personi të ndaluar përbëjnë përndjekje, edhe në qoftë se vetë ndalimi ishte pasojë e diskriminimit.

63. Së dyti, dhe më me rëndësi, nuk pajtohem me mendimin e Shumicës se pesë rastet e dhunës seksuale mund t'i ngarkohen Gjorgjeviqit në bazë të kategorisë III të NPK-së. para së gjithash, Shumica pranon se keqbërësit nuk ishin anëtarë të NPK-së.¹⁶⁸ Mirëpo, në vend që të bënte një analizë në varësi të rrethanave të çështjes nëse kishte lidhje midis keqbërësve dhe Gjorgjeviqit apo ndonjë anëtari tjetër të NPK-së,¹⁶⁹ Shumica thjesht mjaftohet me formulimin se “forcat serbe u përdorën nga anëtarët e NPK-së” për kryerjen e veprimit të fajshëm të krimeve në kuadër të qëllimit të përbashkët, dhe se “po këto forca” kryen dhunë seksuale kundër Dëshmitares K14 dhe Dëshmitares K20, dhe dy femrave të tjera në Beleg.¹⁷⁰ Lidhur me vajzën nga kolona, Shumica konstaton se identiteti i njërit prej keqbërësve është i paqartë, por gjykon se “identiteti i tij nuk është aq i rëndësishëm” meqenëse keqbërësi tjetër ishte “polic, pra pjesëtar i forcave serbe”.¹⁷¹ Për mendimin tim, deklarata të tilla përgjithëse janë të pamjaftueshme për të vërtetuar se ekzistonte lidhja e nevojshme midis autorëve të dhunës seksuale në këto pesë raste dhe një anëtari të NPK-së.¹⁷²

64. Për më tepër, nuk më bind vlerësimi i Shumicës lidhur me parashikueshmërinë e dhunës seksuale. Lidhur me krime të kryera nga joanëtarë të NPK-së, duhet të vërtetohet se për të akuzuarin ishte e parashikueshme se “një krim i tillë mund të kryhej nga një apo më shumë persona të përdorur nga ai vetë (apo nga ndonjë anëtar tjetër i NPK-së) me qëllim realizimin e veprimit të fajshëm të krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët”, dhe se ai me vullnet të lirë mori këtë rrezik.¹⁷³ Për mendimin tim, Shumica nuk i përmbahet këtij standardi. Si bazë për nxjerrjen e përfundimit se për Gjorgjeviqin ishte e parashikueshme se “mund të kryheshin krime të natyrës seksuale”, Shumica ndërthur në mënyrë jo të përpiktë një numër faktesh të

¹⁶⁷ Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 186, ku Dhoma e Apelit konkludoi se megjithëse në objektin e burgimit kishte si të burgosur serbë, po ashtu edhe të burgosur joserbë, u rrahën vetëm ata që ishin joserbë. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykoj se në këtë kontekst, rrethanat që mund të merren parasysh gjatë deduktimit të synimit diskriminues të krimeve të kryera gjatë burgimit “përfshijnë mënyrën e funksionimit të burgut (veçanërisht natyrën sistematike të krimeve të kryera kundër një grupi racor ose fetar) dhe qëndrimin e përgjithshëm të autorit të pretenduar të krimit, ashtu siç shihet nga sjellja e tij.” Shih Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184. Ngjashëm, Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinović*, para. 572.

¹⁶⁸ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 911-913, 927.

¹⁶⁹ Krahaso Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 236; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413.

¹⁷⁰ Aktgjykimi i Apelit, para. 927.

¹⁷¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 927.

¹⁷² Si shembull të një analize të hollësishme të këtij kushti të bërë rast pas rasti, shih Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*, para. 239-282; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 174-212. Veçanërisht theksoj se në *Martiq*, Dhoma e Apelit shfuqizoi verdiktin e fajësisë së Apellesit për sjelljen kriminale të personave ose ushtarëve të panjohur serbë të armatosur, me arsyetimin se “prejardhja e këtyre burrave dhe përkatësia e tyre mbetet e paqartë” dhe se “pa një shqyrtim të mëtejshëm të përkatësisë së këtyre burrave të armatosur, asnjë gjykes i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të gjykonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirrej nga rrethanat ishte se këto krime mund t'i atribuoheshin një anëtari të NPK-së.” Shih Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 200.

¹⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 411.

përgjithshme lidhur kontekstin më të gjerë të konfliktit në Kosovë dhe pozitën e Gjorgjeviqit brenda MPB-së.¹⁷⁴

65. Rrjedhimisht, Shumica përmend, ndër të tjera, përfundimin e Dhomës Gjyqësore se, si njëri nga zyrtarët më të lartë të MPB-së, Gjorgjeviqi ishte i informuar në hollësi për ngjarjet në terren dhe luajti rol kyç në koordinimin e veprimtarisë së forcave të MPB-së në Kosovë më 1998 dhe 1999.¹⁷⁵ Ajo konkludon se, nëpërmjet rolit dhe përfshirjes së tij në operacionet në Kosovë, Gjorgjeviqi ishte i informuar në hollësi për kryerjen e operacioneve, situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, dhe kryerjen e krimeve të rënda nga ana e forcave serbe, ndër të cilat plaçkitje, zjarrvënie, përdorim i forcës së tepruar, dhe vrasje.¹⁷⁶ Shumica gjithashtu thekson se Gjorgjeviqi kishte synimin e NPK-së, qëllimi i përbashkët i së cilës ishte ndryshimi i përbërjes etnike të Kosovës nëpërmjet krijimit të një atmosfere terrori dhe frike ndër popullatën shqiptare kosovare, dhe se ai ishte në dijeni të shpërnguljes masive të shqiptarëve kosovarë.¹⁷⁷ Së fundi, Shumica thekson se shqiptarët kosovarë u shpërngulën me dhunë dhe u keqtrajtuuan gjerësisht nga forcat serbe të cilat vepronin thuajse pa frikë nga ndëshkimi, dhe se gratë shpesh ndaheshin nga burrat, që i bënte ato veçanërisht të pambrojtura, dhe konkludon se, “në rrethana të tilla, mundësia e kryerjes së dhunës seksuale ishte thelbësore në atë masë sa e bënte të parashikueshme për Gjorgjeviqin”.¹⁷⁸

66. Megjithatë, në Aktgjykim nuk përmendet asnjë provë se Gjorgjeviqi mori informacion lidhur me dhunën seksuale gjatë apo para periudhës së Aktakuzës, që të paktën do ta kishte paralajmëruar për tendencën e disa pjesëtarëve të forcave serbe për kryer krime seksuale. Ndonëse Shumica përmend dijeninë e Gjorgjeviqit për plaçkitjet, zjarrvëniet, përdorimin e forcës së tepruar dhe vrasjet e kryera nga forcat serbe në Kosovë, nuk jam i bindur se parashikueshmëria e dhunës seksuale mund të deduktohet logjikisht nga këto lloje të tjera të veçanta krimesh. Për më tepër, Shumica nuk tregon prova se Gjorgjeviqi ishte në dijeni të faktorëve që i bënin gratë shqiptare kosovare veçanërisht të pambrojtura në atë kohë. Po kështu, nuk më bind as mbështetja e Shumicës në qëllimin e përbashkët dhe synimin e Gjorgjeviqit lidhur me këtë pikë. Këta faktorë në vetvete nuk mund të vërtetojnë se ishte e parashikueshme për Gjorgjeviqin dhe se ai me vetëdije mori rrezikun që pjesëtarë të NPK-së, apo persona të përdorur prej tyre për kryerjen e krimeve që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët, mund të kryenin edhe dhunë seksuale përndjekëse.

¹⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 926.

¹⁷⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit, para. 923.

¹⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 924.

¹⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 925.

¹⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 926.

67. Si përfundim, rezulton se Shumica vlerëson nëse dhuna seksuale si kategori krimi ishte përgjithësisht e parashikueshme gjatë konfliktit në Kosovë, dhe mbi këtë bazë shpall Gjorgjeviqin fajtor për pesë rastet konkrete të dhunës seksuale. Për mendimin tim, ky përfundim është problematik përse i përket parimit të individualizimit të fajësisë. Unë gjithashtu ngre një pikëpyetje në lidhje me problemin se a do të mund të mbrohej Gjorgjeviqi me sukses kundër përgjithësimeve të këtilla dhe nëse Shumica bën dallimin midis krimeve që ishin të parashikueshme për Gjorgjeviqin dhe atyre që nuk ishin të parashikueshme për të.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht, ku teksti në anglisht ka përparësi.

Gjykatës Bakhtiyar Tuzmukhamedov

Sot, më 27 janar 2014,
në Hagë, Holandë.

[Vula e Tribunalit]

XXIV. SHTOJCA A – HISTORIA PROCEDURALE

A. Apeli

1. Përbërja e Dhomës së Apelit

1. Më 8 mars 2011, Kryetari i atëhershëm i Tribunalit, gjykatësi Patrick Robinson, caktoi gjykatësin Mehmet Güney, gjykatësin Fausto Pocar, gjykatësin Liu Daqun, gjykatësen Andréia Vaz, dhe gjykatësin Carmel Agius në përbërje të Dhomës së Apelit në këtë çështje.¹ Më 14 mars 2011, gjykatësi Carmel Agius, pas zgjedhjes si kryegjykatës në këtë çështje, caktoi veten për Gjykatës të Paraapelimit përgjegjës për fazën paraapeluese në këtë çështje.² Më 7 mars 2012, me urdhër të Kryetarit të Tribunalit, gjykatësit Theodor Meron, gjykatësja Khalida Rachid Khan u caktua që të zëvendësonte gjykatësin Fausto Pocar në këtë çështje.³ Më 27 shtator 2012, Kryetari Theodor Meron emëroi gjykatësin Patrick Robinson, ish-kryetar i Tribunalit, që të zëvendësonte gjykatësin Liu Daqun në këtë çështje.⁴ Më 19 mars 2013, me urdhër të Kryetarit, Theodor Meron, gjykatësi Tuzmukhamedov u caktua si zëvendësues i gjykatëses Andréia Vaz në këtë çështje.⁵

2. Njoftimet për Apel

2. Në përputhje me vendimin e Gjykatësit të Paraapelimit të datës 16 mars 2011, afati kohor për dorëzimin e njoftimeve për apel në këtë çështje u zgjat me 60 ditë.⁶ Rrjedhimisht, palët dorëzuan njoftimet e apelit më 24 maj 2011.⁷

3. Dosjet

3. Më 27 maj 2011, Gjorgjeviqi paraqiti mocion ku kërkonte zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e dosjes së apelit me 60 ditë dhe për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në gjithsej 60.000 fjalë.⁸ Me anë të një vendimi gojor të Gjykatësit të Paraapelimit më 30 maj 2011,⁹ afati kohor për dorëzimin e dosjeve të apelit në këtë çështje u zgjat me shtatë ditë, deri më 15 gusht 2011, për të dy palët. Lidhur me dosjen e apelit, Gjorgjeviqit iu miratua edhe tejkalim i numrit të lejuar të fjalëve me 15.000 fjalë, duke i mundësuar kështu që të dorëzonte

¹ Urdhër për Caktimin e Gjykatësve në një Çështje para. Dhomes së Apelit, 8 mars 2011

² Urdhër për Caktimin e Gjykatësit të Paraapelimit, 14 mars 2011.

³ Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje para. Dhomes së Apelit, 7 mars 2012.

⁴ Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje para. Dhomes së Apelit, 27 shtator 2012.

⁵ Urdhër për Zëvendësimin e një Gjykatësi në një Çështje para. Dhomes së Apelit, 19 mars 2013.

⁶ Vendim mbi Mocionin e Vllastimir Gjorgjeviqit për Zgjatjen e Afatit Kohor për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 16 mars 2011, f. 3.

⁷ Njoftimi për Apelin e Prokurorisë, 24 maj 2011; Njoftimi për Apelin e Vllastimir Gjorgjeviqit, 24 maj 2011.

⁸ Mocion i Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit Kohor dhe Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 27 maj 2011.

⁹ Konferencë për Gjendjen, 30 maj 2011, AT. 8.

dosjen me më së shumti 45.000 fjalë. I njëjti numër fjalësh shtesë iu miratua edhe Prokurorisë lidhur me dosjen e përgjigjes.¹⁰

4. Gjatë Konferencës për Gjendjen të mbajtur më 21 shtator 2011, Gjorgjeviqi kërkoi gojarisht zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e Dosjes së Kundërpërgjigjes për 15 ditë, dhe leje për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve me gjithsej 15.000 fjalë lidhur me këtë dosje.¹¹ Përmes një vendimi gojor të Gjykatësit të Paraapelimit, afati kohor për dorëzimin e dosjeve të kundërpërgjigjeve për të dy palët u zgjat deri më 26 tetor 2011.¹² Gjorgjeviqit iu miratua edhe kërkesa për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve me gjithsej 12.000 fjalë.¹³

5. Prokuroria dorëzoi Dosjen e Apelit më 15 gusht 2011.¹⁴ Gjorgjeviqi dorëzoi Dosjen e Përgjigjes më 26 shtator 2011.¹⁵ Prokuroria dorëzoi kundërpërgjigjen më 26 tetor 2011.¹⁶

6. Gjorgjeviqi dorëzoi Dosjen e Apelit më 15 gusht 2011.¹⁷ Prokuroria dorëzoi Dosjen e Përgjigjes më 26 shtator 2011.¹⁸ Gjorgjeviqi dorëzoi kundërpërgjigjen më 26 tetor 2011.¹⁹

4. Vendime dhe Urdhra të Tjerë

7. Më 18 tetor 2012, Gjykatësi i Paraapelimit i urdhëroi palët që të dorëzonin jo më vonë se 29 nëntor 2012 mocionet e tyre të mundshme për ndryshimin e pikave të apelit pas marrjes së përkthimit në BKS të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore.²⁰ Më 29 nëntor 2012, Gjorgjeviqi paraqiti një parashtrim ku e paralajmëroi Dhomën e Apelit për disa çështje, pa kërkuar ndryshimin e pikave të apelit.²¹

¹⁰ Konferencë për Gjendjen, 30 maj 2011, AT. 8-9.

¹¹ Konferencë për Gjendjen, 21 shtator 2011, AT. 16-17.

¹² Konferencë për Gjendjen, 21 shtator 2011, AT. 18.

¹³ Konferencë për Gjendjen, 21 shtator 2011, AT. 18.

¹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, 15 gusht 2011 (konfidenciale; versioni i redaktuar publik dorëzuar më 17 gusht 2011).

¹⁵ Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit, 26 shtator 2011 (konfidenciale; versioni i redaktuar publik dorëzuar më 30 janar 2012).

¹⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, 26 tetor 2011 (konfidenciale; versioni i redaktuar publik dorëzuar më 8 shkurt 2012).

¹⁷ Dosja e Apelit të Gjorgjeviqit, 15 gusht 2011 (konfidenciale; versioni i redaktuar publik dorëzuar më 23 janar 2012). Shih gjithashtu Burimet e Cituara në Dosjen e Apelit të Vllastimir Gjorgjeviqit, 15 gusht 2011, plotësuar më 23 janar 2014 (Shih *Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda Nr. IT-05-87/1-A, Vendim mbi Mocionin e Vllastimir Gjorgjeviqit për Dorëzimin e Listës Plotësuese të Burimeve të Cituara, 23 janar 2014).

¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, 26 shtator 2011 (konfidenciale; versioni i redaktuar publik dorëzuar më 30 janar 2012).

¹⁹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 tetor 2011 (konfidenciale; riklasifikohet si publike më 9 shkurt 2012).

²⁰ Urdhër për Caktimin e Afateve Kohore për Paraqitjen e Mocioneve për Ndryshimin e Pikave të Apelit pas Marrjes së Përkthimit të Aktgjykimit në B/K/S, 18 tetor 2012. Përkthimi në BKS i Aktgjykimit u dorëzua më 17 tetor 2012 (*Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit*, Lënda Nr. IT-05-87/1-T, *Presuda*, 17 tetor 2012 (pjesërisht konfidenciale).

²¹ Parashtrimet e Vllastimir Gjorgjeviqit pas Përkthimit të Aktgjykimit, 29 nëntor 2012. Shih gjithashtu Konferencë për Gjendjen, 5 Dhjetor 2012, AT. 42.

5. Konferencë për Gjendjen

8. Në përputhje me Rregullën 65bis(B) të Rregullores, Konferencë për Gjendjen u mbajt më: 30 maj 2011,²² 21 shtator 2011,²³ 16 janar 2012,²⁴ 11 maj 2012,²⁵ 23 gusht 2012,²⁶ 5 dhjetor 2012,²⁷ 9 prill 2013,²⁸ 17 korrik 2013,²⁹ dhe 13 nëntor 2013.³⁰

6. Seanca e Apelit

9. Më 22 mars 2013, Dhoma e Apelit lëshoi urdhër për caktimin e datës së Seancës së Apelit në këtë çështje.³¹ Më 12 prill 2013, Dhoma e Apelit lëshoi dhe *shtojcën* ku i informoi palët për disa modalitete të Seancës së Apelit dhe i ftoi që të trajtonin disa çështje konkrete.³² Seanca e Apelit u mbajt në Hagë më 13 maj 2013.

²² Urdhër për Caktim Date, 4 maj 2011; Urdhër i Ndryshuar për Caktim Date, 17 maj 2011; Konferencë për Gjendjen, 30 maj 2011, AT. 1-10.

²³ Urdhër për Caktim Date, 24 gusht 2011; Konferencë për Gjendjen, 21 shtator 2011, AT. 11-19.

²⁴ Urdhër për Caktim Date, 29 nëntor 2012; Konferencë për Gjendjen, 16 janar 2012, AT. 20-25.

²⁵ Urdhër për Caktim Date, 29 mars 2012; Konferencë për Gjendjen, 11 maj 2012, AT. 26-30.

²⁶ Urdhër për Caktim Date, 10 korrik 2012; Konferencë për Gjendjen, 23 gusht 2012, AT. 31-36.

²⁷ Urdhër për Caktim Date, 2 nëntor 2012; Shih gjithashtu Urdhër i Ndryshuar për Caktim Date, 22 nëntor 2012; Konferencë për Gjendjen, 5 dhjetor 2012, AT. 37-43.

²⁸ Urdhër për Caktim Date, 15 mars 2013; Konferencë për Gjendjen, 9 prill 2013, AT. 44-52.

²⁹ Urdhër për Caktim Date, 12 qershor 2013; Konferencë për Gjendjen 17 korrik, AT 210-215.

³⁰ Urdhër për Caktim Date, 14 tetor 2013; Konferencë për Gjendjen, 13 nëntor 2013, AT. 216-220.

³¹ Urdhër për Caktim Date, 22 mars 2013.

³² Shtojcë e Urdhrit për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit, 12 prill 2013 ("Shtojca"). Më 8 maj 2013, Dhoma e Apelit nxori urdhrin për ndryshimin e Shtojcës (Urdhër për Ndryshimin e Shtojcës së Urdhrit për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit, 8 maj 2013).

XXV. SHTOJCA B – FJALORI I TERMAVE**A. Nga jurisprudenca****1. TPNJ****ALEKSOVSKI**

Prokurori k. Zllatko Aleksovskit, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim mbi Apelin e Prokurorisë lidhur me Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999

Prokurori k. Zllatko Aleksovskit, Lënda Nr. IT-95-14/1-T, Aktgjykim, 25 qershor 1999 (“Aktgjykimi Aleksovski”)

Prokurori k. Zllatko Aleksovskit, Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000 (“Aktgjykimi i Apelit Aleksovski”)

BABIQ

Prokurori k. Millan Babiqit, Lënda Nr. IT-03-72-A, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 18 korrik 2005 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit Babiq”)

BLLAGOJEVIQ DHE JOKIQ

Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit, Lënda Nr. IT-02-60-T, Aktgjykim, 17 janar 2005 (“Aktgjykimi Bllagojeviq dhe Jokiq”)

Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit, Lënda. Nr. IT-02-60-A, Aktgjykim, 9 maj 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq”)

BLLASHKIQ

Prokurori k. Tihomir Bllashkiqit, Lënda. Nr. IT-95-14-T, Aktgjykim, 3 mars 2000 (“Aktgjykimi Bllashkiq”)

Prokurori k. Tihomir Bllashkiqit, Lënda. Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim, 29 korrik 2004 (“Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq”)

BOSHKOSKI AND TARÇULLOVSKI

Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçullovskit, Lënda Nr. IT-04-82-T, Aktgjykim, 10 korrik 2008 (“Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçullovski”)

Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçullovskit, Lënda. Nr. IT-04-82-A, Aktgjykim, 19 maj 2010 (“Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçullovski”)

BËRGJANIN

Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit, Lënda Nr. IT-99-36-AR73.10, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm, 19 mars 2004 (“Vendim i Apelit Bërgjanin i datës 19 mars 2004”)

Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit, Lënda Nr. IT-99-36-T, Aktgjykim, 1 shtator 2004 (“Aktgjykimi Bërgjanin”)

Prokurori k. Radosllav Bërgjaninit, Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin”)

DELALIQ DHE TË TJERËT (“ÇELEBIQI”)

Prokurori k. Zejnil Delalijit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-96-21-A, Aktgjykim, 20 shkurt 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Çelebici*”)

DERONJIQ

Prokurori k. Miroslav Deronjiqit, Lënda Nr. IT-02-61-A, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 20 korrik 2005 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Deronjiq*”)

GJORGJEVIQ

Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Përbashkët të Ndryshuar për Herë të Tretë, Lënda Nr. IT-05-87/1-PT, 7 korrik 2008 (“Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Ndryshimin e Aktakuzës i datës 7 korrik 2008”)

Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin si Provë të Videofilmimit MFI P1575, 30 mars 2010 (“Vendimi *Gjorgjeviq* mbi Pranimin e Provave i datës 30 mars 2010”)

ERDEMOVIQ

Prokurori k. Drazhen Erdemoviqit, Lënda Nr. IT-96-22-A, Aktgjykim, 7 tetor 1997 (“Aktgjykimi i Apelit *Erdemoviq*”)

FURUNXHIIJA

Prokurori k. Anto Furunxhisë, Lënda Nr. IT-95-17/1-T, Aktgjykim, 10 dhjetor 1998 (“Aktgjykimi *Furunxhija*”)

Prokurori k. Anto Furunxhisë, Lënda Nr. IT-95-17/1-A, Aktgjykim, 21 korrik 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*”)

GALIQ

Prokurori k. Stanisllav Galiqit, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm lidhur me Rregullën 92 bis(C), 7 qershor 2002 (“Vendimi i Apelit *Galiq* lidhur me Rregullën 92 bis(C) i datës 7 qershor 2002”)

Prokurori k. Stanisllav Galiqit, Lënda Nr. IT-98-29-A, Aktgjykim, 30 nëntor 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Galiq*”)

GOTOVINA DHE TË TJERËT

Prokurori k. Ante Gotovinës dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-06-90-T, Aktgjykim, 15 prill 2011 (“Aktgjykimi *Gotovina dhe të tjerët*”)

Prokurori k. Ante Gotovinës dhe Mlladen Markaçit, Lënda Nr. IT-06-90-A, Vendim mbi Mocionin për Përfshirje dhe Shprehje Interesi të Republikës së Kroacisë, 8 shkurt 2012

Prokurori k. Ante Gotovinës dhe Mlladen Markaçit, Lënda Nr. IT-06-90-A, Aktgjykim, 16 nëntor 2012 (“Aktgjykimi i Apelit *Gotovina dhe Markaç*”)

HAXHIHASANOVIQ DHE KUBURA

Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës, Lënda Nr. IT-01-47-A, Aktgjykim, 22 prill 2008 (“Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq dhe Kubura*”)

HALILOVIQ

Prokurori k. Sefer Haliloviqit, Lënda Nr. IT-01-48-A, Aktgjykim, 16 tetor 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*”)

HARADINAJ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008 (“Aktgjykimi *Haradinaj dhe të tjerët*”)

Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. 04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010 (“Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj dhe të tjerët*”)

JELISHIQ

Prokurori k. Goran Jelisiqit, Lënda Nr. IT-95-10-T, Aktgjykim, 14 dhjetor 1999 (“Aktgjykimi *Jelishiq*”)

Prokurori k. Goran Jelisiqit, Lënda Nr. IT-95-10-A, Aktgjykim, 5 korrik 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*”)

M. JOKIQ

Prokurori k. Miodrag Jokiqit, Lënda Nr. IT-01-42/1-A, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 30 gusht 2005 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *Jokiq*”)

KARAXHIQ

Prokurori k. Radovan Karaxhiqit, Lënda Nr. IT-95-5/18-AR72.4, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë III të NPK-së, 25 qershor 2009 (“Vendimi i Apelit *Karaxhiq* lidhur me Parashikueshmërinë sipas Kategorisë së Tretë të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, i datës 25 qershor 2009”)

Prokurori k. Radovan Karaxhiqit, Lënda Nr. IT-95-5/18-AR72.5, Vendim mbi Apelin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore lidhur me Mocionin Paraprak për Heqjen e Pikës 11 të Aktakuzës, 9 korrik 2009

KORDIQ DHE ÇERKEZ

Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit, Lënda Nr. IT-95-14/2-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2001 (“Aktgjykimi *Kordiq dhe Çerkez*”)

Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*”)

KRAJISHNIK

Prokurori k. Momçillo Krajishnikut, Lënda Nr. IT-00-39-T, Aktgjykim, 27 shtator 2006 (“Aktgjykimi *Krajishnik*”)

Prokurori k. Momçillo Krajishnikut, Lënda Nr. IT-00-39-A, Aktgjykim, 17 mars 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Krajishnik*”)

KËRNOJELAC

Prokurori k. Millorad Kërnojelacit, Lënda Nr. IT-97-25-PT, Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes lidhur me Formën e Aktakuzës, 24 shkurt 1999

Prokurori k. Millorad Kërnojelacit, Lënda Nr. IT-97-25-T, Aktgjykim, 15 mars 2002 (“Aktgjykimi *Kërnojelac*”)

Prokurori k. Millorad Kërnojelacit, Lënda Nr. IT-97-25-A, Aktgjykim, 17 shtator 2003 (“Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*”)

KËRSTIQ

Prokurori k. Radisllav Kërstiqit, Lënda Nr. IT-98-33-T, Aktgjykim, 2 gusht 2001 (“Aktgjykimi Kërstiq”)

Prokurori k. Radisllav Kërstiqit, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004 (“Aktgjykimi i Apelit Kërstiq”)

KUNARAC DHE TË TJERËT.

Prokurori k. Dragosllav Kunaracit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-96-23-A dhe IT-96-23/1-A, 12 qershor 2002 (“Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët”)

KUPRESHKIQ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-95-16-T, Aktgjykim, 14 janar 2000 (“Aktgjykimi Kupreshkiq dhe të tjerët”)

Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-95-16-A, Aktgjykimi i Apelit, 23 tetor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët”)

KVOÇKA DHE TË TJERËT

Prokurori k. Miroslav Kvoçkës dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-98-30/1-T, Aktgjykim, 2 nëntor 2001 (“Aktgjykimi Kvoçka dhe të tjerët”)

Prokurori k. Miroslav Kvoçkës dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005 (“Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët”)

LIMAJ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005 (“Aktgjykimi Limaj dhe të tjerët”)

Prokurori k. Fatmir Limajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-03-66-A, Aktgjykim, 27 shtator 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Limaj dhe të tjerët”)

LLUKIQ DHE LLUKIQ

Prokurori k. Millan Llukiqit dhe Sredoje Llukiqit, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Aktgjykim, 20 korrik 2009 (“Aktgjykimi Llukiq dhe Llukiq”)

Prokurori k. Millan Llukiqit dhe Sredoje Llukiqit, Lënda Nr. IT-98-32/1-A, Aktgjykim, 4 dhjetor 2012 (“Aktgjykimi i Apelit Llukiq dhe Llukiq”)

MARTIQ

Prokurori k. Millan Martiqit, Lënda Nr. IT-95-11-T, Aktgjykim, 12 qershor 2007 (“Aktgjykimi Martiq”)

Prokurori k. Millan Martiqit, Lënda Nr. IT-95-11-A, Aktgjykim, 8 tetor 2008 (“Aktgjykimi i Apelit Martiq”)

D. MILLOSHEVIQ

Prokurori k. Dragomir Millosheviqit, Lënda Nr. IT-98-29/1-T, Aktgjykim, 12 dhjetor 2007 (“Aktgjykimi D. Millosheviq”)

Prokurori k. Dragomir Millosheviqit, Lënda Nr. IT-98-29/1-A, Aktgjykim, 12 nëntor 2009 (“Aktgjykimi i Apelit D. Millosheviq”)

MILLUTINOVIQ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Millan Millutinoviçit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-99-37-AR72, Vendim mbi Mocionin e Dragolub Ojdaniçit për Mospranim Juridiksioni – Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale, 21 maj 2003 (“Vendimi i Apelit *Millutinoviçit dhe të tjerët* lidhur me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i datës 21 maj 2003”)

Prokurori k. Millan Millutinoviçit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-87-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2009 (“Aktgjykimi *Millutinoviçit dhe të tjerët*”)

MËRKSHIQ DHE SHLIVANÇANIN

Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-95-13/1-T, Aktgjykim, 27 shtator 2007 (“Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerët*”)

Prokurori k. Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit, Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Aktgjykim, 5 maj 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Mërkshiq dhe Shlivançanin*”)

NALETILIQ AND MARTINOVIQ

Prokurori k. Mlladen Naletiliqit, i njohur si “Tuta” dhe Vinko Martinoviçit, i njohur si “Tela”, Lënda Nr. 98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq dhe Martinoviç*”)

DRAGAN NIKOLIQ

Prokurori k. Dragan Nikoliqit, Lënda Nr. IT-94-2-A, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 4 shkurt 2005 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *D. Nikoliq*”)

MOMIR NIKOLIQ

Prokurori k. Momir Nikoliqit, Lënda Nr. IT-02-60/1-A, Aktgjykimi i Apelit të Dënimit, 8 mars 2006 (“Aktgjykimi i Apelit të Dënimit *M. Nikoliq*”)

ORIQ

Prokurori k. Naser Oriqit, Lënda Nr. IT-03-68-A, Aktgjykim, 3 korrik 2008 (“Aktgjykimi i Apelit *Oriq*”)

PERISHIQ

Prokurori k. Momçillo Perishiqit, Lënda Nr. IT-04-81-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2013 (“Aktgjykimi i Apelit *Perishiq*”)

POPOVIQ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Vujadin Popoviçit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-88-AR73.3, Vendim mbi Besueshmërinë, 1 shkurt 2008 (“Vendimi *Popoviçit mbi Besueshmërinë*”)

Prokurori k. Vujadin Popoviçit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-88-T, Aktgjykim, 10 qershor 2010 (“Aktgjykimi *Popoviçit dhe të tjerët*”)

PËRLIQ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Jadranko Përliqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim mbi Apelimet e Vendimit për Pranimin si Provë të Transkriptit të Intervistës së Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007

RAJIQ

Prokurori k. Ivica Rajiqit, i njohur si Viktor Andriq, Lënda Nr. IT-95-12-S, Aktgjykim i Dënimit, 8 maj 2006 (“Aktgjykimi i Dënimit *Rajiq*”)

SHAINOVIQ DHE TË TJERËT

Prokurori k. Shainoviqit dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-87-A, Aktgjykim, 23 janar 2014 (“Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerët*”)

SIMIQ

Prokurori k. Bllagoje Simiqit, Lënda Nr. IT-95-9-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Simiq*”)

STAKIQ

Prokurori k. Millomir Stakiqit, Lënda Nr. IT-97-24-T, Aktgjykim, 31 korrik 2003 (“Aktgjykimi *Stakiq*”)

Prokurori k. Millomir Stakiqit, Lënda Nr. IT-97-24-A, Aktgjykim, 22 mars 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*”)

STANISHIQ DHE ZHUPLANIN

Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit, Lënda Nr. IT-08-91-AR65.1, Vendim mbi Apelimin prej Miqo Stanishiqit të Vendimit lidhur me Mocionin e Tij për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 11 maj 2011

Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit, Lënda Nr. IT-08-91-T, Aktgjykim, 27 mars 2013 (“Aktgjykimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*”)

STRUGAR

Prokurori k. Pavle Strugarit, Lënda Nr. IT-01-42-T, Aktgjykim, 31 janar 2005 (“Aktgjykim *Strugar*”)

Prokurori k. Pavle Strugarit, Lënda Nr. IT-01-42-A, Aktgjykim, 17 korrik 2008 (“Aktgjykimi i Apelit *Strugar*”)

TADIQ

Prokurori k. Dushko Tadiqit, Lënda Nr. IT-94-1-AR72, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Apelim të Ndërkohshëm të Juridiksionit, 2 tetor 1995

Prokurori k. Dushko Tadiqit, Lënda Nr. IT-94-1-A, Aktgjykim, 15 korrik 1999 (“Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*”)

TOLIMIR

Prokurori k. Zdravko Tolimirit, Lënda Nr. IT-05-88/2-T, Aktgjykim, 12 dhjetor 2012 (“Aktgjykimi *Tolimir*”)

VASILEVIQ

Prokurori k. Mitar Vasileviqit, Lënda Nr. IT-98-32-A, Aktgjykim, 25 shkurt 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*”)

ZHIGIQ

Prokurori k. Zoran Zhigiqit, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim mbi Mocionin e Zoran Zhigiqit për rishikimin e Aktgjykimit të Dhomës së Apelit IT-98-30/1-A të Shqiptuar më 28 shkurt 2005”, 26 qershor 2006

2. TPNR

AKAYESU

Prokurori k. Jean-Paul Akayesu, Lënda Nr. ICTR-96-4-T, Aktgjykim, 2 shtator 1998 (“Aktgjykimi Akayesu”)

Prokurori k. Jean-Paul Akayesu, Lënda Nr. ICTR-96-4-A, Aktgjykim, 1 qershor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Akayesu”)

BAGILISHEMA

Prokurori k. Ignace Bagilishema, Lënda Nr. ICTR-95-1A-T, Aktgjykim, 7 qershor 2001 (“Aktgjykimi Bagilishema”)

Prokurori k. Ignace Bagilishema, Lënda Nr. ICTR-95-1A-A, Aktgjykim (Arsyet), 3 korrik 2002 (“Aktgjykimi i Apelit Bagilishema”)

BAGOSORA DHE TË TJERËT

Prokurori v. Théoneste Bagosora dhe të tjerëve, Lënda Nr. ICTR-98-41-AR73, Vendim mbi Apelimin e Ndërkohshëm të Aloys Ntabakuze-s mbi Aspekte Ligjore të Ngritura në Vendimin e Dhomës Gjyqësore I të datës 29 qershor 2006 lidhur me Mocionin për Përjashtimin e Provave, 18 shtator 2006 (“Vendimi Bagosora më 18 shtator 2006”)

Théoneste Bagosora dhe Nsengiyumva k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-98-41-A, Aktgjykim, 14 dhjetor 2011 (“Aktgjykimi i Apelit Bagosora dhe Nsengiyumva”)

BIKINDI

Simon Bikindi k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-72-A, Aktgjykim, 18 mars 2010 (“Aktgjykimi i Apelit Bikindi”)

GACUMBITSI

Sylvestre Gacumbitsi k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-2001-64-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006 (“Aktgjykimi i Apelit Gacumbitsi”)

GATETE

Jean-Baptiste Gatete k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-00-61-A, Aktgjykim, 9 tetor 2012 (“Aktgjykimi i Apelit Gatete”)

KAJELIJELI

Juvénal Kajelijeli k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-98-44A-A, Aktgjykim, 23 maj 2005 (“Aktgjykimi i Apelit Kajelijeli”)

KALIMANZIRA

Callixte Kalimanzira k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-05-88-A, Aktgjykim, 20 tetor 2010 (“Aktgjykimi i Apelit Kalimanzira”)

KAMUHANDA

Jean de Dieu Kamuhanda k. Prokurorit, ICTR-99-54A-A, Aktgjykim, 19 shtator 2005 (“Aktgjykimi i Apelit Kamuhanda”)

KAREMERA DHE TË TJERËT

Edouard Karemera dhe të tjerët k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-98-44-AR72.5 dhe ICTR-98-44-AR72.6, Vendim mbi Apelimet lidhur me Juridiksionin: Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale, 12 prill 2006

KARERA

François Karera k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-74-A, Aktgjykim, 2 shkurt 2009 (“Aktgjykimi i Apelit Karera”)

KAYISHEMA DHE RUZINDANA

Prokurori k. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana, Lënda Nr. ICTR-95-1-T, Aktgjykim, 21 maj 1999 (“Aktgjykimi Kayishema dhe Ruzindana”)

Prokurori k. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana, Lënda Nr. ICTR-95-1-A, Aktgjykim (Arsyet), 1 qershor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Kayishema dhe Ruzindana”)

MUGENZI AND MUGIRANEZA

Justin Mugenzi dhe Prosper Mugiraneza k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-99-50-A, Aktgjykim, 4 shkurt 2013 (“Aktgjykimi i Apelit Mugenzi dhe Mugiraneza”)

MUHIMANA

Prokurori k. Mikaeli Muhimana, Lënda Nr. ICTR-95-1B-T, Aktgjykim dhe Dënim, 28 prill 2005 (“Aktgjykimi Muhimana”)

Mikaeli Muhimana k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-95-1B-A, Aktgjykim, 21 maj 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Muhimana”)

MUNYAKAZI

Prokurori k. Yussuf Munyai, Lënda Nr. ICTR-97-36A-A, Aktgjykim, 28 shtator 2011 (“Aktgjykimi i Apelit Munyai”)

MUVUNYI

Tharcisse Muvunyi k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-00-55A-AR73, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë lidhur me Vendimin e Dhomës Gjyqësore II të Datës 23 shkurt 2005, 12 maj 2005 (“Vendimi Muvunyi”)

Tharcisse Muvunyi k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-2000-55A-A, Aktgjykim, 29 gusht 2008 (“Aktgjykimi i Apelit Muvunyi I”)

Tharcisse Muvunyi k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-00-55A-A, Aktgjykim, 1 prill 2011 (“Aktgjykimi i Apelit Muvunyi II”)

MUSEMA

Prokurori k. Alfred Musema, Lënda Nr. ICTR-96-13-T, Aktgjykimi, 27 janar 2000 (“Aktgjykimi Musema”)

Alfred Musema k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-96-13-A, Aktgjykim, 16 nëntor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Musema”)

NAHIMANA DHE TË TJERËT

Ferdinand Nahimana, Jean-Bosco Barayagwiza, Hassan Ngeze k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-99-52-A, Aktgjykim, 28 nëntor 2007 (“Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerët”)

NCHAMIHIGO

Siméon Nchamihigo k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-63-A, Aktgjykim, 18 mars 2010 (“Aktgjykimi i Apelit Nchamihigo”)

NDAHIMANA

Grégoire Ndahimana k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-68-A, Aktgjykim, 16 dhjetor 2013
 (“Aktgjykimi i Apelit *Ndahimana*”)

NDINDABAHIZI

Prokurori k. Emmanuel Ndindabahizi, Lënda Nr. ICTR-01-71-A, Aktgjykim, 16 janar 2007
 (“Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*”)

NIYTEGEKA

Prokurori k. Eliézer Niyitegeka, Lënda Nr. ICTR-96-14-A, Aktgjykim, 9 korrik 2004
 (“Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*”)

NTABAKUZE

Prokurori k. Aloys Ntabakuze, Lënda Nr. ICTR-98-41A-A, Aktgjykim, 8 maj 2012
 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntabakuze*”)

NTAGERURA DHE TË TJERËT

Prokurori k. André Ntagerura, Emmanuel Bagambiki, dhe Samuel Imanishimwe, Lënda Nr. ICTR-99-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*”)

NTAKIRUTIMANA AND NTAKIRUTIMANA

Prokurori k. Elizaphan Ntakirutimana dhe Gérard Ntakirutimana, Lënda Nr. ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A, Aktgjykim, 13 dhjetor 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*”)

RENZAHO

Prokurori k. Tharcisse Renzaho, Lënda Nr. ICTR-97-31-A, Aktgjykim, 1 prill 2011
 (“Aktgjykimi i Apelit *Renzaho*”)

RUKUNDO

Emmanuel Rukundo k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-2001-70-A, Aktgjykim, 20 tetor 2010
 (“Aktgjykimi i Apelit *Rukundo*”)

RUTAGANDA

Prokurori k. Georges Anderson Nderubumwe Rutaganda, Lënda Nr. ICTR-96-3-T, Aktgjykim, 6 dhjetor 1999 (“Aktgjykimi *Rutaganda*”)

Georges Anderson Nderubumwe Rutaganda k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-96-3-A, Aktgjykim, 26 maj 2003 (“Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*”)

RWAMAKUBA

André Rwamakuba k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-98-44-AR72.4, Vendim mbi Apelin e Përkohshëm lidhur me Zbatueshmërinë e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale në Krimin e Gjenocidit, 22 tetor 2004 (“Vendimi i Apelit *Rwamakuba* mbi Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale i datës 22 tetor 2004”)

SEMANZA

Laurent Semanza k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Vendim, 31 maj 2000

Prokurori k. Laurent Semanza, Lënda Nr. ICTR-97-20-T, Aktgjykim dhe Dënim, 15 maj 2003
 (“Aktgjykimi *Semanza*”)

Laurent Semanza k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Aktgjykim, 20 maj 2005
 (“Aktgjykimi i Apelit *Semanza*”)

SEROMBA

Prokurori k. Athanase Seromba, Lënda Nr. ICTR-01-66-A, Aktgjykim, 12 mars 2008 (“Aktgjykimi i Apelit *Seromba*”)

SETAKO

Ephrem Setako k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-04-81-A, Aktgjykim 28 shtator 2011 (“Aktgjykimi i Apelit *Setako*”)

SIMBA

Aloys Simba k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-76-A, Aktgjykim, 27 nëntor 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Simba*”)

ZIGIRANYIRAZO

Protais Zigiranyirazo k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-01-73-A, Aktgjykim, 16 nëntor 2009 (“Aktgjykimi i Apelit *Zigiranyirazo*”)

3. Vendime lidhur me krime të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore

Trial of Erich Heyer and Six Others, British Military Court for the Trial of War Criminals, Essen, 18th-19th and 21st-22nd December, 1945, Law Reports of Trials of War Criminals, UNWCC, vol. I, Case No. 8 (“*Essen Lynching case*”)

The United States of America v. Kurt Goebell et al., Records of United States Army War Crimes Trials, February 6 – March 21, 1946, National Archives Microfilm Publications M1103, (Washington: 1980) (“*Borkum Island case*”)

The United States of America, the French Republic, the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland, and the Union of Soviet Socialist Republics against Herman Wilhelm Göring et al., Judgement, 1 October 1946, Trial of Major War Criminals Before the International Military Tribunal Under Control Council Law No. 10, Vol. 1 (1947) (“*IMT Judgement*”)

The United States of America v. Alstoetter et al., U.S. Military Tribunal, Judgement, 3 and 4 December 1947, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10 (1951), Vol. III (“*Justice case*”)

The United States of America v. Greifelt et al., U.S. Military Tribunal, Judgement, 10 March 1948, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10 (1951), Vol. V (“*RuSHA case*”)

The United States of America v. Otto Ohlenforf et al., U.S. Military Tribunal, Judgement, 8 and 9 April 1948, Trials of War Criminals Before the Nuernberg Military Tribunals Under Control Council Law No. 10, Vol. IV (“*Einsatzgruppen case*” and “*Einsatzgruppen Judgement*”)

Review of Proceedings of General Military Court in the case of *United States vs. Martin Gottfried Weiss et al.* of the Recommendation of the Staff Judge Advocate (“*Weiss et al. case*”)

Decision of the Supreme Court for the British Zone against *Sch. et al.*, 20 April 1949, *Entscheidungen des Obersten Gerichtshofes für die Britische Zone, Entscheidungen in Strafsachen*, Walter de Gruyter & Co. (Berlin: 1950), vol. 2 (“*Sch. et al. case*”)

4. GJPN

Prosecutor v. Jean-Pierre Bemba Gombo, Case No. ICC-01/05-01/08, Decision Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Bemba Gombo, 15 June 2009/*Prokurori k. Jean-Pierre Bemba Gombo*, Lënda Nr. ICC-01/05-01/08, Vendim sipas Nenit 61(7)(a) dhe (b) të Statutit të Romës mbi Akuzat e Prokurorisë kundër Jean-Pierre Bemba Gombo, 15 qershor 2009

Prosecutor v. Omar Hassan Ahmad Al Bashir, Case No. ICC-02/05-01/09, Decision on the Prosecution's Application for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir, 4 March 2009/*Prokurori k. Omar Hassan Ahmad Al Bashir*, Lënda Nr. ICC-02/05-01/09, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Fletarrestim kundër Omar Hassan Ahmad Al Bashir, 4 mars 2009

Prosecutor v. Germain Katanga and Mathieu Ngudjolo, Case No. ICC-01/04-01/07, Decision on the Confirmation of Charges, 30 September 2008/*Prokurori k. Germain Katanga dhe Mathieu Ngudjolo*, Lënda Nr. ICC-01/04-01/07, Vendim mbi Konfirmimin e Akuzave, 30 shtator 2008

Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo, Case No. ICC-01/04-01/06, Decision on the Confirmation of Charges, 29 January 2007 (“*Lubanga Decision on Confirmation of Charges*”)/*Prokurori k. Thomas Lubanga Dyilo*, Lënda Nr. ICC-01/04-01/06, Vendim mbi Konfirmimin e Akuzave, 29 janar 2007 (“Vendimi *Lubanga* mbi Konfirmimin e Akuzave”)

5. TSL

The Prosecutor v. Salim Jamil Ayyash et al., Case No. STL-11-01/I/AC/R176bis, Interlocutory Decision on the Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging, 16 February 2011 (“*STL Decision of 16 February 2011*”)/*Prokurori k. Salim Jamil Ayyash dhe të tjerëve*, Lënda Nr. STL-11-01/I/AC/R176bis, Vendim i Ndërkohshëm lidhur me Ligjin Përkatës: Terrorizëm, Konspiracion, Vrasje, Kryerje, Akuza të Shumëfishta, 16 shkurt 2011 (“Vendimi i GJSL-së i datës 16 shkurt 2011”)

6. ECCC

Prosecutor v. Ieng Thirith et al. (Case 002), Case File: 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ (PTC38), Decision on the Appeals Against the Co-Investigative Judges Order on Joint Criminal Enterprise (JCE), 20 May 2010 (“*ECCC Decision on Joint Criminal Enterprise of 20 May 2010*”)

Prosecutor v. Guek Eav Kaing alias “Duch”, Case Case File: 001/18-07-2007/ECCC/TC, Trial Judgement, 26 July 2010 (“*Duch Trial Judgement*”)

7. GJND

North Sea Continental Shelf cases, ICJ, Judgement, 20 February 1969, ICJ Reports 1969

8. Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut

Cyprus v. Turkey, European Commission of Human Rights, European Human Rights Reports, Vol. 4 (1982), pp 482-528 (“*Cyprus v. Turkey case*”)

9. Nga jurisprudenca e shteteve(a) Australi

Ivan Timofeyevich Polyukhovich v The Commonwealth of Australia and Anor, (1991) 172 CLR 501 (“*Polyukhovich case*”)

(b) Izrael

Israel v. Adolph Eichmann, District Court of Jerusalem, Judgement of 12 December 1961, 36 *International Law Reports* 5

B. Burime të tjera1. Botime

A. Cassese, “The Proper Limits of Individual Responsibility under the Doctrine of Joint Criminal Enterprise”, *Journal of International Criminal Justice*, vol. 5 (2007), pp 109-133

R. Cryer / H. Friman / D. Robinson / E. Wilmschurst, *An Introduction to International Criminal Law and Procedure* (Cambridge University Press 2007)

P.L. Fanflik, *Victim Responses to Sexual Assault: Counter-Intuitive or Simply Adaptive* (National District Attorneys Association American Prosecutors Research Institute, Special Topic Series, Aug 2007)

Robert. H. Jackson, *Report of Robert H. Jackson, United States Representative to International Conference on Military Trials* (U.S. Department of State, 1949) (“*Jackson Report*”)

J.S. Martinez / A.M. Danner, “Guilty Associations: Joint Criminal Enterprise, Command Responsibility, and the Development of International Criminal Law”, 93 *California Law Review* 75 (2005)

H. Olásolo, *The Criminal Responsibility of Senior Political and Military Leaders as Principals to International Crimes* (Hart Publishing, 2009)

S.G. Smith, “The Process and Meaning of Sexual Assault Disclosure”, *Psychology Dissertation*, paper 7 (2005)

K.G. Weiss, “Too ashamed to report: Deconstructing the shame of sexual victimization”, *Feminist Criminology*, Vol. 5(3) (July 2010)

2. Dokumente të tjera

Merriam-Webster Dictionary Online, Unabridged (Merriam-Webster, Incorporated, 2013)

Report of the International Law Commission on the work of its 43rd Session, 29 April-19 July 1991, General Assembly Official Records, 46th Session, Supplement No. 10, U.N. Doc. A/46/10 (1991) (“1991 ILC Report”)

Report of the International Law Commission on the work of its 48th Session, 6 May-26 July 1996, General Assembly Official Records, 51st Session, Supplement No. 10, U.N. Doc. A/51/10 (1996) (“1996 ILC Report”)

Oxford English Dictionary Online (Oxford University Press, 2013)

Lista e termave të përkufizuara dhe shkurtesave

Sipas Rregullës 2(B) të Rregullores, gjinia mashkullore përfshin femëroren dhe njëjësi shumësin, dhe anasjelltas.

Aktakuza	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1-PT, Aktakuza e Ndryshuar për të Katërtën Herë, 9 korrik 2008</i>
Aktgjykimi	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1-A, Aktgjykimi i Apelit, 27 janar 2014</i>
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Aktgjykimi Publik me Shtojcën Konfidenciale, 23 shkurt 2011</i>
Apeli i Gjorgjeviqit	<i>Njoftimi për Apel dhe Dosja e Apelit e Vllastimir Gjorgjeviqit së bashku</i>
Apeli i Prokurorisë	<i>Njoftimi për Apel dhe Dosja e Apelit të Prokurorisë së bashku</i>
APJ	<i>Armata Popullore e Jugosllavisë (Jugoslovenska Narodna Armija)</i>
AT.	<i>Transkripti i seancës së apelit të kësaj çështjeje.</i> <i>Të gjitha faqet e transkriptit të përmendura në këtë Aktgjykim janë marrë nga versioni i pakorrigjuar i transkriptit. Si rrjedhojë, mund të ekzistojnë dallime të vogla në faqosje midis këtij versioni dhe transkriptit përfundimtar publik.</i>
DHN	<i>E Drejta Humanitare Ndërkombëtare</i>
Dhoma e Apelit	<i>Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991</i>
Dhoma Gjyqësore	<i>Trupi Gjyqësor i Dhomës Gjyqësore II të Tribunalit i cilit iu caktua çështja Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit, Lënda Nr. IT-05-87/1</i>
Direktiva për Operacionin Grom-3	<i>Direktivë e UJ-së e datës 16 janar 1999, e nënshkruar nga Dragolub Ojdaniqi</i>
Dosja e Apelit të Vllastimir Gjorgjeviqit	<i>Dosja e Apelit të Vllastimir Gjorgjeviqit, 15 gusht 2011 (konfidenciale; versioni publik i redaktuar dorëzuar më 23 janar 2012)</i>
Dosja e Apelit të Prokurorisë	<i>Dosja e Apelit të Prokurorisë, 15 gusht 2011 (konfidenciale; versioni publik i redaktuar dorëzuar më 17 gusht 2011)</i>
Dosja e Kundërpërgjigjes së Gjorgjeviqit	<i>Dosja e Kundërpërgjigjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 tetor 2011 (konfidenciale; njoftimi për ndryshimin e statusit konfidencial në publik paraqitur më 9 shkurt 2012)</i>
Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë	<i>Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, 26 tetor 2011 (konfidenciale; versioni publik i redaktuar dorëzuar më 8 shkurt 2012)</i>
Dosja e Përgjigjes së Gjorgjeviqit	<i>Dosja e Përgjigjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 shtator 2011 (konfidenciale; versioni publik i redaktuar dorëzuar më 30 janar 2012)</i>

Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë	Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, 26 shtator 2011 (konfidenciale; versioni publik i redaktuar dorëzuar më 30 janar 2012)
Dosja Paragjyqësore e Gjorgjeviqit	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit</i> , Lënda Nr. IT-05-87/1-PT, Dosja Paragjyqësore e Vllastimir Gjorgjeviqit sipas Rregullës 65iter(F), 22 shtator 2008
Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit</i> , Lënda Nr. IT-05-87/1-PT, Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, 1 shtator 2008
Dosja Përfundimtare e Gjorgjeviqit	<i>Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviqit</i> , Lënda Nr. IT-05-87/1-T, Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Vllastimir Gjorgjeviqit, 30 qershor 2010
DPB	Dega e Punëve të Brendshme
ECCC	Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias
Forcat serbe	Forcat e RFJ-së, në veçanti forcat e UJ-së, ose forcat e Republikës së Serbisë, në veçanti forcat e MPB-së, apo kombinim i këtyre forcave
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
Gjorgjeviq	Vllastimir Gjorgjeviq, apeluesi
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
Grupi i Punës	Grupi i punës i krijuar në maj 2001 për hetimin e akuzave në lidhje me një kamion frigorifer të ngarkuar me kufoma, i gjetur në Danub më 1999.
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
JSO	Njësitë për Operacione të Posaçme të MPB-së (<i>Jedinica za Specijalne Operacije</i>)
Karta e TUN-së	Karta e Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar, <i>Marrëveshje për Ndjekjen Penale dhe Ndëshkimin e Kriminelëve të Mëdhenj të Luftës e Boshtit Evropian (Marrëveshja e Londrës)</i> , 8 gusht 1945, 58 Stat. 1544, E.A.S. No. 472, 82 U.N.T.S. 280
KiM	Kosova dhe Metohija (<i>Kosova i Metohije</i>)
Kodi Penal i RSFJ-së	Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë
Kolegjiumi Ministror	Organ i përbërë nga Ministri i MPB-së dhe shefat e administratave të RJB-së
Komanda e Përbashkët	Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë
Konventa e Gjenevës III	Konventa e Gjenevës III për Trajtimin e Robërve të Luftës e 12 gushtit 1949, 75 U.N.T.S. 135
Konventa e Gjenevës IV	Konventa e Gjenevës IV për Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Luftë e 12 gushtit 1949, 75 U.N.T.S. 287
Konventat e Gjenevës	Konventat e Gjenevës I- IV të 12 gushtit 1949
Mbrojtja	Avokatët e Vllastimir Gjorgjeviqit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë (<i>Ministarstvo Unutrasnjih Poslova</i>)
MT	Mbrojtja Territoriale (<i>Teritorijalna odbrana</i>)

MVK	Misioni Verifikues për Kosovën
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
Njoftimi për Apel i Gjorgjeviqit	Njoftimi për Apel i Vllastimir Gjorgjeviqit, 24 maj 2011
Njoftimi për Apel i Prokurorisë	Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 24 maj 2011
NPK	Ndërmarrja e përbashkët kriminale me qëllimin e ndryshimit të përbërjes etnike të Kosovës, për të siguruar kontrollin serb mbi krahinën përmes një fushate terrori kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës.
PJP	Njësitë e Posaçme Policore (<i>Posebne Jedinice Policije</i>)
Plani për Shtypjen e Terrorizmit	Plan i RFJ-së për zbrapsjen e veprimeve të UÇK-së në Kosovë, miratuar në korrik 1998
Prokuroria	Zyra e Prokurorit të Tribunalit
Protokolli Shtesë I	Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokolli Shtesë I), 8 qershor 1977, 1125 U.N.T.S. 3
Protokolli Shtesë II	Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II), 8 qershor 1977, 1125 U.N.T.S. 609
RDB	Drejtoria e Sigurimit Shtetëror e MPB-së (<i>Resor Državne Bezbednosti</i>)
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RJB	Drejtoria e Sigurimit Publik e MPB-së (<i>Resor Javne Bezbednosti</i>)
RPO	Detashment Policor Rezervist (<i>Rezervni Policijski Odred</i>)
Rregullorja	Rregullorja e Procedurës dhe Provave e Tribunalit
SAJ	Njësi e Posaçme Kundërterroriste (<i>Specijalna Antiteroristička Jedinica</i>)
SAO	Krahina Autonome Serbe (<i>Srpska autonomna oblast</i>)
sh.	Shënim (shënime)
Shënimet e Grupit të Punës	Shënime Zyrtare nga intervistat, të përpiluara nga Grupi i Punës
Shtabi Ministror	Shtabi Ministror për Shtypjen e Terrorizmit
SPB	Sekretariati i Punëve të Brendshme (<i>Sekretarijat Unutrasnjih Poslova</i>)
Statuti	Statuti i Tribunalit
Statuti i GJPN-së	Statuti i GJPN-së
Statuti i TPNJ-së	Statuti i TPNJ-së
Statuti i TPNR-së	Statuti i TPNR-së

T.	Transkripti i seancave gjyqësore të kësaj çështjeje
TPNJ	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
TPNR	Tribunali Penal për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe Qytetarëve Ruandezë Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të tjera të Ngjashme të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje, nga 1 janari 1994 deri më 31 dhjetor 1994
Tribunali	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
TSL	Gjykata Speciale për Libanin
TUN	Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar i Nyrenbergut për Gjykimin e Drejtë dhe të Shpejtë dhe Ndëshkimin e Kriminelëve të Mëdhenj të Luftës të Fuqive të Boshtit Evropian, themeluar më 8 gusht 1945
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UJ	Ushtria e Jugosllavisë (<i>Vojska Jugosllavije</i>)
Vendimi i Ministrit	Prova Materiale P57 (vendim i Ministrit të Punëve të Brendshme, Vllajko Stojilkoviçit, i datës 16 qershor 1998 për ngritjen e “Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit”)
ZPZHML	Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë